



Imam Xhafer Sadiku (paqja çoftë mbi të!)..... *Muhamed Husejn*  
*Mudhaffar*



Imam Xhafer Sadiku (paqja qoftë mbi të!)..... *Muhamed Husejn*  
*Mudhaffar*

# **IMAM XHAFER SADIKU**

*(paqja qoftë mbi të!)*



*TIRANË, 2011*

Imam Xhafer Sadiku (paqja qoftë mbi të!)..... **Muhamed Husejn  
Mudhaffar**

**Titulli i librit: Imam Xhafer Sadiku (paqja qoftë mbi të!)**

**Autori: Eruditi Muhamed Husejn Mudhaffar**

**Recensent: Prof. Muhamed Reza Haj Khezr**

**E përktheu nga arabishtja: Haxhi Selim Stafa**

**E redaktoi: Jerida Kulla**

**E korrektoi: Vullnet Merja**

**Përkujdesja grafike: Kozeta Laperi**

**Botoi: Shoqata Flladi**

**© copyright: Shoqata Flladi**

**Libri u botua në bashkëpunim me**

**“Qendrën Ndërkombëtare të Predikimit”**

## ***PËRMBAJTJA E LIBRIT***

<b><i>ME EMRIN E ALL'LLAHUT, TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT</i></b> .....	7
<b><i>KUSHTIM</i></b> .....	10
<b><i>EHLI BEJTI</i></b> .....	11
<b><i>EMEVITËT</i></b> .....	17
<b><i>ABASITËT</i></b> .....	34
<b><i>CILI QE FAJI I EHLI BEJTIT?!</i></b> .....	44
<b><i>MEDH'HEBET DHE FRAKSIONET</i></b> .....	58
<b><i>IMAMATI</i></b> .....	96
<b><i>KUSH ËSHTË IMAM SÀDIKU?</i></b> .....	106
<b><i>SÀDIKU DHE SPROVAT</i></b> .....	137
<b><i>QËNDRIMET E SÀDIKUT MDAJ MENSÛRIT</i></b>	
<b><i>DHE SHTETARËVE TË TIJ</i></b> .....	172
<b><i>IMAM SÀDIKU NË IRAK</i></b> .....	186
<b><i>JETA E TIJ SHKENCORE</i></b> .....	198
<b><i>SI U BË MEDH'HEBI?</i></b> .....	269
<b><i>DISKUTIMET E TIJ</i></b> .....	275
<b><i>JETËSHKRIMI DHE MORALET E TIJ</i></b> .....	322

Imam Xhafer Sadiku (paqja goftë mbi tël)..... *Muhamed Husejn  
Mudhaffar*

<i>KERAMETET E TIJ</i> .....	357
<i>PËRZGJEDHJE NGA FJALA E TIJ</i> .....	387
<i>LINDJA DHE VDEKJA E TIJ</i> .....	521
<i>FËMIJËT E TIJ</i> .....	529
<i>TRANSMETUESIT E TIJ</i> .....	553
<i>TRANSMETUESIT E TIJ TË BESUESHËM, MË TË DËGJUAR, PREJ SHI'AVE</i> .....	560
<i>PËRKRAHËSIT E TIJ</i> .....	619



**ME EMRIN E ALL'LLAHUT, I GJITHËMËSHIRSHMI,  
MËSHIRPLOTI**

*Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun, Paqe e shpëtim për zotërinë tonë!, Muhammedin dhe për pjesëtarët e familjes së tij.*

*Për asnjë mysliman dhe për asnjë dijetar, madje edhe për të gjithë të tjerët, nuk është e panjohur pozita e imam Ebu Abdullah Xha'fer ibn Muhammed Sádik (paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Ai është pishtari i udhëzimit dhe fanari i fesë islame, i kësaj feje, që në kohën e tij u përhap në të gjitha anët e globit.*

*Drita e saj rrezatoi edhe skajet më të largëta të botës. Në këtë kohë, nga shkollat e Islamit dolën përcjellësit e haditheve të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!), dijetarë në fushën e hadithit dhe teologë të përgjithshëm dhe për degë të veçanta të diturive. Me gjuhët tona dhe me penat tona të pafuqishme e kemi të pamundur të njihemi me këtë personalitet të madh islam, ashtu siç e meriton të njihet ai dhe ta kuptojmë atë në thellësi e në gjerësi. Prandaj na mbetet vetëm të bëjmë një kalim të shpejtë në jetën e tij.*

*Për të gjitha këto, falënderimi është vetëm për All'llahun. Shoqata "FLLADI" ndërmoi botimin në gjuhën shqipe të librit të dijetarit shejh Muhammed Husejn Mudhaffer. Në këtë libër, shejhu i nderuar ka dhënë një studim konciz mbi jetën e imam Xha'fer Sadikut, duke përfshirë shumë anë nga jeta e tij, nga shkolla e tij shkencore,*

Imam Xhafer Sadiku (paqja goftë mbi tël)..... *Muhamed Husejn  
Mudhaffar*

*nga mësimet, nga studimet, nga fjalimet, nga thëniet dhe nga  
përcjelljet e tij të përgjithshme e të veçanta.*

*I lutemi All'llahut të Lartësuar, që ky libër të jetë i  
dobishëm për besimtarët musliman shqiptarë që të njihen sa  
më shumë me jetën dhe veprën e personaliteteve të larta të  
fesë islame. Padyshim, vetëm All'llahu e sjell mbarësinë.*

*Shoqata FLLADI*





*Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit*

*Falënderimi e lavdërimi është vetëm për All'llahun, Zotin e botëve, të Gjithëmëshirshmin, Mëshirëplotin, Sunduesin e Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty ndihmë të kërkojmë. Na udhëzo në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”*

*“All'llahu dhe engjëjt e Tij e nderojnë Profetin; O ju që keni besuar, lutuni (bini salavat) për të dhe dërgojini atij selam!”*

*“Paqe mbi familjen e JaSin-it, (profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij).”*

## **KUSHTIM**

*Zotëria im, Ebu Abdil-lah!*

*Me të dyja duart po i ngre këto faqe të shkruara shkurtimisht, për t'ia dhuruar lartësisë së sinqeritetit tënd, i vetëdijshëm se nuk jam prej atyre që kanë fuqi të ngjiten në të tilla lartësi ose të parashtroj mallin e tij në këtë treg të shtrenjtë. Por unë jam kapur fort në verigën e degëzimit të pastër dhe jam varur në degët e kësaj peme të begatë, prandaj dëshira ime është që punën e mundimin tim ta llogaris ndër ata që kanë fatin të jenë në shërbim të tyre.*

*O Zoti im! Njohja ime përfundon në fletët që unë kam ndër duar. Vetëm kaq arrin dituria ime, përfshin grumbullimin e materialit, shkrimin dhe komentimin. Vlera e çdo njeriu qëndron në atë që ai vërtet di ta bëjë, prandaj, nëse në punimin tim ka ndonjë të mirë, ajo është prej Teje dhe për Ty, nëse në të ka shterpësi, ajo është nga fodullëku i penës sime. E kush i fal më shumë se Ty shkarjet, duke e ditur që prej tyre janë të pakët ata që*

*shpëtojnë? Duke pohuar se edhe unë gaboj, nuk shpresoj gjë tjetër veç asaj që Ti, me mirësinë Tëndë, ta blesh këtë pak mall prej robit Tënd. Çmimi i mallit është vetëm pranimi. Por sa çmim i lartë që është!*

*Shërbyesi yt,  
Muhamed Husejn Mudhaffar*

### **EHLI BEJTI**

*Kush është Ehli Bejti?*

*Kur'ani i Madhëruar, nëpërmjet fjalës së tij të nderuar, na flet qartë për pozitën e Ehli Bejtit: "Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij! O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht." (Sure "El Ahzàb", ajeti 33)*

*Patjetër që ky pastrim është për virtytet e tyre të larta, të cilëve nuk mund t'u afrohet asnjë njeri.*

*Nuk ka nderim më të madh e më të dobishëm se sa largimi i ndyrësisë së mëkateve dhe pastrimi i tyre nga të gjitha të metat. Ky është pastrimi që dëshiron për ta i Buti i Lartësuar. Ky pastrim nuk është i kushtëzuar as me ndonjë ndyrësi të veçantë e as me ndonjë send të përcaktuar, pasi*

*ajeti flet për pastrim të përgjithshëm nga çdo e metë, nga çdo faj e mëkat.*

*Nga ky ajet kuptojmë se familjen e profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) janë të ruajtur nga mëkatet, pasi çdo mëkat është ndyrësi dhe bërja e mëkateve nuk mund të qëndrojë përkrah largimit të ndyrësive dhe pastrimit të tyre. Nën gjykimin e këtij ajeti. Ata janë të pastruar nga të gjitha ndyrësitë e mëkatet. A ka gjë tjetër pas kësaj ruajtjeje?*

*Po, çështja qëndron në kuptimin e këtij virtyti të lartë, me të cilin ata janë dalluar mbi të gjithë ummetin: A janë pjesëtarë të Ehli Bejtit ata që ishin në shtëpi në kohën kur ka zbritur ky ajet i nderuar apo janë të gjithë ata që kanë lidhje me të Dërguarin e All'llahut, për shkak krushqie apo afrimiteti fisnor? Nëse merret në konsideratë nocioni i dytë, realiteti dëshmon për të kundërtën dhe në kontekstin e ajetit, gratë e tij nuk janë të përfshira në qëllimin e ajetit, kurse veçimi i disa grave të tij është thjesht gjykim personal.*

*Kjo ishte për ata të afërm për shkak krushqie, ndërsa nga të afërmit e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për shkak të afrimitetit fisnor, ka nga ata që kanë kryer mëkate të rënda, madje aq të rënda, sa shkojnë deri në krime; prandaj nuk mund të jetë e vlefshme që i Larti, Fuqiploti, të Cilit nuk i mungon asgjë e që nuk ka nevojë për asgjë, të dëshirojë diçka në vullnetin e Tij të krijimit<sup>1</sup> dhe pastaj ajo gjë të mos ndodhë.*

---

<sup>1</sup> Vullneti i krijimit është ai vullnet që lidhet me veprimin e vetë qëllimvënësit dhe përballë këtij vullneti qëndron vullneti legjislativ, i cili

*Është krejtësisht e pamundur që All'llahu të vendosë krijimin e një sendi që Ai të mos e dijë. Prandaj gratë dhe të gjithë pjesëtarët e fisit Hashim nuk janë të përfshirë në qëllimin e ajetit, për shkak se ato dhe ata kanë bërë veprime, që janë në kundërshtim me pastrimin. Për më tepër, askush nuk ka thënë se gratë e Profetit dhe hashimitët në përgjithësi janë të ruajtur nga mëkatet.*

*Sikur qëllimi kryesor të ishte vullneti ligjor, atëherë nuk do të kishte vend të flitej për vullnet të pastrimit të Ehli Bejtit në veçanti, sepse i Lartësuarit e dëshiron pastrimin për të gjithë njerëzit, kurse veçimi i këtij pastrimi vetëm për Ehli Bejtin është tregues i karakteristikës së tyre dhe të virtytit me të cilin ata janë krijuar. Përveç kësaj, vullneti ligjor, në fakt, ka lidhje me veprimin e dikujt, ndërsa ai që ka lidhje në këtë ajet, është vetë All'llahu i Lartësuar. Nëse do të ishte fjala për vullnetin ligjor, patjetër që do të thoshte: "Për të larguar e për të pastruar vetveten."*

*Padyshim që ajeti ka kuptimin e parë. Dua të them se qëllimi i thënies së këtij ajeti janë njerëzit që ishin në shtëpinë e të Dërguarit të All'llahut, të cilët ai i nderoi duke i mbështjellë me rrobën e vet. Ky ajet ka zbritur pikërisht për ta dhe ata janë: Aliu, Fatimja dhe dy djemtë e tyre (Paqja qoftë mbi ta!). Këtë të vërtetë e dëshmojnë hadithet e sakta, të përcjella nga të dyja grupimet.<sup>1</sup>*

---

*lidhet me veprimin e tjetrit, me veprimin që bën dikush, ashtu siç është çështja me adhurimet e urdhëruara.*

<sup>1</sup> Referohu në "Mexhmaul Bejân" dhe në hadithet e transmetuara, si dhe në komentin e haditheve, vëll. 4, f. 356; Tefsirin e "Sheukâniut", vëll. 4, f. 270; hadithet janë transmetuar me disa rrugë prej Umm Selemes, Aishes dhe të tjerëve, si dhe ajo që Ibn Haxheri ka përmendur në "Es Sauâ'ik", f. 87, i cili është shprehur se shumica e komentuesve të Kur'ânit

*El-Àlùsiu, në tefsirin e tij “Ruhul-Me’ànij”, pasi ka përmendur hadithe të shumta, që kanë ardhur për veçantitë e atyre që Profeti (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i mbështolli me rrobën e tij, është përpjekur që në ajet të përfshijë gratë e Profetit dhe besimtarët e fisit Beni Hashim. Por ajo që ne përmendëm më sipër është më se e mjaftueshme për të mos e pranuar thënien e Àlusiut.*

*Edhe sikur të mos kishte tekst të qartë në Kur’àn, për këtë veçanti të këtij grupi të pastër, të përfshirë në këtë ajet, vetë veçantia e tyre do të ishte argumenti më i madh për të provuar këtë karakteristikë të tyre, sepse punët dhe fjalët e tyre na bëjnë ta pohojmë këtë pastërti për Ehli Bejtin.*

*Kjo e vërtetë e qartë si kristali nuk ka qenë e panjohur për ata që dinë të vështrojnë në kohën kur ka zbritur ky ajet i prerë e deri në ditët tona.*

*Mbase disa anëtarë të fisit Hashim dhe ndër ta dinastia e abasitëve, e kanë shfrytëzuar kuptimin përgjithësues të fjalës Ehli Bejt për të realizuar qëllimet e veta për kapjen e fronit. Madje të gjithë hashimitët u janë paraqitur njerëzve me këtë ajet.*

*Gjithashtu, në mënyrë përgjithësuese është shfrytëzuar edhe fjala teshejju’ (ndjekje, përkatësi) për të njohur të drejtën e sundimit të Aliut dhe të familjes së tij, në një kuptim përgjithësues dhe jo në veçanti për ata që Profeti i mbështolli nën rrobën e vet dhe të imamëve pasardhës të fëmijëve të Husejnit (Paqja qoftë mbi të!).*

---

*kanë thënë se ajeti i lartpërmendur ka zbritur për Aliun, Fatimen, Hasanin e Husejnin (Paqja qoftë mbi ta!). Të njëjtën gjë kanë thënë edhe autorë të tjerë komentesh të Kur’anit, librave të hadithit dhe historianë.*

*Kështu është për ata që nuk kanë rënë në rrjedhën e ngatërresave të mbjella nga njerëz, që nuk kanë as zemër e as mendje. Por ata nuk i bëjnë të heqin dorë nga e drejta dhe e vërteta. Në fakt, njerëzit filluan të njihen me të drejtën e pushtetit që u takon imamëve vetëm pasi kaloi çereku i parë i sundimit të shtetit abasid, atëherë kur u hoq mbulesa nga ajo heshtje që kishte mbërthyer njerëzit; ishte koha kur filloi acari i shfryrjes së revolucioneve të alevitëve (mbështetësve të Aliut). Pikërisht në atë kohë filloi të flitet hapur për Ehli Bejtin e për zotërinjtë imamë.*

*Jemi dëshmitarë se abasitët u ngjitën në fronin e pushtetit dhe kryen shkatërrimin e shtetit të emevive pa zhurmën më të vogël, duke përdorur vetëm emrin e Ehli Bejtit, me pretendimin se ishin njerëzit më të afërm të mbartësit të mesazhit të All'llahut të Madhëruar. Ata vepruan kështu për të zbutur zemrat e shi'ave (ndjekësve) të Aliut. Njëkohësisht aksionin e tyre ta merrnin për ndërtimin e shtetit të tyre dhe për të shkatërruar godinën e shtetit të emevive, të atij shteti që gjatë gjithë kohës së sundimit të tij ishte përballur me rezistencën e Ehli Bejtit e të ndjekësve të tyre, të cilët, me gjakun që derdhën, skuqën sipërfaqen e tokës.*

*Abasitët nuk do t'i bënin dot realitet shpresat e veta sikur të mos mbaheshin pas këtij pretendimi, edhe sikur të mos bënin urë kalimi për arritjen e synimeve të tyre aksionin që ndërmorën së bashku me ta ndjekësit e Ehli Bejtit, pa bërë asnjë dallim ndërmjet bijve të Abbasit, Ebu Talibit, Aliut, Xha'ferit, Ukajlit, Hasanit apo Husejnit.*

*E tillë ishte thirrja dhe ngritja e çdo hashimiu, si p.sh ngritja që bëri Abdullah ibn Muàvije ibn Abdullah ibn*

*Xha'fer në Kufe dhe pastaj në Persi. Në të dyja këto vende pati mbështetës të Ehli Bejtit, por Ebù Muslimi i vrau ata, pasi njerëzit u shpërndanë dhe u strehuan pranë tij. Njerëz si Zejdi dhe djali i tij Jahja, nuk kishin të bënë fare me ngritjen apo edhe dy vëllezërit Muhammed dhe Ibrahim, të cilët, gjithashtu, nuk kishin të bënë fare me ngritjen, u vranë. Nëse do të kërkonim arsyet e vrasjeve, mund të numëronim: ishin pjesëtarë të Ehli Bejtit, të shuanin qëllimet e larta të thirrjes dhe dëshira e madhe për të marrë trashëgiminë e Ehli Bejtit.*

*Për njerëzit u bë e qartë se abasitët nuk ishin prej Ehli Bejtit, kur ata ngritën shpatën e mizorisë mbi pjesëtarët e Ehli Bejtit dhe të afërmit e të Dërguarit të All'llahut. Njerëzit mësuuan se parullat e abasitëve për përmbysjen e shtetit të emevive nën parullën e gjakmarrjes për të vrarët e Taffit, të kryqëzuarit e Kennases dhe Xheuzexhànit e të tjerëve, ishte vetëm rrugë që ata të arrinin qëllimin që i kishin vënë vetes. Pasi abasitët ngritën kolonat e pushtetit të tyre mbi kafkat e të mashtruarve nga dashamirësit e Ehli Bejtit, doli sheshit ajo që ata mbanin fshehur në zemrat e tyre, si dhe qëllimi i tyre për të përdorur të tjerët në arritjen e synimeve që kishin. Në këto kushte, edhe Muhammedi e Ibrahimimi u fshehën nga dora e gjakatarit për t'i shpëtuar dorës së gjykimit, por ata nuk u fshehën për ndonjë shkak tjetër përveç asaj që ata dinin prej qëllimeve të këqija të tyre ndaj kujtdo që kishte afërsi me të Dërguarin e All'llahut. Dëshmi për të gjitha këto janë presioni e shtypja e ushtruar mbi Ehli Bejtin e mbi përkrahësit e tyre. Gjatë shfletimit të këtij libri do të njiheni me shumë fakte bindëse për këto që u thanë.*



\* \* \*

## EMEVITËT

### *Cilët janë emevitët?*

*Kur'ani Famëlartë shpall qartë në fjalën e tij: “(Kujto) kur Ne të thamë: “Me të vërtetë, Zoti yt, do të të mbrojë nga njerëzit!” Vizionin që ta treguam, e bëmë vetëm sprovë për njerëzit, ashtu si dhe pemën e mallkuar në Kuran. Dhe Ne i frikësojmë (paralajmërojmë) ata, por kjo vetëm u shton mohimin e madh.” (Sure “El –Isrâ”, ajeti 60)*

*Tefsiri (shkenca e komentimit të Kur'anit) na flet për shkakun e zbritjes së këtij ajeti: Profeti (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) pa në ëndërr majmunë që kërcenin mbi minberin e tij, ndërkaq Xhibrili e njoftoi se ata ishin bijtë e fisit emevi, të cilët, pasi të shtinin në dorë pushtetin, do të ngjiteshin në minberin e tij. Ata janë pema e mallkuar. Pas kësaj dhe derisa ndërroi jetë, i Dërguari i All'lahut vazhdimisht qeshte.<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> “Mexhma‘ul Bejân”, vëll. 3, f. 424; “Sherhu-n Nehxh”, vëll. 3, f. 488 dhe vëll. 2, f. 466. Në tefsirin e tij, Sheukâniu ka thënë se ata janë familja e Ebul Àsit. Për këtë ka disa transmetime hadithesh.

Në lidhje me poshtërimin e fisit emevi dhe atakimin e tyre me fjalë të rënda, ka shumë ajete të Kur'ânit. Le t'i referohemi Hâkimit në hadithin e përcjellë prej Aliut, në lidhje me ajetin: “Vallë, a nuk i sheh ata që dhuntinë e Allahut e kanë ndërruar me mohim dhe e kanë sjellë popullin e tyre në Shtëpinë e shkatërrimit?” (Sure “Ibrâhim”, ajeti 28), tek thotë: ‘Më mëkatarët e kurejshëve janë nga bijtë e Umejjes dhe bijtë e Mugires.’ Gjithashtu, në tefsirin e Ibn Xheririt (Tabariut), në lidhje me ajetin: “Luftoni në rrugën e All’llahut ashtu si duhet luftuar...” (Sure “El-Haxh”, ajeti 78), Ibn Xheriri thotë se ata, që i Larti i urdhëron të luftojnë në rrugën e Tij, janë mahzumët dhe emevitët<sup>1</sup>, etj.

I Dërguari, i drejti, besniku (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ndjek Kur’ânin e lavdishëm me fjalën e tij: «O Zoti im, mallkoji të gjithë emevitët!», si dhe thënie të tjera të ngjashme. Në mënyrë të veçantë ai ka veçuar Ebû Sufjanin dhe dy djemtë e tij, Jezidin dhe Muâvijen, pa lënë në harresë atë që është thënë prej tij për familjen e Ebûl Àsit, sidomos për Hakemin dhe djalin e tij, Mervânin.<sup>2</sup>

A e shikon se si e lavdëron Libri i qartë (Kur’âni) EHLLI BEJTIN dhe si i përmend për të keq e me sharje bijtë e Umejjes?! A mundet që i Drejti dhe i Larti t’i lavdërojnë këta kaq shumë dhe ata, të tjerët, t’i atakojë e t’i poshtërojnë deri në këtë shkallë?! I lartë është vetëm All’llahu.

<sup>1</sup>“Tefsiri i Tabariut”, vëll. 17, f. 142.

<sup>2</sup> Specialisti nuk ka nevojë për burimet, pasi ato janë të shumta. Nëse dëshiron të qëndrosh në ndonjë burim, referohu në shpjeguesin e Ibn Ebil-Xhedidit në komentuesin e ngjarjeve të kaluara, në pjesët dhe në faqet: vëll. 1, f. 361; vëll. 2, f. 106, f. 410; vëll. 4, f. 148. Gjithashtu, referohu në “El-Isti’âb” të Ibn Abdul-Berrit në lidhje me Mervânin; referoju edhe Hâkimit në hadithin e përcjellë prej Ebû Hurejres për familjen e El Àsit, Mervânit, babait dhe djemve të tij. Po kështu, mund të referohesh edhe në burime të tjera.

*Por, është fakt se bindja është ajo që e afron njeriun pranë Krijuesit dhe se mëkati e kundërshtimi i urdhrave të Tij janë ato që e largojnë robin prej Krijuesit. Në këtë kuadër, robtë e Tij të bindur gëzojnë tek Ai përkujdesjen, butësinë dhe mëshirën, kurse dënimin e Tij e meritojnë në bazë ligjore dhe në mënyrë të barabartë të gjithë ata që kundërshtojnë All'llahun dhe bëjnë mëkate. All'llahu fut në Xhennet këdo që i bindet Atij, qoftë edhe nga shtresa më e ulët e skllëvërve, ashtu siç fut në zjarrin e Xhehennemit këdo që kundërshton dhe mëkaton, edhe nëse ai është nga paria e kurejshëve.*

*Fakti që Ehli Bejti është kaq afër "vathës" së shenjtërisë dhe që i Larti u ka dhuruar këtë "dekoratë" kaq të lartë, të cilën nuk ka fatin ta ketë asnjë njeri tjetër, tregon qartë se këtë gradë e ka për devotshmërinë dhe për përvetësimin e urdhrave të All'llahut. Bijtë e fisit emevi janë larg sferës së mëshirës së Krijuesit, sa në Kur'an përmenden me fjalën "Pema e mallkuar". Gjithashtu, ata, në shumë raste, janë përfshirë në mallkimin e të Dërguarit të All'llahut dhe në shumë raste të tjera në mallkimin e tij janë veçuar disa prej tyre, për shkak se ata kanë kundërshtuar Mposhtësin e qiejve e të Tokës dhe se ata kanë vazhduar në mëkate e në kundërshtim.*

*Nëse historia nuk do të na e lexonte gradën e lartë të bindjes që kishte Ehli Bejti, si dhe shkallën e atij mëkati e kundërshtimi që treguan emevitë, do të ishte i mjaftueshëm shenjtërimi i nderuar dhe ajo fatbardhësi që na e tregon Libri i All'llahut për ta, kur zbulon gradën e lartë të bindjes e të udhëzimit që kishte Ehli Bejti. Por Libri i All'llahut zbulon edhe shkallën e kryengritjes, të kundërshtimit e të largimit që shfaqti fisi i emevive.*

*Ky konkluzion është i prekshëm në tekstet e Kur'ânit dhe në hadithet profetike, pa kërkuar ndonjë talent të mprehtë apo thellim në mendime. Nëse do të shikonim në përshkrimin e fisit të emevive para Islamit e pas tij dhe deri në rrënimin e pushtetit të tyre, do të mësonim se All'llahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me Kur'ânin e me Sunnetin e Profetit, kanë zbuluar këtë përshkrim e këtë ndërgjegje të kalbur. Madje All'llahu i Lartësuar, në dy ajete, na ka njoftuar atë që njerëzit nuk e dinin për emevitet. Ky deklaram ishte rreptësisht i ndaluar, për shkak të ndjeshmërisë që kishin përkrahësit e tyre, për shkak të punëve të ulëta e të gabuara që kishin bërë. Megjithëse Kur'âni dhe Hadithi e deklarojnë qartë këtë fakt, në ditët tona njerëzit vazhdojnë të jenë të ndarë në miq e përkrahës, në mbrojtës e pasues.*

*Me qëllim që të qetësohen zemrat për këtë të vërtetë, do të kujtojmë vetëm disa nga bëmat e rënda të emevive, për të cilat na njoftojnë faktet e besueshme të historisë.*

*Abdumenâfi la disa djem pas vdekjes, ndër të cilët Hashimin, Muttalibin, Neufelin dhe Abdushemsin. Nga të gjithë djemtë e lartpërmendur, Hashimi ishte më i mençuri dhe më i larti në virtyte, prandaj kurejshët e gjetën me vend që ai të merrte përsipër detyrën e ushqimit dhe të shpërndarjes së ujit për hanxhinjtë. Këtë detyrë e kishte mbajtur babai i tyre, Abdumenâfi. Hashimi doli pikërisht ashtu siç kishin menduar kurejshët. Për më tepër, ai shtoi mbi respektin e të atit aktin e dy udhëtimeve, udhëtimit të dimrit për në Jemen dhe udhëtimit të verës për në Sham, të cilat janë përmendur edhe në Kur'ânin Famëlartë, "Sure "Kurejsh", ajeti 2". Qëllimi i vetëm i Hashimit në kryerjen e këtyre udhëtimeve ishte që të shtonte pasurinë e*

*kurejshëve dhe më këtë pasuri të kishte mundësi të ushqente haxhinjtë. Nuk ka diskutim që kjo ishte një cilësi e lavdëruar, të cilën Hashimi e dëshironte për popullin e tij. Pra, ai kishte karakteristikat e njerëzve të mëdhenj, të cilët synojnë, që, me popullin e vet, të kryejnë vetëm punë të mëdha dhe të arrijnë shkallët më të larta të prosperitetit.*

*Për më tepër, Hashimi, me aktin e ushqimit të haxhinjve dëshironte të ishte model për popullin e tij, prandaj shpërndante me aq zemërgjerësi ushqim. Kësaj bujarie të tij i kënduan poetët.*

*Poeti thotë: “Amri i madhështive ofroi shumë supë me mish për popullin e tij,  
kur burrave të Mekës u ka ikur yndyra.”*

*Në shumë vjersha me famë, Hashimi u etiketua me këtë pseudonim. Të shumtë ishin ata që e thërrisnin Amr<sup>1</sup>. Bujaria ishte njëra nga virtytet e Hashimit, që e bëri atë zotëri të kurejshëve dhe të gjithë arabëve.*

*Vëllezërit e Hashimit u ndanë dhe kështu, Muttalibi mori anën e Hashimit, kurse Neufeli dhe Abdushemsi qëndruan së bashku. Këta dy të fundit filluan ta konkurrojnë Hashimin dhe përpiqeshin që ta parakalonin në punët e nderuara që ai bënte. Pavarësisht nga të gjitha këto, punët e tij i zvogëlonin punët e atyre të dyve. Por Hashimi, falë punëve të tij të nderuara dhe cilësive të tij të lavdëruara, ishte zotëria i bujarëve që nuk mund të mënjanohej.*

---

<sup>1</sup> Shpjeguesi i “En’Nehxh”, vëll. 3, f. 458.

*Kur vdiq Abdushemsi, djali i tij, Umejeh, u përpoq që të ndiqte Hashimin në pozitën që mbante dhe të bënte atë që nuk e bëri dot më parë babai i tij. Por ku ishte Umejeh dhe ku ishte Hashimi, për nga pikëpamja e moshës dhe e rëndësisë që kishte: Hashimi u bë zotëria i kurejshëve, për shkak të virtyteve të larta që kishte, kurse te Umjeja i ri, përveç pasurisë e fëmijëve, këto virtyte mungonin. Dihet se pasuria e fëmijët e shumtë nuk janë të mjaftueshme për të qenë zotëri i vërtetë, kur këto dy mirësi nuk janë të shoqëruara me vepra që të lartësojnë në gradat më të larta.*

*Një ditë, Umejja deshi të sfidonte e të armiqësohej me Hashimin. Kjo ishte një kuturisje, që nuk pritej prej një njeriu si ai ndaj një burri si Hashimi, megjithëse ne nuk e dimë shkakun që e bindi Hashimin për këtë lloj armiqësie të ndërsjellë, në një kohë që ai ishte i pari ndër bujarët dhe prijësi i kurejshëve. Hashimi e dinte se nuk do të ishte e largët dita kur Umejje do të mbahej me të madh para tij, ngaqë e njihnte mospërmbajtjen e Umejjes dhe shpirtin e tij të ulët, për t'u dukur ashtu siç nuk ishte në të vërtetë. Në fakt, Hashimi e braktisi Umejjen dhe e largoi prej Mekkes për dhjetë vjet, megjithëse Umejja shpresonte se Hashimi, si njeri fisnik që ishte, nuk do të përpiqej ta braktiste atë dhe, i bindur në ndershmërinë e Hashimit, filloi të thoshte se Umejja u armiqësua me të parin e "Shtëpisë së Shenjtë" dhe kështu, u kthye në vendin e vet.*

*Kur Abdulmuttalibi arriti të bëhej i njohur pas babait të tij, Hashimit dhe pas xhaxhait të vet, Muttalibit, e ngriti akoma më lart respektin e familjes së tij dhe krenarinë e prindërve të vet, sidomos kur hapi pusin e Zemzemit, për të cilin më parë kurejshët nuk kishin qenë në një mendje. Pasi ai e hapi pusin, ata filluan ta kenë smirë dhe deshën të ishin ortakë me të në nderimin e dhënies ujë haxhinjve prej ujit të këtij pusi, por ai nuk e pranoi kërkesën e tyre. Në këtë gjendje, ata kërkuan gjykim në orakullin e idhullit*

*“Hudhejl” në Sham. Gjatë rrugës për në Sham, kur panë disa veprime të jashtëzakonshme të Abdulmuttalibit, hoqën dorë nga gjykimi dhe kështu e lanë Zemzemin dhe detyrën e nderit për t’u dhënë ujë haxhinjve në dorën e Abdulmuttalibit.*

*Pikërisht, Abdulmuttalibi ishte ai që e paralajmëroi Ebrehenë, komandantin e abisinasve dhe princin që qeveriste Jemenin në emër të Nexhàshiut, mbretit të Abisinisë, kur ai erdhi nga Jemeni me një ushtri të madhe, me qëllim që të shembte Qabenë, që arabët ta bënë më pas Haxhin në Jemen. Në këtë kohë, Abdulmuttalibi nuk u largua nga shtëpia, siç bënë të gjithë kurejshët e tjerë për t’i shpëtuar dhunës së abisinasve. Kur’ani Famëlartë<sup>1</sup> na njofton se fundi i abisinasve qe shkatërrim i plotë. Atyre u ndodhi pikërisht ashtu siç i kishte paralajmëruar zotëria i vendit të bujarisë.*

*Por kurejshët, edhe për këtë nderim, që ai fitoi, e shihnin me smirë. Dihet se të virtytshmin gjithmonë e kanë smirë e zili, prandaj Umejja nuk u mjaftua vetëm me armiqësinë ndaj Hashimit, por u përpoq të konkurronte edhe Abdulmuttalibin. Umejja i kërkoi atij të bënin garë në vrap. Abdulmuttalibi e fitoi garën dhe kështu ai e robëroi Umejjen për dhjetë vjet.*

*Edhe Harbi, i biri i Umejjes, i krekosej Abdulmuttalibit me pasurinë e me familjen që kishte, por ai nuk e dinte se nderimi qëndron vetëm në virtytet e në veprat e nderuara. Harb ibn Umejja e acaroi punën aq shumë, sa i kërkoi Abdulmuttalibit armiqësimin dhe braktisjen. Qe një guxim i tejskajshëm nga ana e Ibn Umejjes, nën shtytjen e smirës e mendjemadhësisë, megjithëse ai ishte i vetëdijshtëm se nuk i gërvishte dot plakut të kurejshëve as pluhurin e trupit. Ne mendojmë se Harb ibn Umejja kishte bindjen se vetëm akti i shpalljes së*

---

<sup>1</sup> Sure “El Fil”.

*armiqësisë dhe braktisja do ta bënëin atë të ishte i dëgjuar, edhe pse atë e kishte braktisur Abdulmuttalibi, i cili çuditej me ambicien e Harbit për t'u armiqësuar me të parin e fisnikëve, punët e të cilit ishin garant për humbjen e Harbit. Prandaj një herë i është thënë atij:*

*“Babai yt është imoral dhe babai i tij i ndershëm.*

*Ishte ai që sprapsi elefantin nga vendi i shenjtë.”*

*Ky fakt është një dëshmi e pozitës që kishte Abdulmuttalibi dhe familja e tij, ashtu siç dëshmon se Harbi dhe prindërit e tij synonin të shtinin në dorë këto dy detyra nderimi, pretendonin para njerëzve të kishin pushtetin mbi Hashimin e djemtë e tij në çdo armiqësi të ndërsjellë e në çdo konkurs.*

*Nuk duhet harruar as ai që u quajt “Pakti i Fadlëve” (u quajt kështu për shkak të tre pjesëmarrësve në të me emrin Fadl ose me kuptimin: pakti i të mirëve), që është pakti më i nderuar që kanë lidhur kurejshët - madje të gjithë arabët - për të sprapsur padrejtësinë dhe për të ndihmuar të dhunuarit. Në këtë pakt ka hyrë edhe i Dërguari (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ky pakt është lidhur para Islamit, por më vonë Profeti, në lidhje me këtë pakt, ka thënë: “Nëse do të më bëhej thirrje për një të tillë, patjetër që do t'i përgjigjesha.” Sa pasuri e grabitur dhe sende të rrëmbyera janë kthyer! Shkak për këtë ishte Zubejr ibn Abdulmuttalibi. Në këtë pakt nuk hynë bijtë e Neufelit e të Abdishemsit. Dikush mund të pyesë me të drejtë për shkakun që ata nuk hynë në këtë lloj pakti: “Mos ishin shkak hashimitët apo se ai pakt ishte një virtyt i lartë? Përse?”*



*Kështu ishte gjendja e fisit emevi, nëse do të thelloheshe deri në kohën para lindjes së diellit të Islamit. Nëse do të shikosh qëndrimet e tyre pas lindjes së këtij dielli ndriçues, patjetër që do të bindeshe përse “kjo pemë” është theksuar edhe në Librin e zbritur, jo vetëm për atë që besimi i vërtetë kurrë nuk hyri në zemrat e tyre, por se ata nuk lanë rrugë e mjet për ta mbuluar këtë dritë shkëlqyese. Me këto qëllime depërtuan në të, madje duke ngritur zërin, gjoja në mbrojtje të Islamit, kur në të vërtetë synonin të shembnin godinën e tij madhështore. Nuk po përmendim punët e tyre të mynxyrshme, që nuk i pranon as mendja e as burrëria, punë që janë në kundërshtim të hapur me nderin dhe virtytin.*

*Vallë, a mund të harrojë njeriu mundimin që i ka dhënë Ebù Sufjani të Dërguarit të All'lahut para emigrimit dhe ato që ai bëri kundër tij pas emigrimit të tij: lufta e Uhudit dhe lufta e forcave të bashkuara të idhujtarëve kundër tij, ngjarja e Hudejbijes e të tjera ndodhi, të cilat historia i ka përjetësuar? Të gjitha këto japin një njoftim të mjaftueshëm se cili ishte Ebù Sufjani dhe pjesëtarët e tjerë të fisit të tij, të cilët e kanë shoqëruar atë në të gjitha fushatat kundër të Dërguarit të All'lahut. Si mund të harrojë myslimani këto ndodhi, që historia i përmend në çdo kohë?! A ka njeri që nuk e di se Ebù Sufjani dhe djali i tij Muàvija e pranuan Islamin vetëm atëherë kur Islami i kishte mbërthyer ata dhe po u zinte frymën? Ata e pranuan Islamin, pasi nuk gjetën ndonjë shteg që të iknin prej tij. Megjithëkëtë, i urti, Profeti i Islamit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) pas çlirimit të Mekkës edhe këta i trajtoi me dashamirësi të madhe, madje u dhuroi shumë nga plaçka që u realizua në luftën e*

*Hunejnit. Megjithëkëtë, ambicia i shkoi në ndihmë frikës për këtë ndryshim, kurse në zemrat e tyre qëndronin të palosura veset e vjetra: smira, urrejtja dhe pritja e rastit për të shtënë në dorë trashëgiminë e bijve, dajallarëve dhe gjyshërve, të cilët kishin rënë nën tehun e mprehtë të shpatave islame.*

*Ebù Sufjani nuk u përpoq ta mbante të fshehur këtë urrejtje e smirë të madhe, e cila dilte nga anët e gjuhës së tij, sidomos gjatë kohës së sundimit të Osmanit,<sup>1</sup> kur ai kishte siguri se nuk do të dënohej për fjalët që thoshte, sepse ai, që ka siguri se nuk dënohet, ka edukatë e sjellje të keqe. Ebù Sufjani ndihej i siguruar, edhe atëherë kur shkemoi me këmbën e tij varrin e Hamza ibn Abdulmuttalibit, pasi, sipas shprehjes së tij, pushtetin e kishin në dorë djemtë e tij.*

*Edhe djali i Ebù Sufjanit, Muàvija,<sup>2</sup> u fut në Islam vetëm atëherë kur pa se Islami po gjente terren në të gjithë vendin, kur Islami po forconte bazat e veta dhe degët e tij po lulëzonin. Pikërisht në këtë kohë Muàvija u fut në Islam, me qëllim që ta shkulte Islamin nga rrënjët. Në fakt, kur Muàvija vuri nën sundimin e tij pjesën më të madhe të*

<sup>1</sup> "El Egànij", vëll. 6, f. 90-96.

<sup>2</sup> Për Muàvijen janë transmetuar shumë hadithe të Profetit (a.s). Nëse ke dëshirë të njihesh me disa nga këto hadithe, po sjellim hadithet që flasin në vetën e dytë: "O Ammâr, ty do të të vrasë grupi anarkist në Siffin". Këtë hadith Sujuti u ka vënë në shkallën e njoftimeve muteuâtir. Nga ky grup hadithesh kemi edhe hadithin vijues: "Në të vërtetë Aliu do të bëjë luftë me ata që kanë hequr dorë nga e drejta dhe këta janë Muàvija dhe ushtria e tij". Gjithashtu,, mund të referohesh edhe në "Sherhu Nehxhul Belaga": vëll. 1, f. 347; vëll. 3, f. 443; vëll. 1, f 254; vëll. 2, f. 363; vëll. 2, f. 102; vëll. 1, f. 372, 361, 355, 373, dhe 113. Gjithashtu, referohu në "Mendimet e njerëzve për Muàvijen" vëll. 1, f. 463. Lexo në këtë libër edhe atë që thonë njerëzit për Muàvijen e për fisin emevi, si dhe vëll. 3, f. 15 dhe në vëll. 4, f. 192 të librit "El Istij'âb" në lidhje me Muàvijen.

*vendit, Islami njohu tkurrje të re, sepse ai kundërshtoi të gjitha ligjet islame dhe nëpërkëmbi të gjitha dispozitat e Islamit. Megjithëkëtë, ai asnjëherë nuk e hoqi rrobën e jashtme të Islamit. Si do ta flakte ai këtë veshje, që e kishte përdorur si mjet për të arritur këtë sundim mbi treva pa anë e pa fund, sundim të cilin nuk e kishin ëndërruar as Sahr ibn Harbi, madje nuk e kishte ëndërruar as vetë Umejja para këtij të fundit?! Paraqitja e jashtme islame nuk i sillte asnjë dëm Muàvijes, përkundrazi, ajo i shërbente atij për të livadhisur lirshëm në pronat e tij të gjera dhe në të njëjtën kohë, nën këtë paraqitje të jashtme islame ai punonte për të shkatërruar kolonat e ndritura të Islamit.*

*Mjafton lufta që ai bëri kundër Prijësit të Besimtarëve për të kuptuar se Muàvija ka luftuar vetë të Dërguarin e All'llahut, i cili i ka thënë Prijësit të Besimtarëve, Aliut: "Paqja jote është paqja ime dhe lufta jote është lufta ime."<sup>1</sup> Gjithashtu, Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Pas meje ti do të bësh luftë me ata që thyejnë besën, me ata që kanë hequr dorë nga e drejta dhe me ata që kanë dalë nga feja."<sup>2</sup>*

*Fjala ishte për luftën e emevive kundër Ebù Hasanit (Aliut) (Paqja qoftë mbi të!) kur kërkesa e tyre për vrasësit e Osmanit erdhi tek ai. Në atë kohë njerëzve u ishin errësuar zemrat, por unë nuk e kuptoj se si mund të ishte Muàvija personi që kishte në dorë gjakun e Osmanit, në një kohë kur Aliu ishte Prijësi i Besimtarëve dhe i pari i tyre!*

*Për hir të së vërtetës, duhet thënë se Muàvija qëllimet e veta i maskonte pas lajkave. Për këtë ne sjellim dëshmi: Sikur ai të mos luftonte Islamin e të Dërguarin e*

<sup>1</sup>"Musnedi" i Ahmed ibn Hanbelit, vëll. 2, 442 dhe "Usudul Gàbeh", vëll. 3, f. 11.

<sup>2</sup>"Meànil Akhbàr", f. 204; "Suneni" i Ibn Mâxhes., vëll. 8, f. 395.

*Islamit, ai nuk do të kishte mprehur shpatën për të zhdukur familjen e të Dërguarit të All'llahut, në një kohë që Kur'ani i Lartësuar flet hapur për respekt e për dashuri ndaj pjesëtarëve të kësaj familjeje. Edhe vetë i Dërguari i All'llahut bën thirrje që sundimi t'u jepet atyre dhe njerëzit të mbahen me ta. I vetmi faj i tyre, në sytë e Muàvijes, ishte se ata ishin njerëzit më të dashur të Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe ishin më të afërmit e familjes së tij, ishin ruajtësit e fesë dhe thirrës në fe. Nëse Muàvija do t'i kishte përqaftuar ata ose do të ishte treguar tolerant ndaj tyre, kurrë nuk do të kishte arritur të vinte nën zotërimin e vet aq shumë prona, krah të qenit kryetar shteti. Qëllimi kryesor i tij ishte të luftonte të Dërguarin dhe ligjin e fesë së tij.<sup>1</sup>*

*Muàvija nuk do të vdiste pa plotësuar maksimumin e dëshirave të tij në luftën kundër të Dërguarit dhe mesazhit që ai kumtoi, derisa këtë problem t'ia afronte djalit të tij, Jezidit. Fatkeqësisht Jezidi nuk kishte mprehtësinë dhe zgjuarsinë e babait të tij, Muàvijes, i cili e fuste helmin në gjalpë për të ngritur kurthe kundër Islamit. Më pas qëllimet e veprimeve të tij u bënë të qarta dhe dolën sheshit pa asnjë lloj veshjeje, sidomos kur ai u vërsul mbi Husejnin, nipin e të Dërguarit të All'llahut, që ishte borziloku i tij dhe zotëria i të rinjve prej banorëve të Xhennetit.*

*Veç kësaj, Husejini dhe njerëzit e familjes jo vetëm që ishin të pajisur me virtytet më të larta, por punonin sinqerisht për pajtim e përmirësim. Ende nuk kishte rënë*

---

<sup>1</sup> "Sherhu Nehxh", vëll. 1, f. 463 dhe "Murùxhu Dhehebi", vëll. 1, f. 341 transmetojnë atë që ka përcjellë Mugireh ibn Shu'beh për shpalljen e Muàvijes mohues nga ana e tij. Ky është Mugireh. Por si do të ishte puna për Muàvijen?! (Mjerë për atë që ka e shpallur mohues Nemrudi!)

*nata dhe Jezidi bëri çfarë deshë në shtëpinë e emigrimit edhe me ata që kishin mbetur nga sahabët e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai u sul mbi ta, si të ishte duke u eglendisur, pa pikën e fesë, të burrërisë e të turpit, madje ai nuk hezitoi të rrethojë edhe Qabenë, të flakë gurët e saj dhe pa u merakosur mposhti të gjithë banorët.*

*Cilët janë shkrirë më shumë për Islamin dhe cilët e kanë mbrojtur atë më shumë se Husejni dhe familja e tij? Cili vend doli më shumë në ndjekje të Islamit në atë kohë se sa qytetet e dy Xhamive të Shenjta? A la ndonjë gjë pa bërë Ibn Mejsuni kundër Islamit dhe të Dërguarin të All'llahut, familjes dhe sahabët e tij? Nëse do të dëshiroje të shpalesje veprimet që kanë bërë emevitë për të luftuar Islamin dhe mbartësin besnik të kësaj feje, do të lodheshe duke i numëruar dhe do të dilje jashtë qëllimit. Nuk ka asnjë problem, nëse do të mjaftohemi të kujtojmë vetëm ato që ka thënë El Mukrizi, autori i kumtesës "En'Nizâ'u uet'Tekhâsum", si dhe El Xhâhidhi në kumtesën e tij, ku sjell shembuj të armiqësisë e të mendjemadhësisë së fisit të emevitëve ndaj fisit të hashimitëve. Ja se ç'ka thënë:*

*"Emevitë i kapnin për qafe sahabët, mbi shpatullat e myslimanëve damkosnin shenjat e skllavërimit dhe të Dërguarin e konsideronin më poshtë se kalifin. Përdhosën myslimanët duke i skllavëruar në vendin e tyre, vononin faljen e namazit me pretekst të këndimit të hutbes, hanin e pinin mbi minberin e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i*

*All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe e shisnin burrin e përkushtuar në zbatimin e urdhrave të fesë.”<sup>1</sup>*

*Këto ishin disa nga punët e urryera të emevive dhe disa nga kundërshtimet që ata i bënë ligjit të fesë së All'lahut. Vallë, a nuk e kanë njohur ata fenë dhe penalitetet e ligjit të fesë, sistemet dhe kufizimet që feja ka vënë? Është vendi të theksohet lufta e ashpër që kanë bërë emevitë për uljen e ligjit të fesë, me të cilin erdhi Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), si dhe fakti se ata mesazhin e All'lahut të Lartësuar e konsideronin si pronë, me të cilën luanin hashimitët. Nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por në rrugën e përdhosjes së fesë së All'lahut edhe Librin e Tij e bënë tabelë për ta qëlluar me shigjeta. U munduan shumë që edhe Haxhi të kryhej në “Bejti'l Makdis” dhe më vonë në xhaminë që ata ndërjuan në Damask. Emevitë shkuan deri aty sa edhe Qabenë e gjuajtën me katapultë.*

*Nuk ke përse të pyesësh se çfarë pësoi familja e Profetit prej emevive: që nga të kryqëzuarit e Kennases dhe Xheuzexhànit, Zejdi dhe djali i tij, Jahja, deri në asgjësimin me helm të Hasanit, Sexh'xhàdit e Bakirit (Paqja qoftë mbi ta!) pastaj vijnë më radhë Ebù Hàshim ibn El-Hanefijeh dhe Ibrahim ibn Muhammedi, vëllai i Seffàhut e të tjerë si këta, përveç të internuarve nëpër provincat e largëta, si dhe të atyre që vuanin në birucat e burgjeve.*

*Umer ibn Abdul Azizi, që ishte më i miri i tyre, e dinte zemërimin e njerëzve ndaj familjes së tij, prandaj u*

---

<sup>1</sup> “Sherhu Nehxhul Belaga”, vëll. 3, f. 470.

*përpoq që ta ndryshonte këtë mendim dhe fjalët që qarkullonin për emevitë.<sup>1</sup>*

*Nuk ka asgjë që të çudit, nëse njerëzit ishin të kënaqur me qeverisjen e atyre njerëzve, sepse njerëz të kallëpit të tyre priren me shumë dëshirë ndaj të ngjashmëve.*

*Feja kërkon prej njerëzve devotshmëri, fshehtazi dhe haptazi, ndjekjen e rrugës së drejtë në afërsi e në largësi, ashtu siç kërkon ndalim të prerë nga punët e liga, të dukshme e të padukshme, heqjen dorë nga agresioni në gjendje kënaqësie dhe zemërimi. Por sa larg janë njerëzit nga këto kërkesa të fesë! Kush do ta drejtojë shpirtin e njeriut në ndjekjen e ligjit të fesë, edhe pse atij i ngushtohet rruga e plotësimit të dëshirave dhe i ndalohet padrejtësia dhe agresioni, në një kohë që shpirti anon kah e keqja?!*

*Sikur njerëzit të dëshironin udhëzimin për në rrugën e drejtë, për ata nuk do të ishin të panjohur udhëzuesit, të drejtët, njerëzit me besim të vërtetë e të sinqertë. Por të tillë drejtues, me të tilla veti të nderuara, nuk mund të pajtoheshin me njerëzit që janë aq larg virtyteve të larta sa ç'janë bishat nga engjëjt dhe guralecët nga yjet e qiellit.*

*Nëse do të thelloheshe në gjendjet e njerëzve, vetvetiu do të ndërgjegjësoheshe për të vërtetën e këtyre*

---

<sup>1</sup> Nuk mund të thuhet më mirë nga sa e ka thënë gjykatësi egjiptian, Ebù Hanife En'Nu'màn në librin e tij "El Menàkibu uel Methàlibu" për nderimin që gëzojnë hashimitët dhe mangësitë që kanë emevitët. Sikur të lexosh këtë libër, me siguri që do të mësosh veprimet e mynxyrshme që kanë kryer emevitët. Nga ana tjetër, sikur të fillonim të numëronim ligësitë e tyre, për të kuptuar atë që kërkohet, ato do të rezultonin në shumëfishin e asaj që kemi përmendur deri tani. Libri i lartpërmendur është në dorëshkrim dhe akoma nuk e ka parë dritën e botimit. Unë kam parë një kopje të këtij dorëshkrimi në disa biblioteka të Nexhefit.

*fjalëve të përjetshme profetike: “Ashtu si jeni, ashtu do t’i keni edhe ata që ju qeverisin.”<sup>1</sup> Vallë, a do të ishte i kënaqur dijetari të qeverisej prej injorantit dhe i drejti të drejtohej prej mëkatarit?!*

*Sikur krerët e injorancës, të mëkatit e të së keqes, të mos gjenin ndihmë të ngjashme me veten dhe të mos gjenin heshtjen ndaj punëve të tyre, shpirtrat e tyre kurrë nuk do të aspironin të udhëhiqeshin nga dëshirat e të zhyteshin në llumin e epsheve. Gjithashtu, ata kurrë nuk do të guxonin as të ulnin vlerën e mrekullive të Profetit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e të veprave të larta (kerameteve) të pjesëtarëve të familjes profetike dhe as të lëviznin mesazhin e Profetit e të luftonin pjesëtarët e familjes së tij.*

*Studimi i sjelljeve të këtyre njerëzve dhe thellimi në punët e tyre të liga janë mishërim i pabesisë, tradhtisë, partishmërisë për në rrugën e humbjes kundër udhëzimit për në rrugën e drejtë dhe vënien e të gabuarës kundër të vërtetës deri në atë shkallë, sa do të çuditëshe dhe të pyesje veten: “Si është e mundur që deri më sot nuk është larguar e vërteta dhe nuk janë asgjësuar korifenjtë e udhëzimit për në rrugën e drejtë? Duhet të përmendim se dishepujt e së vërtetës, në çdo kohë e në çdo vend, kanë qenë shumë të pakët, ashtu siç thotë i Larti në fjalën e tij: “...pak nga robërit e Mi janë falënderues.” (Sure “Sebe”, ajeti 13)*

*Ku është fshehur kjo e vërtetë? Në kohën tonë mjafton vetëm një vështrim e do të shikosh sa e ngjashme është e gabuara me të vërtetën dhe se si e gabuara e mposht të vërtetën me përkrahësit e mbështetësit që ka. Nuk ka asgjë për t’u çuditur, por e çuditshme dhe e rrallë*

---

<sup>1</sup> “Musnedi” i Ahmed ibn Hanbelit, vëll. 4, f. 437.



*është ajo që në disa kohë përputhet fitorja e të drejtëve dhe mposhtet e gabuara. Nëse Ebù Hasani (Aliu) dhe vetë Hasani do të kishin triumfuar mbi Muàvijen dhe Husejni do të kishte mposhtur Jezidin, në atë kohë do të qe një punë që ndodhte për herë të parë, por nuk do të qe kështu në kohën tonë. Edhe fitorja e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) pas gjithë atyre luftërave të përgjakshme, ishte vetëm për të pasur argumentin, ashtu siç na njofton i Larti në fjalën e Tij: "...kush duhej të vdiste, të vdiste me prova të qarta dhe kush mbetej gjallë, le të jetonte me prova të qarta..." (Sure "El Enfâl", ajeti 42)*

*Nëse mohimi do të kishte mposhtur Islamin, kurrë nuk do të ishte plotësuar as drita e tij dhe as nuk do të ekzistonte argumenti i tij.*

*I Dërguari besnik erdhi për njerëzit me të gjitha virtytet, me lumturi e me moral të nderuar, por njerëzit u pozicionuan, që të mos e kryenin porosinë e mesazhit të tij dhe të mos e zbatonin thirrjen e tij, megjithëse i gjithë mesazhi, që kumtoi Profeti i Islamit, është vetëm për të mirën e njerëzve, ashtu siç është për lumturinë e tyre edhe thirrja islame. Atëherë, pse nuk pranuan shpirtrat e njerëzve të dorëzoheshin para këtyre virtyteve, pa iu kundërvënë e pa e kundërshtuar rrugën e tij me ndërgjegjen e tyre?! Vallë, mos njerëzit u nënshtruan ta pranonin këtë lumturi vetëm pasi panë mbi kokat e tyre shpatën dhe vetëm kur u goditej kurrizi me kamxhik?! Sa shpejtuan për t'i kthyer shpinën Islamit! Sapo ai erdhi në trevat e Kudsit; ata i thyen rregullat e ligjit të tij dhe shfrytëzonin çdo rast për ta braktisur, ashtu siç njofton i Larti në fjalën e Tij: "Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes*

*ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit.” (Sure “Àl ‘Imràn”, ajeti 144)*

*Kurse emevitë, kollosëve, që i kishin zemrat të mbushura me besim dhe që u ngritën në mbrojtje të së vërtetës, u vunë përpara luftën e armatosur për të mbrojtur të gabuarën. Edhe në këtë veprim të tyre nuk ka asgjë për t’u çuditur, sepse i Larti thotë: “...Ai e nxjerr të gjallën prej të vdekurit...” (Sure “El En’àm”, ajeti 95)*

*Padyshim që mallkimi nuk i përfshin ata të gjithë, sepse Libri i nderuar thotë: “...ai që është në rrugën e humbur, nuk mund t’ju dëmtojë, nëse ju jeni të udhëzuar në rrugën e drejtë...” (Sure “El Mâide”, ajeti 105); dhe: “...dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit...” (Sure “El En’àm”, ajeti 164); dhe: “Kush bën mirë, e bën për dobinë e vet dhe kush punon keq, e bën në dëmin e vet...” (Sure “Fussilet”, ajeti 46); dhe: “...nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmirëve...” (Sure “Et Teubeh”, ajeti 91)*

\* \* \*

## ABASITËT

*Mizoria e emevitëve përfshiu të gjithë njerëzit. Ata nuk dhunuan vetëm njerëzit e mirë dhe familjen e Profetit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Prandaj, nga fundi i sundimit të tyre, emevitët, urryen më shumë njerëzit e ligj. Kjo nuk do të thotë që urrejtja ndaj njerëzve të mirë mori fund. Dikush qante për fenë e tij, një tjetër qante për interesat e kësaj bote; njerëzit*

*kërkonin të largoheshin nga dhuna e emevive e t'i shpëtonin sundimit të tyre, ndërkaq emevitët kërcënonin të gjitha trevat islame me banorët e Shamit, të cilët ishin ushtarët e tyre të bindur, kishin të njëjtin mendim me ta dhe kurrë nuk i kundërshtonin urdhrat e tyre. Me banorët e Shamit dhe së bashku me ta, Muàvija vuri nën sundim Egjiptin, Irakun dhe Hixhàzin; megjithëse Hixhàzi dhe Iraku kishte burra, që, për nga mendimi e trimëria, dallonin në dëshirat e tyre nga banorët e Shamit e nga shoqëria e tyre. Ibn Zijadi i drejtoi ushtarët e Damaskut në Kufe kundër nipit të Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) pa ushtruar ndaj tyre ndonjë kërcënim, por vetëm me premtime e pará. Gjithashtu, edhe Abdul Meliku mposhti irakienët dhe qytetet e dy Xhamive të Shenjta, duke i rrëmbyer pushtetin familjes së Zubejrit, pikërisht me këta ushtarë, sepse Shami nuk njihete për mbret njeri tjetër përveç emevive. Madje, si ushtarë të bindur ndaj çdo thirrjeje që u bëhej, ata as për kalifatin nuk pranonin të ishte tjetërkush veç emevive. Në një gjendje të tillë, emevitë u bënë absolutë mbi një territor shumë të gjerë.*

*Gjendja vazhdoi e tillë derisa vetë emevitë filluan të grinden mes tyre. Puna shkoi deri aty, sa ata u vranë njëri me tjetrin. Për pasojë, edhe te banorët e Shamit filluan ngatërresat e kundërshtimet sipas kundërshtimeve e grindjeve të emevive. Kështu, fjala e emevive u copëzua, për pasojë u përçanë edhe komandantët, të cilët i çuan njerëzit në rrugën e humbjes, por edhe njerëzit ranë në rrugën e gabuar së bashku me ta.*

*Kur fjala e emevive filloi të hasë kundërshtime, menjëherë u drejtuan vështrimet mbi pushtetin e tyre dhe shpirtrat u shtynë të synojnë tokat e tyre. Por kush do të ishte ai që do t'i shpallte hapur këto shpresa e dëshira ndaj*

*Shamit, që u kishte robëruar zemrat? Si mund të harronin njerëzit forcën dhe ashpërsinë e ushtrive të banorëve të Shamit?! Nuk kaloi shumë kohë pas ngjarjes në Fushën e Kerbelasë, ku emevitë praktikuan mënyrat më të stërholluara të terrorizmit, të njollosjes e të hakmarrjes. Mjafton të kujtojmë ndodhinë e Harres, gjatë së cilës ata demonstuan format më të padëgjua të urrejtjes, të prostitucionit e të poshtërsive me gjëra të ndaluara. Nuk mund të harrohen as dy rrethimet e Qabes, një herë prej Jezid ibn Murrees dhe herën tjetër prej Abdul Melikut. Mizoria arriti deri aty, sa Qabeja të goditej me katapultë, t'i vihej zjarri e të shembej. Nuk mund të harrohet as vrasja e Zejdit, kryqëzimi e djegia e tij apo vrasja e Jahjasë dhe kryqëzimi i tij, si dhe të gjitha mënyrat që ata praktikuan mbi njerëzit, pa i kushtuar rëndësi paprekshmërisë së Vendeve të Shenjta dhe pa u sprapsur para asnjë lloj veprimi haram. Për emevitë njerëzit, sendet e shtrenjta, nderi dhe pasuria ishin vetëm ushqim dhe mjete që ata të përmbushnin dëshirat dhe epshtet e tyre. Atëherë, në një gjendje të tillë terrori, si u bë e mundur që Ibn Hurreh të fliste hapur për të sulmuar emevitë ose të thurte plane në fshehtësi kundër shtetit të tyre?*

*Askush përveç hashimitëve nuk mund të shpresonte t'u hiqte atyre kurorën dhe t'u merrte pushtetin, sepse hilafeti (kalifati, pushteti) u takonte atyre sipas tekstit, goftë edhe për shkak të afërsisë që kishin me të Dërguarin e Allahut, si dhe për shkak të virtyteve që ata kishin. Në fshehtësi njerëzit filluan të kërkojnë që ata të ngriheshin dhe me zë të ulët, vesh më vesh, i nxisnin për veprim të menjëhershëm.*

*Në të vërtetë, ndër hashimitët kishte shumë burra të denjë për të marrë kryesinë, të aftë për të marrë në dorë administrimin e punëve dhe për të trajtuar me urtësi çështjet e politikës. Vallë, a do të hidhej në veprim me ta zotëruesi i kalifatit dhe kryesuesi i imamatit, Ebù Abdil'lah, Xha'fer ibn Muhammed Es Sadiku (Paqja qoftë mbi të dy!) apo do të lëvizte Abdullah ibn Hasani, që ishte më i virtytshmi i djemve të Hasanit dhe dijetari i tyre ose djali i tij Muhammedi, që ishte i pajisur me cilësitë më të larta, apo vëllai i tij Ibrahim Ebi Dajmi, apo Muhammed ibn Muhammed El Abbasi, apo dy vëllezërit e tij Seffàhu dhe Mensùri, të cilët ishin burra me vullnet e nuhatje të hollë, apo ai që do të ngrihej do të qe Abdullah ibn Muàvijeh El Xha'feriu, të cilin pozita e lartë shoqërore dhe cilësitë e tij të nderuara e bënë personin më të përshtatshëm për këtë post, pa përmendur të tjerët që do të mbushnin një listë të gjatë. Nëse çdonjëri prej tyre do të angazhohej për një post të tillë, me siguri që ai vetëm do ta zbukuronte vendin akoma më shumë me cilësitë e tij të larta.*

*Nëse imam Sadiku (Paqja qoftë mbi tël) do ta kishte pranuar i pari këtë post, askush nuk dilte para tij, për shkak të virtytit dhe përkrahësve të shumtë që kishte, por ai i largonte ata që e nxisnin dhe nuk u përgjigjej atyre që i kërkonin të hidhej në veprim.*

*Kur njerëzit nuk patën më shpresë se Sadiku do të hidhej në veprim, hoqën dorë prej tij dhe filluan të merren me të tjerët. Ata, herë i jepnin besën Muhammedit dhe në pararojë të besëdhënësve ishte babai e vëllai i tij, bijtë e Hasanit dhe bijtë e Abbasit; herë tjetër i bënë thirrje Ebù Muslimit në Horasan, që të ngrihej në favor të abasive ose i drejtoheshin Ebù Seleme Hilalit në Kufe, që të ngrihej për*

*Rizanë, që ishte prej familjes së Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Në Kufe u ngrit djali i Xha'ferit, por puna e tij mbeti e pa plotësuar, herë tjetër ai shfaqej në Persi, por përsëri çështja e tij nuk ishte në rrugën e duhur dhe kështu ai ia mbathi për tek Ebù Muslimi në Horasan. Në një gjendje të tillë ai i ngjante atij që luan me zjarrin, pasi në të vërtetë jeta e tij ishte në dorën e Ebù Muslimit. Kjo gjendje, me furtuna të nxehta dhe e mbarsur me trazira, nuk mund të vazhdonte gjatë, prandaj çështja përfundoi në dorën e Beni Abbasit (abasive).*

*Rrokullisja e ngjarjeve bëri që çështja të përfundonte në dorën e Seffâhut e të Mensûrit. Kush mund të besonte se dy vëllezërit, që lëviznin nëpër lagjet e qytetit për t'u dhënë ujë njerëzve e që i njihnin virtytet e Ebu Hasanit, të cilin e kishin si mjet për të kërkuar prej tij dashamirësi dhe tek i cili shtrinin dorën për të kërkuar mirësi; kush mund të mendonte se këta dy vëllezër, që i dhanë besën Ebù Hasanit ditën kur u mblodhën në Ebvâ, pa ndonjë paramendim e pa ndonjë shpresë se do të kishin pushtetin dhe që kishin shërbyer nën flamurin e Ibn Xha'ferit e në ushtrinë e tij, ditën kur ai u shfaq në Persi dhe prej të cilit përfituan shumë, do të merrnin në dorë frenat e qeverisjes dhe do t'u rrëmbenin fronin emevive? A i shkonte ndërmend ndonjërit se Ibn Xha'feri, kalorësi i aksionit, do të vritej pikërisht prej këtyre të dyve, të cilët kishin mbështetjen e Ebù Muslimit dhe ishin prej ushtarëve të tij? Kush mendonte se Ibn Hasani, që e shpresonte për vete postin e hilafetit (kalifatit), ashtu siç shpresonin edhe të tjerët dhe që i kishin dhënë besën për të vdekur, do të*

*binte i vdekur së bashku me vëllanë e vet Ibrahimin nga shpata e Mensùrit?*

*Ky është Vendimi dhe Caktimi i All'llahut dhe askush nuk e mposht atë që është vendosur në diturinë e Tij, që në fronin e sundimit të ulëshin abasitë dhe shteti i emevive të bëhej thjesht një objekt që njoftonte çrrënjosjen. Nuk ka keqardhje për atë që shkon dhe as gëzim për atë që po vjen. Shkuan njerëzit mëkatarë dhe erdhi një shtet dhunues i së drejtës.*

*Seffâhu u ngjit në fronin e pushtetit dhe bota i qeshi atij, pasi i kishte rrudhur sytë, i ofroi atij nderimin, kur më parë i kishte kthyer shpinën. Por edhe sikur burrit t'i vësh përpara të gjithë botën, ai nuk mund të ndihet i qetë nga ajo që mund të sjellin pasionet. Biri i Abbasit u vu ndërmjet dy problemeve: problemit për pastrimin e vendit prej emevive, që të shpëtonte i gjithë ummeti prej tyre dhe problemit ndaj konkurrencës për fronin nga ana e djemve të Aliut, në një kohë që fronit akoma nuk i ishin vënë themelet dhe nuk ishin forcuar institucionet mbështetëse të tij. Nuk vonoi shumë dhe filluan furtunat e kryengritjeve kundër tij. Pa u qetësuar mirë nga problemi i parë, Seffahun filloi ta shqetësojë problemi i dytë. Si mund të ishte i sigurt ai prej djemve të Aliut, kur Ebù Abdil'lah, Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ishte në detyrën e imamit të të bindurve të gjysmës së këtij ummeti, pra, në shumicën e ushtarëve me të cilët bijtë e Abbasit (abasitët) përmbysën bijtë e Mervànit (emevitët)?! Madje ata edhe Ebù Seleme El-Hilalin e vranë, sepse e nuhatën se ai punonte të sillte në pushtet djemtë e Aliut. Për më tepër, edhe besa që iu dha Seffâhut ishte që të mposhtej Ebù Selemeja dhe që t'i paraprihej atij në veprimin që donte të kryente.*

*Si mund të ndihej i qetë Seffàhu se atë nuk do ta konkuronin alevitët (djemtë e Aliut), në një kohë që Muhammed ibn Hasanit i ishte dhënë besa në Ebvà? Për më tepër, vetë Seffahu e Mensùri kishin shtrënguar duart e tyre me dorën e Muhammedit dhe e kishin përqaftuar atë, duke e ditur se ai ishte plotësisht i merituar për fronin mbi të cilin ishin ngjitur ata. Të gjitha këto dëshira e shpresa vazhdonin të trazonin shpirtin e tij. Atëherë përse Seffàhu i kishte mbajtur të fshehura këto deri ditën kur mori në dorë pushtetin? A nuk merr edhe luani pozicion për t'u hedhur?*

*Biri i Abbasit u mundua të qetësohej prej këtij problemi, duke i vënë nga pas Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) agjentë të fshehtë, edhe pse ai nuk kishte demonstruar ndonjë veprim që t'i frikësonte ata për pushtetin. Megjithëkëtë, ai e vuri Sadikun në presion të gjithanshëm, megjithëse kurrë nuk pa te ai asgjë nga ato që kishte frikë. Pavarësisht nga këto, ai e dërgoi Sadikun në Medinë, duke u kthyer përsëri në marrëzitë që e ngacmonin.*

*Më pas, ai u vu në kërkim të dy djemve të Abdullah ibn Hasanit, të cilët qëndronin të fshehur nga frika e goditjeve të tij. Sa më shumë këmbëngulte ai në kërkimin e tyre, aq më shumë fshiheshin ata prej tij.*

*Mori fund radha e shkurtër e Seffàhut dhe e Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe erdhi në pushtet Mensùri. Për djemtë e Aliut gjendja u përkeqësua gjithnjë e më shumë. Mensùri nuk e la Sadikun të zinte vend në qytetin ku u shpërngul i Dërguari i All'llahut, por herë pas here e sillte pranë vetes. Çdo herë Sadiku ndeshej me keqtrajtimin e Mensùrit. Mensuri e vazhdoi keqtrajtimin ndaj tij, derisa më në fund e helmoi.*



*Përsa i përket Muhammedit e Ibrahimit, ai vazhdonte t'i kërkonte me të gjitha mjetet e mashtrimet. Herë shpallte për të dy siguri, herë shtonte dhunën mbi babain e tyre dhe mbi djemtë e tjerë të Hasanit. Të gjitha këto nuk sollën asnjë dobi, që ai të arrinte tek ata të dy. Më pas, Mensuri i sollti djemtë e Hasanit në Irak, ku i mbylli nëpër qelitë e burgjeve, derisa pjesën më të madhe të tyre i vrau me mënyrat më makabre. Mensuri vazhdonte të këmbëngulte për të shtënë në dorë Muhammedin, qoftë edhe rastësisht, gjatë lëvizjeve të tij në Medine e në Basra. Prandaj ai vazhdimisht ishte në përgjim dhe i kishte shtrirë krahët për ta zënë, duke mos iu frikësuar takimit me All'llahun. Vdekja e mposhti.*

*Sapo abasitët morën në dorë sundimin, menjëherë dolën sheshit kurthet dhe pabesia e tyre. Ata i dhanë besën djalit të Hasanit, por pastaj, në përgjigje të kërkesës së tij dhe kërkesës së vëllait të tij, u përpoqën shumë për t'i vrarë të dy. Djali i Abbasit u përpoq, që duart e tyre të shtrëngonin dorën e tij dhe kështu, ata të dorëzoheshin. Por si do të dorëzoheshin ata njerëz me shpirt të paepur e të mbushur me madhështi, në një kohë që gëzonin përkrahjen e njerëzve?! Populli i kërkonte që të ngriheshin për fitore, i cili, edhe nëse do të konstatonte se shpirti i fitores te ata të dy po shuhej, menjëherë do t'i ngacmonin shpirtrat e tyre për t'u ngritur. Njerëzit vazhduan t'i nxisnin. Ata u ngritën, pasi kishin qëndruar të fshehur për një kohë të gjatë.*

*Kjo pabesi e abasive nuk e ishte e vetmja që ata kanë bërë kundër djemve të Hasanit gjatë sundimit të tyre. Mensuri, me anë të Ebù Muslimit, tradhtoi ndërtuesit e shtetit të tyre dhe vranë Ebù Seleme El Hilalin, arrestuan Ja'kùb ibn Dàùdin, vranë Fadl ibn Sehlín dhe sa e sa të*

*tjerë. Sa qëllime patën ata ndaj dy ministrave Ali ibn Jaktinit dhe Xha'fer Muhammed El Esh'athit?*

*Gjithashtu, Mensùri qe i pabesë edhe ndaj Isà ibn Mùsà El Abbàsit, të cilin e pezulloi nga posti i zëvendësmbretit dhe në vend të tij vuri djalin e vet, Mehdiun, në një kohë që vetë Mensuri ia kishte dhënë këtë post Isàit si shpërblim për sprovën që ai kishte kaluar në luftën kundër Muhammedit e Ibrahimit, si dhe për asgjësimin e këtyre të dyve për shkak të kryengritjes që ata bënë. Është fjala për kryengritjen që e shqetësoi shumë Mensurin, sa e bëri të besonte se me të vërtetë pushtetit të tij i erdhi fundi.*

*I pabesë qe edhe Reshidi me ministrat e tij bermekij. Jahjà El-Hasenijun u kishte dhënë siguri. Pabesi bëri edhe Emini ndaj vëllait të vet Me'mùnit, kur e pezulloi nga posti i mëkëmbësit të mbretit. Por edhe Me'mùni, nga ana e tij, bëri pabesi ndaj Rizàit (Paqja qoftë mbi të!) kur e helmoi atë, edhe pse i kishte dhënë besën për postin e mëkëmbësit. Nuk numërohen pabesitë dhe krimet e bëra nga abasitë.*

*Në fakt, pabesia më e madhe, që bënë abasitët, ishte ndaj djemve të Husejnit (Paqja qoftë mbi të!). Ashtu siç u tha më lart, përkrahësit e djemve të Aliut qenë ushtarë të abasive për asgjësimin e emevive. Parrulla e tyre ishte kërkesa e gjakmarrjes për të vrrarët e Ehli Bejtit. Vallë, a nuk vrau shpata e emevive vetëm pjesëtarët e fisit të Ebu Talibit? Vallë, a nuk rëndoi forca dhe presioni i gjithanshëm i emevive vetëm mbi pasardhësit e Aliut? Nëse të tjerë nga fisi i Hashimit pësuan diçka nga kjo dhunë, ajo nuk ishte e ngjashme më atë që ra mbi familjen e Ebu Tàlibit.*

*Abasitët u bënë thirrje njerëzve për të kërkuar gjakmarrje, madje vetë njerëzit e kërkuan këtë prej tyre. Ky ishte mjeti më i mirë që i ndihmoi abasitët të arrijnë forcimin e tyre. Sapo ata i forcuan këmbët mbi truallin e pushtetit, pa humbur kohë, filluan ndjekjet kundër familjes së të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Pjesëtarët e kësaj familjeje u ndoqën, sikur të ishin ata që kishin acaruar në kulm ngjarjet e rënda ditën e Kerbelasë. Veç kësaj, abasitët shanë bashkëshortet e Profetit dhe masakruan barbarisht Zejdin, Jahjanë e të tjerë. Punët paraqiteshin sikur të vrrarët dhe të rënë të robëri ishin prej abasive dhe kriminelët, që i kryenin këto krime, ishin nga fisi i imam Aliut.*

*Por, a nuk qenë pjesëtarët e fisit të Aliut ata që ngritën njerëzit për t'u hakmarrë kundër abasitëve, duke i futur në udhën që donin?!*

*Pa u sosur ngjarjet, që përfunduan me përzënie e emevive, ndër të vrrarët në këto ngjarje ishin edhe pjesëtarët e Ehli Bejtit. Në vend që të kishin mirënjohjen e abasive, ndodhi e kundërta: përndjekja e abasitëve ndaj Ehli Bejtit që më e përgjakshme se ajo e emevive, edhe pse abasitët u ngjitën në pushtet me ndihmën e tyre.*

*U shpërndanë pluhurat që mbulonin ngjarjet, pasi abasitët morën në dorë frerët e qeverisjes dhe akoma njerëzit nuk e kishin harruar atë që i kishte ndodhur Ehli Bejtit prej emevitëve, por edhe tani ata po shihnin goditjen e abasive të binte mbi kokat e tyre pa mëshirë, pa u ndalur dhe jo me fushatë. Pse e gjitha kjo? Përse vetëm Ehli Bejtë u bënë shtëpia e fatkeqësive dhe e pësimeve të rënda dhe jo shtëpitë e tjera? Le t'i përgjigjemi këtyre pyetjeve në kaptinën vijuese.*

\* \* \*



*Shoqata*

*Filadi*

### **CILI QE FAJI I EHLI BEJTIT?!**

*Kur'ani i Madhërueshëm, në shumë ajete të tij, flet qartë për pozitën dhe vlerësimin e Ehli Bejtit, duke urdhëruar dashuri, duke njoftuar pastërtinë dhe duke nxitur mbështetjen. Njëkohësisht njofton cilësitë e vyera dhe pozitën e lartë të kësaj familjeje.*

*Në rrugën e Kur'anit të Madhërueshëm ka ecur i Dërguari (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) gjatë gjithë jetës së vet, duke zbuluar cilësitë më të larta e më të dobishme të kësaj familjeje. Ai herë e bën të detyrueshme bindjen dhe ecjen në rrugën e tyre,*

*herë kërkon që zemrat të kenë dashuri për ta, pa përmendur porosi të tjera veç këtyre që u thanë.<sup>1</sup>*

*Të gjitha këto ishin vetëm për lumturinë e njerëzve, që fenë ta merrnin prej atyre që kanë fe dhe diturinë ta merrnin nga vetë burimi. Njerëzit kanë detyrë të tregojnë respekt ndaj tyre, të jenë vetëm me ta dhe të largohen nga të tjerët.*

*Ehli Bejti, d.m.th. Aliu, Fatime Zehraja, dy djemtë e tyre dhe djemtë e Husejnit (Paqja qoftë mbi ta!) i ngjanin të Dërguarit në moral, virtyte, cilësi dhe në veprime. Prandaj, ai që dëshiron të dijë për të Dërguarin, duhet të kuptojë se ata janë portat e qytetit të tij; ai që dëshiron të mësojë për logjikën e tij (tyre), do të kuptojë se ata ishin pasqyra e gjuhës së qartë në stilin më të përsosur; ai, që dëshiron të njihet më moralin e tij, do të shohë se ata janë shembuj konkretë të jetëshkrimit të tij; ai, që dëshiron fenë e tij, do të gjejë se ata janë pishtarët e ligjit të fesë së tij; ai, që dëshiron përkohshmërinë e tyre, do t'i gjejë ata në rrugën e tij; ai, që dëshiron mirësinë në degët e tij, do të gjejë se ata janë pasardhësit e tij më të pastër; ai, që dëshiron t'i shohë, ata ishin bukuri e pamjes së tij. Të tillë ishin pjesëtarët e Ehli Bejtit, pasi rrënjët e tyre janë tek i zoti i shtëpisë. Këto ishin vetëm disa nga ngjasimet që ata kishin me personin e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) Ai, që kërkon të shoqërohet vetëm me të Dërguarin do ta marrë shoqërimin prej tyre; ai, që do të rrijë me Islamin, do të kuptojë se ata janë furnizimi më i mirë për të; ai, që së bashku me fenë dëshiron freskinë, do të kuptojë se ata janë ruajtësi më i mirë i kopshtit të saj; ai, që krahas urdhërimit për të mirë duhet të luftojë në rrugën e urdhërimit për të mirë, do të*

---

<sup>1</sup> Në librin tonë "Esh'Shi'atu ue silsiletu 'usùrihà" ("Shi'at dhe vargu i epokave të tyre") kemi përmendur diçka nga ajo që thotë Kur'ani dhe Sunneti për pozitën e Ehli Bejtit, mirësinë dhe thirrjen për sundim të kësaj familjeje të lartë.

*kuptojë se ata janë bijtë e thirrjes së tij dhe për pushtetarin që bën veprime të liga, ata janë armiq të planit të tij.*

*Nëse përmendet mirësia, ata ishin orientuesit drejt saj; nëse virtyti bënte përpara, ata ishin flamuri i tij; nëse drejtësia përhapej, ata e donin drejtësinë më shumë se kushdo tjetër; nëse njerëzit kujtonin bëmat, ata ishin më të kapshmit dhe perla më e shtrenjtë; nëse njerëzit garonin në vepra të nderuara, ata ishin mbi ta dhe një hap para tyre; nëse njerëzit garonin në nderim, te ta ishte qëndrimi dhe dorëheqja; nuk kishte ndonjë virtyt që ata të mos ishin modeli më i përkryer dhe i dalë prej tyre.*

*Ehli Bejti ishte ashtu siç e përshkruam, prandaj emevitët nuk mund të mos merrnin ndaj tyre pozitën e armikut të ashpër e kryeneç. A nuk kishte vlarë i Dërguari në rrugën e All'llahut ata që kishte vlarë prej fisit të Beni Umejjes, të cilët rrinin në pritje të rastit për të marrë gjakun për të vlarët e tyre? Nëse emevitët do të afroreshin me mbrojtësit e Islamit e me thirrësit për në fe, atëherë Profeti, me thirrjen e tij, do të rikthehej sikur të ishte gjallë. Për pasojë Islami do të vijonte rrugën përpara, dispozitat e ligjit të fesë e sistemi i tij do të ishin ashtu siç i dëshiron i Larti dhe i Dërguari (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Nëse emevitët do të kishin marrë qëndrim asnjanes, atëherë njerëzit do të mësonin për meritat dhe virtytet e Ehli Bejtit. Njerëzit kanë të drejtat e tyre, atëherë për emevitët nuk do të kishte mbetur më asnjë mjet, me të cilin ata do të ngjiteshin në podiumet e Islamit e as ndonjë verigë, që ata të shtinin në dorë sundimin e vendit e të skllavëronin njerëzit.*

*Emevitët vazhduan të nxirrnin në pah drejtësinë e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) edhe pse nuk mund të gjendet shembull për qëndrimet e tyre makabre, tashmë të njohura ndaj familjes ku zbriti shpallja, pavarësisht se qëndrimet e tyre ndaj*

*familjes profetike janë e kundërta e asaj që njohën kohët. Veprimet e tyre dëshmojnë ashpërsinë e sjelljeve dhe amoralitetin e paparë të emevive.*

*Kurse abasitët, kur morën në dorë pushtetin dhe kaluan urën, që i çonte në arritjen e qëllimeve të tyre, atë urë që ata e ngritën mbi shpinat e mbështetësve të Ehli Bejtit, kolonat e asaj ure ata i ngulën mbi kafkat e të sinqertëve, shumë shpejt kuptuan se gjendja, edhe pse ishte e qetësuar, mund të ndryshonte nga çasti në çast. Njerëzit nuk do të vononin të kërkonin llogari për të drejtën dhe vendin që i takon së drejtës, si dhe për hilafetin dhe se kujt i takon të jetë halif. Njerëzit u ngritën përkrah tyre vetëm që të shkatërronin fronin e emevive dhe të merrnin hakun për atë gjak të pastër, që u derdh pa kryer asnjë krim. Njëkohësisht, ata u ngritën, që në postin e halifit të vihej Rizai, i cili ishte nga familja e Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!); njerëzit u ngritën dhe bënë rezistencë, që në pushtet të vinin pasardhësit e Aliut (alevitët) dhe jo pasardhësit e Abbasit (abasitët). Në një situatë të tillë, abasitët filluan të mendojnë për të vrrarë në pabesi e me tradhti burrat që u shtruan atyre rrugët dhe u forcuan atyre kolonat që ata të ngjiteshin në kolltukët e sundimit, siç qenë Ebù Seleme El-Hilàliu, etj. Abasitët i morën këto masa nga frika se do t'u kërkohej llogari, pikërisht kësaj llogarie i druheshin shumë. Në një gjendje të tillë, abasitët vepruan me shpejtësi dhe pasardhësit e Aliut i vunë në shtrëngim nga të gjitha drejtimet; prapa tyre ata vunë sy që i vëzhgonin dhe u ngritën prita, sepse abasitët kishin frikë nga konfliktet, të cilat, nga njëra anë, turbullonin shpirtrat dhe nga ana tjetër i bënë njerëzit të ngriheshin kundër tyre. Për të zotëruar këtë gjendje dhe për të shpëtuar nga dhënia llogari, ata*

*vendosën të mbyllin me terror gojët e pasardhësve të Aliut e të përkrahësve të tyre.*

*“Delikti” i vetëm i pasardhësve të Aliut ndaj tyre ishte vetëm një: Ata ishin njerëzit që kishin të drejtë, prandaj sundimi u takonte atyre. Ishin njerëzit, që u ishte dhënë besa dhe hilafeti u takonte vetëm atyre, qoftë nga afërsia me Profetin, qoftë nga teksti i qartë, qoftë nga virtytet e cilësitë e larta që kishin.*

*Nuk kishte asnjë shkak që t’i bënte abasitët të ndërmerrnin goditjen kundër pasardhësve të Aliut, përveç faktit se pasardhësit e Aliut ishin më të merituar se abasitët për postin e hilafetit. Këtë post abasitët e morën me forcë. Abasitët nuk mund të ishin të sigurt nga veprimet e pasardhësve të Aliut, të cilët vazhdonin të gëzonin respektin dhe nderimin e njerëzve, madje vazhdimisht shikimet e njerëzve ishin drejtuar vetëm kah ata dhe zemrat dëshironin vetëm ata. Abasitët e njihnin vlerën e familjes profetike dhe pozitën që kishte te njerëzit, prandaj nuk gjetën mënyrë tjetër më të përshtatshme se sa t’i kundërviheshin kësaj familjeje me vrasje e me forma represioni nga më të rëndat. Ata u sulën të asgjësonin filizat e pastër, për të vetmin shkak se zemrat e njerëzve prireshin kah tyre, pasi dëshirat e veta i shihnin të përmbushura vetëm me ta. Përballë dashurisë së njerëzve për Ehli Bejtin qëndronte ngulmimi i ashpërsisë së abasive për të mbytur çdo shfryrje të përkrahësve të Ehli Bejtit, që familja e uruar të mos përbënte forcë e fuqi, të mos kishte mundësi të kërkonte ndihmë për t’u ngritur.*

*Ndryshimi ndërmjet emevive dhe abasive qëndron në atë se emevitët u shtynë të luftonin hashimitët për dy*



*shkaqe: të hakmerreshin ndaj të Dërguarit dhe të shtinin në dorë kryesinë; kurse abasitët i shtynte vetëm fronti dhe stabilitetit i tij, pa pasur qëllim të luftojnë Profetin (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ose ligjin e fesë, me të cilin ai erdhi, edhe pse lufta, që ata ndërморën kundër dijetarëve të fesë, ishte luftë kundër vetë ligjit të fesë e për t'i bërë bisht zbatimit të këtij ligji.*

*Nëse do të hidhje një vështrim të shpejtë në goditjet e rënda, që ranë mbi Ehli Bejtin, për shkak të virtyteve dhe cilësive të larta, që kishte kjo familje e pastër, do të mësoje edhe shkakun përse bota e lufton fenë, përse njerëzit e duan kaq shumë këtë botë dhe ata që i mbështesin në këtë veprim; ashtu siç do të mësosh edhe shkakun përse njerëzit kanë armiqësi ndaj fesë e ndaj atyre që e praktikojnë atë. Nuk ka dyshim se vetëm me këtë vështrim të shpejtë do të shihje qartë se abasitët vazhduan në gjurmët e emevive, madje abasitët shkuan shumë më larg se emevitët në luftën kundër Ehli Bejtit.*

*Emevitët vranë Husejnin, të birin e Aliut (Paqja qoftë mbi të dy!) në Taff (vendi më i nderuar në Irak). Së bashku me të, emevitët vranë më të pastrit e Ehli Bejtit, shokët e tij më të mirë e më të dalluar. Kjo vrasje u krye atëherë kur Husejni u ngrit të kundërshtonte lojërat që emevitët bënë me fenë për të kënaqur dëshirat e tyre. Nga ana e tyre, abasitët vranë në pritë Husejnin, të birin e Aliut, së bashku me krerët e pasardhësve të Aliut, të cilëve nuk u gjendej shoku në të gjithë faqen e dheut për nga madhështia e bujaria. Abasitët i vranë atëherë kur ata u ngritën të kundërshtonin punët e liga që po bënin abasitët, punë që zemëronin këdo që praktikonte fenë.*

*Emevitët helmuan tre imamë: Hasanin, Sexhâdin dhe Bâkirin (Paqja qoftë mbi ta!) kurse abasitët vranë gjashtë nga*

*imamët: Sàdikun, Qàzimin, Rizàin, Xhevàdin, Hàdiun dhe Askeriun (Paqja e shpëtimi qoftë mbi ta!).*

*Hishàm ibn AbdulMeliku i dërgoi Bàkirin dhe Sàdikun (Paqja qoftë për të dy!) në Sham, që aty ta pësonin. Por kur ata erdhën në Sham, ai nuk pati rrugë tjetër veçse t'i respektonte e t'i lironte dhe t'i kthente që të dy në Medine. Këtë e bëri që të merrte masa për t'u ruajtur dhe që njerëzit të mos ndikoheshin prej tyre. Kurse abasitët nuk lanë asnjë imam të qëndronte në shtëpinë e tij: Seffàhu dërgoi njerëz prapa Sàdikut, gjithashtu edhe Mensùri disa herë ka dërguar njerëz kundër tij. Edhe Reshidi dërgoi njerëz prapa Qàzimit (Kadhim), të cilin e burgosi dhe pastaj e liroi, por nuk kaloi shumë kohë dhe përsëri i vuri njerëz dhe e burgosi dhe së fundi, imami doli nga burgu i helmuar. Nuk thuhet dot se çfarë punuan me të kur ai doli nga burgu dhe si ata i kundërviheshin imamil, edhe kur ai kalonte rrugës. Edhe Me'mùni dërgoi njerëz prapa Rizàit në Tùs, i cili u helmua sapo u kthye pranë familjes në Horasan. Gjithashtu, Me'mùni arrestoi edhe Xhevàdin, por pastaj e liroi pa arritur t'i bënte ndonjë të keqe. Erdhi radha e Mu'tesimit, i cili, me të kapur frerët e pushtetit, dërgoi njerëz prapa Ebù Xha'fer Xhevàdit (Paqja qoftë mbi të!) dhe e liroi atë nga burgu vetëm pasi kurdisi vrasjen e tij me helmim. Gjithashtu, edhe Ebù Hasan Hàdiun (Paqja qoftë mbi të!) e ndiqnin nga prapa njerëzit e Mutevekkilit, i cili, derisa vdiq, u përpoq që të fitonte simpatinë e imamil. Ndërkaq, ky imam vazhdoi të pësojë prej mbretërve abasi vetëm mundime, poshtëtime e shtrëngim të gjithanshëm: herë e burgosnin, herë e lironin, derisa më në fund Mu'tezzi i dha të pinte helmin. Në Samara kishte mbetur babai i tij, Ebù Muhammed Hasani (Paqja qoftë mbi të!) të cilin as nuk e lejonin që të vinte në Medine dhe as nuk e linin të zinte vend në shtëpinë e tij. Por edhe këtë herë, e*

*burgosin, më pas e liruan. Ky ragvim vazhdoi derisa edhe ky helmua. Mu'temidit, sapo mësoi se Ebù Muhammed Hasani kishte një djalë pesëvjeçar, që quhej Ebul-Kàsim, menjëherë u vu në kërkim të tij, me qëllim që ta vriste edhe atë. Djali u fsheh e u largua prej krimeve e prej vrasjeve të abasive dhe deri më sot ai qëndron i fshehur.*

*Emevitët asgjësuan një grup prej pasardhësve të imam Aliut (alevitëve) me shumë mënyra: me helm, burgim, vrasje dhe me çdo mjet tjetër të fortë, si p.sh. Zejdin dhe Jahjànë, një grup tjetër të madh prej tyre e asgjësuan ditën e Harres, ashtu siç vranë Abdullah Ebu Hàshim ibn Muhammedin ibn El-Hanefijeh, pa përmendur të tjerët. Por, sa pak janë këta në krahasim me ata që asgjësuan abasitët. Mjafton të përmenden të vrarët nga kjo bandë në birucat e burgjeve. Sapo një abasit ngjitej në fron, menjëherë ai do të vriste një grup nga pasardhësit e Aliut.*

*Prej krimeve të emevive mundën të largoheshin burra të tillë si Jahjà e Abdullah El-Xha'feri dhe tre apo katër të tjerë. Por si mund të krahasohen burrat e shumtë, që u fshehën e u larguan nga frika e abasive? Ku janë Kàsimi e Ahmedi, dy djemtë e imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të!) apo Isà ibn Zejdi e të tjerë? Duhet theksuar se pasardhësit e Aliut (alevitët), për t'u ruajtur nga dhuna e tyre, u shpërndanë nëpër skajet më të largëta, si në Indi e në Iran. Madje shumë prej tyre, për të ruajtur afërsinë e tyre me Profetin (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), arrinin deri aty sa të fshihnin edhe origjinën e tyre.*

*Nëse emevitët helmuan disa prej pasardhësve të imam Aliut dhe disa prej pasardhësve të Abbàsit, nuk ke*

*përse të pyesësh se sa e deri ku shkoi tradhtia dhe pabesia e abasive ndaj pasardhësve të Aliut. Nëse do të lexosh librin “Vrasësi i bijve të Tàlibit”, me siguri do të mësosh se ç’kanë punuar abasitët mbi ta.*

*Nëse emevitët, ditën e Taffit dogjën shtëpitë e bijve të Shtëpisë së Mesazhit, nga ana e tyre abasitët i vunë zjarrin shtëpisë së Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) derisa vetë Sàdiku është detyruar të dalë për të shuar flakët e zjarrit, që kishte arritur deri në bodrumin e shtëpisë.*

*Nëse emevitët, ditën e Taffit grabitën bijat e Shtëpisë së Mesazhit, Reshidi dërgoi komandantin e tij, El-Xhelùdij në Medine, që të rrëmbente nga bijat e fisit të Tàlibit të gjitha bizhuteritë që ato kishin. El-Xhelùdiu qe shumë më i ashpër se sa Xhelmedi në kryerjen e veprimeve. Ai nuk i la asnjërës prej bijave pasardhëse të Aliut apo të Tàlibit as stolinë më të vogël.*

*Pas ndodhisë me Zejdin, Hishami i detyroi të gjithë pasardhësit e Aliut të lënë Irakun dhe të shkojnë në Medine dhe ngarkoi persona që ata të mos i lejonin të dilnin kurrë prej tij. Gjithashtu, pas ndodhisë së Feh’hut, ai detyroi Mùsà El-Hàdiun, së bashku me fëmijët, të linte Medinen e të vinte në Bagdad, ku provuan urinë, tmerrin e raskapitjen nga ndodhitë që u detyruan të përballojnë.*

*Nëse dëshirojmë të bëjmë një krahasim mes veprimeve të dy shteteve, do të shohim se çdo veprim të keq, që ndërmoren emevitët kundër Ehli Bejtit, do ta gjejmë të shumëfishuar prej abasive, veprimet e të cilëve, në fakt, kryheshin nën shembullin e veprimeve të emevive, me ndryshim se abasitët, nga dita në ditë i rënduan gjithnjë e më shumë veprimet e tyre kundër familjes së pastër. Jo vetëm kaq, por abasitët praktikuan kundër pasardhësve të Aliut veprime shtesë shumë të rënda, që nuk i kishin bërë emevitët. Ata shkuan deri aty sa pasardhësit e Aliut i futën nëpër qyngje e tuba, mbi të cilat Mensuri vuri themelet e*

*ndërtesave të Bagdadit. Mos pyet se sa zotërinj të rinj, prej pasardhësve të Aliut, të pajisur me virtytet më të larta, murosi Reshidi në themelet e atyre ndërtesave.*

*Mbi varrin e Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) ishte një pemë, nën hijen e së cilës qëndronin vizitorët. Por Reshidi e preu pemën, kurse Mutevekkili shkatërroi varrin e Husejnit, ndërtesat e shtëpitë që ishin përreth varrit. Gjithashtu, që të mos shiheshin fare shenjat e varrit, ai lëroi dhe mbolli tokën e Kerbelasë. Për këtë veprim të tij u tha:*

*“Për All’llah, kur erdhën Beni Umejjet,  
djali i vajzës së Profetit u vra padrejtësisht;  
Por kur erdhën bijtë e xhaxhait të tyre,  
pasha jetën tënde, ata u lëshuan të shembnin  
varrin e tij;  
Me keqardhje, që s’ morën pjesë në vrasjen e  
tij,  
ata e ndoqën atë me shkatërrim.”*

*Në fakt, sundimi i emevive vazhdoi 1000 muaj. Gjatë kësaj kohe ata vranë më të mirët e pasardhësve të imam Aliut. Nëse do të bëje llogari se sa kanë vranë, që nga fillimi i sundimit të abasive dhe për 1000 muaj, do të rezultonte se abasitët kanë vranë prej pasardhësve të imam Aliut disafish më shumë nga sa kanë vranë emevitët. Arsyeja e vetme e asgjësimit të tyre ishte se ishin të virtytshëm dhe të afërm të Profetit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Jahja Mùsà ibn Isà, i cili luftoi njerëzit që ishin në kurth, për Husejnin dhe shokët e tij, që u zunë në kurth, thotë: “Për Allah, ata ishin njerëzit më të nderuar*

*e më bujarë që ka krijuar All'llahu, ata ishin njerëzit, që kishin më shumë të drejtë të kishin atë që ishte në dorën tonë, por pushteti është shterp. Sikur ai, që prehet në këtë varr, d.m.th. Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) të na e hiqte pushtetin, ne do t'i prisnim me shpatë hundën deri në rrëzë.”<sup>1</sup>*

*Edhe pse ky mëkatar guxon të pohojë fajin e vet, përsëri nuk e thotë të vërtetën ashtu siç është. I Dërguari i All'llahut dhe të tjerët nga familja e tij nuk e kanë kërkuar pushtetin për pushtet, por për fenë, për të urdhëruar veprimin e mirë, për të ndaluar veprimin e urryer dhe për të zhdukur sajesat e shkarjet në rrugën e gabuar. Sikur ata të kishin kërkuar pushtetin për pushtet, ne kurrë nuk do të hidhnim mbi emevitët e abasitët shigjetat e njollosjes për atë që kanë bërë me pasardhësit e Talibit. Vallë, a qortohet triumfatori me të ngjashmin e tij, kur të dy kanë ngritur shpatat mbi sulltanin?!*

*Husejni, në kryengritjen e tij, Zejdi, në ngritjen që bëri, Jahja, në luftën e tij në rrugën e All'llahut apo Husejni, që u mbrojt në Fah dhe të tjerë si këta pasardhës të Talibit, ishin burra të përkushtuar në fe dhe që shihnin në thellësi të punëve, që të gjithë për sulltanin (pushtetarin) sakrifikonin veten dhe atë që kishin më të shtrenjtë. Atëherë, si është e mundur të mendohet se ata kërkonin interesat e kësaj bote, në një kohë që ata ishin thirrës në fe, ishin drejtues të udhëzimit për në rrugën e drejtë dhe ishin fanarët e këtij udhëzimi?! Si ka mundësi të mendohet se ata kërkonin pushtet, në një kohë që e dinin se kishin atë forcë, në të cilën nuk i parakalon dot asnjë*

---

<sup>1</sup> “Mekâtilu-t”Tâlibijîn”, për vrasjen e Husejn ibn Aliut, në ndodhinë e Fahut.

*kryengritës që kërkon të arrijë fitore e triumf?! Po, ata ishin shpirtra të vyer e të shtrenjtë, të cilët kishin njohur se feja ishte më e vyer se shpirtrat e tyre. Ai, që e ka të lartë çmimin, nuk e ka të vështirë ta blejë. A nuk e mësuan njerëzit të vërtetën, që feja u bë e qartë vetëm pas këtyre kurbanëve dhe a nuk doli në shesh e vërteta mbi të gabuarën me argumente e fakte vetëm pas këtij flijimi?!*

*Ndodhia e Taffit dhe sakrificat e pasardhësve të imam Aliut ishin shembull për krerët e fesë dhe mësim për ata që njohin të vërtetën në konkurrencën ndërmjet udhëzimit për në rrugën e drejtë dhe shkarjes në rrugën e humbjes. Gjithashtu, ato sakrifica nuk kanë lënë më shteg që thirrësit e fesë të kërkojnë ndjesë për të mos u sakrifikuar në rrugën e dhënies së ndihmës e mbështetjes, sepse ata, me veprën e tyre, i mësuan thirrësit e fesë se si arrihet fitorja në këto sakrifica, ç'kuptim merr jeta në këto vdekje dhe se pikërisht, ato sakrifica janë frerë që ndalojnë gojët për të kërkuar ndjesë për pamundësi. Fitorja nuk mund të jetë një triumf i shpejtë, me përjashtim të fitores që u realizua në ditën e Husejnit dhe të fitores që korrën mbi armiqtë e tyre pasardhësit e Aliut dhe mbështetësit e tyre, megjithëse njerëzit i kanë njohur fitoret e tyre vetëm pasi kaloi një kohë e mirë. Atëherë njerëzit mësuan se pasuesit e Aliut i arritën ato fitore me veprimtaritë e me kryengritjet që bënë në rrugën e fesë. Por krahas kësaj, njerëzit mësuan se humbja e madhe në këtë botë dhe në fe që pikërisht për armiqtë e tyre, edhe pse në ato ditë ishin fitimtarë.*

*Nga këto ngjarje e ndodhi bota mori vesh se çfarë ka bërë Ehli Bejti për fenë dhe ç'luftë ka bërë për të ringjallur ligjin e fesë. Gjithashtu, njerëzit morën vesh se sa të dhënë*

*ishin armiqtë e Ehli Bejtit pas interesave të kësaj bote dhe si ata e kanë luftuar fenë. Nga zhvillimi i këtyre ngjarjeve u bënë të qarta qëllimet e të dyja palëve dhe dolën në dritën e diellit synimet e punëve të të dyja grupeve. Atëherë, ç'faj ka foshnja, që i është tharë qumështi, ç'faj ka foshnja, që i janë çarë buzët nga etja e madhe, kur së fundi ai vritet mbi kraharonin e babait të tij dhe shigjeta e bën të dridhet si një shpend i therur?!*

*Ç'faj kishin ata fëmijë, që nuk kishin armë në dorë, që u zhytën në vorbullën e përgjakshme të luftës dhe që u therën me aq gjakftohtësi apo që u shtypën nën thundrat e kuajve?!*

*Ç'faj kishin femrat e familjes së të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të merreshin robëresha lufte e të poshtëroheshin, pasi më parë ishin grabitur, sharë e rrahur? Përse ato u çuan sa në një vend në një tjetër, ashtu siç çoheshin skllëvërit nëpër tregje?!*

*Edhe sikur Husejni me të tijtë, të kishte luftuar për pushtet, pas vrasjes së tij, në asnjë mënyrë nuk mund të ishte e lejuar që trupi i tij të shkelej me këmbë, që koka e tij të vihej në majë të ushtës dhe që familja e tij të robërohej e të poshtërohej. Si mund të mendosh se atyre, që ua prenë kokat, atyre që iu çanë gjokset e shpinat nga patkonjtë e kuajve dhe kufomat u lanë pa u varrosur e lakuriq mbi sipërfaqen e tokës, u hodhën në kryengritje për pasuri e pushtet?!*

*Por ajo, që hedh kripë mbi plagën, që gërvisht çibanin dhe që shton akoma më shumë fatkeqësinë, është*



*se njerëzit i bënë ato veprime makabre mbi Husejnin e familjen e tij duke mos e ditur pozitën e tij dhe duke besuar se ai kishte dalë nga feja. Jo, ata e dinin mirë se ai ishte mbrojtës i fesë, ishte zotërues i kalifatit dhe i imamatit, ata e dinin se ai ishte zotëria i rinisë së Xhennetit dhe borziloku i të Dërguarit, madje ata i njihnin mirë edhe të gjitha përparësitë e virtytet e tij.*

*Nëse do të bësh një “inspektim” në një çështje tjetër, përveç asaj të Husejnit, do të gjesh të njëjtën gjendje edhe me Zejdin, Jahjan dhe me ata që u vranë në Fah’, pa folur për të ngjashëm me këta nga pjesëtarët e Ehli Bejtit, që ranë nën tehun e shpatave, efektin e helmit apo që u mbyllën nëpër qelitë e errëta të burgjeve. Që të gjithë i njihnin mirë, ashtu siç njihnin Husejnin, prandaj e vërteta është se ata, të gjitha padrejtësitë e mizoritë ndaj tyre, i kanë kryer me qëllim.*

*Nuk është hera e parë që bota mëson për këto qëndrime konkrete e për këto dëshmi të njohura se lufta ndërmjet Ehli Bejtit dhe armiqve të tyre është lufta ndërmjet virtytit e poshtërsisë. Ata, që synojnë pushtetin, nuk mund të ulen dot mbi fron pa luftuar Ehli Bejtin, mundësisht ta fshijnë nga fleta e ekzistencës. Ata janë të vetëdijshëm se nuk e arrijnë dot qëllimin e tyre, pasi përfytyrimi i Ehli Bejtit është i pranishëm dhe në hijen e tij njerëzit kthehen vazhdimisht. Atëherë, ku qëndron krimi i Ehli Bejtit ndaj njerëzve, përveç asaj që ata ishin mbartësit e fesë dhe zotëruesit e virtyteve?! Por njerëzit nuk mund të ngjisnin shkallët e postit të kalifit kur Ehli Bejti ishte më i denjë për atë post, sepse hilafeti është krijuar për ta dhe ata janë krijuar për të, prandaj i gjithë ummeti i dallon ata ndër të gjithë bijtë e Islamit.*

\* \* \*

## **MEDH'HEBET DHE FRAKSIONET**

*Koha, në të cilën jetoi imam Ebù Abdil-lah Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ishte koha e pretendimeve të rreme (fraksioneve), medh'hebeve, mendimeve, dëshirave, fjalëve, studimeve, sajeseve, shkarjeve në rrugën e humbjes, përngjasimeve dhe dyshimeve. Në vijim do të përmendim shkurtimisht bazat e grupeve të medh'hebeve (shkolla juridike të fesë) sipas metodologjisë që kemi ndjekur deri tani, pasi shtrirja në studime na nxjerr nga esenca e librit. Në librin “El-milelu uen'nihalu” ka mjaft material për këto grupe e medh'hebe.*

### **Bazat e grupeve islame**

*Ummeti islam është ndarë në 73 grupime, ashtu siç kishte njoftuar Profeti i drejtë dhe besnik (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në fjalën e tij: “Ummeti do të ndahet në 73 grupime...”. Nuk ka dyshim se ky është nga njoftimet e shumta të profetësisë së tij.*

*Në këtë kapitull, objekti i studimit tonë do të jenë grupet më të dallueshme, që njiheshin në kohën e imam Sàdikut. Gjithashtu, studimin tonë dëshirojmë ta lokalizojmë në bazat mbi të cilat dolën grupimet e*

*degëzimet. Pasi të trajtojmë bazën, do të tregojmë edhe për disa nga këto degëzime, me synimin që kështu të jemi sa më afër qëllimit tonë dhe plani, që kemi vënë, të jetë më i prekshëm.*

*Në fakt, bazat, mbi të cilat mbështeten të gjitha grupimet islame, janë katër: murxhi'at, mu'tezilitët, shi'itët dhe havarixhët.<sup>1</sup> Çdo grupim tjetër mbështetet në njërin nga këto baza, kurse të gjithë ekstremistët (gulât) e çdo grupimi, përfshihen në kategorinë e mohuesve, edhe pse ata pretendojnë se janë degëzime të këtyre bazave. Gjithsesi, objekti i studimit tonë do të jenë këto katër baza.*

### *1 – Murxhi'at*

*Mund të themi se në ditët e sotme me murxhi'a përfshihen vetëm esh'arijtë, që në kohën tonë janë masa e Ehli Sunnetit në besim. Në ditët e sotme nuk dihet të ketë mbetur ndonjë, që të përmbahet në grupin e atyre që u larguan e u mënjanuan nga rruga e drejtë e Islamit.*

*Para esh'arijve murxhi'at ishin shumë grupe dhe që të gjithë ishin pjesë e Ehli Sunnetit përballë shi'ave dhe havarixhëve. Por kur në medh'hebin esh'arij ndodhi përmbysja në besim, atëherë murxhi'at u bënë një emër tjetër për Ehli Sunnetin ose për medh'hebin esh'arij në përgjithësi. Shehrastâni, në librin "El Milelu uen'Nihalu"<sup>2</sup>, ka shkruar: "U fol për vonimin e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) prej shkallës së parë deri në të katërtën." dhe vetëm*

---

<sup>1</sup> "Firaku-sh'shi'ah" i Ebû Hasan En'Nûbekhtij, f. 17; Ibn Hazmi në pjesën e dytë, f. 88 ka përmendur se pesë prej tyre e bëjnë Ehli Sunnetin një grup më vete përballë murxhi'ave dhe mu'tezilitëve.

<sup>2</sup> Shtypur në margjinaturën e kapitullit, vëll. 1, f. 145.

*kaq. Siç shihet, kjo fjalë përkon me atë që thotë i gjithë Ehli Sunneti.*

*Qëllimi ynë nuk është të studiojmë në mënyrë të njëanshme të gjitha këto emërtime të përfshira në medh'hebin esh'arij apo t'i ndajmë ato prej tij. Në të vërtetë, qëllimi ynë parësor është që të njohim se ç'përfaqësojnë murxhi'at në ditët e sotme, pasi nuk ka dyshim se murxhi'at e asaj kohe ishin grupe e medh'hebe që i bashkonte thënia e tyre: "Është i mjaftueshëm vetëm besimi me fjalë, edhe nëse nuk shoqërohet me punë, madje edhe atëherë kur ai që pretendon se ky besim kryen krime e mëkate nga më të rëndat." Megjithëkëtë, mëkatet e krimet te murxhi'at nuk e nxjerrin mëkatarin nga lidhja e tij me besimin, pasi murxhi'at i përmbahen pikëpamjes se ky mëkatar mbetet në besimin e Xhibrilit e të Mikàilit. Gjithashtu, për këta bërës të mëkateve të mëdha, ata shpresojnë faljen e mëkateve. Mbase nga ky kuptim ata u quajtën murxhi'a, në kuptimin se All'llahu e vonon dhe e shtyn dënimin e mëkatarëve. Në këtë kuptim, emri "murxhi'a" ka dalë nga fjala "irxha" – vonim ose u adresohet edhe atyre që e shtynë imam Aliun nga grada e parë në të katërtën, ashtu siç e ka cituar Shehrastaniu.*

*Më e shumta, që mund të mësohet nga ajo që thuhet për grupet e murxhi'ave, rezulton të jetë ajo që ne treguam më lart dhe për të cilën bëjnë fjalë librat e të dyja grupeve, ku përmendet ajo që i bashkon dhe ajo që i ndan grupet e tyre.*

A ishte Ebù Hanifeja dhe të ngjashëm me të prej murxhi'ave el-màsirijeh,<sup>1</sup> që janë murxhi'at e banorëve të Irakut apo Shafi'iju, Theurijju, Mâlik ibn Enesi, Ibn Ebi Lejlà, Sherijk ibn Abdullah e të ngjashëm me këta prej murxhi'ave, të cilët quheshin "Esh'shekàk", ose "El Beterijjeh" dhe që janë masa e gjerë e quajtur hasheuijeh. Për këtë çështje ne nuk kemi mundësi të flasim me saktësi, sepse vetë librat e grupimeve japin mendime të ndryshme për bazën e afërsisë së këtyre grupeve, të cilat, për të vërtetuar fjalën që thonë, nuk janë mbështetur në ndonjë burim të qartë që na jep mundësi të njohim saktësinë e thënieve të tyre. Nëse ka fanatizëm në mendimet e paqarta e në medh'hebet e këtyre autorëve, kjo vërehet në faktin kur mendimet e tjera i bëjnë objekt të synimeve të veta. Kjo ka ndihmuar pushtetarët e atyre kohërave në fushën e fajësimit, të cilët, kur donin të bënin propagandë në favor të një grupi, ose kur donin të luftonin një grupim tjetër, kundrejt shpërblimit, angazhonin oratorë e podiume. Pikërisht këtu mund të humbë e vërteta për cilindo që nuk ka parime e që nuk e ndjek dot fillin e ngjarjes.

Ka të ngjarë që shumë nga këto libra e vepra të kenë rënë në çarqet e shtrirjes e të përzierjes së çështjeve.

Fjala më e zgjedhur, për këtë çështje, është se mbështetja në këto libra, për të njohur origjinën e atyre grupimeve, nuk është punë e lehtë, pasi për nga qartësia e

---

<sup>1</sup> "El Milelu uen'Nihalu" në anësoret e kapitullit: vëll. 1, f. 147, në fjalën e tij, në lidhje me merxheitë El-Gassànijeh. Gjithashtu, në f. 151 në fjalën e tij, në lidhje me burrat e merxheive; janë përmendur disa biseda të zhvilluara me Ebù Hanifen, kur ai u fliste pasuesve të tij: "Na është kumtuar, o murxhi'a..." Ehe Ebù Hanifeh nuk e ka mohuar lidhjen me murxhi'at. Për këtë referoju "Tàrikhul-Khatib", vëll. 13, f. 370 dhe në vijim, ku do të gesh hollësi për lidhjen e tij në murxhi'at.

*besimit, ashtu siç e përmendëm dhe ashtu siç pohojnë shumica e librave, origjina e tyre shkon nga murxhi'at deri të xhehmijtë, që ishin pasues të Xhehm ibn Safuànit.*

*Gjithashtu, ata kanë transmetuar, në lidhje me mallkimin e murxhi'ave prej Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) kur iu tha: "Kush janë murxhi'at, o i Dërguar i All'lahut?", ai tha: "Ata që thonë se besimi është fjalë."<sup>1</sup>*

*Si rezyeme, mund të themi se murxhi'at, në atë kohë, ishin të ndarë në shumë grupe, të cilat, ashtu siç e thamë më lart, i bashkonte mendimi se për besimin mjafton vetëm fjala, edhe kur nuk ka punë që përputhet me këtë besim, madje edhe kur puna është në kundërshtim me fjalën. Ne nuk kemi nevojë të hyjmë në thellësi të rrymave e të veçorive të besimit të këtyre degëzimeve, që të arrijmë njohjen e vlefshmërisë, kur ne vetë jemi në një fushë ku mund të biem në të tilla rrëshqitje, prandaj i lutemi All'lahut të Lartësuar të na mbrojë nga gabimet dhe të na japë siguri nga e keqja.*

## *2 – Mu'tezilitët*

*Nuk ka dyshim se largimi (i'tizàli) u shfaq në kohën e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe se kjo rrymë lindi dhe u rrit në atë kohë. Rryma e mu'tezilitëve doli atëherë kur ndodhi largimi i Amr ibn Ubejdit, Uàsil ibn Atàsë e i të tjerëve që ishin në rrethin e Hasan Basriut. Pikërisht nga largimi ata u etiketuan me emrin "të larguarit", "të mënjanuarit" (mu'tezile). Gjithashtu, është thënë se largimi e mënjanimi (i'tizàli) është shfaqur në kohën e Prijësit të Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) atëherë kur prej luftërave të*

---

<sup>1</sup> El-Farku bejne'l Firak, f. 190.

*tij u larguan e u mënjanuan Sa'd ibn Ebi Uekkâsi, Ibn Umeri dhe Usâme ibn Zejdi. Për këtë çështje, nuk mund të ketë vlerësim, sepse ai mënjanim nuk qe mënjanim e veçim juridik, i bazuar në mendimin apo në dyshimin në fe, por një largim prej Prijësit të Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) prandaj në atë kohë nuk ishte i njohur emri i mu'tezilitëve. Madje, në atë kohë ata as nuk ishin emërtuar me emrin mu'tezile. Për më tepër mu'tezilitët e asaj kohe nuk mbështeteshin në ndonjë medh'heb.*

*Edhe mu'tezilitët u ndanë në grupe të shumta, menjëherë pasi ranë dakord që të qëndronin të mënjanuar. Në ditët tona nuk ka ndonjë që të dihet se i përket atyre dhe unë, personalisht, nuk mendoj se ka të tillë.*

*Është shkruar qartë nga autori i librit "Dallimi ndërmjet grupimeve" – (El-Farku bejne'l Firak) – f. 94, se çfarë e bashkon besimin e mu'tezilitëve: "Të gjithë mu'tezilitët kanë një mendim të përbashkët se All'llahu i Lartësuar është një send jo si të gjithë sendet dhe se Ai është Krijuesi i trupave e i të gjitha gjendjeve; çdo gjë All'llahu e ka krijuar nga asgjëja, njerëzit i bëjnë punët e tyre sipas atij caktimi që ka vënë All'llahu i Madhëruar për ta. Të gjithë grupet e mu'tezilitëve ndajnë një mendim të përbashkët se All'llahu nuk i fal pa bërë pendim (teubeh) ata që kryejnë mëkate të rënda."*

*Në përgjithësi, kjo është ajo çka na tregon autori sipas citimit të El-Ka'biut për besimin e mu'tezilitëve, prandaj edhe ne do të mjaftohemi vetëm me kaq, pasi ne nuk jemi ata që japin këshilla e që vëmë peshoren e kritikës për fjalët e tyre. Por ne dimë të vërtetën e fjalës së drejtë, që ka thënë autori i librit "El Firek" në shumë thënie të tij.*

*Gjithashtu, ne nuk do të zgjerohemi në studimin tonë rreth degëve të asaj baze dhe në të veçantën që karakterizon çdo degëzim të tyre në besim, përveç asaj që ata kanë të përgjithshme, pasi zgjerimi dhe shtrirja na largojnë nga qëllimi i vënë, megjithëse edhe kështu, nuk mund të jemi të siguruar nga e keqja.*

*A janë kaderijtë pikërisht mu'tezilitët apo ata janë vetë esh'arijtë? Ky është objekt dyshimi, sepse, nëse do të themi që mu'tezilitët janë kaderijtë, gjejmë nga kaderijtë që thonë: "Punët e njerëzve janë të krijuara për ata dhe se punët bëhen sipas atij caktimi që është i posaçëm për ta, sepse All'llahu ka krijuar te njerëzit forcë e fuqi, që njerëzit t'i bëjnë punët." Po kështu thonë mu'tezilitët, ashtu siç u shpjegua më lart në përgjithësi për thëniet e tyre. Megjithëkëtë, kaderijtë nuk mund të jenë si esh'arijtë, sepse esh'arijtë janë në kundërshtim më atë që u tha më lart, sepse ata besojnë se të gjitha punët janë krijim i All'llahut të Lartësuar dhe i caktimit të Tij dhe se punët nuk janë prej njerëzve.*

*Gjithashtu, ne gjejmë se nga kaderijtë ka që thonë se kaderi (caktimi) me të mirën e të keqen është prej All'llahut të Lartësuar, prandaj nga kjo pikëpamje ata janë plotësisht si esh'arijtë.*

*Shehrastaniu ka transmetuar prej Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai ka thënë: "Kaderijtë janë mexhûsët (adhurues të zjarrit) e këtij ummeti", si dhe fjala tjetër e tij: "Kaderijtë janë armiq të All'llahut në kaderin."<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Referohu në librin "El-Milelu uen'Nihalu", në të shtypurën anësore të pjesës së parë, f. 50-51.



*Ne nuk e dimë, nëse ky transmetim është i saktë, se kujt i drejtohet ky poshtërim i drejtpërdrejtë dhe se kujt i vihet kjo etiketë diskredituese.*

### *3 – Shi'at*

*Shi'at ishin që në kohën e lumtur të sjellësit të ligjit të fesë. Me emrin “shi'a” u emërtuan disa nga sahabët e nderuar që nga ajo kohë, siç ishin: Selmani, Ebù Dherri, Mikdâdi, Ammâri, Hudhejfe, Khuzejme, Xhâbiri, Ebù Seid El-Khuderiu, Ebù Ejjûbi, Hâlid ibn Seid ibn El-Às, Kajs ibn Sa'd e të tjerë.<sup>1</sup>*

*Nga pikëpamja gjuhësore fjala “shi'a” do të thotë: ndjekës, dishepuj, ndihmues. Origjina e kësaj fjale është “mushâje'ah” - e shoqëroi atë, e ndoqi atë. Kjo fjalë është bërë karakteristikë për ndjekësit dhe dashamirët e imam Aliut e të familjes së tij.<sup>2</sup>*

*I pari, që e ka shqiptuar fjalën “shi'a”, me qëllimin për të përcaktuar atë që ndjek dhe do Aliun e imamët, që janë prej familjes së tij, është vetë sjellësi i ligjit të fesë, zotëria i të gjithë profetëve (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), prej të cilit, për këtë çështje janë transmetuar disa hadithe.<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> “El-Istij'âb”, në lidhje me Ebù Dherrin; “Ed'Derexhetu-rr'Rrefi'ah” e autorit Sejjid Ali Khân në parathënien për Selmanin; “Reudâtul-Xhennât”, cituar prej librit “Ez'Zijneh” të Ebù Hâtem Er'Râziz; “Sherhu-n'Nehxh”, vëll. 4, f. 225; “Khututu-sh'Shâm” e Muhammed Kerdali, vëll. 5, f. 251-256.

<sup>2</sup> “El-Kâmûs”; “Lisànul-Arab”; “En'Nihâjeh” e Ibn Ethirit; “El Mukaddimeh” e Ibn Khaldûnit, f. 138 dhe të tjerë libra si këto.

<sup>3</sup> Për këtë çështje referohu në librin “Es'Sauâik”, pas ajetit të tetë dhe ajetit të dhjetë, që flasin për mirësitë e virtytet e EHLI BEJTIT; “En'Nihâjeh” e Ibn Ethirit; “Ed'Durrul-Menthûr” e Sujutiut në komentin e fjalës së të Lartit: “Në të vërtetë, ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira,

*Përsa i përket grupeve të shi'ave, ato janë të shumta dhe në disa libra të vëllimit "El Milelu uen'Nihal", janë numëruar më shumë nga sa njohim prej tyre. Në këto libra janë përmendur grupe të shumta, që mbajnë emrat e drejtuesve të vet, si: hishàmijte, sipas emrit të Hishàm ibn Hakemit; zeràrijte sipas emrit të Zeràreh ibn A'junit; shejtànijte, sipas emrit të Mu'min Et'tàk Muhammed ibn En'Nu'màn El-Ahuelit; junusijte, sipas emrit të Junus ibn Abdurrahmànit, si dhe të tjera grupime që pretendojnë se origjina e tyre është Ehli Bejti. Por Ehli Bejti e di më mirë nga ne sa të vërteta janë pretendimet e tyre. Për më tepër, ne nuk dimë asgjë konkrete nëse ka ndonjë gjurmë të këtyre grupeve, ashtu siç nuk dimë gjë për fjalët që thuhën për origjinën e atyre burrave.*

*Kushdo që shikon në librat e haditheve dhe në librat e autorëve shi'a, do të mësojë se ata janë nga imamët e përveçëm, mbi të cilët shi'at mbështeten dhe i referohen. Nëse ata do të kishin mendime e medh'hebe, nga të cilat imamët nuk do të ishin të kënaqur, patjetër që do të zemëroheshin me ta dhe do t'i largonin nga vetja. Kush e fsheh atë që është njoftuar nga burra që kanë stisur sajaset për diturinë e imamëve, në një kohë që ata nuk kanë asnjë përgjegjësi për atë që u vishet atyre?! Prandaj ata, për fjalët, që u vishen, janë krejtësisht të pafajshëm, ashtu siç ndodhi me fjalët që sajoi për ta Ibn Sebei, të cilin ata e mallkuan dhe u ruajtën prej sajeseve të tij. Gjithashtu, ata janë krejtësisht të pafajshëm prej fjalëve të Mugireh ibn Seidit, kur ai filloi të gënjejë për Bâkirin (Paqja qoftë mbi të!) dhe të shpifë për të broçkulla të padëgjua; ashtu siç është krejtësisht i pafajshëm edhe Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) prej*

---

*janë njerëzit më të mirë." (Sure "El-Bejjine", ajeti 7), si dhe në ajete të tjera të ngjashme të Kur'ànit.*

asaj që i vunë Ebul-Khattàbi e grupi i tij ose edhe prej Ebul-Xhàrùdit dhe ashtu siç kanë thënë për fisin Benij Fedâl: “Merreni atë çka tregojnë dhe lëreni atë çka ata mendojnë.” Po kështu, ata nuk kanë asnjë përgjegjësi për argumentin e fshehur nga një grup njerëzish, të cilët bënë përzierje të çështjeve të fesë e pastaj pretendonin se janë portat e vetë fesë. Nuk është e nevojshme të përmenden gënjeshtarë të tjerë të këtij kallëpi.<sup>1</sup> Sikur këta burra të kulluar të manifestonin të tilla shkarje në rrugën e humbjes që u vihen, me siguri që ardhmëria e tyre, si imamë, do të ishte e njëjtë me atë që pret cilido që shkon me dashje në rrugën e humbjes. Në vend të pastërtisë e të pafajësisë do të kishin poshtërimin e mallkimin.

Është e vërtetë se shi’at, para kohës së imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi tël) ishin grupe, por, edhe pas tij, ata kanë qenë grupe, që kanë shkuar shumë larg, megjithëse sot prej këtyre grupeve nuk ka mbetur më asgjë që të njihet, përveç tre grupeve që janë:

1. Imàmijët: janë ata që u përmbahen të dymbëdhjetë imamëve dhe se imami i dymbëdhjetë ka lindur e është i gjallë edhe në ditët e sotme, prandaj imàmijët, në çdo çast, janë në pritje të shfaqjes së tij.
2. Zejditët: janë ata që besojnë për imam Zejdin dhe cilindo që ka qëndruar me shpatë në dorë nga bijtë e Fatimesë e ka qenë i pajisur me të gjitha cilësitë e lavdërueshme.

---

<sup>1</sup> Për të gjitha këto referohu në “Gajbeh” e shejhut Tùsij - Qoftë gjithmonë erëkëndshme trashëgimia e tij!

3. *Ismailijtë: janë ata pas Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe që njohin për imam djalin e tij, Ismailin dhe nuk njohin Mùsà Kadhimin dhe djemtë e tij (Paqja qoftë mbi ta!).*

*Kaq kanë mbetur nga grupet e shumta të shi'ave, që njihen që nga kohët e largëta e deri në ditët e sotme. Përsa i përket asaj, që ata kanë pasur në kohën e kaluar, ajo është objekt i studimit të En'Nùbehtiut në librin e tij "Firaku-sh'shi'ah" (grupet e shi'ave). Në ditët e sotme, përveç grupeve që u përmendën, nuk ka mbetur ndonjë grup prej grupeve të shi'ave që të njihet.*

*Është në interes të studimit tonë të përmendim ato grupe që ishin në kohën e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) edhe pse në ditët e sotme nuk ka mbetur prej tyre asnjë gjurmë.*

#### *Kisànijtë <sup>1</sup>*

*Ndër grupet shi'ite, që ishin në kohën e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) ishin edhe ata që u quajtën kisanij, të cilët thoshin se imam është Muhammed ibn El Hanefijeh. Ka mendime të ndryshme për emërtimin e tyre me këtë emër. Kisanijtë përfunduan në grupime të ndryshme.*

*Një grup prej tyre thotë se Muhammedi është Mehdiu, është ai për të cilin ka lënë porosi Prijësi i Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) dhe askush prej njerëzve të familjes së tij nuk e kundërshton atë. Gjithashtu, ata thonë se edhe pajtimi, që bëri imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) me*

---

<sup>1</sup> Për shumë çështje, që ne kemi përmendur për kisanijtë jemi bazuar te librat: "Firaku Shi'ah"; "El Milelu uen'Nihalu" dhe "El-Farku bejnel Firak".

*Muàvijen, ishte me lejen e tij; po kështu ata thonë se edhe kryengritja që bëri Husejni (Paqja qoftë mbi të) përsëri është bërë me lejen e tij dhe gjithnjë me lejen e tij është ngritur edhe Muhtari në kërkim të gjakmarrjes. Një grup tjetër prej tyre thotë: “Ai është imam pas dy vëllezërve të tij të quajtur Husejn dhe se pikërisht ky është Mehdiu. Këtë emër atij ia vuri babai i tij dhe se ai nuk ka vdekur e nuk vdes. Kjo thënie është pa vlerë, sepse Mehdiu është fshehur dhe nuk dihet ku është, por ai do të kthehet dhe do të mbretërojë në të gjithë tokën. Gjithashtu, pas fshehjes së tij nuk ka më imam tjetër, derisa ai të kthehet.”*

*Ata që mbartin të tilla mendime janë pasuesit e Ibn Kerbit dhe prandaj janë quajtur grupi “Kerbijje”.*

*Një grup tjetër ka thënë se ai banon në malet Riduà, ndërmjet Mekkës e Medines dhe te ky grup ai është imami i pritshëm.*

*Një grup tjetër ka thënë: Ai ka vdekur dhe imam pas tij është djali i tij, Abdullahu, i cili thirret me epitetin Ebù Hàshim, pasi ai është më i madhi i djemve për të cilin ka lënë porosi babai i tij. Ky grupim është quajtur “Grupi i hashimijve” me imam Ebù Hàshimin, për të cilin ky grupim ka thënë ashtu siç kishin thënë grupet e mëparshme për babain e këtij se ai është Mehdiu, se është gjallë e nuk ka vdekur. Madje, për këtë çështje, ata kaluan në ekstremitet, kur thanë se ai ngjall të vdekurit. Kur vdiq vetë Ebù Hàshimi, pasuesit e tij u shpërndanë në grupime të ndryshme.*

*Duhet thënë se ndër kisanijtë ka pasur burra që kanë lënë emër dhe kanë qenë mjaft të dëgjuar, ashtu siç ka*

*pasur prej tyre që kanë arritur pushtet. Për këtë fakt ekziston edhe një poezi e përcjellë gojarisht.*

*Ndër kisanijtë ishte edhe i famshmi Sejjid Ismail El Humejriu, për të cilin ka edhe një poezi që dëshmon çka është thënë për të, por ai vetë hoqi dorë nga nderimi që ata i bënë në favor të njohjes së imamatit për imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) Kjo ndodhi pasi Sàdiku u ballafaqua me të e i vuri para fakte e argumente. Në lidhje me heqjen dorë prej tij dhe me pranimin e imamatit për Sàdiku, gjithashtu ka një poezi mjaft të dëgjuar.*

*Nga kisanijtë është Hajjàn Es'Seràxhi, i cili, një ditë hyri te imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) dhe imam Sàdiku i tha: “O Hajjàn, ç’thonë pasuesit tuaj për Muhammed ibn El Hanefijjen?”*

*Hajjàni u përgjigj: “Ata thonë se ai është gjallë dhe ushqehet.”*

*Atëherë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Babai im (Paqja qoftë mbi të!) më ka thënë se ai ka qenë ndër ata që e kanë vizituar Muhammedin gjatë kohës që ishte i sëmurë, madje ai është prej atyre që i ka mbyllur sytë dhe që e ka varrosur. Gjithashtu, babai më ka thënë se ka martuar gratë e tij dhe ka pjesëtuar pasurinë e lënë prej tij.”*

*Por Hajjàni tha: “O Ebù Abdil-lah, shembulli i Muhammedit në këtë ummet është si shembulli i Isàit, të birit të Merjemit, puna e të cilit iu shëmbëlleu njerëzve.”*

*Imam Sàdiku tha: “Puna e tij i shëmbëlleu miqve apo armiqve të tij?”*

*Hajjàni tha: “Jo, i shëmbëlleu armiqve të tij.”*

*Atëherë imam Sàdiku tha: “A beson se Ebù Xha’fer Muhammed ibn Aliu (Paqja qoftë mbi të dy!) ishte armik i xhaxhait të tij, Muhammed ibn El-Hanefijeh?”*

*Hajjàni u përgjigj: “Jo.”*

*Pastaj imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “O Hajjàn, ju u keni kthyer shpinën argumenteve të All’llahut të Lartësuar, i Cili, me madhërinë e Tij thotë: “...Ne do t’i dënojmë me dënimin të rëndë ata që shmangen nga shpalljet Tona, për shkak se u larguan.” (Sure “El-En’àm”, ajeti 157)<sup>1</sup>*

*Burejd El Axhelij<sup>2</sup> tregon: “Hyra te imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) dhe ai më tha: “Sikur të kishe ardhur pak më përpara, do të ishe takuar me Hajjàn Es’Seràxhin.” dhe bëri me shenjë në një vend të shtëpisë. Pastaj shtoi: “Ja aty ishte ulur, kur më përmendi Muhammed ibn El Hanefijjen, madje për jetën e tij më foli me aq shumë lëvdata, sa e ngriti në kult dhe i veshi gjëra të mëdha. Prandaj unë i thashë: “O Hajjàn, po thua gjëra të pavërteta dhe ata të tjerët po thonë të pavërteta. Ti po tregon, por edhe ata po tregojnë çdo gjë që ka ndodhur ndër Beni Israilët. Do të ketë një të ngjashëm edhe në këtë ummet?”*

*Ai tha: “Ashtu është.”*

*Atëherë i foli: “O kemi menduar ju dhe ne, a kemi dëgjuar për një dijetar, që ka vdekur para syve të njerëzve, gratë e të cilit u martuan dhe pasuria e tij u pjesëtua dhe*

---

<sup>1</sup> “Ikmâludîn” e Sudukut, f. 22; “Rixhàlu Keshà”, f. 203.

<sup>2</sup> Është nga pasuesit më në zë e ndër të besuarit e Sàdikut.

*që ky të jetë i gjallë e të mos vdesë?” Hajjàni u çua në këmbë dhe nuk më ktheu asnjë përgjigje.”<sup>1</sup>*

*Kisanijtë janë nga ato grupe të zhdukura dhe ne nuk kemi dëgjuar që sot të ketë ndonjë që thotë se i përket këtij grupi.*

### *Zejdijtë*

*Është prej grupeve që janë pasues të zejdijve, sipas emrit të Zejd ibn Ali ibn Husejn (Paqja qoftë mbi të dy!). Pasuesit e këtij grupi thonë se Zejdi është imam.*

*Vetë Zejdi nuk ka pretenduar se është imam, por janë njerëzit ata që e kanë një pretendim të tillë për të. Zejdi ka bërë thirrje për t’u ngritur vetëm për të ndihmuar të vërtetën e për të luftuar të gabuarën. Zejdi ishte tepër i lartë dhe me dinjitet për të kërkuar atë që nuk ishte e tij. Por edhe sikur të fitonte, patjetër që do të dinte se ku do ta vendoste veten. Disa hadithe, të transmetuara prej tij, flasin se imamati i takon atij. Pavarësisht nga këto hadithe, fytyra e tij është e shkëlqyer, sepse imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) që i druhej ligësisë së emevive, nuk mund të kishte më siguri, nëse do ta akuzonin se Zejdi u hodh në kryengritje me urdhrin e tij, pasi, për këtë “krim”, ndëshkimi do të binte mbi të, mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë pasuesit e tij. Prandaj imam Sàdiku, me këtë veprim sprapste rrezikun që i kanosej të gjithëve. Nëse Zejdi do të ishte ashtu siç e përshkruajnë ato hadithe, atë kurrë nuk do ta kishin qarë dy gjyshërit e tij, që para lindjes, për sprovat e rënda që do të kalonin, Muhammed Mustafai (Profeti) (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Murtedai (Aliu) (Paqja qoftë mbi të!), as nuk do të ishte*

---

<sup>1</sup> “Rixhàlul Keshà”, në shpjegimet për Hajjànin. f. 202.



*kumtuar prej atyre të dyve hidhërimi i thellë dhe pësimet e rënda që ai do të kalonte, ashtu siç ndodhi me prindërit e tij dhe me të pas vrasjes.*

*Për të treguar rëndësinë e kryengritjes së tij dhe pafajësinë e Zejdit, mjafton të përmenden vetëm fjalët që ka thënë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) kur ai qau mbi të, kur bëri pjesëtimin e pasurisë ndër familjet e atyre që u vranë përkrah tij dhe qortimin që ai u bëri atyre që nuk u ngritën ta ndihmonin. Gjithashtu, është e mjaftueshme të përmendet se ata kryengritës besimtarë, që u ngritën e luftuan së bashku me të, u quajtën mohues.*

*Si mund ta kërkonte ai imamatin për vete, kur imam Sàdiku thoshte: “E mëshiroftë All’llahu! Ai ishte besimtar, njohës i mirë i cilësive të All’llahut, ishte dijetar dhe i drejtë. Nëse ai do të kishte fituar, padyshim që do të ishte ruajtur nga mëkatet dhe nëse ai do të kishte sunduar, patjetër që do të dinte si të vepronte me sundimin.”<sup>1</sup>*

*Gjithashtu, imam Sàdiku thoshte: “Mos thoni se Zejdi doli të luftojë, sepse Zejdi, me të vërtetë, ishte dijetar, ishte i drejtë e i besueshëm dhe ai nuk ju bëri thirrje që të ngriheni për të, por ju bëri thirrje që të ngriheni për të ndihmuar Rizàin<sup>2</sup> kundër atyre që munduan Muhammedin (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij). Nëse ai do të kishte fituar,<sup>3</sup> patjetër që do ta mbante*

---

<sup>1</sup> “Rixhàlul-Keshà”, në përshkrimin për Sejjid El-Humejrij, f. 184.

<sup>2</sup> Rizà, është epiteti për imamin e kohës nga të Ehli Bejtit dhe ai është quajtur me epitet e nuk është thirrur në emrin e tij të plotë si masë mbrojtëse.

<sup>3</sup> Në një dorëshkrim, fjala “fituar” është “doli sheshit”.

*besën për atë thirrje që ju kishte bërë, sepse në të vërtetë, ai u ngrit kundër një sunduesi për ta përmbysur.”<sup>1</sup>*

*Imam Rizài (Paqja qoftë mbi të!) i thotë Me'mùniti: “Mos ushtro presion mbi vëllain tim, Zejdin. (është fjala për Zejd ibn Aliun (Paqja qoftë mbi të dy!) sepse ai ishte nga dijetarët e familjes së Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai zemërohej vetëm për të drejtën e All'llahut të Lartësuar. Ai i luftoi armiqtë e All'llahut derisa u vra në këtë rrugë.”*

*Imam Rizài vazhdoi të flasë dhe tha: “Zejd ibn Aliu kurrë nuk ka pretenduar ndonjë gjë për të cilën nuk kishte të drejtë. Ai ishte prej atyre që e kanë më shumë frikë All'llahun për këto çështje dhe ai vetëm ka thënë: “Unë ju bëj thirrje për Rizànë, që është nga të familjes së Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).”*

*Kjo deklaratë e qartë nga ana e imam Rizàit (Paqja qoftë mbi të!) u bë pikërisht në kohën e sundimit të abasitëve dhe për këtë, djali i tij, Jahjà, thotë: “Babai im – All'llahu e mëshiroftë! – ishte prej atyre që natën falnin namaz dhe ditën agjëronin. Ai ka luftuar në rrugën e All'llahut ashtu siç është e drejta e All'llahut të luftohet në rrugën e Tij.” Ndërsa Umejr ibn El-Muteuekkil El-Belkhij tregon: “Unë thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'llahut me këto cilësi të larta do të jetë imami?”*

*Ai më tha: “O Abdullah, babai im nuk ka qenë imam, por ai ishte nga zotërinjtë e nderuar dhe nga më të*

---

<sup>1</sup> “El-Uâfi ‘anil-Kâfi”, libri i argumentit, kapitulli: “Zejd ibn Aliu është i kënaqur”, vëll. 1, f. 141.

*përkorët prej tyre. Ai ishte prej luftëtarëve në rrugën e All'lahut.” Por unë përsëri i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) babai yt e ka pretenduar imamatin për veten e tij dhe ka dalë të luftojë në rrugën e All'lahut, por është shumë e vërtetë që i Dërguari i Allahut ka njoftuar edhe për gënjeshtarë, që do të pretendojnë imamatin!”*

*Atëherë ai më tha: “Mjaft, mjaft o Abdullah, babai im ishte aq i mençur, sa të mos pretendonte një gjë për të cilën nuk kishte të drejtë, por ai vetëm ka thënë: “U bëj thirrje për Rizàin kundër atyre që kanë munduar Muhammedin -(Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).” Këtë ma ka thënë djali i xhaxhait tim Xha'feri (Paqja qoftë mbi të!).”*

*Ndërkaq unë thashë: “Po, ai sot është jurist!”*

*Ai shtoi: “Ashtu është, ai është njeriu që e njeh më mirë ligjin e fesë ndër bijtë e Hàshimit.”<sup>(1)</sup>*

*Kjo bisedë nxjerr në pah pozitën e lartë të Zejdut në çështjet e fesë dhe në virtytet e tij, njëkohësisht hedh poshtë gjithçka të pavlerë e të padenjë që i janë veshur atij. Për Jahjàin është vërtetuar saktësisht pozita e lartë që ai kishte në dituri, në devotshmëri, në shkencë dhe në fushën e jurisprudencës.*

*Hadithet, që flasin për pastërtinë e Zejdut dhe për gradën e tij të lartë, janë të shumta dhe në fakt, ai ishte njeriu që e kishte shumë frikë All'lahun e ishte shumë i pastër për të njollosur veten e të pretendonte për vete imamatin. Por janë disa njerëz, që e kanë pretenduar*

*imamatin për të pas vdekjes së tij, pikërisht ata pretendues që njihen sot me emrin zejdi.*

*Zejdijtë janë grupe që ndajnë këtë mendim të përbashkët: Imamati është vetëm te pasardhësit e Fâtimesë (Paqja qoftë mbi të!) dhe ata nuk lejojnë vërtetimin e imamtit në të tjerë, përveçse në pasardhësit e Fâtimesë. Ata kanë lejuar që çdo pasardhës i Fâtimes të jetë dijetar, i përkorë (zâhid) trim e bujar, që ka dalë imam me shpatë. Është detyrë bindja ndaj tij, qoftë nga pasardhësit e imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) qoftë nga pasardhësit e imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!). Më pas, një grup prej tyre është shprehur për imamatin e Muhammedit e të Ibrahimit, dy djemtë e Abdullah ibn Hasan ibn Hasanit<sup>1</sup>. Mendoj se kushtëzimi i imamtit te bijtë e Fâtimesë ka të bëjë me atë se cili do të ishte imam pas Zejdit, pasi, disa grupe mendojnë se imamati është vërtetuar për të dy pleqtë, Ebù Bekrin dhe Umerin, ashtu siç do të mësojmë më pas.*

#### *Beterijtë*

*Nga grupet e zejdiëve janë edhe beterijtë, të cilët janë ndjekësit e Kethir En'Neuà, Hasan ibn Sàlih ibn Hajj, Sàlim ibn Ebù Hafsah, Hakem ibn Uajneh, Selemeh ibn Kuhejl dhe të Ebul-Mikdàm Thàbit El-Haddàd, pra, janë ata që bënë thirrje për vilajetin (sundimin) e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) por më pas ata e përzier çështjen e vilajetit edhe me vilajetin e Ebù Bekrit e të Umerit, duke vërtetuar imamatin edhe për ata të dy. Gjithashtu, ata atakuan Osmanin, Talhanë, Zubejrin dhe Àishenë. Thuhet se u quajtën beteri, për shkak se Zejd ibn Aliu u tha atyre kur*

---

<sup>1</sup> El-Milelu uen'Nihalu", shtypur në margjinaturën e kapitullit, vëll. 1, f. 159.

filluan të përmendnin besimet e veta: “E ndërpretë punën tonë, ju ndërpreftë All’llahu!”; por thuhet, gjithashtu, se ata u quajtën me këtë emër për shkak të origjinës së tyre si ndjekës të Kethir En’Neuàsë, i cili ishte dorëprerë.<sup>1</sup>

Nëse kjo origjinë do të ishte e vërtetë, do të qe më e drejtë që ata të quheshin “ebterij” dhe jo “beterij”.

### Sulejmanijtë

Nga grupet e zejdiive janë edhe sulejmanijtë, që i mbështeten Sulejman ibn Xheririt. Sulejmanijtë besojnë në imamatin e të dy pleqve: Ebù Bekrit dhe Umerit, por ata kundërshtonin Osmanin, Talhanë, Zubejrin dhe Àishen, madje i akuzonin për mohues. Gjithashtu, ata thoshin se imamati është kolegjal (shùrà) dhe se do të lidhet duke vënë dy burra nga më të mirët e ummetit. Sulejmanijtë lejojnë që imam të caktohet edhe një që ka më pak merita e virtyte, pavarësisht se është një tjetër me më shumë merita e virtyte. Gjithashtu, ata pretendojnë se ummeti, në rastin e besëdhënies, la më të përshtatshmen e më të mirën kur i dhanë besën Ebù Bekrit e Umerit, duke lënë Aliun në një kohë që Aliu e meritonte imamatin më shumë se ata të dy. Megjithëkëtë, gabimi i besëdhënies për ata të dy nuk e bën të detyrueshme etiketimin mohues e mëkatar i madh.<sup>2</sup>

Nga sa u tha deri tani, bëhet e qartë se, ndër pretendimet që vihen në gojën e zejdiive, imamati pas Zejdit nuk mund të vërtetohet për asnjë tjetër, përveç pasardhësve të Fâtimesë, edhe pse ai tjetri është ngritur me shpatë në dorë.

---

<sup>1</sup> “Menhexhul-Mekâl” e shejhut Ebù Ali El-Hàirij në lidhje me mbiemrat.

<sup>2</sup> “El Farku bejnel-firak”, f. 23; “El Milel”, pjesa e parë, f. 164

*Por ne nuk njohim ndonjë rrugë që t'i tubojmë këto dy grupe në numrin e grupeve të shi'ave.*

### *Xhàrùdijtë*

*Nga grupet e zejdijsve janë edhe xhàrùdijtë, pasuesit e të verbrit nga Kufa, Zijàd ibn Mundhir Ebùl-Xhàrùd Es'Serhùb. Ata quhen edhe serhùbij dhe thuhet se Serhùb është emri i një shejtani që banon në det. Me këtë emër është quajtur edhe Ebul-Xhàrùdi, i cili ishte nga pasuesit e imam Bàkirit e të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të dy!) por kur doli Zejdi, ai ndryshoi. Është përcjellë nga imam Sàdiku se ai e ka mallkuar Xhàrùdin, ka përgënjeshtuar fjalët e tij dhe e ka shpallur mohues. Së bashku me të ishin edhe Kethirun'Neuà e Sàlim ibn Ebi Hafsah, për të cilin është thënë se ishte i verbër jo vetëm nga sytë, por edhe nga zemra.<sup>1</sup>*

*Xhàrùdijtë mendojnë se njerëzit kanë treguar mangësi në kërkim të njohjes së imamit, sepse i kishin mundësitë që ta njihnin atë, madje xhàrùdijtë i kanë shpallur mohues ata që i dhanë besën Ebù Bekrit. Gjithashtu, ata nuk besojnë në imamatin e tre kalifëve, për të cilët deklarohen se ata janë mohues, për shkak se kanë pretenduar imamatin dhe nuk i kanë dhënë besën Aliut (Paqja qoftë mbi të!).<sup>2</sup>*

### *Sàlihijtë*

*Thuhet se nga zejdijsve janë edhe sàlihijtë, që janë pasues të Hasan ibn Sàlihut. Më lart mësuam se ata i përkisnin grupit të betërijve, sepse Hasani ishte njëri prej*

<sup>1</sup> Referohu në përshkrimin "Libri i burrave".

<sup>2</sup> "El Farku bejnel-firak", f. 22; "El Milel" në margjinaturën e pjesës së parë, f. 163.

*krerëve të betërijve, prandaj nuk mund të ketë arsye që ata të quhen grup i pavarur. Megjithëse është e vërtetë se atje kishte grupe të vogla, që qëndronin mes Hasan ibn Sàlihut dhe Kethirun'Neuàsë, kreut të betërijve. Ne nuk pretendojmë që grupi i tij të jetë një grup që ka ndryshim nga betërijtë.*

*En'Nùbekhtiu, në librin e tij "Firaku-sh'Shi'ah", i ka përmendur zejditë jo në këtë platformë. Për këtë grup ai ka shtuar: "Ne nuk mendojmë të ketë diçka më afër se ajo që ne kemi shkruar në këto radhë dhe nga ajo që kemi thënë në librin "El Milelu uen'Nihalu". Nëse kërkon shpjegime më të zgjeruara, referohu në librin e lartpërmendur."*

### *Ismailijtë*

*Nga grupet e shi'ave janë edhe ismailijtë. Fjala për imamatin e Ismailit doli në kohën e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), por ai qe imam vetëm se ashtu e mendonin disa prej tyre. Si rregull, imamati i takonte më të madhit dhe Ismaili ishte më i madhi i vëllezërve të tij, krahas virtyteve që kishte. Por ai vdiq kur jetonte ende babai i tij dhe atëherë për ata u bë e qartë se e kishin gabim.*

*Përsa i përket atyre, që i qëndruan mendimit se ai është imam, ata janë të ndarë në grupe: prej tyre ka që e mohojnë se ka vdekur gjatë kohës, që babai i tij ishte gjallë. Për këtë çështje ata kanë thënë se ky ishte maskim, që kishte bërë i ati nga frika e njerëzve, prandaj e fshehu atë prej tyre. Gjithashtu, ata pretendojnë se Ismaili nuk do të vdesë derisa të sundojë globin, do të urdhërojë njerëzit dhe se ai është më këmbë, sepse babai i tij ka dhënë shenja se, pas vdekjes së tij, ai do të ishte imami. Kur ai vdiq, ne mësuam se ai kishte thënë të vërtetën, pra, ai është gjithnjë më këmbë dhe nuk vdes.*

*Ndër ismailijtë ka që thonë se ai ka vdekur dhe se imamati i kaloi djalit të tij Muhammedit, sepse imamati është vetëm te ata që vijnë pas dhe nuk është te vëllezërit, me përjashtim të Hasanit e të Husejnit (Paqja qoftë mbi të dy!). Kur vdiq Ismaili, ishte detyrë që pas Xha'ferit imam të ishte Muhammed ibn Ismaili dhe nuk mund të ishte ndonjë prej vëllezërve të Ismailit. Prandaj kurrë nuk ka pasur të drejtë të ishte imam Muhammed ibn El-Hanefijeh krahas Ali ibn Husejnit -Paqja qoftë mbi të dy!. Mbartësit e kësaj fjale quhen "mubàrekij", sipas emrit të një kryetari të tyre që quhej Mubàrek.*

*Përsa i përket khattàbijve, pasuesve të Ebul-Khattàb Muhammed ibn Ebi Zejneb El-Esedij El-Exhda', pas vrasjes së Ebul-Khattàbit, përfshihen në grupin e atyre që pretendojnë imamatin për Muhammed ibn Ismailin. Pjesëtarët e këtij grupi janë nga lloji i ekstremistëve; më pas ata u ndanë në shumë degë dhe njëra prej tyre janë karàmitët.<sup>1</sup>*

*Vetë Ebul-Khattàbi ka qenë nga pasuesit e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe, kur imam Sàdiku mori vesh se ai gënjente për të, e përzuri, u shfajësua nga fjalët e tij dhe e mallkoi.*

*Më pas ai pretendoi profetësinë dhe qenien Zot për Xha'fer ibn Muhammedin. Gjithashtu, ai pretendonte se ishte i dërguar prej vetë Xha'ferit. Prej Ebul-Khattàbit dhe grupit të tij dolën shumë sajesa, veprime sipas dëshirave dhe shumë lejime. Por kur Isà ibn Mùsà arriti në Kufe, si i ngarkuar i Mensùrit në këtë qytet, mori vesh se ç'ishte e ç'bënte Ebul-Khattàbi me grupin e tij prej shtatëdhjetë burrash që ndodheshin në xhaminë e Kufes. Isài i luftoi ata*

---

<sup>1</sup> "Firaku-sh'Shi'ah", f. 67 dhe f. 76.



*dhe i vrau që të gjithë, me përjashtim të njërit, i cili kishte marrë disa plagë dhe ishte shtrirë ndër të vrarët, pastaj gjeti rastin dhe shpëtoi. Ebul-Khattabu ra rob dhe atë e vrau Isà ibn Mùsài në bregun e lumit Euftrat, kurse një grup të vrarësh, pasi i ekspozoi, urdhëroi që kufomat e tyre të digjeshin. Urdhri u zbatua. Kokat e tyre i kishte dërguar tek Mensùri, i cili, pasi i ekspozoi për tri ditë në portën e qytetit të Bagdadit, urdhëroi që të digjeshin.<sup>1</sup>*

### *Imàmijte*

*Ndër grupet shi'ah janë edhe imàmijte, që njihen me emrin xha'ferij, ndjekës të Xha'fer ibn Muhammedit (Paqja qoftë mbi të dy!) dhe të shkollës së tij juridike (medh'hebit). Më poshtë do të shpjegohet se si ai u bë medh'heb dhe nuk u bënë imamët e tjerë, megjithëse të gjithë imamët, në lidhje me dispozitat, janë medh'heb.*

*Imàmijte janë ata që besojnë në dymbëdhjetë imamët: Aliun, Hasanin, Husejnin, Ali ibn Husejnin, Muhammed ibn Aliun, Xha'fer ibn Muhammedin, Mùsà ibn Xha'ferin, Ali ibn Mùsàin, Muhammed ibn Aliun, Hasan ibn Aliun dhe djalin e tij Mehdiun e fshehur, për të cilin imamijte rrinë në pritje që ai të shfaqet në çdo kohë (Paqja qoftë mbi të gjithë ata!).*

*Ata besojnë se imàmati i dymbëdhjetë imamëve është saktësuar me tekst të qartë nga ana e All'llahut të Lartësuar me fjalën e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe se vetë i Dërguari i All'llahut është shprehur qartë, që kalif të ishte Prijësi i Besimtarëve, ashtu siç është shprehur për të se ai që është imam, është vëllai i tij dhe personi të cilit i ka lënë porositë. Këto fjalë*

---

<sup>1</sup> "Firaku-sh'Shi'ah", f. 69.

*Profeti i ka thënë në shumë vende, si p.sh. në Ditën e Gadirit. Gjithashtu, i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka njoftuar një për një emrat e kalifëve e të imamëve, që do të vinin pas Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) sipas asaj radhe që i përmendëm edhe ne emrat e tyre. Pra, i Dërguari i All'llahut ka theksuar caktimin e tyre njëri pas tjetrit: Hasanin pas Aliut, Husejnin pas Hasanit, të birin e Husejnit Aliun pas tij dhe kështu me radhë biri pas babait, derisa përfundon me djalin e pritshëm të Hasanit, për të cilin imamijtë besojnë se ai është gjallë që pas lindjes së tij, në vitin 255h, në gjysmën e muajit Sha'bàn. Gjithashtu, ata besojnë se ai është fshehur nga frika e fir'aunëve të kohës së tij dhe se ai është Mehdiu që do të mbushë botën me drejtësi, pasi ajo ishte e mbushur me padrejtësi e mizori.<sup>1</sup>*

*Imamijtë besojnë se këta imamë janë të ruajtur nga fajet, nga gabimet, nga harresa dhe nga shkujdesja, ashtu siç është Profeti ynë e të gjithë profetët e tjerë (Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!). Gjithashtu, imamijtë besojnë se dituria e këtyre imamëve nuk është me të mësuar, por është me frymëzim dhe e trashëguar prej Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) duke ia lënë trashëgim babai djalit e vëllai vëllait, ashtu siç ndodhi me imam Hasanin e imam Husejnin. Meqenëse i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte trashëguesi i diturisë së të gjithë*

---

<sup>1</sup> Imam Mehdiun e kanë përmendur edhe shumë autorë nga Ehli Sunneti dhe kanë thënë se ai është djali i Hasan Askeriut. Kanë pohuar ekzistencën e tij se ai është i premtuari; referohu në: "Metâlibu-s'su'l"; "El-Huxh'xheh" e Ibn Rexhebit; "Leuâkihul-enuâr"; "Et'Tedhkireh"; "Sherhud'Dâireh"; "El-Fusûlul-muhimmeh"; "Ferâidu-s'Semtijn" e të tjera libra; madje disa prej tyre kanë pretenduar se e kanë parë dhe kanë qëndruar me të.

*profetëve e të dërguarve dhe kishte diturinë e të parëve e të pasardhësve, rrjedhimisht edhe Prijësi i Besimtarëve ishte magazina e gjithë kësaj diturie, ashtu siç ka thënë vetë i Dërguari i All'llahut: "Unë jam qyteti i dijës dhe Aliu është porta e këtij qyteti.", pa përmendur hadithe të tjera e ajete të Kur'ân Kerimit.<sup>1</sup> Gjithë këtë dituri e trashëguan djemtë e tij imamë.*

*Imamijtë besojnë se imamët janë rob të All'llahut dhe janë krijuar vetëm për Të. Ata ushqehen e furnizohen prej Tij dhe se nuk kanë të bëjnë me punët e njerëzve, siç është jeta e vdekja, dhënia e mosdhënia apo të ndalojnë gjëra të tjera, por vetëm me urdhër e me leje prej të Lartit, ashtu siç thuhet në Kur'ânin Kerim për Isâin - Paqja qoftë mbi të!: "... se si me vullnetin Tim krijoje një figurë shpendi prej balte, pastaj fryje në të dhe ajo bëhej zog me vullnetin Tim; se si me vullnetin Tim i shëroje të lindurit të verbër e të lebrosurit; se si me vullnetin Tim i ngjallje të vdekurit; se si i pengova sulmet e izraelitëve kundër teje, atëherë kur iu solle atyre prova të qarta e mohuesit në radhët e tyre thanë: "Kjo është vetëm magji e kulluar!" (Sure "El-Mâide", ajeti 110)*

*Të gjitha këto, imamijtë i kanë vërtetuar me argumente logjike dhe me njoftime e dokumente të hershme. Në këtë kapitull do të cekim pak edhe këto argumente.*

---

<sup>1</sup> Kam shkruar një kumtesë për hadithin "Eth'Thekalejn", si dhe për argumentet e këtij hadithi, që flasin për pagabueshmërinë e imamëve dhe diturinë e tyre për çdo send. Kjo kumtesë ka dalë nga shtypshkronja. Gjithashtu, kam shkruar një kumtesë tjetër për diturinë e imamet dhe mënyrën e kësaj diturie. Mbase botimi i kësaj të fundit do të përputhet me botimin e së parës.

*Gjithashtu, imamijtë i kanë vërtetuar thëniet e veta me tekste të qarta, që flasin në mënyrë të veçantë për imamët. Janë tekste të transmetuara prej Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) sipas rrugës së transmetuesve të dy krahëve, ashtu siç ka thënë vetë i Dërguari i All'llahut: "Imamët janë prej kurejshëve, ata janë dymbëdhjetë<sup>(1)</sup> dhe janë prej bijve të Aliut e të Fatimesë." dhe i ka emërtuar ata me emër njëri pas tjetrit.<sup>1</sup>*

*Përveç kësaj, reduktimi i imamatit vetëm te ata, është argumentuar edhe me qenien e tyre njerëz dashamirës e të shoqërueshëm. Prandaj, nëse do të ishte edhe një imam i vetëm, qenia e tij imam është detyrë, ashtu siç është detyrë bindja dhe njohja e tij.*

*Për dispozitat e fesë, imamijtë referohen vetëm në këta imamë dhe vetëm në atë çka është vërtetuar se ka ardhur prej Profetit ose prej vetë imamëve, atëherë ata veprojnë sipas saj. Në rast se njoftimet janë të ndryshme e të kundërta, ata veprojnë në bazë të balancimit e sipas asaj që nga anon më shumë mendja dhe ashtu siç është sanksionuar tek ata në bazat e njohjes së ligjit të fesë.*

*Imamijtë u përmbahen katër argumenteve: Kur'ânit, Sunnetit, fjalës së përbashkët të dijetarëve (Ixmà') dhe gjykimit të prerë të mendjes. Në rast kur nuk janë të katër argumentet, ata i referohen bazave praktike, që janë matësit e asaj që presupozojnë rregullat e përgjithshme të ligjit të fesë, të vërtetuara me argumente e fakte.*

---

<sup>1</sup> Muslimi në "Sahihun" e tij sipas përcjelljes së Xhàbirit; "Musnedi" i Ahmedit, vëll. 5, f. 89 dhe vëll. 2, f. 28; "Es'Sauàiku". Pjesa e tretë, kapitulli i parë; Sujutiu në "Tàrikhul-Khulefài", f. 5 dhe në libra të tjerë.

*Imamijtë besojnë se hadithet e përcjella prej tyre janë prej Sunnetit, sepse ata janë mbartësit e diturisë së Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ashtu siç janë edhe ruajtësit e ligjit të fesë, me të cilën ai erdhi. Prandaj ajo që është tek ata, është prej të Dërguarit të All'lahut dhe nuk është as në rrugë hulumtimi e as nga mendimi i tyre. Tek imamijtë Sunneti është njëri nga katër argumentet mbi të cilat ata mbështeten në nxjerrjen e dispozitave dytësore. Mbi këto katër baza bëhet shpjegimi rreth argumentimit të tyre dhe mënyra e referimit në librat e bazave të ligjit të fesë.*

*Përsa i përket besimit të imamijve te All'llahu i Lartësuar, ata besojnë se All'llahu, me madhërinë e Tij, është send, por jo si sendet. Ai është pa trup e pa formë. All'llahu nuk mund të shikohet as në këtë botë e as në botën tjetër, atë nuk e shikojnë dot sytë, kurse Ai i shikon sytë. Cilësitë e Tij janë vetë Qenia e All'lahut. All'llahu i Lartësuar është i drejtë dhe nuk i bën padrejtësi askujt prej robëve të Tij, për shkak të paudhësive e të veprave të këqija që ata bëjnë sipas gjykimit të mendjes së tyre. Gjithashtu, imamijtë besojnë se All'llahu të gjitha sendet i ka krijuar nga asgjëja.*

*Përsa i përket besimit të tyre te Profeti ynë Muhamedi (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) imamijtë besojnë se ai është i ruajtur nga fajet, nga gabimet, nga shkarjet e vogla, nga harresa, nga shkujdesja, nga mëkatet e mëdha e të vogla dhe se ai nuk ka bërë asgjë nga këto që u thanë as para profetësisë e as pas saj. Gjithashtu, imamijtë besojnë se ai është i dërguar për mbarë botën. I tillë është besimi i imamëve edhe për profetët e të dërguarit e tjerë nga ana e ruajtjes (ismet).*

*Gjithashtu, ata besojnë se imamati është nga bazat, prandaj duhet vërtetuar me argumente logjike, përveç*

*teksteve të cituara. Ndër argumentet logjike të imamijetë është edhe kujdesi e interesimi ndaj personit me të cilin shoqërohesh.*

*Përsa i përket ringjalljes, imamijetë besojnë se All'llahu, - U lartësoftë emri i Tij! -, do të ringjallë njerëzit për të dhënë llogari me fizikun që kanë qenë në këtë botë dhe me atë trup. Ata ose do të kenë mirësitë e Xhenneteve, ose do të dënohen në Zjarr.*

*Në lidhje me punët e njerëzve, imamijetë besojnë se ato qëndrojnë ndërmjet dy çështjeve: as detyrim me forcë e as veprim i kushtëzuar, që do të thotë se All'llahu i Lartësuar nuk i detyron njerëzit me forcë në punët e tyre, ndryshe do të dukej se po u bën padrejtësi njerëzve në dënimet që Ai jep për mëkatet që ata kryejnë; gjithashtu, Ai u ka dhënë njerëzve fuqi për të bërë punët e tyre sipas zgjedhjes së tyre. All'llahu i Lartësuar ka deleguar tek njerëzit krijimin e punëve të tyre, derisa ato dalin nga pushteti i fuqisë së Tij për tek robët e Tij, pasi vetëm Atij i takon gjykimi dhe e gjithë puna, sepse Ai është i gjithëfuqishëm mbi të gjitha sendet dhe është gjithërrethues për robët e Vet.*

*All'llahu i Lartësuar përgatit për njerëzit shkaqet e bindjes e të udhëzimit në rrugën e drejtë, njëkohësisht ua ndalon atyre shkaqet e veprimit në kundërshtim me urdhrin e Tij dhe shkaqet e shkarjes në rrugën e humbjes. Të gjitha këto All'llahu i Lartësuar i bën nga mëshira e madhe që ka për robët e Vet. Pikërisht, kjo është ajo që ne e quajmë "teufik" – mbarësi, sukses.*

*Këto ishin disa nga besimet e imamijetëve, në lidhje me ekzistencën e All'llahut, besimin se vetëm All'llahu*

*është Zoti Një e i Vetëm, cilësitë e All'llahut, profetësinë, imamatin, ringjalljen dhe punët e njerëzve.*

*Të gjitha i përmendëm kalimthi, duke e konsideruar të mjaftueshme aq sa u tha për këto besime, pasi ato janë objekt i studimit të librave të teologjisë e të besimit.*

*Në ditët e sotme, imamijtë janë shumica e shi'ave në të gjitha trevat islame. Gjithashtu, edhe librat e tyre, në të gjitha degët e diturisë, që nga dita e parë kur ka filluar shkrimi i librave e deri sot, janë të shpërndara ndër të gjithë popujt, prandaj ato ka mundësi t'i lexojë qytetari e fshatari, dijetari dhe ai me pak shkollë.*

*Në ditët e sotme, përveç imamijve, zejdiqve dhe ismailijve nuk ka grupime të tjera të njohura dhe, o Zoti im, me përjashtim të disa grupimeve ekstremiste (gulat), të cilët anojnë kah "teshejju", që do të thotë: pretendojnë atë që është e tjetrit.*

*Meqenëse po bëjmë fjalë për grupet që ishin në kohën e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) kemi anashkaluar disa grupe që dolën pas imam Sàdikut, siç ishin fetahijtë, nàùsijtë dhe uàkifijtë.*

#### *4 – Hauàrixhët*

*Ky grup doli ditën e luftës së Siffinit me mashtrimin e Ibn Àsit, kur ai i bëri shenjë Muàvijes, i cili, në fakt ishte i pafuqishëm të rezistonte. Sipas asaj shenje, ai ngriti lart librin e Kur'ànit, duke bërë thirrje për shtrimin e çështjes në arbitrim. Pikërisht, në kohën që ata ngritën mus'hafet, një grup nga pasuesit e Prijësit të Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) u hoqën mënjanë dhe thanë: "Këta po na bëjnë*

*thirrje me Librin e All'llahut, ndërsa ti na bën thirrje për shpatën?!”*

*Prijësi i Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i qortoi dhe u përpoq që ata t'i thërrisnin mendjes e të mos binin pre e këtij mashtrimi, duke u thënë: “Ç’po thoni?! Unë e di më mirë Librin e All'llahut!” Por atyre nuk u sillnin dobi as qortimet, as frikësimet e as paraqitja e argumenteve dhe fakteve. Madje, ata arritën deri aty sa i thanë: “Patjetër të kthesh Malikun, që të mos luftojë myslimanët, përndryshe ne do të veprojmë me ty ashtu siç vepruam me Osmanin!”*

*Në një situatë të tillë, mam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) u detyrua të kthente Mâlikun, i cili kishte shpartalluar forcat kundërshtare dhe ata i kishin kthyer shpinën sheshit të betejës. Gjithashtu, ata e imponuan atë që të pranonte arbitrazhin. Prijësi i Besimtarëve donte që të dërgonte Abdullah ibn Abbâsin, por ata kundërshtuan dhe kërkuan që të dërgonte Ebû Mûsà El Ash’ariun. Kur u bë arbitrazhi, havarixhët thanë: “Përse i gjykove burrat me fenë e All'llahut? Nuk ka gjykim tjetër përveç gjykimit për All'llahun.”*

*Nga ky çast ata u quajtën gjykatës. Edhe pasi Prijësi i Besimtarëve u kthye nga beteja e Siffinit, ata këmbëngulnin të qëndronin të veçuar e të kundërshtonin urdhrat. Së fundi u mblodhën në vendin e quajtur Harûrà, pranë Kufes dhe për këtë shkak u quajtën harûrij.*

*Urdhri i fundit, i atyre, që vazhduan të qëndronin të veçuar, ishte që të vrisnin Prijësin e Besimtarëve në Nehrauàn, edhe pasi atyre u ishin parashtruar argumentet e u ishin hapur të gjitha rrugët për të kërkuar ndjesë. Havarixhët, kudo ku shkonin, mbillnin ngatërresa, bënin*



*shkatërrime e vrasje. Ata vranë edhe Khabbàbin, që ishte ndër shokët më të mirë të Profetit. Krimet e tyre shkuan deri aty sa të çanin barqet e grave shtatzëna.*

*Kjo frymë nuk u shkul me shpartallimin e tyre në Nehrauàn, pasi në çdo kohë e në çdo shekull do të kishte njerëz kryengritës, që do të mbartnin mendime të tilla. Hauàrixhët kanë shqetësuar mbretër e sundimtarë krahinash gjatë gjithë atyre shekujve. Sa herë që disa prej tyre asgjësoheshin, dilnin të tjerë më të guximshëm. Njerëzit ishin të terrorizuar, për shkak të veprimeve të tyre makabre e të ashpërsisë që tregonin, sepse ata nuk ndaleshin para asgjëje dhe arrinin deri në përdhosjen e gjërave krejtësisht të ndaluara. Nisur nga doktrina e tyre, hauàrixhët, me qetësinë më të madhe, luftuan mbretër e pushtetarë të krahinave. I gjeje të luftonin në radhët e para me trimëri të madhe e me furi, sa që njerëzit nuk u dilnin përballë e druheshin prej tyre edhe kur ishin disa herë më të shumtë se ata. Hauàrixhët nuk mund të duronin një doktrinë që kundërshtonte doktrinën e tyre, por, kur e shihnin veten të pafuqishëm, vepronin në errësirën e natës. Prandaj asnjë vend nuk ishte i sigurt nga ligësitë e tyre.*

*Hauàrixhët praktikonin adhurimet. Ndërkaq, me këtë pamje të mirë afroheshin pranë staneve e vendeve, ku njerëzit u jepnin ujë bagëtive dhe aty, krahas thirrjes për t'u ngritur kundër mbretit, që shkonte në rrugën e gabuar, bënë thirrje edhe për të vepruar sipas Librit të All'llahut e Sunnetit të Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në një kohë, që me veprimet e tyre i kundërshtonin e i shkelnin rëndë të gjitha këto shfaqje të jashtme, pasi kudo, që shkonin, mbillnin vetëm shkatërrim e ngatërresa. Megjithëkëtë njerëzit naivë mashtroheshin nga*

*pamja e jashtme e riteve që ata kryenin dhe nga rruga e paqësimit që ata paraqisnin. Madje nga kjo fasadë e jashtme dhe e bukur u mashtruan edhe disa nga ithtarët e librave të mëparshme (jehuditë e kristianët) si dhe ata që nuk besojnë në vërtetësinë e fesë islame, për pasojë u bashkuan me hauàrixhët dhe shtuan radhët e tyre.*

*Më pas dhuna e hauàrixhëve erdhi duke rënë e duke u pakësuar. Për njëfarë kohe njerëzit qenë të qetë prej tyre. Gjatë kohës së Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) hauàrixhët ngritën përsëri kokë dhe njëri nga krerët e tyre, pikërisht Abdullah ibn Jahjà El-Kindij, i mbiquajtur “Kërkuesi i së vërtetës”, u hodh në kryengritje në Hadrameut, pasi më parë ishte këshilluar me ibadijtë në Basra, të cilët i vunë detyrë të domosdoshme që ai të ngrihej. Nga ana e ibadijve shkuan tek ai në Hadrameut Ebù Hamza el-Muhtàr ibn ‘Auf El-Ezdij dhe Belh ibn ‘Ukbeh El-Mes‘ùdij. El-Kindit i dhanë besën 2000 vetë, me të cilët doli sheshit. Kur grupi i tij u shtua, ai u drejtua për në San‘à (kryeqyteti i Jemenit) dhe që këtu dërgoi letra në të gjitha vendet ku kishte hauàrixhë. Në luftërat që u zhvilluan mes pushtetarit të San‘àsë dhe Allahit, ky i fundit triumfoi, madje futi në dorën e tij edhe depot e parave, pastaj vuri nën pushtetin e tij Jemenin. Kur erdhi koha e Haxhit, Ebù Hamza, Belhu dhe Ebrehe ibn Es‘Sabàhu u nisën për në Mekkë, me 1000 vetë, të prirur nga Ebù Hamzai, të cilin Abdullahi e urdhëroi të banonte në Mekkë kur të dilnin njerëzit, kurse Belhu u nis për në Sham. Ata hynë në Mekkë ditën e Teruijes (data tetë dhul-hixh‘xheh). Në këtë kohë, sundimtar në Mekkë e në Medine ishte Abdul Uàhid ibn Sulejmàn ibn Abdul Melik nën hilafetin e Meruàn Himàrit. Meqë njerëzit u frikësuan prej tyre, Abdul Uàhidi nuk e pa*

me vend të luftonte me ta, por Abdul Uàhidi pati një letërkëmbim me ta dhe u kërkoi që të mos ndalonin njerëzit të kryenin Haxhin, duke i kujtuar se në këtë periudhë të gjithë janë në sigurinë e njëri-tjetrit, derisa të largohet edhe personi i fundit. Kur u largua edhe njeriu i fundit, u largua edhe vetë Abdul Uàhidi, duke lënë Mekkën pa luftë në dorë të Hamzait. Ndërkaq, Abdul Uàhidi hyri në Medine dhe, me ushtrinë që përgatiti me banorët e saj, u takua me forcat kundërshtare në vendin e quajtur Kadid, ku disfata që për ushtrinë e Medines dhe fitorja për Sheratin. Në këtë luftë numri i të vrarëve nga banorët e Medines arriti në 2230 burra. Pastaj Belhu hyri në Medine pa luftë, kurse Abdul Uàhidi udhëtoi për në Sham. Pa humbur kohë, Mervani i përgatiti Abdul Uàhidit një ushtri me 4000 luftëtarë, me kalorës e kuadro ushtarakë, të pajisur me mjete e me furnizime të shumta. Këtë ushtri e komandonte Abdul Melik ibn 'Atijeh Es'Sa'dij. Kur Sherati mori njoftimin se ushtria e Shamit ishte drejtuar kundër tyre, ai përgatiti 600 vetë nën komandën e Belh ibn 'Atijeh El Mes'ùdiut. Të dyja ushtritë u takuan në vendin e quajtur Uàdil Kurà, në fillim të muajit Xhumàdel Ula të vitit 130h. Pikërisht në këtë vend, njerëzit u pozicionuan kundër njëri-tjetrit. Shpartallimi që për hauàrixhët. Në luftë e sipër u vra Belhu e Sherati dhe prej tyre mbetën gjallë vetëm 30 vetë, të cilët ia mbathën për në Medine. Në këtë kohë në Medine sundonte Mufaddal El Ezdiu dhe Umer ibn AbduRrahman ibn Zejd ibn El Khattàbi u bëri thirrje njerëzve të luftonin Sheratin brenda në Medine, por thirrjes së tij nuk iu përgjigj asnjë njeri. Atëherë rreth tij u mblodhën berberët, zezakët dhe banorët e tregut dhe ai me këta burra luftoi Sheratin. Në këtë luftë u vra Mufaddali dhe shumica e pasuesve të tij. Ata që shpëtuan ia dhanë

vrapit e u larguan. Ndërkaq Ibn 'Atijeh hyri në Medine, ku qëndroi një muaj, kurse Ebù Hamzai ishte në Mekkë. Ibn 'Atijeh, pa humbur kohë, u drejtua për tek Ebù Hamzai në Mekkë dhe ndërmjet tyre u zhvillua një luftë e ashpër, gjatë së cilës Sherati pati një vrasje të shëmtuar, u vra edhe Ebù Hamzai dhe Ebrehe ibn Es'Sabàhu. Ibn 'Atijeh zuri rob 400 vetë prej trupave të Ebù Hamzait, të cilët, më pas, u vranë të gjithë. Gjithashtu, Ibn 'Atijeh internoi në skutat e Hajfit prindërit e Hamzait e të Ebrehes, internoi edhe Ali ibn Husejnin. Kështu vajti filli i punëve derisa në pushtet erdhën abasitët dhe Ibn 'Atijeh me të tijtë u vu në dispozicion të Seffàhut. Më pas, Ibn 'Atijeh shkoi në Tàif, ndërkaq Abdullah ibn Jahjà, "Kërkuesi i së vërtetës", që ishte në San'à, mësoi ç'kishte ndodhur me Ebù Hamzanë e me grupin e tij, prandaj u nis të luftonte Ibn 'Atijen, i cili, nga ana e tij, pasi përcaktoi drejtimin nga do të vinte Abdullahi, u nis në drejtim të tij. Në këtë betejë nga të dyja palët u vranë shumë vetë. Abdullahi marshoi në krye të 1000 luftëtarëve dhe vazhdoi luftën derisa u vranë të gjithë, u vra edhe vetë Abdullahi, kokën e të cilit Ibn 'Atijeh ia dërgoi Mervànit. Pas fitores mbi hauàrixhët, Ibn 'Atijeh shkoi të qëndronte në Hadrameut, ku i erdhi një shkresë nga ana e Mervànit, i cili e urdhëronte që të shpejtonte për në Mekkë, me qëllim që të kryente Haxhin me njerëzit. Në zbatim të këtij urdhri, Ibn 'Atijeh u nis me shpejtësi për në Mekkë vetëm me një shpurë të vogël prej 19 kalorësish. Ndërkaq, Mervani u pendua që e urdhëroi të nisej dhe tha: "E vrava Ibn 'Atijen, sepse ai, me qëllim që të arrijë Haxhin sa më shpejt, do të largohet nga Jemeni me shumë pak njerëz dhe me siguri që do ta vrasin hauàrixhët." Ndodhi ashtu siç e parashikoi Mervàni: Ibn 'Atijeh u takua rrugës me një nga grupet e shpërndarë të hauàrixhëve, me

*të cilët ishin bashkuar edhe të tjerë. Hauàrixhët e njohën Ibn 'Atijjen, u hodhën mbi të dhe e vranë.<sup>1</sup>*

*Pas kësaj ndodhie lufta për hauàrixhët ishte vetëm një doktrinë e një mendim, pa arritur asnjë rezultat në luftimin e mbretërve. Edhe në ditët tona vazhdon të ketë prej tyre që marrin qëndrime ekstreme. Hauàrixhë të tillë ka Omàni, megjithëse nuk kanë ndonjë aktivitet, që i bën të ndihen e të kenë ndonjë rëndësi.*

*Hauàrixhët janë ata kryengritës, për të cilët e kishte njoftuar Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) Prijësin e Besimtarëve, imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) se ai do të luftonte kundër tyre dhe se do të dilte fitues mbi ta.*

*Hauàrixhët ishin shumë grupe, që i bashkonte një fjalë: Ata konsideronin mohues Aliun, Osmanin, dy arbritrat, luftëtarët e Ushtrisë së Devesë dhe ata që miratonin gjykimin e dy arbitrave. Gjithashtu, ata konsideronin mohues mëkatarët dhe e konsideronin detyrë të ngriheshin kundër një imami mëkatar, ashtu siç tregohet edhe në librin "El-Farku bejnel-firak" – ("Dallimi ndërmjet grupeve") – të autorit El-Ka'bij, f. 55.*

*Është transmetuar prej Ebù Hasen El Ash'ariut, se shumica e tyre e mohojnë që i konsiderojnë mohues mëkatarët. Për këtë çështje ai ka cituar hollësi. Hauàrixhët kanë përfunduar në degëzime të shumta, të cilat koha i ka asgjësuar, kurse ata hauàrixhë, që gjenden sot në Omàn, i përkasin grupit të ibàdijve.*

---

<sup>1</sup> Referohu në "Sherhu-n'Nehxh", vëll. 1, f. 455-463, ku do të gesh hollësi të asaj që ne e dhamë të shkurtuar.

### *Ekstremistët dhe ata që janë larguar nga Islami*

*Në fillim të këtij kapitulli kemi thënë se bazat e grupimeve islame janë katër, prej të cilave janë degëzuar të gjitha grupet. Gjithashtu, kemi thënë se grupet e ekstremistëve janë nga degët e atyre bazave, por për ata nuk do të gjesh bazë, përveçse disa degëzime ekstremiste.*

*Çështja e grupeve ekstremiste (gulat) reduktohet në ato që mund të pretendojë dikush, siç është çështja e anulimit të ndërsjellë, lejimeve, shëmbëllimit e të tjera çështje, të cilat, tek disa grupe të myslimanëve, çojnë deri në mohim. Sulmi mbi ta, duke i shpallur mohues, nisur nga gjërat në të cilat ata besojnë, nuk është nga punët e lehta, sepse etiketimi mohues i atij, që pohon dy “dëshmitë”, nuk mund të thuhet për atë që manifeston një ngushtim në fe, pa u bazuar në një argument të sigurt. Përderisa ne jemi të gjerë në këto çështje, nuk e hapim fare këtë kapitull e nuk e hedhim veten nga lartësitë dhe pastaj të “diagnostifikojmë” se kush është i shëndetshëm që të shpëtojë, sidomos kur këto grupe janë goditur me daljen jashtë rrethit të Islamit të vërtetë, për shkak të disa besimeve të shtrembëruara që ata manifestojnë në mënyrën më të gabuar, por që në fakt, janë bërë vetëm një njoftim nga të serisë “Na ishte një herë”. Nga ato besime kanë mbetur vetëm disa cifla të perënduara, që nuk kanë asnjë rëndësi ndërmjet bijve të Islamit. Gjithashtu, nuk ekziston as frika nga depërtimi i besimeve të tyre të shprishura, pasi ata kanë rënë në një gjendje të atillë sa besimet e veta i mbajnë të fshehura nga frika e goditjeve të atyre që i përmbahen fesë me argumente e fakte, të cilat i bëjnë hi e pluhur besimet e tyre të gabuara. Gjithashtu, ata ruhen*

*shumë që të mos etiketohen si mohues dhe si njerëz që kanë dalë jashtë radhëve të Islamit.*

*Ruajtja nga përhapja e kësaj sëmundjeje ndër krerët e injorantëve është akoma më e rëndësishme nga ç'ka qenë tek të parët, të cilët i kundërshtuan ato sajesa e shkarje në rrugën e humbjes me tërë forcën dhe i zunë para tyre të gjitha rrugët. Sot jemi në siguri të plotë se mund të mashtrohemi nga shkarjet në rrugën e humbjes të grupeve të tanishme të hauàrixhëve. Si është e mundur të bëjnë sajesa këto grupe të asfiksuara, të cilat janë vënë në shënjestër e në rrethin e ndjekjes?!*

### *I ngjashëm me ateizmin*

*Në ditët e sotme kujdesi duhet të përqendrohet nga zhvillimet që kanë marrë veprimet e ngjashme me ateizmin: dyshimet e adhuruesve të kohës e natyralistët, të cilëve u punon mendja me të gjitha mënyrat se si të shpëtojnë nga ato që ata i quajnë “pranga” të fesë. Është fjala për ato kufizime, që në të vërtetë e lartësojnë njeriun në radhët e engjëjve e të qenieve shpirtërore, që e nxjerrin atë nga barbaria vrastare, e ruajnë nga epshet shkatërruese dhe e bëjnë të ketë siguri nga sulmi në çdonjërin nga gjërat më të çmuara të kësaj bote: jetën, nderin e pasurinë. Gjithashtu, të ashtuquajturat pranga të fesë, i bëjnë njerëzit të kenë siguri për atë që është më e vlefshme për njerëzit, të kenë siguri për lirinë që e dëshirojnë dhe së cilës i thurin himne. Janë pikërisht veprimet që u thanë në fillim, ato që e nxjerrin njeriun nga fusha e të mençurve dhe e njerëzve të ndershëm, duke e futur në lukuninë e egërsirave, ndjekjen e dëshirave të ulëta e të prostitucionit, këtij vesi kaq të dëmshëm shoqëror e moral që ka*

*mashtuar disa të rinj, të cilët bien në kurthe të rrezikshme e shkojnë drejt rrjetave mashtruese të prostitucionit. Kjo, pasi rinia, nga vetë mosha e re, është e prirur të tërhiqet kah plotësimi i instinkteve dhe të këpusë ato “pranga” të paqena. Prandaj është detyrë e përhershme t’i kushtohet rëndësi kthimit në udhëzimin për në rrugën e drejtë para se mendja e të riut të vetëmashtrohet.*

\* \* \*

## IMAMATI

*Në të vërtetë, myslimanët janë në medh’hebin e imamatit, pasi kanë rënë në një mendim të përbashkët që imamati është detyrë e domosdoshme, duke vënë në konsideratë se imami është bashkuesi i pjesëve të tyre të shpërndara, është udhëzuesi për të mos rënë në rrugën e humbjes, është ngritësi për të përhapur me ta flamujt e ligjit islam dhe shpirtin e gjallë të mësimëve të tij.*

*Nga urtësia në shkallën më të lartë të politikës së ligjëvendësimit të Islamit, Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimi i All’lahun qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), është urdhri i tij për njohjen e imamit, për të cilin ai ka thënë: “Kush vdes pa e njohur imamin e kohës së tij, ka vdekur si në kohën e injorancës para Islamit.”<sup>1</sup>, por kjo është si të mos ketë hyrë kurrë në rrethin e Islamit.*

---

<sup>1</sup> Ky hadith është në themelin e librit, megjithëkëtë ne nuk e kemi hasur atë në librat ekzistues. Ajo që ne kemi arritur të gjejmë është vetëm teksti: “Kush vdes pa e njohur imamin e kohës së tij, ka vdekur si në kohën e injorancës para Islamit”, “Kenzul-Ummâl”, vëll. 1, f. 103.



*Sikur myslimanët të kishin punuar sipas kësaj detyre, sikur të kishin bërë realitet atë domosdoshmëri, që presupozon detyra për njohjen e imamit dhe të kishin dëgjuar fjalën e tij, pasi të arrinin tek ai, padyshim që do të ishin bërë një ushtri e vetme dhe komandanti i tyre do të ishte imami, atëherë nuk do të kishte asnjë mysliman që të mos i dinte e të mos i mësonte dispozitat e ligjit të fesë dhe të mos punonte në përputhje me to. Gjithashtu, nuk do të kishte mbetur asnjë vend në të gjithë botën, që të mos e ndiente peshën e neneve të ligjit islam.*

*Në të kaluarën, hilafeti dhe imamati ishin një pistë garimi. Kreun e zinte vetëm ai që kapte kallamin e garës, qoftë edhe me gjakderdhje e me përdhosjen e gjërave më të shenjta, madje edhe sikur kalifi, pasi të shtinte në dorë frerët e pushtetit, të ishte i paturpshëm e kumarxhi tipik, nuk do të merakosej fare për veprimet që kryente.*

*Porse shi'at imamij (shiitët imamatë), që në fillim të kohës as nuk e kanë vënë në peshë një hilafet të tillë dhe as nuk e kanë njohur imamin e kësaj kategorie, pasi ata besojnë që kalifi e imami është i pajisur me cilësi e veti më të plotësuar, është i zhveshur nga të gjitha mangësitë e veset. Ai vepron me urdhrat e ligjit të fesë, fshehtazi dhe haptazi. Ai urdhëron me ligjin e fesë, qëndron larg ndalimeve të dukshme e të padukshme që ka vënë ligji i fesë dhe i ndalon ato, shpjegon ligjin e fesë, i bazuar ose në vënësin e ligjit të fesë (Profetin Muhammed), ose në imamin para tij. Ai vepron sipas urdhrat të All'lahut të Lartësuar, të Plotpushtetshmit, të Cilit nuk i mungon asgjë e nuk ka nevojë për asgjë. All'lahu është më i miri Shikues për robët e Vet dhe Ai i vëzhgon në thellësi robët e Tij se cili është më i përshtatshëm për këtë post kaq të rëndësishëm.*

*Mos e beso për imam atë që e vënë njerëzit, pasi imam është ai për të cilin janë argumentet dhe e tregojnë shenjat, pavarësisht se njerëzit nuk e ndjekin. Madje njerëzit edhe mund të qëndrojnë përballë tij dhe ta pengojnë, që ai të mos kryejë detyrimin që i ngarkon detyra parësore e imamet, si dhe detyra e të qenit në krye të punëve.*

*Mosbindja e njerëzve ndaj imamet, ose kundërshtimi që ata i bëjnë atij, nuk kanë ndonjë efekt në atë që ai e ka të mjaftueshme që të ngrihet për të mbajtur barrën e imamet, pasi për njerëzit, edhe gabimet e tij janë fatmirësi dhe gjetje e udhëzimit për në rrugën e drejtë që ata e kishin humbur.*

*Imami, ashtu siç e besojnë imamijtë, është mbartësi i barrës së imametit në të gjitha gjendjet e tij: kur është në këmbë ose ulur, kur flet ose hesht, kur del i pari në garim ose kur mbetet prapa, sepse qenia e tij imam nuk bëhet me një rrobë të huazuar, të cilën ai e vesh nëse çështja e tij përzihet me ndonjë tjetër apo zhvishet nga ajo rrobë kur atij ia heqin.*

*Meqenëse imami është argument i qartë, nga detyrat e imamet është që ai të njoftojë njerëzit për imametin e tij. Në raste domosdoshmërie të parashtrijë fakte e argumente, që vërtetojnë se me të vërtetë ai është imami, ashtu siç është detyrë për ummetin, që ta njohë e t'i bindet atij kur ta njohin se cili është.*

*Parashtrimi i fakteve e i argumenteve, për të vërtetuar imametin e tij, herë bëhet me deklaram dhe herë me nxjerrje në dukje. Është e mjaftueshme që argumenti të*

*tregohet nëpërmjet veprave të jashtëzakonshme (keramete), ose shfaq nga dituria atë që njerëzit e kanë të pamundur ta arrijnë me një të ngjashme, me përjashtim të rasteve kur shpatat e kanë ndarë fjalën pa lejen e tij. Gjithsesi, punët e cilësitë e tij të larta flasin vetë për pozitën e lartë që ka imami, edhe atëherë kur gjuha e tij hesht.*

*Që nga dita kur u largua nga kjo botë zotëruesi i thirrjes islame (Profeti Muhammed), imamati ka qenë e vazhdon të jetë objekt polemikash e armiqësish, që zhvillohen ndërmjet myslimanëve me laps e me fjalë, me shpatë e me ushta. Megjithatë, edhe sot themelet e imamtit vazhdojnë të ndërtohen mbi gërmadhat e së kaluarës, prandaj imamati, edhe në ditët e sotme, është ashtu siç ishte dje: ndarës ndër grupet, edhe pse myslimanët janë unikë në Librin e All'lahut, në Profetin dhe në Kiblenë. Në të gjitha grupet e myslimanëve, sot dhe dje, ka burra të mençur e me mendime të qarta e të drejta, që kanë mundësi t'i mbledhin këto kapacitete nën një flamur të vetëm e t'ua bëjnë të qartë njerëzve se mungesa e imamit çon në prapambetje e në thirrjen e njëri-tjetrit me nofka përçmuese. Gjithashtu, ata janë në gjendje t'u bëjnë të njohur njerëzve dobitë e pastrimit e t'i paralajmërojnë ata për të këqijat e përçarjes.*

*Imamati, ashtu siç ka qenë kryqëzim rrugësh, patjetër që duhet të jetë edhe bashkim i këtyre ndarjeve. Nëse njerëzit, në ditët e sotme, do të njihnin të vërtetën e imamtit dhe se kush është imami, nëse ata do të ngriheshin për unitet rreth imamit, ose të ngriheshin edhe vetëm disa prej tyre, patjetër që do të shihnin se vetëm aty gjendet bashkimi ndërmjet grupeve. Që nga ky çast do të*

*merrte fund përçarja, gjendja e acaruar, anarkia dhe fjalët e mbushura me konflikte.*

*Unë do të mundohem të tregoj disa nga detyrat e imamit, edhe pse fjalën time mund ta marrin shakullinat e erërave e të mos tërheqë as vëmendjen e të shkujdesurve, madje të mos e dëgjojnë as njerëzit vigjilentë me mirësinë e tyre. Megjithëkëtë, mua kjo nuk më sjell ndonjë zemërim, përderisa qëllimi është i mirë dhe synimi më i lartë është vetëm kërkimi i kënaqësisë së All'llahut të Lartësuar.*

*Unë them se sistemi, me të cilin erdhi Vula e Profetëve (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është sistem gjithëpërfshirës, që bashkon dy rrugë: rrugën e njeriut me Krijuesin dhe rrugën e tij me krijesën. Ai që erdhi me këtë sistem, detyrimisht duhej të ishte i fuqishëm për ta vënë atë në zbatim, të lartësohej në gradat më të larta, thirrja e tij të shtrihej në të gjitha tokat e banuara dhe të punonte, që ligji i fesë së tij mundësisht të praktikohet në të gjithë botën. Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), në zbatimin e ligjit të fesë së tij, ishte zotërues i dy pushteteve: pushtetit kohor dhe shpirtëror. Kur All'llahu e thirri atë në shoqërinë e tij, për ummetin u bë domosdoshmëri që të përfundonte në thirrjen që i kishte bërë Profeti që kur ishte në këtë jetë për vendosjen e imamit. Prandaj ata gjykuan se funksionet e patjetërsueshme të zotëruesit të thirrjes mund t'i kryente vetëm një imam, që të kishte në dorë kryesinë e përgjithshme mbi të gjithë ummetin islam; po ashtu, të kishte edhe dy pushtetet, që i kishte pasur i Dërguari besnik i All'llahut -(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ndryshe ky sistem garantues për të dyja lumturitë do të mbetej i pazbatueshëm, për pasojë nuk*

*do të plotësohej asgjë nga dobitë që përmban ky ligj dhe do të shkonte kot mundimi e bashkë me të edhe sakrificat e rënda nëpër të cilat kaloi mbajtësi i mesazhit.*

*Meqenëse imamati është detyrë e domosdoshme për ummetin, lind pyetja: Cili është më i meritueshëm për këtë detyrë kaq të madhe? A mendon që ai më i meritueshmi të jetë si vetë mbajtësi i mesazhit dhe një kopje identike e tij në dituri e në punë, i udhëzuar në rrugën e drejtë për veten dhe për të tjerët, që sjell argument, që i tejkalon vitet, argument, që nuk njeh venitje e nuk i kalon koha?! Nëse njerëzit kërkojnë prej tij të bëjë diçka të jashtëzakonshme (mu'xhize) në punë e në fjalë, ai ka mundësi të vijë me atë që i kërkohet pa vonesë e pa ndonjë kujdes të veçantë, qoftë kur argumenti kërkohet prej atij që dëshiron të udhëzohet në rrugën e drejtë, qoftë kur kërkohet prej ndonjë kryeneçi. Gjithashtu, imami di atë çka ka ardhur prej zotëruesit të ligjit islam dhe vepron me atë ligj. Ai njeh Kur'anin, njeh vendet dhe shkaqet e zbritjes, njeh edhe shpjegimin e Kur'anit. Ai është i pajisur me cilësitë më të larta dhe asnjëra nga këto cilësi nuk hiqet prej tij. Edhe një cilësi e vetme e tij është më e mirë se të gjitha virtytet e mbarë njerëzimit. Imami është pa vese dhe asnjë lloj vesi nuk mund të gjendet te ai, qoftë edhe për një çast të vetëm. Me një fjalë, ai është modeli i vërtetë i të Dërguarit në të gjitha vetitë e tij shpirtërore, në cilësitë e në punët e tij.*

*Në rast se në postin e imamt do të thuhej se është më i meritueshëm ai që nuk ka dijeni fare për këto që u thanë më sipër, është njeri i panjohur, ose ai që ka vetëm disa cilësi dhe nuk ka disa të tjera, nuk ka dyshim se ti do të përgjigjesh: "I pari është më i meritueshëm dhe ka të*

*drejtë të jetë në këtë post kaq të lartë, sepse nuk mund të ketë ndonjë vëzhgues të vëmendshëm, që të thotë se i dyti është më i meritueshëm e ka më shumë të drejtë për atë post.”*

*Por unë dua të të jap rastin që ti të pohosh se i gjithë problemi qëndron në vërtetimin e dy çështjeve. E para: detyra e vënies së një imami me ato cilësi e karakteristika që u thanë dhe e dyta: prania e tij me të gjitha këto veti e cilësi të larta në ummetin islam. Sikur ne të vërtetojmë se në personin e imamatit detyrimisht duhet të jenë të gjitha këto cilësi e virtyte dhe se me të vërtetë ai gjendet e i ka të gjitha këto cilësi, atëherë mosnjohja dhe mospranimi i imamatit të tij me fjalë e i urdhrave të tij, është thjesht vetëm kokëfortësi, nga e cila nuk mund të jetë i kënaqur kushdo që ka fe e aftësinë për të parë në thelbin e problemit.*

*Unë them: “Për ty do të vërtetoj të dyja çështjet, me shpresë se ti do të jesh prej atyre që dëgjojnë dhe padyshim All’llahu është dëshmues.*

*Ja, shkurtimisht, argumenti për çështjen e parë: Profeti (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) - ishte i vetëdijshëm për atë që shpallte me zë të lartë, kishte dijeni për pyetjet që i bëheshin. Ligji i fesë së tij është unik. Në këtë ligj nuk ka asnjë kundërshtim dhe është i përhershëm deri në Ditën e Ringjalljes. Ajo çka ishte hallall për Muhammedin është hallall deri në Ditën e Kiametit, por edhe ajo çka ishte haram për të është haram deri në Ditën e Kiametit. Nëse imamin, që do të kryente funksionet e tij, do ta kërkonim tek pjesëtarët e ummetit, me siguri që do të të vinte rëndë kur të konstatoje se*

*ummeti nuk i njeh dispozitat e ligjit të fesë, nuk dallon as haramin nga hallalli e as hallallin nga harami, sepse në ummet nuk ka gjykim të prerë në fushën e dijeve të ligjit të fesë që t'i referohen fjalës së vetë Profetit, nuk ka asnjë sundimtar të drejtë që të zbatojë saktësisht pjesën e penaliteteve të ligjit të fesë, nuk ka asnjë sundimtar të atillë, që njerëzit të jenë të nënshtruar ndaj urdhrit të tij. E gjitha kjo ka çuar në copëzimin në shumë medh'hebe e mendime të gabuara. Secili paraqit argument për mendimin që shpreh, sjell edhe fakte për vërtetësinë e doktrinës së tij, ashtu siç ka qenë edhe në atë kohë kur njerëzit zgjidhnin të vetët dhe për interesat e veta imamin ose kalifin. Kanë zgjedhur kalifë, që nuk i dinin të gjitha ato me të cilat erdhi i Dërguari bujar (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe për shumicën e pyetjeve, që u bëheshin, ishin krejtësisht injorantë. Pas zgjedhjes, ai duhej të ishte sundues i ndershëm, ndarës i çështjeve dhe gjykatës i drejtë, por njerëzit nuk gjenin tek ata sundimtarë atë që kërkohesh në qeverisje e në gjykim, derisa çdonjëri paraqitej me medh'hebin e me mendimet e tij dhe për pasojë, asnjëri prej tyre nuk kishte argument të prerë e të qartë, asnjëri nuk sillte argument dritëdhënës, me të cilin të hidhte poshtë ato medh'hebe të stisura e mendime të dyshimta, të kundërshtonte mendimet e gabuara dhe çdo gjë të rreme që i adresohesh ligjit të fesë. Me një fjalë, ai nuk kishte asgjë nga feja. Ku është hallalli e harami, që janë të patjetërsueshëm deri në orën e fundit të gjithësisë? Ku është ligji i fesë (sheri'ati), unik e i përjetshëm gjatë gjithë kohëve?! Në fakt, në Islam, pas Profetit, dolën ligjëvënës e ligje feje, dolën fe e medh'hebe.*

*Meqenëse ky tjetërsim u krye me dëshirën e njerëzve, të cilët preferuan atë që nuk i dinte të gjitha sa kanë ardhur në ligjin e fesë e që në të njëjtën kohë të ishte dijetar e sundues, që u shkul dhëmbët llafazanëve e u shkurton gjuhët atyre që stisin fjalë të rreme, herë me argumente e herë me mprehtësinë e tehut, sundimtar të cilin pas kësaj nuk e kundërshtojnë njerëzit dhe nuk kanë ndryshim në mendime e në dëshira; për të gjitha këto, për ummetin është detyrë e domosdoshme të zgjedhë një imam, i cili të dijë plotësisht atë që thuhet në ligjin e fesë, me të cilin erdhi Muhammedi, që ai të punojë në zbatim të ditorisë që ka dhe të ketë dituri sa të jetë në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen. Gjithashtu, imami duhet të ketë argumente për të hedhur poshtë iluzionet, gjërat e gabuara, injorancën e formave të shumta dhe shkarjet në rrugën e humbjes, me qëllim që ligji i fesë të qëndrojë erëkëndshëm përgjithmonë, ashtu siç e shpalli dhe e shpjegoi i Dërguari (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij), që hallalli e harami i tij të mos zëvendësojnë njëri-tjetrin sa të jetë jeta, pasi nuk ka më as ligje, as ligjvënës, as medh'hebe e as fe të tjera.*

*Por si ta përzgjedhë ummeti këtë sundimtar dijetar? Nga do ta njohë ummeti atë? Edhe sikur ta njohë, prej nga do të vijë për ummetin përputhja në fjalë në lidhje me atë imam, kur njerëzit janë në zallamahinë e grindjeve dhe kanë qëllime diametralisht të kundërta?*

*I Larti, me madhërinë e Tij, për të mirën e njerëzve e ka marrë në dorën e Tij detyrën e vendosjes së imamit, prandaj Ai, me anë të të Dërguarit, i ka njoftuar njerëzit se cili është ky pasardhës i drejtë, dijetar e punëtor, sepse All'llahu i Lartësuar ka mundësuar për robët e Tij dhe i ka*



*mësuar ata të dinë se cili është më i meritueshëm për këtë post kaq të rëndësishëm e për këtë nderim të madh.*

*Meqenëse vënia e imamit qenka nga detyrat e All'llahut të Lartësuar, mendjet e kanë të pamundur të anashkalojnë të Lartësuarin në detyrën që është në të mirë të robëve të Tij, prandaj Ai i udhëzon krijesat e Veta në rrugën e drejtë; ashtu siç ishte e pamundur edhe për të Dërguarin që të linte kumtimin që kishte marrë nga i Larti në lidhje me vendosjen e këtij imami dhe, nëse do të ishte e lejueshme lënia e kësaj detyre, atëherë do të ishte e lejuar edhe për të tjerët.*

*Kur u bë detyrë ardhja e të Dërguarit, u bë detyrë edhe vënia e imamit. Kur All'llahu dërgon një profet, Ai vë edhe imamin, sepse nuk ka të dërguar pa imamë dhe nuk ka ligj feje (sheri'at) pa komentim e pa zbatim.*

*Përsa i përket argumentit për të dytin, ai është ekzistenca e këtij imami. Për rrjedhojë, pas asaj që u tha më sipër, çështja në lidhje me të lehtësohet, sepse në të vërtetë ne besojmë në detyrën e vënies së imamit me ato cilësi. Gjithashtu, besojmë se atë e ka vendosur vetë All'llahu i Lartësuar për krijesat e Tij dhe se i Larti nuk e ka lënë të panjohur atë as si emër e as si origjinë, ndryshe ummeti do ta kishte të vështirë ta njohte atë. Për më tepër, ne nuk njohim në të gjithë ummetin imamë me të tilla cilësi, që të kenë pretenduar për veten postin e imamit, përveç Aliut e djemve të tij -Paqja qoftë mbi ta!. Nëse ata nuk do të ishin imamë, atëherë imamati dhe kjo detyrë do të ishin vetëm fjalë boshe.*

*Tani nuk ka mbetur gjë tjetër veçse të mësojmë se ata janë dijetarët, të cilët, në asnjë rast, nuk janë të pa ditur dhe janë imamët e drejtë, që kurrë nuk mëkatojnë. Përsa i përket drejtësisë, asnjëri prej tyre nuk ka gjykuar përveç Prijësit të Besimtarëve dhe për pozitën e tij shpjegimet nuk janë të nevojshme. Dituria e tyre dhe gjurmët që ata kanë lënë, flasin vetë, prandaj ti ndiqi, se do të gjesh të vërtetën që është thënë e që thuhet. Ky libër, që ke ndër duar, është një vaditje për këtë dituri të mbuluar.*

\* \* \*

### *KUSH ËSHTË IMAM SÀDIKU?*

*Është e drejtë e shkrimtarit të japë një paraqitje të përgjithshme të personit që përshkruan para se të fillojë të depërtojë në thellësitë e këtij personaliteti. Shkrimtari këtë e bën, me qëllim që lexuesi të mos jetë i huaj për çdo pjesë të jetës së tij.*

*Në këtë kapitull mendova të citoj diçka nga mendimet që kanë shprehur dijetarët në thëniet e tyre për Xha'fer Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!), sepse thëniet e atyre njerëzve të shquar shprehin mendimet e brezave rreth këtij personaliteti të nderuar. Dhe tani, disa nga mendimet e dijetarëve:*

*Edh'Dhebiju<sup>1</sup> në librin "Mizànul-I'tidâl", vëll. 1, f. 192, kur ka përmendur imamin thotë: "Xha'fer ibn Muhammed Ali ibn Husejn El-Hàshimij, Ebù Abdil-lah*

---

<sup>1</sup> Hafiz i Kur'ànit, dijetar në fushën e shkencave të hadithit Shemsud'dijn Ebù Abdil-lah Muhammed ibn Ahmed ibn Uthmàn Ed'Dimeshkij, ka lindur në vitin 673 dhe ka vdekur në vitin 748.

*Ahmed, është nga kolosët e imamëve, njeri bamirës, i drejtë dhe me autoritet të madh.”*

*En’Neueuiju,<sup>1</sup> në librin “Tehdhibul-Esmài uel’Lugât”, vëll. 1, f. 149-150, thotë: “Në lidhje me të kanë treguar Muhammed ibn Is’hàku, Jahjà El-Ensàriu, Màliku, dy Sufjànët, Ibn Xhurejhi, Shu’beh, Jahjà El-Kattàni e të tjerë. Të gjithë kanë një mendim të përbashkët për imamatin e për madhështinë e tij: “Ai ishte njeri i nderuar.”*

*Kurse Amr ibn Ebu Mikdàmi thotë: “Kur unë shikoja te Xha’fer ibn Muhammedin, mësoja se ai me të vërtetë ishte prej pasardhësve të profetëve.”*

*Ibn Khil-likàni,<sup>2</sup> ka thënë: “Njëri nga të dymbëdhjetë imamët e medh’hebit imamij, ishte nga zotërinjtë e nderuar të Ehli Bejtit. Për vërtetësinë e shkrimeve të tij është thirrur me epitetin Sàdik. Nga mirësia e virtyti ai qëndron shumë më lart nga sa përmendet.”*

*Gjithashtu, nxënësi i tij, Ebù Mùsà Xhàhir ibn Hajjàn Es’Sufij Et’Tartùsi,<sup>3</sup> ka shkruar një libër me më shumë se*

---

<sup>1</sup> Hafiz i Kur’ànit Ebù Zekerijà Muhji-d’din ibn Sherefu-d’din, vdekur në vitin 676.

<sup>2</sup> Ahmed ibn Muhammed ibn Ibrahim ibn Ebù Bekr ibn Khil’likàn, ka lindur në qytetin Irbil pranë Mosulit, ka shkuar të banojë në Mosul. Më vonë ka udhëtuar për Haleb dhe ka hyrë në trevat egjiptiane. Ka qenë zëvendës gjykatës i Sekhàuijut. Për dhjetë vjet me radhë ka ushtruar detyrën e gjykatësit në Shàm. Ka vdekur në Damask në vitin 681. Për të janë dhënë përshkrime në librin “Tabekàtu Shàfi’ijeh”, vëll. 5, f. 14; në librin “Feuàtul Uefijjàt”, vëll. 1, f. 55. Për të ka shkruar edhe Sujùtiu në librin “Husnul-Muhàdareh”, vëll. 1, f. 268; “Mu’xhemul Metbù’ât”, vëll. 1, f. 98 etj.

<sup>3</sup> Më poshtë do të flasim për jetën e tij shkencore dhe diturinë e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) në fushën e kimisë. Prej Sàdikut ka marrë mësim Xhàbiri. Gjithashtu, do të flasim shkurtimisht edhe për jetën e Xhàbirit.

*1000 faqe, që përmbajnë pesëqind letrat e Sàdikut dhe ka thënë: “Është varrosur në Baki, në të njëjtin vend ku janë varrosur babai i tij, Muhammed Bàkiri, gjyshi i tij, Zejnul Àbidini e xhaxhai i gjyshit të tij, imam Hasan ibn Aliu (Paqja qoftë mbi ta!)*

*Esh’Shebelenxhiu,<sup>1</sup> në librin “Nùrul Ebsàr”, f. 131 thotë: “Meritat e tij janë aq të shumta, sa e kapërcejnë edhe kufirin e mundësisë për t’u numëruar. Në llojshmërinë e tyre, ato duhen kërkuar në zgjuarsinë e vetë atij që i manifeston.” Përsëri ai ka thënë: “Edhe në jetën e kafshës më të madhe ka një dobi.” Kështu thotë Ibn Kutejbeh në librin “Edebul Kàtib” dhe vazhdon: “...në librin “Kitàbul Xhefr”, të shkruar prej imamet Xha’fer Sàdik Ibn Muhammed El-Bàkir, nga dituria e tij ka çdo gjë që atyre u nevojitet deri në Ditën e Kiàmetit.”*

*Pikërisht për këtë shërim ka folur Ebul-A’là në fjalën e tij:*

*“Ata u çuditën për Ehli Bejtin kur atyre u erdhi dituria në lëkurën e shërimit.*

*Pasqyra e astronomit është e vogël, e bën atë të shohë çdo vend të banuar e çdo hënë.”*

*Muhammed Es’Sabbàn,<sup>2</sup> në librin e tij “Is’âfur’Ràgibin”, shtypur në margjinaturën e librit “Nùrul Ebsàr” f. 308, ka thënë: “Përsa i përket Xha’fer Sàdikut, ai ishte imam fisnik...” dhe ka shtuar: “...lutja e tij gjente përgjigje.*

---

<sup>1</sup> Mu’min ibn Hasan Mu’min El-Misrij, kurse Shebelenxh është emri i një fshati në Egjipt. Mësimet i ka marrë në Universitetin e Ez’herit. Ka lindur në gjysmën e vitit 1250, por nuk dihet data e vdekjes së tij.

<sup>2</sup> Muhammed ibn Ali Es’Sabbàn Esh’Shâfi’ij, është i medh’hebit hanefi. Ka lindur në Egjipt dhe për të ka një përshkrim në “Mu’xhemul-Metbù’ât”, vëll. 2, f. 1194.

*Kur ai i lutej All'llahut për ndonjë gjë, pa e mbaruar fjalën, do ta kishte para duarve.”*

*Sha'ràniu,<sup>1</sup> në librin “Leuàkihul-Enuàr”, thotë: “Paqja e All'llahut qoftë mbi të! Kur kishte nevojë për ndonjë send, thoshte: “O Zoti im, unë kam nevojë për këtë gjë!” dhe, pa e plotësuar akoma lutjen e tij, gjëja do të ishte vënë pranë tij.”*

*Edhe Ibnul-Xheuzij<sup>2</sup> ka shkruar gjatë në librin “Tedhkiretu Khauàsìl ummeh”. Në faqen 192 thotë: “Biografët kanë thënë: “Kohën e zinte me adhurime dhe jo në kërkim të kryesisë. Nga moralet e tij të lavdëruara është edhe ajo që ka përmendur Zemahsheri në librin e tij “Rebi'ul-Ebràr”, treguar prej Shukràniut, shërbyesit të Dërguarit të All'llahut -(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ka thënë: “...në kohën e Mensùrit, ‘Atàu shkoi në luftë, kështu që për mua nuk kishte kush të ndërmjetësonte. Prandaj po rrija në mëdyshje pranë portës. Xha'fer ibn Muhammedi u afrua pranë meje. Nuk e humba rastin dhe i thashë hallin që kisha. Ai hyri e doli duke mbajtur në mëngën e tij atë që do të më jepej mua. Pasi ma dha, më tha: “E mira, prej cilitdo që të vijë, është e mirë, por prej teje është akoma më e mirë për pozitën e lartë që ke tek ne. Gjithashtu, edhe e keqja, prej cilitdo që të vijë, përsëri e keqe është, por prej teje është shumë më e keqe për pozitën e lartë që ti ke tek ne.”*

---

<sup>1</sup> Abdul-Uehhàb ibn Ahmed ibn Ali El-Ensàrij, është i medh'hebit shàfi'i, zotërues i shumë talenteve. Është egjiptian i njohur me emrin Sha'rànij. Hyri në Kajro në vitin 911 dhe aty ka vdekur. Për të janë dhënë përshkrime në librin “Mu'xhemul-Metbù'ât”, vëll. 1, f. 1126.

<sup>2</sup> Ebù Mudhaffer Shemsu-d'din Jùsuf ibn Kazgalij, lektor i dëgjuar i medh'hebit hanefi. Ka lindur në vitin 582 dhe ka vdekur në vitin 654 më 21 të muajit Dhul-Hixheh.

*Në të vërtetë, Xha'feri i tha këto fjalë, pasi Shukràniu pinte pije të ndaluara. Nga moralet e tij të larta ishte fakti se në fillim e përshëndeti dhe pastaj i plotësoi nevojën që kishte, megjithëse e dinte se si ishte, pastaj e këshilloi në mënyrë të zgjeruar. Kjo mënyrë veprimi është nga edukata e morali i profetëve.”*

*Muhammed ibn Talha,<sup>1</sup> në librin “Metàlibu-s’Su’l”, f. 81, thotë: “Ai është nga më të mëdhenjtë e Ehli Bejtit e nga më të nderuarit e tyre. Ai zotëron dituri të shumta. Kryente shumë adhurim, vazhdimisht përsëriste pjesë të zgjedhura nga Kur’ani, përkohshmëria e tij ishte e dukshme, këndonte shumë Kur’an, ndiqte kuptimet e Kur’ànit Famëlartë, nxirrte diamantet nga deti i Kur’ànit e mblidhte konkluzionet e çudirave të Librit të All’llahut. Kohën e tij e pjesëtonte për lloje të ndryshme adhurimesh dhe për këtë i kërkonte llogari vetes. Shikimi i tij të kujtonte Botën e Ardhsme, dëgjimi i bisedës së tij ishte përkohshmëri në këtë botë, udhëzimi sipas shembullit të tij të jepte trashëgim Xhennetin, drita e bukurive të tij dëshmonte se ai ishte pasardhës i profetësisë, pastërtia e punëve të tij fliste me zë të lartë se ai ishte pinjoll i Familjes së Mesazhit.”*

*Më pas vazhdon: “...kurse meritat dhe cilësitë e tij e tejkalonin mundësinë për t’u përshkruar dhe në llojin e tyre ato ishin depërtuese në shkallën më të lartë. Dituri të shumta i vërshonin në mendje e në zemër, si të rridhnin nga lart prej devotshmërisë së tij. Dispozitat e ligjit të fesë, që në shumë mendje ishin të pafuqishme për t’i arritur e*

---

<sup>1</sup> Kemàlu-d’din, është i medh’hebit shàfi’i. Ka vdekur në vitin 654.

*për t'i shpjeguar, te ai ishin me tepricë dhe rridhnin si lumë.*"

*Në librin "Sauàik" të Ibn Haxherit<sup>1</sup> thuhet: "Njerëzit kanë përcjellë dituri të shumta prej tij, aq sa nuk ua mbanin këmbët. Ai njihej në të gjitha vendet."*

*Në librin "Jenàbi'ul-Meueddeh"<sup>2</sup>, botuar në Stamboll, f. 380, lexojmë: "Nga imamët e Ehli Bejtit është edhe Ebù Abdil-lah Xha'fer Sàdiku." dhe vazhdon: "...ishte nga të nderuarit e Ehli Bejtit."*

*Shejhu Ebù Abdir-Rahmàn Es'Sàlimij, në librin "Tabekàtul-Meshàjikhî-s'Sùfijjeh" ka thënë: "Xha'fer Sàdiku ishte më lart se gjithë të tjerët prej Ehli Bejtit, ishte zotërues i diturive të shumta. Ishte tepër i përkorë në gjërat e kësaj bote, shumë i ruajtur nga epshet dhe kishte edukatë të plotë të mbushur me urtësi."*

*Dhe tani ja ç'thotë hafiz Ebù Neimî<sup>3</sup> në librin "Hiljetul-Eulijà", vëll. 3, f. 192: "...dhe prej tyre është imami mendimtar e prijës në fushën e mendimeve, Ebù Abdil-lah Xha'fer ibn Muhammed Sàdiku, më i përkryeri në adhurimin e në nënshtrimin ndaj All'llahut të Lartësuar. Ai kishte preferuar qëndrimin mënjanë dhe përkushtimin. Ai e kishte privuar<sup>4</sup> veten nga postet e larta e nga tubimet." Pastaj përcjell thënien e mëparshme të Amr ibn Ebil-*

---

<sup>1</sup> Shihàbudin Ahmed ibn Haxher dijetar në shkencën e hadithit, nga fisi Hejthem, banor i Mekkës.

<sup>2</sup> Kjo është prej shejhut Sulejmàn ibn Ibrahim, i njohur me emrin Khauàxha Kelàn, librin e ka shkruar në datën nëntë Ramazan të vitit 1291.

<sup>3</sup> Ahmed ibn Abdil'lah El Asbehànij ka vdekur në vitin 430.

<sup>4</sup> Kështu është në origjinal dhe në librin "Keshful Ghummeh" të Haliut është shkruar "për ato", por që të dyja janë plotësisht të përshtatshme për vendin ku janë vënë.

*Mikdàmmit dhe vijon të përcjellë prej Hejxh ibn Bestàmî<sup>1</sup> thënien e tij: “Xha’fer ibn Muhammedi ushqente të varfrit derisa nuk i mbetej gjë për njerëzit e familjes së vet.”*

*Ibn Sabbàgu, i medh’hebit màliki,<sup>2</sup> në librin “El-Fusùlul-Muhimmeh”, thotë: “Ndër vëllezërit e vet ai ishte zëvendësi i babait të tij dhe atij i kishte lënë kujdestarinë. Ai mbante imamatin pas babait të vet. U shqua mbi njerëzit e tij në virtyte. Ishte më i kujdesshmi i tyre në përmendjen e All’llahut. Ndër ta ai dallohej për autoritet dhe njerëzit kanë marrë prej tij aq shumë dituri, sa nuk ua mbajnë këmbët. Ai ishte shumë i dëgjuar dhe përmendej në të gjitha vendet.”; dhe në fund të fjalës së tij thotë: “Madhështia e diturisë së Ebù Abdil-lah Xha’fer Sàdikut ishte virtyt, pastërtia e tij në nder ishte e plotë, bujaria e tij rridhte pa pushim dhe kuvendet e lavdishme dhe krenaria me madhështinë e me veprat e tij ishin plotësisht të meritueshme.”*

*Kurse Es’Suvejdiu,<sup>3</sup> në librin “Sebàiku-dh’Dheheb”, f. 72, thotë: “Ndër vëllezërit e vet ai ishte zëvendësi i babait të tij dhe personi të cilit ai i la porosinë e kujdestarisë. Prej tij janë përcjellë aq dituri, sa nuk është përcjellë prej dikujt tjetër. Ai ishte imam edhe në fushën e hadithit.”*

---

<sup>1</sup> Et’Temimij El Handhalij El Heruij udhëtoi për në Irak, ku dëgjoji dijetarët e kohës së vet. Kur shkoi në Bagdad bisedoi me dituritë që kishte dëgjuar. Vdiq në vitin 177. El Khatib El Bagdadiu e ka përshkruar në veprën e tij vëll. 14, f. 80.

<sup>2</sup> Nùrudin Ali ibn Muhammed Sabbàg, i medh’hebit màliki, ka lindur në vitin 784 dhe ka vdekur në vitin 855. Për të ka lënë përshkrim Sekhàviu në librin “Ed’dau’u-l’lami”, vëll. 5, f. 283. Shejhët e tij dhe autorët, që kanë shkruar për të, në mjaft kapituj të rëndësishëm kanë dhënë njoftime për imamët, të cilët janë dymbëdhjetë.

<sup>3</sup> Muhammed Emin El Bagdadij shpjegon se familja Suvejd është nga shtëpitë e mëdha në Bagdad deri në ditët e sotme, kurse ai është nga burrat e shekullit të kaluar. Librin e tij e shkroi në vitin 1229.



*Vazhdon e thotë: “Meritat e tij ishin të shumta.”*

*Në librin “Umdetu-t’Tàlib”<sup>1</sup>, f. 184 shkruhet: “Për të thuhet se është kolona e nderit, meritat e tij janë të shumta e mjaft të njohura si te njerëzit e shquar, ashtu edhe të zakonshëm. Mensùr Ed’Deuàniku disa herë kishte vënë qëllim ta vriste, por All’llahu e ruajti prej tij.”*

*Shehrastàniu,<sup>2</sup> në librin “El-Milelu uen’Nihalu”, shkruan: “Ai zotëron dituri të shumta në fe e në edukatë, është i plotësuar në urtësi, shumë i përkorë dhe plotësisht i ruajtur nga epshet. Shi’at, që e ndjekin atë, njoftojnë se për disa kohë ka banuar në Medine. Pasuesve të vet u ka dhënë sekretet e diturive. Pastaj ka shkuar në Irak, ku ka banuar për disa kohë, por kurrë nuk e ekspozoi imamatin<sup>3</sup> dhe me asnjë nuk ka pasur konflikt për punën e hilafetit. Ai, që është zhytur në detin e njohjes (ma’rifeh), nuk synon bregun. Ai, që është ngjitur në majën më të lartë të së vërtetës, kurrë nuk ka frikë se bie poshtë, prandaj është thënë: “Kush miqësohet me All’llahun, bëhet i ashpër me njerëzit dhe kush kërkon shoqërimin me dikë tjetër dhe jo me All’llahun, atë e ka rrëmbyer djalli.”*

---

<sup>1</sup> Xhemàludin Ahmed ibn Ali Ed’Dàudij El Hasenij, njohës i shquar i trungjeve të familjeve, ka vdekur në vitin 828.

<sup>2</sup> Ebul-Fet’h Muhammed ibn Ebil-Kàsım ka qenë jurist e teolog në medh’hebin esh’arij. Ka shkuar në Bagdad në vitin 510 dhe aty ka banuar tre vjet. Ka lindur në Shehrastàn dhe po aty ka vdekur në vitin 548. Për të është folur në librat: “El-Uefijjât”, “Mu’xhemul Udebà”, “Tabekât” i Es’Subkijut, si dhe në librat “Raudàtul Xhennât”, “Miftàhu-s’Seàdeh” dhe në libra të tjerë.

<sup>3</sup> Këtu me imamat kuptojmë atë imam që vënë njerëzit, ndryshe ai është imam për të cilin njerëzit janë të bashkuar rreth tij ose janë të përçarë. Ai ose e parashtron çështjen, ose largohet.

*El-Jâfi'iu<sup>1</sup>, është ndër ata që kanë vdekur në vitin 148. Në librin "Mir'âtul-Xhinàn", vëll. 1, f. 304 thotë: "Në të (në Medine) vdiq imami, zotëria i lartë nga pasardhësit e profetësisë dhe burimi i pastërtisë. Ebù Abdil-lah Xha'fer Sàdiku, është varrosur në Baki, në atë varr ku është varrosur babai i tij, Muhammed Bâkiri, gjyshi i tij, Zejnel Àbidini dhe xhaxhai i gjyshit të tij, Hasan ibn Ali - Kënaqësia e All'llahut qoftë mbi ata të gjithë!. Sa varr i nderuar është ky! Aty janë mbledhur më të nderuarit, më bujarët dhe burrat me autoritet të lartë. Është quajtur Sàdik për shkak të vërtetësisë së shkrimeve të tij. Gjithashtu, ai ka një botim shumë të dobishëm për shkencat e Teuhidit – besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm - si dhe vepra të tjera. Nxënësi i tij, sufiu Xhàbir ibn Hajjàn ka shkruar një libër me 1000 faqe dhe ka përfshirë në këtë libër letrat e tij, që janë plot 500."*

*Sadùku<sup>2</sup> (u shtoftë mirësia e tij!) në librin e tij "Emàlij", në faqen 42, transmeton sipas përcjelljes së Sulejmàn ibn Dàùd El-Munkirij<sup>3</sup>, prej Hafs ibn Gajjàthit<sup>4</sup>, tregon se kur ai na fliste për Xha'fer ibn Muhammedin (Paqja qoftë mbi të!) thoshte: "Më ka folur më i miri i xha'ferijve."*

<sup>1</sup> Ebù Muhammed ibn Sa'd ibn Ali ibn Sulejmàn Afifudin El-Jâfi'ij El Jemànij, vizitor i dy Xhamive të Shenjta, ka vdekur në vitin 768.

<sup>2</sup> Muhammed ibn Ali ibn Bâbeuejh El Kummij, dijetar në shkencën e hadithit, autor i shumë veprave të vlefshme, të shkruara me stil shumë të lartë. Ka shkruar afërsisht 300 vepra. Ka ardhur në Bagdad në vitin 352. Shejhët e medh'hebit (xha'ferij) kanë dëgjuar për moshën e tij të re. Ka vdekur në Rej në vitin 381.

<sup>3</sup> I njohur me emrin Ibn Esh'Shàdhekùnij, është prej atyre që kanë shkruar për Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!). Gjithashtu, ka shkruar edhe për përcjellësit e tij, ndërsa vetë ka qenë ndër përcjellësit e besueshëm.

<sup>4</sup> El Kùfij El Kàdij, në pjesën ku do të flitet për përcjellësit e besueshëm, do të shpjegohet se ai është nga përcjellësit më të dëgjuar të njoftimeve për Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) Në të vërtetë ai është nga të Ehli Sunnetit.

*Gjithashtu, Saduku tregon, duke u bazuar te Ali ibn Gurabin, se kur ai fliste për Xha'fer ibn Muhammedin thoshte: "I vërteti Xha'fer ibn Muhammed më ka folur për All'Ilahun ..."*

*Gjithashtu, në faqen 32 të librit, i bazuar në përcjelljen e Muhammed ibn Zijad El Ezdij<sup>1</sup>, i cili ka thënë: "Kam dëgjuar Mâlikun, të birin e Enesit<sup>2</sup> të thotë: "Shkoj tek Sâdiku Xha'fer ibn Muhammedi (Paqja qoftë mbi të!) dhe ai më jep një jastëk që të mbështetem, sepse ai e njuh rëndësinë time. Ai kurrë nuk ka hequr dorë nga tri cilësi të larta: ose do të ishte agjërueshëm, ose do të falte namaz, ose ishte duke bërë dhikr. Ai bënte adhurim më shumë se kushdo tjetër dhe ishte më i larti i të përkorëve që e kanë frikë All'Ilahun e Lartësuar. Dinte shumë hadithe. Biseda me të ishte kënaqësi. Prej tij vinin shumë dobi. Një herë*

<sup>1</sup> Ai është i njohur me emrin Ibn Ebi 'Umejr. Është takuar me Qazimin (Kadhim), Rizain dhe Xhevadin (Paqja qoftë mbi ta!). Reshidi e ka burgosur "Natën e zhdukjes", me qëllim që t'i tregonte vendin ku gjendeshin shi'at dhe ndjekësit e Qazimit (Paqja qoftë mbi të!). Gjithashtu, thuhet se e kanë rrahur me kamzhik, bëri sikur foli, por nuk bëri asnjë pohim. Në të njëqind librat e treguara prej tij rezulton se ai ishte njëri nga pasuesit e Sâdikut. Gjithashtu, për të ka shumë botime dhe është prej atyre që i merrnin njoftimet vetëm nga përcjellës të besueshëm. Grupi është në një mendim të përbashkët për të pranuar ata që i kanë shkruar atij. Vetë ai ka qenë pjesëtar i grupit, që kanë ndarë një mendim të përbashkët për të verifikuar saktësinë e atyre njoftimeve vërtet të sakta. Të dy grupet kanë një mendim të përbashkët se ai është nga të besueshmit, ashtu siç kanë një mendim të përbashkët edhe për gradën e tij të lartë. Thuhet se korrespondentët e tij i pranuan, pasi ditën e arrestimit ai i propozoi librat e veta, të cilat u prishën. Pastaj nga këto libra ai ka komentuar vetëm ato që ka mbajtur mend. Është normale që përcjellësi të harrojë, edhe pse e ka ditur përmendësh tregimin. Vdiq në vitin 217.

<sup>2</sup> Është i medh'hebit medenij, i pari i katër medh'hebeve. Është prej atyre që kanë mësuar prej Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!), ashtu siç do të shpjegohet në kapitullin "Pasuesit e Sâdikut". Ky është medh'hebi i banorëve të Hixhazit dhe e ka origjinën në medh'hebin mâlikij.

*kam qenë në Haxh së bashku me të dhe kishim veshur ihramin dhe ai hipi mbi kafshën e tij. Sa herë që donte të këndonte “Telbijen”, i ngecte zëri në fyt dhe gati sa nuk po rrëzohej nga kafsha. Atëherë unë i thashë: “O bir i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) mjaft, mos e thuaj.”*

*Por ai më tha: “O bir i Àmirit, si mund të kem guxim e të mos them: “Tu përgjigja thirrjes Tënde, o Zoti im, iu përgjigja thirrjes Tënde!”, në një kohë që unë kam shumë frikë se All’llahu i Lartësuar mund të thotë: “Nuk ka as “Iu përgjigja thirrjes” e as “Tu bëfsha kurban.”*

*Ibn Shehràshùbi,<sup>1</sup> në librin e tij “Fi Menàkibi Ahuàli-s’Sàdik alejhi-s’selàm”, përsëri prej Màlik ibn Enesit, transmeton fjalën e tij: “Asnjë sy nuk ka parë, asnjë vesh nuk ka dëgjuar, asnjë zemër nuk ka ndier njeri më të mirë se Xha’fer Sadiku në virtyt, në adhurim, në dituri e në ruajtjen nga mëkatet.” Kurse Saduku ka shtuar në librin e tij “Emàlij”, f. 81: “Për All’llah, ai, kur fliste, thoshte të vërtetën.”*

*Edhe Ebul-Kàsım El-Bugàr, në “Musnedin” e tij ka përmendur Ebù Hanifen<sup>2</sup>, për të cilin Hasan ibn Zijadi ka*

---

<sup>1</sup> Muhammed Ali El Mâzenderànij Rashidudin; është nga dijetarët dhe juristët e medh’hebit. Ka qenë poet i talentuar dhe shumë krijues. Ka shkruar disa vëllime, ndër të cilat: “Meàlimul Ulemài”, librin “Trungu gjenealogjik i familjes së Ebù Tàlibit” dhe librin “Meritat e familjes së Ebù Talibit” dhe ky është libri për të cilin kemi treguar më parë. Shumë nga tregimet i kemi marrë nga ky libër.

<sup>2</sup> En’Nu’màn ibn Thàbit, themeluesi i medh’hebit të dytë të Ehli Sunnetit. Gjithashtu, është prej atyre që kanë marrë mësim prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Origjina e tij është në fisin Hanifeh, por për këtë do të flitet kur të trajtojmë pasuesit dhe shokët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!).

*thënë: “Kam dëgjuar Ebù Hanifen kur u pyet: “Kush është burri më i ditur në fushën e jurisprudencës që ke parë ti?”*

*Ai tha: “Xha’fer ibn Muhammedin dhe kur në pushtet erdhi Mensùri, më thirri e më tha: “O Ebù Hanife, njerëzit kanë shpifur për Xha’fer ibn Muhammedin, prandaj ti përgatit për të nga ato çështjet e tua të forta.” Unë përgatita dyzet çështje. Më pas Ebù Xha’feri më ftoi të shkoj në Hire, ku ai ndodhej. Vajta te ai, përshëndeta me “Selam” dhe shërbyesi më futi në kuvend dhe, pasi më ftoi të zija vend, tha: “O Ebù Abdil-lah, ky është Ebù Hanifeh.”*

*“Po - u përgjigj - e njoh.”*

*U kthye nga unë e më tha: “Përmendja Ebi Abdullahut disa nga ato çështjet e tua.” dhe unë ashtu veprova. Ndërkaq, ai menjëherë më kthente përgjigje dhe shtonte: “Ju thoni kështu, dijetarët e Medines thonë ashtu, ne nga ana jonë themi tjetër gjë; nganjëherë ndjekim atë që thoni ju, herë tjetër ndjekim ata të tjerët e herë i kundërshtojmë të gjithë.”*

*Unë vazhdova derisa erdha në çështjen e dyzetë dhe ai nuk ngeci në asnjë përgjigje. Pastaj Ebù Hanifeh tha: “A nuk është më i dituri i njerëzve, edhe pse njerëzit janë të ndryshëm?!”*

*Por edhe Mensùri, që kishte mësuar se si ta fshihte zemërimin kundër Ebi Abdil-lahit (Paqja qoftë mbi të!) në fakt, ka thënë të vërtetën, kur është përmendur emri i Ebi Abdil-lahit, ose kur e ka takuar, është shprehur: “Ky i dëshpëruar, i ekspozuar në rrethin tim, është më i dituri i njerëzve të kohës së tij.”<sup>1</sup> Në një rast tjetër ka thënë: “Ai*

---

<sup>1</sup> “Kitàbul Uesij’jeh” i Mes’ùdij’jit.

është prej atyre që dëshirojnë Ahiretin dhe jo këtë botë.”<sup>1</sup>; një herë tjetër ka thënë: “Ai nuk është prej familjes së shtëpisë së profetësisë, por ai është dijetar në fushën e hadithit dhe sot Xha’fer ibn Muhammedi është dijetari ynë në shkencën e hadithit.”<sup>2</sup>

Duke iu drejtuar Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) në një takim, që pati me të, tha: “Ne vazhdojmë të marrim me grushte nga uji i detit tënd, tek ti vijmë të kalojmë natën, ti bën të shikojnë të verbrit, me dritën tënde dalin në dritë edhe fjalët pa kuptim<sup>3</sup>, ne notojmë në retë e shenjtërisë tënde e mbi majën e valëve të detit tënd.”<sup>4</sup> Gjithashtu, i ka thënë portierit të tij Rebi’: “Këtyre që janë nga bijtë e Fàtimes nuk ua njeh të drsejtën vetëm një injorant që nuk ka asnjë njohuri nga ligji i fesë.”<sup>5</sup>

Ismàil ibn Ali ibn Abdil-lah ibn Abbàs thotë: “Një ditë shkova tek Xha’fer Mensùri, pashë se mjekra i ishte njomur nga lotët. Ai më tha: “Nuk po di si do të vazhdojmë me familjen tënde.”

Unë i thashë: “Si kështu, o Prijës i Besimtarëve?”

Ai përsëri foli: “Zotëria i tyre, dijetari i tyre dhe ai që kishte mbetur prej të mirëve të tyre vdiq.”

E pyeta: “Cili është ky?”

<sup>1</sup> Heqja e ankthit, nga libri “Tedhkireh” e Ibn Hamdùnit, vëll. 1, f. 209.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli “Lindja e tij (Paqja qoftë mbi të!) vëll. 1, f. 475; “Besàiru Derexhât”; “El Menàkib”; “El Kharàixhu uelxheràihu”.

<sup>3</sup> Nata e errët, ka të ngjarë të jetë sinonim i punëve të dyshimta, të cilave njerëzit nuk ua gjejnë fillin e zgjidhjes.

<sup>4</sup> “Bihàrul Anuàr”, në lidhje me gjendjet e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) vëll. 47, f. 199.

<sup>5</sup> Mehxhu Da’uàt” e Ibn Tàùsit, f. 192 dhe “Bihàrul Anuàr”, vëll. 47, f. 199.

*Ai më tha: “Xha’fer ibn Muhammedi.”*

*Atëherë unë shtova: “All’llahu i dhëntë shpërblimin më të madh Prijësit të Besimtarëve e i zgjattë kohën e qëndrimit për të mirën tonë!”*

*Por ai më tha: “Me të vërtetë, Xha’feri ishte prej atyre, për të cilin All’llahu ka thënë: . “Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të. Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.” (Sure “Fâtir”, ajeti 32) dhe ai ishte prej të zgjedhurve të All’llahut dhe kreu i njerëzve punëmirë.”<sup>1</sup>*

*Ja, ky është Mensùri, armiku më i betuar i Sàdikut, i cili u mundua shumë të arrinte respektin e tij dhe ta zhdukte atë.*

*Edhe ateistët, me gjithë mohimin dhe armiqësinë e tyre ndaj Islamit dhe kolosëve të tij, kanë pohuar dituritë e tij të shumta e karakteristikat e cilësive të tij shpirtërore. Gjithashtu, ata kanë njohur edhe fuqinë e shenjtërisë së tij, siç ka qenë p.sh. Ibn Mukaffa’, Ibn Ebi ‘Auxhà’, Ed’Disàniju e të tjerë.*

*Ibn Mukaffa’ thotë: “A i shikoni këta njerëz?” - dhe bëri me shenjë nga vendi ku bëhet Tauàfi. “Vetëm njëri prej tyre e ka hak të quhet njeri dhe është ai plaku që është ulur atje.”, aludonte për Sàdikun.*

---

<sup>1</sup>“Tàrikhul Ja’kùbij”, vëll. 3, f. 117.

*Ibn Ebi'Auxhà ka thënë: "Ky nuk është thjesht njeri. Nëse në këtë botë ka qenie shpirtërore, që trupëzohet kur të dëshirojë dhe të bëhet shpirt i padukshëm kur të dojë, është pikërisht ky.", duke aluduar për Sàdikun.<sup>1</sup>*

*Ibn Ebi 'Auxhà, kur pyeste për ndonjë çështje ndonjërin prej pasuesve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) , i pyeturi i kërkonte pak kohë dhe pastaj i vinte me përgjigjen, të cilën ai e miratonte dhe thoshte: "Kjo është marrë prej Hixhàzit."*

*Kështu sillej edhe Ed'Disàniyu me pasuesit e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), pasi edhe thoshte të njëjtat fjalë, kur ata i sillnin përgjigjen e pyetjes së tij.*

*Këto që u thanë ishin vetëm një pikë uji nga ai shi i rrëmbyeshëm i fjalëve të njerëzve të virtytshëm, me të cilat ata janë shprehur për autoritetin dhe pozitën e lartë të Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), pavarësisht nga koha kur ata janë shprehur, pavarësisht nga vendi ku kanë folur dhe pavarësisht nga etika e nga mendimi i tyre. Të gjitha këto thënie unë i parashtrova para hyrjes në hollësitë e jetës së tij, me qëllim që të vë në dorën e lexuesit një përshtkrim përgjithësues për këtë personalitet kaq të shquar. Megjithëse këto fjalë janë tepër koncize, përsëri lexuesi do të mësojë ç'virtyte e ç'mirësi kishte Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!); gjithashtu, do të mësojë se ç'vepra e ç'gjurmë ka lënë.*

\* \* \*

---

<sup>1</sup> "El-Kâfij", libri i Teuhijdit, kapitulli: "Krijimi i gjithësisë dhe vërtetimi i Krijuesit", vëll. 1, f. 74.



## **RUAJTJA, MASKIMI**

**(tekijeh)**

### **Parashtrim**

*Ishte në caktimin dhe në vendimin e All'llahut që Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), ndër të gjithë imamët e tjerë, të ishte bashkëkohës i dy dinastive, të emevive e të abasive, dy dinastitë që luftuan ligjin e fesë dhe kumtuesin e kësaj feje, duke ndjekur rrugën e plotësimit të epsheve, të përhapjes së ngatërresave dhe shijimit të kënaqësisë në veprime të ndaluara.*

*Nuk mund të ndodhte ndryshe në këtë mjedis tamtamesh e valltarësh, mbushur me mëkate e krime, veçse të dilnin edhe autorët e sajësive e të medh'hebeve, të mendimeve e shtytësve të plotësimit të dëshirave, të cilët ngritën kurthet e tyre të gjahut për të përfituar emër e famë në një kohë që mungonte kërkuesi i llogarisë dhe ndëshkuesi. Ishte koha kur nuk kishte as ndalues nga punët e liga e as urdhërues për punë të mira, pasi vetë shteti ishte mbartës i të gjitha llojeve të kontradiktave e konflikteve, që synonin vetëm dobësimin e medh'hebit të Ehli Bejtit dhe pakësimin e përkrahësve të tij.*

*Ebù Abdil'lah Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ishte dëshmues i kësaj beteje që zhvillohej ndërmjet fesë e dy qeverive, ndërmjet të vërtetës e mbartësve të sajësive.*

*Si mendon ti, për qëndrimin që duhej të merrte ai në atë mjedis të trazuar, që e rrethonte nga të gjitha anët? T'i*

*shpallte luftë pushtetit, kur ai i njihte njerëzit dhe dobësinë e tyre ndaj së vërtetës?!*

*Sa e sa tradhti kishte parë e dëgjuar ai ndaj përkrahësve të Aliut (alevitëve) apo pabesi ndaj hashimitëve. E gjithë kjo nuk do ta shqetësonte atë aspak sikur me të vërtetë ta çonte drejt qëllimit të tij, ashtu siç veproi edhe Husejni (Paqja qoftë mbi të!). Në pikëpamjen e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) jeta e tij nuk ishte më e shtrenjtë për të se sa feja, por ai e dinte mirë dhe e kishte të qartë së ngritja kundër pushtetit do të çonte në asgjësimin e më të çmuarës në jetën e tij, pa i sjellë fesë asnjë dobi apo të sillte për të ndonjë pasuri, ose duhej të heshtte para kësaj lufte, për të cilën ai kishte përgjegjësinë më të madhe para All'llahut e para kumtuesit të ligjit të fesë. Prandaj ishte e domosdoshme, që në këtë gjendje ai të gjente një rrugëdalje për të shpëtuar fenë nga kjo betejë, njëkohësisht të shpëtonte veten dhe ajkën e burrave nga kthetrat e atyre bishave gjakatare.*

*Politika e tij, në realizimin e kësaj rruge, ishte përhapja e diturisë, njohurive, rrënjësja e dispozitave të ligjit të fesë, veprimi me urtësi, sa më shumë virtyte e cilësi të lavdëruara dhe frenimi i veprimeve të gabuara me argumente. Të gjitha këto nën hijen e tekijes (ruajtjes), të cilën ai e kishte marrë si pritë e mburojë për të zbatuar politikën e tij të urtë. Mësimet e tij i shërbenin ligjit të fesë, adhurimet e tij për njerëzit ishin direktivë për punë të mira, argumentimet e tij ishin kundërvënie ndaj sajesave (bidateve). Ai luftoi për të gjitha këto derisa i erdhi ora të linte këtë botë.*

*Tani është bërë e detyrueshme të flasim për tekijjen (ruajtjen), emërtimi i këtij kapitulli të veçantë.*

#### *Argumenti për tekijjen (ruajtjen)*

*Fjala “tekijeh” vjen nga fjala “uikàjeh”, që do të thotë: masë mbrojtëse, masë ruajtjeje, profilaksi. Pra, “tekijeh” është një perde që vihet para elementëve frikësues e para rreziqeve, kur mendon se vihen në rrezik gjërat më të çmuara, siç është jeta, etj.*

*Argument për tekijjen (ruajtjen) janë: Kur’ani, Sunneti, mendja (‘akl) dhe fjala e përbashkët e dijetarëve (ixhma’) tek shi’at. Si argument nga Kur’ani, mjafton të sjellim vetëm fjalën e të Lartit: “Besimtarët të mos i marrin për miq e mbrojtës mohuesit, në vend të besimtarëve. Ata që veprojnë kështu, nuk kanë çfarë të shpresojnë tek All’llahu, vetëm nëse këtë e bëjnë (me gojë e jo me zemër) për t’u ruajtur nga ata. All’llahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij, sepse të gjithë do të ktheheni tek All’llahu.” (Sure “Àl ‘Imràn”, ajeti 28)*

*Siç shihet, All’llahu i lejon besimtarët që të tregojnë miqësi ndaj mohuesve, me qëllim që të ruhen kur kanë frikë nga e keqja e tyre. Ka edhe ajete të tjera që flasin për këtë çështje. Disa nga ato do t’i shohim në vijim.*

*Argumenti nga Sun’neti: Prej transmetuesve të Ehli Bejtit dhe të tjerëve janë përcjellë shumë hadithe, sa nuk numërohen. Por në kuadrin e këtij studimi, do të sjellim një pjesë nga ato dhe mendojmë se është e mjaftueshme, që nga Sunneti të sillen hadithe që janë transmetuar nga të dy grupet (sunnitët dhe shi’itët), siç është hadithi që tregon ngjarjen e Ammàrit, të cilin e ka justifikuar vetë All’llahu i*

*Lartësuar në Librin e tij Famëlartë me fjalën e Tij: "...me përjashtim të atij që dhunohet e që zemra e tij është e mbushur me besim..." (Sure "En'Nahl", ajeti 106)*

*Përsa i përket të gjithë shi'ave, në lidhje me ligjshmërinë, madje me detyrën për të praktikuar tekijjen (ruajtjen), nuk ka asnjë diskutim. Le të përmendim burimet e shi'ave, ku do të shohim se problemi i praktikimit të tekijjes (ruajtjes), tek Ehli Bejti e tek pasuesit e tyre, ishte domosdoshmëri. Për këtë çështje të dy grupet nuk kanë mendime ndryshe.*

*Në lidhje me argumentin e mendjes, është nga karakteristikat e larta të mendjes që gjykon se është detyrë të ruhet gjëja më e shtrenjtë, jeta, dhe ajo të ruhet me ato mjete e rrugë, që njeriu ka mundësi. Gjithashtu, gjykimi i mendjes e ndalon që vetja të vihet në rrezik, për më tepër, ekspozimin e vetes para rrezikut e ndalon edhe Libri i All'llahut: "Shpenzoheni pasurinë në rrugën e All'llahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; All'llahu me të vërtetë i do bamirësit." (Sure "El-Bekare", ajeti 195)*

*Gjithashtu, i Larti thotë: "... dhe mos e vritni veten (as njëri-tjetrin); me të vërtetë All'llahu është Mëshirëplotë për ju." (Sure "En'Nisà", ajeti 29)*

*Biografia e njerëzve të mençur është në përputhje me këtë gjykim të mendjes, pasi vetë instinkti i njeriut vepron në çast për t'u ruajtur. Nëse ke të bësh me njerëz, të cilët kanë kundërshtime me ty për çështje të medh'hebit, ose për parime politike dhe ti ke frikë prej tyre nëse ata e marrin vesh medh'hebin apo parimin që ti ke, patjetër do të gjesh se ruajtja është domosdoshmëri që duhet ta*

*praktikosh. Edhe Profeti -Paqja e All'lahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!-, në fillimet e thirrjes, e mbajti të fshehur misionin e tij, kurse thirrjen haptazi e filloi pasi më parë i bëri thirrje fisit të Hashimit dhe vetëm atëherë kur e urdhëroi All'llahu i Lartësuar, që misionin e tij ta kumtonte haptazi: "Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar dhe largohu nga idhujtarët." (Sure "El-Hixhr", ajeti 94)*

*Edhe myslimanët e kanë mbajtur të fshehur se janë myslimanë para se Islami të forcohej e të përhapej, madje edhe Ebù Tàlibi e mbajti të fshehur se ka pranuar Islamin, me qëllim që të kishte mundësi të mbronte të Dërguarin (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) njëkohësisht, që të largonte nga vetja akuzat që i bëheshin, për shkak të mbrojtjes që i jepte atij.*

*Po si u kthye puna kokëposhtë, atëherë kur minaretë e Islamit ngriheshin lart dhe kur mohuesit në Mekkë e në Medine hiqeshin si myslimanë dhe në brendësi kishin mohimin?!*

*Fillimi i tekijes (ruajtjes) dhe arsyet e saj*

*Tekijeh (ruajtja), nga ana shi'ave, nuk ka filluar në kohën e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), por ajo ka qenë që në kohën e Prijësit të Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!), i cili e ka përdorur tekijjen (ruajtjen) edhe për veten e tij gjatë pjesës më të madhe të jetës së vet. Me siguri e di se, me fillimin e hilafetit, ai mendonte se hilafeti i takonte atij, po kështu mendonte edhe një pjesë e njerëzve. Por kur ai nuk gjeti mbështetës e përkrahës, u qetësua dhe heshti së bashku me përkrahësit e tij. Nëse do të kishte gjetur të paktën dyzet burra të vendosur, patjetër që të gjithë*

*njerëzit do të ishin ngritur, ashtu siç është shprehur vetë, pasi edhe ata, që e kundërshtonin, do ta merrnin vesh se ai kishte autoritet te njerëzit, prandaj më pas, ata donin që ai të jepte besën në këshill (shùrà) se do të ndiqte rrugën e të parëve. Por ai nuk pranoi rrugë tjetër përveç asaj të Librit të All'lahut e Sunnetit të të Dërguarit të Tij.*

*Ai heshte për shumë nga gjërat e çuditshme që shihte dhe që atëherë filloi të ruhej. Madje ai e ka praktikuar tekijjen (ruajtjen) edhe kur pushteti ishte në dorën e tij, sepse ai e dinte se midis njerëzve kishte nga ata që e kundërshtonin e i kundërviheshin. Sikur të kishte lejuar të gjitha gjërat që ishin tek ai, nuk do të ishte i sigurt se njerëzit nuk do t'i kundërviheshin. Një grup kishte thyer besën, një tjetër tregonte ashpërsi, të tjerë izololeshin e mënjanoleshin. Nëse ai do të ishte shprehur haptazi për të gjitha sa dinte e sa shihte, me siguri që prej tij do të ishin shkëputur pjesët e trupit.*

*Edhe pse në Kufe, shumica ishin nga përkrahësit e pasuesit e tij dhe ajo ishte kryeqyteti i mbretërimit të tij, ai nuk mundi të ndryshonte gjithçka që ishte trashëguar prej kohës së mëparshme. Gjithashtu, ai nuk mund të lejonte në Kufe të gjitha sa dinte, për shkak se ato do të ishin në gjendje t'i mbanin fare pak njerëz, kurse të tjerët e kishin krejtësisht të pamundur për ta mbajtur. Kështu veproi ai që kishte në dorë të dy pushtetet: pushtetin shpirtëror dhe pushtetin e kohës. Vallë, si do të ishte ai kur të ndodhej i veçuar e i izoluar?! Si do të vepronin djemtë e tij përballë dhunës e forcës që ushtrohej mbi ta?!*

*Ata e praktikuan tekijjen (ruajtjen) vetëm atëherë kur mësuan "fajet e rënda", që do hidheshin mbi ta e mbi*

*përkrahësit e tyre nëse do të dilnin hapur. Në fakt, vetë Prijësi i Besimtarëve e ka urdhëruar tekijjen (ruajtjen) para dy djemve të tij dhe, sipas transmetimit të Tabrasijut,<sup>1</sup> në disa nga librat e tij “El Ihtixhâxhât” (“Paraqitja e argumenteve”) ka thënë: “Ju urdhëroj që në fenë tuaj të praktikoni tekijjen (ruajtjen). Me këtë do të ruani të gjithë ata që njihen si përkrahës dhe vëllezërit tanë, sepse kështu është shumë më mirë se të ekspozoheni para shkatërrimit të plotë. Me tekijjen (ruajtjen) ka kohë për të kryer punë për fenë dhe për të përmirësuar gjendjen e vëllezërve tuaj besimtarë, por kujdes dhe shumë kujdes të mos e braktisni tekijjen (ruajtjen), për të cilën ju urdhërova, sepse është i shtrenjtë gjaku juaj e gjaku i vëllezërve tuaj. Mos e vini veten dhe ata para zhdukjes, që t’i poshtëroni në duart e armiqve të fesë, kur All’llahu ju ka urdhëruar që t’i lartësoni ata. Nëse do të kundërshtoni porosinë time, dëmi, që do të shkaktoni, do të bjerë mbi vëllezërit tuaj e mbi ju shumë më i rëndë nga dëmi që është shkruar të keni prej mohuesit.”*

*Vështro si e urdhëron Prijësi i Besimtarëve mikun e vet, që t’i përmbahet tekijjes (ruajtjes), duke i bërë të qartë dobitë që vijnë nga ajo, si dhe dëmi që vjen nga kundërshtimi i saj.*

*Medh’hebi shi’it dhe grupi (shi’at) dolën që në kohën e Prijësit të Besimtarëve, sepse pushteti ishte në dorën e tij, madje në dorën e tij ishte edhe e ardhmja e këtij pushteti. Por, kur këtë fakt e mësuan armiqtë e tyre në të*

---

<sup>1</sup> Ahmed ibn Ali Ebi Tâlib, është nga dijetarët e mëdhenj të grupit dhe libri i tij “El’Ihtixhâxh”, është libër me dobi të shumta e të larta.

*gjitha qytetet e krahinat, a të shkon ndërmend se si do të vepronin ata për të gërryer pushtetin e tij?*

*Muàvija i luftoi ata me të gjitha mjetet që pati në dorë: me lëvizje, forcë, kurthe e mashtrime. Ndër këto mjete ishin edhe sharjet në adresë të Ebù Hasanit (Aliut) e të çështjes së tij. Ai i hidhte ato sharje, me qëllim që të dyshonte i vogli e të ngrihej kundër tij i madhi, ashtu siç shprehej ai vetë. Në këtë vazhdë u bë luftë e madhe për t'i poshtëruar ata. Pastaj erdhi vrasja e burrave të tyre të dëgjuar, shumica e të cilëve gjendeshin në Kufe. Gjithashtu, Muàvija angazhoi kundër tyre Zijàdin dhe futi nën sundimin e vet Basran, megjithëse i njihnte shumë mirë ata. El-Medàinij thotë: "Ai i vrau ata nën çdo gur e në çdo pellg, por edhe kishte frikë prej tyre. Ai preu duar e këmbë, nxori sy dhe i kryqëzoi ata në trungjet e hurmave, i ndoqi e internoi ata nga Iraku, derisa prej tyre nuk mbeti ndonjë që të kishte emër."<sup>1</sup>*

*Kishte prej atyre që nuk kishin mundësi të largoheshin, për shkak se njiheshin se cilët ishin. Edhe ata që u larguan, i kapën ata që ishin vënë në kërkim të tyre. Fundi i tyre ishte vdekja nën tehun e shpatës, siç i ndodhi Hixhr ibn Adiut e pasuesve të tij apo Amr ibn El-Hamkut e të ngjashmëve me të.*

*El-Aberij, në "Historinë" e tij, f. 87, thotë: "Muàvija gjithmonë i bënte sytë katër, që të vriste shi'at kudo që t'i pikaste."*

*Imam Bàkiri (Paqja e shpëtimi qoftë mbi të!), duke përmendur pësimet që ranë mbi ta (pasardhësit e Aliut) e*

---

<sup>1</sup> "Sherhu-n'Nehxh", vëll. 3, f. 15.



*mbi pasuesit e tyre, thotë: “Më të rëndat e më të mëdhatë kanë qenë në kohën e Muàvijes, pas vdekjes së imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!). Përkrahësit tanë u vranë në çdo qytet, u prenë duar e këmbë. Kushdo që na përmendte ne me dashamirësi ose shoqërohej me ne, burgosej, i grabitej pasuria dhe i shembej shtëpia.”<sup>1</sup>*

*Muàvija e kishte frikë imam Hasanin (Paqja qoftë mbi të!), sepse njerëzit rrinin në pritje, që ai të ngrihej. Muàvija bëri paqe me të vetëm me kushte, ndër të cilat ishte që hilafeti t'i jepej atij pas vdekjes së imam Hasanit. Pastaj ai e shpejtoi vdekjen e imam Hasanit me helm. Ndërkaq, njerëzit i kishin hedhur sytë tek Ebù Muhammedi, i cili, sa që gjallë, bashkë me rrethin e tij të ngushtë, kanë qenë vazhdimisht nën terror. Të tilla ishin punët e Muàvijes. Mos pyet se ç'bëri ai me shi'at, pas vdekjes së imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!).*

*Kur pushteti ra në dorë të Jezidit e të djalit të Zijadit, që të dy ishin më të paskrupullt se Muàvija e Zijadi në vrasjet haptazi e në pabesitë dhe qenë më të guximshëm se ata të dy në derdhjen e gjakut. Djali i Zijadit vrau Muslimin, Hànin, Reshidin, El Hixhriun, Mejtheme Et'Temmàrin, madje vrau edhe një vajzë nga të shi'ave. Ai mbushi qelitë e burgjeve me parinë e shi'ave, aq sa të burgosurit arrinin në 12000 vetë dhe më pas ndodhi edhe ngjarja e Taffit.*

*Nuk ishin harruar as trekëmbëshat e varjes e as gjymtimet, derisa erdhi radha e gjakderdhjeve që kreu Haxhàxhi. Për këtë le t'ia lëmë fjalën immit tonë Bàkirit*

---

<sup>1</sup> “Sherhu-n'Nehxh”, vëll. 3, f. 15.

*(Paqja qoftë mbi të!) , që të na flasë për punën e Haxhàxhit, ashtu siç e ka parë ai vetë dhe imami tregon: “Pastaj erdhi Haxhàxhi, i cili i vrau ata – d.m.th. shi’at. Për çdo vrasje, dënim e akuzë, në këtë kohë burri do të dëshironte që më mirë t’i vinin etiketën ateist ose mohues, se sa t’i thoshin se ti je nga pasuesit (shi’at) e Aliut (Paqja qoftë mbi të!).”<sup>1</sup>*

*E tillë ishte këmbëngulja e emevitëve kundër pasardhësve të Aliut (alevitëve) dhe pasuesve të tyre (shi’ave). Një pjesë të këtyre ngjarjeve ti i mësove më përpara.*

*Nëse do të vazhdohej me njoftimet e kohës së abasive, do të mësoje se shteti i abasive eci nën shembullin e emevive në ndjekjen e vijës së ashpër ndaj pasardhësve të Aliut e të pasuesve të tyre. Deri tani kemi folur për emevitë e abasitë dhe për dhunën e ashpër që ata kanë ushtruar mbi Ehli Bejtin, si dhe për armiqësinë e urrejtjen që kanë treguar ndaj tyre.*

*Vallë, pas gjithë këtyre dhunimeve e pas gjithë këtyre vështirësive të mëdha, a do të ishte e mundur për Ehli Bejtin e për pasuesit e tyre të ngrinin zërin për punët e fesë, atyre punëve që pushteti u kundërvihej në parime, në besim, në rrugën e ndjekur nga feja dhe në veprime?*

*Peshoje me ndërgjegjen tënde, ti që ke marrë përsipër të jesh vëzhgues i paanshëm: Sikur ti dhe pasuesit e tu të kalonit sprova e ndodhi të hidhura, duke e vënë veten se je prijës e përgjegjës, a do t’i nxisje pasuesit e tu të flisnin haptazi, që pastaj të bëheshin pre e kasaphanës së armiqve dhe objektivi i atyre që ishin të gatshëm të dënonin apo do t’i urdhëroje të mbyllnin gojën, të*

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm.

*fshiheshin e të largoheshin nga vrasjet dhe nga dhembjet e ndëshkimeve e të prangave?*

*Dihet që familja profetike është njëra nga dy shtyllat ku ruhet feja dhe se ata janë mbajtësit e sekreteve. Nëse ata do të asgjësoheshin nga i pari deri tek i fundit në rrëmujën e luftërave, vallë a do të mbetej më këmbë nga feja ndonjë fanar ndriçues ose ndonjë hije, ku të preheshin njerëzit?*

*Për të gjitha këto që thamë, nuk mbetet asnjë arsyetim që të justifikojë largimin nga tekijeh (ruajtja) kur ti e dëshiron familjen profetike (el-itreh) si vazhduese të Kur'ânit, që të të mësojë çka në të, derisa bashkërisht të takoheni tek burimi (haud) me të Dërguarin e All'llahut - Paqja e All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!. Ata duan të zbardhin e të nxjerrin në dritë dhunën e padrejtësitë e bëra nga sundimtarët apo kur duan të shpjegojnë se si kanë vepruar vënësit e sajësive në fe, për ta veshur fenë me gjëra të gabuara e me injorancë.*

*Këto janë arsyet, që e shtynë Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) të deklarojë: "Tekijja (ruajtja) është feja ime dhe feja e prindërve të mi, kurse për atë, që nuk ka fe, nuk ka as tekijje (ruajtje), sepse ai, që përhap çështjen tonë, është si luftëtari në rrugën e saj."*

*Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë një grupi të pasuesve të tij, me të cilët po bisedonte: "Mos e përhapni punën tonë e mos flisni për të, me përjashtim të atyre që janë me ne, sepse ai, që përhap sekretet tona kundër nesh,*

*është ndihmësi më i madh i armikut tonë. Tani largohuni, All'llahu ju mëshiroftë dhe mos e përhapni sekretin tonë!*<sup>1</sup>

*Frymëmarrja e atij që shqetësohet për padrejtësitë që janë bërë mbi ne, është tesbih (falënderim i All'llahut me veneracion), shqetësimi i tij për ne është adhurim dhe mbajtja fshehur e sekretit tonë është luftë në rrugën e All'llahut.*<sup>2</sup>

*Ai (Paqja qoftë mbi të!) i thotë Mudrik ibn El-Hez'hezit<sup>3</sup>: "O Mudrik, çështja jonë nuk është që vetëm ta pranosh atë, por ta ruash e ta mbash të fshehur nga ata që nuk janë tanët. Bëju të fala shokëve tanë dhe përshëndeti me "Selâm". Uroju atyre mëshirën e All'llahut dhe begatitë e Tij dhe u thuaj: "E mëshiroftë All'llahu atë që ndjell dashurinë e njerëzve ndaj nesh dhe që u flet atyre të bëjnë ato punë që ata i dinë të mira e të ndalojnë çdo punë që ata e dinë të ligë e të dëmshme."*<sup>4</sup>

*Ata vazhdimisht u kanë lënë këto porosi pasuesve të vet, madje edhe Xhàbir El-Xhu'fij, që është nga përcjellësit e besueshëm e të sigurt të njoftimeve të Bàkirit e të Sàdikut (Paqja qoftë mbi të dy!) thotë: "Kam përcjellë 15000 hadithe, por askush nuk i ka dëgjuar ato prej meje. Është thënë se janë 70000, ashtu siç është thënë se janë 90000 vetëm prej Bàkirit dhe për to asnjë njeri nuk ka thënë ndonjë fjalë."*<sup>5</sup>

*Për këto shkaqe, Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Mual'la ibn Khanijsit: "Mos jini robër lufte në duart e njerëzve me hadithin tonë. Nëse ata duan, ju besojnë e*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 74 dhe f. 42.

<sup>2</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 64 dhe f. 1.

<sup>3</sup> Ose Ibn Ebi El Hez'hàz En'Nekha'ij El Kufij, ka përcjellë prej Sàdikut, por edhe për të kanë përcjellë transmetues të besueshëm.

<sup>4</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 77 dhe f. 62.

<sup>5</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 69 dhe f. 21-22.

*nëse duan, ju vrasin. Gjithashtu, thoshte: “Mual’la u vra vetëm se përhap hadithin tonë .”<sup>1</sup>*

*Prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) janë transmetuar shumë hadithe për mospranimin e atij që ka përhapur sekretin e tyre ose ai e ka bërë hadithin e tyre objekt bisede. Për këtë ai ka thënë: “Ai që përhap sekretin e tyre është si vrasësi i tyre me qëllim, prandaj ai nuk ka pjesë.”<sup>2</sup>*

*Këto hadithe dhe të tjera të ngjashme zbulojnë para teje çështjen e tyre për tekijjen (ruajtjen) dhe del sikur ata e dinin se njerëzit shumë shpejt do t’i vinin shi’at në shënjestër për tekijjen (ruajtjen). Prandaj edhe shi’at, nga ana e tyre, e kanë bërë tekijjen (ruajtjen) detyrim të përhershëm.*

#### *Efekti i tekijjes (ruajtjes) në shërbim të fesë*

*Në të vërtetë, efekti i tekijjes (ruajtjes) në shërbim të fesë e të shoqërisë shi’ite akoma mbetet i panjohur, sepse shi’at në Kufe, gjatë kohës së Zijàdit, u dobësuan shumë. Në fakt, nga shi’at nuk mbeti ndonjë gjë që të njihej. Për më tepër, gjatë kohës së Haxhàxhit gjendja arriti deri aty sa burri do të dëshironte më shumë të quhej ateist e mohues se sa t’i thuhej se je nga pasuesit e Aliut. Por nuk kaloi shumë kohë pas acarimit të gjendjes, që shi’at të fillonin mënjanimin nga njerëzit dhe të ndiqnin politikën e maskimit të tyre prapa perdes së tekijjes (ruajtjes), pasi vetëm kështu u bë e mundur, që edhe transmetuesit e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) të arrinin në më shumë se 4000 vetë, sipas numërimit që i kanë bërë atyre Ibn ‘Ukdeh, shejhu Et’Tùsij në librin “Kitàbu Rixhàl”,*

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 21, f. 71 dhe f. 34.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 2, f. 74 dhe f. 45.

*Et'Tabrasiju në librin "A'làmul Uerà", si dhe dijetari El Hil'lij në librin "El Mu'teber". Duhet theksuar se shumica e tyre ishin nga banorët e Kufes dhe vetë Hasan ibn Ali El Ueshà<sup>1</sup> thoshte: "Sikur ta dija se ky hadith do të kishte këtë kërkesë, patjetër që do vilja më shumë, pasi unë kam arritur të njoh në këtë xhami – d.m.th. në xhaminë e Kufes – 900 shejhë. Çdonjëri prej tyre thoshte: "Mua më ka folur Xha'fer ibn Muhammedi (Paqja qoftë mbi të!) kurse vetë El Ueshà ka arritur nga kjo shtresë vetëm pak prej tyre."*

*Tani e mësove sekretin përse ka kaq shumë transmetime prej imam Sádikut (Paqja qoftë mbi të!). Përse ai u bë vendburimi i diturive, i njohjeve, i dispozitave dhe i gjykimit? Përse u bë medh'heb për shi'at?*

*Përse kanë transmetuar për të deri edhe vetë imamët e ummetit e kolosët e tyre, si: Màliku, Ebù Hanifeh, dy Sufjanët, Ejjüb Es'Sekhtejaniju, Shu'beh, Ibn Xherijh e të tjerë? E gjitha kjo ka ndodhur për faktin se ai ishte larguar e mënjauar nga shoqërimi i njerëzve, të cilët e qëllonin me akuzën se ai kërkonte kryesinë dhe hilafetin, si dhe për maskimin e tij në përhapjen e diturisë e të moraleve. Por, nëse ai nuk do të ishte mënjauar, kurrë nuk do të dilnin në dritë dituritë e virtytet e tij. Njerëzit nuk do të njiheshin me pozitën e EHLLI BEJTIT, me të vërtetën e Kur'ànit e me shkencat e fesë. Kurrë nuk do të bëhej e qartë se ç'kanë bërë krerët e të dy pushteteve, nuk do të kishin dalë shumë nga grupet e gabuara e për pasojë, dijetarët, që njihnin mirë ligjin e fesë dhe teologët, nuk do të kishin parashtruar argumente kundër. Së fundi, as numri i shi'ave*

---

<sup>1</sup> El-Bexhelijju'l-Kufij, është nga autoritetet e grupit dhe nga shokët e Rizait (Paqja qoftë mbi të!); gjithashtu, është nga transmetuesit e tij të besueshëm. Ka shkruar disa libra, ndër to edhe librin "Mesàilu Ridà". Për të kanë shkruar shumë autorë.

*nuk do të kishte arritur në 70.000.000 vetë, të shpërndarë deri në skajet më të largëta të shumë vendeve.*

*Kështu, ti u njohe edhe me efektin e tekijes (ruajtjes) në shërbim të fesë e të ligjit të fesë (sheri'atit), me sprapsjen e atyre që bëjnë thirrje për padrejtësi, për mizori e për shkuarjen në rrugën e humbjes, të informimit të njerëzve me të vërtetat e besimit dhe me pavlefshmërinë e dyshimeve e të sajësive.*

*Edhe pas këtij shpjegimi do të të jap rastin të dëgjosh me vëmendje diçka nga ato romuzet për tekijjen (ruajtjen) dhe thënien se shi'at janë nga grupet e batinijve (ezoteristë).*

*Kjo zgjatje ishte vetëm e vetëm për të ngritur atë mbulesë të zezë para të vërtetave për cilindo që pretendon se tekijja (ruajtja) i mban të panjohura veprat e mira, se ajo është një perde e dendur, prapa së cilës është e mundur të ketë një mijë të meta e një mijë mangësi. Për këtë arsye janë bërë shumë pyetje. Po përmendim disa prej tyre: Si do ta dinë njerëzit se çka ai, si do ta shohin ata bukurinë e asaj që ka në ndërgjegjen e tij? Si mendon, a është i drejtë ky qortim dhe kjo e metë, pas asaj që ne të parashtruam dhe të bëjmë të shohësh për dobitë e tekijes (ruajtjes)?*

*Kurse sot, në sajë të shtypshkronjave, dituritë e shi'ave dhe besimi i tyre janë përhapur kudo. Atëherë ku është heshtja e ku është ruajtja? Në fakt, ruajtja ishte vetëm për atë kohë, kur shi'at ishin të pakët në numër, por ishin vigjilentë. Nëse ata do të kishin rënë nën tehun e shpatës, njerëzit e familjes profetike nuk do të përmendeshin, nuk do të kishte as dituri, as argument e as transmetim. Kurse*

*sot, ata janë në lulishten e bekuar të botimit të këtyre librave, të cilat kanë mbushur lindjen e perëndimin e nuk i kanë lënë vend për justifikim asnjë shkrimtari e lexuesi që pretendon se imametë janë grup batinishë (të mbyllur nga brenda) e që fshihen me tekijën (ruajtjen), prandaj ne nuk njohim as parimet e as doktrinat e tyre, nuk njohim as bazat e as degët.*

*Librat e imamive janë në duart e njerëzve, në të gjitha fushat e dijes e të shkencës, referencat e tyre janë të lexueshme dhe kuptimet e tyre janë të shpërndara gjithandej.*





## SÀDIKU DHE SPROVAT

*Nga sprovat që ka kaluar Ehli Bejti mjafton të kujtojmë ndeshjen e ndërsjellë ndërmjet fesë e kësaj bote (dyn'jāsë). Shumë pak herë mund të jenë pajtuar në ndonjë shekull. Por, pa mendo çfarë do të kishte ndodhur sikur të mos ishte praktikuar tekijje (ruajtja) në ato goditje të rënda e të shumta që ranë mbi Ehli Bejtin?!*

*Ndeshja ndërmjet Ehli Bejtit dhe emevive e abasive nuk përbën ndonjë gjë të rrallë, përderisa Ehli Bejti është shembulli i ndjekjes së fesë dhe ata janë shembulli i plotësimit të qëllimeve të kësaj bote.*

*Emevitët e abasitët e dinin se imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ishte lideri i kësaj ndeshjeje, por edhe pse ai qëndronte në heshtje e nuk dilte të luftonte me ta me armë, përsëri heshtja e tij nuk ishte siguri për ta se ai nuk do t'i luftonte. Mbase vetë heshtja ishte nga mjetet e përplasjes ose edhe vetë përplasja, pasi ashtu siç thonë: "Qetësia mund të jetë përgjigje."*

*Më pas, në çdo kohë Sàdikun e gjen të jetë fushë sprovash të rënda, pasi ata nuk i quanin të mjaftueshme as poshtërimet që i bënin dhe as faktin se qëndronte i mënjanuar e merrej vetëm me adhurim e me dituri. Edhe në këtë gjendje, ata e shikonin si armë lufte, sepse personi i Sàdikut paraqiste pamjen e jashtme të fesë, prandaj mbi të ishin drejtuar shikimet e njerëzve; sa herë që lartësohej pozita e imam Sàdikut, feja forcohej dhe kur forcohej feja, admiruesit e kënaqësive të kësaj bote zhyteshin akoma më*

*shumë e më me vrull në plotësimin e kënaqësive të kësaj bote.*

*Sikur emevitët të ishin të qetë nga ngatërresat e shpifjet ndërmjet tyre, ata kurrë nuk do ta kishin lënë gjallë imam Sàdikun, ashtu siç nuk lanë as të parët e tij, madje u shtynë edhe jashtë rrethit të tij të ngushtë dhe vrasjet i shtrinë deri tek djemtë më të afërm të xhaxhait të tij. Në Librin e All'lahut thuhet: "...besimtarët që kanë lidhje farefisnore, janë më të afërt me njëri-tjetrin..." (Sure "El Enfâl", ajeti 75)*

*Seffâhu sundoi vetëm katër vjet, por kjo kohë ishte e pamjaftueshme për pastrimin e terrenit nga emevitët, për të vënë themelet e mbretërimit dhe për të forcuar kolonat mbajtëse të mbretërimit. As ky shqetësim nuk e bëri atë që të hiqte dorë nga imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) sepse ai akoma nuk ndihej i sigurt prej emevive e nga fryma e përkrahjes ndaj tyre. Pa mbaruar akoma vënien e themeleve të shtetit, ai e solli Sàdikun nga Medineja në Hijreh, me qëllim që ta vriste tradhtisht, por u mjaftua vetëm duke e vënë nën ruajtje.*

*Megjithëkëtë imam Sàdiku ishte njëri nga shqetësimet e tij të shumta, megjithëse ishte djali i xhaxhait të tyre dhe njeri që merrej me adhurim, mësimdhënie e udhëzim. Për më të tepër, i kishte njoftuar se pushtetin do ta kishin ata dhe jo djemtë e Hasanit. Përsëri abasitët, nga frika e emevive, ndiheshin më ngushtë se në strofkën e zhapikut të rërës dhe më të shqetësuar se pupla në shtjellat e erës.*

*Seffâhun nuk do ta sprapste nga veprimi i përbindshëm asgjë përveç asaj që ne thamë në lidhje me ndeshjen, të cilën ai e shihte si masë mbrojtëse për të*

*ndaluar njerëzit, që të mos i drejtoheshin Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), sepse njerëzit, në fakt, e njihnin mirë pozitën e tij. Veç kësaj, në atë kohë njerëzit besonin se hilafeti ishte mbledhësi i dy pushteteve, i atij shpirtëror dhe i atij shekullar, pra, nuk e mendonin pushtet atë që nuk kishte lidhje me fenë. Prandaj njerëzit nuk largoheshin nga Sàdiku, sepse ai ishte fetar i pastër. Madje disa njerëz, pikërisht për këtë, kërkuan që ai të merrte imamatin, pasi me të ishin të sigurt në këtë botë, ashtu siç ishin të sigurt me të edhe për fenë e tyre.*

*I kapur pas kësaj mase mbrojtëse, edhe Mensùri nuk ngurroi t'i vërë prita imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), duke i shkaktuar vuajtje e mundime nga më të ndryshmet e nga më të paskrupullta. Megjithëkëtë, me paturpësi, nuk hoqi dorë nga masat shtrënguese ndaj imamit, derisa më në fund e helmoi.*

*Nuk ka asgjë për t'u çuditur në këto sprova të rënda që ranë mbi Ebù Abdil'lahin, sepse njeriu sprovohet sipas virtyteve e cilësive që ka, sipas autoritetit që gëzon ndër njerëzit dhe sipas aspiratave personale për ngjitjen në grada të larta shpirtërore.*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka jetuar dymbëdhjetë vjet nën mbretërimin e Mensùrit. Gjatë kësaj kohë nuk gjeti një ditë qetësi, edhe pse ndërmjet tyre kishte një distancë kaq të gjatë, imam Sàdiku në Hixhàz dhe Mensùri në Irak, aq sa dukej sikur Mensùri kishte hyrë në "aleancë" me Sàdikun për ta munduar e për ta poshtëruar sa më shumë e gjithnjë e me më shumë këmbëngulje, si të ishte një dashamirës, që i jep besën*

*mikut të vet të zembrës për ndihmë të menjëhershme e me dhurata të rralla.*

*Ibn Tàùs Ebul-Kàsim Ali<sup>1</sup> -Erëkëndshëm qoftë dheu ku ka rënë!-, në librin “Mehxhu-d’Da’auât”, në kapitullin “Lutjet e imam Sàdikut”, thotë: “Sa herë që Mensùri shkante për të kryer Haxhin, thërriste edhe Sàdikun. E ka thirrur plot shtatë here, pasi ai herë ndodhej në Medine e herë në Zibdeh. Disa herë i ka çuar njerëz nga Kufe, disa herë të tjera nga Bagdadi. Çdo herë e ka thirrur, me qëllim që ta vriste. Patjetër që kjo i kapërcente të gjitha fyerjet e sharjet që ai ka pësuar prej tij. Tani do t’i përmendim këto më në hollësi:*

*E para: Ibn Tàùsi transmeton sipas përcjelljes së Rebi’t, portierit të Mensùrit: “Kur Mensùri kreu Haxhin<sup>2</sup>, një natë në Medine nuk vuri gjumë në sy, më thirri e më tha: “O Rebi’, nisu që tani, fluturimthi e me hapa sa më të lehta, nëse ke mundësi nisu vetëm dhe vepro derisa të më*

<sup>1</sup> Radiju-d’din Ebul Kàsim Ali ibn Mùsà El Hasenij El-Hil-lij, është nga familja Tàùs, në personin e tij ishin mbledhur dituria, adhurimi, përkohshmëria, poezia, letërsia, thurja e vargjeve dhe retorika. Për të thuhet se ka bërë shumë vepra të larta. Gjithashtu, për të thuhet: “Ai ishte njeriu që bënte më shumë adhurim e njeriu më i përkorë i kohës së tij. Dijetari El Hilij, në disa nga dëftesat e aftësimin që ka lëshuar, rezultojnë se është prej atyre për të cilët janë bërë transmetime. Kur e përmend atë thotë: “Radijudin Aliu ishte bërës veprash të jashtëzakonshme. Për disa nga këto vepra të tij mua më ka treguar babai im, kurse disa të tjera i kam mësuar me rrugë transmetimi. Ai ishte njeriu më i përkorë i kohës së tij.”

<sup>2</sup> Gjatë kohës që ishte gjallë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) Mensùri ka bërë Haxh tre herë: në vitin 140, 144 dhe në vitin 147; kurse pas vdekjes së Sàdikut ai ka bërë Haxh dy herë: në vitin 152 dhe në vitin 158, por kësaj here nuk e plotësoi Haxhin; referohu në “Tàrikhul Jà’kùbij”, vëll. 3, f. 122, botuar në Nexhef. Ajo që bie në sy është se Mensùri, në tri herët e para, ka urdhëruar që të merrnin edhe Sàdikun - Paqja qoftë mbi të!

*sjellësh këtu Ebù Abdil'lah Xha'fer ibn Muhammedin dhe i thuaj që djali i xhaxhait tënd të çon "Selam" dhe të thotë se shtëpia edhe në rënkoftë, ashtu e ka gjendjen. Nëse ka kundërshtim, nga gjaku ne jemi më të afërm se krahu i djathtë me të majtin, jemi më të afërm sa freri që mbahet ndërmjet dy gishtave.<sup>1</sup> Ai të lutet të shkosh tek ai që tani. Nëse vjen me ty, prijti përpara dhe eja sa më shpejt, nëse nuk vjen për ndonjë pengesë apo për diçka tjetër, përsëritja urdhrin për të ardhur e nëse ai të thotë që ta mbyllësh këtë punë, mbaj qetësi, tregohu tolerues dhe mos ushtro presion, kërkoji falje, mos u trego hundëpërpjetë as në fjalë e as në veprime."*

*Rebi'u thotë: "U gjenda në portën e tij dhe e gjeta në dhomën ku qëndronte i veçuar. Hyra tek ai pa kërkuar leje dhe pashë se faqet i kishin marrë ngjyrë bardh e zi. Ishte me duar të lëshuara, si të varura nga lodhja. Në fytyrë e në duar kishte shenja dheu. Më erdhi rëndë të thosha diçka, para se ai të mbaronte namazin e lutjen e tij. Në të vërtetë, kur mbaroi, ai u kthye me fytyrë nga unë. E përshëndeta: "Es'selàmu alejke jà Ebà Abdil-làh!", -"Paqja mbi ty, o Ebu Abdil-lah!". Përshëndetjen ma ktheu me të njëjtat fjalë: "U alejke-s'selàmu jà ekhij!" -Edhe mbi ty paqe, o vëllai im!"*

*Më pyeti: "Ç'hall të ka sjellë?"*

*Atëherë i thashë: "Djali i xhaxhait tënd të bën selam." dhe vazhdova derisa e sosa fjalën. Më dëgjoi me vëmendje dhe më tha: "Ah, mor i mjeri Rebi'!" dhe lexoi: "A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu*

---

<sup>1</sup> Freri i kalit mbahet mes gishtit të mesit dhe gishtit që vjen pas tij.

*është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur.” (Sure “El-Hadid”, ajeti 16)*

*“A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve<sup>1</sup> se nuk do t’iu vijë dënimi Ynë natën, ndërkohë që flenë?! A janë të sigurt ata se nuk do t’iu vijë dënimi Ynë ditën, ndërkohë që argëtohen?! A janë të sigurt ata nga të papriturat e Allahut? Vetëm ata që janë të humbur nuk u frikësohen të papriturave të Allahut.” (Sure “El-A’râf”, ajeti 97-99)*

*Unë përshëndeta me selam edhe Prijësin e Besimtarëve (Aliun) – Mëshira e begatia e All’llahut qoftë mbi të! – pastaj, ai u kthye në namazin e tij dhe, pasi mbaroi, unë thashë: “Po pas namazit, a ka ndonjë qortim ose ndonjë përgjigje?”*

*Ai më tha: “Po, i thuaj atij: A e ke vënë re atë që shmanget (nga e vërteta) dhe jep pak e pa qejf? A i di ai vallë gjërat e padukshme, a i sheh ato? Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Shkrimet e Musait dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet: se askush nuk do t’i mbartë gjynahet e tjetrit dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar; se përpjekjet e tij do të shihen.” (Sure “En’Nexhm” 33-40)*

*Betohem në All’llah o Prijës i Besimtarëve, ne kemi frikë prej teje dhe prej frikës sonë kishin frikë edhe gratë, të cilat ti i njuh më mirë se cilat janë. Patjetër ne na duhen*

---

<sup>1</sup> Mekës dhe rrethinave të saj.

*sqarime për të.<sup>1</sup> Nëse heq dorë, atëherë e parashtrajmë emrin tënd tek All'illahu i Lartësuar çdo ditë pesë herë<sup>2</sup> dhe ti na fol ne për babain e për gjyshin tënd, sepse i Dërguari i All'illahut -Paqja e All'illahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!- ka thënë: “Katër lutje nuk kthehen pa u pranuar prej All'illahut të Lartësuar: lutja e djalit për babën e vet, lutja e vëllait për vëllanë e vet pa prezencën e tij, lutja e të sinqertit...”*

*Rebi'u thotë: “Pa e përfunduar mirë fjalën, korrierët e Mensùrit, që kishin mësuar se ku gjendesha, arritën si të kishin shkelur mbi gjurmët e mia. U ktheva në çast dhe e njoftova si e gjeta.”*

*Mensùri filloi të qante, pastaj më tha: “Kthehu dhe i thuaj atij: “Çështja është në takimin me ty aty tek ti dhe të ulemi, kurse për gratë që ti përmende, bëji shumë selam, pasi All'illahu, me të vërtetë, i ka siguruar ato nga padija dhe u ka hequr frikën që ato kishin.”*

*Rebi'u vazhdon: “U ktheva tek ai dhe e njoftova se ç'më tha Mensùri. Atëherë ai tha: “I thuaj atij: “Mbajte lidhjet me një nga të afërmit dhe shpërbleve të mirën.” Pastaj sytë e tij u mbushën me lot, lotët filluan të rridhnin, aq shumë sa i pikonin në prehër.”*

*Pastaj ai foli: “O Rebi', kjo botë, edhe nëse e gëzon të mirën e saj, të mashtron me gjërat e saj të bukura.”*

*Edhe unë fola: “O Ebù Abdil-lah, po të pyes me gjithë të vërtetën që është ndërmjet teje e All'illahut të Lartësuar dhe të më thuash me ç'lutje iu drejtove Zotit tënd*

---

<sup>1</sup> Mendoj se ai dëshiron që patjetër të flasë hapur për të vërtetën e gjendjes.

<sup>2</sup> Dëshiron që të lutet për të pas çdo namazi dhe të jetë lutje e atij që i është bërë padrejtësi, pasi kjo lutje nuk kthehet pa përgjigje.

*të Lartësuar dhe këtë lutje e bëre ndarës ndërmjet vetes e ndërmjet kujt do që të paralajmëron e të frikëson. Mbase All'llahu i Lartësuar, me ilaçin tënd, shëron kockat e thyera të ndonjërit, pasuron një të varfër. Betohem në All'llah se nuk kam qëllim ndonjë tjetër veç vetes sime.”*

*Ai ngriti dorën dhe tha: “Thuaj: O Zoti im, Ty të lutem o Arritës i të ikurve, o vendstrehimi i të frikësuarve dhe plotësoje lutjen.”<sup>1</sup>*

*Në ftesën që Mensùri i ka drejtuar Sàdikut kësaj here, nuk duket të ketë ndonjë të keqe, por ajo që e shqetësonte Ebù Abdullaun ishte se gratë e tij, ngaqë ishin shumë të turpshme, kishin hequr dorë edhe nga gjërat e lejuara, prandaj ai kërkoi ndërmjetësim e afrim tek All'llahu i Lartësuar që të largonte të keqen e Mensùrit.*

*Ebù Abdil-lahi ishte shumë i vëmendshëm ndaj njerëzve të vet e i kuptonte më mirë se askush tjetër qëllimet e tyre. Në nënkapituj e tjerë do të zbulohen qëllimet e Mensùrit kundër imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), pasi ai në çdo thirrje që i bënte, nuk synonte gjë tjetër përveç të keqes.*

*E dyta: Ibn Tàusi transmeton, gjithnjë sipas përcjelljes së Rebi'ut: “Kreva Haxhin me Ebù Xha'fer Mensùrin dhe, kur kishim bërë një pjesë të mirë të rrugës, Mensùri më tha: “O Rebi', kur të arrijmë në Medine, më kujto për Xha'fer ibn Muhammed ibn Ali ibn Husejn ibn Aliun.” (Paqja qoftë mbi të gjithë!), pastaj shtoi: “Betohem në*

---

<sup>1</sup> Lutjet e këtij kapitulli i kemi përfshirë në lutjet e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), por, kur pamë se lutjet e tij në këtë kapitull ishin të gjata e të shumta, e pamë të udhës, që t'i mblidhnim me lutjet e tjera dhe kështu doli një libër më vete, të cilin e emërtuam “Duatë e imam Sàdikut”. Deri tani pranë nesh janë bërë 400 faqe në masën e faqeve të këtij libri.



*All'lahun e Madhëruar se atë nuk e vret dot njeri tjetër veç  
meje. Kujdes se mos nuk më kujton."*

*Kur arritëm në Medine, All'lahu i Lartësuar bëri që  
unë të harroj dhe kështu nuk ia kujtova, por, kur arritëm  
në Mekke, më tha: "O Rebi', a nuk të urdhërova të më  
kujtoje për Xha'fer ibn Muhammedin kur të hynim në  
Medine?"*

*Unë u përgjigjja: "Harrova, o zotëria im, o Prijës i  
Besimtarëve."*

*Atëherë ai më tha: "Kur të kthehem në Medine,  
patjetër të më kujtosh, sepse ai duhet vrarë se s'bën!",  
pastaj m'u drejtua e më tha: "Nëse nuk bën kështu siç të  
urdhëroj, mos dysho se nuk do të ta pres kokën."*

*I thashë: "Po, o Prijës i Besimtarëve."*

*Si u ndava prej tij, porosita shokët e shërbyesit e mi:  
"Kur, me lejen e All'lahut, të hyjmë në Medine, më kujtoni  
për Xha'fer ibn Muhammedin."*

*Shokët e shërbyesit ma kujtonin vazhdimisht, në çdo  
vend që ndalonim e në çdo shtëpi që ndalonte Mensùri.  
Vazhduam udhëtimin derisa erdhëm në Medine. Kur zumë  
vend në Medine, hyra tek Mensùri, qëndrova para tij dhe i  
thashë: "O Prijës i Besimtarëve, Xha'fer ibn Muhammedi."*

*Ai qeshi dhe më tha: "Po, shko, o Rebi', e ma sill  
këtu, por mos eja pa të! Shiko, të ma sjellësh duke e  
tërhequr!"*

*“O sundimtari im, - i thashë, - me gjithë dëshirë e bindje të plotë unë do ta bëj këtë në zbatim të urdhrin tënd.”*

*Pastaj Rebi’u vazhdon: “U ngrita, por isha në hall të madh, që do të bëja këtë krim. Megjithatë, shkova tek imam Sàdik Xha’fer ibn Muhammed (Paqja qoftë mbi të dy!), të cilin e gjeta ndenjor në mes të shtëpisë së tij. I thashë: “Kurban t’u bëfsha, Prijësi i Besimtarëve të fton të shkosh tek ai.”*

*Me kënaqësi e me bindje të plotë.” - foli imami, pastaj u ngrit dhe po ecte më këmbë së bashku me mua.*

*“Unë i thashë, - vazhdon Rebi’u tregimin: “O biri i të Dërguarit të All’llahut -Paqja e All’llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!-, ai më ka urdhëruar që unë të të çoj tek ai vetëm duke të tërhequr.”*

*“Mirë, foli imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), zbatoje urdhrin, o Rebi’, ashtu siç të ka urdhëruar.”*

*Ndërkaq - thotë Rebi’u - i kapa njërin cep të mëngës dhe fillova ta tërheq. Kur hymë tek ai, e pashë të ulur mbi krevatin e tij. Në dorë mbante një shufër hekuri, me të cilën donte të vriste imamin. Hodha shikimin kah Xha’fer ibn Muhammedi, që po lëvizte buzët, nuk dyshova që do ta vriste dhe ndalova t’i shoh që të dy, por kur Xha’fer ibn Muhammedi u afrua pranë tij, Mensùri i tha: “Afrohu o djalë i xhaxhait tim.” Fytyra i shkëlqeu. Pastaj e afroi aq afër, sa e uli të rrinin bashkë mbi krevat. Pastaj tha: “O djalë, sille këtu pranë meje atë kutinë e sendeve të shtrenjta!” Brenda në kuti ishte një gotë shumë e*

*çmueshme, e mbylli kutinë<sup>1</sup> dhe pastaj e ngarkoi mbi një mushkë, urdhëroi t'i jepnin një qese me para dhe një rrobë, pastaj e urdhëroi të shkonte.*

*“Unë - thotë Rebi’u - dola nga dhoma e Mensùrit dhe e shoqërova imamin derisa arritëm në shtëpinë e tij.*

*Aty i thashë: “Kurban t’u bëfshin nëna e babai im ty, o nipi i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), nuk pata asnjë dyshim se ai do të të vriste sapo të hyje, por unë vura re se ti po lëvizje buzët, pikërisht atëherë kur hyre tek ai. Çfarë the?”*

*Ai më tha: “Po, o Rebi’, mëso se çfarë thashë: “Mua më mjafton Zoti prej pushtetarëve, mua më mjafton Krijuesi prej të krijuarve...”*

*E treta: Ibn Tàusi tregon se, kur e ka thirrur herën e tretë në Rebdheh,<sup>2</sup> Makhremeh El-Kindij thotë: “Kur Ebù Xha’fer Mensùri qëndroi në Rebdheh, atë ditë aty u ndodh edhe Xha’fer ibn Muhammedi (Paqja qoftë mbi të!).*

*Mensùri tha: “Kush më ndalon nga ky Xha’feri?- dhe herë nxirrte përpara njëren këmbë, herë tërhiqte prapa këmbën tjetër dhe thoshte: “Të shpëtojmë nga Muhammedi.<sup>3</sup> Nëse ai triumfon, puna është në dorën time,*

---

<sup>1</sup> Domethënë ai e mbuloi si shenjë, se kishte vënë në të sende shumë të kushtueshme.

<sup>2</sup> Vend ndërmjet Mekës e Medines, ku ka qenë banesa e Ebù Dherrit, para se të pranonte Islamin. Në këtë vend e kanë internuar dhe aty ka vdekur e është varrosur.

<sup>3</sup> Ibn Abdull’illâh ibn Hasan, duhet të ishte Haxhi i vitit 144, para daljes së Muhammedit ose dy haxhet e para kanë qenë në vitet 140 dhe 147. Nuk është e detyrueshme renditja e shpjegimit, megjithëse Sherif Ibn Tàusi duhet të kishte vënë renditjen e viteve. Për më tepër ai nuk thotë gjë për vitin kur është bërë Haxhi.

sepse herë tjetër unë do ta ruaj veten dhe, për All'Allah, patjetër që do ta vras. Pastaj u kthye në drejtim të Ibrahim ibn Xhebeleh dhe tha: "O djalë i Xhebelehit, ngrihu e shko tek ai, vëri rrobën e vet në fyt e ma sill këtu duke e tërhequr."

Ibrahimi thotë: "Dola dhe shkova në shtëpinë e tij, por nuk e gjeta, kështu që e kërkova në xhaminë e Ebù Dherrit. E gjeta në derën e xhamisë."

Më tha: "Të vjen turp të bësh atë që je urdhëruar?!"

Unë e kapa për mënge dhe i thashë: "Përgjigju Prijësit të Besimtarëve!"

Ndërkaq ai lexoi ajetin: "...ne jemi të All'Allahut dhe tek Ai do të kthehemi..." (Sure "El-Bekare", ajeti 156) dhe shtoi: "Më lër sa të fal dy rekate namaz." Pastaj qau shumë. Unë isha prapa tij.

Pastaj tha: "O Zoti im, Ti je siguria ime në çdo pësim, Ti je shpresa ime në çdo vështirësi!" dhe vazhdoi lutjen. Pastaj më tha: "Bëj atë që je urdhëruar!"

"Jo i thashë, për All'Allah nuk e bëj edhe sikur të mendosh se unë do të vritem!" Kështu që shkova me të, por, betohem në All'Allah, nuk kisha dyshim se do ta vriste. Kur arritëm para derës së fshehtë, ai tha: "O Zot i Xhebràijlit, Mijkàijlit, e Isràfijlit, Zoti i Ibràhijmit, Is'hàkut e Zoti i Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në këtë paradite merre Ti në dorë shëndetin tim, mos më vër nën sundimin e asnjërit prej krijesave të tua në ndonjë send, për të cilin unë nuk ia kam fuqinë atij."

*Pastaj Ibrahim i thotë: “E futa tek ai. Ishte ulur dhe, si kaloi një farë kohe, foli: “Nxirre përpara një këmbë dhe le mbrapa këmbën tjetër, por të betohem në All’llah se do të vras!”*

*Atëherë ai tha: “O prijës i besimtarëve, për çka kam bërë tregohu i butë me mua, pasi unë rrallë herë jam në shoqërinë tënde.”*

*Atëherë Ebù Xha’feri i tha: “Largohu!”*

*Pastaj iu drejtua Isà ibn Aliut<sup>1</sup> dhe i tha: “O Ebù Abbàs, shkoi nga pas dhe pyete a me atë apo me mua?”*

*Ebù Abbàsi nxitoi derisa e arriti dhe e i tha: “O Ebu Abdullah, Prijësi i Besimtarëve thotë për ty: “A me ty apo me atë?”*

*“Jo, i tha, me mua.”*

*Atëherë Ebù Xha’feri tha: “Ka thënë të vërtetën.”<sup>2</sup>*

*Ibrahim ibn Xhebeleh ka thënë: “Dola dhe e gjeta ndenjor duke më pritur, që të më falënderonte për punën e mirë që i bëra. Filloi të falënderojë All’llahun duke thënë: “Falënderimi i takon vetëm All’llahut, të Cilit i lutem dhe Ai i përgjigjet lutjes sime. Edhe pse jam i ngadaltë, kur lutem, plotësoje lutjen.”*

*E katërta: Sherif Ibn Tàusi thotë: “Kjo është hera e katërt, që ai e thërret në Kufe.”*

---

<sup>1</sup> Ibn Abdullah ibn Abbàs është xhaxhai i Mensùrit.

<sup>2</sup> Kjo fjalë është e qartë dhe është thënë afër vdekjes së Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe ka qenë Haxhi i vitit 147; kurse deklaratat e tij, e para ka ndodhur para daljes së Muhammedit, rezulton të kenë qenë Haxhi i vitit 144, por është jashtë mendjes që Mensùri t’i besojë Sàdikut dhe ta pyesë atë për radhën se kush do të ishte i pari, në një kohë që ai pësonte prej tij atë që nuk mund të thuhet, nga më të këqijat e më të urryerat.

*Fadl ibn Rrebij'ë, pasi përmend përcjellësit, tregon: "Babai im Rrebij'ë ka thënë: "Mensùri dërgoi Ibrahim ibn Xhebeleh në Medine, që të verifikonte Xha'fer ibn Muhammedin. Ibrahim më ka thënë mua se, kur, ai kishte arritur tek Xha'feri dhe e kishte njoftuar për letrën e Mensùrit, dëgjova të thoshte: "O Zoti im, Ti je siguria ime në çdo pësim dhe shpresa ime në çdo vështirësi... plotëso lutjen!" I sollën kafshën dhe, kur ai doli që të hipte mbi kafshën, e dëgjova të thoshte: "O Zoti im, me Ty e hap dhe me Ty kërkoj shpëtimin, plotëso lutjen."*

*Kur hymë në Kufe, vazhdon tregimin Ibrahim, zbriti nga kafsha, fali dy rekate namaz dhe pastaj ngriti dorën në drejtim të qiellit dhe tha: "O Zoti im, Zoti i qiejve dhe i gjithçkaje që bën hije, Zot i shtatë tokave dhe i gjithçkaje që është e vogël, plotësoje lutjen."*

*Rebi'u thotë: "Kur arritën në audiencë të Mensùrit, hyra dhe e njoftova se Xha'feri e Ibrahim kishin arritur. Mensùri thirri Musejjib ibn Zuhejr Edh'Dhabijin, i dha një shpatë dhe i tha: "Kur të hyjë Xha'fer ibn Muhammedi dhe unë të jem duke biseduar me të, do të të bëj shenjë në drejtim të tij, atëherë ti prijti kokën dhe mos prit urdhër."<sup>1</sup>*

*Rebiu' tregon: "Dola të takohem me të, si dy vetë që kanë kryer Haxh së bashku dhe i thashë: "O nipi i të Dërguarit të All'llahut, ky tiran ka urdhëruar që mbi ty të kryhet një veprim, që nuk dua të ndodhë me ty. Prandaj, nëse në vetvete ke ndonjë gjë, thuaje dhe ato fjalë të jenë porosi për mua. Atëherë ai tha: "Ti as mos u çudit e as mos u frikëso nga kjo. Sikur të më kishte përpara, e gjitha kjo nuk do të ndodhte."*

---

<sup>1</sup> Domethënë pa u këshilluar.

*Pastaj, duke u përqendruar tërësisht në fshehtësinë e tij, tha: “O Zot i Xhebràilit, Mikàilit, e Isràfilit, Zoti i Ibràhimit, Is’hàkut e Zoti i Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në këtë paradite merre Ti në dorë shëndetin tim, mos më vër nën sundimin e asnjërit prej krijesave të Tua në ndonjë send për të cilin unë nuk ia kam fuqinë atij!” Pastaj kur hyri, lëvizi buzët e shqiptoi diçka që unë nuk e kuptova. Shikova Mensùrin dhe pashë se ngjante me një zjarr, mbi të cilin kanë hedhur ujë dhe është fikur. Ai po mundohej të qetësonte zemërimin e tij, derisa pranë tij u afrua Xha’fer ibn Muhammedi (Paqja qoftë mbi të dy!). Mensùri u ngrit, e mori për dore dhe e ngriti mbi shtratin e vet, pastaj i tha: “O Ebù Abdil’lah, është krenari për mua të të ndjek ty, por në fakt, të kam thirrur këtu që të ankoem për njerëzit e familjes tënde, të cilët i kanë prerë lidhjet e farefisnisë me mua, më kanë kundërshtuar në fenë time dhe kanë mbledhur njerëzit kundër meje.”*

*Xha’feri (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “Ku është me ty ajo prirje kah brezi i të parëve të mirë? Ejjùbi (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) u vu në sprovë të rëndë dhe duroi; Jùsufit (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) – iu bë padrejtësi dhe fali; Sulejmànit (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) iu dha pasuri dhe falënderoi.”*

*Atëherë Mensùri tha: “Durova, fala dhe falënderova.”*

*Pastaj tha: “O Ebù Abdil’lah, na thuaj atë bisedën që unë e kam dëgjuar prej teje për mbajtjen e lidhjeve me të afërmit dhe ai tha: “Kam dëgjuar babain tim, i cili e ka dëgjuar prej gjyshit tim se i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë:*

*«Mirësi është mbajtja e lidhjeve me të afërmit, popullimi i vendeve të banuara dhe shtimi i ndërtimeve.»*

*Por ai tha: “Kjo nuk është e gjitha.”*

*Atëherë Xha’fer ibn Muhammedi tha: “Babai ka biseduar me mua se gjyshi im i ka thënë atij se i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: «Kush dëshiron që ta shtyjë kohën e vdekjes së tij dhe të ketë shëndet në trupin e vet, le të mbajë lidhjet me të afërmit e tij.»*

*Përsëri Mensùri i tha: “Kjo nuk është e gjitha.”*

*Po - i tha edhe Xha’fer ibn Muhammedi, babai më ka thënë se gjyshi im ka dëgjuar të Dërguarin e All’llahut të thotë: “Kam parë një mitër të varur në Arsh, që i ankohej All’llahut të Lartësuar për shkak se i kishin ndërprerë lidhjet e afërsisë me të. Unë e pyeta: “O Xhibril, sa larg janë njëri me tjetrin?”*

*Ai më tha: “Shtatë breza.”*

*Përsëri Mensùri tha: “Kjo nuk është e gjitha.”*

*Pastaj Ebù Abdil’lahi tha: “Po, babai më ka treguar se gjyshi im ka dëgjuar Profetin (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) të thotë: “Ishin pranë njëri-tjetrit në agoni një burrë, që kishte treguar mirësjellje ndaj prindërve dhe një tjetër, që nuk kishte respektuar prindërit. All’llahu i Lartësuar i tha engjëllit të vdekjes: “O engjëll i vdekjes, sa i ka mbetur nga jeta atij që nuk ka respektuar prindërit?”*

*Engjëlli tha: “Tridhjetë vjet.”*



*All'llahu urdhëroi: "Jepja këto vite atij që ka treguar mirësjellje me prindërit."<sup>1</sup>*

*Atëherë Mensùri urdhëroi shërbyesin që t'i sillte kutinë e parave, e hapi me dorën e vet dhe pastaj i afroi Ebù Abdil-lahit katër mijë dinarë. Lajmëroi që t'i sillnin kafshën dhe, kur ata e sollën, ai po thoshte: "Afrohu, afrohu, derisa kafsha erdhi pranë shtratit." Unë e ndihmova Xha'fer ibn Muhammedin (Paqja qoftë mbi të dy!) të hipë dhe drekova me të, ndërkaq e dëgjova të thotë: "Falënderimi i takon vetëm All'llahut, të Cilit i lutem dhe Ai i përgjigjet lutjes time."*

*Edhe unë i thashë: "O nipi i të Dërguarit të All'llahut, ky tiran herë pas here, më kërcënon me shpatë. Ai ka thirrur Musejib ibn Zuhejrin, i ka dhënë shpatën në dorë dhe e ka urdhëruar që të të priste kokën, por, në kohën kur hyre, unë të pashë të lëvizje buzët dhe shqiptove diçka që nuk e kuptova."*

*Ai më tha: "Nuk është vendi për këtë."*

*Prandaj i shkova në darkë dhe atëherë ai më tha: "Po, babai më ka folur për një histori që i ka treguar babai i tij, gjyshi im: "Dita më e vështirë për të Dërguarin e All'llahut ishte kur jehudijtë dhe fiset fezareh e gatafàn u vërsulën mbi të. Ja se çfarë thotë i Larti për këtë ngjarje: "Dhe kur ata erdhën mbi ju prej së larti e nga poshtë dhe kur shikimet u shtangën e zemrat arritën në fyt, ju sajuat*

---

<sup>1</sup> Nuk është se Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) nuk e dinte bisedën që dëshironte Mensùri, por ai tha aq shumë nga hadithet, që flasin për mbajtjen e lidhjeve me të afërmit, që t'i bënte Mensùrit të njohur qëndrimin e tij ndaj të afërmeve.

*mendime të shumëllojshme për All'llahun.” (Sure “El-Ahzàb”,  
ajeti 10)*

*Kjo ka qenë dita më e rëndë për të Dërguarin e  
All'llahut. Nga vështirësia hynte e dilte pa pushim.  
Shikonte në drejtim të qiellit e thoshte: «Ngushtica ime, Ti  
zgjeroje!»*

*Gjatë disa netëve dilte jashtë dhe një natë, kur pa një  
person, i tha Hudhejfes: “Vështro, kush është ky?”*

*Ai tha: “O i Dërguar i All'llahut, ai është Ali ibn Ebu  
Tàlibi.”*

*Atëherë, i Dërguari i All'llahut -Paqja e Allahut qoftë  
mbi të e mbi familjen e tij!- i foli Aliut: “O Ebù Hasan, mos kishe  
frikë se do të bije në sy?”*

*Aliu tha: “Veten ia kam dhuruar All'llahut e të  
Dërguarit të Tij. Sonte unë dola të bëj rojë për  
myslimanët.”*

*Nuk e kishin mbaruar akoma bisedën, kur Xhibrili  
zbriti dhe tha: “O Muhammed, All'llahu të çon selam dhe të  
thotë: “Në fakt, ti e pe qëndrimin e Aliut sonte dhe nga ana  
Ime i kam dhuruar atij disa fjalë, me të cilat, kur kërkohet  
mbrojtje prej ndonjë djalli kryefortë apo prej mbreti tiran,  
apo në rast zjarri e mbytjeje, apo në raste shembjeje e  
fundosjeje të tokës, ose për mbrojtje prej ndonjë bishe  
dëmtuese, apo prej ndonjë vjedhësi, patjetër që All'llahu e  
siguron. Këto janë fjalët që ai të thotë: “O Zoti im, na ruaj  
ne me syrin Tënd, që kurrë nuk ka gjumë...”*

*E pesta: Mensùri e thirri imam Sàdikun (Paqja qoftë  
mbi të!) në Bagdad para se të vriteshin dy djemtë e*

*Abdullah ibn Hasanit,<sup>1</sup> Muhammedi e Ibrahimit. Këtë ngjarje e transmeton Sherijf Radijudini, sipas përcjelljes së portierit të Mensùrit, Rebijut: “Një ditë Mensùri ishte ulur në sallën “Kubeja e blertë” të pallatit të tij. Kjo sallë, para vrasjes së Muhammedit e Ibrahimit, quhej “Kubeja e kuqe”. Mensùri rrinte në këtë sallë në një nga ditët që ai e kishte caktuar vetë. Këtë ditë e quante dita e therjes. Mensùri e kishte sjellë Xha’fer ibn Muhammedin prej Medines dhe atë ditë e kaloi duke qëndruar në sallën e kuqe, madje vazhdoi të qëndrojë aty edhe pasi u err. Vetëm si kaloi pjesa më e madhe e natës, thirri Rrebij’un dhe i tha: “O Rebij, ti e di vendin që zë tek unë, aq sa për të mirën e punës ti nuk ia thua as nënave të djemve (grave të tua) dhe ti je ai që ndërhyt e i rregullon punët.”*

*Rebiju tha: “O Prijës i Besimtarëve, kjo është nga mirësitë e All’llahut për mua dhe nga mirësia e Prijësit të Besimtarëve, por unë nuk kam qëllim më të lartë se këshillën.”*

*Atëherë Mensùri i tha: “Kështu është, por nisu, që në këtë çast, për tek Xha’fer ibn Muhammed ibn Fàtime dhe ma sill këtu ashtu si ta gjesh, të mos ndërrojë asnjë send që ka mbi trup.”*

*Rebiju tha: “Ne jemi të All’llahut e tek Ai është kthimi ynë” dhe me vete tha: “Betohem në All’llah se kjo është vrasje. Nëse do ta çoj tek ai në atë gjendje zemërimi, që po e shikoj, ai do ta vrasë dhe për mua mbaroi bota e ardhshme. Nëse nuk veproj sipas urdhrit të tij, ai do të më*

---

<sup>1</sup> Vrasja e tyre ka ndodhur në vitin 145 dhe shpërngulja e Mensurit ka ndodhur në vitin 146. Nuk ka ndonjë të dhënë që të njoftojë se ai e ka thirrur atë të shkojë në Bagdad para vrasjes së atyre të dyve. Mbase ai ka qenë në Kufe dhe gabimi mund të jetë i shkruarit ose edhe i përcjellësit, ose e ka thirrur pas vrasjes së atyre të dyve.

*vrasë mua, do të vrasë edhe pasardhësit e mi dhe do të më marrë pasurinë. Po vija në peshë dallimin mes kësaj bote e botës së ardhshme, por shpirti më anoi nga kjo botë.”*

*Muhammed ibn Rebiju ka thënë: “Më thirri babai, pasi ndër të gjithë djemtë e tij unë isha më i ashpëri e më zemërguri e më tha: “Shko tek Xha’fer ibn Muhammedi, ngjitu mbi murin e tij dhe mos i kërko të hapë portën se pastaj ai ndërron rrobat që ka mbi trup, hyr tek ai dhe sille në çast, ashtu si është.”*

*Muhammed ibn Rebuju vazhdon: “Unë shkova tek ai, kur nga nata kishte mbetur fare pak. Vura shkallët e u ngjita mbi mur. Kur hyra në shtëpi, e gjeta më këmbë duke falur namaz, veshur me një këmishë dhe një shall, që e kishte lidhur si trobë të poshtme. Pasi dha “Selam” dhe përfundoi namazin, i thashë: “Përgjigju Prijësit të Besimtarëve!”*

*Ai më tha: “Më le të bëj lutjen e të vesh rrobat!”*

*Unë i thashë: “Nuk ka asnjë mundësi për këtë.”*

*Ai përsëri më tha: “Po sa të hy në banjë, që të lahem e të pastrohem.”*

*I thashë të njëjtën fjalë: “Nuk ka asnjë mundësi për këto, mos e lodh veten, se unë nuk të lë të ndërrosh asnjë send.”*

*Pastaj e nxora zbathur vetëm me këmishën e me atë shallin e tij. Në këtë kohë ai i kishte kaluar të*

shtatëdhjetat.<sup>1</sup> Ecëm një pjesë të rrugës dhe plakun e lanë fuqitë. Me erdhi keq për të dhe i thashë të hipte mbi mushkën e qiraxhiut, që unë e kisha marrë me mëditje dhe që ishte me ne. Shkuam tek Rebiju, të cilin e dëgjova të thoshte: “Ah mor i mjeri Rebij!”

Në fakt, burri i kishte ngadalësuar hapat, megjithëse po e nxiste shumë e me forcë. Kur sytë e Rrebij’ut ranë mbi Xha’ferin, i cili ishte në atë gjendje, qau, pasi Rebiju ishte afruar në përkrahje të pasardhësve të Aliut.

Xha’feri (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “O Rebij, unë e di prirjen tënde kah ne, por më lejo të fal dy rekate namaz dhe të lutem.”

Rebiju foli: “Është puna jote dhe bëj ç’të duash.”

Ai fali shumë shkurt dy rakate namaz dhe pastaj bëri një lutje, që unë nuk e kuptova, megjithëse lutja e tij qe e gjatë. Ndërkaq Mensùri i kërkonte Rebijut të shpejtonte dhe kur Xha’feri mbaroi lutjen e tij të gjatë, Rrebij’ë e kapi për krahu dhe e futi tek Mensùri. Por, kur ishin në korridor, ai qëndroi, lëvizi buzët dhe tha diçka që unë nuk e di se ç’tha. Rebiju vazhdon: “E futa atë dhe ai qëndroi para Mensùrit, i cili, pasi i hodhi një vështrim të rëndë, i tha: “Ti o Xha’fer, nuk po heq dorë nga smira, nga dalja jashtë ligjit e nga ngatërresat në kurriz të njerëzve të shtëpisë së Abbàsit (abasitëve), prandaj All’llahu, për të gjitha këto, ta ka shtuar akoma më shumë smirën e vështirësitë. Çfarë do të arrish me këtë dhe çfarë fuqie do të kesh prej kësaj?”

---

<sup>1</sup> Sàdiku nuk i kishte kapërcyer të shtatëdhjetat dhe akoma shpresonte për Muhammedin. Mendoj se veproi me mëshirë kur pa sa i pafuqishëm ishte ai.

*Xha'fer ibn Muhammedi (Paqja e shpëtimiti qoftë mbi të!) i tha Mensùrit: "Betohem në All'Allah, o Prijës i Besimtarëve, unë nuk kam bërë asgjë nga ato punë. Veç kësaj, unë kam qenë edhe në kohën e sundimit të emevive. Ti e di se ata kanë qenë armiqtë më të ashpër ndaj nesh e ndaj jush, gjithashtu ti e di se për këtë armiqësi ndaj nesh ata nuk kishin të drejtë. Përsëri betohem në All'Allah se unë edhe atëherë nuk jam ngritur kundër tyre dhe asgjë nuk i ka ardhur atyre prej meje, megjithë ftohtësinë që kishin ata ndaj meje. Si është e mundur, o Prijës i Besimtarëve, ta bëj unë këtë tani, kur ti je djali i xhaxhait tim dhe njeriu më i afërm që kam, je ai që më jep më shumë e që më bën të mira? Si do ta bëj unë këtë? Mensùri përnjëherë uli kokën mbi gjoks, ishte ulur mbi një qilim të leshtë dhe nga e majta kishte një mbështetëse krahu, kurse nën qilim kishte një shpatë me gdhendje, nga e cila nuk ndahej asnjëherë kur rrinte në kubenë dhe tha: "Gabove dhe mëkatove." Pastaj ngriti të palosurën e qilimit dhe nxori prej saj disa fletë të shkruara, të bëra shuk dhe ia hodhi, duke i thënë: "Këto janë letrat e tua, që ti u ke shkruar banorëve të Horosànit. Në këto letra ti i bën thirrje atyre që të prishin besën që më kanë dhënë mua dhe të ta japin ty."*

*Imam Xha'feri (Paqja qoftë mbi të!) tha: "O Prijës i Besimtarëve, as nuk e kam bërë e as nuk mund ta lejoj këtë. Për më tepër, ky nuk është medh'hebi im, sepse unë besoj se ndaj teje duhet treguar bindje në të gjitha gjendjet. Jam shumë plak e nuk e kam më fuqinë për të tilla punë. Mandej, edhe sikur të kisha dëshirë për këtë veprim, patjetër që do të më kishin mbyllur në ndonjë nga burgjet e tua dhe aty do të më mbanin derisa të mbyllja sytë, kurse vdekja tanimë është afruar shumë."*

*Por Mensùri tha: “Jo dhe jo, nuk ka ndershmëri.”*

*Pastaj kërrusi kokën mbi gjoks dhe lëvizi dorën mbi shpatë, e nxori atë nga këllëfi, sa madhësia e një pëllëmbë dhe e kapi nga doreza.*

*“Unë, tregon Rebiju, thashë me vete: “Jemi të All’llahut, për All’llah burri shkoi!”, por ai e la shpatën dhe tha: “O Xha’fer, a nuk ke turp, që me gjithë këto thinja mbi kokë dhe me këtë fis që ke, të flasësh gjëra të gabuara e të kundërshtosh bashkësinë e myslimanëve? Ti dëshiron të derdhësh gjak e të përhapësh ngatërresa ndër të sunduarit e miqtë.”*

*Ai tha: “Jo, o prijës i besimtarëve, betohem në All’llah, se nuk e kam bërë, as këto fletë të shkruara nuk janë të miat, nuk është as shkrimi im e as vula ime.”*

*Ai përsëri e nxori shpatën nga këllëfi, gati sa madhësia e një krahu, dhe unë - tregon Rebiju, - thashë me vete: “Ne jemi të All’llahut, vajti burri!” dhe e vendosa me vete: “Nëse më urdhëron, do ta kundërshtoj.”*

*Mendova se ai do të më urdhëronte që të merrja shpatën dhe me të të godisja Xha’ferin. Nëse më urdhëron, po mendoja, do të godas Mensùrin, edhe pse dënimi do të binte mbi mua e mbi fëmijët e mi, por bëra Teube (pendim) para All’llahut të Lartësuar për nijetin që pata në fillim, sepse ai po vazhdonte ta qortonte, por edhe Xha’feri justifikohet. Pastaj ai e nxori shpatën nga këllëfi gati të gjithë, por e futi përsëri në këllëf dhe kërrusi kokën mbi gjoks për një kohë të gjatë. Kur e ngriti kokën, i tha: “Mendoj se thua të vërtetën.”*

*Pastaj më tha mua: “O Rebij, sille atë kutinë që është te vendi i vet në kube!”*

*Kur ia solla, ai tha: “Fute dorën brenda saj.”*

*Kutia ishte e mbushur me një përzierje parfumesh, me të cilën ai parfumoi mjekrën e Xha’ferit, e cila nga e bardhë, u nxi dhe pastaj më tha mua: “Vëre në enën e tij, që është në kafshën që i hipi unë dhe jepi 10000 dirhem, pastaj përcille me respekt për në shtëpinë e tij.”*

*Kur arritëm te banesa e tij, Xha’feri mbeti në mëdyshje: të qëndronte me ne dhe ta respektonim apo të largohej për në qytetin e gjyshit të tij, të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) pasi ishte i çuditur nga ajo që Mensùri e veproi dhe nga ajo mbrojtje që gjeti tek ai. Nuk ka asgjë të çuditshme në punët e All’llahut të Lartësuar. Kur dolëm në korridor, unë i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut nuk ka asgjë të çuditshme, as në atë që u bë me ty në derën e banesës tënde dhe as në atë mbrojtje e shpërblim që bëri All’llahu për ty. Nuk ka çudira në punët e All’llahut të Lartësuar, sepse unë të dëgjova që u lute, pasi fale ato dy rekatet namaz, por nuk e di se si është ajo lutje. Di që ishte lutje e gjatë. Këtu në korridor ti lëvize buzët dhe the diçka, por nuk e di se si qe ajo. Ai më tha: “E para ishte lutja për pësimet e rënda e vështirësitë. Me atë lutje nuk jam lutur për ndonjërin deri më sot. Atë lutje e bëra si kompensim. Lutja ishte e gjatë, për shkak të lutjeve të shumta që unë këndoj pas çdo namazi. Prandaj edhe në këtë rast unë nuk mund të lija pa kënduar ato lutje, që këndoj përherë. Përsa i përket asaj lutjes, që ti thua se luajte buzët, ajo është lutja me të cilën është lutur i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të*



e mbi familjen e tij!) ditën e luftës së grupeve (Hendekut). Këtë lutje ma ka treguar babai im, i cili, nga ana e tij e ka dëgjuar prej gjyshit të tij, Prijësit të Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i cili ka treguar se i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: “Ditën e luftës së grupeve, Medineja ishte si kurorë nga ushtarët e idhujtarëve, të cilët vinin ashtu siç thotë All'lahu i Lartësuar në fjalën e Tij: “Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe “besimi juaj tek Allahu u lëkund.” (Sure “El-Ahzàb”, ajeti 10) dhe përmendi lutjen.

Pastaj Xha'feri tha: “Sikur të mos ishte frika prej Prijësit të Besimtarëve, këto para do të t'i jepja ty. Ti më ke kërkuar tokën time në Medine, për të cilën më ofrove 10000 dinarë, por unë nuk ta shita. Tani po ta dhuroj.”

Atëherë i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dëshira ime është në lutjen e parë dhe të dytë. Nëse ti e bën këtë, më ke bërë mirësinë më të madhe. Unë nuk kam nevojë për tokën.”

Por ai më tha: “Ne të Ehli Bejtit nuk tërhiqemi me të njohurit tanë, ne do ta shkruajmë lutjen për ty dhe do të ta japim edhe tokën, prandaj eja me mua deri në banesë.”

Eca së bashku dhe ai veproi me mua ashtu siç bëri më parë me të edhe Mensùri. Ai hartoi për mua shkresën e pronësisë mbi tokën dhe më diktoi lutjen e të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), më diktoi edhe lutjen që ai këndoi pas faljes së dy rekatëve. Pastaj unë thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'lahut, Mensùri kërkonte që unë të nxitohesha, ndërsa

*ti, pa u merakosur luteshe me këtë lutje kaq të gjatë, sikur nuk kishe fare frikë.”*

*Ai tha: “Po, pas faljes së namazit të Sabahut, unë bëj një lutje, të cilën patjetër duhet ta këndoj çdo herë, kurse ato dy rekatët, nuk janë namazi i Sabahut, por janë namazi i kohës para namazit të drekës, prandaj i fala aq shkurt dhe pas faljes u luta me këtë lutje.”*

*E pyeta: “A nuk e kishe frikë Ebù Xha’ferin, që kishte bërë gati për ty ato që kishte bërë?”*

*Ai më tha: “Çfarë kishte bërë gati?! Frikë prej All’lلاهut dhe jo frikë prej tij. Në zemrën time All’llahu ishte më i madh se ai.”*

*Rebiju thotë: “Nuk po e njihja veten nga zemërimi e mllefi i Mensùrit ndaj Xha’ferit, por edhe nga respekti e nga bujaria e madhe, që ai tregoi ndaj tij dhe, një herë, kur e gjeta vetëm e me shpirt të qetë, i thashë: “O Prijës i Besimtarëve, tek ti pashë një çudi.”*

*“Si është ajo?”- më tha.*

*“O prijës i besimtarëve, i thashë, zemërimi yt ndaj Xha’ferit ishte i atillë, që kurrë nuk të kam parë të zemërohesh me ndonjë tjetër, madje as me Abdullah ibn Hasanin; sepse do ta kishe vrarë atë me shpatë. Vura re se ti e nxore shpatën nga këllëfi sa madhësia e një pëllëmbë, pastaj e fute në këllëf, pastaj e nxore sa madhësia e një krahu, por përsëri e fute në këllëf, edhe një herë e nxore gati të gjithë, por edhe kësaj here e fute në këllëf. Në këtë çast ti u duke aq i kënaqur, sa më urdhërove mua të merrja kutinë dhe i leve mjekrën me të zezë me atë parfumin e shtrenjtë, që e hap vetëm ti dhe prej tij nuk i jep as djalit*

*tënd, Mehdiut e as atij që i ke trashëguar pushtetin e as xhaxhallarëve tuaj; gjithashtu e shpërbleve atë dhe më urdhërova që ta përcillja me respekt.”*

*Mensùri më tha: “Ah, mor i varfëri Rrebij’ë, nuk është ai për të cilin duhet të flas dhe është më mirë që ta lëmë, gjithashtu nuk dua që djali i Fatimes të arrijë që të tjerët të krenohen me të dhe të përsërisin emrin e tij dhe jo emrin tonë, megjithëse për ne është e mjaftueshme vendi që zëmë. Nuk dua të fsheh asgjë. Shiko brenda shtëpisë dhe shih se kush është.”*

*Pashë nga të gjitha anët, por përsëri ai më tha: “Kthehu e shiko përsëri, se mos ka mbetur ndonjë njeri.”*

*Bëra ashtu siç më urdhëroi dhe pastaj më tha: “Nuk ka njeri tjetër veç teje e meje, të betohem në All’llah, ti e di se unë të dua më shumë se çdo njeri tjetër. Nëse do të kishe dëgjuar zë, do të të kisha vrarë ty, fëmijët e gjithë familjen tënde, do të merrja edhe pasurinë.”*

*Rebij’ë vazhdon tregimin: “I thashë: “Kërkoj mbrojtjen e All’llahut prej teje.”*

*Atëherë ai foli: “O Rebij, isha i vendosur ta vrisja Xha’ferin, të mos i dëgjoj asnjë fjalë dhe të mos i pranoj asnjë justifikim, por kur desha të realizoj qëllimin tim, herën e parë, më doli përpara i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe hyri mes meje e mes tij me duar të shtrira e krahë të zbuluar, i vrenjtur e më shikonte në fytyrë me vetulla të ngrysura. Unë e largova fytyrën time prej tij. Pastaj, kur desha ta vras herën e dytë dhe e nxora shpatën nga këllëfi më shumë se herën e parë, përsëri i Dërguari i All’llahut*

*m'u afrua dhe vazhdonte të më afrohej me forcë të madhe dhe po më mësynte. Nëse unë do të kisha vepruar, me siguri që edhe ai do të kishte vepruar. Prandaj unë u frenova; ngrita kokën dhe thashë: "Kjo është punë e atij që ndjek xhinët." Pastaj e nxora shpatën herën e tretë nga këllëfi dhe përsëri më doli para syve i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) me krahë të shtrirë, i gatshëm të më hidhej, me fytyrë të skuqur, i vrenjtur e me vetulla të ngrysura, aq sa kujtova se po vinte dorë mbi mua. U frikësova dhe të betohem në All'lah, nëse unë do të kisha vepruar, me siguri edhe ai do të kishte vepruar. Prandaj ti pe ato që pe. Të drejtën e këtyre bijve të Fâtimesë nuk e di vetëm një injorant dhe ai që nuk ka asnjë njohuri nga ligji i fesë. Bëj kujdes, këtë bisedë të mos e marrë vesh askush."*

*Muhammed ibn R'ebiju thotë: "As mua nuk më ka treguar pa vdekur Mensùri, por edhe unë, nga ana ime, nuk e kam bërë fjalë me asnjë, derisa vdiq Mehdiu, Mùsài (Hàdiu), Hàrùni (Reshijdi) dhe derisa u vra edhe Muhammedi (Emini).*

*E gjashta: Sherif Radijudijn Ibn Tàùsi thotë: "Mensùri e thirri atë të vinte nga Medina në Bagdad për herë të dytë, pasi u vranë dy djemtë e Hasanit,<sup>1</sup> Muhammedi dhe Ibrahimimi. Kjo është transmetuar prej Safvàn ibn Mehràn El*

---

<sup>1</sup> Vrasja e atyre të dyve ka ndodhur në vitin 145. Nga komentet tona kam mësuar, në lidhje me herën e pestë, që e ka thirrur, se nuk është e vërtetë që këtë herë e ka thirrur në Bagdad, nëse ka ndodhur pas vrasjes së atyre të dyve; si dhe për faktin se ndërmjet shpërnguljes së Mensùrit në Bagdad dhe vdekjes së Sàdikut janë dy vjet, prandaj është larg mundësisë që vetëm në këto dy vjet ta ketë thirrur disa herë.

*Xhem'màlit<sup>1</sup>, i cili ka thënë: “Një burrë nga kurejshët e Medines, nga fisi Makhzùm, i çoi fjalë Ebù Xha'fer Mensùrit, pasi kishte vrarë dy djemtë e Abdullah ibn Hasanit, Muhammedin e Ibrahimin dhe i thotë se Xha'fer ibn Muhammedi ka dërguar shërbyesin e tij Mual'là ibn Khanijsin<sup>2</sup> për të mbledhur para ndër përkrahësit e tij, që me ato para të ndihmonte Muhammed ibn Abdullahun. Nga zemërimi ndaj Xha'fer ibn Muhammedit, Mensùri sa nuk kafshoi duart e veta dhe në këtë e sipër i shkroi xhaxhait të tij, Dàùd ibn Ali, i cili ishte emiri (i ngarkuari me drejtimin e punëve) i Medines,<sup>3</sup> që të sillte tek ai sa më shpejt Xha'fer ibn Muhammedin dhe të mos e lejonte atë të qëndronte e të ndalonte diku. Dàùdi i çoi Xha'ferit letrën e Mensùrit dhe i tha: “Nisu për tek Prijësi i Besimtarëve që të nesërmen dhe mos u vono.”*

*Safvànì vazhdon: “Atë ditë isha në Medine dhe, sapo e mora vesh, shkova tek imam Xha'fer Sadiku (Paqja qoftë mbi të!). Ai më tha: “Bëje gati kafshën tonë, se, me lejen e All'llahut, nesër do të udhëtojme për në Irak.”*

*Pastaj u ngrit menjëherë dhe, së bashku, shkuan në xhaminë e Profetit. Duhet të ketë qenë në mes kohës së namazit të drekës e namazit të pasdites, fali në xhami disa rekate namaz, pastaj ngriti duart dhe atë ditë unë mësova*

---

<sup>1</sup> Më poshtë do të flitet për të si njëri nga përcjellësit e dëgjuar e të besueshëm të Ebù Abdil-lahit (Paqja qoftë mbi të!).

<sup>2</sup> Edhe për këtë do të tregohet se është ndër përcjellësit e dëgjuar.

<sup>3</sup> Ky Dàùdi është ai që vrau El Mual'là ibn Khanijsin e që i mori pasurinë, madje ky ka dashur të vrasë edhe imam Sàdikun (Paqja e shpëtimi qoftë mbi të!) prandaj imam Sàdiku është lutur kundër këtij dhe All'llahu i Lartësuar e shpejtoi shkatërrimin e tij, ashtu siç do të shpjegohet në kapitullin: “Pranimi i duasë së tij”.

*përmendësh lutjen që ai këndoi: “O Ti që nuk ke fillim e mbarim<sup>1</sup>, o Ti që nuk ke kohë e përfundim...”*

*Safvâni tregon: “Unë i çova devenë Ebù Abdil-lahit. Sapo u ngrit në mëngjes udhëtoi për në Irak dhe arriti në qytetin e Ebù Xha’ferit.<sup>2</sup> U paraqit, kërkoi leje dhe e lejuan të hyjë.”*

*Safvâni ka thënë: “Disa, që janë ndodhur aty, kur imam Sàdiku ka hyrë te Ebù Xha’feri, më kanë njoftuar se ai, sapo e pa, e afroi pranë vetes. Pastaj kërkoi që t’i parashtronin përmbajtjen e padisë që kishte ngritur ai burri kundër Ebù Abdil-lahit (Paqja qoftë mbi të!) Në padinë e tij ai burri thoshte: “Mual’là ibn Khanijsi, shërbyesi i Xha’feri ibn Muhammedit mbledh taksat nga të gjitha anët dhe se me këto para ai ka furnizuar Muhammed ibn Abdullahun.”*

*Mensùri ia dha padinë Ebù Abdil-lahit dhe ai e lexoi. Mensùri iu kthye përballë dhe i tha: “O Xha’fer bin Muhammed, ç’janë këto para që vjel për ty Mual’là ibn Khanijsi?”*

*Ebù Abdil-lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Më ruajt All’llahu nga këto gjëra o Prijës i Besimtarëve.”*

*Mensùri i tha: “A betohesh për pafajësinë tënde me divorcin e me lirim nga skllavëria?”*

*“Po, tha ai, betohem në All’llah, se nuk ka asgjë të vërtetë nga kjo që thuhet.”*

---

<sup>1</sup> Në një tekst të kopjuar është “nuk zhdukesh”.

<sup>2</sup> Ky është Bagdadi, që në atë kohë quhej qyteti i Ebù Xha’ferit, sepse ishte ai që e ndërtoi. Shpërngulja e tij në Bagdad ka ndodhur në vitin 146 dhe mbase në po këtë vit ai e ka thirrur Sàdikun që të vinte aty.

*Mirëpo Ebù Xha'feri i tha: "Jo, betohu me divorcin e me lirim nga skllavëria."*

*Atëherë Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: "A nuk je i kënaqur me betimin tim në All'lah, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër?"*

*Ebù Xha'feri i tha: "Mos më mëso mua ligjin e fesë."*

*Atëherë Ebù Abdil'lahi i tha: "Ku do të shkosh me ligjin e fesë para meje o Prijës i Besimtarëve?"<sup>1</sup>*

*Mensùri përsëri i tha: "Lëre këtë se, që tani, do të të ballafaqoj me atë burrin që ka ngritur padinë kundër teje." E sollën atë burrin dhe e pyetën në prani të Xha'ferit (Paqja qoftë mbi të!) dhe ai burri foli: "Po, kjo është e vërtetë dhe ky është Xha'fer ibn Muhammedi. Ajo që unë kam thënë në atë padi është plotësisht e vërtetë."*

*Atëherë Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Betohu or burrë, se kjo që thua është e vërtetë!"*

*Burri tha: "Po dhe filloi të betohet, duke thënë: "Betohem në All'lah, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, në Kërkuesin, Mposhtësin, të Gjallin, të Përhershmin!" Por imam Xha'feri (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Mos u shpejto kaq shumë në betimin tënd, sepse unë do të mësoj se si të betohesh."*

*Por Mensùri i tha: "Çfarë s'pëlqen në këtë betim?"*

*Dhe ai tha: "All'lahu i Lartësuar, i Gjalli, Bujari turpërohet prej robit të Tij, kur ai e lavdëron dhe Ai t'ia*

---

<sup>1</sup> Nuk ishte se Mensùri s'kishte njohuri për betimin e Ehli Bejtit në divorcin e në lirim nga skllavit. Ata nuk mëkatonin e më pas të betoheshin, pasi ata nuk i ndajnë gratë e nuk i lirojnë skllavërit. Mensùri u përpoq të merrte vesh ndershmërinë e imam Sādikut.

*shpejtojë dënimin për lavdërimin që po i bën. Prandaj ti mor burrë thuaj: “Unë e dëlirë veten para All’llahut prej forcës e fuqisë së tij, mbrohem me forcën e me fuqinë time se unë jam i vërtetë e i drejtë për çka them.”*

*Mensùri i tha atij burri nga të kurejshëve: “Betohu me ato fjalë, që të mësoi Ebù Abdil’lahi.” Burri u betua, por pa e plotësuar të gjithë betimin u këput e ra i vdekur në tokë. Ebù Xha’feri, Mensuri, u trondit shumë nga kjo që i panë sytë e iu drodhën të gjitha gjymtyrët. Pastaj tha: “O Ebù Abdil-lah, që nesër nisu për në Xhaminë e Shenjtë të gjyshit tënd, nëse kjo të pëlqen. Nëse preferon të qëndrosh me ne, ne nuk do të lodhemi duke të respektuar e duke të bërë mirësi. Betohem në All’llah se, pas ditës së sotme, kurrë nuk do të pranoj fjalë prej asnjë njeriu.”<sup>1</sup>*

*E shtata: Sherijf Ebùl Kàsimi herën e shtatë ka përmendur një tregim prej Muhammed ibn Abdullah El-Iskenderijut<sup>2</sup>, i cili ishte nga të veçantët që e shoqëronin Mensùrin në pije e në argëtime. Muhammedi thotë: “Një ditë hyra tek ai dhe e gjeta të pikëlluar e të zhytur në mendime të zymta. Kishte një frymëmarrje të ftohtë. I thashë: “Ç’janë këto mendime o Prijës i Besimtarëve?”*

*Ai më tha: “O Muhammed, nga bijtë e Fàtimes kanë vdekur afërsisht më shumë se njëqind vetë<sup>3</sup> dhe ka mbetur*

<sup>1</sup> Këtë vepër të jashtëzakonshme (keramet) të Ebù Abdil’lahit (Paqja qoftë mbi tël) e kanë përmendur në librat e tyre shumë nga dijetarët e Ehli Sun’netit kur kanë folur për jetën e Sàdikut. Ndër ta janë: Esh’shebenlexhij në “Nùrul-Ebsâr”; Es’sibt në “Et’tedhkireh”; Ibn Talha në “Metàlibu-s’suël”; Ibn Es’Sab’bàgu në “El Fusùl”; Ibn Haxheri në “Es’Savàik”, etj.

<sup>2</sup> Nuk përmendet në librat e burrave tanë dhe prej tij nuk dimë ndonjë transmetim tjetër veç këtij transmetimi, të cilin e kanë përmendur të mëvonshmit. Vetë tregimi është shumë i qartë për të vërtetuar se ishte i prirur kah përkrahësit e pasardhësve të Aliut.

<sup>3</sup> Mendoj se ky tregim është pas vrasjes së Muhammedit e Ibrahimit, sepse lufta në Medine, në Bakhmerij dhe burgjet në Hàshimij’jej asgjësuan një numër të madh nga përkrahësit e Aliut (alevitë), përveç atyre që vdiqën nga rrahjet. Ka të ngjarë që ai, kësaj here, e ka thirrur në Bagdad.



*zotëria e imami i tyre.”*

*Muhammedi e pyeti: “Kush është ai?”*

*Mensùri iu përgjigj: “Xhafer ibn Muhammed Sàdiku.”*

*Muhammedi i tha: “O Prijës i Besimtarëve, atë e ka gërryer adhurimi dhe merret me All’llahun në kërkim të sundimit e të hilafetit.”*

*Mensùri i tha: “O Muhammed, unë kam mësuar se ti pohon imamatin e tij, por dije se sundimi është shterp, po e provoj në shpirtin tim dhe dua që të mos ngrysem pa shpëtuar prej tij.”*

*Muhammedi tregon: “Për All’llah, toka mu duk shumë e ngushtë, me gjithë gjerësinë që ajo ka.”*

*Pastaj ai thirri një shpatar dhe i tha: “Kur unë e Ebu Abdil’lah Sàdiku të jemi duke biseduar dhe unë të vë në kokë kësulën time, kjo do të jetë shenjë që e di vetëm ti e unë, atëherë menjëherë prijë kokën.”*

*Pas pak erdhi Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!). Unë e arrita kur po hynte në shtëpi dhe e pashë duke lëvizur buzët. Nuk e di se çfarë këndoi. Ndërkaq pashë se pallati lëkundej si të ishte një anije mes dallgëve të detit dhe vura re se Ebù Xha’fer Mensùri po ecte para tij zbathur, kokëzbuluar, dhëmbët i kërcëllinin dhe i dridheshin gjymtyrët, herë skuqej e herë zverdhej. Mori Ebù Abdil’lahin për krahu dhe e uli në fronin e tij. Rrinte para tij i frikësuar, ashtu siç rri skllavi para zotërsisë së tij. Ebù Abdil’lahi i tha: “Të erdha o Prijës i Besimtarëve, në bindje të All’llahut e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i All’llahut*

*qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe në bindje të Prijësit të Besimtarëve, All'llahu i shtoftë fuqinë!"<sup>1</sup>*

*Mensùri i tha: "Nuk të kam thirrur, gabimi është i korrierit."*

*Pastaj shtoi: "Ç'nevojë ke?"*

*Ai i tha: "Të lutem, mos më thirr pa pasur punë."*

*Mensùri i tha: "Ke këtë edhe të tjera."*

*Pastaj Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) u largua me të shpejtë duke falënderuar pa pushim All'llahun. Ebù Xha'fer Mensùri urdhëroi t'i sillnin një jorgan atllazi të kushtueshëm, u shtri të flejë, por gjumi e zuri vetëm pas mesit të natës. Kur u zgjua, unë isha ulur te koka e tij dhe për këtë u gëzua e më tha: "Mos dil derisa të fal namazet, që nuk arrita t'i fal se dua të bëj me ty një bisedë."*

*Pasi mbaroi faljen e namazit, erdhi pranë Muhammedit dhe i foli për gjërat e tmerrshme që kishte parë dhe që e frikësuan aq shumë në kohën e ardhjes së imam Sàdikut. Ato gjëra kishin qenë shkaku që ai hoqi dorë nga vrasja e tij e që i bëri aq shumë respekt e i dha aq gjëra të mira.*

*Muhammedi thotë: "I thashë Mensùrit: "Kjo nuk është për t'u çuditur, o Prijës i Besimtarëve, pasi Ebù Abdil'lahi është trashëguesi i diturisë së Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe gjyshi i tij është Prijësi i Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!)"*

<sup>1</sup> Nuk ishte ndonjë problem nëse në fillim do të kishte thënë: "Në bindje të All'llahut, të Dërguarit të tij e të Prijësit të Besimtarëve" edhe pse për Mensùrin nuk kishte bindje, por frika për jetën e bënte të detyrueshme të shkonte tek ai, pasi ruajtja ishte detyrë dhe nga mosvajtja do të merrnin fund të dy.

*gjithashtu, ai ka emrat e të gjitha lutjeve, të cilat, nëse do t'i këndonte kundër natës, do ta ndriçonte, nëse do t'i këndonte kundër ditës, me siguri do ta errësonte, nëse do t'i këndonte ato për dallgët e detit, deti i trazuar do të qetësohej.”<sup>1</sup>*

*Muhammedi vazhdon tregimin: “Pas disa ditësh i thashë: “O Prijës i Besimtarëve, a më lejon të shkoj për vizitë tek Ebù Abdil’lah Sàdiku?”*

*U përgjigj e nuk kundërshtoi dhe unë shkova tek Ebù Abdil’lahi. Hyra, e përshëndeta me “Selam” dhe i thashë: “Zotëria im, të lutem me të vërtetën e gjyshit tënd, Muhammedit, të Dëguarit të Zotit të gjithëfuqishëm të më mësosh lutjen që këndove kur hyre tek Ebù Xha’fer Mensùri.”*

*“Po, ty do ta mësoj.”*

*Imam Sàdiku i përshkroi Muhammedit rëndësinë e lutjes para se t'i mësonte fjalët e saj dhe pastaj i tha edhe lutjen, por ajo është e gjatë.<sup>2</sup>*

*Këto ishin disa nga sprovat që përjetoi imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) prej Mensùrit, por ai shpëtoi nga qëllimet e tij në sajë të lutjeve. Ibn Ràusi, Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!, ka përmendur edhe dy herë të tjera që*

---

<sup>1</sup> Kjo fjalë tregon se Muhammedi prirëj kah pasardhësit e Aliut dhe se si e shprehu këtë fakt vetë Mensùri. Por edhe kjo nuk përbën ndonjë çudi, pasi Mensùri e dinte më mirë se Muhammedi se cili ishte Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!).

<sup>2</sup> Nuk është se na ka shpëtuar pa i përmendur këto lutje, pasi ne i kemi mbledhur këto lutje. Janë afërsisht katërqind lutje që janë botuar në një libër në formatin e këtij libri, por jemi të vetëdijshëm se shumë lutje të tjera të tij nuk kemi mundur t'i gjejmë.

*Mensùri ka dashur ta vrasë imam Sàdikun, por All'illahu i Lartësuar, në të dyja herët, e ka larguar të keqen prej tij.*

*Disa nga këto sprova dhe shpëtimin e imam Sàdikut nga vrasja, në sajë të lutjeve të tij, i kanë përmendur autorë të dëgjuar, në pjesët që përshkruajnë gjendjet, në të cilat është gjendur imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!). Ndër këta autorë janë: Esh'Shebelenxhij në librin "Nùrul Ebsâr"; Es'sibt në librin "Et'tedhkireh"; Ibn Talha në librin "Metàlibu s'suël"; Ibnu Sab'bàgu në librin "El-Fusùlu Muhim'meh"; Ibn Haxheri në librin "Ës'savàik"; sheh Sulejmàni në librin "El Jenàbij'ë"; El Kulijnij në librin "El Kàfij" në kapitullin "Lutja", El Mexjlisij'ji në librin "El Bihàr", vëll. 11; Ibn Shehràshùb në librin "El Menàkib"; shejh Mufijdi në librin "El Irshàd", etj.*



*Shoqata*

\* \* \*

*Fladi*

### **QËNDRIMET E SÀDIKUT MDAJ MENSÛRIT DHE SHTETARËVE TË TIJ**

*Ndër mirësitë, që i janë dhuruar Ehli Bejtit, është edhe urtësia, domethënë njohja e sendeve të mira me diturinë e shumtë dhe me ligjin e fesë. Patjetër që kjo mirësi është njëra nga cilësitë e tyre të veçanta që i karakterizojnë ata. Ti mbase do të çuditeshe nga qëndrimet e Sàdikut ndaj Mensùrit e shtetarëve të tij. Herë do të shikosh se ai flet butë, duke u munduar të shfajësoje veten,*

*herë tjetër atë e trajtojnë me ashpërsi e me dhunë pa e njoftuar për asgjë, për personin e tij të lartë, edhe pse ky qëndrim i tij tingëllonte për të keq tek ata.*

*Imam Sàdiku e dinte mirë se ç'bënte e ç'fliste, ai tregohej i butë kur e dinte se butësia ishte mënyra më e mirë, por tregohej i ashpër vetëm atëherë kur e dinte se ashpërsia ishte e domosdoshme, pasi butësia nuk është veprim i lavdëruar në çdo kohë e në të gjitha rastet. Por dallimi ndërmjet qëndrimeve ka nevojë për urtësi në gjykim dhe dituri. Ne e pamë se ai i flet Mensùrit: "Betohem në All'Allah, as nuk e kam bërë, as nuk e lejoj e as është në medh'hebin tim, sepse unë jam prej atyre që përmbahen në bindjen tënde në të gjitha gjendjet. Për më tepër, kam arritur në një moshë që nuk e kam më fuqinë për të tilla punë. Pastaj, edhe sikur unë të kisha dashur, me siguri që do të isha në ndonjërin nga burgjet e tua, ku do të qëndroja derisa të më vinte vdekja. Tashmë ajo më është afruar shumë." Herë tjetër ai i flet Mensùrit me gjuhën e të Dërguarit: "Nëse ndalohesh, mirë, ndryshe e çojmë emrin tënd në gjykimin e All'llahut për çdo ditë nga pesë herë." Dy llojet e qëndrimeve të tij janë të shumta, por, ashtu siç e mësove deri tani, ato kanë qenë qëndrime të buta. Tani do të njihesh me diçka nga ashpërsia në qëndrimet e tij. Edhe pse ne nuk e njohim mirë atë kohë, për ne nuk është e panjohur as psikologjia e imam Sàdikut e as psikologjia e të vrarëve, gjithashtu për ne nuk është e panjohur as historia e ngjarjeve të asaj kohe.*

*Mensùri, edhe pse e vuri vendin nën sundim nën emrin e hilafetit, përsëri e dinte mirë se mbajtësi i postit të kalifit duhet të ishte pikërisht Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ashtu siç ishte mbajtës i të gjitha cilësive të larta e i të*

*gjitha virtyteve. Por edhe nëse puna do ta kishte sjellë, që ai të ishte i parë, Mensùri nuk mund të duronte njeri tjetër veç atij. Prandaj herë e sheh atë të gjerë ndaj izolimeve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) sepse Mensùri nuk ka dëshirë, që nga fjalët të shtohen armiqësitë dhe për pasojë shpirtërat të vlojnë nga brenda e të shkaktojnë atë që ai i frikësohet, kundërshtimet e kryengritjet. Dashuria e madhe për pushtet e pasuri është shterpësi, kurse vetë dashuria është e verbër dhe e shurdhër. Që të gjitha këto e shtynin Mesnùrin t'i shkaktonte Sàdikut vetëm të këqija dhe të shpejtonte për ta vrrarë atë. Por këtij qëndrimi të dytë të Mensùrit, Sàdiku i vinte përballë butësinë, me qëllim që ai të hiqte dorë nga tirania e sulmi.*

*Në fillim do të sjellim disa nga qëndrimet e imam Sàdikut ndaj Mensùrit e shtetarëve të tij. Në këto qëndrime ai shpall të vërtetën pa u merakosur për tiraninë e tij e për ashpërsinë e shtetarëve të tij.*

*Një ditë Mensùri e pyeti Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) për një mizë, e cila po fluturonte aq pranë fytyrës së tij, sa po e shqetësonte dhe i tha: “O Ebù Abdil-lah, përse e ka krijuar All'lahu mizën?”*

*Imam Sàdiku i tha: “Që me të të ulë hundën e tiranëve.”<sup>1</sup>*

*Mensùri heshti. Nëse do t'i kishte kthyer përgjigje imam Sàdikut, me siguri ai do të kishte lëshuar kundër tij një shigjetë akoma më të mprehtë, e cila me siguri do t'i shkaktonte plagë më të thellë.*

*Një herë Mensùri i shkroi: “Përse nuk na mbulon edhe ne ashtu siç mbulon njerëzit?”*

---

<sup>1</sup> “Nùrul Ebsàr”, e autorit Esh'shebenlexhij, f. 141.

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj: “Ne nuk kemi ndonjë gjë për të cilën të kemi frikë prej teje, por as ti nuk ke ndonjë nga punët e botës tjetër, që ne ta shpresojmë atë prej teje. Ti nuk ke ndonjë mirësi, për të cilën ne të urojmë. Ti nuk e shikon mirësinë si dënim, që ne të të ngushëllojmë. Ç’do të bëjmë ne tek ti?” Në një letër i thotë: “Kush dëshiron këtë botë, ai nuk të këshillon ty dhe kush dëshiron botën e ardhshme, nuk të shoqëron ty.”*

*Atëherë Mensùri tha: “Betohem në All’llah, ai ka dalluar se tek unë ka vend për atë që dëshiron këtë botë ndaj atij që dëshiron botën e ardhshme, si dhe atë që dëshiron botën e ardhshme e nuk dëshiron këtë botë.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Në të vërtetë, Mensùri nuk donte këshillë që do ta përmirësonte. Nëse ai do të dëshironte të përmirësonte veten, do të ishte larguar nga pushteti, që të mos mëkatonte në dëm të këtij ummeti, por në fakt ai donte të tërhiqte imam Sàdikun dhe ta bënte atë prej pasuesve të vet, pasi kështu njerëzit do të merrnin vesh se imami nuk është më mbrojtës dhe ndjekës i tij (shi’at) nuk do t’i referoheshin më Sàdikut. Për ata do të bëhej e qartë se ai tashmë ishte ndjekës i Mensùrit. Por imami nuk mund të jetë pasues i pushtetmbajtësve me zgjedhjen e vet. Nga ana tjetër, për Sàdikun nuk ishte i panjohur qëllimi i Mensùrit.*

*Kjo fjalë e tij na jep një mësim të lartë rreth qëndrimeve të njerëzve me mbretërit e me sundimtarët, si dhe për qëndrimet e atyre që i afrohen sundimtarëve,*

---

<sup>1</sup> “Keshful Gum’meh fij Ahvâli Sàdik” (Paqja qoftë mbi të!) cituar sipas “Et’tedhkireh” të Ibn Hamdunit, vëll. 2, f. 208.

*gjithashtu na mëson se si duhet të jenë qëndrimet e njerëzve të fesë ndaj sundimtarëve.*

*Një herë Mensuri, i zemëruar me Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!), e thirri dhe, kur ai hyri, i tha: “O Xha’fer, kam mësuar se i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) i ka thënë gjyshit tënd Ali ibn Ebij Tàlibit: “Sikur një grup prej ummetit tim të mos thoshte për ty atë çka thonë kristianët për Mesijhun, do të kisha thënë një fjalë për ty, që kur të kaloje ti ndër njerëzit, ata do të merrnin dheun e këmbëve të tua, që ta përdornin për shërim.” Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Në lidhje me mua, do të shkatërrohen dy dhe për këtë mbi mua nuk rëndon asnjë mëkat: një dashamirës, që e tejkalon kufirin në përmendjen e meritave dhe një urryes, që e zvogëlon vlerën time.”*

*Ai e tha këtë fjalë për të kërkuar ndjesë, sepse ai nuk është i kënaqur nga ajo që mund të thotë dashamirësi, që e tejkalon kufirin apo një urryes, që e kapërcen kufirin e arsyes. Nëse edhe Isai, i biri i Merjemit (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) do të kishte heshtur ndaj asaj që thoshin kristianët për të, patjetër që All’llahu do ta kishte dënuar. Ti e di se ç’rena e shpifje thonë njerëzit për ty, prandaj qoftë heshtja jote, qoftë miratimi yt, është zemërim i Llogarimarrësit; pasi shërbëtorët e Hixhâzitet dhe njerëzit pa zemër e mendje pretendojnë se ti je dijetari i të gjitha kohërave dhe mbajtësi i sekretit, je argumenti e përkthyesi i të Adhuruarit, je kutia e diturisë së Tij dhe peshorja e drejtësisë së tij, je feneri, me të cilin studenti kalon errësirën për të dalë në dritë dhe se All’llahu në këtë botë nuk e pranon punën e atij që nuk njeh pozitën e bujarinë tënde, kurse në Ditën e Gjykimit për të nuk do të vërë gjë*



*në peshoren e punëve. Për ty kanë thënë edhe attribute të tjera përveç këtyre. Kanë thënë ato çka nuk janë tek ti.*

*Mensùri tha: “I pari, që ka thënë të vërtetën, është gjyshi yt; i pari, që e ka vërtetuar fjalën e tij të drejtë, është babai yt, prandaj ti duhet të ndjekësh gjurmët e tyre dhe pasardhësit e tu të ecin në rrugën e tyre.”*

*Më pas tha: “Unë jam njëra nga degët e ullirit, jam njëri nga kandilat e shtëpisë profetike, shtruesi i sofrës, besëmarrësi nga bujarët e të nderuarit, jam njëra nga llambat e kamares, në të cilën është drita e dritave, jam fjala e pastër dhe e qëndrueshme e të përzgjedhurit të fundit deri në Ditën e Gjykimit.*

*Mensùri u kthye kah të pranishmit dhe tha: “Ky më ka futur mua në një det të trazuar nga dallgët, det pa anë e pa fund, në të cilin nuk orientohen dot as dijetarët dhe mbyten notarët, madje notarit edhe horizonti i ngushtohet. Ky i brengosur ka dalë të kundërshtojë lartësinë e kalifëve. Por këtë as nuk e lejoj që të internohet e as të vritet. Sikur mua dhe këtë të mos na bashkonte ajo pema rrënjëmirë, me degë të larta e me fruta të ëmbla e që ka begati të pasardhësit dhe është e shenjtëruar në shkrime, prej meje do të ishte ajo që nuk lavdërohet në fund.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Mos e prano te të afërmit e tu e te ata që ke në ngarkim nga familja jote fjalën e atij për të cilin All’llahu e ka bërë haram Xhennetin dhe për banesë i ka bërë zjarrin, sepse thashethemexhiu është dëshmitar i rremë, është ortak me djallin për çoroditjen e njerëzve. All’llahu i Lartësuar thotë: “O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë*

*lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.” (Sure “El Huxhurà”, ajeti 6)*

*Ne për ty jemi dishepuj e ndihmës, për ju jemi përforcues e kolona, ke urdhëruar për punë të mira e bamirësi, ndër shtetasit ke zbatuar dispozitat e Kur’ànit dhe me bindjen tënde ndaj All’llahut ke synuar t’i thyesh hundën shejtanit. Nëse është detyrë për ty të zgjerosh fushën e kuptimit e të shtosh diturinë, duhet të njihesh me edukatën e All’llahut: të mbash lidhjet me të afërmin, që i ka ndërprerë lidhjet me ty, t’i japësh atij që nuk të ka dhënë, të falësh atë që të ka bërë padrejtësi, sepse shpërblyesi nuk është mbajtësi i lidhjeve me të afërmin, në të kundërt mbajtës i lidhjeve me të afërmin është ai që ruan lidhjet me të afërmin edhe kur i afërmi i ka ndërprerë lidhjet me të. Mbaji lidhjet me të afërmit, që All’llahu të të shtojë jetën dhe të të lehtësojë llogarinë Ditën e llogaridhënies.”*

*Atëherë Mensùri tha: “E shpalose rëndësinë tënde, e kapërceve sinqeritetin tënd, por më fol për veten tënde me fjalë që për mua të jenë këshillë dhe pritë e vërtetë nga mëkatet e mëdha.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi tël) tha: “Ke detyrë të jesh i butë, sepse butësia është shtylla mbajtëse e diturisë. Frenoje veten, kur i ke shkaqet e fuqisë; nëse mbi dikë do të veprosh me aq sa ke fuqi, je si ai që i është afruar zemërimit, ose që dëgjon oshtimën e urrejtjes, ose që dëshiron të përmendet për punë të mëdha, por dije mirë, nëse përfundon me meritë, nuk do të ketë virtyt më të cilin të përshkruhesh përveç drejtësisë. Gjithashtu, gjendja që e*

*bën detyrë falënderimin, është më e mirë se gjendja që e bën detyrë durimin.”*

*Menjëherë Mensùri tha: “Më këshillove dhe bëre mirë, bisedove dhe fole përmbledhur.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Shembuj të tillë qëndrimesh të japin një mësim të mjaftueshëm për politikën, diturinë, besimin e për të tjera si këto që kishin njerëzit e asaj kohe. Tani do të njihemi me disa çështje:*

1. *Mensùri donte që imam Sàdiku të mos dilte me fasadën e imamatit, prandaj u mundua që ta mashtrojë atë para njerëzve me fjalë të buta. Është e qartë se këtu del në shesh edhe zgjuarsia e Mensùrit. Dihet se abasitët ishin ulur këmbëkryq në krye të kuvendit në emër të imamatit e hilafetit. Sikur të kishte një imam tjetër, gjysma e ummetit do të besonte se atij i takonte froni e kurora, për pasojë abasive nuk do t’u plotësohej urdhri, në një kohë kur donin që askush të mos i kundërshtonte në pushtetin e tyre. Prandaj Mensùri e largonte atë nga froni herë me ashpërsi e herë me butësi. Ishte në politikën e tij, që me Sàdikun të ballafaqohej me të tilla fjalë në prani të njerëzve, sepse ai besonte se imam Sàdiku, shumë shpejt, do t’i konsideronte të gabuara fjalët që thoshin njerëzit për imam Aliun. Me këtë rrugë ai arrinte atë çka dëshironte, sepse e dinte mirë që Sàdiku nuk do t’i kthente përgjigje nga frika e dhunës së tij.*

2. *Në të vërtetë, Sàdiku është imam me bërjen hyjnore, ashtu siç e beson ti dhe siç e besojnë të gjithë përkrahësit e pasardhësve të Aliut (shi’at) se imamati është te pjesëtarët e Ehli Bejtit, pra, është edhe te Sàdiku. Nuk*

---

<sup>1</sup> Domethënë e bëri atë të fuqishëm, që të hakmerrej ndaj vëllezërve të vet.

është se imamati doli në kohën e Mensùrit, por ai është që në kohën e mbajtësit të mesazhit. Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) u ndodh ndërmjet dy teheve të mprehtë: nëse do të ecte përkrah Mensùrit, do të ishte i detyruar të shpallte të gabuar imamatin hyjnor, nëse do ta kundërshtonte atë, nuk kishte siguri nga e keqja e tij, prandaj iu përgjigj me fjalë të përgjithshme, pa u deklaruar për imamatin dhe pa shpallur të gabuara fjalët që thoshin njerëzit për të. Ky ishte edhe shkaku që Mensùri tha: “Më fute në një det të trazuar nga dallgët, pa anë e pa fund.”

3. Fjalët e përkrahësve të pasardhësve të imam Aliut (shi’ave) janë ashtu siç kanë qenë edhe në atë kohë. Kjo është në përputhje me kërkesat e bazave të medh’hebit, ashtu siç tregojnë njoftimet për Ehli Bejtin dhe dituria që ata kanë lënë.

4. Heshtja e imam Sàdikut dhe mos prononcimi i tij për të zhvlerësuar fjalën e tij “ashtu siç thonë njerëzit”, është një argument se e vërteta e imamtit është pikërisht ashtu siç e tregoi Mensùri, duke përsëritur fjalët që thonë njerëzit. Nëse e vërteta e imamtit do të ishte diçka tjetër dhe jo kështu, Sàdiku, me siguri, do të kishte thënë: “Ky besim e këto fjalë janë të gabuara.” Madje do të ishte detyrë, që ai të njoftonte njerëzit se një besim i tillë është krejtësisht i gabuar. Prandaj njerëzit e kishin detyrë ta flaknin këtë lloj besimi.

5. Që Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ishte imam e pohonin shumë njerëz, por pikërisht ky pohim i njerëzve e bënte Mensùrin të mendonte e të kishte frikë se ky pohim mund të përhapej. Gjithashtu, ai kishte frikë edhe nga pasojat që mund të rridhnin nga ky pohim i njerëzve. Prandaj, për ta luftuar imam Sàdikun ai u mundua të zgjerohej në fjalë kundër tij.

6. Njeriu e mat veten me mundësinë më të vogël që ka, prandaj edhe për imam Sàdikun, nëse njoftimet e

dituria e tij nuk do të kishin parakaluar pozitën e tij, patjetër që fjala e tij do të përputhej me qëndrimet e tij. Kjo, nga ana e saj, tregon për rëndësinë e pozitën që ai kishte. A e pe si i rrëshqiti Sàdiku përgjigjes së Mensùrit, kur ai deshi ta hutonte? Ai nuk u prononcua në kundërshtim me fjalët që thuhën për përkrahësit e pasardhësve të imam Aliut (shi'ave), njëkohësisht nuk u prononcua as në favor të asaj që ata shihnin. Si mund të kuptohej ky shpjegim prej tij për personin e tij? Patjetër vetëm me gojëtarin, me fjalë të përzgjedhura e me kuptime të larta. Si do ta këshillonte ai Mensùrin me ato fjalë që u përshtaten mbretërve dhe që përputhen aq shumë me sprovat që ata kalojnë?!

Kjo është vetëm një pjesë e asaj që mund të shihet nga qëndrimi i tij dhe nga kuptimi i gjendjes së njerëzve në atë ditë. Por edhe kjo është e mjaftueshme, prandaj nuk nevojë për shpjegime të tjera.

Ai hyri tek Mensùri në njërën nga ato ardhjet e tij. Në derë e pritë Rebiju e i tha: “O Ebù Abdil’lah, është nxehur shumë zjarri i zemërimit të tij ndaj teje dhe e kam dëgjuar të thotë: “Betohem në All’llah, atij nuk do t’i lë dru hurme pa i prerë, pasuri pa ia marrë me forcë dhe pasardhës pa i skllavëruar.” Kur Sàdiku hyri, ai e përshëndeti me “Selam” dhe u ul.

Atëherë Mensùri i tha: “Dëgjo këtu, betohem në All’llah, kisha dëshirë që të mos lë për ju dru hurme pa e djegur e as pasuri pa e marrë me forcë.”

Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “O Prijës i Besimtarëve, All’llahu i Lartësuar e sprovoi Ejùbin dhe ai duroi, i dha Dàùdit dhe ai falënderoi, i dha fuqi<sup>(1)</sup> Jùsufit dhe ai fali, por edhe ti je nga ajo origjinë, e cila nuk vjen në ndonjë tjetër përveçse në atë që i ngjason.”

Mensùri tha: “The të vërtetën dhe unë ju kam falur.”

Atëherë imam Sàdiku tha: “Në të vërtetë, nëse arrin dikush të vrasë ndonjërin prej nesh të Ehli Bejtit, All’llahu ia ka hequr atij sundimin.” Mirëpo kjo fjalë ia shtoi zemërimin, prandaj Sàdiku – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të! - i tha: “Më qetë, a nuk ishte sundimi në dorën e pasardhësve të Ebù Sufjânit, kur Jezidi vrau Husejnin (Paqja qoftë mbi të!) dhe All’llahu ia hoqi atij sundimin kur atë e trashëguan pasardhësit e Mervànit; kur Hishàmi vrau Zejdin, All’llahu ia hoqi sundimin dhe e trashëgoi Mervàn ibn Muhammedi, kur Mervàni vrau imam Ibrahimin, All’llahu ia hoqi sundimin dhe ua dha ju. Mensùri tha: “The të vërtetën.”<sup>1</sup>

Unë them: “Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) nuk kërkoi ndjesë për fjalën e tij të parë. Në të kundërt, solli argumente në favor të saj, por nuk e përmendi vëllanë e tij Ibrahimin, me qëllim që me këtë kujdes të largonte sherrin e tij.”

Për imam Sàdikun mund të përmendin edhe shumë qëndrime të tjera të ngjashme, që atij i është dashur të mbajë ndaj Mensùrit.

Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka qenë i detyruar të mbajë qëndrime të ndryshme edhe ndaj shtetarëve të Mensùrit, qëndrime, të cilat, për nga ashpërsia, kanë qenë të ngjashme me qëndrimet që ai ka mbajtur ndaj vetë Mensùrit. Në Medine erdhi një prefekt i emëruar prej Mensùrit. Kjo ka ndodhur pas vrasjes së Muhammedit e Ibrahimit. Prefekti quhej Shejbeh ibn Ak’kâl, për të cilin Abdullah ibn Sulejman Et’temijmij thotë: “Ditën e Xhuma ai erdhi në xhaminë e Profetit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) u ngjit në minber,

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, Libri i lutjeve, kapitulli: Lutja në raste pësimesh të rënda, shqetësimesh dhe hidhërimesh, vëll. 2, f. 563.

*falënderoi All'llahun dhe pastaj tha: "Me të vërtetë, Ali ibn Ebij Tàlibi kundërshtoi bashkësinë e myslimanëve dhe luftoi besimtarët, sepse e donte pushtetin për vete, por atë e pengoi familja e vet, prandaj All'llahu e privoi atë nga sundimi dhe bëri që ai të vdesë në bukën e tij; gjithashtu edhe djemtë e tij ndoqën gjurmët e tij në përhapjen e ngatërresave e në kërkim të pushtetit, pa e merituar atë, prandaj tani janë të shpërndarë, të përgjakur e të vdekur në të katër anët e tokës."*

*Kjo fjalë e tij i rëndoi shumë njerëzit, por asnjëri nuk guxoi të nxjerrë qoftë edhe një shkronjë të vetme e jo më fjalë. Ndërkaq u ngrit një burrë dhe tha: "Falënderojmë All'llahun, paqe e shpëtim për Muhammedin, vulën e profetëve e të dërguarve, paqe e shpëtim edhe mbi të gjithë të dërguarit e profetët e All'llahut; për fjalët e mira që the. Ne jemi njerëz të mirë. Përsa i përket fjalëve të këqija që the, ti dhe zotëria yt jeni, në radhë të parë, ato që i meritoni ato. Thirri mendjes or ti, që i ke hipur kafshës së huaj, ti që ha nga furnizimi i tjetrit dhe kthehu ashtu i lidhur siç je."*

*Pastaj u kthye në drejtim të njerëzve dhe tha: "A doni t'ju them se kush do ta ketë të zbrazur peshoren e punëve në Ditën e Gjykimit dhe se kush do të jetë më i humburi? Ai që shet botën e tij të ardhshme me botën e tjetrit, ja ky është mëkatari më i madh."*

*Njerëzit heshtnin dhe prefekti doli nga xhamia pa thënë asnjë fjalë. Pyeta se cili ishte ai burrë dhe më thanë se është Xha'fer ibn Muhammed, ibn Ali ibn Husejn ibn Ali ibn Ebij Tàlib (Paqja qoftë mbi të gjithë!)<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> "Mexhàlis" e shejhut Tùsij, erëkëndshëm qoftë dheu i tij, kuvendi i parë.

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tregon: “Isha tek Zijàd ibn Abdullahu me disa nga të familjes sime dhe ai tha: “O bijtë e Fàtimes, çfarë ju lartëson ju mbi njerëzit?”*

*Ata heshtën, prandaj unë fola: “Nga meritat mbi njerëzit është se ne duam të jemi vetvetja, por edhe asnjë nga njerëzit nuk dëshiron të jetë prej nesh.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Shkuan tek ai me zar bixhozi dhe kjo fjalë, edhe pse e përmbledhur, ka përfshirë të gjitha virtytet dhe është me shumë argumente.”*

*Dàùd ibn Ali ibn Abdil’lah ibn Abbàsi ishte prefekt i Medines, i emëruar prej Mensùrit. Dàùdi arrestoi Mual’là ibn Khanijsin, shërbëtorin e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), me qëllim që t’i tregonte pasuesit dhe njerëzit e besueshëm të tij. Mual’là e injoroi e nuk ia tregoi, megjithëse Dàùdi i bëri presion, madje e kërcënoi se do ta vriste. Mual’là i tha atij: “Nuk merakosem për vrasjen, me të cilën ti më kërcënon. Beto hem në All’llah, ata, edhe sikur të ishin poshtë këmbës sime, unë kurrë nuk do të ngrija këmbën e t’i zbuloja. Nëse ti më vret mua, do të më lumturosh, por veten tënde do ta numërosh ndër më të këqijtë.”*

*Kur Dàùdi pa vendosmërinë e Mual’làsë për të mos treguar, e vrau dhe i mori pasurinë, që në fakt ishte pasuri e imam Sàdikut.*

*Kur imam Sàdiku u njoftua për këtë ngjarje, u ngrit i zemëruar, duke tërhequr rrobën e tij të poshtme, shkoi te Dàùdi dhe i tha: “Vrave shërbyesin tim dhe more pasurinë time. A nuk e di se burri fle mbi atë që ka humbur dhe nuk fle mbi luftën?”*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 47, f. 166 dhe f. 8, në kapitullin “Gjendjet e Sàdikut (Paqja qoftë mbi të).”



*Pastaj imam Sàdiku i kërkoi atij zbatimin e ligjit të fesë për vrasësin dhe ai i solli përpara personin që e kishte vrarë Mual'lânë, i cili, në fakt ishte shefi i policisë së tij. "Kur atë e sollën para, që ai ta vriste për të shpague vrasjen sipas ligjit të fesë, ai filloi të thërrasë me të madhe: "Më urdhërojnë të vras njerëzit për ta dhe pastaj më vrasin mua!"*

*Pas kësaj ndodhie Dàùdi i vuri nga pas imam Sàdikut pesëmbëdhjetë roje dhe i tha atyre: "Ma sillni këtu! Nëse ai nuk pranon të vijë, atëherë më sillni kokën e tij."*

*Ata hynë tek ai. Megjithëse e gjetën duke falur namaz, i thanë: "Përgjigju Dàùdit."*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: "E nëse nuk i përgjigjem?"*

*Ata thanë: "Na ka dhënë një urdhër."*

*Ai tha: "Shkoni, sepse ai është më i mirë për ju në këtë botë e në botën e ardhshme."*

*Ata këmbëngulën dhe e nxorën jashtë. Ndërkaq, ai ngriti duart, i vuri mbi supe, pastaj i ngriti lart dhe me gishtin e tij tregues filloi të lutej dhe u dëgjua të thoshte: "Në çast, në çast!" derisa u dëgjua një britmë e lartë dhe atyre u thanë: "Zotëria juaj vdiq, prandaj largohuni!"*

*Këto ishin disa nga qëndrimet e tij me shtetarët e Mensùrit. Për të vërtetën imam Sàdiku, shtyhej deri në ashpërsi e në zemërim, kur mendonte se fjala ishte më e rëndësishme se heshtja, edhe pse tregohej i gjerë në përdorimin e shpatës.*

## IMAM SÂDIKU NË IRAK

*Politika e abasitëve, puna e përkryer e shtetarëve të tyre dhe pa dyshim, ajo që ishte vendosur në caktimin e All'llahut, ishte shembja e sundimit të emevive dhe prerja e rrugës së fitores për përkrahësit të Husejnit e përhapjes së frymës së imamatit ndër njerëzit në favor të përkrahësve të Husejnit (Husejnijtë). Por ata gabuan në politikën e dhunës e të frikësimit, që ndoqën ndaj imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!), duke e thirrur disa herë në Irak. Me këtë veprim të tyre abasitët i shërbyen imamatit dhe vunë në dukje çështjen e Ehli Bejtit më shumë se ta kishin lënë atë të rrinte në vendin e vet.*

*Toka e Irakut është përzier me dashurinë për Ehli Bejtin që me fillimet e Islamit në këtë vend, sidomos kur, për një kohë të mirë qe kryeqyteti i mbretit të tyre. Në tokën e Irakut janë varrosur disa nga burrat e tyre të mëdhenj; gjithashtu, në tokën e Irakut janë zhvilluar ngjarje, që nuk do të harrohen kurrë as nga njerëzit e as nga historia, derisa të ketë njerëz mbi faqen e dheut dhe derisa historia të shkruhet, siç janë ndodhia e Taffit apo ndodhia e Zejdit.*

*Shikimi me sy dhe prania ka atë efekt që nuk e arrin me të dëgjuar, gjithashtu edhe bukuria qëndron në faktin se ajo i tërheq më shumë shpirtrat e tejdukshëm e ndjenjat e holla gjatë soditjes me sy se sa me të dëgjuar me veshë. Është e vërtetë se edhe disa gjëra bëjnë efekt më shumë*

*me të dëgjuar, sepse disa herë veshi ngjit para syrit. Por me të dëgjuar nuk mund të realizohet përshtkrimi i asaj që dëgjohet, sado e lartë të jetë shkalla e përfytyrimit për objektin konkret, pasi vetëm shikimi ballë për ballë i tërheq më shumë zemrat e ndjenjat.*

*Gjithashtu, është e vërtetë se edhe mizoria e padrejtësia ngjallin dashuri në zemra e mëshirë në shpirtra, veçanërisht kur personi, të cilit i është bërë padrejtësi është nga njerëzit e lartë e nga dijetarët e mëdhenj.*

*Në zemrat e njerëzve mbizotëron dashuria për imam Sàdikun vetëm me atë që kanë dëgjuar dhe besojnë në imamatin e tij me argumente. Atëherë ku është kjo dashuri, në krahasim me dashurinë që arrihet me të parë, me parashtrimin e argumenteve e me dëgjimin e shpjegimeve? Ardhja e Sàdikut në Irak qe një kurorëzim i familjes erëkëndshme, ishte një ekspozim i cilësive e i virtyteve të tyre të larta, pasi shpirtrat e njerëzve u impresionuan shumë duke dëgjuar këshillat e tij e duke parë gjërat e rralla që dilnin prej tij. Dashuria e tyre ndaj tij prirrej gjithnjë e më shumë, madje më shumë nga sa e kishin më parë, kur vetëm kishin dëgjuar për të, pasi jo të gjithë njerëzit shkonin në Haxh dhe ai të mblidhej me ta. Bisedat e tij të shumta i bënë pikërisht gjatë këtyre ardhjeve në Irak.*

*Të gjitha këto e rritën edhe jehonën e dhunimit e të padrejtësisë që i bëhej atij, pasi të gjithë njerëzit, ose shumica e tyre, e dinin tashmë se imam Sàdiku, në çdo ardhje i nënshtrohej padrejtësisë, dhunimit e shtypjes. Njerëzit tani i dinin të këqijat e torturat që i binin në çdo ardhje të tij. Mbi të gjitha këto, ishte zemërimi që u shkaktonte atyre besimi i njerëzve për pozitën e lartë të Sàdikut e për faktin se njerëzit tanimë merrnin vesh shtrëngimin që i bëhej atij nga të gjitha anët, si dhe masat*

*që ata merrnin për të penguar përhapjen e dijeve dhe të njohurive të tij.*

*As përkrahësit e pasardhësve të imam Aliut (shi'at) nuk kishin ndonjë njohuri të saktë rreth imamt, pozitës së tij, diturisë e veprave të jashtëzakonshme (kerameteve) që ai bënte, ashtu siç i njohën pas ardhjeve të tij, sepse vetë tekijja (ruajtja) nga armiqësia e pushtetit, në fakt e pengonin si një mur ndarës përhapjen e virtyteve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) për të cilin Amr ibn Ebij Mikdàm thotë: “Kur e vështroja atë, menjëherë e kuptoja se ai ishte nga pasardhësit e profetëve dhe ashtu siç thotë Ibn Talha në librin “Metàlibu-s’Su’l”: “Shikimi në të të kujton Botën e Ardhshme (Ahiretin), dëgjimi i bisedës së tij të bën të përkorë në këtë botë, veprimi sipas shembullit të tij të bën trashëgimtar të Xhennetit. Drita e bukurive të tij dëshmon se ai është pasardhës i profetësisë, pastërtia e punëve të tij flet me zë të lartë se ai është nga ata që kanë mesazhin.”*

*Ja edhe Hishàm ibn El Hakemi, i cili megjithëse ishte nga grupi i xhehmijve, thotë të vërtetën për imamat, kur thotë që imamati i përgjigjet plotësisht Sàdikut dhe i takon atij, por ajo, që ia mbushi atij shpirtin me madhësi dhe kënaqësi të veçantë dhe që ai e ndjeu në brendësi të vet, ishte shikimi në të, pasi vetëm atëherë ai konkludoi se kjo karakteristikë nuk mund të jetë te të gjithë njerëzit, por vetëm te profetët e te ata që mbajnë porosinë. Nga gjurmët e ardhjeve të tij në Irak është edhe udhëzimi i vetë Hishàmit në rrugën e drejtë. Ti tani e di se cili është Hishàmi, si dhe veprimtarinë e tij në shërbim të Ehli BEJTT e të fesë.<sup>1</sup>*

*Dokumente të shkruara vërtetojnë se ardhja e imam Sàdikut në Irak shënon edhe përcaktimin e saktë prej tij të varrit të Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi*

---

<sup>1</sup> Në lidhje me Hishàm ibn Hakemin kam shkruar një kumtesë, ku, me aq sa ka qenë e mundur, kam nxjerrë njoftime që flasin për të.

të!). Ndër përkrahësit e Aliut, ka orientuar pak veta për në varrin e Prijësit të besimtarëve, në një kohë që shumica e tyre nuk e dinin saktësisht vendin ku ndodhej varri, por dinin vetëm se varri i Prijësit të Besimtarëve ishte jashtë Kufes e në afërsi të Nexhefit. Këtë e dinin vetëm nga fakti që djemtë e tij luftuan, ashtu siç dinin se varri gjendej në një ndonjë vend të mënjanuar e që mbahej i fshehur nga frika e armiqve të tij. Ja, kështu, ky vend u bë për përkrahësit e pasardhësve të Aliut (shi'at) vend vizitash. Në çdo vizitë të tijën, imam Sàdiku ka shoqëruar për aty disa nga përkrahësit e tij. Gjithashtu, ai urdhëroi edhe Safuàn ibn Mehràn El Xhemmàlin që të ndërtonte një objekt mbi atë truall.

Shejhu i grupit, Muhammed ibn Hasan Et'Tùsij, e ka përmendur këtë fakt në librin e tij "Et'Tehdhib", kapitulli "Vendi i vizitës", pjesa: "Kufe", vendi ku përgatiteshin vizitat e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!)."

Gjithashtu, një shembull të ngjashëm kanë përmendur shejhu El-Kulejni, në librin "El Kâfij"; Sejjid Ibn Tàùs në librin "Ferhatul Gharij"; El Mexhllisiju në librin "Mezàrul Bihàr", vëll. 22; shejhu El Hurru'l Àmilij në librin "Uesàilu Shi'ah", vëll. 2 dhe shumë autorë të tjerë.

Për ty, nga këto vizita të imam Sàdikut do të sjellim disa e fakte. Shejhu Ebù Xha'fer Et'Tùsij ka thënë: "Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) e ka vizituar varrin e Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) disa herë. Njëra nga ato vizita ka ndodhur kur Seffàhu e solli në Hijreh me forcë. Nga këto vizita është edhe ajo që tregon Abdullah ibn Talha El-Hindij<sup>1</sup>, i cili thotë: "Shkova tek Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) dhe bashkë me të ecëm derisa arritëm

---

<sup>1</sup> Është arab nga Kufe dhe ka transmetuar për imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!). Për të kanë treguar një grup prej përcjellësish të besueshëm, si p.sh: Ali ibn Ismàil El Mejshemij, Muhammed ibn Sinàn dhe Ibn Mahbùbi.

*në një vend, ku dheu dukej si i lyer me ngjyrë të kuqe. Ai erdhi pikërisht aty dhe fali namaz në atë vend.”*

*Gjithashtu, ai ka përmendur ardhjen e tij një herë tjetër nga Hijreh, i shoqëruar nga Jùnusi ibn Dhabjàn<sup>1</sup> dhe thotë se ai është lutur e ka falur namaz pranë varrit. Me këtë rast Jùnusi e mësoi se ai është varri i Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), sepse vetë Jùnusi, para kësaj vizite, nuk e dinte saktësisht se ku gjendej varri i Prijësit të Besimtarëve. Dinte atë që flitej midis njerëzve se varri i tij gjendej në shkretëtirë.*

*El Kulejni ka transmetuar prej Jezid ibn Amr ibn Talha<sup>2</sup> dhe tregon: “Kur Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) ishte në Hijreh më tha: “A e dëshiron atë që të premtova?”*

*“Posi jo, - i thashë - dhe ishte fjala për të shkuar tek varri i Prijësit të Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!).”*

*Ai hipi mbi kafshën, edhe Ismàili i hipi kafshës. U nisa edhe unë së bashku me ata të dy dhe udhëtuam derisa arritëm në vendin e varrit, vend që ishte ndërmjet Hijres e Nexhefit, pranë disa shkëmbinjve, që dukeshin si të ishin të skuqur nga nxehtësia.<sup>3</sup> Aty zbriti, pas tij zbriti edhe*

---

<sup>1</sup> Është nga Kufe dhe prej atyre që kanë transmetuar për imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!). Gjithashtu, për të ka shumë tregime, që i vënë të meta, por ka tregime të tjera që e përmendin me fjalë lavdëruese. Gjithsesi, në lidhje me të kanë përcjellë tregimet e tyre një grup i madh përcjellësish të besueshëm, madje disa prej tyre janë pjesëtarë të grupit të dijetarëve.

<sup>2</sup> Është nga Kufe, prej tij nuk dihet ndonjë transmetim tjetër përveç këtij, por për të është e mjaftueshme ajo që ka treguar El Kelbij.

<sup>3</sup> Në tekst është “dhekeuât” që është shumësi i fjalës “dhekueh” që do të thotë thëngjill i tej skuqur, vend i nxirë. Por të dy këto emra nuk janë në përshtatje me vendin e nderuar. Mbase me këtë fjalë përshkruhen kodrinat e vogla që janë rreth varrit, të cilat i kanë krahasuar me thëngjijtë

*Ismàili dhe patjetër zbrita edhe unë. Aty ai fali namaz, fali namaz Ismàili, gjithashtu edhe unë fala aty namaz.”*

*Shejhu El Hurr ka përmendur se imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka vizituar varrin e Prijësit të Besimtarëve disa herë me radhë. Njëra nga vizitat është edhe vizita e transmetuar prej Sadùkut, - All'llahu e mëshiroftë! - dhe e përcjellë prej Safuàn ibn Mehràn El Xhemmàlit, i cili tregon: “Imam Sàdiku udhëtoi për në Kàdisijje. Së bashku me të udhëtova edhe unë. Vazhdoi udhëtimin derisa pa Nexhefin, vazhdoi rrugën derisa arriti tek shkëmbinjtë flakërues. Aty qëndroi dhe shkoi pranë varrit, përshëndeti me selam të gjithë profetët një e nga një me emër, duke filluar me Àdemin, gjithashtu edhe unë përsërita përshëndetjet me selam si ai, derisa erdhëm tek emri i Profetit tonë (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Pastaj ai ra mbi varr, e përshëndeti me selam dhe qau me zë të lartë. Unë i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'llahut i kujt është ky varr?” dhe ai më tha: “Është varri i gjyshit tim, Ali ibn Ebi Tàlibit’.”*

*El Mexhlisiju ka përmendur një vizitë, para së cilës ai kishte bërë disa vizita të tjera. Gjithashtu, në një formë tjetër ka përmendur vizitën që ka bërë i shoqëruar prej Safuànit. Në këtë vizitë imam Sàdiku i ka marrë erë dheut të Prijësit të Besimtarëve. Fryma i mbeti në fyt aq gjatë, sa unë kujtova se u nda nga kjo botë. Kur erdhi në vete, më tha: “Betohem në All'llah, ja këtu është varri i Prijësit të Besimtarëve!” Pastaj bëri disa vija të shumta si shkrime. Unë i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'llahut çfarë i ka*

---

*e tej skuqur, për shkak të shkëlqimit të fortë që lëshojnë, pasi ky vend, i quajtur “El Gira”, është ranor e me shkëmbinj të copëtuar si çakëll dhe që kanë shkëlqim e ndriçim.*

*penguar njerëzit e mirë të Ehli Bejtit, që të mos e bënë të njohur varrin e tij?”*

*Ai më tha: “Kujdesi për t’u ruajtur prej emevive e hauarixhëve, që të mos kurdisnin ndonjë mashtrim për ta përdhosur atë.” Është transmetuar prej Amr ibn Jezijdit<sup>1</sup> se ai ka shkuar tek Abdullah ibn Sinani<sup>2</sup> dhe, pasi kanë hipur mbi kafshët, kanë udhëtuar derisa kanë arritur në shtëpinë e Hafs El Kennasiut<sup>3</sup>, e kanë marrë edhe atë dhe së bashku kanë arritur tek shkëmbinjtë flakërues (El Garij). Përfundimisht kanë qëndruar tek varri dhe aty ka thënë: “Zbrisni, ky është varri i prijësit të besimtarëve!”*

*Abdullahu e ka pyetur: “Nga e mësove ti këtë?”*

*Ai i tha: “Kam ardhur këtu me Ebù Abdil’lahin (Paqja qoftë mbi të!) kur ai ndodhej në Hijreh. Nuk kam ardhur me të vetëm një herë. Pikërisht këtu ai më ka njoftuar se ky është varri i tij.”*

*Është transmetuar prej Jùnus ibn Dhabjanit se ai ishte tek imam Sàdiku në Hijreh, kur e kishte thirrur të vinte aty Ebù Xha’feri, në një rën nga ato netët e tij me hënë, kur ai frikësohej. Në vijim të tregimit ai thotë: “Ai hipi mbi kafshë, hipa edhe unë dhe udhëtuaam së bashku derisa arritëm tek shkëmbinjtë e tej skuqur. U afrua pranë një vendi të nxirë në të kuq dhe aty fali namaz, pastaj u kërrus mbi atë vend dhe qau derisa më në fund foli: “Ky është*

---

<sup>1</sup> Krerët e burrave kanë përmendur se me emrin Amr ibn Zejd janë dy vetë, njëri prej tyre është shitës mishi dhe tjetri kalitës i shpatave. Së bashku kanë transmetuar njoftime për imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) dhe nuk mund të përjashtohet që të jenë nga përcjellësit e besueshëm.

<sup>2</sup> Më poshtë do të përmendet ndër përcjellësit e dëgjuar.

<sup>3</sup> Është Ibn Abd Rabbih, është nga Kufe dhe ndër pasuesit e imam Sàdikut. Disa autorë kanë zbuluar se ai është nga imamijtë.



*varri i Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).”*

*Ka të ngjarë që ky tregim të jetë tregimi i parë i Jûnusit.*

*Prej Ebul Ferexh Es’Sindij<sup>1</sup> tregohet se ai ka ardhur prej Hijres së bashku me imam Sâdikun në vendin e shkëmbinjve të tej skuqur dhe ka vizituar varrin e Prijësit të Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!).*

*Një transmetim i ngjashëm bëhet edhe prej Abdullah ibn Ubejd ibn Zejdit<sup>2</sup>, i cili ka përmendur se Abdullah ibn Hasani ishte së bashku me të ka kënduar ezânin e ikâmetin dhe ka falur namaz së bashku me imam Sâdikun.*

*Ajo që duket sheshit në këtë tregim është se vizita ka ndodhur në kohën e Seffâhut, i cili e kishte thirrur Abdullah ibn Hasanin, ashtu siç kishte thirrur edhe imam Sâdikun (Paqja qoftë mbi të!). Gjithashtu, transmetohet prej Ebul Alâ’ Et’Tâ’ij<sup>3</sup> një bisedë e gjatë, në të cilën flitet për ardhjen e imam Sâdikut në Hijre. Tregohet se lajmi i ardhjes së tij u përhap edhe në Kufe, ashtu siç tregohet edhe për ata që rrinin në pritje të tij, për pyetjet që i janë bërë për varrin që ata e kishin aq pranë, por që nuk e dinin se ishte varri i Prijësit të Besimtarëve por që e vërtetoi fjala që tha imam Sâdiku: “Po, or shejh, betohem në All’llah, është e vërtetë.”*

---

<sup>1</sup> Emri i tij është Isà dhe numërohet ndër përkrahësit e imam Sâdikut e nga ata që kanë transmetuar njoftime për të.

<sup>2</sup> Nuk është përmendur te librat e burrave me të këtë titull, por është thënë se ishte nga përkrahësit e imam Sâdikut, megjithëse shumë vetë quhen Abdullah ibn Ubejd.

<sup>3</sup> Nuk ka qëndruar në gjendjen e tij.

*Prej Safuànit tregohet se ai shkonte tek varri, pasi imam Sàdiku i tregoi se ku ndodhej dhe se ka falur namaz pranë varrit njëzet vjet me radhë.”*

*Zotëria i nderuar Abdul Kerijm ibn Tàùs në librin “Ferhatul Garij” ka shkruar për ato vizitat që u thanë më lart dhe ka përmendur shumë ngjarje. Nuk është qëllimi që ty të të njoftojmë për të gjitha vizitat që janë transmetuar prej tij, pasi qëllimi është që ti të orientohesh drejt në këtë politikë gjakatare që shpikën e përpunuan abasitet kundër Ebù Abdil’lahit, imam Sadikut, gjithashtu, duam që ti të informohesh për rolin e madh të atyre ardhjeve, që nxorën në dritë akoma më mirë çështjen e Ehli Bejtit.*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) në çdo vizitë merrte për shok rruge një ose më shumë nga përkrahësit e tij, që t’u tregonte atyre vendin e varrit. Në një vizitë tjetër merrte për shoqërues të tjerë përkrahës dhe kështu me radhë, me qëllim që të rritej numri i atyre që e mësonin vendin e varrit, njëkohësisht të shtohet edhe numri i vizitorëve në këtë varr. Janë të shumtë burrat, që kanë transmetuar për këto vizita, ndër të cilët përmendim: Safuàn ibn El Xhemmàli, Muhammed ibn Muslim Eth’Thekafij, Ebù Besir, Abdullah ibn Ubejd ibn Zejd, Ebul Ferexh es’Sindij, Ebàn ibn Tagleb, Mubàrek El Khabbàz<sup>1</sup>, Muhammed ibn Ma’rùf El Hilàlij, Ebu Alà’ Et’Tàij, El Mual’là ibn Khanijs. Zejd ibn Talha, Umer ibn Jezid, Jezid ibn Amr, Abdullah ibn Talha En’Nehdij, Jùnus ibn Dhabjàn e të tjerë veç këtyre që u thanë.*

---

<sup>1</sup> Prej tij nuk njihet ndonjë transmetim tjetër veç këtij.

*Imam Sàdiku i ka dhënë një sasi dërhemësh Safuàn El Xhemmàlit, që ai të kryente punimet e rindërtimit të varrit, pas prishjes që kishte shkaktuar një rrjedhë uji e furishme. Nga kjo mësojmë se varri ishte i dukshëm, por ata, edhe gjatë vizitave të tij, nuk tregonin se ku ndodhej, me qëllim që të mos e mësonin emevitët e hauarixhët. Prandaj edhe Ebu Ala' pyeti për varrin që ata e shihnin: "A, ky është varri i Prijësit të Besimtarëve?" Në qoftë se ata nuk do ta kishin parë varrin të ngritur, nuk kishte përse ta bënë atë pyetje, por Safuàni e ka pyetur vetëm atëherë kur ai ra pa ndjenja mbi varr dhe vetëm atëherë i tha: "O nipi i të Dërguarit të All'llahut, i kujt është ky varr?"*

*Në kohën e imam Sàdikut, në sajë të vizitave të tij, njerëzit mësuuan ku ndodhej varri i tij, prandaj nuk e pyesnin më atë për varrin, por e pyesnin për edukatën e vizitës së këtij varri. Ndër ata, që e kanë pyetur, janë: Muhammed ibn Muslimi, Safuàni, Jùnus ibn Dhabjàni e të tjerë.*

*Nga gjurmët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) në Irak, gjatë këtyre vizitave, është edhe mihrabi i tij në xhaminë e Kufes, që ndodhet nga ana lindore e xhamisë, afër murit të saj dhe në afërsi të varrit të Muslimit, që është ndërmjet Ma'rùfit në Xhami. Por pranë tij nuk ka mihrab, përveç atij që u tha më sipër. Për këtë mihrab ka një falje namazi dhe një lutje që bëhet në mihrabin e tij në xhaminë Suhejl (Es'Sehleh), që ndodhet në mesin e xhamisë, për të cilin, gjithashtu, ka falje namazi e lutje. Shkaku për këto lutje është i njohur. Kur imam Sàdiku ishte në Kufe, tek ai ka shkuar Besh'shàr El-Mekàrij<sup>1</sup>, i cili e njoftoi se një polic*

---

<sup>1</sup> Nuk kam hasur në ndonjë përshkrim për të.

po rrihte në kokë një grua, të cilën po e çonte në burg. Ajo thërriste me sa zë kishte: “Më ndihmoni, për hir të All’llahut e të Dërguarit të Tij!” Asnjë njeri nuk afrohej ta ndihmonte. Imam Sàdiku pyeti: “Përse vepron kështu ai me atë grua?”

Besh’shàri i tha: “Dëgjova njerëzit të thoshin se ajo, duke qarë, ka thënë: “I mallkoftë All’llahu ata që të bënë padrejtësi ty, o Fàtime!”, prandaj edhe ai polici i bëri asaj atë që i bëri. Në këtë kohë Sàdiku e la ushqimin që po hante, qau aq shumë, sa nga lotët iu lagën shamia e dorës, mjekra e gjoksi. Pastaj imam Sàdiku dhe bashkë me të edhe Besh’shàri u ngrit me të shpejtë e shkuan në xhaminë “Es’Sehleh”. Aty fali dy rekate namaz dhe u lut<sup>1</sup>. Kur doli nga xhamia, erdhi korrieri dhe e njoftoi se atë gruan e kishin liruar. Patjetër që ky lajm e gëzoi shumë dhe i dërgoi asaj disa qepë. Më parë gruaja, megjithëse ishte nevojtare<sup>2</sup> kishte refuzuar të pranonte nga prefekti (vàliu) ndonjë gjë, edhe pse ai i kishte dhënë dyqind dërhemë. Edhe sot e kësaj dite njerëzit shkojnë në mihrabin e kësaj xhamie dhe lutën me këtë lutje për nevojat që kanë.

Në bregun e lumit në Kerbela është një faltore, nga ato që quhen “Husejnije”. Faltorja është me mihrab dhe brenda kësaj faltoreje ka një ndërtim, që i adresohet imam Sàdikut. Thuhet se ai ka falur namaz në këtë vend ditën që ka vizituar Husejnin -Paqja e shpëtimit qoftë mbi të!. Vizitën e tij tek imam Husejni (Paqja qoftë mbi të!) e ka përmendur Husejn Ibn Ebi Alà’ Et’Tàij në një njoftim të gjatë, për të cilin kemi folur më sipër dhe që e kanë përmendur Ibn

<sup>1</sup> Këtë lutje e kemi përfshirë në librin e lutjeve të tij, që kemi mundur të mbledhim.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuàr”, , f. 100, f. 440 dhe f. 21; “Mezàrul Bihàr”, vëll. 22, f. 103.

*Tàusi në librin “El Ferha” dhe El-Mexhlisiju në librin “El Bihàru fij Mezàrihí”.*

*Në një hadith thuhet: “I thashë atij: “Kurban t’u bëfshin nëna e babai im, ky varr që ti shkove, a është varri i imam Husejnit?”*

*Ai më tha: “Patjetër, betohem në All’llah, o shejh, kjo është e vërteta.”*

*Në anën perëndimore të Bagdadit, në bregun e lumit, nga e majta është ura e sotme perëndimore, që njihet me emrin “Ura e Vjetër”. Aty është një vend, të cilin njerëzit e thërrasin me emrin “Shkolla e imam Sàdikut”. Edhe pse në kohën e sotme nuk ka mbetur ndonjë shenjë prej saj, ka të ngjarë që aty njerëzit të kenë përfituar kur ai vinte në Bagdad në kohën e Mensùrit.*

*Është e habitshme që Khatibi, në “Historinë” e tij, nuk bën fjalë se imam Sàdiku ishte ndër ata që kanë ardhur në Bagdad, megjithëse ai ka përmendur djalin e tij, imam Qazimin dhe nipin e tij, imam Xhevadin (Paqja qoftë mbi të dy!).*

*Është e mjaftueshme kaq sa përmendëm për ndodhitë e imam Sàdikut gjatë ardhjeve të tij në Irak, kur atë e kanë thirrur Seffâhu e Mensuri. Këto ardhje të tij e shtuan akoma më shumë përhapjen e autoritet të EHLLI BEJTIT. Hekuri pastrohet me të nxehur.*

\* \* \*

## JETA E TIJ SHKENCORE

*Dituria e tij është frymëzim*

*Nuk ka virtyt si dituria. Te dituria qëndron jeta e lumturia e kombeve, përparimi e përjetësia e tyre; qëndron fama e njeriut, lartësia e pozicionit që ai ka dhe nderimi i personit të tij.*

*Nuk ka asgjë për t'u çuditur, nëse dituria është më e vlerësuar se adhurimi, sepse adhuruesi vepron drejt në rrugën e shpëtimit, por ama ka shpëtuar vetëm shpirtin e vet. Kurse dijetari është reformator, që ka mundësi të nxjerrë shumë të tjerë nga humnerat e rrugës së humbjes dhe, njëkohësisht, ka përmirësuar edhe veten. Dijetari i ka mbajtur sytë të hapur në rrugën që përshkon dhe ai, që mban sytë hapur, e shikon rrugën nga të gjitha drejtimet.*

*Ndër të gjitha virtytet, dituria është ajo që i përmirëson njerëzit. Prej saj ata kanë shumë dobi. Gjurmët e diturisë janë të qëndrueshme. Adhurimi, trimëria, bujaria e të tjera virtyte si këto, dobia që kanë njerëzit nga këto virtyte vazhdon për aq kohë sa të jetojë mbartësi i këtyre virtyteve dhe pas vdekjes së tij nuk ka më asgjë, përveç kujtimit të mirë. Dobia e dijetarit mbetet për aq kohë sa të jetë dituria e tij, për rrjedhojë, edhe gjurmët e tij janë të përhershme.*

*Në Sunnetin e pastër, dituria e dijetarët janë përmendur me lavdërimet më të larta. Gjithashtu, edhe në Kur'anin Kerim ka mjaft ajete që lavdërojnë diturinë e dijetarët. Në Kur'an kjo çështje është e plotë dhe nuk ka nevojë as të kërkohen dëshmues e as të nxirren argumente.*

*Por, problemi shtrohet nëse ky vlerësim me lavdërimet është i veçantë për diturinë e fesë e për dijetarët e fesë apo është përgjithësues për çdo dituri e për çdo dijetar. Që lavdërimi është veçanti e diturisë fetare dhe e dijetarëve të fesë, nuk ka asnjë dyshim, për vetë faktin se argumentet, që flasin për këtë çështje, janë shumë të qarta. Mjafton, që për këtë të sjellim fjalën e të Lartit: "Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, All'lahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës." (Sure "El-Fâtir", ajeti 28)*

*Është e vërtetë që frikën ndaj All'lahut e gjejmë vetëm te dijetarët e fesë, kurse te dijetarët e fushave të industrisë e të fushave të tjera të dijës, ka mundësi të mos e gjesh këtë frikë, madje disa prej tyre nuk pohojnë as*

*ekzistencën e All'llahut e as besimin se vetëm All'llahu është Zoti Një e i Vetëm.*

*Dijetarët e fesë e kanë merituar këtë vlerësim të lartë, për faktin se ata dëshirojnë të mirën për njerëzit, punojnë për gjetjen e rrugëve, që mundësojnë arritjen e së mirës. Ata do t'i gjesh udhërrëfyes, udhëzues për në rrugën e drejtë dhe shpëtues.*

*Dituria e fesë është e frymëzuar dhe e fituar. Në diturinë e fituar ndodh gabimi, saktësia dhe e vërteta. Por gabimi i dijetarit rëndon mbi gjithë botën, sepse njerëzit janë ndjekës të dijetarëve në dispozitat ligjore, në hallallin e në haramin, kurse All'llahu, me Madhërinë e Tij, do që njerëzit të punojnë vetëm sipas ligjit që Ai ka zbritur dhe vetëm sipas atyre dispozitave, që Ai ka ligjëruar. Atëherë është domosdoshmëri që midis njerëzve të jetë një dijetar që nuk gabon, që nuk harron e që nuk është i shkujdesur, me qëllim që ai të drejtojë njerëzit në ligjin e zbritur prej All'llahut të Lartësuar e në ato dispozita të ligjëruara prej vetë të Plotpushtetshmit, me qëllim që ummeti të mos bjerë në kurthet e gabimeve e të mos ngatërrohet në fijet e gjërave të kota. Por kjo është e mundur vetëm kur dituria e dijetarit është ose revelatë ose frymëzim.*

*Nga kjo del se është domosdoshmëri që dituria e profetëve dhe e atyre që ata i kanë lënë porosi të jetë e reveluar ose e frymëzuar, që ata të jenë të ruajtur për veten e tyre dhe për kombet, që të mos bien në gabim.*

*All'llahu i Lartësuar ka zbritur një ligj të vetëm dhe jo shumë ligje. Për çdo çështje ka një dispozitë dhe nuk ka shumë dispozita; për ummetin, në çdo kohë, Ai ka vënë një orientues dhe jo shumë orientues. Në ditët e sotme, ne*



*gjejmë për ummetin shumë ligje e ligjvënës të atyre ligjeve dhe nuk gjejmë një ligj e një ligjvënës të vetëm. Shikojmë se për çdo çështje ka disa dispozita dhe jo një dispozitë të vetme; në çdo kohë ka orientues që kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe janë në armiqësi të ndërsjellë, madje shpallin mohues disa të tjerë, ose disa që shfaqësohen nga disa të tjerë. Nuk ka një drejtues të vetëm... Por e gjitha kjo nuk është ajo me të cilën erdhi reformatori më i madh, i Dërguari i All'Allahut (Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe nuk është ajo që ai dëshiroi për ummetin e tij.*

*Nuk ka asgjë për t'u çuditur, nëse mendja gjykon se detyra e të Lartit, në të gjitha kohët, ka konsistuar në vendosjen e një dijetari, i cili të drejtojë njerëzit në rrugën e ligjit, ashtu siç janë zbritur dispozitat. Por a mund të jetë e vlefshme kjo për ndonjë tjetër përveç Aliut e bijve të tij? Para duarve ke njoftimet rreth diturisë së tyre, prandaj kërko që ato t'i lexosh, duke shpresuar se në to do të gesh dritën e udhëzimit për në rrugën e drejtë. Edhe nëse nuk do të kishim as njoftime e as argument tjetër, është plotësisht e mjaftueshme fjala e të Dërguarit të All'Allahut (Paqja dhe bekimi i All'Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): "Unë jam qyteti i dijes dhe Aliu është porta e tij.<sup>1</sup>", si dhe fjala tjetër e tij: "Unë po lë ndër ju dy gjëra të një rëndësie të veçantë, Librin e All'Allahut dhe degëzimet e mia, Ehli Bejtin tim."<sup>2</sup>*

*Siç shihet, Ehli Bejti janë dijetarët e ligjit të fesë dhe të Librit të All'Allahut, sepse ata e kanë marrë diturinë nga origjina e saj dhe e kanë pirë atë nga burimi i saj. Nëse*

<sup>1</sup> "Tàrikhu Bagdàd", vëll. 2, f. 377; "Kenzul Ummàl", vëll. 6, f. 156.

<sup>2</sup> "Musnedi" i Ahmed ibn Hanbelit, vëll. 4, f. 366; "Sahihu" i Tirmidhijut, vëll. 2, f. 308.

*dituria e tyre do të ishte e fituar, i Dërguari i All'llahut kurrë nuk do t'i veçonte ata nga njerëzit e tjerë dhe t'i bënte vetëm ata në jetë të jetëve dijetarë të Librit të All'llahut. Nëse njerëzit do të ishin të barabartë në dituri, nga se do të dalloheshin nga njerëzit e tjerë?*

*Ajo që tërheq vëmendjen është fakti se njerëzit gjithmonë kanë pasur nevojë për diturinë e tyre. Sa herë u janë referuar atyre për ndonjë problem, diturinë, që u duhej për problemin në fjalë, e kanë gjetur tek ata, prandaj kurrë nuk kanë pasur nevojë për diturinë e njerëzve të tjerë.*

*Nuk dëshirojmë të ta prekim ty këtë të vërtetë me njoftime pa dokumente, pasi dokumentet me informacionin që kanë, kanë më shumë vlerë për të vështruar në to. Njoftimet rreth tyre dëshmojnë për vërtetësinë e asaj që ata pretendojnë ose të asaj që të tjerët pretendojnë për ta. Ja, një çështje që i duhet kushtuar vëmendje. Imam Xhevadi (Paqja qoftë mbi të!) mori në dorë imamatin, kur ishte djalë shtatë vjeç dhe mbajti të gjithë barrën që ka kjo detyrë. I qëndroi në këmbë të gjitha punëve të mësimdhënies e të orientimit, ashtu siç i kishin qëndruar edhe të parët e tij. Dijetarët morën e përfituan prej tij dituri të nënshtruar dhe në diturinë e tij nuk u gjend ndonjë mangësi në argumente. Ja edhe Ali ibn Xha'feri, shejhu më i ri në moshë e me virtyte të larta i përkrahësve të Aliut (alevitëve) të kohës së tij. Kur erdhi imam Xhevadi, ai ngrihet e i puth dorën, kur ai del, i drejton këpucët. Kur është pyetur se kush do të jetë shpjeguesi pas imam Rizait, ai tha: "Ebù Xha'feri, djali i tij."*

*Dhe kur iu tha se ti je në këtë moshë e në këtë lartësi, por edhe babai yt, Xha'fer ibn Muhammedi thotë po të njëjtën fjalë për këtë djalë, iu përgjigj: "Unë ty të shoh djall." Pastaj e kapi për mjekre dhe i tha: "Ku qëndron hileja ime nëse vetë All'illahu e ka bërë atë të jetë i tillë dhe nuk ka bërë që këto thinja të jenë të përshtatshme për atë detyrë?"<sup>1</sup>*

*Duhet theksuar se babai i imam Xhevàdit është ndarë prej tij kur ndërmori udhëtimin për në Horasan. Në atë kohë ai ishte vetëm pesë vjeç. Atëherë, kush e edukoi dhe i dha kulturë atij pas babait të vet, derisa arriti në këtë pozitë të lartë? Sikur ajo që kishin ata të ishte me rrugë mësimi e edukimi, atëherë përse vetë mësuesi dhe edukuesi nuk e arrin atë pozitë, por e arriti vetëm ai?*

*Imam Xhevàdi vdiq në moshën njëzet e pesë vjeç dhe ti e di se një djalë në këtë moshë nuk arrin ndonjë gjë në dituri, edhe nëse gjithë jetën e ka kaluar në kërkim të diturisë. Atëherë, si është e mundur që ai është dijetari e orientuesi i ummetit dhe mësuesi e edukuesi i dijetarëve, duke shtuar se përkrahësit e pasardhësve të Aliut (shi'at) dhe dijetarët e tyre i janë referuar atij, që në ditën kur vdiq babai i tij, Rizai (Paqja qoftë mbi të!)?*

*E tillë është edhe çështja e pozitës për djalin e tij, imam Ali Hâdin (Paqja qoftë mbi të!). Imam Xhevàdi u nda nga kjo botë në një kohë kur djali i tij Hâdi ishte gjashtë ose tetë vjeç. Kush e edukoi dhe e bëri atë në këtë pozitë kaq të lartë? Si është e mundur që dijetarët dhe përkrahësit e pasardhësve të Aliut (shi'at) t'i referohen atij kur ai ishte*

---

<sup>1</sup> "Rixhâlul Keshà", f. 269 dhe f. 270.

*djalë i vogël? Çfarë do të kishte të mirë te një njeri në këtë moshë, nëse diturinë do ta kishte marrë me të mësuar?*

*Edhe imam Sàdiku, si të gjithë imamët, diturinë, as nuk e kishte dituri me të mësuar, as nuk e kishte marrë nga gojët e burrave dhe as e kishte mësuar përmendësh prej tyre. Nëse diturinë do ta kishte me të mësuar, atëherë prej kujt e ka marrë dhe ç'shkollë ka kryer? Në jetëshkrimin e asnjërit prej imamëve nuk rezulton që ai të ketë mësuar ose të ketë lexuar tek ndonjë njeri, madje edhe në moshën e fëmijërisë, asgjë nga këto nuk përmendet në jetëshkrimin e fëmijërisë së tyre; ose të shkruhet se ai është ulur në bankat e shkollës, ose ka mësuar Kur'ânin prej hafizëve, si të gjithë fëmijët e tjerë. Por jo! Dituria e imamit është vetëm me trashëgimi prej babait të tij, prej gjyshit të tij, prej të Dërguarit të All'llahut, prej Xhibrilit. Ky i fundit prej All'llahut të Lartësuar. Më poshtë do flasim për disa njoftime rreth diturisë së tij, si dhe për mësimin që ai u ka dhënë nxënësve të vet. Do të flasim edhe për disa çështje të tjera, që bëjnë pjesë në jetën e tij shkencore.*

#### *Shkolla e tij shkencore*

*Marrja e diturisë prej tij nuk ka qenë sipas atij modeli që e gjejmë sot në fushat shkencore dhe nga diskutimi në një argument të caktuar. Përkundrazi, nxënësit e tij, përveç një pakice, që të gjithë besonin në imamatin e tij dhe imamët, siç u shpjegua më sipër, presupozon se në diturinë e imamit nuk hyn as mendimi e as hulumtimi (ixhtihàdi), por imami diskuton i bazuar në burimin e në argumentin, prandaj puna e tij është hyjnore dhe e trashëguar. Ka të ngjarë që dikush mund ta pyesë për*

*shkakun e dispozitës, por kjo është pyetje për të mësuar e për të përfituar dhe nuk është pyetje as për kundërpërgjigje e as për polemikë.*

*Nga jo imamijtë, që kanë marrë dituri prej tij, ishin të atillë që e besonin madhësitinë, parësinë e imamatit<sup>1</sup> të tij, madje marrjen e ditorisë prej tij e kanë konsideruar një privilegj e nder të veçantë për gjithçka që kanë fituar nga dituria e tij.<sup>2</sup>*

*Edhe Ibn Ebu Hadidi i është referuar atij në shkencën e katër medh'hebeve (të katër shkollave juridike) për çështjet e fik'hut<sup>3</sup> (dispozitat e ligjit të fesë).*

*Pyetësi vinte tek ai dhe kërkonte të mësonte prej tij atë që e kishte të paqartë, madje shumica e atyre, që vinin tek ai, merrnin me vete edhe mjete shkrimi e letër, që të shkruanin atë që do t'i diktonte imami, që pastaj ai ta tregonte saktësisht.*

*Nëse me të vërtetë dëshiron të njihesh se deri ku arrin dituria e tij, shiko se sa shumë janë ata që e kanë njohur e që kanë marrë dituri prej tij, janë më shumë se katër mijë vetë. Përse vallë këta kanë treguar kaq shumë interes për të dhe nuk kanë treguar për të tjerë, edhe pse në kohën e tij kishte shumë dijetarë?! Përse kur ndonjëri prej tyre tregon për të, qëndron vetëm në të dhe nuk pyet prej kujt e ka përcjellë dhe çfarë i ka diktuar, por vetëm njofton atë që ka shkruar sipas diktimit të babait të vet dhe*

---

<sup>1</sup> "Tehdhibul Esmâi uel'lugâti ue jenâbi'ul Meueddeti".

<sup>2</sup> "Metâlibu Su'l".

<sup>3</sup> "Sherhu Nehxhul Belaga", vëll. 1, f. 6.

*babai prej gjyshit të tij, të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).*

*Kjo shkollë, nga e cila ka dalë ky numër kaq i madh nxënësish, nuk ka qenë shkollë që kishte si qëllim mësimin e diturive për të fituar emër, për të qenë i përmendur, për krenari e për të qenë i respektuar. Qëllimi i nxënësve të saj ishte të mësonin dituri për të qenë në shërbim të vetë diturisë, në shërbim të fesë e në shërbim të ligjit të fesë. Ai, që e kundërshtonte këtë vijë të shkollës, largohej nga rrethi i tij. Sa njerëz ka përzënë ai dhe sa të tjerë, që i janë kundërvënë atij, ka mallkuar! Prandaj këshillat e orientimet e tij vazhdojnë të jenë më përpara se mësimet e tij ose janë të shoqëruara me shpjegimet që ai ka dhënë.*

#### *Mësimet e tij për nxënësit e vet*

*Janë të shumta mësimet, këshillat e porositë e tij. Për të gjitha këto do të ketë kapituj të veçantë, por këtu do të përmendim vetëm ato që i përkasin kërimit të diturisë.*

*Amr ibn Ebul-Mikdàmi<sup>1</sup> ka thënë: “Ebù Abdil-lahi, (Paqja qoftë mbi të!) herën e parë, që hyra tek ai, më ka thënë: “Mësoni sinqeritetin para hadithit!”<sup>2</sup>*

*Sa këshillë e vlefshme! Kështu ka vazhduar ai të këshillojë të gjithë dashamirët e vet dhe çdo njeri tjetër që hynte tek ai. I këshillonte për sinqeritet e për të kryer emanetin. Në këtë këshillë nuk ka ndonjë qëllim, pasi në sinqeritetin e në kryerjen e emanetit njeriu arrin në këtë jetë lumturi, pasuri, autoritet, qetësi shpirtërore, kënaqësinë e qeverisë dhe të njerëzve.*

---

<sup>1</sup> Më poshtë do të flitet për të kur të trajtojmë përcjellësit e dëgjuar të tij.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Sinqeriteti dhe kryerja e amanetit”.

*Në lidhje me orientimin e tij në kërkim të diturisë, ai ka thënë shumë fjalë: herë thotë: “Asnjëherë nuk dua të shoh të rinjtë tuaj duke bredhur, por dua që ata t’i shoh ose dijetarë, ose prej atyre që mësojnë. Nëse ai nuk e bën këtë, atëherë do të tejkalojë masën, por ai që kalon masën, pëson humbje dhe, ai, që pëson humbje, mëkaton.”<sup>1</sup>*

*Herë tjetër thotë: “Kërkojeni diturinë dhe zbukurohuni me butësi e urtësi.”<sup>2</sup> Ai nuk kufizohej vetëm që t’i nxiste në kërkimin e diturisë, por i nxiste që të kërkonin edhe atë që i zbukuronte me diturinë, si: butësinë e urtësinë, madje i porosiste për kryeultësi, ashtu siç thotë në një fjalë të tij: “Jini modestë me atë që i mësoni dituri, jini modestë me atë që i kërkon dituri, të mos jini dijetarë brutalë, sepse atëherë e gabuara do të marrë të drejtën tuaj.”<sup>3</sup>*

*Sa këshillë e hollë, sa mësim i lartë, sepse dituria nuk i sjell dobi as vetë dijetarit e as njerëzve, kur ajo nuk është e shoqëruar me modesti dhe është e barabartë si për mësuesin, ashtu edhe për nxënësin, sepse njerëzit largohen prej mendjemëdhenjve, atëherë brutaliteti i asgjëson të drejtat që i takojnë të diturit.*

*Ai, për orientimin që i jep kërkuesit të diturisë, thotë: “Mos e kërko diturinë për tri gjëra: që me diturinë të dukesh, që me diturinë të krekosesh dhe që me diturinë të dyshosh. Por as mos e lë diturinë për tri gjëra: nga dëshira për të mposhtur injorancën, nga dëshira për të qenë i*

---

<sup>1</sup> “Mexhâlisu shejkhu Sudûk”, All’lalu e mëshiroftë, kuvendi 11.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 36 dhe f. 1.

<sup>3</sup> “Mexhâlisu Shejkhu Sudûk” kuvendi 17; “Bihârul Anuâr”, vëll. 2, f. 41 dhe f. 2.

*përkorë në dije dhe që të kesh turp prej njerëzve, sepse dituria e ruajtur është si llamba e mbuluar me kapak.”<sup>1</sup>*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) dëshiron që kërkimi i diturisë të jetë vetëm për atë dituri që i sjell dobi ummetit. Nëse njeriu e kërkon diturinë për hipokrizi, ose për t’u dukur, ose për të diskutuar gjëra pa vlerë, në këtë rast as kërkuesi s’ka dobi e as të tjerët s’shohin dobi prej kësaj diturie, në të kundërt, dëmtohet kërkuesi dhe të tjerët. Gjithashtu, edhe moskërkimi i diturisë nga dëshira për të qëndruar në injorancë apo nga frika që të mos jetë i përkorë në dituri, është veprim që, në fakt, zbulon marrëzinë. Nuk ka asnjë të mirë në turpin që të çon në veprime të ulëta e të largon nga virtyti. Dobia e diturisë për njerëzit arrihet vetëm me përhapjen e saj, pasi çfarë dobie ka nga llamba e mbuluar me kapak?!*

*Duke qenë se dituria është nga gjërat më të vlefshme, ai e ka nxitur kërkimin e diturisë, edhe kur ajo kushton shtrenjtë dhe ka thënë: “Kërkojeni diturinë, edhe sikur të përshkoni luginat e të çani valët e detit.”<sup>2</sup>*

*Duke qenë vetë minerali (ma’deni) i diturisë, ai i ndaloi ata që të merrnin dituri nga ata që nuk janë dijetarë: “Kërkojeni diturinë nga ma’deni i diturisë dhe bëni kujdes nga pseudodijetarët, se ata ju largojnë prej All’llahut.”<sup>3</sup>*

*Kemi shembuj që nxënësi ushqehet me shpirtin e mësuesit të tij dhe ngopet me mësimet e tij. Nxënësi është pranë rrugës së humbjes, nëse mësuesi i tij ka qenë në rrugën e humbjes dhe ai është më afër udhëzimit për në rrugën e drejtë, nëse mësuesi ka qenë udhëzues për në*

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 17, f. 270.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 35 dhe f. 5

<sup>3</sup> Libri “Zejudu Zerrâd”, është nga librat fundamentale, që merren në konsideratë me vlerësime.



*rrugën e drejtë, sepse instinkti i përngjasimit forcohet tek nxënësi, kur krahasohet me mësuesin e tij.*

*Ai jo vetëm që i ka nxitur në kërkimin e diturisë, por ka dashur prej tyre, që kur të mësojnë dituri, të punojnë me të. Për këtë ka thënë: “Mësoni dituri sa të dëshironi, por All’llahu kurrë nuk do t’ju sjellë dobi me diturinë, derisa ju të punoni me të. Shqetësimi i dijetarëve është përkujdesja, kurse shqetësimi i naivit është tregimi.”<sup>1</sup> Gjithashtu, ka thënë: “Dituria, me të cilën nuk punohet më të, është si thesari që nuk shpenzohet, ke lodhur veten për ta grumbulluar atë thesar dhe nuk e arrin dobinë e tij.”<sup>2</sup> Shembulli i atij që mëson të mirën dhe nuk punon me të, është si shembulli i një llambe që bën dritë për njerëzit dhe djeg vetveten.”<sup>3</sup>*

*Gjithashtu, ka thënë: “Dijetari, kur nuk punon me diturinë e tij, predikimi i tij rrëshqet prej zemrave ashtu siç rrëshqet uji i shiut prej kullësës.”<sup>4</sup>*

*Ai i ka orientuar ata, që të ruajnë atë që mësojnë: “Shkruani, sepse ju nuk do të mbani mend, nëse nuk shkruani.”<sup>5</sup>*

*Ja çfarë i ka thënë Mufeddal ibn Umerit: “Shkruaje diturinë dhe shpërndaje ndër vëllezërit e tu. Nëse vdes, shkrimet e tua i trashëgojnë djemtë e tu. Do të vijë një*

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 2, f. 37 dhe f. 54.

<sup>2</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 2, f. 37 dhe f. 55.

<sup>3</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 2, f. 37 dhe f. 56.

<sup>4</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 2, f. 39 dhe f. 68.

<sup>5</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 52 dhe f. 9.

*kohë, kur do të ngatërrohet dituria dhe ajo që i bën ata humanë, përveç librave të tyre.”<sup>1</sup>*

*Dhe ka thënë: “Ruajini shkrimet tuaja, sepse shpejt do të keni nevojë për to.”<sup>2</sup>*

*Ai nuk e deshi mirësinë e diturisë vetëm për njerëzit e kohës së tij, por e ka dashur për çdo brez e për çdo kohë. Gjithashtu, ai i porosiste ata që mësonin në mënyrë autodidakte, që, krahas diturisë, të arrinin të gjitha virtytet. Do të njihesh më poshtë me porosinë e tij, ashtu siç e mësove prej fjalës së tij.*

*Në të vërtetë, kur një burrë prej jush është strikt në përkushtimin e tij ndaj fesë, ai beson në hadithin, kryen emanetin dhe ka moral të mirë me njerëzit; është thënë se ky burrë është xha’ferij dhe kjo mua më gëzon, por edhe prej tij më futet gëzim. Nëse do të ishte ndryshe dhe jo kështu, te mua do të hynte e keqja e turpi i tij. Gjithashtu, është thënë se kjo është edukata e ima Xha’fer Sadikut.*

*Vetë imam Sàdiku e prindërit e tij më parë, si dhe djemtë e tij më pas, kanë luftuar për miredukimin e ummetit dhe orientimin e tij në virtyte, si dhe për largimin e tij nga veprat e ulëta me të gjitha mjetet; prandaj, ku është mashtrimi i tyre, kur njerëzit këmbëngulin për të mos ndjekur rrugën e së vërtetës dhe i rrinë në krah rrugës së gabuar?!*

*Aq sa ka nxitur kërkimin e diturisë, po aq ka nxitur edhe kujdesin ndaj dijetarëve e dashamirësinë ndaj tyre:*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 52 dhe f. 11.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 52 dhe f. 10.

*“Me të vërtetë, unë jam më i mëshirshëm me tre: me një të fuqishëm, që ka rënë poshtë, me një të pasur, që ka rënë në nevojë dhe me një dijetar, të cilin e ulin familja e tij e injorantët.”<sup>1</sup>*

*“Tre ankohen tek All’llahu i Lartësuar: një xhami e shkatërruar, në të cilën banorët nuk falin namaz, një dijetar mes injorantëve dhe një Kur’àn i varur, që ka zënë pluhur dhe nuk e lexojnë.”<sup>2</sup>*

*Is’hàk ibn Ammàr Es’Sajrefij<sup>3</sup> tregon: “I thashë imam Sàdikut: “A duhet të ngrihet më këmbë burri nga kuvendi i tij për të nderuar një burrë tjetër?” Ai tha: “Veprim i urryer, me përjashtim të rastit kur ngrihet për një burrë feje.” Gjithashtu, ka thënë: “Kush nderon një dijetar mysliman të dispozitave të ligjit të fesë (fakih), All’llahu do të jetë i kënaqur në Ditën e Kiametit dhe kush poshtëron një fakih mysliman, All’llahu do të jetë i zemëruar me të në Ditën e Kiametit.”<sup>4</sup>*

*Janë të shumta thëniet e tij për kujdesin, për dijetarët dhe për vlerësimin e tyre, si dhe për respektin e nderimin e tyre. Ja, kështu luftonte ai për të kulturuar ndjekësit e vet, për t’i edukuar ata dhe për t’u mësuar atyre moralet e larta.*

### *Hadithi*

*Tani e mësove se ata, që kanë përcjellë hadithe prej tij, janë më shumë se katër mijë. Shkrimi i haditheve ka qenë edhe para tij, por në kohën e tij u shtua më shumë dhe hadithi shkruhej për të gjitha dituritë e tij.*

---

<sup>1</sup> “Khisàlu Sudùk” f. 87.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 92 dhe f. 195.

<sup>3</sup> Në vijim do të vijë ndër përcjellësit e besueshëm dhe si njëri nga shokët e tij.

<sup>4</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 13, f. 44 dhe f. 47.

*Përkrahësit e pasardhësve të imam Aliut (shi'at) e merrnin hadithin prej tij si ai që e merrte prej Zotërisë së të dërguarve (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), sepse ata besonin pa asnjë mëdyshje e pa asnjë hulumentim se ajo, që është tek ai, është prej të Dërguarit. Prandaj ata e merrnin prej tij të sigurt e pa asnjë dyshim e pengim. Ata e pyesnin për të gjitha gjërat, për të cilat kishin nevojë, prandaj hadithi, i transmetuar prej tij, përfshin çdo gjë.*

*Kur përcjellësit janë më shumë se katër mijë, atëherë sa duhet të jetë numri i haditheve? Krerët e burrave kanë thënë se vetëm Ebàn ibn Taglebi ka transmetuar prej tij 30.000 hadithe, kurse Muhammed ibn Muslim ka transmetuar prej tij 10.000 hadithe, prej Bâkrit janë transmetuar 30.000 hadithe. Mos pyet sa hadithe ka transmetuar Xhâbir El-Xha'fiu. Vallë, a numërohen njoftimet me llojet e tyre të shumta, që janë transmetuar prej tij? Tani, ndër duart e njerëzve nga këto tregime, edhe pas humbjeve të shumta nga pakujdesia e disave, kanë mbetur aq sa të mbushen faqet e vëllimeve.*

*Kam mbledhur një pjesë të haditheve të transmetuara prej tij, prej të parëve të tij e prej djemve të tij në fushat e moralit, edukatës e të dispozitave në katër librat: "El Kâfij", "Men lâ jahduruhul-fakijh", "Et'Tehdhib" dhe "El Istibsâr". Hadithe ka mbledhur edhe mulla Muhsin El Fejd El-Kâshâni,<sup>1</sup> në librin "El Uâfij" dhe, kur El Hurr El Àmilij<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> Autor i shumë veprave të vlefshme. Thuhet se janë afro njëqind vepra, nga të cilat libri "El Uâfij" ka shpjegime të shumta për hadithet; apo libri "Es'Sâfij fit'Tefsijr" dhe varianti i shkurtuar i librit "Esh'Shâfij", si dhe librat: "El Mehaxhetul Bejdà fi Ihjàil Ahjài", rezume e librit "El Hakàik", "Mefâtihu sh'Sherà'i fil Fik'hi" "Ilmul Jekin", "Ajnul Jekin" e të tjerë libra. Ka vdekur në vitin 1091 të hixhrit.

<sup>2</sup> Ai është Muhammed ibn Hasan ibn Ali El Hurr El Àmilij. Libri i tij "El Uesàil" është nga librat më të vlefshëm edhe për nga pikëpamja e renditjes dhe e ndarjes së kapitujve. Ai e ka mbaruar së shkruari këtë libër

*gjeti libra të tjerë, që shërbenin veçanërisht si burim për dispozitat, i bashkoi me ato që gjendeshin në katër librat dhe shkroi librin e tij “Tefsilu Uesàili-sh’Shi’ah”. Të transmetuar prej tij, pa ndërmjetës, ishin tetëdhjetë libra, kurse të transmetuar me ndërmjetës ishin shtatëdhjetë libra.*

*Së fundi, dijetari En’Nùrij Mirza Husejn,<sup>1</sup> u përqendrua në disa libra të vlefshëm, që të ishin si materiale burimore. Në mënyrë të veçantë, ai mblodhi shumë gjëra për dispozitat dhe, sipas metodës së librit “El Uesàil” të El Hurrit, shkroi një libër, të cilin e emërtoi “Mustedrekul Uesàil”.*

*Kjo ishte vetëm për hadithet, që kanë lidhje me dispozitat, kurse për ato që kanë lidhje me moralin dhe edukatën, prej katër librave ka mbledhur vetëm “El-Kâfij” dhe më të shumtat janë të transmetuara prej tij. Nëse dëshiron të numërosh librat, që kanë transmetuar prej tyre dhe prej tij, do të dilte një numër shumë i madh. Vetëm shejhu Es’Sadùk Muhammed ibn Ali ibn Bâbùjeh ka shkruar dhjetëra libra me hadithet e tyre.*

*Të shumta janë edhe hadithet që ka mbledhur prej tyre dijetari El-Mexhlijs<sup>2</sup> në librin “Bihàrul Anuâr”.*

---

*në gjysmën e muajit Rexheb të vitit 1082 të hixhrit. Gjithashtu, ai ka shkruar edhe librin “Emelul Àmili”, që flet për dijetarët e malit Àmil. Ka lindur në vitin 1033 në datë tetë Rexheb në fshatin Meshgarah në malin Àmil dhe ka vdekur në Horasàn në datën 21 të muajit Ramazan të vitit 1104 hixhri.*

<sup>1</sup> *Autor i shumë librave të vlefshëm. Ka punuar shumë për mbledhjen e njoftimeve dhe shkrimin e librave. Ka vdekur në vitin 1320 hixhri.*

<sup>2</sup> *Ai është Shejhul Islami Muhammed Bâkir Ibnu shejh Muhammed Tekij El Mexhlijs, -Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!. Në kohën e vet ka qenë njeri me pushtet në shtetin e shahut Husejn Safeviut. Në grupin e tij shkencor mblidheshin një mijë nxënës. Përveç librit “El-Bihâr” ka shkruar edhe vepra të tjera të vyera. Ka lindur në vitin 1037 hixhri dhe ka vdekur në vitin 1110 hixhri ose në vitin 1111 hixhri në Asfahàn. Varri i tij është në këtë qytet edhe në ditët e sotme është i njohur dhe vizitohet.*

*Si të gjithë librat e zgjeruar, edhe në këtë libër janë përfshirë e sëmura dhe e shëndosha. Vetëm kur të lexosh disa prej librave të tij, do të mësosh se sa shumë ka në ato libra. Është e habitshme, që ky libër të jetë gjithëpërfshirës. Deri më sot nuk është shkruar një libër i tillë.*

*Disa dijetarë të kohës (All'llahu ua bëftë mbarë!)<sup>1</sup> i hynë punës për të mbledhur librin "Mustedrekun lil-bihâri" dhe deri më sot janë mbledhur një pjesë e madhe.*

*Imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi të!) i shtynte shokët e tij që të kishin dëshirë në tregimin e haditheve dhe i thotë Muâvijeh ibn Uehbit<sup>2</sup> për transmetimin e hadithit: "I dituri në çështjet e ligjit të fesë është më i vlerësuar se një mijë adhurues,, që nuk kanë as dituri rreth ligjit të fesë dhe as transmetime hadithesh.*

*Unë them: "Ti nuk ke përse të çuditesh nga kjo preferencë, sepse All'llahu i lartësuar dëshiron që robët e Tij t'i sjellin dobi njëri-tjetrit dhe të përmirësojnë njëri-tjetrin; adhuruesi është i mirë, kurse dijetari në fushën e hadithit e në fushën e dijeve të ligjit të fesë është përmirësues dhe i mirë."*

#### *Fik'hu*

*Fik'hu është njohja e degëzimeve të dispozitave, duke filluar me pastërtinë deri tek shuma për shlyerjen e gjakut. Të gjitha këto dispozita, shumica e të cilave janë të shpjeguara gjerësisht, janë marrë nga katër argumentet që janë: Sunneti, që është hadithi i të Dërguarit dhe tek shi'at*

---

<sup>1</sup> Është dijetar i madh në fushën e Sunnetit e të moralit. Mirza Muhammed Et'Tahrâniybanor i qytetit Samerâ në ditët e sotme.

<sup>2</sup> Ajo që duket qartë është se ky është El Bexhelij El Kufij, përcjellës i besueshëm dhe i lartë. Ka transmetuar prej imam Sâdikut e prej imam Qazimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka shkruar një libër sipas transmetimeve të një grupi përcjellësish të dalluar.

*edhe hadithi i Ehli Bejtit. Librat e shi'ave në fushën e fik'hut janë të marra nga argumentet e këtyre katër librave, por duhet thënë se shumica e Sunnetit janë hadithe të imam Sàdikut. Dhe, sikur të mos ishte hadithi i tij, dijetarët e fesë do të ishin shumë në mëdyshje për të nxjerrë pjesën më të madhe të dispozitave.*

*Jo vetëm juristët fetarë (fukahatë) shi'a kanë pasur nevojë për të, por edhe juristët fetarë bashkëkohës të tij kanë pasur nevojë ta marrin fik'h'un prej tij, siç kanë qenë Màliku, Ebù Hanifeh, dy Sufjanët, Ejjùbi e të tjerë, për të cilët do të mësoh në kapitullin përkatës, madje Ibn Ebul Hadidi në librin "Sherhu-n'Nehxhul Belaga" (6:1) edhe fik'h'un e të katër medh'hebeve ia referon atij. Kurse El Àlùsiju, në variantin e shkurtuar të librit "Et'Tuhfetul Ithnàsherijeh" faqe 8, thotë: "Ebù Hanifeh, që është nga të Ehli Sunnetit, krenohej kur thoshte shprehimisht: "Sikur të mos ishin dy vjetët, Nu'màni do të ishte shkatërruar." Me dy vjetët ai kishte qëllim ato dy vjet, që ka qenë në shoqërinë e imam Xha'fer Sàdikut për të marrë dituri."*

*Ishte plotësisht e drejtë që Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi tël) të ishte i vetmi fakih i Islamit, pasi është e mjaftueshme ajo sasi e madhe tregimesh dhe përcjellësish që kanë transmetuar prej tij. Nga përshkrimi i librave të haditheve mësove shumë hadithe prej imam Sàdikut, njëkohësisht u njohe edhe me shumë përcjellës, që kanë transmetuar prej tij, duke theksuar se bashkëkohës të tij kanë qenë shumë dijetarë në fushën e dispozitave të ligjit të fesë. Për asnjërin prej tyre nuk ka aq transmetues sa ka për të, askush nuk ka hedhur në treg dituri e fik'h aq shumë sa ka hedhur ai dhe për çdo gjë që pyet, ndalo në përgjigjen e tij.*

*Fik'hu është sistem i përgjithshëm për njerëzit, pasi feja nuk mund të njihet vetëm se me të. Nisur nga ky fakt, Sadiku i urdhëronte burrat e tij të bëheshin të ditur në dispozitat e ligjit të fesë dhe thoshte: “Një hadith për hallallin e haramin, që ti e merr prej imam Sàdikut, është më i mirë se kjo botë, me të gjithë arin e argjendin që ajo ka.”*

*Më pas ka thënë: “Mos të të shqetësojë kërkimi i kësaj bote mbi kërkimin e fesë tënde, sepse kërkuesi i kësaj bote ka të ngjarë që e humb atë dhe i shkatërrohen edhe ato që kishte marrë prej saj.”*

*Nga kujdesi i madh për të qenë i ditur në dispozitat e ligjit të fesë, ai ka thënë: “Ah sikur kamzhikmbajtësi të qëndronte mbi kokat e shokëve të mi, derisa ata të bëheshin të ditur në hallallin e në haramin.”*

*“Bëhuni të ditur në dispozitat e ligjit të fesë, sepse kushdo prej jush, që nuk i mëson ato, është si banorët e shkretëtirës.”. Kur është pyetur për fjalën “hikmet” (urtësi) në ajetin e Kur’ànit: “... dhe kujt i është dhënë urtësia, atij i janë dhënë mirësi të shumta...” (Sure “El Bekare”, ajeti 269), ai tha: “Në të vërtetë, urtësi është njohja dhe dituria e dispozitave të ligjit të fesë.”*

*Dijetari i dispozitave të ligjit të fesë është edhe njohës i hadithit. Për këtë ka thënë: “Njiheni pozitën e përkrahësve tanë sipas shkallës së transmetimeve që ata kanë përcjellë prej nesh, pasi ne nuk e konsiderojmë dijetar në dispozitat e ligjit të fesë (fakih) asnjërin prej tyre, derisa ai të jetë edhe i ditur në fushën e hadithit.”*

*Moralet*



*Dituria e moraleve në fillim nuk ka qenë e ndarë në kapituj, pasi moralet çukiteshin prej ajeteve të Librit të All'lahut<sup>(4)</sup>, prej fjalëve të Zotërisë së profetëve, prej thënieve të zotërisë së testamentmbajtësve dhe prej bijve të atyre të dyve. Në fakt, tek shi'at, shkrimin e librave në fushën e moraleve e ka filluar nga fundi i shekullit të dytë Ismàil ibn Mehràn ibn Ebu Nasr Es'Sekùnij dhe ishte nga pasuesit e Rizait -Paqja e shpëtimi qoftë mbi të!. Gjithashtu, ai është edhe nga përcjellësit e besueshëm, si dhe ka shkruar librin "Sifetul-mu'mini uel fâxhiri" - "Cilësia e besimtarit dhe e mëkatarit". Nga autorët, që kanë shkruar në fushën e moraleve gjatë shekullit të tretë është, Ebù Xha'fer ibn Muhammed ibn Khàlid El-Berkij, i cili ka qenë nga përcjellësit e besueshëm, gjithashtu ai është nga shokët e Rizait dhe nga përcjellit e besueshëm të tij. Libri i Ebù Xha'ferit "El Mehâsinu", është nga librat më të mirë. Ebù Xha'feri ka vdekur në Kum në vitin 274 ose në vitin 280. Nga autorët e këtij shekulli, që kanë shkruar vepra në fushën e moraleve, është edhe Hasan Ibn Ali ibn Shu'beh. Libri i tij "Tuhaful Ukùl", është libër me vlera të mëdha dhe përmban fjalë të urta, këshilla e morale nga të gjithë imamët. Më vonë, shkrimi i veprave në fushën e moraleve është zgjeruar. Vepra më e mirë në këtë fushë është libri "Usùlul Kâfij", me autor, argumentin e Islamit, El Kulejnij. Ka vdekur në vitin 329. Ka punuar për shumë vite për të shkruar këtë libër, derisa e bëri një përzgjedhje të haditheve e të përcjellësve të tij. Sikur të hidhje një vështrim të shkurtër mbi librat e tij, me siguri do të mësoje se ç'janë moralet dhe si është dituria e imam Sàdikut dhe e Ehli Bejtit për moralet.*

*Në qoftë se një shikues do të përqendrohej në këtë libër, patjetër që do të mësonte se burimi më i mirë për diturinë e moraleve pas Librit madhështor, është fjala e atij që ka pasur moralin më të lartë dhe fjala e atyre që kanë trashëguar çdo dituri e virtyt. Më poshtë do të hasesh me vërtetësinë e kësaj fjale, kur të lexosh në këtë libër “Përzgjedhje nga thëniet e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!)”.*

### *Komentimi i Kur’ànit (Tefsiri)*

*Në hadithet e transmetuara prej Ehli Bejtit, që ne i cekëm më sipër, ka material të shumtë për komentimin (tefsirin) e Kur’ànit, madje disa komentues (mufessirinë) të Kur’ànit, komentimin e tyre e kanë mbështetur kryesisht mbi hadithet. Nëse dëshiron të njihesh me diçka nga fjalët e imam Sàdikut për komentimin e Kur’ànit, lexo librin “Muxhmeul Bejàn”, autori i të cilit, në komentimin e tij, ka sjellë edhe nga hadithet e tij; gjithashtu ky autor ka treguar mendimin e Ehli Bejtit, që ai e ka nxjerrë prej hadithit të tyre.*

*Janë disa vepra, që flasin për dispozitat. Autorë të ndryshëm i kanë shpjeguar me atë që është thënë në komentimin për ato dispozita, duke treguar se ato janë marrë nëpërmjet rrugës së Ehli Bejtit e të haditheve të tyre. Ja edhe hadithi i ardhur prej Zotërisë së të dërguarve dhe i përcjellë në disa gradë e me disa rrugë: “Unë kam lënë ndër ju dy gjëra të rëndësishme: Librin e All’llahut dhe degëzimin tim, Ehli Bejtin tim. Përderisa ju të përmbaheni me këta të dy, kurrë dhe asnjëherë nuk do të shkisni në rrugën e humbjes pas meje, sepse ata të dy nuk do të ndahen asnjëherë derisa të kthehen tek unë në Haud (burim).” Hadithi na njuh me gradën e atyre që punojnë me Kur’ànin dhe na njofton se në çdo kohë prej tyre ka një*

*dijetar të Kur'ânit. Si ky hadith janë edhe hadithet e shumta të ardhura prej Ehli Bejtit, për pozitën e punës së tyre sipas Kur'ânit. Vetë imam Sâdiku thotë: “Betohem në All’llah, jam më i dituri në Librin e All’llahut, nga fillimi e deri në fundin e tij, si të jetë në pëllëmbën e dorës sime; në të janë njoftime të qiellit e njoftime të tokës, njoftime për ato që kanë qenë e për ato që janë, ashtu siç thotë i Larti në fjalën e Tij: “...në të ka sqarim për të gjitha sendet...”<sup>1</sup>*

*Herë tjetër ai hap gishtat, i ve mbi gjoksin e vet dhe thotë: “Tek ne, betohem në All’llah, është dituria e të gjithë Librit.”<sup>2</sup>, si dhe shprehje të tjera të ngjashme.*

*Patjetër që në çdo kohë duhet të jetë një dijetar, që të njohë Kur'ânin ashtu siç ka zbritur. Këtë e dëshmon hadithi i njohur me emrin “Hadithi thekalejn”, sepse Kur'âni është imam i heshtur. Në të ka ajete taksative dhe ajete që kanë fushë për hulumtim, ka ajete përgjithësuese dhe shpjeguese, të përgjithshme e të veçanta, ajete që i trajtojnë çështjet në përgjithësi dhe ajete që ato i trajtojnë të kushtëzuara, pa folur për ajete të tjera, që njerëzit nuk i dinë. Çdo grup islam pretendon se Kur'âni është burimi i besimit të tij, se ka arritur në kuptimet e tij dhe është udhëzuar në qëllimet e Kur'ânit, madje për këtë pretendim sjellin argumente. Sipas thënies së pjesëtarëve të grupeve islame, Kur'âni është burimi i të gjitha grupeve. Atëherë kush është arbitri ndarës, që do t'i përgjigjet fjalës e komentimit të Kur'ânit nga dyshimet e këtyre grupeve dhe pretendimeve të këtyre medh'hebeve? “Hadithi thekalejn” tregon se dijetarët e Kur'ânit janë degët e shtëpisë*

---

<sup>1</sup> Ka qëllim të tregojë fjalën e të Lartit: “...Ne të zbritëm ty Librin sqarues për të gjitha sendet...” (Sure “En’Nahl”, ajeti 89)

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 5 dhe f. 229.

*profetike, Ehli Bejtit dhe prej tyre në çdo kohë do të jetë dijetari i Kur'ânit.*

*Nëse imam Sàdiku, në kohën e tij, nuk do të ishte ai dijetari i Kur'ânit, atëherë kush tjetër do të ishte veç tij? Nuk ka njeri që të thotë se ndër pjesëtarët e Ehli Bejtit ka më të ditur se imam Sàdiku në fushën e komentimit (tefsijrit) apo në degë të tjera të diturisë.*

### *Apologjia (ilmul kelàm)*

*Me termin Apologji (ilmul-kelàm) kuptojmë atë dituri që studion Ekzistencën (Vuxhùd), Njëtimin (Teuhid), Cilësitë (Es'Sifât) dhe çka vjen si domosdoshmëri e këtyre studimeve: profetësinë, imamatin e ringjalljen dhe të gjitha këto argumente logjike, të ndërtuara mbi baza racionale të sakta. Me termin Apologji (ilmul-kelàm) nuk kuptojmë diturinë për polemikë, dituri në të cilën sillen vërdallë shumica e njerëzve, për shkak se mbështeten në veprime, në mendime e në iluzione, që u shkojnë në mendje, që i çojnë në fjalë të atilla, në të cilat del sheshit vetëm dëshira për të polemizuar, pa u mbështetur në ndonjë argument të sigurt, ose këtë dituri ta marrin nga minerali i vërtetë.*

*Nëse ka mangësi e qortim në gjuhën e bisedave të atyre që i shprehin kuptimet e shpirtit me fjalë, domethënë të atyre që e kanë mësuar polemikën për t'u dukur e për të qenë mbizotërues dhe nuk kanë pirë ujë në burimin e saj, ata nuk janë të përgatitur për rezultatet shkatërruese ku i çon fjala; kurse ata, që janë vaditur me burimin e dijes dhe e ndërtojnë polemikën mbi baza të vërteta e mbi kolona të genësishme, janë gjuhët e së vërtetës, janë udhëzuesit drejt së vërtetës dhe thirrësit në besim e orientuesit e tij.*

*I pari, që ka argumentuar Ekzistencën dhe domosdoshmërinë e Ekzistencës me argumente racionale e me dokumente të njohura, është Prijësi i Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), madje gati sa nuk u hodhën dyshime për ato fjalime, prej atyre që nuk e njihnin ose hiqeshin se nuk e njihnin pozitën e diturisë hyjnore të Ebù Hasanit, me pretendimin se të tilla baza nuk ishin të zakonshme në atë kohë. Nëse ky injorant nuk e di se dituria e Ebù Hasanit është me frymëzim, e cila vaditet prej burimit të pastër, atëherë ai nuk e di as atë që ka thënë Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në lidhje me të: "Unë jam qyteti i dijes dhe Aliu është porta e këtij qyteti."*

*Në avlëmendin e Ebù Hasanit e punuan këtë dituri edhe bijtë e tij, të cilët vazhdojnë të derdhin mbi njerëzit nga dituria e tyre e bollshme rreth Ekzistencës dhe domosdoshmërive të saj. Si do të adhurojnë njerëzit një Zot, që nuk e njohin, t'i binden një profeti, që nuk e dinë si është dhe të ndjekin një imam, që nuk e kuptojnë pozitën e tij?! Njohja është para çdo diturie, është më e mirë se çdo dituri. Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) thotë: "Adhurimi më i mirë është dituria për All'llahun."<sup>1</sup>*

*Në këto baza e kolona nuk ka ndonjë vend-hyrje për atë që merret me të dëgjuar, sepse imitimi i koncepteve është pa vlerë tek racionalistët.*

*Ndodh që një citim të vijë si argument, por edhe ai është orientim për gjykimin e mendjes, ose është shenjë që tregon krijimin e pastër, ashtu siç thuhet në fjalën e të*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", f. 21 dhe f. 215.

*Lartit: “Të dërguarit e tyre u thanë: “Vallë, a mund të dyshohet në Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?! Ai ju thërret juve për t’ju falur disa gjynahe tuajat dhe që t’ju lërë deri në afatin e caktuar”. Ata thanë: “Ju jeni vetëm njerëz si ne. Ju dëshironi të na shmangni nga ajo që kanë adhuruar të parët tanë. Andaj, na sillni prova të dukshme!” (Sure “Ibrâhim”, ajeti 10), si dhe ajete të tjera të Kur’ânit Famëlartë. Ky ajet i nderuar nuk të bën që të thuash se Ekzistenca është domosdoshmëri, por të tërheq vëmendjen në drejtim të shenjave dalluese dhe që ta shohësh.*

*Meqenëse argumentet për rregullat, mbi të cilat ndërtohen dispozitat, vijnë prej të Dërguarit dhe familjes, detyrimisht fjala e tyre për çështje të tilla është orientim për gjykimin e mendjes, pasi ata vazhdojnë të të orientojnë drejt argumenteve. Ja, vetë imam Sàdiku thotë: “Mendja është udhërrëfyese i besimtarit.”*

*Përsëri thotë: “Mbajtësi i njeriut është mendja.”<sup>1</sup>*

*Gjithashtu, thotë: “Nuk shpëton ai që nuk ka mend.”<sup>2</sup>*

*Sikur të lexoje atë, që imam Qazimi (Paqja qoftë mbi të!) i diktoi Hishàm ibn Hakemit, në lidhje me mendjen e të mençurit<sup>(4)</sup>, do të mësoje se si e kanë njohur ata të vërtetën e mendjes, ç’kanë treguar për mendjen dhe si kanë nxitur të tjerët për të kërkuar ndriçim me dritën e mendjes.*

*Në fjalët e tyre janë thënë shumë gjëra në kërkim të argumenteve për këto baza. Ja, në librin “Nehxhul Belàga” janë mbledhur shumë argumente, sa çudisin mendjet e*

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 26 dhe f. 29.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 12 dhe f. 13.

*hutojnë të mençurit; ashtu siç janë mbledhur shumë argumente të këtilla edhe në librat e hadithit e të teologjisë. Nga këto libra përmendim: “Ihtixhâxh” i Tabrasij, “Usûlul Kâfij”, “Teuhidu Sudûk”; vëllimi i parë e i dytë i librit “El Bihâr”, gjithashtu edhe në libra të tjerë, që i kanë shkruar imamët, fjala e të cilëve përmendet në shpjegimet që ata kanë dhënë.*

*Tani do të njoftojmë diçka që ka ardhur prej imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!) për disa nga këto baza.*

### *Ekzistenca (El Vuxhûd) dhe Njëtimi (Teuhid)*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka shkruar kumtesa të shumta për argumentimin e Ekzistencës e Njëtimin të All'lahut të Lartësuar. Njëra ndër kumtesat është edhe “Njëtimi i Mufeddalit”. Në fakt, këto kumtesa janë mësim, që ai i ka dhënë Mufeddal ibn Umer El Xha'fij El Kufij, që është njëri ndër shokët e tij, të cilët kishin bashkuar diturinë me punën. Kumtesa “El-Ihlijlexheh”, është transmetuar prej Mufeddalit, i cili Teuhidin (Njëtimin) e ka marrë prej tij gojarisht, kurse kumtesën e ka transmetuar me shkrim. Të dyja këto kumtesa dhe përcjellësit e tyre kanë shkëputje, por shpjegimi e bën të qartë për ty të vërtetën e lidhjes dhe, sikur të mos dilnin nga plani që kemi, do të sillnim të plota të dyja kumtesat, të shoqëruara me disa shpjegime të shkurtra. Megjithëkëtë, do të sjellim diçka nga dy kumtesat që u thanë, me qëllim që të mos mbetet i zbrazur ky udhëtim nëpër të tilla lidhje shpirtërore.*

### *Njëtimi (Teuhidi) i Mufeddalit*

*Në xhaminë e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) Mufeddali dëgjoi Ibn Ebul Auxhaë dhe përkrah tij edhe njërin prej shokëve të tij që, në intimitet, po përmendnin Profetin. Ishin të mahnitur prej urtësisë e lartësisë së tij. Më pas kaluan në çështjen e origjinës dhe Ibn Ebul Auxha' mohoi Ekzistencën dhe padrejtësisht thoshte se sendet filluan nga shkujdesja. Kjo fjalë e shqetësoi aq shumë Mufeddalin, sa nga zemërimi nuk e përmbante dot veten; pastaj iu kthye atij me të shara. Pas një ballafaqimi me dokumente, që u zhvillua ndërmjet të dyve, Mufeddali u largua dhe shkoi tek imam Sàdiku. Dëshpërimi ishte i dukshëm në të gjitha tiparet e tij dhe po mendonte për sprovën e rëndë që kishte rënë mbi Islamin e myslimanët prej mohimit të asaj bande e prej gjërave të gabuara që ata shprehnin. Imam Sàdiku, kur pa atë pikëllim të madh në fytyrën e tij, e pyeti si e kishte hallin. Ai e njoftoi përsa kishte dëgjuar prej atyre dy ateistëve dhe si i ishte përgjigjur atyre. Imam Sàdiku i tha: "Do të flas për urtësinë e të Lartësuarit në krijimin e botës, të egërsirave, kafshëve, shpendëve, insekteve dhe të çdo gjëje të gjallë me shpirt, bimëve e pemëve frutore e jo frutore, të farërave e të zhardhokëve, që hahen e nuk hahen, nga të cilat nxjerrin mësim ata që kërkojnë të marrin mësim dhe, që me njohjen e Tij, qetësohet besimtari e në këto mbeten të hutuar ateistët. Por eja nesër në mëngjes.*

*Dhe imam Sàdiku i foli Mufeddalit me hollësi e me qartësi, i ndriçoi argumentin e i sqaroi dyshimin, madje duke mos lënë fare vend për dyshim e as rrugë për dyshimin. I foli rreth krijimit të krijesave nga e para, për çuditë e mjeshtërisë së Tij, nga të cilat hutohen të*



*mençurit, e habiten mendjet. Ai nxori në dritë nga ato të fshehta të urtësisë së tij, prej të cilave nuk mund të udhëzojë askush përveç të ngjashmëve me të, të cilëve u është dhënë urtësia e gojëtaria.*

*Sa herë që jam munduar të përzgjedh pjesë të veçanta nga të tilla mrekulli, nuk e kam mbajtur dot, sepse që të gjitha i gjej pjesë të përzgjedhura. Edhe nëse do të doja, që në çdo lulishte të këpusja lulet e saj të freskëta, përsëri nuk do të kisha mundësi, sepse unë i shikoj të gjitha një lule të vetme në ngjyrë e në aromë. Prandaj kam menduar që të flas vetëm për fillimin e çdo pjese, duke të treguar diçka prej saj. Pjesët janë katër:*

- 1 -

*Pasi përmendi verbërinë e ateistëve, shkaqet e dyshimit të tyre, formësimin e kësaj bote, përbërjen e pjesëve të botës dhe përsosjen e tyre, tha: "O Mufeddal, do të fillojmë me krijimin e njeriut, prandaj vlerësoje këtë: "E para është sistemimi i fetusit në mitër, i mbuluar me tri errësira: errësirën e barkut, errësirën e mitrës dhe errësirën e placentës. Për të nuk ka ndonjë veprim as në kërkim të ushqimit, as të largojë ndonjë mundim, as të sjellë ndonjë dobi e as të sprapsë ndonjë dëm, sepse tek ai, nëpërmjet gjakut të menstruacioneve, vijnë lëndët që e ushqejnë atë, ashtu si ushqen uji bimët. Ky ushqim për të vazhdon derisa të plotësohet krijimi i tij: përsoset trupi, i forcohet lëkura e tij ndaj kontaktit me ajrin dhe shikimi nga kontakti me dritën, nënës së tij i vijnë shenjat e lindjes, të shoqëruara me dhembje, duke i sjellë asaj shqetësimin më të madh e më të fortë derisa ai lind. Kur lind, gjaku, që e kishte ushqyer deri tani, nëpërmjet gjakut të nënës kthehet në*

*gjirin e saj dhe aty i shndërrohet shija e ngjyra e bëhet një lloj tjetër ushqimi, që për të lindurin është shumë më i përshtatshëm se gjaku. Ky ushqim i vjen të lindurit me bollëk në kohën që ai ka nevojë për të. Qëkur lind, lëviz buzët në kërkim të qumështit dhe ai gjen gjinjtë e nënës së tij si dy enë të mbushura, të varura për nevojat e tij, ai vazhdon të ushqehet me qumësht, derisa trupin e ka të butë, zorrët të holla e gjymtyrët të brishta, derisa lëviz, atëherë ai ka nevojë për ushqim, që ka më shumë fortësi që të forcohet fizikisht. I dalin edhe bularësit, dhëmbët e dhëmballët, që me ta të kafshojë ushqimin e ta bëjë atë të butë, që ta kalojë në brendësi me lehtësi. Kështu do të vazhdojë derisa të kuptojë dhe kur të kuptojë, nëse është mashkull, i dalin qimet në faqe, që janë shenja të mashkullit dhe krenari e burrit që ka dalë nga caku i fëmijërisë e nga ngjasimi me gratë; nëse është femër, fytyra e saj mbetet e pastër nga qimet, që në atë të qëndrojnë gëzimi e njomësia, që i vë burrat në lëvizje për në atë që është vazhdimi e qëndrueshmëria e llojit.*

*Vështro me vëmendje o Mufeddal në ato që e sistemojnë njeriun në këto gjendje të ndryshme. A beson se është e mundur që kjo të jetë nga shkujdesja? Sikur gjaku të mos shkonte, kur ishte në mitër, do të thahej e do të dobësohej, ashtu siç thahen bimët, kur nuk i shkon uji. Sikur atë të mos e shtynin ujërat e lindjes në kohën që kishte përfunduar formimi i tij, a nuk do të mbetej ai në mitër si i murosur në tokë? Sikur qumështi të mos përputhej me lindjen e tij, a nuk do të vdiste ai nga uria, ose do të ushqehet me ushqim të papërshtatshëm e që nuk i bën mirë trupit të tij? Sikur atij të mos i dilnin dhëmbët në kohën e duhur, a nuk do të pengohej nga marrja e*

*ushqimit e kalimi i tij në brendësi? Në të kundërt, do të vazhdonte të ushqej me gjë. Për pasojë, trupi i tij nuk do të forcohej e nuk do të ishte i përshtatshëm për asnjë punë. Më pas nëna e tij merret me shërbimin e me edukimin e tij e të fëmijëve të tjerë. Sikur qimet të mos i dilnin në faqet e tij në kohën e vet, a nuk do të mbetej ai në formën e fëmijëve e të grave? Për pasojë ai nuk do të kishte as krenari e as autoritetin e burrit. Kush tjetër rri në vëzhgim të tij, që të gjitha gjërat të jenë në përputhje me nevojat e tij të domosdoshme, përveç Atij që e krijoi, duke mos qenë dhe pasi u bë, për të mirën e tij e mori nën kujdestari? Nëse do të ishte që shkujdesja të vinte me një sistemim të tillë, atëherë qëllimi dhe caktimi do të sillnin gabimin. Kjo është e pamundur, sepse që të dy, qëllimi e caktimi, janë e kundërta e shkujdesjes. Por kjo është shumë e rëndë të thuhet dhe është injorant ai që e thotë, sepse shkujdesja nuk mund të sjellë punë të bërë mirë, as kontradikta nuk sjell rregullsi, i lartë mbi çdo lartësi është vetëm All'illahu nga ato që thonë ateistët.”*

*Unë them: “Me të vërtetë shkujdesja gjithmonë sjell gabimin, ashtu siç e shohim konkretisht. A e beson se, kur ti e lëshon ujin në të mbjellat dhe lë pas dorë pjesëtimin e ujit në vijat, uji nuk do të shkojë në të gjitha vijat. A do të mbijnë farat nëse ti i mbjell në kohën e gabuar? A do të bëhet karrigia, nëse copat e dërrasës i bashkon me gozhdë jo sipas skicës që të është dhënë?”*

*Sikur fëmija të lindë i mençur e të kuptojë, nuk do ta njihete botën. Do të rrinte i hutuar e i trullosur kur të shikonte ato që nuk i di. Mbi të do të kalonin sende, që ai nuk i ka parë, kafshë e shpendë me forma të ndryshme dhe të gjitha gjërat e tjera, të cilat ai i sheh orë pas ore e*

*ditë pas dite. Bëj kujdes për këtë. Kur i rrituri i mençur shkon nga një vend në tjetrin, ai do të jetë si një i dëshpëruar që rri i hutuar, prandaj nuk nxiton të mësojë fjalët e të pranojë edukatën, ashtu siç do të nxitonte një i vogël që nuk kupton. Nëse njeriu do të lindte i mençur, do të gjente një errësirë, kur ta shihte veten në duart e të tjerëve, të pinte gjirin e nënës, i mbështjellë me pelena në djep, pasi për shkak të brishtësisë së trupit të tij, në kohën e lindjes ai ka nevojë për të gjitha këto; veç kësaj, ai nuk do ta gjente ëmbëlsinë që gjen fëmija, ai do të dilte në këtë botë i panjohur e i shkujdesur se ç'bëhet në familjen e tij dhe prandaj kontakti i tij me sendet kryhet me mendje të dobët, me njohje të mangët. Ai do të vazhdojë të shtojë njohuritë pak e nga pak dhe send pas sendi e gjendje pas gjendjeje, derisa të mësohet me sendet, të ushtrohet me to dhe vazhdon në to; atëherë ai del nga caku i meditimit e i hutimit dhe kalon në veprim e në vorbullat e jetës me mendjen e me lëvizjet e tij, kalon në vlerësim, në bindje, në harresë, në shkujdesje dhe në mëkate. Edhe këtu mund të sjellim një shembull tjetër: Sikur ai të lindë me mendje të plotësuar e i pavarur në vetvete, me siguri që do të shkonte në institucionet parashkollore të edukimit të fëmijëve; ai nuk do ishte i interesuar që prindërit të merreshin me fëmijën e me shqetësimet e tjera të prindërve ndaj fëmijëve, që ata pastaj t'ia shpërblejnë me mirësi e dashuri, kur të kenë nevojë për këto. Pastaj as fëmijët nuk do t'i donin prindërit e tyre e as prindërit nuk do t'i donin fëmijët e vet, sepse fëmijët nuk do të kishin nevojë për kujdesin prindëror. Ata do të largoheshin prej prindërve, që kur të lindin dhe kështu burri nuk do të njihte babën e nënën e vet. Duke mos i njohur femrat, me të cilat nuk lejohet martesë, për të nuk do të kishte asnjë ndalim që të*

*martohej me nënën, me motrën e me të afërmet e tjera. E keqja më e pakët, që mund të vijë nga kjo, madje më e shëmtuara, më e përbindshmja dhe më e urryera është sikur i linduri të dalë i mençur nga barku i nënës së tij dhe të mendojë gjëra që nuk i ka të lejuara, madje as i lejohet t'i shohë. A e shikon se si çdo send, në krijim, është vënë me përsosmërinë më të madhe dhe jashtë nga mundësia e ndonjë gabimi të vogël e të madh?”*

*Unë them: “Në disa pjesë të këtij shpjegimi të mrekullueshëm të imamit për periudhat e rritjes së njeriut dhe rritjes së tij në kohën e duhur, është e mjaftueshme që mendja të gjykojë se për atë ka një mjeshtër, që e ka punuar me dituri, me urtësi, me qëllim e me sistem të plotësuar.”*

*Pastaj imam Sàdiku foli mbi dobitë që kanë fëmijët nga e qara, nga tharja e lagështirës së lotëve, pasi qëndrimi i lagështirës rrezikon sytë e trupin.*

*Pastaj foli për gjymtyrët e trupit dhe për urtësinë e bërjes së çdo njëres prej tyre në atë formë që janë. Këtu Mufeddali i thotë atij: “O zotëria im, ka njerëz që thonë se kjo është punë e natyrës.” Atëherë imami i tha: “Pyeti ata për natyrën, a ka ajo ndonjë dituri e fuqi për të tilla punë apo nuk është e tillë? Nëse ata të përgjigjen se ajo ka dituri e fuqi, atëherë çfarë i pengon ata të vërtetojnë Krijuesin, pasi kjo është cilësi e Tij. Ata thonë se ajo i bën këto pa dituri e pa qëllim, megjithëse në punët e saj paska kaq përsosmëri, urtësi e dituri, ashtu siç e sheh edhe ti, por kjo është punë për Krijuesin, të Urtin dhe se ajo, që ata e kanë emërtuar natyrë, është rrugë e vijueshme, në të cilën Ai krijon krijesat e Veta.”*

*Unë them: “Shiko te natyralistët. Ata kanë ecur në një linjë të vetme që nga koha e imam Sàdikut dhe deri në ditët tona, sikur të mos kenë menduar fare këtë përgjigje të prerë ndaj argumenteve të tyre ose si të kenë mbyllur sytë e të këmbëngulin me inat e me mohim.”*

*Imami e reduktoi natyrën ndërmjet dy nocioneve pa të tretë: “Ajo ose duhet të ketë dituri, urtësi e fuqi ose të mos ketë asgjë nga këto; nëse është e para, ajo ka atë që ne e vërtetojmë për Krijuesin. Atëherë nuk ka ndryshim ndërmjet tyre e ndërmjet nesh veçse në emërtim; nëse është e dyta, është e domosdoshme që gjurmët e saj të jenë të paqarta, pa caktim, pa sistem, pra, është si puna e atij që nuk mendon, nuk shikon dhe nuk dëgjon në punët e tij, në një kohë që ne i shohim gjurmët të ndërtuara me dituri, urtësi, fuqi e caktim, rrjedhimisht puna nuk është e një natyre të verbër e shurdhe dhe se kjo natyrë qenka diçka tjetër e jo All’llahu, i Dituri, Fuqiploti, Rregulluesi. Për pasojë, vetë natyra nuk mund të jetë gjë tjetër veçse rruga e Tij në krijim dhe nuk mund të ketë ndonjë gjë që të jetë e pavarur prej Krijuesit të gjithësisë.”*

*Pastaj imami u kthye në fjalën e tij të parë rreth arritjes së ushqimit në trup, foli për mënyrën e kalimit të këtij ushqimi të kulluar nga stomaku në mëlçi, në enët e gjakut të trasha e të holla që janë aq të ndërthurura njëra me tjetrën e që janë si një rafineri për ushqimin; pastaj ky ushqim bëhet gjak e kalimi i tij nëpër të gjithë trupin nëpër vendrrjedhat e përgatitura për këtë proces; pastaj mënyra e pjesëtimit të tij në trup, duke dalë edhe teprica e tij; imami shpjegon si të ishte mjek i mbaruar dhe që nuk gjendet një i dytë si ai në fushën e mjekësisë, ose si të ishte një dietetar i shkëlqyer në fushën e anatomisë, që gjithë jetën e ka*

*kaluar në operacione autopsie, madje imami, me këtë shpjegim, zbuloi qarkullimin e gjakut, për të cilin mburren perëndimorët, se janë ata që e kanë zbuluar. Gjithsesi, imami i ka parakaluar ata në këtë fushë afërsisht dymbëdhjetë shekuj më parë.*

*Pastaj e drejtoi fjalën e tij në formimin e në rritjen e trupit etapë pas etape dhe shpjegoi se All'illahu e ka nderuar njeriun dhe e ka dalluar atë në krijim nga të gjitha kafshët; pastaj vazhdoi fjalën me shqisat, me të cilat All'illahu e ka veçuar njeriun; foli për dobitë e shqisave dhe tregoi se Ai i ka bërë ato në formën që ato kanë dhe efekti i specialitetit të çdonjërës prej tyre nuk e kalon efektin e së dytës. Ja kështu vazhdon shpjegimin e tij për gjymtyrët e organet, një e nga një apo edhe të dyzuara, si dhe shkaqet për të cilat, ndërtimin e tyre, Ai e ka bërë në këtë formë ndërtimi. Vazhdon shpjegimin e tij për mirësitë që i ka dhuruar Madhështori, si ushqime e pije, si dhe dallimet, që ai ka bërë në krijim, saqë asnjë njeri nuk ngjason me tjetrin.*

*Vazhdoi shpjegimin dhe tha: “Sikur të shikojë një figurë njeriu të fotografuar në mur dhe dikush të thoshte se kjo figurë doli këtu vetvetiu dhe nuk e ka bërë askush, a do ta pranoje ti këtë? Jo, madje edhe do të talleshe me të. Si e mohon këtë për një figurë të ngurtë, të fotografuar dhe nuk e mohon te njeriu i gjallë që flet?”*

*Unë them: “Sa argument i fuqishëm, sa shpjegim i lartë! Kushdo, që shikon te njerëzit e çdo shekulli, do të thotë: “Ai, për njerëzit e kohës e të shekullit të tij, solli ato argumente e atë metodologji, që e gjeti të përshtatshme për shpjegim e për argumentim.”*

*Ditën e dytë i shpalosi Mufeddalit pjesën e dytë, që bënte fjalë për krijimin e kafshës. “Po filloj për ty me përshkrimin e kafshës, që ta kesh të qartë punën e saj dhe të krijesave të tjera. Pa mendo për ndërtimin e trupit të kafshës e formën që ajo ka? Trupi i saj nuk është i ngurtë. Nëse trupi i saj do të ishte i tillë, kafsha as nuk do të lakohej e as nuk do të vepronte; por trupi i saj nuk është as tepër i butë e me muskuj të dobët, ndryshe nuk do të ngarkohej e nuk do të kishte pavarësi në vetvete. Trupi i saj është i bërë prej mishi të butë e të lakueshëm, i ndërthurur me kocka të forta. Nga të gjitha pjesët, trupin e kafshës e përshkojnë nerva e damarë, që e forcojnë dhe e bashkojnë. Mishi e kockat janë të vëna njëra mbi tjetrën dhe mbi to është lëkura, e cila mbështjell të gjithë trupin.*

*Ngjasojnë me kafshën edhe ato kukullat që punohen me dërrasë, të cilat bëhen të çara e forcohen me penj, pastaj nga sipër lyhen me rrëshirë. Po bëjmë një analogji të këtyre pjesëve: dërrasat janë në vend të kockave, të çarat në vend të mishit, penjtë në vend të nervave e të damarëve dhe lyrja me rrëshirë në vend të lëkurës; nëse pranohet që kafsha, që lëviz, është e ardhur nga shkujdesja pa ndonjë mjeshtër që e ka bërë, atëherë kjo duhet të pranohet edhe për këto kukulla pa jetë; por nëse kjo nuk është e pranueshme për kukullat, akoma më shumë nuk është e pranueshme për kafshën.*

*Mendo për trupat e kafshëve shtëpiake, që janë të krijuara si trupi i njeriut, prej mishi, kocke, nervash e damarësh dhe u është dhënë dëgjimi e shikimi, që njeriu të plotësojë me to nevojat e tij. Nëse ato do të ishin të verbra*



*e shurdhe, njeriu nuk do të kishte ndonjë dobi prej kafshëve shtëpiake, pasi ato nuk do t'i shërbenin në punët e tij. Kafshëve shtëpiake nuk u është dhënë zgjuarsi e mendje, që ato të jenë të nënshtruara ndaj njeriut dhe të mos e ndalojnë njeriun kur ai i vë në punë të lodhshme dhe i ngarkon me barrë të rëndë. Dikush mund të thotë: "Njeriu mund të ketë edhe skllevër, të cilët janë të nënshtruar e vihen në punë të lodhshme." Megjithatë, ata nuk janë pa mendje e pa zgjuarsi. Këtij personi i thuhet: "Nga kjo kategori njerëzish ka fare pak, kurse pjesa me e madhe e njerëzve nuk nënshtrohen ashtu siç nënshtrohen kafshët, duke i ngarkuar me barrë të rëndë apo të vihen të rrotullojnë mullirin e blojës e në punë të tjera të ngjashme; gjithashtu, skllevërit nuk bëjnë të gjitha punët që ata kanë nevojë prej tyre. Sikur njerëzit të vazhdonin të bënin të tilla punë me trupat e tyre dhe të merreshin me të gjitha punët, atëherë, në vend të një deveje apo të një mushke të vetme, do të duheshin disa njerëz dhe prej tyre nuk do të kishte asnjë të mirë në mjeshtëritë, pa folur për lodhjen e madhe fizike e jetën e tyre të vështirë e të rëndë."*

*Pastaj foli për karakteristikat dalluese të çdo njërit nga tre llojet e kafshëve: njeriut, mishngrënësve dhe barngrënësve; foli për nevojat e secilit grup dhe për mënyrën e ndërtimit të organeve e të gjymtyrëve të tyre. Të gjitha këto ti i sheh të jenë të arrira me urtësinë më të lartë, me fuqi të përsosur dhe me pamje të bukur.*

*Ai flet për urtësinë e bërjes së syve në pjesën e sipërme të fytyrës së kafshës dhe zgavrën e gojës poshtë hundës, por nuk e ka bërë si goja e njeriut e të tjera veçori të organeve e të gjymtyrëve.*

*E gjitha kjo orienton zgjuarsinë, të tjera veçori udhëzojnë interesat e kafshës. Kaprolli e ndien rrezikun. Është dikush që e pengon atë kur shkon të pijë ujë. Pirja e ujit do ta vriste atë, pasi menjëherë do t'i hidhej gjarpri; apo dhelpra që shtrihet në shpinë dhe fryn barkun, kur është e uritur, që shpendët ta kujtojnë të ngordhur. Kur shpendi bie mbi të, që të çukisë mishin e saj, ajo hidhet mbi shpendin. Ka edhe të tjera kafshë si këto. Po të drejttoj tani një pyetje, tha Sàdiku: “Kush i bëri këto hile karakteristika në disa kafshë, që të jenë në interes të saj?”*

*Më pas parashtroi gjallesën një qelizore, milingonën e vogël dhe merimangën. Ai foli për krijimin e plotësuar të gjallesës një qelizore, edhe pse ajo ka vëllim të vogël. Foli për milingonën dhe për punën që ajo bën në përputhje me fuqinë e saj, foli edhe për merimangën, se si e përgatit kurthin për të gjuajtur mizat. Pastaj tha: “Vështro në këto insekte të vogla, se si i ka bërë ata të kryejnë veprime, që kurrë nuk arrin t'i bëjë njeriu, pa përdorur mashtrime e mjete. Prandaj mos e flak një send, kur mësimi, që merret prej tij, është i qartë, qoftë gjallesë një qelizore apo milingonë e të ngjashme me këto. Kuptimi i vlefshëm ndodh të jetë i përfaqësuar edhe në një send pa vlerë e të përçmuar, prandaj mos u nxito në asnjërën nga këto, ashtu siç nuk duhet të nxitohesh në peshimin e një dinari, që është ar me një mithkal prej hekuri.”*

*Vazhdoi të flasë për shpendët; peshën e lehtë të trupit të tyre dhe si është përsosur krijimi i tyre, forma e kraharorit të shpendit është bërë si bashi i anijes, që ai ta këtë të lehtë të çajë ajrin e të tjera veçanti të krijimit të tyre; foli edhe për urtësinë në krijimin e këtyre karakteristikave. Urtësia e karakteristikave vijon në krijimin*

e pulës, të harabelit, të lakuriqit të natës, të bletës, të karkalecit, të shpendëve të tjerë e insekteve fluturuese. Ai foli edhe për karakterin dhe zgjuarsinë e këtyre krijesave, që All'llahu ka vënë te to, që të mundësojnë kërkimin e ushqimit, pa folur për mrekulli të tjera të krijimit, që janë në ato krijesa.

Ai parashtroi krijimin e peshkut e përshtatshmërinë e tij në mjedisin e caktuar të jetës. Pastaj thotë: “Nëse dëshiron të njohësh gjerësinë e urtësisë së Krijuesit dhe diturinë e pakët të të krijuarve, shiko në det llojet e peshqve, të kafshëve ujore e të llojeve të panumërueshme të gjallesave me guaskë, që janë në det, dobitë e të cilave t'i i njuh pak e nga pak.”

Këtu përfundon edhe kjo pjesë.

Unë them: “Nuk ka asgjë të çuditshme prej Krijuesit të gjallesave: monoqelizore, të kribave e të llojeve të peshqve. E shumëllojshme është edhe urtësia në të gjitha këto krijesa. Megjithëkëtë, për atë, që udhëzohet për të njohur urtësinë e Krijuesit, nuk ka asnjë çudi, pasi çudia është në atë që mohon Krijuesin e qiejve, të tokave dhe çka ndërmjet tyre e në brendësi të tyre dhe kjo krahas mjeshtërisë, përsosjes së krijimit dhe përbërjes së mrekullueshme. Sikur mohuesi të shikonte mjeshtërinë e krijimit të tij, patjetër që do të ishte argumenti më i madh për vërtetimin e Ekzistencës e të Njëtimin të Ekzistencës.”

- 3 -

Ditën e tretë Mufeddali shkoi shumë herët në mëngjes dhe imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi tël) i tha: “O Mufeddal, të shpjegova krijimin e njeriut, ndryshimet e

*lëvizjet e tij në të gjitha gjendjet, të fola edhe për mësimet që nxirren nga këto; të shpjegova edhe çështjen e kafshës dhe tani do të filloj të flas për qiellin, diellin, hënën, yjet, planetët, natën, ditën, të nxehtë, të ftohtë, erën, shiun, shkëmbinjte, malet, dheun, gurët, mineralet, bimët, hurmën, pemët dhe argumentet e mësimet, që mund të nxirren nga të gjitha këto.*

*Pa mendo për ngjyrën e qiellit dhe për atë rregullsi të përsosur që ka në qiell. Kjo është ngjyra më e përshtatshme dhe më forcuese për syrin. Madje recetat e mjekëve, për atë që ka ndonjë dëmtim në syrin e tij, e këshillojnë që të shikojë sa më shumë gjelbërimin që afrohet në të zezë. Një mjek i mirë prej tyre e këshillon atë që ka dobësim në shikimin e tij të vështrojë një govatë me ngjyrë të gjelbër të mbushur me ujë. Shiko si e ka bërë All'llahu i Lartësuar shtresën e qiellit me ngjyrë të gjelbër në të zezë, me qëllim që të mos shkaktohet ndonjë dëmtim nga shikimi i gjatë i tij. Pra, ajo që njerëzit e kuptuan me anë të mendimit, të shikimit e të eksperimenteve, gjendet në hapësirën e krijimit. Një urtësi shumë e madhe për të marrë mësim prej saj, ata që duan të nxjerrin mësim, që ateistët të mendojnë për të.*

*Mendo o Mufeddal lindjen e perëndimin e diellit, dy shtetet e natës e të ditës. Sikur të mos ishte lindja e diellit, me siguri që do të prishej e gjithë puna e botës, pasi njerëzit nuk do të dilnin në kërkim të mjeteve të jetesës, do të veçoheshin në punët e tyre. Mendo edhe për dobinë e perëndimit të diellit. Sikur të mos ishte perëndimi i diellit, njerëzit nuk do të kishin as qetësi, me gjithë nevojën e tyre të madhe për pushim, që të shtrijnë e të qetësojnë trupat e tyre, që të vihen në qetësi shqisat e tyre,*

*të ripërtërihet fuqia e tretjes së ushqimit dhe kalimi i tij në pjesët e trupit. Pastaj kujdesi i shtyn të vazhdojnë punën e ta bëjnë atë të lehtë, që trupat e tyre të mos mposhten, pasi shumë njerëz, nëse nuk do të ishte nata, me errësirën e saj, nuk do të kishin qetësi e as kujdes për të fituar, për të mbledhur ushqim e për ta ruajtur atë. Nëse dielli do të ndriçonte vazhdimisht, edhe toka do të nxehej. All'illahu, me urtësinë e me sistemin e Tij, ka caktuar për diellin kohë për të perënduar, ka caktuar edhe një kohë që dielli arrin në pozicionin kur ndriçon, që njerëzit të ngrihen për të plotësuar nevojat që kanë. Pastaj dielli u humb njerëzve nga sytë, pikërisht për atë qetësi e pushim që ata kanë nevojë. Drita dhe errësira, edhe pse janë të kundërta, janë bërë orientuese për atë që është e mirë.”*

*Vazhdoi deri në fundin e kësaj pjese dhe tha: “Mendo për barnat dhe për të veçantën e veprimit të çdo njërit prej tyre në disa sëmundje. Njëri depërton në kyçe dhe nxjerr jashtë mbeturinat, tjetri bën të rrjedhë gjakun e zi, ai tjetri largon gazrat, ky tjetri shëron plagët.”*

*Përmendi edhe të tjera veprime të barnave. Të gjitha këto fuqi nuk i ka bërë askush tjetër përveç Atij që i ka krijuar ato për të sjellë dobi.*

*Vazhdoi të flasë derisa tha: “Mësoje se pozita e sendit nuk është sipas vlerës së tij, por ka dy vlera të ndryshme dhe dy tregje. Mbase ishte i ulët në tregun e fitimit dhe i vlefshëm në tregun e dijes. Mos e zvogëlo mësimin që nxirret nga një send, për shkak se ai është i vogël. Sikur t’u mësohej kërkuesve të kimitë se çka në fekalet, patjetër që do ta blinin me çmimin më të shtrenjtë.”*

*Edhe ditën e katërt Mufed'ali shkoi herët në mëngjes dhe imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “O Mufeddal, të kam shpjeguar argumente për krijimin dhe dëshmi për përsosmërinë e rregullimit, me të gjitha pasojat në jetën e njeriut, të kafshës, të bimëve, të pemëve, etj. Të kam folur edhe për mësimet, që dalin nga të gjitha këto për cilindo që dëshiron të nxjerrë mësim. Tani do të të shpjegoj për sëmundjet e fenomenet që ndodhin herë pas here, të cilat, disa injorantë, i morën si mjet për të mohuar Krijuesin, krijimin, qëllimin dhe sistemimin e parashikuar me të gjitha pasojat, si dhe veprimet e urryera e vështirësitë apo vdekjen e zhdukjen që mohuan anarkistët e manevitë, apo thëniet e atyre që i përmbahen rrymës së karaktereve dhe të kujtdo që pretendon në mënyrë të gabuar se sendet janë nga rastësia e nga përshtatshmëria.*

*Disa njerëz injorantë, fenomenet, që shfaqeshin në kohë të ndryshme, si epidemitë, vullkanet, të ftohtët e karkalecat i morën si mjete për të mohuar krijimin, sistemimin dhe Krijuesin. Në përgjigje të kësaj thuhet: “Nëse nuk do të kishte Krijues e Sistemues, përse atëherë nuk ka më shumë nga këto fenomene? A e imagjinoni dot se si mund të jetë jeta, nëse qielli bie mbi tokën, toka fundoset e shkon poshtë, vonohet dalja e diellit në vendlindjen e tij, lumenjtë e krojet thahen, derisa të mos ketë ujë për njomur buzët, era të mos lëvizë fare derisa sendet të nxehen e të prishen dhe uji i detit të vërshojë mbi tokë e ta përmbysë atë?*

*Por të gjitha këto fenomene, që ne i përmendëm, duke filluar me epidemitë, karkalecat e të tjera të*

*ngjashme, nuk janë të vazhdueshme e nuk shtrihen deri në atë shkallë sa të asgjësohet çdo gjë që është në këtë botë. Ato mund të ndodhin në disa raste, të qëndrojnë dhe të largohen. A e shikon se bota ruhet e mbrohet nga të tilla fenomene të mëdha, të cilat, sikur të ndodhte një pjesë prej tyre, do të shkatërronte jetën. Ndodh që këto sëmundje, në disa raste të "kafshojnë" lehtazi, por edhe kjo bëhet për të edukuar e për të vënë njerëzit në udhën e drejtë. Pastaj këto sëmundje nuk janë të vazhdueshme, por largohen nga njerëzit. Ajo bie mbi njerëzit, kur ata e presin shpresën nga mëshira e All'llahut. Prandaj rënia e saj është këshillë, kurse largimi i saj është mëshirë. Anarkistët kanë mohuar atë që mohuan manevitë: gjërat e urryera e vështirësitë, që prekin njerëzit dhe të dy grupet thonë: "Nëse bota do të kishte Krijues të dhembshur e të mëshirëplotë, përse ndodhin këto gjëra të urryera?" Ai që e thotë këtë fjalë shkon më tutje dhe thotë se patjetër jeta e njeriut në këtë botë duhet të jetë e pastër nga çdo turbullirë. Nëse do të ishte kështu, njeriu do të dilte nga më e keqja e nga mendjemadhësia e tejskajshme për të hyrë në atë që nuk shërben as për fenë e as për këtë botë, si ai që shikon nga ata që i ka prishur pasuria e shumtë, ose prej atyre që janë lindur në mirëqenie e në siguri e që dalin prej saj. Madje ndonjëri prej tyre harron se është njeri, ose që është adhurues, ose ka mundësi që njeriun ta prekë ndonjë dëm, ose ndonjë gjë e urryer bie mbi të, ose i duhet të mëshirojë një të pafuqishëm, apo të trajtojë me dashuri një të varfër, ose do të vajtojë për ndonjë pësim, që e godet, ose do të vajtojë për hallin e ndonjë të mjeruari, ose do të ndiejë dashamirësi për një që është goditur nga ndonjë gjëmë e rëndë; kur atë vetë e prekin gjëra të urryera dhe ai e gjen atë të dhimbshme, pranon*

*këshillën dhe mendohet shumë për atë që nuk e ka ditur e ndaj asaj që ka qenë i shkujdesur dhe kthehet në ato gjëra, ose në shumicën e tyre, që ai kishte detyrë t'i kryente; mohuesit e këtyre barnave janë si fëmijët e vegjël, të cilët nuk i duan. Ka nga ata që ndalohen, zemërohen, që u janë ndaluar ushqimet e dëmshme. Ata urrejnë edukatën e punën dhe duan që vetëm të luajnë e të rrinë pa bërë asnjë punë, duan të arrijnë çdo vend ku ka ushqime e pije. Ata nuk e dinë se në ç'zakone të këqija i çon papunësia; ata nuk e dinë se sa të mira i vijnë atyre nga edukata e përmirësimit; nuk dinë dobitë që kanë nga barnat, edhe pse u janë zbardhur flokët nga gjërat e urryera.*

*Unë them: "Në një mënyrë apo në një tjetër, imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) solli si shembull fjalët e atyre ateistëve, në lidhje me sëmundjen, kurse përgjigjen për ta e dha në dritën e argumentit. E përfundon fjalën me shpjegimin e Krijuesit. Midis fjalëve është edhe kjo pyetje: "Si mund të detyrohet njeriu i pafuqishëm të njohë All'llahun me atë mendje të butë e që nuk ka dituri për Të?"*

*Në përgjigje thotë: "Në të vërtetë, njerëzit duhet t'i kryejnë detyrat sipas fuqisë që kanë, që të ndërgjegjësohen për Atë dhe të qëndrojnë në urdhrat e në ndalimet e Tij. Robtë nuk janë të obliguar për njohjen e cilësive të Tij, ashtu siç nuk i obligon mbreti shtetasit e tij, që ata të dinë se ai është shtatgjatë apo shtatshkurtër, është i bardhë apo zeshkan, por i detyron t'i binden pushtetit të tij dhe të zbatojnë urdhrin e tij. Si mendon ti, do të jetë gjendja e një burri, që vjen në portën e mbretit dhe i thotë: "Dil para meje, që unë të vlerësoj diturinë tënde, ndryshe nuk të bindem!" Padyshim që ky burrë e ka lejuar dënimin për*



*veten e vet. Kështu është edhe ai që nuk pohon Krijuesin, të Plotpushtetshmin derisa të kuptojë të vërtetën e Tij, duke ekspozuar veten para zemërimit të Tij.*

*Me shpjegim të tillë brilant dhe argument të shkëlqyeshëm, imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi të!) i plotësoi mësimet që i dha Mufeddal ibn Umerit. Në fund të fjalës së tij tha: “O Mufeddal, merr atë çka të dhashë dhe të jesh prej falënderuesve, për argumentet e Tij të jesh prej mirënjohësve, për miqtë e Tij të jesh prej të bindurve. Unë të shpjegova argumente për krijimin dhe dëshmi për përsosmërinë e rregullimit deri në parashikimin e pasojave dhe për qëllimin, të shpjegova pak nga shumica dhe një pjesë nga e gjitha, prandaj ti njihu me çështjen dhe sistemoje deri në fund, pastaj mendo në të dhe nxirr mësim prej saj.”*

*Mufed’ali thotë: “Unë u largova prej zotërisë tim me atë që nuk është larguar ndonjë tjetër.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Dijetarët e meritojnë plotësisht që t’i numërojnë çështjet e qarta të kësaj urtësie si një thesar të rrallë, ashtu siç i numëroi edhe Mufeddali.*

*Ebù Abdil’lahi shpjegoi me qartësi urtësitë e sekreteve dhe sekretet e urtësive, megjithëse për shumë njerëz është e*

---

<sup>1</sup> Ky Njëtim (Teuhijd), i njohur me emrin “Teuhijdi i Mufeddalit” është botuar disa herë dhe është transmetuar në librin “Bihàrul Enuâr”, vëll. 2, f. 17-47. Të gjitha botimet nuk kanë shpëtuar dot nga gabimet e shtypshkrimit. Prandaj ky citim i tij është bërë pas një verifikimi të kujdesshëm. Është botimi më i saktë që është bërë në shtypshkronjën “Hajdarijeh”, në vitin 1369 të hixhrit. Dëshmitë e shumta vërtetojnë katërçipërisht se ky është “Teuhijdi” i imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!) por këtu nuk është vendi që të përmenden.

*panjohur dituria e tij dhe është e vështirë që atë ta kuptojnë njerëzit.*

*Këto mësimë na treguan për të Urtin e për mjeshtërinë e Tij të bërjes, na informojnë me dijen e tij, me filozofinë e krijimit. Në këto mësimë ti ke parë një filozof hyjnor, një dijetar teolog, një mjek thellësisht diagnostikues, një kimist analist, një mjeshtër në autopsi, një agronom në bujqësi e pemëtari, një dijetar të krijesave, që janë ndërmjet qiellit e tokës dhe një burrë të aftë për të shprehur sekretet e urtësisë në të gjitha krijesat.”*

*El Ihlijlexheh (bërthama e frytit të pemës Ihlijlexheh)*

*Ky Teuhijd është quajtur El Ihlijlexheh, për shkak se imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) po shikonte një mjek indian, që mbante në dorë një bërthamë të frytit të pemës Ihlijlexheh (pemë që rritet në Hindi, Kabul dhe Pakistan – shënimi në kllapa sipas fjalorit: “El-muxhmeul-Vesijt”). Mufeddal ibn Umeri i kishte shkruar imam Sàdikut dhe e njoftonte se disa vetë të popullit të tij mohonin se All’llahu është Krijuesi, madje edhe polemizonin për këtë. Prandaj i kërkonte që t’i përgjigjej atyre dhe t’ua hidhte poshtë fjalën me argumente, ashtu siç kishte vepruar edhe me të tjerë.*

*Imam Sàdiku, ndër të tjera, i shkroi: “Letra jote që e mjaftueshme për mua. Unë kam shkruar një letër për ty, ku shkëmbeva fjalë dhe i mposhta disa që besonin në një fe mohuese. Kjo ndodhi kur mua më erdhi një mjek nga trevat e Indisë, i cili vazhdimisht më kundërshtonte me mendimin e tij dhe polemizonte me mua për çështje të rrugës së humbjes ku ai ishte. Një ditë, ndërsa ishte duke shtypur një bërthamë nga fryti i pemës Ihlijlexheh, që ta*

*përziende me barnat e veta, tha një fjalë kundërshtuese të mendimeve të mia. Ai pretendonte se bota as nuk është zhdukur e as nuk do të zhduket, një pemë lind, një pemë tjetër rrëzohet, një shpirt lind e një tjetër vdes; gjithashtu ai thoshte se pretendimi për njohjen e All'llahut është një pretendim për të cilin unë nuk kisha as argumente e as fakte dhe se kjo është një çështje që i mbrapsmi e ka marrë prej të parit dhe i vogli prej të madhit dhe se sendet e krijuara, të shkatërruara, të brendshme e të jashtme, në të vërtetë njihen nga pesë shqisat: shikimi, dëgjimi, nuhatja, shijimi dhe prekja. Pastaj ai e drejtoi logjikën e tij mbi atë bazë që e kishte vënë dhe tha: "Te shqisat e mia nuk ka rënë asgjë prej një Krijuesi që të hyjë në zemrën time."*

*Mohim i mirëfilltë i All'llahut të Lartësuar.*

*Pastaj më tha: "Më thuaj, me çfarë e argumenton njohjen e Zotit tënd, të Cilit i përshkruan fuqinë dhe aftësinë e krijimit, pasi zemra të gjitha sendet i njeh në sajë të argumenteve që unë të përshkrova?"*

*I thashë: "Me mendjen që është në zemrën time, me argumentin, që unë argumentoj njohjen e Tij."*

*Atëherë ai më tha: "Si mund të jetë kështu, kur ti e di se zemra nuk njeh asnjë send pa shqisat. Vallë a e ke parë ti Zotin tënd me sy, a e ke dëgjuar me veshë zërin e Tij ose a ke nuhatur erën e Tij, a e ke shijuar Atë me gojë apo e ke prekur me dorë dhe pastaj këto e drejtuan njohjen për në zemrën tënde?"*

*I thashë: "Me ato, që thua për ndjeshmërinë e shqisave të tua, unë pohoj me fjalën tënde se patjetër njëri nga ne të dy është i drejtë dhe tjetri gënjeshtar."*

*Ai tha: "Jo."*

*Atëherë thashë: "A beson te fjala jote? A ke ndopak frikë nga ato që unë të flas për dënimin e All'llahut?"*

*Ai tha: "Jo."*

*Përsëri fola: "A e beson, nëse është siç them unë, se e vërteta është në dorën time? Atëherë a nuk i bie që unë po të frikësoj me dënimin e All'llahut?"*

*Tha: "Patjetër."*

*Atëherë thashë: "Erdhëm më lart kraharorit dhe më afër shpëtimit."*

*Ai tha: "Ti po, sepse në punën tënde ka pretendim dhe dyshim, kurse unë jam bazuar te dija e saktë dhe te siguria, sepse unë nuk shoh që pesë shqisat e mia ta kenë kuptuar Atë. Atë që nuk e kuptojnë shqisat e mia, për mua nuk ekziston."*

*I thashë: "Domethënë se, kur shqisat e tua janë të pafuqishme të kuptojnë All'llahun, ti e mohon Atë? Unë them se shqisat e mia, me të vërtetë, janë të pafuqishme për të kuptuar All'llahun, por unë e vërtetoj Atë."*

*"Si është kjo pyetje?"*

*I thashë: "Mbi çdo send do të ketë shenja të përbërjes, p.sh: syri ka parë një ngjyrë. Por ajo, që kupton syri dhe e arrijnë shqisat, është diçka tjetër dhe jo All'llahu i Lartësuar, sepse Ai nuk ngjason me krijesat dhe krijesat nuk ngjasojnë me Të. Krijesat pësojnë ndryshime e zhduken dhe çdo send, që i nënshtrohet ndryshimit e*

*zhdukjes, është i ngjashëm me sendin tjetër, prandaj krijesat nuk janë si Krijuesi dhe as i bëri nuk është si Bërësi.”*

*Pastaj Sàdiku - (Paqja e shpëtimiti qoftë mbi të!) - vazhdon: “I thashë atij: “Më thuaj, a i di të gjitha anët dhe a ke arritur në fundin e tyre?”*

*Tha: “Jo.”*

*I thashë: “A je ngjitur në qiellin që shikon, ose a ke hyrë poshtë në tokë dhe ke parë të gjitha vendet e saj? A ke ecur mbi valët e detit dhe ke çarë anët e ajrit, që janë mbi qiellin, ose ato që janë poshtë qiellit deri në tokë, madje edhe poshtë tokës? Të gjitha këto i gjete pa ndonjë Rregullues të urtë, të ditur dhe që i vazhdon punët në tërësi e në thellësi?”*

*Tha: “Jo.”*

*I thashë: “Çfarë të bëri të ulesh kështu? Mbase Ai, që zemra jote e mohon, është në disa që nuk e kuptojnë shqisat e tua dhe nuk e arrin as mendja jote.”*

*Tha: “Nuk e di, mbase në disa nga ato që përmende ti ka rregullues, por përsëri nuk e di. Mbase në të gjithë këtë nuk ka asgjë.”*

*Unë them: “Mbase krijohet iluzioni se në këtë fjalë të Sàdikut ka shenja të trupëzimit, sepse ai e mundësoi që ai të ishte në një anë të caktuar. Kjo gjë është karakteristikë e trupave. Në të vërtetë, e gjitha kjo ishte për të hedhur poshtë fjalën e mjekut, i cili donte të nxirrte argumente për të vërtetuar mosekzistencën pas gjendjeve shpirtërore. Imam Sàdiku donte të përgënjeshtronte pretendimin e tij*

*për mosekzistencën e gjendjeve shpirtërore. Për këtë i sjell atij mundësinë e ekzistencës në ndonjë anë, të cilën nuk e kishte arritur mjeku, pasi mundësia e ekzistencës së tij edhe në një anë të vetme, ishte e mjaftueshme për të hedhur poshtë pretendimin e tij për mosekzistencën e gjendjeve shpirtërore, por ky është nga kapitulli i detyrimit të kundërshtarit dhe prishja e argumentit të tij, dhe nuk është nga kapitulli i vërtetimit të ekzistencës së Tij në ndonjë anë. Më përpara është folur për mohimin që ai i bën kuptimit me anë të shqisave dhe të asaj që vërtetohet në ndonjë anë të caktuar dhe që kuptohet me shqisa.”*

*Pastaj imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) vazhdon: “Thashë: “Kur dole nga caku i mohimit për në pozicionin e dyshimit, të lutem të dalësh për te njohja.”*

*Ai tha: “Në fakt, mua më ka hyrë dyshimi për pyetjen që më bëre për atë që unë nuk e di. Por nga do të hyjë dituria e saktë për atë që nuk e kuptojnë shqisat e mia?”*

*I thashë: “Prej kësaj bërthamës tënde të frytit të pemës Ihljlexheh.”*

*Ai tha: “Kjo na qenka më vërtetuese për argumentin apo është nga edukata e mjekësisë, e cila, nga ana e saj, pohon më shumë njohuritë e tij.”*

*Pastaj imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të) i drejtoi mjekut disa pyetje të veçanta për Ihljlexheh, për mënyrën e bërjes së saj, nëse ka në botë të ngjashme me të. Ndërkaq mjeku filloi të jetë i prerë në përgjigjet e tij, si masë mbrojtëse, për të mos u shprehur për bërjen, e cila është treguese e bërësit. Vazhdoi kështu me pyetje-përgjigje, derisa ai u detyrua të pohonte se ajo kishte dalë nga një pemë.*

*Pastaj imam Sàdiku tha: “A e ke parë Ihlijlexheh, para se të bëhej fryt, kur në kokrrën e saj kishte ujë dhe nuk kishte bërthamë, as mish, as lëkurë, as ngjyrë, as shije e as fortësi?”*

*Tha: “Po.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “I thashë atij: “Si mendon se do të ishte jeta e kësaj kokrre, sikur Krijuesi të mos e kishte holluar atë ujë të dobët e të pakët në atë farëz të vogël e të qullët, nëse Ai nuk do ta kishte forcuar atë me fuqinë e Tij, ta kishte formësuar me urtësinë e Tij dhe me caktimin e Tij të mos i kishte dhënë përmasat që ka? A do të kishte ujë më shumë në brendësi të kokrrës dhe jo në të gjithë trupin, ose edhe në vetë kokrrën pa ndonjë ndarje? Nëse do të shtohej, do të shtohej ujë, pa formë, pa sistem, pa shtim të pjesëve të frytit dhe pa formuar shtresat.”*

*Ai tha: “Më tregove figurën e pemës së saj, formimin e krijimit të saj, daljen e frytit të saj, shtimin e pjesëve dhe sqarove përbërësit e saj me argumentet më të qarta dhe me faktet më të dukshme për njohjen e Bërësit. Ti the të vërtetën se sendet janë të bëra, por nuk e di, mbase kjo, Ihlijlexheh dhe sendet kanë bërë vetveten.”*

*Pastaj imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i vërtetoi atij se ajo ishte e bërë nga dikush tjetër, duke mos qenë më përpara dhe se bërja e saj tregon se Bërësi i saj është i urtë e i ditur, gjithashtu ai i parashtrroi atij edhe shumë argumente të tjera.*

*Imam Sàdiku vazhdoi fjalën. Boshti i fjalës mbetej Ihlijlexheh, derisa më në fund argumenti e bëri atë të*

*pohojë Bërësin e Vetëm. Por ky pohim erdhi, pasi ata folën për yjet e për astronomët.*

*Pastaj imam Sàdiku filloi t'i flasë atij për ato shenja dalluese që tregojnë Bërësin e Vetëm, si dhe argumentet për këtë të Urtë, të Gjithëfuqishëm, të Ditur e Vëzhgues. I foli se nga bërjet e Tij janë qielli, toka, pemët, bimët, bagëtitë, etj, i foli edhe për mënyrën e argumentimit.*

*Pastaj filloi t'i përshkruajë cilësitë e Tij, si: butësinë, diturinë, fuqinë, dëgjimin, shikimin, dhembshurinë, mëshirën dhe vullnetin.<sup>1</sup>*

*Unë them: “Në këtë kumtesë, kudo bie në sy kujdesi për të folur sa më shkurt, pasi kjo kumtesë përfshin lloje të shumta dijesh, deri tek forca e argumentit e kualiteti i deklarimit, kur boshti i gjithë diskutimit ishte vetëm bërthama e Ilhijlexheh, që është nga bërjet më të vogla e më e vogla për nga pikëpamja e rëndësisë.”*

*Përmbledhje e argumenteve të tij për Ekzistencën (Vuxhùd) dhe Njëtimin (Teuhijd)*

*Talentet e mëdha njihen nga aftësia e shpjegimit. Prandaj e gjejmë të zgjerohet shumë te argumenti, ashtu siç e pamë në Njëtimin e Mufeddalit. Në raste të tjera ti e sheh atë, që krahas besnikërisë ndaj qëllimit, vjen me shpjegimin më të përmbledhur të argumentit. Kjo ndodh kur ai pyetet për Krijuesin. Thotë: “Ç'nevojë kanë njerëzit?”<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 3, f. 152-170.

<sup>2</sup> “Tuhuful Ukùl”.



*Unë them: “Sa fjalë e shkurtër, por sa argument të madh përmban! Ne i gjejmë njerëzit në nevojë të vazhdueshme për çdo gjë e për çdo problem të jetës. Pikërisht kjo nevojë tregon se për nevojat e tyre duhet të gjendet një Mbështetës, që në vetvete të mos ketë nevojë për njerëzit. Ky Mbështetës është Një e i Vetëm, ndryshe do të ndodhnin mosmarrëveshje në vijueshmërinë dhe në sistemimin e punëve.”*

*Një herë atë e ka pyetur Hishàm ibn Hakemi: “Si është argumenti që All’llahu i Lartësuar është Një e i Vetëm?”*

*I thotë: “Përputhja e rregullimit deri në imtësi dhe plotësimi i punës.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Çdonjëra nga këto dy fjalë janë të përshtatshme të jenë argument më vete, për faktin se përputhja e rregullimit deri në imtësi është dëshmuar se Sistemuesi është Një dhe i Vetëm. Nëse do të ishin dy ose më shumë, padyshim që kundërshtimi mes tyre do të bëhej shkak për të ndodhur të çara e kundërshtime, për pasojë rregullimi nuk do të ishte i përsosur dhe caktimi i vijueshëm. Gjithashtu, edhe plotësimi i punës në krijimin është një dëshmuar tjetër i përhershëm për Njëtimin, sepse vazhdimësia e marrëveshjes ndërmjet dy të barabartëve kurrë nuk mund të ndodhë, ashtu siç e vërejmë te ata që drejtojnë mekanizmin e punëve të vendit. Nëse ndodh kundërshtim, qoftë edhe për pak kohë, krijesat shkatërrohen. Ku është plotësimi i punës? Atëherë edhe plotësimi është argument i Unitetit.”*

---

<sup>1</sup> “Teuhijdu Sudùk”, kapitulli: “Përgjigje ateistëve dhe atyre që thonë se ka dy zota (manevitë)”, f. 243.

*E ka pyetur edhe Shàkir Ed'dIsàniu: "Çfarë argumenti më jep ti, që për gjithçka ka një Bërës?"*

*Imam Sàdiku i thotë: "E gjeta veten të atillë, që nuk ndahet në dy anë, ose e kam bërë unë veten, ose atë e ka bërë dikush tjetër. Mund ta kem bërë unë, por unë nuk ndahem në dy kuptime: prandaj ose e kam bërë unë dhe ajo ishte kështu, prandaj nuk kisha nevojë ta bëja; nëse nuk ishte, ti e di se, nga ajo që nuk është, nuk ndodh e nuk del asgjë. Atëherë vërtetohet e treta, se për mua ka një Punues dhe ky është Zoti i botëve."*

*U ngrit dhe nuk dha më përgjigje tjetër,"<sup>1</sup>*

*Një herë imam Sàdiku e ka pyetur Ibn Ebul Auxhàë dhe i ka thënë: "Ti je apo nuk je i bërë?"*

*Ibn Ebul Auxhà i tha: "Unë nuk jam i bërë."*

*Atëherë imam Sàdiku tha: "Më thuaj, si do të ishte, nëse do të ishte i bërë?"*

*Ai mbeti i anuar dhe nuk po gjente dot përgjigje, u kap pas një dërrase, që kishte përpara dhe tha: "I gjatë, i gjerë, i thellë, i shkurtër, lëvizës, jo lëvizës."*

*Të gjitha këto janë prej cilësive të krijesave të Tij. Atëherë imam Sàdiku i tha: "Nëse ti nuk e di cilësinë e bërjes prej një Bërësi, atëherë bëje veten të bërë."*

*Ibn Ebul Auxhàë tha: "Më pyete për një çështje, që nuk më ka pyetur ndonjë tjetër para teje dhe as do të më bëjë pyetje të ngjashme ndonjë tjetër pas teje."<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> "Et'tauhjd", kapitulli: "I Plotpushtetshmi njihet vetëm me vetveten".

*Unë them: “Vërtetimi i këtyre gjërave të ardhura mbi njeriun, për faktin se ai është i bërë, është fare i qartë, sepse gjatësia e tij, pasi ishte i shkurtër dhe ndryshueshmëria e tij në thellësi e në gjerësi është bërë kohë pas kohe, qëndrimi i tij herë palëvizur dhe herë në lëvizje janë ndodhi që tregojnë se ai ekziston, pasi nuk ishte më parë, ashtu siç tregojnë se ai është i bërë, pasi më parë nuk ishte. Për të bërën detyrimisht duhet të ketë një Bërës dhe për krijesën një Krijues.”*

### *Mohimi i trupëzimit*

*Mbase dyshimi për trupëzimin ka ardhur prej disa ateistëve dhe pastaj ka hyrë te disa nga besimet e atyre myslimanëve, që ndjekin mendime e medh’hebe, të cilët, nga jashtë, janë dogmatikë në fe. Ateistët, kur panë se pësuan humbje në thirrjen e tyre për anarki dhe mohimin e cilësive të All’llahut të Lartësuar, patën sukses në mbjelljen e këtij dyshimi, për të cilin gjejmë shumë fjalë në këtë kohë. Lexojmë shumë për të në pyetjet që i bëhen imamit. Nga këto është edhe përgjigja e tij për këto dyshime: “Trupi është i kufizuar dhe me anë të përfunduara. Kur shtrohet mundësia e kufirit, shtrohet mundësia e shtimit ose e pakësimit. Për atë që shtrohet çështja e shtimit ose e pakësimit, ai është i krijuar.”*

*Pyetësi foli: “Çfarë po them?”*

*Imam Sàdiku tha: “As trup, as figurë, Ai është Trupëzuesi i trupave dhe Formëdhënësi i figurave. Ai as nuk pjesëtohet e as nuk ka fund, Ai as nuk shtohet e as*

---

<sup>1</sup>“Teuhijdu S’udùk”, kapitulli: “Vërtetimi se bota është e ardhur”.

*nuk pakësohet. Sikur të ishte ashtu siç thoni ju, nuk do të kishte dallim ndërmjet Krijuesit e të krijuarit, ndërmjet Bërësit e të bërit. Por ai është Bërësi, që e ka ndarë trupin e Tij e figurën e Tij dhe bërjen e Tij, pasi Atij nuk i ngjason asnjë send dhe Ai nuk ngjason me asnjë send.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Duket që ky shpjegim përcjell butësi e dashamirësi, megjithëse ai e kishte forcën e argumentit dhe konstruktin e çeliktë të kompozimit. Megjithëkëtë, me qartësinë që ka, kalon edhe përtej qartësisë.”*

*Një herë tjetër ai ka thënë: “Kush pretendon padrejtësisht se All’llahu është send ose Ai shndërrohet në një send tjetër, ose prej Tij nuk del ndonjë send, ose me Atë merret një send, në të vërtetë e ka përshkruar Atë me cilësitë e krijesave, kur All’llahu është Krijuesi i të gjitha sendeve dhe nuk matet me ndonjë masë, as nuk ngjan me njerëzit. Për Atë nuk ka vendqëndrim dhe Ai nuk punon në ndonjë vend, Ai është i afërm në largësinë e Tij dhe i largët në afërsinë e Tij. Ky është All’llahu, Zoti ynë, nuk ka zot tjetër përveç Tij.”<sup>2</sup>*

*Unë them: “Sa përshkrim të mrekullueshëm që dha dhe sa hollë e dha kuptimin e fjalës së tij «Ai është i afërm në largësinë e Tij dhe i largët në afërsinë e Tij.», kuptimi i të cilit ka nevojë për butësi të gëzueshme dhe për një natyrë të shëndoshë të qëndrueshme.*

*Në këtë kuptim kanë ardhur thënie prej tij, por ne po mjaftohemi vetëm me kaq. Është detyrë të dihet mohimi i trupëzimit e i figurës së Tij nga ato që kërkon gjykimi i*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Ndalimi i trupëzimit dhe i figurës”; “Teuhijdu S’udûk”, kapitulli: “Ai nuk është as trup e as figurë”.

<sup>2</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 3, f. 2 dhe f. 287.

*mendjes, por mjafton shpjegimi i dhënë për këtë çështje në librat e teologjisë. Gjithashtu, Profeti dhe Ehli Bejti i tij (Paqja e All'lahut qoftë mbi ta!) janë të bashkuar që kjo dëlirësi të jetë orientim për gjykimin e mendjes. Ka shumë thënie të zotërisë së të dërguarve (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) për këtë dëlirësi, si dhe për komentimin që ka ardhur nga Kur'ani Famëlartë rreth trupëzimit, siç janë fjalët e të Lartit: "Mbi Arsh u lartësua."; "Dora e All'lahut është mbi dorën e tyre."; "Kudo është fytyra e All'lahut." Sikur të mos kishim frikë se dalim nga qëllimi, do të sillnim për ty edhe disa nga fjalët e tij. Megjithëkëtë do të përmendim vetëm thënien e përcjellë prej Ibn Abbàsit, i cili tregon: "Një jehudi erdhi tek i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ai quhej Na'thel dhe tha: "O Muhammed, dua të të pyes për disa gjëra, të cilat ka kohë që më trazojnë zemrën. Nëse ti më përgjigjesh për to, do ta pranoj Islamin."*

*Profeti i tha: "Pyet o Ebù Am'màreh."*

*Ai tha: "O Muhammed, më përshkruaj Zotin tënd."*

*Iu përgjigj: "Krijuesi nuk përshkruhet me fjalë të tjera përveçse me ato që Ai ka përshkruar Vetën. Si mund të përshkruhet Krijuesi, të Cilin shqisat nuk e shohin, iluzionet nuk shkojnë deri tek Ai, hamendjet nuk e përkufizojnë, sytë nuk e shohin dot të Lartin, që ta përshkruash siç bëjnë përshkruesit e trungjeve të fiseve, Ai është i largët në afërsinë e Tij, është i afërt në largësinë e Tij, për Atë nuk thuhet përshtatshmëri, nuk thuhet "Si?", "Apo", "Kur?", nuk thuhet "Ku është?". Ai është i Vetëm dhe gjithmonë i Kërkuari për mbështetje, ashtu siç e ka përshkruar veten e Tij. Përshkruesit kurrë nuk arrijnë ta*

*cilësojnë Atë. Ai nuk është i lindur, prej Tij nuk ka lindur ndonjë dhe për Atë nuk mund të ketë të ngjashëm.”*

*Jehudiu tha: “The të vërtetën o Muhammed. Tani më njofto për fjalën që the: “Ai është i Vetëm dhe nuk ka të ngjashëm me Të. A nuk është All’llahu Një dhe njeriu një? Atëherë Njëtimi i Tij i ngjason qenies së njeriut një.”*

*Atëherë, Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) tha: “All’llahu është Një dhe Një në kuptim, kurse njeriu është i dyzuar në kuptim, ai ka trup dhe anësi, ka trup e shpirt, kështu që përngjasimi është vetëm në kuptim dhe jo në tjetër gjë.”*

*Jehudiu tha: “The të vërtetën o Muhammed.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Kjo fjalë e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) është shumë e hapur për dëlirjen e All’llahut të Lartësuar, që ai të përngjasohet me krijesat. Gjithashtu, edhe Kur’ani Famëlartë, me fjalën më të lartë, bën thirrje për pastrim e dëlirje të All’llahut, siç është p.sh. fjala e të Lartit: “Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë.” (Sure “El-En’àm”, ajeti 103)*

*A nuk janë të mjaftueshme fjalët e qarta të këtij ajeti, për të shpjeguar e komentuar fjalët e mësipërme të të Dërguarit apo fjalë të ngjashme, që kanë ardhur prej familjes së tij, për të komentuar të tilla dukuri? Patjetër që pas këtyre fjalëve vjen mbështetja e gjithë urtësisë së mendjes për dëlirësinë e të Lartit nga përngjasimi me*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 3, f. 40 dhe f. 303.

*fenomenet e krijesat apo që Ai të unifikohet me të mundshmet.*

*Nuk e di se si ka depërtuar kjo magji dhe si i ka mbuluar disave aftësinë e shikimit dhe fuqinë e zemrës për të kuptuar. Kjo mund të jetë arsyeja se pse disa njerëz gabojnë kaq rëndë në çështjen e Njëtimit.”*

#### *Cilësitë e ardhura*

*Janë disa cilësi, që e bëjnë të detyrueshme të jenë të ardhura, siç janë: vendi, koha, lëvizja, kalimi nga një vend në tjetrin e të tjera si këto. Disa që nisen nga teksti i ajetit i mendojnë këto cilësi të domosdoshme për trupëzimin. Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i largon këto hamendje me argumentin më të arrirë, pasi disa mendojnë se All’llahu i Lartësuar është trup. Për këtë ata nisen nga fjala e Librit të lavdishëm: “...Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti; as midis pesë vetave e që Ai të mos jetë i gjashti...”(Sure “El Muxhàdeleh”, ajeti 7)*

*Imam Sàdiku në përgjigjen e tij thotë: “Ai është Një, Unik në personin e tij dhe i pavarur prej krijesave të Tij. Kështu e ka përshkruar Ai veten. Ai ka dijeni për të gjitha sendet, duke i mbikëqyrur dhe duke i sunduar me fuqinë e Tij. Për Atë nuk mbetet e panjohur as grimca më e vogël në qiej e në tokë, që të mos e përshijë atë me dituri, por jo me trup, sepse vendet tek Ai nuk mund të jenë të përcaktuara në atë që përfshijnë katër anët. Nëse do të ishte përfshirja me trup, detyrimisht do të ishin të bashkuar.”<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> “Et’teuhijd”, kapitulli: “Lëvizja dhe kalimi nga një vend në tjetrin”.

*Një herë tjetër ka dhënë një shpjegim shumë më të përmbledhur: “Kush pretendon se All’llahu i Lartësuar është për ndonjë send, e ka bërë atë të ardhur; kush pretendon se Ai është në ndonjë send, e ka bërë Atë të kufizuar, kush pretendon se Ai është mbi një send, e ka bërë Atë të mbështetur.”<sup>1</sup>*

*Muhammed ibn En’nuëmàn e ka pyetur Sàdikun për fjalën e Allahut: “Ai është Allahu (i vetmi Zot i Vërtetë) në qiej dhe në Tokë; Ai di çfarë fshihni dhe çfarë tregoni, si dhe atë që arrini të fitoni.” (Sure “El En’àm”, ajeti 3) dhe i është përgjigjur: “I tillë është Ai në çdo vend.”*

*Ai e pyeti: “Me veten e Tij?”*

*Sàdiku tha: “Ah mor i mjerë, vendet janë nga të mundshmet dhe kur ti flet për një vend për Të, patjetër duhet të thuash në të mundshmet ose diçka tjetër, sepse Ai është mbi krijesat e Tij dhe përfshin gjithçka që ka krijuar me dituri, fuqi e pushtet. Dituria e Tij, për çka është në tokë, nuk është më e pakët për çka është në qiell. Për Atë asgjë nuk është larg. Të gjitha sendet për Atë janë të barabarta me dituri, fuqi, pushtet, sundim dhe përfshirje.”<sup>2</sup>*

*E ka pyetur edhe Sulejmàn ibn Mehràn El-Aëmeshi<sup>3</sup> dhe i tha: “A lejohet të thuhet se All’llahu i Lartësuar është në një vend?”*

*Iu përgjigj: “I lartë e pa asnjë të metë është All’llahu i Lartësuar nga të tilla ngjasime. Nëse Ai do të ishte në*

---

<sup>1</sup> “Et’teuhijd”, kapitulli: “Lëvizja dhe kalimi nga një vend

në tjetrin”.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 3, f. 20 dhe f. 323.

<sup>3</sup> Do të vijë ndër përcjellësit më të dëgjuar.



*ndonjë vend, detyrimisht do të ishte i ardhur, sepse qenia në një vend ka nevojë për vend dhe nevoja është nga cilësitë e të ardhurve dhe jo nga cilësitë e Përhershmit.”<sup>1</sup>*

*I ka thënë Ebù Besjrit<sup>2</sup>: “All’llahu i Lartësuar nuk cilësohet as me kohën, as me vendin, as me lëvizjen, as me kalimin nga një vend në një tjetër dhe as me qetësinë, sepse ai është Krijuesi i kohës, vendit, lëvizjes dhe i qetësisë. I lartë është All’llahu nga fjalët e padenja që ata thonë.”<sup>3</sup>*

*Ai nuk cilësohet as me “Si?”, as me “Ku?”, as me “Kur?”. Si mund ta cilësoj unë Atë, kur është Ai që e ka përshtatur “Si-në”, derisa ajo u bë “Si?” dhe unë e njoha “Si-në” ashtu siç e ka përshtatur Ai për ne. Si do ta cilësoj unë Atë me “Ku”? Është Ai që e ka bërë “Ku-në” derisa ajo u bë ajo që unë të njoh, në ç’vend jemi dhe prej nga vijmë. Si do ta përshkruaj unë Atë me “Kur”, kur është Ai që e përshtati “Kur-in” derisa erdhi në këtë formë që unë e njoh. All’llahu i Lartësuar është hyrës në të gjitha vendet dhe dalës prej të gjitha sendeve: “Shikimet nuk e arrijnë Atë dhe Ai i arrin shikimet.”<sup>4</sup>*

*Unë them: “Qëllimi me “Si?”, me “Ku?”, me “Kur?”, është pyetje ose njoftim prej atyre që besojnë në të mundshmet. Por kur i Larti të shpjegohet me “Si?”, e me “Ku?” bëhet e detyrueshme që Ai të ketë trup dhe Nëse është kështu, atëherë Atë e arrijnë shikimet, sepse atë që ka trup dhe gjendet në një vend, patjetër që e arrijnë shikimet; kurse All’llahun e Lartësuar nuk e arrijnë*

<sup>1</sup> “Teuhijdu Sudùk”, kapitulli: “Mohimi i kohës e i vendit”.

<sup>2</sup> Do të vijë ndër përcjellësit më të dëgjuar.

<sup>3</sup> “Et’teuhijjd”, kapitulli: “Mohimi i kohës e i vendit”.

<sup>4</sup> “Et’teuhijjd”; kapitulli: “Ndalimi i cilësimit ndryshe nga sa e ka cilësua

*shikimet, por Ai i arrin shikimet.*

*Ndërmjet tij dhe Ibn Ebul Auxhë<sup>1</sup> u zhvillua një diskutim, pjesë e të cilit është edhe fjala që Ibn Ebu Auxhaë i tha Sàdikut: “Përmende All’llahun dhe lejove të mos jetë prezent (e përmende në vetën e tretë).”*

*Por Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Ç’thua kështu? Si mund të mos jetë prezent Ai, që është së bashku me krijesat e Veta dhe është dëshmuar për ta? Prandaj e kanë Atë më afër se sa damarin e qafës. Ai dëgjon fjalët e tyre, shikon trupat e tyre dhe di të fshehtat e tyre.”*

*Ibn Ebul Auxhaë tha: “A është Ai në çdo vend? Kur Ai është në qiell, si mund të jetë edhe në tokë, ose kur Ai është në tokë, si është e mundur të jetë edhe në qiell?”*

*Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Ti përshkrove të krijuarin kur lëviz nga një vend në tjetrin, i cili një herë është në një vend dhe herë tjetër lë bosh një vend, por që nuk e di ç’ndodh me atë vendin ku ishte. Për All’llahun e madhëruar, Sunduesin e përgjithshëm asnjë vend nuk*

---

<sup>1</sup> Emri i tij është Abdul Kerijm, të cilin Sej’jid El Murtedhà në librin e tij “Emàlij” e ka numëruar ndër ateistët e dëgjuar arabë dhe për shkak të ateizmit të tij është ekzekutuar nga Muhammed ibn Sulejmàni, që ishte vali i Kufes, i emëruar prej Mensurit.

*mbetet bosh pa praninë e Tij dhe Ai të mos jetë aty e në çdo vend tjetër.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Janë thënë shumë nga këto fjalë e të ngjashme me këto për dëlirjen e Krijuesit, si dhe për pozitën e Tij ndaj cilësive të krijesave të tij.”  
Ne po mjaftohemi vetëm me kaq sa u thanë.*

*Atë nuk e arrijnë shikimet*

*Disa nga pjesëtarët e grupeve islame kanë shkuar deri atje sa të thonë se i Larti shihet me sy vetëm në botën e ardhshme, ose edhe në këtë botë e në botën e ardhshme, kurse Ehli Bejti dhe në mënyrë të veçantë Sàdiku – Paqja e shpëtimi qoftë mbi të! – e hedhin poshtë këtë fjalë dhe nuk pranojnë se All’llahu shihet me sy. Në vijim për ty po sjellim disa argumente nga fjala e tij:*

*Hishàmi tregon: “Isha tek imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!). Ndërkaq erdhi Muàvijeh ibn Vehbi Abdul Melik ibn A’juni.<sup>2</sup> Muàvijeh ibn Vehbi i tha imami: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ç’na thua për njoftimin se i Dërguari i All’llahut ka parë Zotin e vet? Në ç’formë e pa? Po për hadithin e transmetuar se besimtarët do të shohin Zotin e tyre në Xhennet? Në ç’formë do ta shikojnë?”*

*Imami Buzëqeshi pastaj tha: “O Muàvije, nuk ka si të jetë më keq për një burrë që ka mbushur shtatëdhjetë apo tetëdhjetë vjeç, që ka jetuar në mbretërinë e All’llahut,*

---

<sup>1</sup> “Teuhijdu Sudùk”, kapitulli: “Lëvizja dhe kalimi nga një vend në tjetrin”.

<sup>2</sup> Të dy janë nga shokët e pasuesit e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe janë nga dijetarët e dëgjuar.

duke ngrënë nga mirësitë e Tij dhe të mos e njohë Atë ashtu siç duhet të njihet Ai. O Muàvijeh, Muhammedi (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) nuk e ka parë Zotin e Lartësuar me sy. Pamja është dy llojesh: pamje me zemër dhe shikim me sy. Kush thotë se e ka parë me zemër, ai anon kah loja dhe kush thotë se e ka parë me sy, me të vërtetë ka mohuar All'llahun dhe argumentet e Tij, kjo sipas fjalës së të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) “Kush e përngjason All'llahun me krijesat e Tij, me të vërtetë ka mohuar.” Mua më ka folur babai im, atë që i ka thënë i ati prej Husejn ibn Aliut (Paqja qoftë mbi ata!): “Është pyetur Prijësi i Besimtarëve dhe i është thënë: “O vëlla i të Dërguarit të All'llahut, a e ke parë Zotin tënd?”

Dhe ai ka thënë: “Si mund të adhuroj Atë që nuk e shikoj? Atë nuk e shohin sytë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por Atë e shikojnë zemrat me të vërtetën e besimit. Nëse besimtari thotë se e sheh Zotin e tij me sy, atëherë duhet të dijë se çdo send, për të cilin lejohet të thuhet se e shohin sytë, ai send është i ardhur, i krijuar dhe kush e shëmbëllen Atë me krijesat e Tij, në të vërtetë i ka vënë shok e ortak All'llahun. Sa mjerim për ata! A nuk e kanë dëgjuar fjalën e lartë të All'llahut: “Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë.” (Sure “El En`àm”, ajeti 103) “dhe Kur Musai erdhi në kohën e caktuar dhe Zoti foli me të, ai tha: “O Zoti im, shfaqu që të të shoh” Zoti tha: “Ti nuk mund të më shohësh! Por shiko në atë mal: nëse ai mbetet në vendin e vet, atëherë ti do të më shohësh Mua”. E kur Zoti i tij iu shfaq malit, e thërrmoi atë dhe e bëri pluhur, ndërsa Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, ai tha: “I lavdëruar qofsh Ti o Zot! Kthehem te Ty i

*penduar. Unë jam i pari i besimtarëve!” (Sure El A’râf, ajeti 143)*

*Në të vërtetë mbi mal ra drita e Tij, si një dritë që del nga vrima e gjilpërës. Toka u rrafshua dhe mali lëshoi një britmë, nga e cila Mùsai ra si i vdekur. Kur iu rikthye shpirti, tha: “I Plotpushtetshëm je vetëm Ti, pendohem para Teje nga fjala e atyre që thonë se Ti shihesh. Jam kthyer në njohjen time se Ty nuk të arrijnë shikimet. Unë jam i pari prej besimtarëve, i pari prej atyre që pohojnë se Ti sheh e nuk shihesh dhe se Ti je në pamjen më të lartë.”*

*Pastaj tha: “Detyra parësore, që duhet të plotësojë njeriu, është njohja e Zotit, pohimi prej tij se vetëm Ai meriton adhurim. Kufiri i njohjes është që të dijë se nuk ka Zot tjetër përveç Atij, se për Atë nuk ka të ngjashëm e as shembull; të njohë se Ai është i përhershëm, i qëndrueshëm dhe që nuk humb; se Ai është i cilësuar pa të ngjashëm. Asnjë send nuk është si Ai, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi. Pas njohjes së All’llahut vjen njohja e të Dërguarit dhe dëshmia e profetësisë. Më e pakta e njohjes për të Dërguarin është pohimi i profetësisë së tij, besimi te ato që i janë dhënë atij, Libri, urdhri e ndalimi. Të gjitha janë prej All’llahut të Lartësuar. Pastaj vjen njohja e imamit, me të cilin është bërë njësh me mirësinë, me cilësinë dhe me emrin e tij, në vështirësi e në gjendje të mirë. Më e ulëta e njohjes së imamit është se ai është i ngjashëm me Profetin. Përveç gradës së profetësisë, është trashëgimtar i tij dhe se bindja ndaj imamit është bindje ndaj të Dërguarit të All’llahut dhe dorëzim për atë në të gjitha punët, i referohet atij dhe veprim me fjalën e tij.”*

*Pastaj ai i përmendi Muàvijes imamët dhe emrat e tyre dhe tha: “O Muàvijeh, për ty vura një bazë për këtë,*

*prandaj puno mbi këtë bazë. Nëse do të vdisje me atë që kishe, do të ishe në gjendjen më të keqe. Mos të të mashtrojë fjala e atij që gënjen se All'llahu i Lartësuar shihet me sy."*

*Pastaj ai i foli Muàvijes për gjëra të urryera, të gabuara e shumë të çuditshme, që i kanë vënë profetëve në përgjithësi si dhe Profetit Muhammed dhe imam Aliut.*

*Këto ishin disa nga fjalët që janë transmetuar prej imam Sàdikut për pamundësinë e shikimit të All'llahut të Lartësuar. Kaq sa thanë është e mjaftueshme. Gjithashtu, prej Sadikut kemi thëniet e tij në të gjithë kapitujt e Njëtimit "Teuhijdit" dhe në të gjitha ajetet që thirren "El Ajàtul Muteshàbiheh" (ajete jo taksative). Por nuk ishte ky qëllimi, që ne të sillnim të gjitha thëniet e tij për shpjegimin e kësaj çështjeje, sepse sjellja e çdo thënieje do të na largonte nga qëllimi. Prandaj edhe kaq sa sollëm për ty është më se e mjaftueshme.*

### *Mjekësia*

*All'llahu i Lartësuar e ka zbritur Librin shpjegues për çdo send dhe Librin, sikurse thonë, e ka përmbledhur mjekësinë në dy fjalë: "O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë." (Sure "El A'râf", ajeti 31)*

*Prandaj nuk ka asgjë të çuditshme kur thuhet se në atë kohë ata, që ishin dijetarë të Kur'anit, ishin të ditur edhe në mjekësi. Tek ata ishte e dukshme shpjegimi i natyrës së sendeve, përdorimi i përzierjeve e i mjeteve dobisjellëse, si dhe njohja me elementët dëmsjellës. Të gjitha këto na orientojnë për praninë e kësaj diturie tek ata. Disa nga dijetarët e brezit të parë të myslimanëve kanë mbledhur në një libër të veçantë shumë nga fjalët e tyre për fushën e mjekësisë. Ata e titulluan librin "Tib'bul*

*Eim'meh" -"Mjekësia e imamëve". Ky libër nuk ka arritur deri në ditët e sotme.*

*El-Mexhlisiu ij, në librin e tij "Bihàrul Anuàr", ka cituar shumë prej atij libri. Gjithashtu, prej atij libri ka cituar edhe El Hurr El Àmilij në librin e tij "El Vesàil".*

*Për të argumentuar diturinë e imam Sàdikut në fushën e mjekësisë është e mjaftueshme ajo që thuhet në "Teuhjadin e Mufeddalit" për karakteristikat dhe dobitë e barnave ose ajo që thuhet për njohjen e organeve, me të cilat është e angazhuar dituria në fushën e autopsisë. Më poshtë do të vijë edhe diskutimi i tij me mjekun hindian, që është një argument dhe tregues për diturinë e tij në fushën e mjekësisë. Shkrimtari ka mundësi të shkruajë një libër të plotë me transmetimet e ardhura prej tij, për të veçantat e sendeve dhe dobitë e tyre, ose për mjekimin e sëmundjeve, të dhembjeve, etheve e profilaksisë. Të gjitha këto gjenden të shpërndara nëpër librat e haditheve e në libra të tjerë. Mbase disa nga këto lloje mjekimesh u zbuluan vetëm nga shkenca moderne, siç është mjekimi i etheve me ujë të ftohtë. Kur atë e kanë pyetur për ethet, ka thënë: «Ne të Ehli Bejtit mjekohemi duke hedhur ujë të ftohtë mbi trup.»*

*Shembull tjetër është larja e frutave para ngrënies. Për këtë ka thënë: "Në çdo fryt ka helm, prandaj, kur t'i merrni, hidhni ujë mbi to dhe i zhysni në ujë."*

*Ne të rekomandojmë kapitullin "Ushqimet dhe pijet" nga libri "El Vesàil", vëll. 3, faqe 276-311, ku do të gjesh shumë për këto që u thanë.*

*Ënjtja (El xhefru)*

*Fjala "El Xhufu" në origjinal është i vogli i deles kur i fryhet barku. Mbase në fillim kjo dituri është shkruar mbi*

*lëkurë qengji dhe kështu mund të ketë marrë këtë emër; por dituria e “El Xhufri”, gjithashtu është dituria e germave, dituri me të cilën mësohen ndodhitë e ardhshme.*

*Imam Sàdiku ka thënë se tek ata është “El Xhufri” dhe ka shpjeguar se ajo është një enë prej lëkure me ngjyrë të errët dhe brenda në të është dituria e profetëve dhe dituria e dijetarëve të kaluar të beni israilëve, prej të cilëve kanë ardhur shumë gjëra që ata dinin për “El Xhufri”. Ne, nuk e njohim këtë dituri dhe ç’qëllim ka ajo, por njohim hadithet, në të cilat përmendet “El Xhufri” dhe dimë se kjo dituri është marrë nga burimet e tyre. Këtë dituri atyre ua kishte dhënë All’llahu. Në librin “El Kâfij” janë shumë hadithe për “El Xhufri”.*

*Në lidhje me “El Xhufri” kanë folur edhe disa dijetarë të Ehli Sun’netit, që janë po nga ato që di edhe imam Aàdiku. Esh’shebelnexhij në librin “Nùrul Ebsàr” faqe 131, thotë: “Ka dobi te kafshët e mëdha.”; kurse Ibn Kutejbeh në librin “Edebul Kàtib”, thotë: “Librin “El Xhufri” e ka shkruar imam Xha’fer Sàdik ibn Muhammed Bàkir. Në të janë të gjitha sa është nevojë të dihen për të deri në Ditën e Kiametit. Për “El Xhefru” tregon edhe Ebul A’là në fjalën e tij: “Ehli Bejti u çudit, kur atyre u erdhi dituria në një lëkurë qengji. Pasqyra e astrologut është shumë e vogël.”*

*E bën atë të shohë çdo vend të banuar e të pabanuar*

*Në kapitujt e rëndësishëm ka thënë: “Është cituar prej disa dijetarësh se librin “El Xhefru”, në zonën e Mgrebit, e trashëgojnë bijtë e Abdul Mu’min ibn Aliut prej fjalës së Xha’fer Sàdikut, i cili ka një autoritet të lartë dhe një gradë që është në lartësinë e virtytit.*



### *Kimia dhe Xhàbir ibn Haj'jàni*

*Diturinë e imam Sàdikut, në fushën e kimisë, e kanë përmendur shumë autorë. Gjithashtu, edhe nxënësi i tij Xhàbir ibn Haj'jàn Es'sùfij Et'tartùsij e ka marrë këtë dituri prej tij dhe për këtë dituri ai ka shkruar pesëqind letra në një mijë faqe, në të cilat janë përfshirë letrat e Xha'fer Sàdikut.*

*Edhe nga orientalistët e hershëm e të mëvonshëm janë thënë shumë fjalë për Xhàbirin. Ndër ata që e kanë përmendur është Ibn Nedijmi, në pasqyrën e lëndës, faqe 498-503. Madje ai është zgjatur në fjalën e tij dhe e ka përmendur atë si autor të librave e letrave të shkencave të ndryshme, sidomos në fushat e kimisë, mjekësisë, filozofisë, teologjisë e në shumë fusha të tjera të dijes, për të cilat nuk do të mjaftonte jeta e zakonshme e njeriut që të shkruheshin, por jo jeta e të dalluarve të kohës, të cilëve u është dhënë zgjuarsi dhe mençuri e madhe dhe që janë përkushtuar të shkruajnë vepra të tilla. Gjithashtu, ai ka përmendur edhe veprat e tij në medh'hebin shi'a, prej të cilave doli sheshit si përkrahës i pasardhësve të imam Aliut. Duket se këtë dituri ai e mori prej imam Sàdikut, pasi siguria e imam Sàdikut për këtë dukuri është dëshmi e daljes së tij në përkrahje të pasardhësve të Aliut.*

*Ibn Nedijmi e ka përmendur Xhàbirin në librin "Edh'dherij'ah" vëll. 2, faqe 451-452, ndër autorët e shi'ave, kur flet për librin e tij, "El Ijdàh" në fushën e kimisë.*

*Sikur të shfletuje disa nga letrat e tij të botuara prej orientalistit Kraus, patjetër do të ndërgegjësoheshe që ai ishte nga përkrahësit e pasardhësve të Aliut. Këtë ai e kishte marrë prej imam imam Sàdikut. E mori prej tij si*

*imam, ndaj të cilit bindja ishte detyrë e domosdoshme dhe mendimi duhet ndjekur. Tani mësove se ai nuk ka marrë prej tij vetëm kiminë, por ka marrë teologjinë e të tjera dituri.*

*Autorët islamë e kanë ngritur shumë pozitën e Xhàbirit dhe e kanë numëruar si një ndër njerëzit, që janë krenaria e Islamit. Megjithatë, për këtë zmadhim nuk ka asnjë hiperbolizim, sepse krijimtaria e tij është më shumë se treqind mijë letra e libra në fusha të ndryshme të dijes, sidomos në shkencat teorike dhe në shkencat e natyrës, të cilat kërkojnë kohë të gjatë që të eksperimentohen e të aplikohen. Këto janë veç veprave që ai shkroi në fushat e filozofisë e teologjisë, prandaj ai është plotësisht i meritueshëm për këtë vlerësim. Është personi me të cilin mund të krenohesh pa frikë për madhësinë e tij.*

*Por orientalistët e kishin të rëndë që një arab mysliman i shekullit të dytë të Hixhretit të dallohej me të tilla mendime të sakta dhe që teoritë e tij të jenë baza të përgjithshme, mbi të cilat u ndërtua shkenca e kimisë së vjetër e të re. Prandaj ata filluan të ulin vlerën e librave të tij dhe ta paraqesin si mbledhës drush natën, herë dyshojnë për ekzistencën e tij e për kohën kur ka jetuar, herë tjetër vënë në dyshim autorësinë e tij në ato libra, herë tjetër dyshojnë për transmetimet e tij prej profesorit të tij, imam Sàdikut, herë tjetër dyshojnë për ndarjen e librave në kapituj dhe për metodologjinë, duke thënë se njerëzit e atij shekulli nuk e njihnin këtë lloj pune. Kështu vijojnë me dyshime të tjera. Disa nga këto dyshime e mashtrime i hodhi poshtë shkrintari Ismail Masar, botues i revistës “El Usùr” në artikujt e botuar në pjesët (68/ 544-551 dhe 617-625).*

*Në këtë pistë garimi shkëlqeu edhe profesori Ahmed Zekij Sàlih në shkrimet që botoi në revistën “Errisàletul Misrij’jeh”, viti i tetë (faqe 1204-1206; 1235-1237; 1268-1270; 1299-1302). Në këto shkrime ai nxori në ndritë, në mënyrë shkencore, të mbushur me urtësi, pavërtetësinë e atyre gënjeshtreve.*

*Disa herë është deklaruar për aderimin e tij ndër përkrahësit e pasardhësve të Aliut dhe në diskutimin e mendimit të profesor Krausit, faqe 1299 thotë: “Është fare e qartë për çdo njeri që ka studiuar teologji se grupet shi’a kanë qenë grupet më aktive në lëvizjen islame dhe ishte më e preferuar për themeluesin e medh’hebeve fetare, që ato të ndërtoheshin mbi baza filozofike, madje disa atribuojnë një filozofi të veçantë për imam Ali ibn Ebi Tàlibin.”*

*Kjo fjalë është prej Ahmed Zekij, me qëllim që të korrigjohet ajo çka i atribuohet Xhàbirit nga krahasimi ndërmjet mendimeve të tij teologjike dhe filozofike.*

*Në përgjithësi, është bërë e qartë aderimi i Xhàbirit ndër përkrahësit e pasardhësve të Aliut, si dhe përparimi i tij në disa dituri, veçanërisht në teologji, filozofi, mjekësi, kimi e në dituritë e përgjithshme. Në të vërtetë, mendimet e tij nuk do të ishin baza të përgjithshme për shkencën e kimisë, sepse ai e mori atë nga mademi i saktë i saj, e mori prej imam Sàdikut.*

*Në fakt, për Xhàbirin mbledha nga disa burime, që nuk mund të vihen në një nëntitull si ky dhe, për të mos u zgjatur, u mjaftova vetëm me këtë përmbledhje të shkurtër. Sikur në studimin tonë do të kishim ngarë fjalën për të gjitha sa nënkupton ky zgjerim, ky libër patjetër do të dilte*

*më disa vëllime, megjithëse nuk do të ishte pa dobi, por do ishim larguar shumë nga jeta e imam Sàdikut.*

### *Të gjitha dituritë*

*Nuk duam të themi se dituritë, që ne kemi përmendur apo për të cilat kemi shkruar dhe që shpjeguar se njerëzit i kanë marrë prej imam Sàdikut, janë gjithçka që ai kishte, pasi imami, në besimin e imamëve, detyrimisht është dijetar për të gjitha sendet. Ai është më i dituri i njerëzve në çdo dituri, art e gjuhë, ashtu siç e kupton edhe gjykimi i mendjes.<sup>1</sup> Sikur të shikonin në argumentin e dëgjuar, pa e vërtetuar atë me imamatin hyjnor, detyrimisht do të kuptonim prej tij se në çdo kohë ka një dijetar prej degës profetike në fushën e Kur'ânit e të Sun'netit, ashtu siç njofton "hadijthi thekalejn", se dijetari i Librit që i zbriti të Dërguarit, është detyrë që ai të jetë dijetar për çdo send, përderisa Libri është deri në Ditën e Gjykimit, është edhe dijetari nga dega profetike. Nuk mund të thuhet që ky dijetar të jetë në kohën e Sàdikut, pasi në kohën e tij, ndër të gjithë pjesëtarët e degës profetike, nuk kishte tjetër më të ditur se ai. Transmetimet prej tij janë të mjaftueshme për të qenë argument për këtë dituri.*

*Atëherë imam Sàdiku i Ehli Bejtit është dijetari i Ehli Bejtit në kohën e tij, është dijetari i degës profetike në Librin e All'lahut, në dituritë dhe në shkencat e tjera. Nuk do të paraqesim pjesën tjetër të diturive e të dëshmuesve të punës së tij në këto dituri, prandaj nuk është e habitshme sikur në bisedë e sipër të thuhej se imam Sàdiku i ka folur persianëve në gjuhën e tyre, me çdo njeri ka biseduar me gjuhën e tij amtare, ka diskutuar dhe ka*

---

<sup>1</sup> Këtë çështje e kemi shpjeguar në kumtesën tonë: "Esh'shijatu uel-imamàmij'jeh", referohu në këtë kumtesë nëse dëshiron ta vërtetosh.

*shkëmbyer polemika me dijetarët e çdo fushe, si p.sh. me astrologët, astronomët, dijetarët e shkencave të natyrës, mjekësisë dhe dijetarë të fushave të tjera. Ai ka folur me dijetarët e të gjitha fushave të dijes. Për këtë flasin njoftimet dhe tregojnë transmetimet e bëra prej tij.*

\* \* \*

### *SI U BË MEDH'HEBI?*

*Medhhebi, në traditën e myslimanëve, është pikë referimi për dispozitat e ligjit të fesë, por kjo nuk nënkupton që vetëm imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) të jetë medh'heb ndër dymbëdhjetë imamët, sepse shi'at besojnë se çdonjërit nga këta imamë, që nga prijësi i besimtarëve deri në imamin e fshehur e të pritshëm, është detyrë t'i besohet fjala dhe të punohet me mendimin e tij, sepse dituria e tyre, siç besojnë ata, është një dituri e vetme, e trashëguar prej të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Prandaj ata nuk kanë kundërshtime e mendime ndryshe në marrjen e diturisë, sepse ata nuk transmetojnë prej tjetër kujt përveçse prej tij. Kështu që dituria e tyre është një zinxhir i vetëm, të cilin e trashëgon djali prej babait të tij pa hulumtim dhe pa asnjë shmangie.*

*Por rastet nuk mundësuan për asnjërin prej tyre që të shpalosnin atë që kishte depozituar në ta i Dërguari dhe që të kumtonin atë që ruanin në mendjen e tyre prej tij, ashtu siç mundësuan për Xha'fer Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!), i cili dha ndihmesën e tij në shpërndarjen e njohurive dhe në*

*përhapjen e diturive që trashëgoi prej paraardhësve.  
Përhapja e tyre u bë në disa drejtime:*

1. *Koha e pavarësisë së imamatit të tij qe më e gjatë se tridhjetë vjet, edhe pse gjyshi i tij, imam Zejnul Abidijni, djali tij imam Mùsà Qazimi, si dhe nipi i tij imam Ali El Hàdi (Paqja qoftë mbi ta!) ishin bashkëshoqërues të tij gjatë kësaj kohe. Megjithëkëtë, për ta nuk u përputh ajo që u përputh për imam Sàdikun, ashtu siç do të shpjegohet më pas.*

2. *Ditët e imamatit të tij qenë edhe ditët e diturisë, të fik'hut, të teologjisë, të diskutimeve, të hadithit e të përcjelljes, të sajësive e të shkarjes në rrugën e humbjes, të mendimeve e të medh'hebeve. Të gjitha këto janë raste të meritueshme, që dijetari të të shpalosë diturinë, me qëllim që me diturinë e tij të mposhtë çdo gjë që çon në rrugën e humbjes e në të gjitha gjërat e gabuara, të zhvlerësojë mendimet e dëshirat, të flasë me zë të lartë për të vërtetën dhe ta përhapë atë.*

3. *Për një kohë ai kaloi një mirëqenie, që e patën Benij Hàshimët dhe që nuk e ka kaluar asnjëri prej imamëve. Megjithëkëtë, as për atë e as për shumicën e prindërve e të djemve të tij, koha nuk punoi që ata të shpallnin me zë të lartë njohuritë e dituritë e tyre, madje mbretërit e kohës së tyre ndaluan edhe njerëzit që t'i afroreshin atyre.*

*Asnjëri prej imamëve nuk mori në dorë pushtetin, përveç Prijësit të Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), por edhe ditët e tij qenë të shkurtra, kaluan nëpër stuhitë e luftës, frikës, kryengritjeve, sajësive dhe*

*veprimeve që çojnë në rrugën e humbjes. Të gjitha këto e detyruan atë të ecë duke gjetur shtigjet e rrugës së drejtë, pasi në kohën e tij nuk ishin ato që kishte në kohën e imam Sàdikut, si përhapja e diturisë në shtresat e shoqërisë, dalja në shesh e dëshirave, mendimeve, pretendimet e gabuara dhe medh'hebet.*

*Sàdiku qe bashkëkohës i dy shteteve të dy dinastive, të emevive dhe abasive, ishte një periudhë kohe kur nuk kishte frikë nga ligësia e mizorit e nga kërcënimi i tiranit. Kjo kohë përkoi me periudhën e fundit të shtetit të emevive dhe fillimin e shtetit të abasive; ishte koha kur emevitët dhe banorët e Shàmrit shpejtuan të vënë dorë mbi Velijd ibn Jezijdin, të cilin e vranë. Kjo shkaktoi pakënaqësi dhe kundër tyre të ngrihen nga të gjitha anët e vendit, për pasojë bazat e pushtetit të tyre u dobësuan. Ndërkaq në të gjitha anët e vendit vazhdonte të përhapej thirrja e lëvizja e hashimive. Të gjitha këto ngjarje ishin furtuna që kaluan mbi emevitët, ishin një lehtësim për jetën shkencore të Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Kur koha punoi për abasitët, ata filluan të pastrojnë vendin nga emevitët dhe të kujdeseshin për themelimin e shtetit të ri. Ti e di sa e nevojshme është koha për themelimin e forcimin e shtetit, kështu që problemi parësor i abasive ishte forcimi i mbretërimit dhe kujdesi i tyre për t'u marrë më punët e shtetit. Prandaj edhe ata, për një farë kohe, nuk i kushtuan shumë rëndësi faktit që imam Sàdiku po vazhdonte përhapjen e diturive, megjithëse Sef'ahu nuk e la fare pas dore atë, por nuk gjeti tek ai asgjë nga ato që e frikësonin. Kur erdhi radha e sundimit të Mensùrit dhe mbretërimi i tij u kristalizua, ai e nxori sheshit armiqësinë*

*ndaj imam Sàdikut herë me shtrëngime, herë duke u hequr se e kishte lënë në harresë.*

*Dijetari Shehràshùb<sup>1</sup> ka transmetuar në librin e tij “El Menàkibu an Ahvâli S’sàdik”, sipas përcjelljes së Mufeddal ibn Umerit: “Mensùri, disa herë ka dashur ta vriste Ebù Abdil’lahin (Paqja qoftë mbi të!). Sa herë që e thërriste të vinte tek ai, gjithnjë kishte qëllim ta vriste. Por, kur shikonte madhështinë që ai kishte, hiqte dorë e nuk e vriste. Megjithëkëtë ai i ndaloi njerëzit të takoheshin me të, ndaloi edhe vetë Sàdikun, që të mos rrinte me njerëzit. Masat shtrënguese, që ai ndërmoi kundër tij, kaluan aq larg, sa edhe ata, që shkonin tek ai të pyesnin për ndonjë problem të fesë, në lidhje me martesën, divorcin apo probleme që nuk i dinin, jo vetëm që nuk arrinin të takoheshin me të, por veçoheshin prej familjeve të tyre. Të gjitha këto rënduan shumë mbi pasuesit e tij dhe çdo gjë për ta bëhej gjithnjë e më e vështirë, derisa All’llahu hodhi në zemrën e Mensùrit, që t’i kërkonte imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) ta respektonte me ndonjë send që kishte ai, por askush tjetër të mos kishte të ngjashëm me atë që do t’i jepte ai. Imam Sàdiku i çoi një shkop<sup>2</sup> në gjatësinë e një krahu, që kishte qenë i Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). U gëzua shumë dhe e urdhëroi që ta ndante në katër copa. Ai e ndau shkopin. Pastaj i tha: “Nuk po të jap shpërblim tjetër, vetëm po të lë të lirë, që të përhapësh diturinë tënde te pasuesit e tu. Nuk do të kesh asnjë pasojë as ti e as ata, prandaj mos rri i ndrojtur, shpjegoju njerëzve çështjet që*

<sup>1</sup> Më sipër kemi treguar diçka edhe për këtë një koment.

<sup>2</sup> Shkop, që mbreti e mbante në dorë, për të bërë shenjë gjatë bashkëbisedimit.



*kanë nevojë dhe mos të qëndro në një vend ku rri unë. Ja kështu u përhap dituria prej Sàdikut dhe ai e lejoi deri në fund.”*

*Librat e hadithit, fik’hut, moralit, argumentimit e të tjera nga librat e njohurive e të dijeve të orientojnë ty në atë që u morën prej tij. Është e mjaftueshme të shohësh vetëm në transmetimet e shumta, që janë bërë prej tij. Për transmetuesit e tij kanë shkruar shumë autorë dhe kanë thënë se numri i atyre, që kanë transmetuar prej tij, është më shumë se katër mijë vetë. Ndër autorët është edhe Ibn Ukdeh<sup>1</sup>. Meqenëse transmetuesit e tij janë më shumë se katër mijë, atëherë sa është numri i transmetimeve? Kur vetëm një përcjellës ka transmetuar prej tij tridhjetë mijë hadithe, sa është numri i transmetimeve të transmetuesve të tjerë? Sa janë dituritë e njohuritë që i janë atribuar atij?*

*Me një fjalë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) patjetër që e dinte se ai ishte medh’heb, për faktin se atij i referohen imamitë dhe Xha’feritë nga dituritë që ishin përhapur prej tij dhe për numrin e madh të haditheve të tij që mësoheshin përmendësh, madje pjesa më e madhe e librave të shi’ave me hadithe janë të transmetuara prej tij.*

*Transmetimet prej tij nuk janë të kufizuara vetëm në shi’at, po prej tij kanë marrë edhe dijetarët e mëdhenj*

---

<sup>1</sup> Ai është Ahmed ibn Muhammed ibn Seijd El kùfij; ka qenë zejdij xhàrùdij. Është mjaft i njohur për madhështi, besueshmëri dhe mbante shumë mend përmendësh. Tregohet se ai ka thënë: “Mbaj mend përmendësh 120.000 hadithe, bashkë me transmetuesit dhe bisedoj për 300.000 hadithe.” Ka shkruar shumë libra, ndër të cilat libri me emrat e burrave, që kanë transmetuar prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Në këtë libër për çdo njërin nga transmetuesit ka nxjerrë një hadith të transmetuar prej tij. Fatkeqësisht ky libër nuk gjendet sot. Ka vdekur në Kufe në vitin 233 të hixhrit.

*bashkëkohës të tij nga të Ehli Sun'netit, ndër të cilët Mâliku, Ebù Hanijfeh, dy Sufjânët, Ej'jùbi, Ibn Xherijhu, Shë'beh e të tjerë. Madje Ibn Ebul Hadijdi edhe fik'hun e katër medh'hebeve ia atribuon atij, ashtu siç thuhet në librin "Sherhu Nehxhul Belaga", vëll. 1, faqe 6.*

*Shi'at i janë referuar atij, qëkur ai ishte në këtë jetë, sepse ai, në porosinë që u jepte pasuesve të tij, thoshte: "Për secilin prej jush, kur është i ruajtur në fenë e tij, njofton saktësisht hadithin, kryen emanetin dhe ka moral të mirë me njerëzit thuhet: "Ky është Xha'feri!" Kjo mua më gëzon. Nëse ai nuk do të ishte i tillë, e keqja dhe turpi i tij do të binte mbi mua, pasi do të thuhej: "Kjo është edukata e Xha'ferit."<sup>1</sup>*

*Kjo mbështetje në të ishte e njohur edhe në atë kohë, madje edhe Sherijh El Kâdij ka parë tek ai dy shi'a. Ata ishin i besueshmi i dëgjuar Muhammedd ibn Muslim, i njohur për shoqërimin e tij me Sâdikun dhe tjetri ishte Ebù Kurejbeh El Ezedij. Sherijhu i pa me vërejtje të dy në fytyrë dhe tha: "Dy Xha'ferij, dy Fâtimij."*

*Nga kjo mëso, se kjo mbështetje e imam Sâdikut ishte që në kohën e tij e vazhdon edhe sot.*

\* \* \*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", vëll. 2, faqe 5 dhe f. 636.

## *DISKUTIMET E TIJ*

*Për Ebù Abdil'lahi Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) ka shumë argumente të një shkalle tepër të lartë. Me këto ai ka nxjerrë në dritë të vërtetën dhe me po këto argumente ka prerë rrugën e mëkateve. Tani do të të njoftojmë me një pjesë nga këto argumente, sepse ato janë vetëm njëra anë e jetës së tij shkencore, e mbushur me mësim e këshilla, me të cilat myslimani detyrimisht duhet të veprojë.*

### *Diskutimet e tij për Njëtimin (Teuhijd)*

*Më sipër është thënë diçka nga fjala e tij për Njëtimin. Në atë pjesë u paraqitën disa diskutime, kurse këtu do të sjellim të tjera, veç atyre që janë përmendur më parë.*

*Nga këto diskutime janë edhe ato që transmetohen prej Hishàm ibn Hakemit, i cili thotë: “Në Egjipt ishte një*

ateist, të cilit i kishin kumtuar disa gjëra për Ebù Abdil'lahin (Paqja qoftë mbi të!), prandaj ai shkoi në Medine, që të diskutonte me të, por nuk e gjeti. I thanë se ka shkuar në Mekkë. Ateisti u nis për në Mekkë, ku ishte Ebù Abdil'lahi, së bashku me ne. Ateisti na gjeti, kur ne po kryenim Tavàfin. Ateisti quhej Abdul Melik dhe thirrej me epitetin Ebù Abdil'lah, takoi supin e tij me supin e Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!) dhe e pyeti: "Si e ke emrin?"

"Abdul Melik." u përgjigj ateisti.

"Po epitetin, si e ke? - e pyeti përsëri imam Sadiku.

Ai tha: "Ebù Abdil'lah."

Atëherë Ebù Abdil'lahi e pyeti: "Kush është ky mbret, rob i të cilit qenke ti? A është nga mbretërit e tokës apo është nga mbretërit e qiellit? Më thuaj për djalin tënd, është robi i zotit të qiellit apo është rob i zotit të tokës? Thuaj ç'të duash dhe vëri fre armiqësisë."

Ai nuk ktheu asnjë përgjigje.

Pastaj imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha atij: "Kur të mbarojmë Tavàfin, eja nga ne."

Kur Ebù Abdil'lahi e përfundoi Tavàfin, ateisti erdhi e qëndroi para tij, ndërsa ne ishim mbledhur tek ai. Ebù Abdil'lahi i tha ateistit: "A di ndonjë për tokën?"

"Po.", foli ai.

"Ke hyrë poshtë saj?"

"Jo.", tha.

*“A e di ç’ka poshtë saj?”*

*“Nuk e di, por them se poshtë saj nuk ka ndonjë send.”*

*Ebù Abdil’lahi tha: “Ajo që thua ti është pamundësi, prandaj përse nuk e vërteton?”*

*Pastaj Ebù Abdil’lahi e pyeti: “A je ngjitur në qiell?”*

*“Jo.”, i tha.*

*“A e di se ç’ka në të?”*

*“Jo.” i tha.*

*Atëherë ai tha: “Sa çudi me ty, nuk ke arritur as aty ku lind dielli e as atje ku ai perëndon, nuk ke hyrë nën tokë dhe nuk je ngjitur lart në qiell, madje atje as nuk je interesuar që të dish se kush i ka krijuar ato. Ti mohon çka në to. Vallë i mohon i mençuri gjërat që nuk i di?”*

*Ateisti tha: “Nuk më ka folur askush kështu ndonjë tjetër veç teje.”*

*Atëherë Ebù Abdil’lahi tha: “Për të gjitha këto ti ke dyshim mbase është ai, mbase nuk është ai.”*

*Ateisti tha: “Mbase është kjo.”*

*Ebù Abdil’lahi tha: “O burrë, për atë që nuk di nuk ka argument kundër atij që di, nuk ka argument për injorantin. O vëlla i banorëve të Egjiptit, kuptoje prej meje se ne kurrë nuk dyshojmë te All’llahu. A nuk e sheh se dielli, hëna, nata e dita hyjnë te njëra-tjetrën dhe nuk përzihen e kthehen? Ato janë të detyruara, sepse për to*

*nuk ka vend tjetër përveç vendit të tyre. Nëse ato do të kishin fuqi që të shkonin, përse kthehen? Nëse nuk janë të detyruara, përse nata nuk shndërrohet në ditë dhe dita në natë? Që të dyja i ka detyruar All'llahu, o vëlla i banorëve të Egjiptit, që të vazhdojnë. Ai, që i ka detyruar ato, është më i ditur e më i madh<sup>1</sup> se ato.”*

*Atëherë ateisti tha: “The të vërtetën.”*

*Pastaj Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: “O vëlla i banorëve të Egjiptit, me të vërtetë ai ku ju shkoni dhe që kujtoni se është koha, nëse është koha, shkon së bashku me to, përse nuk i kthen? Dhe nëse i kthen, përse nuk shkon me ta? Njerëzit janë të detyruar, o vëlla i banorëve të Egjiptit, përse qielli është i ngritur lart dhe toka është e ulët? Përse qielli nuk rrokulliset të bjerë mbi tokën? Përse nuk rrokulliset toka mbi shtresat e saj? Përse qielli e toka nuk palosen njëra mbi tjetrin dhe përse nuk palosen çka është mbi tokë?”*

*Ateisti: “Ato i mban All'llahu, Zoti i të dyjave dhe zotëria i tyre.”*

*Ateisti përqafoi besimin në prani të Ebù Abdil'lahit dhe Hamrà ibn A'juni<sup>2</sup> tha: “Kurban t'u bëfsha, nëse ateistët përqafulan besimin me dorën tënde, mohuesit besuan me dorën e babait tënd. Atëherë besimtari, që përqafoi besimin me dorën Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Më bëj ndër nxënësit e tu.”*

---

<sup>1</sup> Domethënë më i madh në forcë e në fuqi e në të tjera cilësi të ngjashme.

<sup>2</sup> Do të përmendet ndër të besueshmit e tij të dëgjuar.

*Ebù Abdil-lahi tha: “O Hishàm, merre ti!”*

*Atë e mësoi Hishàmi. Ka qenë mësuesi që i mësoi besimin banorëve të Shàmit dhe të Egjiptit, mbajti shumë mirë pastërtinë, derisa me këtë mbeti i kënaqur vetë Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!)<sup>1</sup>*

*Tek ai erdhi një ateist tjetër dhe e pyeti për gjëra të ndryshme. Disa prej tyre po i sjellim për ju: “Si e adhurojnë njerëzit All’llahun dhe kurrë nuk e shohin Atë?”*

*Ebù Abdil’lahi tha: “Atë e kanë parë zemrat me dritën e besimit, e vërtetojnë mendjet me zgjuarsinë e tyre dhe sytë nuk dyshojnë se e shohin; e shohin në sytë që vështrojnë bukurinë e përbërjes dhe përsosmërinë e ndërtimit, pastaj janë të dërguarit dhe argumentet e tyre, librat me ajetet. Dijetarët janë mjaftuar vetëm me atë që shohin nga madhështia e Tij, pa e parë me sy.”*

*Ai tha: “A nuk është Ai i fuqishëm të shfaqet derisa ata ta shohin, ta njohin? Atëherë Ai do të adhurohej me vetëdije?”*

*Ia ktheu përgjigjen: “Nuk ka përgjigje për atë që është e pamundur.”*

*Unë them: “Shikimi vërtetohet për trupat, por i Larti nuk është trup, prandaj është e pamundur që Ai të shihet, sepse e pamundura është e papërcaktueshme jo nga ana e mangësisë në fuqi, pasi mangësia është në vetë papërcaktueshmërinë.”*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 1, f. 74.

*Ateisti tha: “Prej nga janë vërtetuar profetët e të dërguarit?”*

*Ebù Abdil’lahi tha: “Ne e kemi të rrënjosur. Për ne ka një Krijues dhe një Bërës të Gjithëllartësuar, që nuk ka nevojë as prej nesh e as prej gjithçkaje që Ai ka krijuar. Ky Bërës çdo gjë e bën vetëm ashtu siç duhet bërë dhe e vendos vetëm aty ku duhet vendosur. Ai nuk ka lejuar për krijesat e Veta që ta shohin, ta prekin, të rrinë me Të e Ai të rrijë me ata, të polemizojë me ta dhe ata të polemizojnë me Atë. Është vërtetuar se për Të ka ambasadorë në krijesat e Tij dhe adhurues që i orientojnë ata për aty ku është interesi e dobia, aty ku është ruajtja e llojit të tyre, ashtu siç i orientojnë se në lënien e këtyre gjërave vjen zhdukja e tyre. Me këto që u thanë është vërtetuar se për ata ka shpjegues dhe janë profetët, më të pastrit e njerëzve, të ditur dhe edukues me urtësi, të dërguar prej Tij, që janë së bashku me njerëzit në të gjitha gjendjet e hallet që kanë, ashtu siç janë të njëjtë me ta në krijim e në konstrukt. Ata japin mbështetje prej të Urtit, të Gjithëditurit me maturi, me argumente, me fakte e me dëshmi, siç është ngjallja e të vdekurve, shërimi i të verbërve të lindur dhe i lebrozëve.”*

*Pastaj ateisti tha: “Prej çfarë sendi i ka krijuar Ai sendet?”*

*Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Nga asgjëja.”*

*Ai tha: “Si ardhka një send nga asgjëja?”*

*Ebù Abdil’lahi tha: “Sendet ose janë të krijuara prej një sendi ose prej asnjë sendi. Nëse janë krijuar prej një sendi, që ka qenë së bashku me Atë, atëherë ai send është*



*i përhershëm dhe nuk është i ardhur, ai nuk ndryshon, por as nuk përjashtohet që ai send të jetë një xhevahir i vetëm dhe me një ngjyrë të vetme. Nga kanë ardhur këto ngjyra të ndryshme dhe xhevahiret e shumta që gjenden në këtë botë? Nëse sendi, prej të cilit u bënë sendet, ishte i gjallë, prej nga erdhi vdekja? Nga erdhi jeta, nëse sendi, prej të cilit u bënë sendet, ishte i vdekur? Nuk është e pranueshme që ai të jetë prej një të gjalli e një të vdekuri të përhershëm që nuk zhduket, sepse prej të gjallit nuk vjen i vdekuri dhe ai të vazhdojë të jetë i gjallë; gjithashtu nuk është e pranueshme që të jetë prej të vdekurit të përhershëm, që vazhdon të jetë i vdekur, sepse te i vdekuri nuk ka as fuqi e as qëndrueshmëri.”*

*Unë them: “Këtë çështje, me të gjitha hollësitë e saj, imami e qartësoi me mënyrën më të bukur. Prandaj ti numëroje këtë ndër ato punë, që mendje të tjera nuk mund të bëjnë gjë tjetër veç të përsëritin atë që ka thënë imam Ebù Abdil’lahi. Nëse sendi, prej të cilit u krijuan sendet, është i përhershëm, detyrimisht ai send duhet të jetë së bashku me All’llahun e Lartësuar, i Përhershëm dhe i Pakrijuar.*

*Të supozojmë se ai është i krijuar. Atëherë kthehemi në fjalën e parë: “Nga cili send ishte i krijuar? Por i përhershmi nuk ka ardhur dhe prej të vdekurit nuk mund të jetë i gjalli, prej të gjallit nuk është i vdekuri, pasi jeta dhe vdekja nuk mund të kompozohen. Nëse do të kompozoheshin, patjetër që do kthehemi në fjalën e mësipërme, pasi vdekja nuk shërben të jetë te sendet e gjalla. Prandaj detyrimisht del të jetë se All’llahu i Lartësuar i ka krijuar sendet nga asgjëja.”*

*Pastaj ai tha: “Nga e kanë nxjerrë këtë, që sendet janë pa fillim?”*

*Imam Ebù Abdil’lahi tha: “Kjo është një tezë e atyre që thonë se sendet kanë vetërregullsi, e atyre që kanë përgënjeshtuar të dërguarit e çdo fjalë të tyre, që kanë mohuar vetë profetët dhe çdo gjë që ata kanë njoftuar. Madje librat e profetëve ata i quajtën përralla dhe vunë për vete një fe me mendimet e me miratimin e tyre. Por sendet tregojnë qartë se sendet janë të ardhura, qëkur ka filluar lëvizja e shtatë planetëve, lëvizja e tokës dhe çka mbi tokë, përmbysja e kohërave, ngjarjet e ndryshme, që ndodhin në botë, shtimi e pakësimi, vdekja e sprovat e rënda, tronditja e shpirtrave deri në pohimin se për sendet ka një Bërës dhe një Sistemues. A e ke parë se si ëmbëlsira bëhet e thartë, uji i pijshëm bëhet i hidhur, rroba e re bëhet e ronitur? Çdo gjë është në ndryshim e në zhdukje.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Me të vërtetë, argumentimi për përmbysjen e kohërave dhe për rrotullimin e planetëve janë nga argumentet shkencore më të holla që bota është e ardhur, megjithëse deri këtu nuk kanë arritur as mendjet e shumë filozofëve të mëdhenj. Gjithashtu, planetët ai i bëri një planet të vetëm dhe pastaj shpjegimi i tij me shtatë planetët. Kjo e vërtetë mund të përputhet vetëm me teorinë moderne të formës, kur me këtë ka qëllim sistemin diellor. I ngjashëm me këtë është edhe deklarimi i tij për lëvizjen e tokës, për të cilin nuk ka ëndërruar asnjëri nga të mëparshmit, pasi të gjitha këto janë nga zbulimet e shkencës moderne.”*

---

<sup>1</sup> “El Ihtixhàxh” i shejh Tabresij, f. 336-345.

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka disa diskutime edhe me Ibn Ebul Auxhà. Disa nga ato diskutime janë për Njëtimin. Ibn Ebul-Auxhà, që quhej Abdul Kerijm, ishte nga ateistët e dëgjuar dhe ka pohuar se ka fshehur hadithet e rreme te hadithet e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Është e mjaftueshme të njihet ky njeri nga këto diskutime. Është ekzekutuar për ateizmin e tij, ashtu siç është ekzekutuar edhe shoku i tij Ibnul Mukaf'fa.<sup>1</sup>*

*Nga ato diskutime kemi edhe këtë: “Një ditë ky dhe Abdullah ibn El Mukaf'fa ishin në xhaminë e shenjtë të Qabesë dhe Ibnu Mukaf'fa tha: “A i shikoni këta njerëz?” - dhe bëri shenjë me dorë në vendin e Tavàfit, - nuk ka ndonjë prej tyre që të quhet me të drejtë me emrin njeri, përveç atij të moshuarit, që është ulur, e kishte fjalën për imam Ebù Abdil'lah Xha'fer ibn Muhammedin (Paqja qoftë mbi të!) kurse të tjerët janë barinj e kafshë shtëpiake.”*

*Ibn Ebu Auxhà i tha: “Si qenka detyrë ky emër vetëm për atë plak dhe jo për të tjerët?”*

*Ai i tha Ibn Ebu Auxhà: “Unë tek ai pashë atë që nuk e pashë tek ata.”*

*Atëherë Ibn Ebu Auxhà tha: “Patjetër, duhet të provohet ajo që ti thua për të.”*

*Ibnu Mukaf'a i tha atij: “Mos kujto se kam frikë, që të mos prish atë që ti ke në dorë.”*

---

<sup>1</sup> Muhammed ibn Sulejmani, që ishte prefekti i Kufes, i emëruar prej Mensùrit, ka ekzekutuar Ibn Ebu Auxhà, i cili ishte nga nxënësit e Hasan Basriut, por devijoi nga besimi në All'lah dhe qëndroi i veçuar nga rrethi i Hasan Basriut; kurse Ibnu Mukaf'fa më parë ishte mexhùs (adhurues i zjarrit) dhe, për t'u maskuar, përqafoi Islamin. Por punët e fjalët e tij nuk tregojnë se ai ishte me të vërtetë mysliman; ishte me kombësi perse dhe mjeshtër në zanatin e ndërtimit dhe të letërsisë. Ka përshtatur në arabisht librin “Kelilea dhe Demne”. E ka ekzekutuar emiri i Basras, Sufjan El Mehelij në vitin 143, me urdhër të Mensùrit.

*Mirëpo ai i tha: “Ky nuk është mendimi yt, por ti ke frikë që të mos ulet pesha e mendimit tënd tek unë për pozitën me të cilën ti e përshkrove atë.”*

*Ibnu Mukaf’a tha: “Meqenëse ti po dëshmon kundër meje, atëherë ngrehu e shko tek ai, por ruhu nga rrëshqitat dhe mos u përkul të shtrihesh për të parë qiellin se ai të merr për litari e të çon ku të dojë, është një damkosje për atë që ke kundër teje.”*

*Ibn Ebu Auxhà shkoi dhe, kur u kthye, tha: “Mjerim për ty o Ibnu Mukaf’fa, ai nuk është njeri. Nëse në botë do të kishte qenie shpirtërore, që, kur të dëshirojë, marrin formë të dukshme trupi e, kur të dëshirojë, bëhet i padukshëm si erë, është pikërisht ai.”*

*Ai tha: “Si kështu?”*

*Ai tha: “U ula pranë tij dhe, kur tek ai nuk kishte njeri tjetër veç meje, u kthye nga unë e tha: “Nëse puna është ashtu si thonë ata dhe është ashtu siç thonë, domethënë ata që po kryenin Tavâf, kanë shpëtuar dhe ju morët fund, nëse puna është ashtu si e thoni ju dhe jo si e thonë ata, në të vërtetë jeni të barabartë ju dhe ata.””*

*I thashë: “All’llahu të mëshiroftë, çfarë themi ne e çfarë thonë ata? Fjala ime dhe fjala e tyre është e njëjta fjalë.”*

*Atëherë tha: “Si na qenka e njëjtë fjala jote dhe fjala e tyre?”*

*Ata thonë se për ta ka ringjallje, shpërblim dhe dënim. Ata besojnë se për qiellin ka një Zot dhe se qielli ka banorë, kurse ju pretendoni se qielli është bosh dhe në të nuk ka asgjë.”*

*Po përfitoja nga kjo dhe i thashë: “Çfarë e pengon Atë, nëse çështja është ashtu si thonë ata, që Ai t’u shfaqet*

*krijesave të veta dhe t'u bëjë atyre thirrje, që ta adhurojnë? Kështu ata nuk do të kenë kundërshtime që në qiell janë dy. Përse ai u fsheh prej tyre dhe çoi tek ata të dërguar? Sikur të kishte kontaktuar vetë me ta, besimi do të qe më afër tyre.”*

*Atëherë ai më tha: “I mjeri ti, si qenka i fshehur prej teje Ai, fuqinë e të Cilit ti e shikon në veten tënde? Nuk ishe, u bërë, ishe i vogël, u rrite, ishe i dobët, u bërë i fuqishëm, u dobësove, pasi ishte i fuqishëm, u sëmure, pasi ishe shëndoshë e mirë. Shëndeti të erdhi pas sëmundjes, kënaqësia të erdhi pas zemërimit, zemërimi të zuri, pasi ishe i kënaqur, hidhërimi të erdhi pas gëzimit dhe gëzimi pas hidhërimit, dashuria jote pas zemërimit tënd dhe zemërimi yt pas dashurisë tënde, vendosmëria jote pas tërheqjes tënde dhe tërheqja jote pas vendosmërisë tënde, ndijimet e tua shpirtërore pas urrejtjes tënde dhe urrejtja jote pas ndijimeve të tua shpirtërore, kujdesi yt për të pasur një send të erdhi pas frikës tënde; frika jote pas kujdesit tënd për sendin, shpresa jote pas mjerimit tënd dhe mjerimi yt pas shpresës tënde. Të blujnë zemrën ato që nuk ishin në mendjen tënde dhe largimi i asaj që ti besojë nga mendja jote. Mua vazhdon të më rëndojë në shpirt fuqia e Tij dhe që unë nuk e spraps dot, derisa kujtova se Ai do të shfaqej mes meje e atij.”<sup>1</sup>*

*Një ditë ai hyri te imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) dhe tha: “A nuk thua ti se All’llahu i Lartësuar është Krijuesi i çdo sendi?”*

*Imam Ebù Abdil’lahi i tha: “Patjetër.”*

*Atëherë ai foli: “Unë krijoj.”*

*Ai i tha: “Si krijon ti?”*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Njëtimi”, pjesa: “Ardhja e botës dhe vërtetimi i Atij që e bëri të vijë”.

*Ai tha: “Vij në një vend, pastaj qëndroj aty, derisa të bëhet kafshë. Kështu unë e krijova atë.”*

*Imam Ebù Abdil’lahi tha: “Krijuesi i çdo sendi a nuk di sa ka krijuar? Ti a e di nëse është mashkull ose femër, a e di edhe sa vjeç është?”*

*Ai heshti.*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) një diskutim të ngjashëm ka pasur edhe me Xhuad ibn Dirhemin, i cili ishte prej atyre që kishin shkarë në rrugën e humbjes e që bënte sajesa. Për këto e ka ekzekutuar prefekti i Kufes ditën e Kurban Bajramit.*

*Ibn Shehràshùbi ka thënë: “Xhuad ibn Dirhemi kishte futur ujë në një shishe e prej saj kishin dalë krimba e insekte. U tha shokëve të vet: “Unë i krijova këto, sepse unë jam shkaku që ato janë.”*

*Kjo fjalë i shkoi imam Xha’fer ibn Muhammedit dhe tha: “Le të thotë se sa janë ato? Dhe nëse i ka krijuar, ai të na thotë sa janë meshkuj e sa janë femra, sa peshon çdo njëri prej tyre dhe le të urdhërojë atë që shpejton të kthehet tek të tjerat.”*

*Ditën e dytë Ibn Ebu Auxhà u kthye tek ai dhe u ul të rrinte. Qëndronte në heshtje dhe nuk fliste. Atëherë imam Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Erdhe për të vazhduar disa muhabete që kemi lënë.”*

*Ai tha: “E desha këtë o nipi i të Dërguarit të All’lhamit.”*

*Atëherë Ebù Abdil’lahi tha: “Sa e habitshme është kjo? Mohon All’llahun dhe dëshmon se unë jam bir i të*

*Dërguarit të All'Ilahut (Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) Ai tha: "Zakoni ma dikton këtë."*

*Imam Sàdiku i tha: "Ç'të pengon të flasësh?"*

*Ai u përgjigj: "Madhështia dhe autoriteti yt, gjuha ime nuk flet dot para teje, jam ballafaquar me dijetarë dhe kam diskutuar me teologë, por kurrë nuk ka hyrë ajo frikë e ndrojtje që më fut autoriteti e madhështia jote."*

*Atëherë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Le të jetë kështu, atëherë po e hap unë me një pyetje për ty."*

*U afrua më pranë tij dhe tha: "Ti je i bërë apo nuk je i bërë?"*

*Ibn Ebu Auxhà tha: "Unë nuk jam i bërë."*

*Atëherë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Më thuaj, sikur të ishe i bërë, si do të ishe?" Abdul Kerijmi mbeti dhe nuk dinte ç'përgjigje të jepte. U mbështet në një dërrasë, që kishte para vetes, pastaj në qetësi i tha të gjitha cilësitë e tij si krijesë: "I gjatë, i gjerë, i thellë, i shkurtër, i shpejtë."*

*Atëherë Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Nëse nuk di të tjera cilësi të bërjes, atëherë quaje veten tënde të bërë, përderisa nuk gjen në veten tënde nga ato që i sjellin këto punë."*

*Abdul-Kerijmi i tha: "Ti më pyete për një çështje, që nuk më ka pyetur askush para teje dhe as që do të më pyesë ndonjë tjetër më pas për një të ngjashme."*

*Atëherë imam Ebù Abdil'lahi i tha atij: "Qetësohu, ti e di se nuk u pyete për ato që kanë kaluar. Po, sa di ti për ato që do të jenë më vonë? Ti, o Abdul Kerijm, e çarte vetë fjalën tënde, sepse ti thua që sendet, që në fillim, ishin të barabartë. Atëherë si bënë përpara e si mbetën pas? O Abdul Kerijm, a të themi diçka më qartë? Si mendon, sikur ke në një qese xhevahirë dhe dikush të thotë: "A ke dinarë në qese?" Ti i mohon atij se në thes ka dinarë; apo nëse dikush të thotë: "Më përshkruaj dinarët?"*

*Por ti nuk di t'ia përshkruash. A është e drejtë, që ti të mohosh se në qese nuk ka dinarë dhe ti nuk e di?"*

*Ai tha: "Jo."*

*Imam Ebù Abdil'lahi tha: "Bota është më e madhe, më e gjatë, më e gjerë se qesja. Mbase në botë ka një bërje që ti nuk e di, nuk di cilësitë e asaj bërjeje pa qenë e bërë."*

*Abdul Kerijmi e ndërpreu fjalën dhe disa nga shokët e tij pranuan Islamin, kurse disa të tjerë qëndruan me të.*

*Ditën e tretë u kthye dhe tha: "Dua të ndryshoj pyetjen."*

*Imam Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) tha: "Pyet ç'të duash."*

*Ai tha: "Cili është argumenti se trupat janë të ardhur? Unë nuk kam gjetur të vogël e të madh, por atij i është ngjitur edhe një tjetër i njëjtë dhe kështu ai është bërë më i madh në këtë ka asgjësim dhe kalim prej gjendjes së parë. Sikur sendi të ishte i përhershëm, nuk do të kishte as zhdukje e as gjendje, sepse sendi, që zhduket, e merr një gjendje, pranon qenien dhe zhdukjen, pra, ai u bë pasi nuk*



*ishte dhe kështu hyri në të ardhurit. Kurse me qenien e tij të parë, ai hyn në mosqenien, por kurrë e asnjëherë nuk mund të jenë së bashku cilësia e përhershme dhe e mosqenies në të njëjtin send.”*

*Abdul Kerijmi tha: “Mirë, nga ato, që më the, mësova për rrjedhën e dy gjendjeve dhe dy kohëve. Nxore edhe argumentin se ato janë të ardhura. Por, nëse sendet do të qëndronin në vogëlsinë e tyre, nga do ta nxirrje argumentin se ato janë të ardhura?”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Ne po flasim për këtë botë. Nëse e ngremë atë lart dhe vëmë një botë tjetër, asgjë nuk do të na tregonte se bota është e ardhur nga ngritja që ne i bëmë asaj dhe vënia nga ana jonë e një tjetre. Më thuaj, nga e patë mundësinë që të na imponohesh e të thuash se nëse sendet do të qëndronin në vogëlsinë e tyre, patjetër do të ishte mundësia që, kur një send të ngjitet në atë sendin tjetër të njëjtë, ai do të ishte më i madh. Fole edhe për atë, që mbi këtë send është mundësia e shndërrimeve, daljen e tij nga përhershmeria dhe hyrjen e tij në sendet e ardhura. Por pas kësaj nuk ka më asgjë o Abdul Kerijm.” Këtu e preu bisedën dhe u largua.*

*Unë them: “Përmbledhja e fjalës së imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!): “Nëse një sendi të kësaj bote i ngjitet një send tjetër, ndodh një send më i madh, që do të thotë se kemi zhdukje të gjendjes së parë dhe kalim në një gjendje tjetër. Por mbi të përhershmin nuk ndodhin të tilla ndryshime. Sikur kjo përbërje të ishte me supozim e me pandehma, sikur sendet të ishin sipas supozimit të Ibn Ebu Auxhà, të qëndrueshme në vogëlsinë e vet e të mos bëheshin të mëdha, do të ishte e befasueshme, madje më e befasueshme që sendi t’i ngjitet një tjetri dhe të ndodhte shtim në të dy sendet. Kjo është njëra nga katër të papriturat, që në fakt janë baza e matematikës. Imami u*

*kthye në argumentin se bota është e ardhur me shpjegimin më të qartë, por edhe më befasues për mendjet: nuk ndryshojnë të dy sendet. Megjithëkëtë, imam Sàdiku u përgjigj në vlerësim të këtij supozimi të pamundur, që thotë se sendet mbeten në gjendjen që janë edhe duke iu ngjitur njëri-tjetrit. Por ai u përgjigj se vetë ky supozim lejon ndodhjen e ndryshimit, daljen e sendit nga përhershmeria dhe hyrjen e tij në të ardhurit. Supozohet se sendet në këtë botë nuk e pranojnë këtë, por ne supozuam ngritjen lart të kësaj bote dhe ndryshimin e saj, kështu që mundësohet nxjerrja e argumentit të kërkuar. Sa argumentim i mprehtë e sa madhështor! Prandaj edhe Ibn Ebu Auxhà e ndërpreu bisedën dhe u largua.*

*Vitin e ardhshëm ai u takua me atë në Qabe dhe disa nga pasuesit e tij i thanë: “Ibn Ebu Auxhà u bë mysliman.”*

*Por imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Për këtë ai është i verbër dhe nuk e pranon Islamin.”*

*Kur ai pa imam Sàdikun i tha: “Zotëria im, miku im.”*

*Por ai i tha: “Ç’të solli ty në këtë vend?”*

*Ai tha: “Zakoni i trupit, rruga që ndjek vendi dhe që të shikojmë atë çmenduri të njerëzve në ruajtjen e kokës e në gjuajtjen e guralecëve.”*

*Atëherë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “Ti vazhdon në kryeneçësinë tënde e në rrugën e humbjes ku je futur o Abdul Kerijm!”*

*Por ai vazhdoi të flasë, prandaj Sàdiku i tha: “Në Haxh nuk ka polemikë.” Ngriti cepin e rrobës së sipërme nga dora dhe tha: “Nëse puna është ashtu si thua ti, por nuk është ashtu si thua ti, kemi shpëtuar ne dhe ti; nëse*

*puna është ashtu si themi ne dhe ashtu është, kemi shpëtuar ne dhe ti ke marrë fund.”<sup>1</sup>*

*Një ditë ai diskutoi me imam Sàdikun për ndërrimin e lëkurës në zjarr dhe tha: “Ç’thua për ajetin: “Ata që s’besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t’i djegim në zjarr. Sapo t’u digjet lëkura, Ne do t’ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (En’Nisà: 56)*

*Ja lëkurët mëkatuan dhe u ndëshkuan, përse duhet të merakoset tjetri për ndëshkimin?*

*Imam Ebù Abdil’lahi tha: “I mjeri ti, ajo është ajo që është dhe kjo është tjetër gjë.”*

*Ai tha: “Më ndiq mua në këtë fjalë.”*

*Ai i tha: “Si mendon për një burrë, i cili ishte mbështetur mbi një tullë balte të papjekur dhe e theu atë, pastaj mbi të derdhi ujë dhe e zbuti, pastaj e ktheu në formën e saj të parë? A nuk është ajo që ishte dhe ajo është tjetër gjë?”*

*Ai tha: “Posi jo, All’llahu të dhëntë vazhdimësinë.”<sup>2</sup>*

*Unë them: “Në këtë konkluzion kanë arritur edhe filozofët e mëdhenj pas shumë studimesh e pas një pune të gjatë e të lodhshme në analizën për të vërtetën e ndëshkimit të njeriut kriminel. Qelizat e trupit të atij që ka prekur krimineli ndërrohen e shndërrohen gjithmonë, ashtu siç thuhet në fjalën e të Lartit: “Të veshur në petka*

---

<sup>1</sup> “Tuehijdu Sudùk” -Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!-, kapitulli: “Bota është e ardhur”.

<sup>2</sup> “El-Ihtixhàxh”, e shejhut Et’tabresij, f. 354.

*mëndafshi të hollë dhe armaç, të ulur përballë njëri-tjetrit.”  
(Sure “Ed Duhàn”, ajeti 53)*

*Me këtë shpjegim të hollësishëm i përgjigjet përngjasimit të njohur të ngrënësit. Prej nga e di ti këtë filozofi të imët në ato shekuj, që nuk ua ke nuhatur aromën? Ai është imam dhe kaq mjafton.”*

*Edhe Ebù Shàkir Disànij, i cili ishte njëri nga ateistët arabë herë ka pasur diskutime e pyetje me imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!), herë tjetër me Hishàm ibn Hakemin, i cili, për fjalët që tha, e frikësoi atë me imamin e tij, Sàdikun. Kur një ditë ai i tha Hish’shàmit: “Në Kur’àn ka një ajet, që është ndër fjalët tona dhe Hishàmi e pyeti: “Cili ajet është?”*

*Dhe ai tha: “Ai është te Ne, në Librin kryesor (Leuhi-mahfûdh), i lartësuar dhe plot urtësi.” (Sure “Ez Zuruf”, ajeti 4)*

*Hishàmi tregon: “Nuk dita me çfarë t’i përgjigjem atij, prandaj erdha të njoftoj Ebù Abdil’lahin (Paqja qoftë mbi të!), i cili tha: “Fjalë e një ateisti të keq. Kur të kthehesh tek ai, pyete si e ke emrin në Kufe.*

*Do të thotë: “Filani.” Pastaj thuaj: “Si e ke emrin në Basra?”*

*Ai do të thotë: “Filani.”*

*Atëherë edhe ti i thuaj: “Kështu është edhe Zoti ynë: i adhuruar në qiell dhe i adhuruar në tokë, i adhuruar në dete, i adhuruar në vende të thata pa ujë, Ai është i adhuruar në çdo vend.”*

*Pastaj vazhdon tregimin: “Shkova tek Ebù Shakiri dhe e njoftova, por ai më tha: “Kjo është transmetuar prej Hixhazit.”<sup>1</sup>*

*Një ditë Ebù Shakir e ka pyetur Hishàm ibn Hakemin: “A ke Zot ti?”*

*Ai tha: “Patjetër.”*

*Pastaj përsëri i tha: “A është i fuqishëm Ai?”*

*Ai tha: “Po, është i fuqishëm.”*

*Përsëri ai i tha: “Ka fuqi të fusë botën të gjithë në një vezë dhe veza të mos zmadhohet dhe bota të mos zvogëlohet.”*

*Hishàmi tha: “Më prit.”*

*Dhe ai i tha: “Do të pres një vit.”*

*Pastaj u largua prej tij. Hishàmi i hipi kafshës dhe shkoi te imam Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi tël) kërkoi lejë të hyjë dhe ai e lejoi. Pastaj Hishàmi i tha: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij). Abdullah Ed’dIsàni i më erdhi me një çështje, për të cilën mund të kërkohet shpjegim vetëm te All’llahu dhe prej teje.”*

*Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi tël) i tha atij: “O Hishàm, sa shqisa ke ti?”*

*“Pesë.”, i tha.*

---

<sup>1</sup> “El Kàfij”, kapitulli: “Lëvizja dhe kalimi nga një vend në tjetrin”.

*Atëherë ai tha: “Cila është më e vogla?”*

*“Syri.”*

*Ai e pyeti: “Sa është fuqia e syrit?”*

*“Është sa e një lenteje ose e dhe më pak se ajo.”*

*Atëherë ai i tha: “O Hishàm, shiko përpara teje dhe mbi ty dhe më thuaj se çfarë shikon.”*

*Ai tha: “Shoh qiell, tokë, shtëpi, pallate, stepa, male dhe lumenj.”*

*Ebù Abdil’lahi i tha: “Ai, që është i fuqishëm të fusë të gjitha këto në një lente, ose edhe në një më të vogël se ajo, është i fuqishëm të fusë botën të gjithë në një vezë, ku as bota të mos zvogëlohet e as veza të mos zmadhohet.”*

*Hishàmi u kërrus mbi të t’i puthë duart, kokën e këmbët dhe tha: “Kaq më mjafton, o nipi i të Dërguarit të All’llahut!” dhe u largua për në shtëpinë e vet.*

*Unë them: “Kjo përgjigje doli prej imamit, që ta bëjë të heshtë, ta bindë me përgjigje të argumentuar: All’llahu nuk është i fuqishëm për gjëra të tilla, sepse kjo është e pamundur të jetë dhe për të pamundurën nuk ka të fuqishëm; gjithashtu, Ai nuk është i fuqishëm t’i bëjë ortak e shok vetes dhe as të bashkojë dy të kundërta. Por kjo nuk është nga mangësia në fuqi, por është mangësi në fuqinë, sepse fuqia ka nevojë që zbatuesi i fuqisë të jetë i mundur në vetvete. Dallimi është i qartë mes mangësisë në fuqinë dhe mangësisë mbi atë që ushtrohet fuqia. Mbase Disàniju, sikur të jepte një përgjigje të tillë, nuk do të bindej ose nuk do ta shpjegonte.”*

*Tregohet se Prijësi i Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) është pyetur për një çështje si kjo dhe ai është përgjigjur: “All’llahut nuk i adresohet pamundësia. Kurse ajo që më pyete nuk është. Kjo është përgjigja e vërtetë dhe kuptimi i asaj që ne të shpjeguam.”*

*Pastaj Disànij’ju shkoi tek Hishàmi, i cili i tha: “Nëse ke ardhur të kërkosh, përgjigja është kjo, por ai tha: “Kam ardhur tek ti mysliman dhe nuk të kam ardhur të kërktoj përgjigje.”*

*Disànij’ju u largua prej tij dhe shkoi në shtëpinë e Ebù Abdil’lahit. I kërkoi leje dhe ai e lejoi të hynte. Pasi u ul, i tha: “O Xha’fer ibn Muhammed, më trego të adhuruarin tim!”*

*Ebù Abdil’lahi i tha atij: “Si të quajnë?”*

*Ai doli dhe nuk i tha si e kishte emrin. Shokët e pyetën: “Si nuk ia tregove emrin tënd?”*

*Ai tha: “Nëse do t’i thosha se më quajnë Abdullah, ai do të më thoshte: “Kush është ky, që ti qenke rob i tij?”*

*Ata thanë: “Kthehu tek ai dhe i thuaj të tregojë se cili është i adhuruari yt dhe të mos pyesë për emrin.”*

*Ai u kthye dhe i tha: “O Xha’fer ibn Muhammed, më trego të adhuruarin tim dhe mos më pyet për emrin tim.”*

*Atëherë Ebù Abdil’lahi i tha: “Ulu.” Ndërkaq, një djalë i vogël i tij po lozte me një vezë në pëllëmbë të dorës dhe Ebù Abdil’lahi tha: “O Disànij, kjo është një kështjellë e mbuluar larg syve. Ajo ka një lëkurë të trashë, nën lëkurën e trashë ka një lëkurë të hollë, nën lëkurën e hollë*

*ka pjesë floriri të rrjedhshëm dhe një copë argjendi të shkrirë. As floriri i rrjedhshëm nuk përzihet me argjendin e shkrirë dhe as argjendi i shkrirë nuk përzihet me floririn e rrjedhshëm. Ajo është në gjendjen e vet dhe nuk del jashtë saj ndonjë dalës i mirë, që njofton se ajo është e mirë dhe as nuk hyn në të ndonjë prishës, që të njoftojë se ajo është e prishur. Nuk dihet nëse ajo është krijuar për mashkull apo për femër. Ajo shpërbëhet si penda e palloit. A mendon ndonjë rregullues për këtë?”*

*Uli pak kokën mbi gjoks dhe pastaj tha: “Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç All’llahut, Ai është i Vetëm, Ai nuk ka shok e ortak, dëshmoj se Muhammedi është rob i Tij dhe i dërguari i Tij dhe se ti je imam e argument prej All’llahut mbi robët e Tij. Unë bëj pendim për ato që kam bërë.”<sup>1</sup>*

#### *Diskutimi i tij me një mjek*

*Një ditë Ebù Abdil-lahi (Paqja qoftë mbi të!) ishte në një kuvend të Mensùrit. Aty ishte edhe një burrë nga India, i cili lexonte libra mjekësie, çka e bëri Ebù Abdil’lah Sàdikun të dëgjojë me vëmendje leximin e tij. Kur indiani mbaroi, i tha: “O Ebù Abdil-lah, a dëshiron ndonjë gjë nga ato që kam unë?”*

*Ai tha: “Jo, sepse unë kam më të mirën nga ajo që ke ti.”*

*Indiani tha: “Si është ajo?”*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, pjesa: “Teuhijdi”, kapitulli: “Bota është e ardhur dhe vërtetimi i Atij që e bën të vijë”.



*Ai tha: “Unë mjekoj të nxehtin me të ftohtin dhe të ftohtin me të nxehtin, të lagurën me të thatën dhe të thatën me të lagurën. Të gjithë punën e kthej tek All’llahu i Lartësuar, përdor edhe ato që ka thënë i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Mëso se stomaku është shtëpia e sëmundjes, se nxehtësia është ilaçi dhe unë e ushtroj trupin derisa të më bëhet zakon.”*

*Indiani tha: “Pse vetëm kjo është mjekësia?”*

*Imam Sàdiku tha: “Mos mendon se unë e kam marrë këtë prej librave të mjekësisë?”*

*Ai tha: “Po.”*

*Imam Sàdiku tha: “Betohem në All’llah që jo. Këtë unë e kam marrë vetëm prej All’llahut të Lartësuar. Prandaj, më thuaj, kush është më i ditur në mjekësi, unë apo ti?”*

*Indiani i tha: “Patjetër që unë.”*

*Atëherë imam Sàdiku tha: “Dua të të pyes për diçka.”*

*Ai tha: “Pyet.”*

*Imam imam Sàdiku tha: “Më thuaj o hindian, përse në kokë kockat kanë lidhës?”<sup>1</sup>*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

---

<sup>1</sup> Në librin “El Bihâr” ky diskutim është transmetuar prej Ibn Sinës (Avicenës) në fushën e autopsisë se kafka është e përbërë nga shtatë kocka, katër janë si mure, njëri është si bazament dhe prej kockave të tjera formohen kockat pa shtresë dhjamore, disa të tjera janë zgjatje të lidhjeve mes kockave. Unë them mbase, me fjalën kocka të buta, ka pasur qëllim kërcet.

*Imam Sàdiku përsëri e pyeti: “Përse flokët janë mbi kokë?”*

*Përsëri ai tha: “Nuk e di.”*

*Imam Sàdiku vazhdoi të pyesë: “Përse balli nuk ka flokë?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse balli ka vija?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse dy vetullat janë mbi dy sytë?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse dy sytë janë si dy bajame?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse hunda është bërë ndërmjet dy syve?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse buza dhe mustaqet janë mbi gojën?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse dhëmbët e dhëmballët janë unikë dhe dhëmbët e qenit janë më të gjatë?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse burrat kanë mjekër?”*

*Ai tha: “Nuk e di.”*

*“Përse dy shputat e duarve nuk kanë qime?”*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*"Përse thonjtë e flokët nuk kanë jetë?"*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*"Përse zemra është si boçe pishë?"*

*Ai tha: "N nuk e di."*

*"Përse mushkëritë janë dy copa dhe përse ato lëvizin në vendin e vet?"*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*"Përse mëlçia është e lakuar?"*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*"Përse veshka është si fara e bishtajoreve?"*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*"Përse gjunjët palosen nga mbrapa?"*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*"Përse këmba e prek tokën vetëm në dy majat e saj?"*

*Ai tha: "Nuk e di."*

*Atëherë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: "Por unë i di."*

*Ai i tha: "Përgjigju."*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: "Në kokë ka kocka të lidhura, sepse zgavra e kokës, nëse nuk do të ishte me kocka të lidhura, dhembja e kokës do të ishte shumë e shpejtë. Por duke qenë të ndara, dhembja e kokës*

është më larg që të ndodhë. Flokët janë mbi kokë, me qëllim që me nguljen e fijos së flokut të arrijnë yndyrat në tru dhe që të dalin avujt nga maja e flokut, kështu në kokë kthehet e nxehta në të ftohtë. Balli është pa flokë, sepse është vendi ku drita bie për sytë;<sup>1</sup> në ballë janë vijat, me qëllim që të ndalohet djersa që vjen nga koka për në sy dhe që njeriu e largon nga vetja. Këto vija janë si vijat e tokës që mbajnë ujët e lumenjve. Dy vetullat janë vënë përmbi sytë, që të lejojnë kalimin e dritës te sytë aq sa është e mjaftueshme. A e shikon, o hindian, atë që vë dorën mbi sytë nga drita e fortë, me qëllim që të sprapsë dritën e shumtë dhe të lejojë aq sa është e nevojshme? Hunda është bërë mes dy syve që të pjesëtojë dritën në dy pjesë të barabarta për secilin sy. Syri është në formën e bajames, që të lejojë rrëshqitjen e ilaçit dhe të nxjerrë jashtë sëmundjen. Nëse syri do të ishte katror ose i rrumbullakët, as ilaçi nuk do të rrëshqiste në të e as sëmundja nuk do të dilte jashtë tij. Vrimat e hundës janë bërë nga poshtë, që zbresin nga trutë materialet e rrëshqitshme të sëmundjeve dhe që të ngjiten lart aromat në organin e nuhatjes. Nëse vrimat e hundës do të ishin lart, as sëmundja nuk do të zbriste prej hundës e as aromat nuk do të nuhateshin. Mustaqet e buzët janë bërë mbi gojë, që të ndalojnë atë që zbret prej truve për në gojë, ndryshe njeriut do t'i zhyhej ushqimi e pija dhe ai do të mundohej t'i largonte ato nga vetja. Mjekra është bërë vetëm për burrat, pasi ajo plotëson nevojën e veshjes së trupit<sup>2</sup> nga shikimi dhe me mjekrën dallohet mashkulli nga femra. Dhëmbët janë bërë të mprehtë, sepse dhëmbi do të kafshojë, dhëmballët janë bërë të gjera, sepse ato bluajnë e përtypin, dhëmbët e qenit janë të gjatë, që të kenë mbështetje dhëmballët e dhëmbët si puna e kolonës në ndërtime. Shputat e duarve janë pa qime, sepse ato prekin.

<sup>1</sup> Nëse do të kishte flokë në ballë, do të pengonin dritën.

<sup>2</sup> Në zbulimin e pjesëve të trupit, që është detyrë të jenë të mbuluara.

Nëse në duar do të kishte qime, njeriu nuk do të dinte kë ka përpara dhe kë ka prekur. Flokët e thonjtë janë pa jetë, sepse zgjatja e tyre ka pamje të keqe dhe shkurtimi i tyre është i mirë. Sikur flokët e thonjtë të kishin jetë, njeriu do të kishte dhembje, kur t'i shkurtonte ato. Zemra është si boçe pishe, sepse lëvizja e saj është ritmike dhe koka e saj është bërë e hollë, që ajo të futet te mushkëritë, ku ajo freskohet nga të ftohtët e mushkërisë dhe që truri të mos nxehet nga nxehtësia e zemrës:<sup>1</sup> mushkëria është bërë në dy pjesë, që zemra të hyjë ndërmjet presioneve të saj dhe të freskohet nga lëvizjet e mushkërive; mëlçia është e lakuar, që të rëndojnë mbi të stomaku dhe të gjitha organet e tjera, me qëllim që ta shtrydhin mëlçinë dhe ajo të nxjerrë avujt që ka; veshka është si fara e bishtajoreve, sepse mbi të është vendi ku sperma derdhet pika-pika. Sikur veshka të ishte katrore ose e rrumbullakët, do të ndahej dalja e pikës së dytë nga pika e parë, për pasojë nuk do të arrihej kënaqësia që ndien njeriu nga dalja e spermës, pasi sperma zbret nga shtylla kurrizore për në veshkë. Pra, ajo është si valvul, që mbyllet e hapet dhe e flak spermën nga e para në të dytën si pushka që hedh fishekët në krahasim me harkun. Palosja e gjurit është bërë nga mbrapa, sepse njeriu ecën ndërmjet dy duarve të veta dhe kështu balancohen të dyja lëvizjet. Nëse nuk do të ishte kështu, njeriu, gjatë ecjes do të rrëzohej. Këmba është bërë e lakuar, që të mos mbështetet e gjitha mbi tokën. Nëse e gjithë këmba do të prekte tokën, do të rëndonte si të ishte një gurë mulliri. Por, duke shkelur tokën vetëm në dy anët e saj, njeriu ecën përpara dhe, kur në fytyrë ka ndonjë vështirësi, ai e shtyn në këmbën.”

Indiani i tha: “Prej nga e ke ti këtë dituri?”

---

<sup>1</sup> Lidhja ndërmjet zemrës dhe truve realizohet me enët e gjakut. Kur zemra ka nxehtësi, nxehtësia shkon edhe në tru.

*Imam Sàdiku u përgjigj: “E kam marrë prej prindërve të mi dhe ata e kanë marrë prej të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), kurse ai e ka marrë prej Xhibrijlit, prej Zotit të botëve, i Cili ka krijuar trupat e shpirtërat.”*

*Indiani tha: “The të vërtetën dhe unë dëshmoj: “Nuk ka Zot tjetër përveç All’llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All’llahut dhe rob i Tij dhe se ti je më i dituri i njerëzve të kohës.”<sup>1</sup>*

#### *Përparësia e të Dërguarit të All’llahut*

*(Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*

*Ebù Khanijs El Kufij ka thënë: “Isha në një kuvend të imam Sàdikut. Tek ai ishin një grup kristianësh, të cilët thanë: “Virtyti i Mùsàit, Isàit dhe Muham’medit është i barabartë, sepse çdo njëri prej tyre është mbajtës ligji. Atëherë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Muhammedi është më shumë virtyte se sa ata të dy, sepse ai është më i ditur dhe All’llahu i Lartësuar i ka dhënë Muhammedit nga dituria atë që nuk ia ka dhënë asnjë tjetri përveç tij.”*

*Por ata thanë: “A ka zbritur për këtë ndonjë ajet nga libri i All’llahut të Lartësuar?”*

*Imam Sàdiku tha: “Po, është fjala e të Lartit: “Ne i shkruam në Pllaka udhëzime dhe shpjegime për gjithçka: “Merri këto me bindje dhe urdhëroje popullin tënd që t’i përvetësojë në mënyrën më të mirë. Unë do t’ju tregoj shtëpinë e të pabindurve.” (Sure “El A’ràf”, ajeti 145)*

*Fjala e të Lartit për Isàinë: “E, kur Isai solli prova të qarta, tha: “Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t’ju*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 10, f. 207.

shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni. Andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua!” (Sure “Ez Zuhruf”, ajeti 63), si dhe fjala e të Lartit për Mustafanë (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): “All’llahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.” (Sure “En Nahl”, ajeti 78)

Gjithashtu, edhe fjala tjetër e të Lartit: “Në mënyrë që ta dijë nëse i përcjellin mesazhet e Zotit të tyre. Ai përfshin me dijen e Vet gjithçka që ata kanë dhe çdo gjë e ka llogaritur imtësisht.” (Sure “El-Xhinn”, ajeti 28) Prandaj, betohem në All’llah se ai ka më shumë virtyte se ata të dy. Madje sikur të vinin Mùsài dhe Isài e të më pyesnin mua, unë patjetër do t’u përgjigjesha tyre dhe do t’i pyesja ata se si janë përgjigjur.”<sup>1</sup>

Unë them: “Meqenëse Prijësi i Besimtarëve është porta e qytetit të diturisë së të Dërguarit të All’llahut, edhe djemtë e tij janë trashëgimtarë të diturisë së tij. Prandaj ata janë më të diturit e të gjithë njerëzve.”

#### Drejtësi mes grave

Njëri nga ateistët ka pyetur Ebù Xha’fer Al Ahvelin<sup>2</sup> dhe i tha: “Më shpjego pak fjalën e All’llahut të Lartësuar: “Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimeve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do t’i ruheni padrejtësisë më lehtë.” (Sure “En Nisà”, ajeti 3), si dhe fjala tjetër e të Lartit në fundin e sures “En Nisàë”: “Ju nuk do të mund të silleni drejt midis grave tuaja, edhe sikur të

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 10, f. 15 dhe f. 215.

<sup>2</sup> Besimtar i qarkut. Më poshtë do të tregojmë se ai është ndër transmetuesit e besueshëm të tij.

dëshironi. Andaj, mos anoni krejtësisht vetëm nga njëra, duke e lënë tjetrën si të varur. Nëse ju i përmirësoni marrëdhëniet dhe ruheni nga padrejtësia, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.” (Sure “En Nisà”, ajeti 129) Më shpjego dallimin mes dy fjalëve?” Ebù Xha’fer El-Ahveli tregon: “Nuk kisha ç’përgjigje t’i jepja, prandaj shkova në Medine, hyra tek Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) dhe e pyeta për dy ajetet e mësipërme.”

Ai më tha: “Përsa i përket fjalës së të Lartit: “...por nëse kini frikë se nuk do të bëni drejtësi, atëherë merrni vetëm një...”, ka për qëllim drejtësinë në shpenzim për ato, kurse për fjalën e Tij: “Kurrë nuk mund të mbani drejtësi mes grave edhe sikur të bëni kujdes...”, ka qëllim dashurinë, sepse burri është i pafuqishëm të vërë drejtësi mes dy grave, në pikëpamje të dashurisë.” Ebù Xha’feri u kthye dhe e njoftoi atë burrin. Atëherë ai tha: “Këtë ti e ke marrë prej Hixhazit.”<sup>1</sup>

Unë them: “Ky ateist u përpoq të nxirrte ndonjë kontradiktë mes dy ajeteve, pasi ajeti i dytë e bën drejtësinë mes grave të pamundur. Kjo kontradiktë mund të ishte e vërtetë vetëm nëse shpjegimi i dy ajeteve do të ishte i njëjtë. Por, meqenëse shpjegimi i parë është për shpenzimin dhe i dyti për dashurinë, atëherë nuk ka asnjë kontradiktë mes dy ajeteve.”

*Krerët e mu’tezilitëve në besëdhënien për Muhammedin*

*Tek ai hynë disa prej mu’tezileve dhe ndër ata ishin edhe Amër ibn Ubejd, Vâsil ibn Atâ Hafs ibn Sâlim<sup>2</sup> dhe*

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 10, f. 6 dhe f. 202.

<sup>2</sup> Amër ibn Ubejdi është nga Basra. Është ndër nxënësit e Hasan Basriut. Vetëm nga fama, që ai gëzoi, nuk është e nevojshme të njihesh më shumë me të. Është prej atyre që janë takuar me imam Sâdikun dhe që ka transmetuar prej tij. Ka lindur në vitin 80 të hixhrit dhe ka vdekur në vitin 144 të hixhrit.



*disa nga krerët e muëtezileve. Kjo ka ndodhur kur u vra Velijdi dhe banorët e Shàmit po grindeshin ndërmjet tyre. Ishte koha kur ata flisnin shumë dhe kur mbanin fjalime të gjata. Imam Sàdiku u tha atyre: “Ju folët shumë kundër meje, u zgjatët shumë, prandaj lëreni punën në dorën e atij që dëshironi dhe ai le të flasë për argumentin tuaj, qoftë edhe shkurtimisht.”*

*Ata e lanë çështjen në dorë të Amër ibn Ubejdit, i cili foli shumë gjatë e me fjalë të zgjedhura. Në mënyrë të përmbledhur ai tha: “Banorët e Shàmit vranë kalifin e tyre, prandaj All’llahu bëri që ata të godasin njëri-tjetrin dhe çështjen e tyre e bëri pjesë-pjesë. Atëherë ne gjetëm një burrë me fe, të mençur e me burrëri, që ishte nga tabani i hilafetit dhe ky ishte Muhammed ibn Abdullah ibn Hasani. Ne deshëm të bashkohemi rreth tij, prandaj i dhamë besën dhe pastaj për çështjen tonë t’u bënin thirrje njerëzve, që të dilnin në përkrahje të tij. Kush i jepte besën, ne ishim me atë dhe ai ishte me ne; kush mënjanohej prej nesh, edhe ne e linin atë; kush na kundërshtonte, ne e luftonim dhe e llogarisnim ndër kryengritësit, e kthenim në të vërtetën e në njerëzit mbartës të së vërtetës. Ne kishin dëshirë, që këtë ta parashtronin tek ti, sepse ne nuk gjejmë tjetër si ti dhe kjo për virtytet që ti ke, si dhe për pasuesit e shumtë që të ndjekin.”*

*Edhe për Vàsilin, fama e tij është e mjaftueshme për të njohur gjendjen e tij. Ka qenë shumë fjalëmprehtë dhe është nga krerët e muëtezileve. Fjalët i dilnin të anuara nga germa “r”, por ai e mënjanonte këtë defekt në fjalën e tij. Ka lindur në vitin 80 dhe ka vdekur në vitin 131 të Hixhretit.*

*Kurse për Hafsin nuk ka ndonjë përshkrim të dëgjuar, por atë e ka përmendur në librin “Mijzànul I’tidàl”*

*ibn Sàlim Ebul Mukàtil Semerkandij dhe në fakt e ka atakuar.*

*Në lidhje me Mukàtilin Ebul Ferxhi ka thënë: “Mbledhja e tyre është bërë në shtëpinë e Osman ibn Abdurrahman El Makhzùmijit për të diskutuar çështjen se cili do të drejtonte njerëzit dhe mendimet anuan kah Muhammedi. Kjo ka ndodhur para se ata të shkonin tek imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!).*

*Kur ai mbaroi, Ebù Abdil’lahi tha: “A jeni të gjithë ju dakord me fjalën e Amrit?”*

*Ata thanë: “Po.”*

*Atëherë ai falënderoi All’llahun, ra në salavat për Profetin (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) pastaj tha: “Ne zemërohemi kur kundërshtohet All’llahu, por kur ka bindje ndaj All’llahut ne jemi të kënaqur. Më thuaj o Amër, sikur ummeti ta linte punën e tij në dorën tënde dhe ti e more sundimin pa luftë e pa ndihma dhe të të thuhej: “Emëro në punët e shtetit kë të duash, kë do të emëroje?”*

*Ai tha: “Këtë çështje do ta bëja me këshillin e myslimanëve.”*

*Ai tha: “Me të gjithë?”*

*“Po.”, tha ai.*

*Përsëri e pyeti: “Me juristët e fesë e me të mirët e tyre?”*

*“Po.”, tha ai.*

*Përsëri e pyeti: “Me kurejshët e me të tjerët?”*

*Ai tha: “Me arabë e me joarabë.”*

*I tha: “O Amër, a do të emëroje Ebù Bekrin dhe Umerin apo do t’i lije të dy?”*

*Ai tha: “Do t’i emëroja që të dy.”*

*I tha: “O Amër, nëse do të ishte burrë, që do t’i lije ata të dy, atëherë për ty do të ishte e lejuar që edhe t’i kundërshtojë. Nëse do t’i emëroje, në të vërtetë i ke kundërshtuar që të dy. Umeri i dha besën Ebù Bekrit dhe nuk u këshillua me asnjë. Të njëjtin veprim bëri edhe Ebù Bekri me Umerin dhe nuk u këshillua me asnjë. Pastaj Umeri punën e caktimit të kalifit e bëri me kuvendin e të gjashtëve, të cilët ishin të gjithë kurejshë dhe asnjëri nga ensarët. Pastaj i porositi njerëzit me një veprim, për të cilin mendoj se as ti e as shokët nuk jeni të kënaqur.”*

*Ai tha: “Çfarë bëri?”*

*Ai tha: “Urdhëroi Suhajbin t’u printe njerëzve imam në faljen e namazit për tri ditë dhe të konsultoj me ata të gjashtë, ndër të cilët mund të konsultohesh vetëm me Ibn Umerin. Por edhe ai nuk kishte gjë në dorë. Gjithashtu, porositi muhaxhirinët dhe ensarët, që ishin në prani të tij, që pas tri ditëve të shkonin e të jepnin besën dhe të gjashtëve t’u pritej koka. Nëse katër prej tyre do ta miratonin para se të kalonin tri ditët dhe dy të kundërshtonin, atyre të dyve t’u pritej koka. A do të ishit të kënaqur që të bënit një kuvend të tillë për muslimanët?”*

*Ata thanë: “Jo.”*

*Ai tha: “O Amër, e lëmë këtë. A beson sikur t’i japësh besën shokut tënd, për të cilin ti bën thirrje dhe me*

*thirrjen tuaj të bashkohet i gjithë ummeti? Nuk kundërshtojnë as dy vetë dhe ju u nisët kundër idhujtarëve.”*

*Ata thanë: “Po.”*

*Ai tha: “Ç’do të bëni pastaj?”*

*Ai tha: “Do t’i bëjmë thirrje të pranojnë Islamin. Nëse ata nuk pranojnë, do t’i bëjmë thirrje të paguajnë xhizjen (taksa për kokë për jo myslimanët kundrejt mbrojtjes së jetës, nderit e pasurisë).”*

*Ai tha: “Po sikur ata të jenë adhurues të zjarrit e të kafshëve dhe nuk janë prej atyre që u është dhënë libri më parë?”*

*Ai tha: “Janë të barabartë.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Më thuaj për Kur’ànin. A e lexoni ju atë?”*

*Ai tha: “Po.”*

*Ai tha: “Lexo: “Luftojini ata që nuk besojnë në Allahun e as në Ditën e Kiametit, që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar All’llahu dhe i Dërguari i Tij, dhe ata, midis atyre që u është dhënë Libri, që nuk e pranojnë fenë e vërtetë, derisa të japin xhizjen (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përrulur.” (Sure “Et Teube”, ajeti 29)*

*Ai tha: “I Larti ka veçuar dhe ka kushtëzuar me ata që u është dhënë libri, si dhe ata që nuk besojnë janë të barabartë.”*

*Por, imam Sàdiku tha: “Prej nga e keni marrë këtë?”*

*Ai tha: “Kam dëgjuar njerëzit që e thonë këtë.”*

*Ai tha: “Lëre edhe këtë. Nëse ata kundërshtojnë të japin xhizjen dhe ti i luftove ata e dole fitues, ç’do të bësh me plaçkën e luftës?”*

*Ai tha: “Do të ndaj prej saj një të pestën dhe katër të pestat do t’i ndaj ndërmjet atyre që i luftuan ata.”*

*Ai tha: “Do ta pjesëtosh ndër të gjithë ata që luftuan kundër tyre?”*

*Ai tha: “Po.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Kështu ti ke kundërshtuar të Dërguarin e All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në punën e në jetën e tij, mes meje e teje janë juristët e ligjit të fesë së Medines, si dhe dijetarët e tyre. I pyesni ata dhe do të shikosh se nuk kanë kundërshtime e grindje në faktin se i Dërguari i All’llahut u ka dhënë paqe banorëve të shkretëtirës, që t’i lërë në shtëpitë e tyre dhe që ata të mos emigronin. Nëse mbi ta vjen një armik i madh në numër, me qëllim që t’i nxjerrë nga shtëpitë e tyre dhe për këtë ai lufton për ta, në këtë rast ata nuk kanë më pjesë në plaçkën e luftës, kurse ti thua do ta pjesëtoj ndër të gjithë. Kështu ke kundërshtuar të Dërguarin e All’llahut në të gjitha fjalët që the, e ke kundërshtuar atë në të gjitha sjelljet e tij në lidhje me idhujtarët.”*

*“Lëre edhe këtë, ç’na thua për sadakatë?”*

*Ai lexoi ajetin: “Lëmosha e zeqatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për lirimimin e skllevërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, All’llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.” (Sure “Et Teube”, ajeti 60)*

*Ai tha: “Po. Si i pjesëton ndërmjet tyre?”*

*Ai tha: “I ndaj në tetë kategori dhe çdonjëris nga këto i jap një pjesë.”*

*Imam Sàdiku tha: “Në qoftë se një kategori prej tyre është 10.000 vetë dhe një kategori tjetër është vetëm një burrë, ose dy apo tre burra, ti e ndan sadekanë ashtu siç e ndave për 10.000 vetë?”*

*Ai tha: “Po.”*

*Ai tha: “Përsëri ke kundërshtuar të Dërguarin e All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij), sepse i Dërguari i All’llahut gjatë gjithë jetës së tij sadakanë e banorëve të shkretëtirës e ka ndarë për banorët e shkretëtirës dhe sadakanë e qendrave të banuara e ka ndarë për banorët e qendrave të banuara. Nuk i ka ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre, por i ka ndarë sipas atyre që vinin tek ai, por edhe sipas atyre, që ai nuk i shikonte e nuk kishin ardhur tek ai. Nëse ti ke ndonjë gjë në veten tënde, juristët e Medines dhe dijetarët e saj, që të gjithë nuk kanë kundërshtim se i Dërguari i All’llahut ka vepruar kështu.”*

*Pastaj u afrua pranë Amrit dhe tha: “Kije frikë All’llahun o Amër! Edhe ju o njerëz të afërm të këtij, kijeni*

*frikë All'Ilahun, sepse babai im, i cili ishte më i miri i banorëve të tokës dhe më i dituri ndër ata për librin e All'Ilahut dhe sune'netin e të Dërguarit të tij më ka treguar se Profeti ka thënë: “Kush i godet njerëzit me shpatën e tij dhe u bën thirrje atyre për veten e vet ndër të gjithë myslimanët dhe jo për atë që është më i ditur se ai; ky njeri ka shkarë në rrugën e humbjes dhe ka marrë përsipër një punë që nuk i përket.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Një vëzhguesi pyetjet e imamit mund t'i duken të zbrazëta e larg qëllimit dhe të huaja për çështjen e besëdhënies së Muhamedit. Por pas një vështrimi të kujdesshëm, mësohet se qëllimi me këto pyetje del fare i qartë. Rasti është shumë i dallueshëm, sepse ai dëshiron që ata të kuptojnë se janë të paditur në ligjin e fesë dhe në dispozitat e atij ligji dhe se imami, të cilit ata i bëjnë thirrje, është i ngjashëm me ta nga pikëpamja e padijes dhe bazave të fesë. Atëherë, si është e mundur të emërohet injoranti në punët e ummetit, kur në mesin e tij ka më të ditur e më me shumë virtyte?”*

#### *Diskutimi i tij për përkohshmërinë*

*Sufjân Eth'theurij hyri tek imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi tël) dhe pa se rrobat e tij ishin shumë të bardha<sup>2</sup>, prandaj i tha: “Kjo rrobë nuk është nga rrobat e tua.”*

*Ai i tha: “Më dëgjo, se ç'do të them, sepse ajo është e mirë për ty për tani e për më vonë, nëse ti vdes në rrugën e Sunnetit e të Vërtetit dhe nuk vdes në rrugën e sajësave.*

<sup>1</sup> “Ihtixhâxh” i Tabresijit, vëll. 2, f. 364.

<sup>2</sup> Përngjasimi është ose nga e bardha e fortë, ose për shkak të shkëlqimit.

*Të njoftoj se i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ishte në kohë ngushtice dhe thatësire, qëkur erdhi në këtë botë. Ata, që e meritojnë më shumë të jenë ndjekësit e tij, janë njerëzit e mirë dhe jo mëkatarët, besimtarët dhe jo hipokritët, myslimanët dhe jo mohuesit. Unë nuk jam shtrënguar o Theurij, betohem në All'lah se mua më shndrit gjithçka sheh mbi mua, qëkur unë arrita të kuptoj çka kaluar në mëngjes dhe jo në mbrëmje. Betohem në All'lah se për mua nuk ka të vërtetë që të më urdhërojë, që unë ta vendos atë në ndonjë vend dhe të mos e vë atë.”*

*Tek ai shkuan disa vetë prej atyre, që hiqeshin si njerëz të përkorë (zàhidinë), të cilët u bëjnë thirrje njerëzve të jenë bashkë me ta dhe të shtrëngojnë rripin ashtu siç bëjnë edhe ata. Këta njerëz i thanë atij: “Zotëria ynë i ka fjalët e pakta, prandaj nuk kanë arritur tek ti argumentet e tij.”*

*Ai i tha atyre: “Hë, sillni argumentet tuaja!”*

*Ata i thanë: “Argumenti ynë është prej Librit të All'lahut.”*

*Ai i tha: “Ma tregoni atë, sepse unë kam më shumë të drejtë të ndjek e të punoj me të.”*

*Ata thanë: “I Larti, Madhështori, duke njoftuar për disa nga shokët e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) thotë: “Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (Sure “El Hashr”,*



*ajeti 9) dhe ka lavdëruar punën e tyre. Kurse në një vend tjetër thotë: “Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë.” (Sure “El Insàn”, ajeti 8)*

*Ne po mjaftohemi me kaq.*

*Njëri nga ta që ishin ulur tha: “Ne shohim që ju jeni të përkorë edhe në ushqimet e mira. Megjithëkëtë urdhëroni njerëzit që të japin nga pasuria e tyre, që ju të përfitoni prej saj; Ebù Abdil’lahi u tha atyre: “Lëreni atë që nuk sjell dobi, por më thoni, o njerëz, a keni dijeni rreth ajeteve anuluese dhe ajeteve të anuluar të Kur’ànit, për ajetet taksativë dhe për ajetet jo taksativë, në të cilat ka shkarë në rrugën e humbjes ai që ka shkarë dhe është shkatërruar ai që është shkatërruar prej këtij ummeti?” Ata i thanë: “Mbase për disa, por për të gjitha, jo.”*

*Atëherë imami u tha atyre: “Prej andej keni ardhur, po kështu edhe hadithet e të Dërguarit të All’llahut.*

*Ju përmendët njoftimet e All’llahut në Librin e Tij për punët e mira të atyre njerëzve. Ata e kishin të lejuar ta bënë atë punë, prandaj edhe shpërblimi i atyre për atë punë është vetëm prej Tij. All’llahu i Lartësuar ka njoftuar edhe për punën që është lënë mangët në kundërshtim me urdhrin e Tij, kështu që urdhri i Tij është bërë anulues për punën e tyre dhe ndalimin e All’llahut të Lartësuar e ka bërë shfaqje të mëshirës së Tij ndaj besimtarëve, me qëllim që ata të mos e dëmtojnë veten e familjet e tyre, sepse prej tyre ka të pafuqishëm, të vegjël, djem, pleq shumë të vjetër e plaka me moshë të madhe, të cilët nuk e përballojnë dot urinë. Prandaj, nëse unë jap sadaka dy bukë dhe jo një bukë, ata do të vdisnin nga uria, prandaj i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: “Pesë hurma, ose pesë grosh, ose pesë dinarë, ose pesë dirhem, që ka njeriu dhe ka dëshirë*

*t'i shpenzojë, shpenzimi më i mirë, që bën njeriu, është kur shpenzon për dy prindërit e vet, së dyti për vete e për familjen e tij, së treti për të afërmit e tij të varfër, së katërti për fqinjët e vet të varfër dhe e pesta në rrugën e All'lahut. Ky është shpenzimi me shpërblimin më të mirë."*

*Gjithashtu, Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë për njërin prej ensarëve, kur, në çastin e vdekjes, i dha lirinë pesë ose gjashtë sklllevërve, kur nuk kishte pronë tjetër përveç atyre, në një kohë që kishte fëmijë të vegjël: "Nëse do të më kishit njoftuar si e ka punën, nuk do t'u kisha lënë, që atë ta varrosnit së bashku me myslimanët, atë që ka lënë fëmijët e tij të vegjël t'u shtrijnë dorën njerëzve."*

*Pastaj tha: "Babai im më ka treguar se i Dërguari i All'lahut ka thënë: "Fillo me atë që ke në ngarkim, më të afërmin e pastaj më të afërmin."*

*Pastaj, (Paqja qoftë mbi të!) tha: "Kjo është ajo që thotë Libri në përgjigje të fjalës suaj dhe në ndalim të saj të vërë detyrë prej All'lahut, Madhështorit të Urtit me fjalën e Tij: "dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesme." (Sure "El Furkàn", ajeti 67)*

*A nuk e shikojnë se All'llahu i Lartësuar ka thënë ndryshe nga ajo që bëni thirrje? Prandaj veprimi i atij që bën sipas thirrjes suaj është quajtur tejkalues i masës. Në shumë ajete të Librit Famëmadh All'llahu njofton: "Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e*

*teprojnë!” (Sure “El En’âm”, ajeti 141), pra, i ka ndaluar ata nga tejkalimi i masës, por i ka ndaluar edhe nga rrudhja e dorës, prandaj Ai ka urdhëruar një rrugë të mesme, ndërmjet dhënies me të dyja duart dhe rrudhjes së dorës, të mos i japë të gjitha sa ka dhe pastaj t’i lutet All’llyhut që ta ushqejë. Natyrisht Ai nuk do t’i përgjigjet lutjes së tij, ashtu siç na tregon fjala e të Dërguarit të All’llyhut (Paqja dhe bekimi i All’llyhut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): Ka kategori njerëzish prej ummetit tim, të cilët nuk do të marrin përgjigje për lutjet e tyre: Një burrë, që lutet kundër prindërve të vet; një burrë, që lutet kundër atij që i ka marrë borxh, por që nuk ka bërë as shkresë e nuk ka as dëshmitarë kundër tij; një burrë, që lutet kundër gruas së tij, kur All’llyhu i Lartësuar e ka bërë në dorën e tij rrugën e mënjanimet të saj; një burrë, që rri në shtëpi dhe thotë: “O Zot, më furnizo!”, por nuk del të kërkojë furnizimin. Prandaj All’llyhu i Lartësuar i thotë atij: “Robi Im, a nuk kam bërë Unë për ty rrugë që të dalësh të kërkosh dhe të udhëtosh nëpër tokë? Të kam bërë me gjymtyrë të shëndosha, të kam falur shumë nga ato që janë ndërmjet teje e Meje, që të kërkosh në ndjekje të urdhrit Tim dhe të mos jesh barrë mbi familjen tënde. Nëse Unë dua, të furnizoj dhe, nëse dua, e pakësoj shumë furnizimin për ty. Tek Unë je me shumë mëkate.*

*Një burrë, të cilit All’llyhu i ka dhënë pasuri të shumtë, ai e shpenzon pa llogari. Pastaj kthehet dhe lutet: “O Zot, më furnizo me ushqim!”*

*Atëherë All’llyhu i Lartësuar thotë: “A nuk të dhashë Unë ty furnizim me bollëk? A e ekonomizove ti atë ashtu siç të urdhërova? Përse e shpenzove me të dyja duart, kur unë të kisha ndaluar nga shpenzimi me të dyja duart?”*

*Një burrë lutet për të ndërprerë lidhjet me njerëzit e tij të afërm. Pastaj All'llahu i Lartësuar i tregon emrin e tij Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe e njofton se si ai shpenzon: "Ai ka një okë flori, por i rëndon shumë që ky flori të jetë tek ai. Prandaj ai e jep të gjithin sadaka, kështu që nuk ka më asgjë. Dikush vjen t'i lypë, por ai nuk ka se ç'të japë. Atëherë lypësi e qorton. Atij i erren sytë, sepse nuk ka t'i japë atij, në një kohë që ishte shumë i mëshirshëm. All'llahu i Lartësuar e ka edukuar Profetin e Vet me urdhrin e Tij dhe thotë: "Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë." (Sure "El Isrà", ajeti 29) dhe i thotë: "Njerëzit mund të të lypin ty, por nuk të shfajësojnë. Kur ti e jep të gjithë pasurinë që ke, në të vërtetë e ke zhveshur pasurinë.""*

*Këto hadithe të Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) i vërteton Libri dhe Librin e vërtetojnë ata që e besojnë. Ju duhet të dini edhe për virtytet e për përkohshmërinë e Selmanit (All'llahu qoftë i kënaqur prej tij!) e të Ebù Dherrit (All'llahu qoftë i kënaqur prej tij!). Kur Selmani jepte atë që kishte për të dhënë, ai nuk kishte më as bukën e gojës për një vit, derisa edhe atij t'i vinte ajo që dha në masë të njëjtë dhe i thuhej: "O Ebù Abdil'lah, ti me këtë përkohshmërinë tënde bën këtë, kur ti nuk e di se mbase sot ose nesër edhe mund të vdesësh."*

*Përgjigjja e tij ishte: "Çfarë kini, që nuk luteni për mua, që të jem gjallë, ashtu siç kini frikë për vdekjen time? A nuk e dini ju o injorantë se shpirti përzihet me të zotin, kur ai nuk ka asgjë nga mjetet e jetës që të mbështet mbi të? Kur i siguron mjetet e jetës, shpirti i tij gjen qetësi."*

*Kurse Ebù Dherri kishte deve e bagëti, të cilat i milte dhe therte edhe ndonjëren prej tyre kur i hahej mish, ose kur i vinte ndonjë mik, ose kur shihte ata që kishin ujin, por ishin të varfër. Ai therte për ata deve ose dele aq sa të mjaftonte që të hiqte prej tyre oreksin për të ngrënë mish dhe mishin e pjesëtonte ndërmjet tyre, por merrte edhe një pjesë për vete. Pjesa e tij ishte si e gjithë të tjerëve, pa i bërë vetes privilegj. Kush është më i përkorë se këta? Në lidhje me ata, i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë ato që ka thënë, pasi ata arritën deri aty sa të mos kenë më asnjë send; gjithashtu, ata urdhëronin njerëzit të jepnin mallrat e dhentë që ata i preferonin më shumë se veten e familjet e tyre.*

*Mësojeni o njerëz, se unë kam dëgjuar babain tim të transmetojë prej të parëve të tij (Paqja qoftë mbi ta!) se i Dërguari i All'llahut ka thënë një ditë: “Nuk jam çuditur nga asnjë send, siç jam çuditur me një besimtar, i cili, kur jep kredi trupin e vet në këtë botë, është më mirë për atë edhe nëse ai zotëron sa përfshihet ndërmjet lindjes e perëndimit; çdo gjë, që ai bën me trupin e vet, është më mirë për atë. Ah, sikur ta di se a e meriton ndonjëri prej jush atë që unë kam shpjeguar për ju deri më sot apo të shtoj akoma më shumë?”*

*A nuk e dini se All'llahu i Lartësuar, në fillimet e çështjes, kishte vënë detyrë për besimtarin të luftonte dhjetë idhujtarë dhe që ai kurrë të mos i kthente atyre shpinën? Ai, që i kthente atyre shpinën në ato ditë, e kishte gati vendin ku do të rrinte në zjarr. Më pas, nga mëshira për besimtarët Ai e ndryshoi gjendjen e tyre, duke bërë që një besimtar të luftonte vetëm dy idhujtarë. Ky ishte një*

*lehtësim për besimtarët, njëkohësisht ishte edhe anulim që dy burra të luftonin dhjetë.*

*Unë them: “Kur myslimanët emigruan nga Mekka për në Medine në fillim të Hixhretit, emigrantët nuk kishin as ku të strehoheshin e as me se të ushqeheshin, prandaj tek ensarët kishte përparësi. Ishte një punë e domosdoshme, që emigrantëve (muhaxhirinëve) t’u plotësoheshin nevojat që kishin. Kur nevojat u plotësuan, u anulua dhënia përparësi shpenzimit dhe u urdhërua shpenzimi mesatar.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Më kanë njoftuar se a janë mëkatarë gjykatësit, kur gjykojnë çështjen e ndonjërit prej jush për shpenzimet, që ai ka detyrë të bëjë për gruan e tij, kur ai thotë: “Unë jam i përkorë, unë nuk kam asnjë send. Nëse ju thoni mëkat i madh, i bëtë padrejtësi myslimanëve; nëse ju thoni, heqim dorë, kini hyrë në armiqtësi me vetveten. Ata nuk e pranojnë sadakanë e atij që ka dhënë për të mjeruarit në çastet e fundit të jetës, kur ajo është më shumë se një e treta e pasurisë.”*

*Unë them: “Kjo duhet kuptuar kështu: “Nëse dikush lë testament, që pas vdekjes të jepet më shumë se një e treta e pasurisë së tij, ky testament nuk kryhet. Kryhet vetëm në masën e një të tretës dhe jo më shumë, kurse fjala “ata nuk e pranojnë”, domethënë nuk e pranojnë gjykatësit.”*

*Imam Sàdiku tha: “Më thoni, sikur të gjithë njerëzit të ishin si ata, që kanë qëllim përkohshmërinë, si do ndodhte? Do të thotë se ata nuk kanë nevojë për mallrat e tjetrit, as për ato që jepen sadaka për thyerje betimi e për të taksuar, apo as dukatët Farz, që jepen në flori e në argjend, në hurma dhe në të gjitha mallrat, për të cilat është detyrë të*

*jepet zekat, si: deve, lopë, dhen, etj. Nëse puna është ashtu siç thoni ju, askush nuk duhet të ruajë ndonjë send nga gjërat e kësaj bote, por e sjell atë menjëherë, edhe atëherë kur vetë është në varfëri të tejskajshme. Sa keq e mendoni këtë çështje dhe, nga injoranca, u thoni njerëzve se kjo është në Librin e All'llahut e në Sun'netin e Profetit të Tij (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Hadithet e tij vërtetohen nga Libri i zbritur, i cili ju përgjigjet ju për injorancën tuaj.*

*Më thoni, ku jeni ju me Sulejmàn ibn Dàùdin (Paqja e All'llahut qoftë mbi të dy!) kur ai iu lut All'llahut që t'i jepte aq pasuri, sa nuk do të kishte askush pas tij? All'llahu, emri i Tij u lartësoftë, i dha atij atë që i kërkoi. Por ai thoshte vetëm të vërtetën dhe me të vërtetën punonte. Prandaj nuk gjejmë që All'llahu i Lartësuar ta këtë qortuar atë për pasurinë e dhënë, madje nuk gjejmë që Ai, për punë të pasurisë, të qortoje qoftë edhe një besimtar apo të qortoje profetin Dàùd para Sulejmanit për pasurinë e për forcimin e pushtetit të tij.*

*O njerëz pajisuni me edukatën e All'llahut për besimtarët, mjaftohuni vetëm me ato që ka urdhëruar All'llahu e me ato që Ai ka ndaluar, largoni prej jush gjërat që keni dyshim dhe për të cilat nuk keni dijeni. Lëreni diturinë në dorën e dijetarëve, që të shpërbleheni e të shfajësoheni tek All'llahu i Lartësuar, kërkoheni diturinë në ajetet anuluese e të anuluarat të Kur'anit, në ajetet e tij taksative dhe jo taksativë, kërkoni dituri për gjërat që Ai ka lejuar dhe për gjërat që Ai ka ndaluar, sepse kështu do të jeni më afër All'llahut dhe do të jini më larg injorancës. Lëreni injorancën për injorantët. Injorantët janë të shumtë, kurse dijetarët të paktë. All'llahu i Lartësuar thotë: "...mbi çdo të ditshëm ka një më të ditur." (Sure "Jùsuf", ajeti 76)*

*Unë them: "Njerëzit nuk i ka çuar në shqetësimet e injorantëve dhe në mendjemadhësinë e rrugës së humbur*

*asgjë tjetër përveç mbështetjes në mendimet e veta për gjëra, që vetëm sa u shkojnë ndërmend, pa iu referuar Librit dhe Sun'netit, si dhe degëzimit të Profetit, që janë dijetarë të Librit e të Sun'netit. Ti e pe si ua shpjegoi atyre të vërtetën për përkohshmërinë.”*

### *Diskutimi i tij për Sadakanë*

*Nuk ka dyshim se njerëzit do të bien në injorancë e në mendjemadhësi, kur ata mbështeten në veten e tyre dhe nuk i referohen dijetarëve të vërtetë. Atëherë injoranti bëhet mendjemadh me gjithë varfërinë e injorancës. Megjithëkëtë injoranti llogarit se është i ditur në punët e ligjit të fesë. Por, cili do ta orientojë atë e të tjerët si ai në udhëzimin e rrugës së drejtë, kur vetë orientuesi nuk është dijetar në fushën e ligjit të fesë, ashtu siç u tha më sipër?*

*Mes imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe një injoranti, që pretendonte se ishte dijetar, u zhvillua një diskutim për sadakanë. Për këtë tregon vetë Sàdiku: “Kush ndjek dëshirat e veta dhe i pëlqen mendja e vet, është si një burrë për të cilin dëgjova se njerëzit e rëndomtë e madhështonin dhe e nderonin shumë. Prandaj desha të takohem me të pa më njohur mua. E pashë që i shkonin nga mbrapa shumë nga llumi i shoqërisë dhe ai vazhdoi t'i mashtronte derisa u nda prej tyre. Unë e ndoqa nga pas. Nuk vonoi dhe ai kaloi pranë një bukëpjekësi. E hutoi atë dhe mori prej dyqanit të tij dy bukë, pa e parë ai. Unë u çudita prej tij, por me vete thashë: “Mbase është ndonjë bashkëpunim.” Përsëri mendova: “Ç'nevojë ka ai të vjedhë?” Vazhdova të shkoj prapa tij, derisa ai ndaloi tek një pemëshitës, të cilit, priti rastin të ishte i hutuar, i vodhi dy kokrra shegë. U çudita me këtë veprim të tij, por përsëri thashë: “Mbase është bashkëpunim.” Përsëri thashë me vete: “Mirë, po ç'nevojë ka të vjedhë?”*

*Vazhdova të shkoj prapa tij, derisa arriti tek një i sëmurë, të cilit i vuri në dorë dy bukët dhe dy shegët.*



*Pastaj e pyeta për veprimin e tij. Ai tha: “Shpresoj të jesh Xha’fer ibn Muhammedi.”*

*I thashë: “Patjetër.”*

*Ai më tha: “Çfarë dobie të sjell ty ndershmëria e origjinës tënde krahas injorancës tënde?”*

*I thashë: “Ç’është ajo që unë nuk e ditkam?”*

*Ai tha: “Fjala e All’llahut të Lartësuar: “Kush bën një të mirë, shpërblehet me dhjetëfishin e saj dhe kush bën një të keqe, ai ndëshkohet vetëm për atë që bëri...” (Sure “El En’âm”, ajeti 160)*

*Kur unë vodha dy bukët, ishin dy të këqija dhe kur vodha dy shegët, përsëri ishin dy të këqija. Pra, u bënë katër të këqija. Por, kur unë i dhashë ato sadaka, për të gjitha së bashku unë kam dyzet të mira. Nga këto dyzet të mira, hiq katër të këqijat, për mua mbeten tridhjetë e gjashtë të mira.”*

*I thashë: “Të qaftë nëna jote! Ti nuk e di Librin e All’llahut. A nuk e ke dëgjuar fjalën e All’llahut të Lartësuar: “...All’llahu pranon vetëm prej atyre që frikësohen.” (Sure “El Mâide”, ajeti 27)*


*Kur ti vodhe dy bukët, ishin dy të këqija dhe, kur vodhe dy shegët, përsëri ishin dy të këqija. Por, kur ato ia dhe një tjetri, pa lejen e të zotit, mbi këto katër të këqija shtove edhe katër të këqija të tjera dhe nuk shtove dyzet të mira mbi katër të këqijat.”*

*Ai filloi të më shikojë me vëmendje, prandaj edhe unë u largova prej tij dhe e lashë.”*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) për këtë interpretim të keq ka thënë: “Shkojnë vetë në rrugën e humbjes dhe çojnë edhe të tjerët në atë rrugë.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Janë të shumta interpretime të tilla. Por nuk ka ndonjë gjë që nuk dihet, pasi ato janë parashtruar në burimin e parë. Ata, që i thonë, janë prej atyre që pinë ujë nga mirazhi.*

*Këto ishin disa pjesëza nga diskutimet e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe nga argumentimet e tij për ata që i largohen rrugës së udhëzimit të drejtë dhe i bëjnë bisht rrugës së vërtetë. Këto diskutime janë një pikë uji prej atij shiu të bollshëm. Ne sollëm vetëm një model prej asaj jete shkencore me argumente e me fakte.”*



## JETËSHKRIMI DHE MORALET E TIJ

### Parashtrim

*Në të vërtetë, jetëshkrimi i njeriut merr udhë nga ndërgjegjja e tij dhe vetë ndërgjegjja e tij është e palosur në jetëshkrimin e tij.*

*Mjeshtrit e mashtrimit, nëpërmjet fjalëve të bukura dhe të hipokrizisë, përpiqen të paraqiten me cilësi të mira e me udhëzimin në rrugën e drejtë, duke fshehur atë që*

---

<sup>1</sup> “Vesàilu Shi’ah” vëll. 2, f. 57; kapitulli: “Është e preferueshme që sadakaja të jepet nga pasuria më e mirë”.

*kanë në ndërgjegje dhe duke i tjetërsuar mashtrimet e lustrat që kanë në zemër. Shumë shpejt punët i diskreditojnë të tilla gjëra të maskuara dhe shumë shpejt fjalët i nxjerrin bojën këtyre qëllimeve, sepse ato, që janë në zemër, i nxjerrin jashtë gjuhët dhe lëvizjet e punëve.*

*Rroba e hipokrizisë lejon të shihet çka poshtë saj.*

*Kur ti vishesh me atë, në të vërtetë je lakuriq.*

*Ndodh që burrat, me morale të mira dhe dijetarët, të kërkojnë që prej tyre të mos dalin në shesh ato të fshehta të brendshme të kulluara dhe ato ndërgjegje të pastra, me qëllim që t'i ruhen ngatërresave ose edhe famës. Por nuk mund të rrijnë pa u përhapur ato frymëmarrje të zgjuara dhe pa ndriçuar vezullimin e atyre shpirtrave të shenjtë.*

*Sido që të jetë e mira tek një njeri, edhe pse fjalët e mbajnë atë të fshehur nga njerëzit, do të merret vesh.*

*Gjuhët e njerëzve për zbulimin e të vërtetave janë lapsat e të Vërtetit.*

*Po, mbase një shtresë është e prirur të mbrojë këtë grup mashtruesish nga fanatizmi, ose të mashtruar nga fasada e punëve të mira; ose një grup mund të shtyhet të atakojë dinjitetin e mendjeshkurtërve, të cilët ndjekin persona që i ka gërryer sëmundja e smirës dhe e urrejtjes, ose injoranca e inati. Të vërtetën nuk e injoron dot ai që di të vështrojë dhe diellin nuk e mbulon dot shosha.*

*Jetëshkrimi i imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) na tregon e na mëson për ndërgjegjen e tij, pasi ai është prej Ehli Bejtit, prej të cilëve All'illahu e ka hequr ndyrësinë dhe i ka pastruar ata plotësisht. Ai është prej degës profetike,*

*degës që la Profeti (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Në ummetin e tij kjo degë të jetë shpjeguese e Librit të All'lahut dhe së bashku të jenë mbajtëse e fortë, që shpëton prej greminave të rrugës së humbjes këdo që kapet pas saj.*

*Jetëshkrimi i tij i pastër ka pasur qëllim që njerëzit t'i nxjerrë nga mashtrimi në udhëzimin e rrugës së drejtë, nga verbëria në shikimin e thellë, nga injoranca në dituri. Kjo është ajo ndërgjegje e palosur në këtë jetëshkrim.*

*Nga jetëshkrimi i tij do të sjellim ato që janë shprehëse të këtyre moraleve të mëdha, të dobishme, të shenjta e të larta, të cilat nuk shikojnë shqetësim e vullnet tjetër veç luftës në rrugën e All'lahut, në orientim e në përmirësim.*

#### *Edukata e tij në shoqëri*

*Moralet e lavdëruara mund të jenë instinkte psikike dhe karaktere të lindura, siç janë: toleranca, trimëria, buzëqeshja dhe gojëtaria. Mund të jenë edhe me të mësuar e me të përftuar, siç është: adhurimi, përkohshmëria, dituritë, shkencat dhe letërsia.*

*Në të vërtetë, ai që ka njoftime për jetëshkrimin e Hâshimit e të djemve të tij, do të shohë se te ata janë mbledhur virtytet dhe të dyja pjesët e tyre, moralet me dy gjysmat e veta, derisa nga mesi i tyre u dallua i Dërguari (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe që mori më të lartën nga secili virtyt, ashtu siç e kërkonte pozita e tij hyjnore. Prandaj edhe djemtë e tij kishin më shumë të drejtë të ngjiteshin në rrugën e tij e të ndiqnin më të bukurën nga shembulli i tij, veçanërisht virtytin që ishte stema e fisit të tij para kësaj trashëgimie të moraleve e të virtyteve prej të Dërguarit.*

*Kush përqendrohet në jetëshkrimin e Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!) e di se ai ishte një personalitet shembullor e model i babait të tij (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), pasi burri vlerësohet vetëm me punën e tij edhe kur ai hesht të shpjegojë gjendjen e tij e punët e tij. Për atë do të flasë vetë personi.*

*Më sipër ti ke parë se ç'kanë thënë dijetarët për rëndësinë e tij. Është e mjaftueshme aq sa ke lexuar nga jeta e tij shkencore dhe tani do të lexosh pjesë të zgjedhura nga fjala e tij, ku përfaqësohet pozita e tij në morale e në virtyte. Ai duhet të ishte plotësisht i meritueshëm edhe në fjalën e tij para se pasuesit e tij të mbështeteshin tek ai dhe të merrnin prej tij.*

*Nuk i heqim atij asgjë nga madhështia, nëse pohojmë faktin se, ai ndër shokët e tij, ishte si gjithë të tjerët dhe se tek ai nuk dallohej asnjë gjurmë madhështie e afërsie me imamatin. Një ditë ai, i shoqëruar nga disa shokë të tij, doli të shkonte për të ngushëlluar një të afërmin e tij, që kishte humbur djalin. Zhurma e këpucëve të tij u ndërpre. Ai i mori këpucët në dorë dhe filloi të ecë zbathur. Ndërkaq e pa Ibn Ebu Mendhùri<sup>1</sup>, hoqi këpucët nga këmbët e tij dhe, me këpucë në dorë iu afrua Ebù Abdil'lahit. Ai u mënjanua prej tij si ai që është i zemëruar dhe nuk i pranoi t'i veshë këpucët. E i tha: "Jo, në radhë të parë duhet të bëjë durim personi, të cilit i ka ndodhur fatkeqësia." Vazhdoi të ecë këmbëzbathur dhe hyri ashtu tek personi për të cilin kishte ardhur ta ngushëllonte.*

*Kur shtronte tryezën e bukës, ai i nxiste ata të hanin dhe i shtynte të kishin dëshirë të hanin. Ndodhte që u sillte edhe ndonjë gjë tjetër, pasi ata ishin ngopur. Kur ata i kërkonin ndjesë, ai thoshte: "Nuk keni bërë ndonjë gjë, pasi më i dashuri prej jush për ne është ai që ha më mirë tek ne."*

---

<sup>1</sup> Do të përmendet ndër shokët e tij të besueshëm.

*Pastaj i tregonte atyre shembuj nga Profeti (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) me qëllim që ata të ndiheshin mirë shpirtërisht gjatë ngrënies dhe të hanin edhe diçka më shumë, prandaj i tregonte fjalën e Profetit: “Për ne, më i dashur ndër ju është ai që ha më mirë.” Kjo ishte fjala kur Profeti (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) e kishte thënë atëherë kur me të ishin Selmani, Mikdàdi dhe Ebù Dherri.*

*Pasi ata kishin mbaruar së ngrëni, ai u sillte një tenxhere me oriz. Kur ndonjëri prej tyre nuk hante, ai i thoshte atij: “Dashuria e burrit për vëllanë e tij ka rëndësi kur ai shtrin dorën në gjellën e tij.” Pastaj i shkonte afër dhe nxiste atë që të hante.*

*Kur shihte se ata nuk po hanin mirë nga turpi, u thoshte: “Dashuria e burrit për vëllanë e tij duket qartë në atë që ai ha tek ai.”<sup>1</sup>*

*Kur i shtronte ushqim shokëve të tij, i vinte përpara nga ushqimet më të mira. Disa prej tyre thanë: “Ebù Abdil'lahi na shtronte ëmbëlsirë me qumësht dhe ëmbëlsirë me hurma e gjalpë, pastaj na vinte përpara bukë me vaj. Prandaj i thuhej: “Sikur të kishe vënë pak rregull në këtë punë edhe dita do të ishte më e drejtë.” Por ai thoshte: “Ne vëmë rregull me urdhrin e All'lahut. Kur ai na jep me bollëk, edhe ne shtrojmë me bollëk. Kur Ai na i ngushton mjetet e jetesës, patjetër që edhe ne e ngushtojmë.”*

*Ebù Hamzai thotë: “Ishim disa vetë tek Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) kur na sollën një ushqim që ne nuk e kishim shijuar ndonjë herë. Na sollën edhe hurma, aq të*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 47, f. 40, dhe f. 48.

*bukura e aq të pastra, sa mund të shihnin fytyrat tona te ato.*<sup>1</sup>

*Ndodhte që ndonjë prej miqve, për shkak të moshës, të mos ngrihej dot për disa nga nevojat personale. Nëse nuk gjendej ndonjë tjetër, që ta ndihmonte këtë mik, ai ngrihej vetë dhe thoshte: “I Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) e ka ndaluar që miku të përdoret për shërbim.”<sup>2</sup>*

*Kishte shumë dëshirë që miku të qëndronte tek ai. Prandaj nuk e ndihmonte që të nisej për udhëtim. Kështu veproi edhe me ata të fisit Xhuhejneh, kur i urdhëroi shërbyesit e tij, që të mos i ndihmonin ata në përgatitjet e tyre për udhëtim.*

*Ata i thanë: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut na prite dhe mikpritja jote nuk ka si të jetë më e mirë. Na dhe nga gjërat më të mira. Pastaj urdhërove shërbyesit e tu, që të mos na ndihmojnë në përgatitjet për udhëtimin tonë.*

*Pastaj i tha: “Ne të Ehli Bejtit nuk i ndihmojmë miqtë tanë të largohen prej nesh.”<sup>3</sup>*

*Nga dëshira e madhe, që kishte për të bërë mirësi, për të shtruar bukë dhe për të shkëmbyer vizita të ndërsjella, ai i urdhëronte pasuesit e tij me fjalë e me shenja, mbase bërja me shenjë ishte mënyra më e bukur që ata të kishin dëshirë për punë. Kur ai njoftonte për këto cilësi të nderuara, thoshte: “Nëse unë marr pesë dirhem dhe me këto para hy në tregun tuaj, ku blej ushqime, me*

<sup>1</sup> “Vesàilu Shi’ah”, vëll. 3, f. 26.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 47, f. 40, dhe f. 48.

<sup>3</sup> “Mexhàlisu Sudùk”, kuvendi i 18<sup>të</sup>.

*qëllim që të mbledh një grup myslimanësh, kjo është shumë e dashur për mua se sa t'i jap lirinë një skllavi.”<sup>1</sup>*

*Ai thoshte: “Është më e dashur për mua të ushqej një besimtar nevojtar, se sa t'i bëj atij një vizitë. Nëse unë e vizitoj atë, kjo është më e dashur për mua se sa të liroj dhjetë skllever.”<sup>2</sup>*

*Janë të shumtë shembujt e këtij lloji, që na kanë ardhur prej tij.*

*Është nga sekretet e mënyrës së tij dhënia përparësi e disa punëve ndaj disa të tjerave, por dashamirësia dhe dashuria, që ai fuste në mbledhjet me njerëzit, ishin shumë më të vlerësuara.*

*Shiko se si ai të ofron ty sjelljen e mirë dhe virtytin, me qëllim që të nxisë, që edhe ti të bësh nga ato punë dhe thotë: “Nuk ka gjë, që më gëzon më shumë se sa një dorë që e ndjek tjetra, sepse nga e fundit ndërpritet falënderimi për të parën.”<sup>3</sup>*

*Unë them: “Vetë ndjenja e brendshme e dëshmon vërtetësinë e kësaj, sepse dorën e vetme, kur e pason njeriu me një ndërprerje, vetë ndërprerja e ndalon falënderimin për këtë bërje dhe falënderimi nuk vazhdon nëse atë nuk e pasojnë duart.*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 2, f. 15 dhe f. 203.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 2, f. 18 dhe f. 203.

<sup>3</sup> “Keshful Gum'meh”, në lidhje me gjendjet e Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!), vëll. 2, f. 205.



*Nëse dëshiron të qëndrosh në punën e tij, e cila për ty përfaqëson mëshirën e mirësinë, shiko se çka bërë ai në “Ajni Zijâd”, që është një tokë pjellore në rrethinat e Medines. Në këtë tokë kishte shumë hurma dhe disa pronarë kërkuan prej tij që ai ta përmendte këtë në favor të tyre.*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Unë kisha urdhëruar që, kur të piqen frutat, në muret e saj të hapej një e çarë, ku do të hynin njerëzit që të hanin; gjithashtu kisha urdhëruar që çdo ditë të viheshin dhjetë kosha dhe në çdo kosh të uleshin dhjetë vetë. Sa herë që të hanin dhjetë, të vinin dhjetë të tjerë dhe secili prej tyre të merrte një Med (njësi matëse, e barabartë me 950 gr.) me hurma të buta; gjithashtu, për fqinjët e kësaj toke: pleq, plaka, fëmijë, të sëmurë, gra e ata që nuk kanë fuqi të vijnë për të ngrënë, kisha urdhëruar që çdo njeriu t’i jepej një Med dhe, kur të vilesnin hurmat, të gjithë, sa kishin punuar, të merrnin shpërblimin e tyre, kurse pjesën tjetër e çoja në Medine, për t’ua ndarë shtëpive dhe atyre që e meritonin nga dy ose tri barrë, më pak ose më shumë, vetëm sipas asaj që kishin të drejtë të merrnin. Pas kësaj arrita të marr një mijë dinarë, ndërsa i gjithë prodhimi i asaj toke vlerësohej katër mijë dinarë.<sup>1</sup>*

*Ky shpenzim, edhe pse ishte tre mijë dinarë, nuk ishte ndonjë shumë e konsiderueshme për dorëdhënien e Ehli Bejtit. Bukuria e këtij veprimi qëndron në interesimin e tij të madh për të mbajtur lidhje me të pafuqishmit dhe çuarja e mirësisë deri tek ata.*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuâr” f. 47, f. 51 dhe f. 83.

*Më e lavdëruara e moraleve është ajo që tregon për veten e tij, kur thotë: “Kur më vinte nevojtar, unë shpejtoja t’i plotësoja atij nevojën nga frika se më pas ai nuk do të kishte më nevojë për atë.”<sup>1</sup>*

*Këto ishin disa nga moralet e tij të larta, që për ty përfaqësojnë mirësinë e dashamirësinë, mishërojnë dashurinë dhe butësinë, sikur të gjithë njerëzit të ishin njerëzit e familjes së tij, vëllezërit e tij dhe anëtarë të fisit të tij. Megjithatë, në këtë veprim nuk kas asgjë të rrallë, sepse kështu është pozita e imamet te ummeti.*

### *Bujaria e tij*

*Bujaria, kjo cilësi e nderuar e shpirtit të tij, ishte dobisjellëse për personin të cilit ai i jepte, por në bujarinë e tij kishte edhe dobi të tjera shoqërore. Bujari i bën njerëzit, që ta duan dhe dashuria është premisë për lidhje të ngushta, madje dashuria është një shkallë, që në krye të jetë bujari dhe atij t’i dëgjohet fjala. A ka më parësi, kur njeriut përmirësues e bamirës i dëgjohet fjala?*

*Ai i thotë Mual’lâ ibn Khanijsit: “O Mual’lâ, bëhu i dashur tek vëllezërit e tu duke mbajtur lidhjet me ta, sepse All’llahu i Lartësuar dhënien e ka bërë dashuri dhe mosdhënien e ka bërë zemërim. Beto hem në All’llah, nëse më lypni mua dhe unë ju jap, kjo për mua është shumë më e dashur se sa të më lypni dhe unë të mos ju jap gjë e pastaj ju të zemëroheni me mua.”*

*Imam Sàdiku jepte shumë dhe jepte nga gjërat e mira. Ai jepte, por nuk kishte frikë se do të varfërohej. Më*

---

<sup>1</sup> Kuvendi i 31-të nga libri “Emàlij” i Tusji’jit (Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!)

*sipër, kur kemi folur për moralin e tij, janë përmendur dhurimet e tij. Më poshtë do të tregohet se sa shumë i mbante ai lidhjet me të afërmit.*

*Një herë ai i dha një të varfëri katërqind dirhem. I varfëri i mori dhe u largua duke falënderuar. Pastaj i tha shërbyesit të vet: “Sille këtu!”*

*Ai tha: “Zotëria im, unë lypa dhe ti më dhe, po çfarë ka pas dhënies?”*

*Ai i tha të varfërit: “I Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: “Sadakaja më e mirë është ajo që jep pasuri.”, por ne ty nuk të pasuroam, prandaj merre këtë unazë, për të cilën unë kam dhënë dhjetë mijë dirhem. Kur të jesh në nevojë, shite për këtë shumë.”*

*Mendoj se imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ia shtoi dhënien atij për falënderimin, pasi falënderimi është premisë për më shumë, ashtu siç thotë i Larti në fjalën e Tij: “...nëse falënderoni, do t’ua shtoj mirësitë për ju...” (Sure “Ibràhim”, ajeti 7)*

*Ai i ka dhënë një lypësi nga tre kokrra rrushi deri në dy grushte, madje ka shtuar nga njëzet dirhem deri në një këmishë, pa përmendur dhënie të tjera. Kjo për shkak se lypësi ka mbetur i kënaqur me dhënien e parë dhe ka falënderuar All’llahun e Lartësuar, prandaj ai nuk ka hequr dorë nga dhënia, derisa lypësi ka lënë falënderimin dhe është lutur për imam Sàdikun (Paqja mbi të!).*

*Një herë tek ai ka hyrë El Eshxha Selemij dhe e gjeti sëmure, u ul pranë tij dhe e pyeti për sëmundjen e tij.*

*Imam Sàdiku i tha: “Numëroje sëmundjen dhe mbaj mend se ç’kam thënë për të. Pastaj tha:*

*All’llahu nga Vetja të ka veshur shëndetin.*

*Në gjumin tënd i heq rrobat, por gjumi natën nuk të zë.*

*Prej trupit tënd del sëmundja,*

*ashtu siç del përlja e lypësit prej fytit tënd.*

*Dhe tha: “O djalë ke gjë me vete?”*

*Ai tha: “Kam katërqind.”*

*Ai i tha: “Jepja ato Eshxhait.”<sup>1</sup>*

*Ndërkaq tek ai hyri Mufeddal ibn Kajs ibn Rum’màneh, i cili ishte nga transmetuesit e tij të besueshëm e nga shokët e tij të mirë. Ai u ankua për disa probleme që kishte dhe i kërkoi që të lutej për atë. Ai thirri: “O vajzë, sille këtu atë qesen, që na e solli Ebù Xha’feri.”*

*Ajo ia solli qesen. Ai tha: “Në këtë qese ka katërqind dinarë, prandaj merri dhe mbaro punë me këto.”*

*Por ai i tha: “Për All’llah jo, kurban t’u bëfsha! Unë nuk desha këtë, por desha vetëm lutjen.”*

*Atëherë ai i tha: “Unë nuk do ta lë lutjen, por ti mos ia thuaj të gjithë njerëzve hallin që ke, ndryshe do të jesh i përlur tek ata.”<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> “Menàkib” e Ibn Shehràshùbit, vëll. 4, f. 274.

<sup>2</sup> “El Keshà”, f. 121.

*Këto ishin vetëm disa nga aromat e tij. Ne i përmendëm vetëm si shembull për atë krijesë të lartë dhe si argument për pajisjen e tij me këtë cilësi të lavdërueshme. Nuk kemi qëllim të përmendim të gjitha bërjet e tij të mira. Janë mjaft ato që janë thënë e ato që do të vijjnë më pas.*

#### *Dhurimet e tij të fshehta*

*Dhënia edhe nëse është prej babait ose prej një më të mëshirshmi se babai, siç është imami, tek ai që e merr shkakton një çarje dhe përrulje, sepse ajo njofton për virtytin e dhënësit dhe nevojën e marrësit, por nevoja është e metë dhe ndjenjat për këtë të metë sjellin thyerje në shpirt.*

*Te dhënësi mund të shkaktohet një tronditje e vogël për dhënien dhe një mburrje për virtytin e dhënësit, përveç asaj që për dhënien në disa shpirta mund të jetë dashuria për ta përmendur, për t'u krenuar, për të fituar emër ose mund të jetë për hipokrizi dhe për gjëra të tjera, nga të cilat shpirtërat e pastër janë të kulluar.*

*Për këtë e për të tjera shkaqe, njerëzit me morale të lavdërueshme kanë ngulmuar vazhdimisht që ta mbajnë të fshehtë dhënien. Të fshehtë në dhënien e tyre kanë qenë pjesëtarët e Ehli Bejtit. Mund të ndodhë të lexosh jetëshkrimin e ndonjë imami prej tyre, patjetër do të gjesh që ai pret errësirën e fundit të natës dhe në fshehtësi kryen dhëniet e tij.*

*Nuk e mendoj këtë këmbëngulje për ndonjë gjë tjetër përveç faktit se ata nuk dëshirojnë të shikojnë përruljen e nevojtarit ndaj bamirësit, megjithëse ata janë me shpirtin më të pastër dhe janë në pozitën më të lartë, që të kenë nga ngatërresat e dhënies sheshit.*

*Kështu gjejmë, që edhe Sàdiku, sapo vinte errësira e fundit e natës, merrte një enë lëkure, ku fuste bukë, mish e pará, e ngarkonte mbi shpinë dhe shkonte tek ata banorë të Medines që kishin nevojë. E ndante atë që kishte në thesin e tij, pa u njohur se kush ishte. Madje ata nuk e mësuan kurrë se kush qe ai, derisa ai u nis në udhëtimin për tek Zoti i tij. Vetëm atëherë ata mësuan se dhuratat i kishin prej Abù Abdil'lahut (Paqja qoftë mbi të!).<sup>1</sup>*

*Këtë rrugë kishin ndjekur edhe prindërit e tij më parë dhe po këtë rrugë ndoqën edhe djemtë e tij më pas.*

*Kjo sjellje e tij nuk ishte e veçantë vetëm ndaj banorëve të Medines. Ai kështu sillej edhe ndaj hashimive, pasi e ndiente detyrim që t'u jepte atyre dhe njëkohësisht të rrinte i panjohur, që ata të mos e dinin se ato gjëra ua kishte dhënë ai. Prandaj dërgonte dikë që t'i çonte atyre para dhe e porosiste: "U thuaj atyre se këto pará janë dërguar prej Iraku."*

*Kur ai, që kishte dërguar, kthehej, e pyeste se ç'kishin thënë ata.*

*Ai i thoshte: "Ata thanë: "Ty ta shpërbleftë All'llahu me të mira që u jep të afërmve të të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)."*

*Kurse Xha'feri thoshte: "All'llahu gjykoftë mes nesh e atij."*

*Kur Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) binte në sexhde thoshte: "O Zoti im, përrole qafën time për djemtë e babait tim."<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", f. 38, f. 40 dhe f. 47.

<sup>2</sup>

I

njëti

burim.

*Një ditë i dha një enë lëkure Ebù Xha'fer El-Khath'amiut<sup>1</sup> dhe e urdhëroi që ta çonte tek një burrë i fisit hashim, gjithashtu e urdhëroi që këtë punë ta mbante të fshehtë. Kur ai e çoi enën e lëkurës, ai, që e mori, tha: "Ty All'illahu ta shpërbleftë me të mira, vazhdimisht më dërgon dhe ne me atë jetojmë, por nuk më ka dërguar gjë Xha'feri, qoftë edhe një dirhem, megjithëse ai ka shumë pasuri."<sup>2</sup>*

*Imam Sàdiku nuk linte pa i çuar ndonjë gjë as atyre që i kishin ndërprerë lidhjet me të, madje edhe kur ishte në çastet e agonisë dhe grahmat e vdekjes i regëtinin në fyt, ai urdhëroi që të vazhdonin dhënien; urdhëroi që Hasan ibn Ali El Eftasit t'i jepeshin shtatëdhjetë dinarë. Ata që e dëgjuan i thanë: "Si do t'i japësh atij njeriu, që ka ngritur mbi ty shpatën për të të vrarë?"*

*Paqja e shpëtimit qoftë mbi të! – tha: "Të mjerët ju, a nuk e lexoni ajetin: "dhe ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar All'illahu të mbahen, që kanë frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarisë së rëndë." (Sure "Er'Rad", ajeti 21)*

*All'illahu ka krijuar Xhennetin dhe e ka bërë atë me erë të këndshme, që nuhatet në distancë deri një mijë vjet, por erën e tij nuk do ta nuhasë ai që është sjellë keq me prindërit dhe që ka ndërprerë lidhjet me të afërmit."<sup>3</sup>*

*Këto ishin disa nga dhëniet e tij të fshehta e mbajtja e lidhjeve me të afërmin në mënyrë sekrete, por që për ty përfaqësojnë mëshirën e dashamirësinë.*

---

<sup>1</sup> Ai është Muhammed ibn Hakijmi, i cili është nga pasuesit e Sàdikut dhe nga transmetuesit e tij. Për atë kanë njoftuar transmetuesit dhe grupi i dijetarëve.

<sup>2</sup> "Menàkib" i Ibn Sheràshùbit, vëll. 4, f. 273.

<sup>3</sup> "Gajbeh" e shejh Tusit (Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!) dhe "Menàkib", vëll. 4, 273.

### *Butësia e tij*

*Falja atij i vinte për të afërmin e për të largëtin dhe, kur ai takohej me ta, takohej me zemër të hapur, madje e priste me bamiresi e mirësjellje të madhe.*

*Në kapitullin e mëparshëm ke parë një pjesë të faljes së tij. Raste të tilla ka shumë, si në jetën e tij politike, ashtu edhe në sprovat e rënda. Gjithashtu, kjo shfaqje e moralit të tij do të trajtohet edhe në shumë kapituj të tjerë, kurse tani për ty do të sjellim disa njoftime, nga të cilat do të mësosh për këtë njeri bujar.*

*Kur merrte vesh se e kishin përgojuar ose e kishin sharë, ai ngrihej dhe përgatitej të falte namaz. Pasi falte namaz, lutej gjatë e ngulmonte në lutje, duke i kërkuar Zotit të tij që të mos e dënonte fajtorin për padrejtësinë që i kishte bërë dhe as të mos ishte i ashpër ndaj atij fajtori për veprimin që kishte kryer, sepse e drejta i takonte atij dhe ai ia kishte dhuruar atë fajtorit, duke e falur padrejtësinë e tij.<sup>1</sup>*

*Kurse për të afërmit ai ishte akoma më shumë se kaq dhe thoshte: “Unë nuk dua që All’llahu të dijë se unë e kam ulur qafën te të afërmit e mi dhe unë jam i pari që mbaj lidhje me anëtarët e familjes sime, para se ata të mos kenë më nevojë për mua.”<sup>2</sup>*

*Ngjarjet e rënda sjellin rritjen e valëve të grindjes, por në vorbullën e ngjarjeve bëhet e qartë vlera e burrit, vihet në provë ndërgjegjja e njerëzve dhe njihet dallimi*

<sup>1</sup> “Mishkâtul-Envâr”, f. 217.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 2, f. 25 dhe f. 157.



*ndërmjet Ebù Abdil'lahit e të afërmve të tij. Kur ndodhte që ndonjë prej tyre sillej keq me të ose mund edhe ta shante e t'i vishte të meta, ose një i tretë mund të ngrinte edhe shpatën mbi të, me qëllim që ta vriste, pa pasur ndonjë shkak që t'i shtynte në të tilla sjellje të ulëta apo në këtë ashpërsi, ai i trajton ata në të kundërtën e asaj që ata bënin ndaj tij, prandaj ti e shikon atë të mbajë lidhjet me të afërmit, në vend që t'i ndërpresë ato, e shikon të sillet mirë ndaj tyre në vend të përgjigjes me të njëjtën monedhë dhe e shikon dashamirës, në vend të ashpërsisë.*

*Pësimet e rënda, që i solli Mensuri dijetarëve të djemve të Hasanit, e hidhëruan shumë. Ai e ka qarë dhe është ndier shumë i dëshpëruar, madje ka pasur ethe të forta kur Mensuri i detyroi burrat e pasardhësve të Hasanit të linin Medinen e t'i sillte në Kufe, ku u pritën me fjalët më të këqija në Ebvàë, ditën kur deshën t'i jepnin besën Muhammedit. Madje edhe vetë Muhammedi e babai i tij thoshin fjalë të këqija në adresë të tij, duke pretenduar me pa të drejtë se imam Sàdiku ishte pengesë në rrugën e besëdhënies për Muhammedin. Kur Muhammedi u ngrit në Medine, dërgoi njerëz që të kërkonte besëdhënien e Sàdikut dhe, kur ai nuk pranoi, ai e priti njoftimin e mospranimit të tij me fjalë të rënda e me veprime të shëmtuara. Shumë herë, pasardhësit e Abbàsit e njerëzit e tyre, i janë hedhur atij në fyt, por ai nuk kishte në dorë asgjë që të hakmerrej kundër tyre përveç lutjes, e cila për të ishte e mjaftueshme dhe ishte arma më e fortë.*

*Butësia nuk ishte simbol vetëm për të afërmit, por ai ishte i butë edhe me shërbyesit e me të gjithë njerëzit. Një herë ai dërgoi një shërbyes, që të kryente një punë, por ai u vonua, kështu që doli ta kërkonte. E gjeti duke fjetur. U*

*ul pranë kokës së tij duke i bërë fresk, derisa u zgjua dhe, kur ai u zgjua, nuk i tha asnjë fjalë tjetër përveçse: “O filan, çfarë ke që fle ditë e natë? Nata është për ty, kurse për ne prej teje është dita.”<sup>1</sup>*

*Një herë ai ngarkoi një shërbyes jo arab të kryente një punë. Kur shërbyesi erdhi, imam Sàdiku deshi të dinte përgjigjen. Shërbyesi, edhe pse e përsëriti disa herë, fjalët nuk i kuptoheshin. Imam Sàdiku, në vend që të zemërohej me shërbyesin, e shikoi me vëmendje dhe tha: “Nëse je i pamundur në gjuhë, nuk je i pamundur në zemër.”*

*Pastaj shtoi: “Turpi, nderi dhe pamundësia, pamundësia e gjuhës dhe jo pamundësia e zemrës, janë prej besimit, kurse puna e keqe, fjala e rëndë dhe gjuha e gjatë janë prej hipokrizisë.”<sup>2</sup>*

*Ai i kishte ndaluar njerëzit e shtëpisë së tij të ngjiteshin mbi shtëpi. Një ditë, pa një nga shërbyeset, që kujdesej për fëmijët e tij, që ishte ngjitur lart mbi shtëpi dhe me vete kishte edhe një fëmijë. Shërbyesja, kur e pa, u trondit dhe u hutua aq shumë, sa fëmija ra në tokë e vdiq. Kur doli Sàdiku, atij i ishte ndërruar ngjyra e fytyrës. Kur u pyet për këtë, tha: “Mua nuk më ndërroi ngjyra e fytyrës për vdekjen e fëmijës, por nga frika, që unë i futa shërbyeses.”*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 8, f. 87.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 47 dhe f. 61.

*Me këtë rast ai i tha asaj dy herë radhazi: “Ti je e lirë për hir të All’llahut dhe nuk ka asnjë problem për ty.”<sup>1</sup>*

*Por ky qëndrim i tij nuk ishte vetëm ndaj familjes e shërbyesve të tij. Ai ishte i tillë me të gjithë njerëzit. Njëri nga ata, që po kryenin Haxhin, e zuri gjumi në Medine dhe në ëndërr iu bë se i kishin vjedhur rripin e mesit dhe kështu ai doli. Pa imam Sàdikun që po falte namaz dhe nuk e njohu. U afrua pranë tij dhe i tha: “Ti me ke marrë rripin e mesit.”*

*Ai i tha: “Ç’kishe në të?”*

*Ai tha: “Një mijë dinarë.”*

*E mori në shtëpi dhe i peshoi atij një mijë dinarë. Burri u kthye në shtëpinë e vet dhe e gjeti rripin e tij të mesit, prandaj u kthye tek imam Sàdiku, duke i kërkuar ndjesë për shumën që i dha, por ai nuk e pranoi, që t’ia kthente dhe i tha: “Një gjë, që del nga dora ime, nuk kthehet më tek unë.”*

*Burri pyeti për të dhe i thanë: “Ky është Xha’fer Sàdiku.”*

*Atëherë ai tha: “Nuk ka faj, kështu veprojnë të ngjashmit me të.”<sup>2</sup>*

*Këtë sjellje ai e ka manifestuar edhe ndaj armiqve më të egër të tij. Kur Mensùri e dërgoi atë në Hijreh, ai kërkoi lejë të dilte vetëm për një orë. Në fillim të natës përfundoi*

---

<sup>1</sup> “El Menakib”, vëll. 4, f. 275.

<sup>2</sup> “El Menakib” vëll. 4, f. 27/4.

*në vendin e burrave të armatosur. Aty i tha atij: “Nuk do të largohem derisa të pranosh.” dhe këmbënguli shumë duke i kërkuar atij, por ai kundërshtonte me ashpërsi. Së bashku me Sàdikun ishte Meràzimi,<sup>1</sup> një prej shokëve të tij dhe Musàdif<sup>2</sup>, një prej shërbyesve të tij. Ata i thanë: “Ky qen po të fyen shumë, kam frikë se do të të prapësojë dhe nuk e di se ç’do të bëjë Ebù Xha’feri, prandaj, a më lejon mua dhe Muràzimin t’i presim kokën këtij dhe ta hedhim në lumë?”*

*Por ai tha: “Si kështu o Musàdaf?”*

*Ai vazhdoi të qëndrojë pranë tij, derisa kaloi pjesa më e madhe e natës dhe vetëm atëherë ai e lejoi. Kur u larguan prej tij, ai tha: “O Muràzim, kjo është më e mirë apo ajo që më thatë ju të dy?”*

*“Patjetër që është kjo, t’u bëfsha kurban!”*

*Atëherë ai tha: “O Muràzim, burri del nga poshtërsia e vogël si kjo dhe hyn në një poshtërsi të madhe.”<sup>3</sup>*

*Unë them: “Mbase me fjalën “poshtërsi e madhe” ai kishte qëllim vrasjen dhe me fjalën “poshtërsi e vogël” kishte qëllim kërkesën. Patjetër që fjala e drejtpërdrejtë është për mohim.”*

*Këto ishin disa nga sjelljet e tij, që ty të orientojnë në këtë butësi të madhe, me të cilën ai përballonte sulmet e kundërshtimet e fjalëve e të urdhrave të tij.*

---

<sup>1</sup> Për atë do të flitet ndër transmetuesit e tij të besueshëm e të dëgjuar.

<sup>2</sup> Do të përmendet ndër shërbyesit e tij.

<sup>3</sup> “Reudatul Kâfij”, vëll. 8, f. 49 dhe f. 87.

### *Dashamirësia e tij*

*Në mirësi e në dashamirësi imami nuk bënte dallim ndërmjet njerëzve, të afërm e të largët. Tek ai, të gjithë njerëzit kishin një status të veçantë, por mirësia dhe dhëniet e tij arrinin tek njerëzit në errësirën e natës, kur ai i plotësonte nevojat e tyre nga hurmat e kopshtit “Ajni Zijad” dhe ua çonte atyre. Ai mendonte për ta me qenien e tij si imam dhe i parë. Sikur ai të kishte mundësi, të gjithë myslimanët ishin në rrethin e atyre që duhet të gëzonin dhëniet e tij dhe të kishin dashamirësinë e tij.*

*Njëra nga rastet e shumta të dashamirësisë së tij është edhe ajo që ai shfaqti ndaj shërbyesit të tij, Musadefit, të cilin e thirri e, pasi i dha një mijë dinarë, i tha: “Përgatitu të shkosh në Egjipt, pasi njerëzit e mi janë shtuar.”*

*Shërbyesi përgatiti mallra dhe u nis për në Egjipt së bashku me tregtarët. Kur po i afroreshin Egjiptit, i doli përpara një karvan, që po dilte nga Egjipti. Ata të karvanit e pyetën për mallrat që kishte dhe si e kishin gjendjen në Medine. Pasi i njoftuan për mallrat që kishin, ata të karvanit i thanë se në Egjipt nuk kishte asgjë nga këto mallra. Ata u betuan mes njëri-tjetrit dhe biseduan që fitimi të ishte dinar për dinar. Pasi shkëmbyen mallrat, u kthyen në Medine. Musadefi, me dy qese në dorë, me nga një mijë dinarë secila, hyri tek Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: “Kurban t’u bëfsha, në këtë qese është kapitali dhe në qesen tjetër është fitimi.”*

*Por ai i tha: “Ky fitim është shumë. Çfarë bëtë me mallrat?”*

*Ai i tregoi ç'kishin bërë dhe si ishin betuar mes njëri-tjetrit.*

*Por ai tha: "I plotpushtetshëm e që nuk i mungon asgjë është vetëm All'illahu. Betohen në kurriz të myslimanëve, që të mos i shesin atyre pa qenë fitimi dinar për dinar."*

*Pastaj ai i mori të dyja qeset dhe tha: "Kapitali im është ky dhe ne nuk kemi nevojë për fitim."*

*Pastaj shtoi: "O Musàdef, goditja e shpatave është më e lehtë se kërkimi i hallallit."<sup>1</sup>*

*Unë them: "Ky fitim, që realizoi Musàdefi, sipas rregullave të ligjit të fesë, nuk ishte fitim haram, por imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) nuk dëshiron gjë tjetër prej njerëzve përveç butësisë së ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit si vëllezër që duan njëri-tjetrin, veçanërisht kur janë në gjendje vështirësie. Prandaj edhe ai betim e diskutim, që bënë, ishte në kundërshtim me burrërinë; gjithashtu, edhe fitimi i realizuar ishte e kundërta e asaj që kërkon butësia e ndërsjellë. Prandaj, nisur nga këto, imam Sàdiku nuk e miratoi veprimin e tyre dhe fitimin e realizuar në këtë rrugë e konsideroi jo hallall dhe në mënyrë alegorike e quajti fitim haram. Nuk ka dyshim se ky ishte një mësim për Musàdefin e për shërbëtorët e të tjerë që e dëgjuan fjalën e tij.*

*Përçuesi i Haxhi Ebù Hanijfeh u grind me krushkun e tij për çështje trashëgimie. Ndërkaq tek ata erdhi Mufeddal ibn Umeri, i cili ishte veqil (i autorizuar) i imam Sàdikut*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", f. 47, f. 59 dhe f. 111.

*(Paqja e qoftë mbi të!) në Kufe. Pasi qëndroi me ta afro një orë, i urdhëroi që të shkonin bashkë me të në shtëpinë e tij. Aty ai urdhëroi që të dyve t'u jepeshin nga katërqind dinarë. Kështu, atyre të dyve, pasi morën garancinë nga njëri-tjetri, u tha: "Kjo shumë nuk është nga pasuria ime. Ebù Abdil'lahi më ka urdhëruar, që, kur për ndonjë send të grinden dy vetë nga tanët, unë t'i pajtoj ata dhe të shlyej detyrimin prej pasurisë së tij. Prandaj kjo shumë është nga pasuria e Ebù Abdil'lahit."*

*Sa mirë e realizoi pajtimin mes atyre të dyve, por akoma më mirë është pajtuesi, i cili pagoi prej pasurisë së vet. Ja, kjo është ajo ndjenjë e vërtetë, e cila të tregon dashamirësinë e mëshirën në mënyrë konkrete.*

*Ngjarja me dy shërbyesit e me skllaven, që u përmendën më sipër, nuk ishte vetëm butësi, por ishte butësi dhe mëshirë, sepse ai kurrë nuk kënaqej që të tregohej i gjerë me të parin dhe të mos e mëshironte duke i bërë fresk atij në gjumë, në një kohë që ai ishte imami i ummetit. Ndërkaq ai lavdëron të dytin që nuk është i pamundur me zemër dhe skllaves i fal krimin që bëri. Nuk u mjaftua vetëm me këtë nderim, por shtyhet përtej në bampirësinë e tij, i jep asaj lirinë dhe i heq zgjedhën e robërisë.*

*Sa shumë mëshirë që kishte! Sa herë është lutur për lirimin e një të burgosuri, është lutur për Sedijrin e për Abdurrahmanin, të cilët ishin prej pasuesve të tij dhe që të dy ishin të burgosur. I mësoi shumë gjëra nënës së Dàùd Hysniut, i cili ndodhej në burgun e Mensùrit, së bashku me djemtë e Hasanit. Ai i mësoi asaj lutje, punë e agjërime gjatë ditëve të bardha të muajit Rexhep dhe ajo bëri ashtu siç e mësoi ai. Djali u lirua nga burgu, dhe, që nga ajo*

*kohë e deri më sot, ajo punë vazhdon të quhet “Puna e nënës së Dàùdit”, pa përmendur edhe të tjera punë të tij, përveç atyre që u thanë.*

*Ai është lutur për një të sëmurë dhe ai u shërua, është lutur për Hababeh El Vâlibij’jen, e cila ishte nga gratë e virtytshme, është lutur për Jùnus ibn Am’mâr Sajrefij’jin, i cili është nga burrat e besueshëm të imam Sàdikut, është lutur edhe për një burrë, i cili erdhi tek ai dhe i kërkoi që të lutej, është lutur edhe për një grua, të cilës i kishte djegur dielli krahun, është lutur për një burrë, që i erdhi në shtëpi duke kërkuar mbrojtje prej një pësimi të rëndë, është lutur edhe për shumë të tjerë.*

*Ai është lutur për shumë të tjerë, që atyre t’u përmirësohej gjendja financiare dhe lutja e tij është dëgjuar për ata; është lutur për Tarkhàn En’nekhàsin, për Ham’màd ibn Isànë e për të tjerë, përveç këtyre të dyve, që do të përmenden në pranimin e lutjes së tij.*

*Nuk ka asgjë të habitshme që Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) është i pajisur me këtë ndjenjë fisnike, pasi kjo është vetëm një pjesë nga ato që ai e ndjente si detyrime.*

#### *Forca e tij*

*Ai që shikon te Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) këto ndjenja të holla, që i bëjnë sytë të lotojnë, që zjarri shton në zemrën e tij mëshirë dhe, që i largohet aq shpejt gjaku nga fytyra, do të habitet me forcën e tij, të cilën nuk e baraspeshojnë as malet në mundësinë e ndodhjes.*

*Ismaili ishte djali i tij më i madh, ishte i pajisur me virtyte e mendje të ndritur, ishte adhures dhe Sàdiku e*



*donte aq shumë, sa disa mendonin se imamati do të ishte për Ismailin.*

*Gjatë sëmundjes së tij ishte shumë i hidhëruar. Kur ai vdiq, imam Sàdiku kishte mbledhur shokët e tij. Shtroi për ta tryezën me gjellët më të preferuara e me ngjyrat më të mira dhe i nxiste që të hanin. Ata mendonin se ai nuk do të duronte dot dhe do të fillonte të qante, pasi edhe ata ishin të prekur nga dhembja e tij. Prandaj e pyetën për këtë dhe ai u tha: “Përse të mos jem ashtu siç më shikoni, kur ne na ka ardhur njoftimi më i vërtetë prej më të vërtetit: “Unë dhe ju do të vdesim.”?*

*Djali i tij vdiq nga një ushqim që i ngeli në fyt. Ai ecte para tij duke qarë dhe thoshte: “Të kisha shkuar unë e të mbeteshe ti, të isha kalbur unë e të shëroheshe ti.”*

*Pastaj e mbarti për tek gratë, të cilat lëshuan britma kur e panë, por ai u betua që ato të mos e qanin me vaje. Pastaj e nxori për ta varrosur dhe thoshte: “I Plotpushtetshëm është Ai që vret djemtë tanë dhe ne për Atë na shtohet dashuria!” Kurse pas varrimit tha: “Ne jemi njerëz, që i lutemi All’llahut për atë që duam për të dashurit tanë dhe Ai ne na jep. Kur Ai do atë që ne nuk e dëshirojmë për të dashurit tanë, ne mbetemi të kënaqur.”<sup>1</sup>*

*Unë nuk e di se për çfarë do të habitet njeriu, prej forcës së Ebù Abdil’lahit (Paqja qoftë mbi të!) ndaj kësaj të papriture të rëndë apo prej këtij falënderimi të vazhdueshëm ndaj kësaj goditjeje të dhimbshme, apo për këtë dashuri ndaj Krijuesit në të gjitha gjendjet dhe për faktin që ai është i kënaqur në të gjitha punët, apo nga kjo*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 8, f. 18 dhe f. 47.

*lartësi e qartësi gjuhe, me të cilën ai shpreh habinë dhe hutimin? Patjetër, nëse këto cilësi hyjnore dhe këto gjendje kontradiktore nuk do të ishin te Ebù Abdil'lahit ai nuk do të ishte personi i vetëm i pajisur me këto cilësi e virtyte.*

*Gjatë gjithë jetës së tij ai është goditur rëndë nga të dy shtetet dhe ka pasur prej tyre aq dhembje, vuajtje e fyerje të rënda, sa nuk i njeh historia: ai është kërcënuar, është frikësuar dhe është poshtëruar. Gjithnjë tek ai është parë durimi, forca para vështirësisë dhe qëndrueshmëria shpirtërore.*

### *Madhështia e tij*

*Madhështia dhe rëndësia për burrat e mëdhenj mund të jetë nga ajo rëndësi që njeriu i vesh vetes ose që ia veshin ata që e rrethojnë, si: shërbëtorët, njerëzit e fisit ose ushtria e shteti. Por kjo madhështi nuk është e veçantë për disa njerëz, sepse, kushdo, që vishet me këto punë, do të jetë i veshur edhe me këtë madhështi, prandaj kjo madhështi meriton të emërtohet madhështi e punuar, e bërë.*

*Por madhështia mund të jetë për njeriun edhe pa qenë i rrethuar nga ushtria, pa fis të madh, pa shtet, pa pushtet urdhërues e pa mendjemadhësi. Madhështi që është pa veshje të huazuar, këtë madhështi All'llahu i Lartësuar e derdh mbi atë që Ai dëshiron prej robëve të Vet; këtë madhështi nuk e heq kryeultësia, morali dhe toleranca, është madhështi e veshur me dituri dhe me punë sipas diturisë. Kush dëshiron madhështinë pa fis të madh, pa autoritet dhe pa pushtet, le të dalë nga poshtërsia e kundërshtimit të All'llahut për në krenarinë e bindjes ndaj*

*urdhrave të Tij. Pikërisht kjo madhështi meriton të emërtohet madhështi personale.*

*Mensùri e kishte madhështinë e punuar e të bërë. Kush kishte më shumë se ai pushtet, pasuri e më shumë ushtri dhe kush ishte më i fuqishëm se ai për të kryer vrasje e pabesi? Megjithëkëtë, kur ai shikonte Xha'fer ibn Muhammed Sàdikun – Paqja e shpëtimi qoftë mbi të! –, edhe pse ishte i vendosur ta vriste, përsëri tërhiqej nga vendosmëria e tij.*

*Mufeddal ibn Umeri thotë: “Një herë Mensùri deshte të vriste Ebù Abdil’lahin (Paqja qoftë mbi të!) prandaj e thirri për ta vrrarë. Kur e pa atë, e nderoi dhe nuk e vrau.”<sup>1</sup>*

*Kjo madhështi e Ebù Abdil’lahit nuk ndryshon për njerëz të ndryshëm, pasi çdo njeri e ndiente në shpirtin e vet madhështinë e tij, qoftë ai mik ose armik, pajtues ose kundërshtues. Ja Hishàm ibn Hakemi, para se të shprehej për imamët, ishte nga xhehemitë. Por kur u takua me imam Sàdikun në shkretëtirën e Hijres, heshti e uli kokën nga madhështia e tij, megjithëse ishte prej atyre që kishte folur shumë e nuk kishte lënë gjë pa thënë kundër tij. Ai e ndjeu se kjo madhështi e tij ishte nga ajo madhështi me të cilën All’llahu ka lartësuar profetët e tij dhe personat që kanë marrë porosi prej profetëve.<sup>2</sup>*

*Këtë madhështi Hishàmi e kishte ndier kur ishte xhehemi dhe po e ndiente edhe tani që u bë imami. Ndërmjet Hishàmit dhe Amër ibn Ubejdit është zhvilluar një diskutim për imamatin, madje për këtë diskutim Hishàmi kishte shkuar në Basra të takohej me Ubejdin. Kur atë e*

<sup>1</sup> “Menàkib” i Ibn Shehràshùbit, vëll. 4, f. 238.

<sup>2</sup> Rixhàlul Keshà”, f. 166.

*pyeti imami, se ç'ndodhi mes atyre të dyve dhe i kërkoi që t'ia tregojë, Hishâmi tha: "O nipi i të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ti për mua je i madh, unë kam turp prej teje dhe gjuha nuk më punon kur jam para teje."*<sup>1</sup>

*Ja edhe Ibn Ebul Auxhà, i cili, megjithëse ishte ateist, disa herë frenohej të diskutonte me imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) pikërisht prej kësaj madhështie që kishte. Një ditë ai erdhi të diskutojë me imam Sàdikun, por, pasi u ul, heshti. Atëherë imam Sàdiku i tha atij: "Ç'të pengoi që s'flet?"*

*Ai i tha: "Madhështia jote. Gjuha ime nuk flet dot para teje, unë që kam ndenjur me dijetarë dhe kam diskutuar me teologë, asnjëherë nuk më ka hyrë madhështia kështu, siç më hyri madhështia jote."*<sup>2</sup>

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ndër shokë e ndër personat me të cilët kuvendonte ishte si gjithë të tjerët. Ai nuk shfaqej me madhështinë e me autoritetin e imamit, përkundrazi, ishte i shtruar në fjalë, rrinte bashke me ta në tryezën e bukës, i shoqëronte në bisedë, i nxiste të hanin më shumë. Këtë e bënte me qëllim që ata të mos i pengonte madhështia e tij, që ata të rrinin lirshëm në tryezë e të hanin gjellët që dëshironin. Megjithëse kjo madhështi e tij ishte simbolika e madhështisë personale, ajo i ndalonte sytë që ta vështronin dhe i pengonte gjuhët të flisnin lirshëm në prani të tij, megjithëse ai nuk ishte i rrethuar nga shërbyes e nga portierë.*

### *Adhurimi i tij*

<sup>1</sup> "El Kâfij", vëll. 1, f. 3 dhe f. 169.

<sup>2</sup> "Kitàbu Teuhijd", kapitulli: "Vërtetimi se bota është e ardhur".

*Ajo, që kuptohet me fjalën adhurim, sa herë që thuhet kjo fjalë, është adhurimi që kryhet me trup, si: agjërimi, namazi, Haxhi e të tjera, për të cilat është e nevojshme të jetë nijeti për afrim. Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) në këto adhurime ishte zbukuruesi i adhuruesve.*

*Sibti, në librin “Et Tedhkireh”, thotë: “Dijetarët e jetëshkrimt kanë thënë: “Ai angazhohej në adhurime dhe nuk kërkonte kryesinë.”*

*Ibn Talha, në librin “El Metàlib”, thotë: “Zotëronte dituri të shumta, kryente shumë adhurime dhe vazhdimisht bënte dhikr.”*

*Gjithashtu, ai thotë: “E pjesëtonte kohën e tij për llojet e adhurimeve.”*

*Në librin “El Hiljeh” Ebù Naimi thotë: “Ai vinte me adhurim e me kryeultësi, preferonte të rrinte i veçuar në përkushtimin e tij dhe nuk synonte kryesimin aty ku kishte shumë njerëz.”*

*Màlik ibn Enesi thotë: “Xha’fer ibn Muhammedin nuk e gjeje pa tri cilësi: ose agjërueshëm, ose duke falur namaz ose duke bërë dhikr. Ai ishte ndër adhuruesit më të mëdhenj dhe më i përkori i njerëzve që kanë frikë All’llahun e Lartësuar. Në një vit unë kam kryer Haxhin së bashku me të. Kafshën e kishte lënë në qetësinë e saj. Por sa herë donte të këndonte Telbijen, zëri i ndërpritej në fyt dhe gati sa nuk po rrëzohej nga kafsha.”*

*Màliku vazhdon: “...nuk ka sy, që të ketë parë, as vesh, që të ketë dëgjuar e as që i ka shkuar ndokujt në mendje se ka më të mirë se Xha’fer Sàdiku në dituri, në adhurim e në përkushtim, pa folur për vlerësimet e tjera,*

*që janë thënë për adhurimin e tij.” Këto fjalë e të tjera të ngjashme ti i ke lexuar në kapitujt e mësipërm.*

*Nuk ka asgjë të rrallë për atë që Ebù Abdil’lahi ishte më i miri i njerëzve, në pikëpamje të adhurimit, të përkohshmërisë e të përkushtimit, pasi adhurimi i njeriut është në përpjesëtim të drejtë me shkallën e njohjes së Krijuesit të Lartësuar: “Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, All’llahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) All’llahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.” (Sure “El Fàtir”, ajeti 28) dhe ti je i ndërgjegjësuar për diturinë e për njohjen e Sàdikut.*

*Kjo ishte puna e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) në adhurimet trupore, kurse veprimtaria e tij në punë të nderuara është më e pastër, me më shumë efekt. Ajo që është më shumë e përhapur nga veprimtaria e tij, është dituria e tij, janë mësimet që ai jepte dhe orientimi e përmirësimi që dilte prej tij. Të gjithë e dinë, prandaj edhe ti e mësove jetën e tij shkencore në kapitujt e mësipërm, ashtu siç mësove për jetëshkrimin e për moralet e tij, për përpjekjet e tij në fushën e diturisë e të kulturës, si dhe për punën e tij të madhe në bamirësi, në dashamirësi e në edukimin e moraleve. Së shpejti do të njihesh me interesimin e tij të madh, që njerëzit të ecin në rrugën më të mirë, të punojnë me ligjin e fesë dhe të pajisen me moralet më të larta.*

### *Trimëria e tij*

*Gjatë jetës së imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) nuk pati luftë, që feja e bënte të detyrueshme, që ai të dilte në fushën e betejës dhe kështu njerëzit të mësonin për këtë*

*veti të nderuar. Por ka fakte, që tregojnë se kjo fuqi ishte e rrënjosur, siç janë: forca e zemrës dhe siguria nga frika. Ti më lart ke parë qëndrimet e tij në takimet me Mensûrin e me qeveritarët e tij, ke parë edhe fortësinë e tij, e cila të qartësoi se ai ishte i pajisur me këto forca instinktive, kurse frika vjen nga dobësia e zemrës dhe e shpirtit.*

*Mbi të gjitha, është detyrë që besimtari të jetë trim, të mos frikësohet e të mos ngurrojë para armikut në rrugën e fesë e të vërtetës. Sa më të fortë ta ketë ai besimin, aq më trim është, prandaj ti i gjen dishepujt e imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) dhe Ehli Bejtin e tij të çudisnin botën ditën e Taffit. Nëse ata nuk do të ishin më trimat e njerëzve dhe, nëse ata nuk do të kishin atë besim të ndërgjegjshëm e të rrënjosur, nuk do të kishte zgjatur lufta deri në kohën e faljes së namazit të drekës të asaj dite të vendosur në Caktimin e All'lahut, edhe pse ata ishin vetëm shtatëdhjetë vetë përballë shtatëdhjetë mijë vetëve. Megjithëkëtë, të vrarët nga banorët e Kufes nuk numëroheshin.*

*Nga këto që u thanë, bëhet e qartë se imam Sàdiku duhet të ishte më trimi e më i duruari i të gjithë njerëzve, kur lufta ashpërsohej. Këtë luftë ia kërkonte feja dhe për të bën thirrje ligji i fesë.*

#### *Përkohshmëria e tij*

*Përkohshmëria në një send është heqja dorë prej tij. Në të vërtetë, në përkohshmërinë ka një vlerë, me të cilën i përkori fiton një virtyt, kur sendi, nga i cili hiqet dorë, ka vlerë të madhe dhe çmim të lartë. Por, nëse sendi është i lirë, përkohshmëria në atë send nuk ka ndonjë vlerë që*

*duhet të njihet si virtyt. A e mendon se përkohshmëria në një vajzë të re e të freskët, në të cilën janë bashkuar të gjitha atributet e bukurisë dhe edukata më e përsosur, është e njëjtë si ajo në një plakë të zezë e të deformuar? Nuk ka barazim.*

*Në këtë botë përkohshmëria qëndron në heqjen dorë nga shijimet dhe tundimet e saj. Fakti i heqjes dorë nga këto kënaqësi i jep njeriut vlera, e lartëson atë dhe zbulon një shpirt të pastër e të kulluar. Kur ai vështron bukuroshen me cilësi të rralla, ai i kthen asaj shpinën, i largohet bukurisë së saj, i anashkalon hiret e saj. Me këtë heqje dore ai kërkon atë që është më e mirë e më e virtytshme tek All'illahu. Sikur ajo të dilte para tij fytyrëzbuluar, me rroba të zhveshura, duke e vënë atë në sprovë me afrim e me shoqërim, ai e sheh atë të deformuar e të tharë, me të meta të dallueshme e me fizionomi të keqe. Për të ka dëgjuar fjalë të këqija, që ajo nuk mban besën, asnjë fjalë e saj nuk është e vërtetë, nuk qëndron në një gjendje dhe prej saj nuk mund të jetë i sigurt asnjë mik, patjetër që ndaj saj do të jetë i zemëruar dhe i egërsuar. Prandaj ai e sheh shtrembër, me bisht të syrit, ashtu siç shikon ai që është i prirur të urrejë.*

*Edhe ne, me gjithë mangësinë e shikimit tonë e me afrimin e gropës sonë, patjetër që do të dinim se jeta jonë, nëse do të jetë e gjatë, përsëri shkon drejt zhdukjes, se jetesa jonë, edhe kur është e mirë, përsëri priret kah ndalimi, pasi së shpejti do të kalojmë prej kësaj jete të zhdukshme për në shtëpinë e jetës së përhershme, do ta lëmë këtë jetë të mjeruar e do të kalojmë në jetën e bollëkut. Çdo kënaqësi në këtë jetë është e mbushur me gjëra që ne nuk i duam dhe se çdo jetë ka përpara ferrat e*



*ndalimit. Ditët, që ne do të kalojmë, janë fidanishtja për ato ditë të përhershme. A nuk korr burri vetëm atë që ka mbjellë dhe a dënohet ai për ato që nuk i ka bërë? A e shikon të bukur njeriu i mençur e me aftësi për të vështruar, që të vihet në sprovë me të tilla kënaqësi të kësaj bote?*

*Po, në të vërtetë, ato që na vënë me shpejtësi në sprova dhe që t'i largohemi kësaj jete të vonuar, krahas zhdukjes së saj dhe përhershmerisë së tjetrës, janë disa punë, të cilat nuk janë të panjohura për një vëzhgues të vëmendshëm, edhe nëse ti nuk ke shumë mëkate në diskutimin e llogarisë. Bëj kujdes, ato janë: dashuria e shpejtë, dobësia e shpirtit, freskia e zbukurimet e këtyre pamjeve, të cilat bota i ka vënë kurthe e litarë lidhës. Sikur njeriu të donte, qoftë edhe njeriu që di më pak e që ka më pak zgjuarsis, që të shpëtojë nga kjo rrjedhë, patjetër që do të ishte vetëm në kuadrin e asaj që është caktuar për të. Por, si do të ishte kjo situatë me njeriun me mendje më të fuqishme dhe me dituri më të qëndrueshme, me njeriun, që kupton të vërtetat më mirë se kushdo tjetër? Sikur sendeve t'u hiqej mbulesa, ato do të ishin shumë të qarta.*

*Mënjanimi i Muhammedit e i fëmijëve të Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) nga kënaqësitë e kësaj jete të ulët e nga bollëku i saj dhe mjaftimi vetëm me aq sa është e nevojshme për të arritur atë jetë të qëndrueshme, ka ndodhur se ata e shikonin këtë botë më pak se mbeturinat e gjetheve që mbeten në shoshë dhe më të ndyrë se shuma e realizuar nga kamata. Prandaj për atë nuk mund të kishte qëndrim tjetër përveç përkohshmërisë. Madje ky qëndrim i tij është më lart se përkohshmëria dhe, vetëm ngushtica e vendit, bën që këtë*

*qëndrim ta quajmë përkohshmëri, duke e krahasuar me atë që ne njohim nga gjërat e vyera të kësaj gjithësie dhe nga largimet prej tyre.*

*Nuk do të shprehnim ndonjë mendjemadhësi, pasi njohëm këtë qëndrim të Muhammedit e të familjes së tij nga transmetimet e Ehli Bejtit, nga jetëshkrimi i Profetit dhe nga historia, për faktin se ai mbante një xhybe të leshtë, të ashpër e të shkurtër; vishte një rrobë të endur me fije pambuku dhe thoshte: “Ne e veshim xhyben për All’llahun dhe rrobën e endur me pambuk e veshim për ju.”<sup>1</sup>*

*Ai vishte një këmishë të trashë e të ashpër, mbi të cilën vishte xhyben. Gjithashtu, atë do ta shikoje të ushqente mikun, që i vinte në shtëpi me mish, madje ia jepte me dorën e tij, ndërsa vetë hante uthull e vaj dhe thoshte:*

*«Kjo është gjella jonë dhe gjella e profetëve.»<sup>2</sup>*

*Janë të shumtë shembujt e shfaqjes së përkohshmërisë.*

*Ai, që e kap veten nga kjo anë dhe në këtë botë zhvishet nga sprovat tepër mashtruese, që orientohet me të gjitha gjymtyrët e tij për në kënaqësinë e Krijuesit të tij, ashtu siç kanë transmetuar përcjellësit e tij të besueshëm, shton mirësitë e punëve të tij.*

*Nuk ka asgjë të habitshme në transmetimet e ardhura me rastin kur tek ai hyri Sufjân Eth’theurij<sup>1</sup>, i cili në këtë*

---

<sup>1</sup> “Leuâkihul Anuâr” e Sha’râniy Abdul Uehhâb ibn Ahmed Esh’Shafi’ij, vëll.1, f. 28; dhe “Metâlibu Su’l”.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, vëll. 6, f. 4 dhe f. 328.

*rast e gjeti Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) të veshur me një xhybe të thurur me fije të trasha pambuku. Sufjàni, duke shprehur mosmiratimin e tij për këtë veshje, tha: “Ju të Ehli Bejtit të mbani të tillë veshje?”*

*Ja dhe fjala e imam Sàdikut: “Ti nuk e di, por preke xhyben.”*

*Kur preku xhyben, dora e tij ndjeu fije të ashpra. Imam Sàdiku i tha: “O Theurij, tani më trego ti mua se ç’ke nën xhyben tënde.”*

*Nën xhybe ai kishte veshur një këmishë të butë e shumë të bardhë. Sufjanit i erdhi turp dhe imam Sàdiku i tha: “O Theurij, mos eja shpesh tek ne, sepse na dëmton e të dëmtojmë.”<sup>2</sup>*

*Transmetime të ngjashme janë të shumta dhe ne e konsiderojmë të panevojshme t’i sjellim të gjitha, për faktin se zotërinjtë e Ehli Bejtit janë në majë të lartësisë dhe në pozitën më të madhe, që këto punë të llogariten virtyte për ta.*

*Në lidhje me Sufjanin, ai nuk është i merituar të ketë dëshirë për t’iu afruar imamit, derisa e kundërshton atë në mendime, në jetëshkrimin, në punën e në diturinë e tij. Kurse dëmi, që i shkakton imamit, është fakti se ai shkon*

---

<sup>1</sup> Ai është i mirënjohuri Sufjàn ibn Seijd ibn Mesrùk El Kufij. Për atë ka një transmetim prej Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Ka lindur në kohën e sundimit të Abdul Melikut dhe ka vdekur në Basra, në vitin 161H.

<sup>2</sup> “Leuàkihul Anuàr ue Metàlibu-s’suël ue Halij’jetul Eulijài”, vëll. 3, f. 193; mohimi i imam Hasanit prej tij është i njohur dhe është transmetuar në disa rrugë e mënyra. Ai nuk ndalet në të dytën pas përgjigjes së tij në të parën. Prej atyre, që e kanë transmetuar këtë, është Ebù Naimi, në librin “Halij’jetul Eulijài”, vëll. 3, f. 193.

*tek imami, sepse mbreti kishte vënë roje për imamin, që ai të mos e shfaqte pozitën e tij dhe të mos shkonin shumë njerëz tek ai. Prandaj takimi me imamin e vinte atë para rrezikut, ashtu siç e bënte objekt torturash e fyerjesh edhe atë që hynte tek imami, sidomos kur ai, që hynte, ishte njeri me autoritet, siç ishte Sufjàn Eth`theurij.*

*Në fundin e kapitullit: “Jeta e tij shkencore” kemi përmendur diskutimin e gjatë të imam Sàdikut për përkohshmërinë me Sufjànin e grupin e tij.*

\* \* \*



## **KERAMETET E TIJ**

### ***Punët e tij të jashtëzakonshme***

*All'illahu i Lartësuar do më të mirën e krijesave të Tij, që ato ta njohin Atë dhe nga njohja të adhurojnë vetëm Atë: "Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë." (Sure "Edh Dhàrijat", ajeti 56)*

*Krijesat e Tij janë argument për ekzistencën e Tij, për bukurinë e asaj që Ai ka bërë dhe sistemimin e punëve me të gjitha parashikimet deri në fundin e tyre. Kjo tregon Njëtimin e Tij, se Ai është Një e i Vetëm, Ai ka dëshiruar orientimin e njerëzve në të gjitha këto dhe All'illahu për ata ka bërë një drejtues, që është mendja.*

*Por mendja nuk udhëzohet dot vetvetiu në rrugën e drejtë. I Larti ka dashur prej tyre, që ata të adhurojnë vetëm Atë, Ai i ka vënë detyrim Vetes që të dërgojë tek ata dikë, që t'u tregojë atyre dëshirën e Tij dhe t'u mësojë atyre punët që Ai i ka vënë detyrë për njerëzit.*

*Nuk bën që mendja të besojë fjalët e kujt do që pretendon se është profet, pa pasur ai ndonjë argument dhe pa sjellë ndonjë mrekulli. Të gjithë profetët kanë qenë të detyruar të vijnë me argumente për pretendimin e tyre se janë profetë, prandaj ne nuk e njohim atë që pretendon se është profet ose i dërguar, kur ai nuk sjell ndonjë argument të qartë e të lartë, megjithëse shumica e njerëzve janë të prirur të mohojnë, edhe kur u janë parashtruar argumente e fakte. Po si do të ishte puna, kur nuk ka as argument e as fakte? Kuptohet, nëse për një pretendim të tillë nuk ka argument, atëherë do të ishte i gatshëm*

*mospranimi i pretendimit, madje pretenduesi do të kundërshtonte vetveten.*

### *Ç'është argumenti?*

*Kjo pyetje meriton argumentim dhe vështrim të kujdesshëm, sepse vërtetimi i profetësisë qëndron në saktësinë e argumentit.*

*Është larg mendjes që përgjigja për këtë pyetje të jetë shumë e lehtë. Nisur nga argumentet e profetëve dhe të të dërguarve, që janë treguar në Librin e Ndritur, ti shikon se argumenti i Mùsàit është dora e bardhë dhe shkopi, argumenti i Isàsë është shërimi i të verbërve të lindur, i lebrozëve, ngjallja e të vdekurve dhe krijimi i shpendëve, argumenti i profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) është vetë Kur'âni, patjetër do të mësosh se argumentet e profetëve janë punë, të cilat njerëzit nuk kanë mundësi t'i bëjnë. Megjithatë, edhe profetët janë njerëz. Gjithashtu, do të mësosh diturinë dhe fuqinë që ka profeti për t'i sjellë ato punë. Por, cili është ai, që, me diturinë, me fuqinë dhe pushtetin e tij, ka mundësi ta bëjë zjarrin të ftohtë dhe shpëtim, t'i presë shpendët copa-copa, t'i shpërndajë nëpër male dhe ato të vijnë në dorën e tij kur ai t'i thërrasë, ta bëjë dorën e tij të bardhë pa pësuar gjë, ta bëjë shkopin që ecën gjarpër dhe të përpijë bërjet e magjistarëve, të shërojë të verbrit e lindur dhe lebrozët, të ngjallë të vdekurit, të krijojë shpendë nga balta, të fryjë në to dhe ato të jenë shpendë, me të gjitha veçantitë që i përshkruan Kur'âni.*

*Me këto ti njeh dallimin ndërmjet mrekullisë dhe magjisë, mes mrekullisë dhe shpikjeve industriale të kohës sonë. Por mrekulli është vetëm ajo që realizohet në rrugë jo të natyrshme. Megjithëkëtë, sendi, që do të shërbejë si mrekulli, patjetër duhet të ekzistojë, sepse ai, që nuk ekziston, kurrë nuk mund të ndodhë. Gjithashtu, mrekullia ndodh vetëm në dorën e njerëzve më të shquar e vetëm kur ata i luten të Lartësuarit. Treguesi për këtë është vetë i Plotpushtetshmi, sepse është domosdoshmëri që mrekullia të jetë më lart se niveli i fuqisë së njerëzve, prandaj ajo është vetëm dhuratë prej All'llahut të Lartësuar, dhuratë që Ai ia jep cilit të dëshirojë prej robëve të Tij të afërm.*

*Kurse magjia, në fakt, është një lloj arti, të cilin ka fuqi ta bëjë çdo njeri kur e mëson atë, pasi magjia është fantazi dhe futje në rrugën e humbjes, gjithashtu në magji nuk ka asgjë nga realiteti e nga e vërteta.*

*Edhe industria është një dituri që ecën sipas ligjeve të natyrës, prandaj për atë ka fuqi çdo njeri që di karakteristikat dhe përbërjen e sendeve.*

*Mbase mund të thuhet: Shkenca nuk e pranon mrekullinë, për faktin se ajo bëhet e pa mbështetur në ligjet e natyrës, pra, kemi të bëjmë me një bërje pa shkaqe të zakonshme. Prandaj, si është e mundur të bëhen punët pa u bazuar në shkaqe të zakonshme? Përgjigjja për këtë lloj pyetje është në disa mënyra:*

*1. Kur'ani flet qartë se profetët kanë ardhur me argumente të jashtëzakonshme, të demonstruara, jo sipas ligjeve të natyrës, siç qe shpëtimi i Ibrahimit prej zjarrit, ardhja e shpendëve, pasi ai i kishte copëtuar; bërja e*

*bardhë e dorës së Mùsàsë, pa pësuar ndonjë të keqe, bërja e shkopit të tij gjarpër, shërimi prej Isàit i sëmundjeve, të cilat mjekësia nuk ka mundësi t'i shërojë, siç ishin shërimi i të verbërve të lindur dhe i lebrozëve apo më shumë se kaq, ngjallja e të vdekurve, krijimi i shpendëve e të tjera argumente veç këtyre që u thanë. Sa është vlera e shkencës, kur ajo kundërshton atë që Kur'ani e thotë shprehimisht? Në të vërtetë, ajo nuk është më shkencë e saktë, për shkak të gabimeve që ka në disa postulate të saj.*

*2. Nëse këto argumente, në vetvete, janë të mundshme, atëherë cila është arsyeja e mohimit të tyre? Ato nuk janë të pamundura, kur edhe nevoja për to është shumë e madhe dhe fuqia e All'llahut është gjithëpërfshirëse dhe në të cilën nuk ka asnjë pengesë e mangësi që ta ndalojë, sepse vetëm All'llahu është Fuqiploti mbi të gjitha sendet.*

*Po, ne ndalohemi para gjërave, që në vetvete janë të pamundura të ndodhin, siç është bërja shok e ortak e All'llahut, bashkimi i dy të kundërtave, futja e gjithë botës, që është kaq e madhe, në një kokërr vezë, që është kaq e vogël. Është kështu për shkak se e pamundura nuk shërben dhe mangësia është nga ana e atij që i është dhënë fuqi dhe jo nga ana e vetë fuqisë.*

*Për punë të këtilla, si: e folura e guralecëve, çarja e hënës dhe ecja e pemëve, nuk ka veprim të ngjashëm, por nuk ka as pengim, që ato të jenë të pamundura, sepse nuk mund të ketë pengim për fuqinë e të Lartësuarit mbi ndonjë send.*

*3. Kur ne i pranojmë këto argumente për të Lartin, atëherë si do të jetë etaloni për vërtetimin e profetësisë te*



*profetët? Nëse profetësia do të ishte e lejuar të pranohet pa argument, atëherë çdo njeri ka mundësi të pretendojë se është profet, për pasojë, ku është dallimi mes një profeti të vërtetë dhe një profeti të rremë?*

*Kur flitet për gjenialit, zgjuarsi, gojëtar, dituri, besnikëri e drejtësi dhe kur këto janë me shumicë e në mënyrën më të plotësuar në personin që pretendon profetësinë, për më tepër, në sajë të këtyre virtyteve, ai dallohet nga të gjithë njerëzit, atëherë këto janë të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimin e tij për profetësinë.*

*Ne themi: "Shumica e njerëzve nuk i vënë në peshë këto punë, madje nuk kanë mundësi as t'i dallojnë ashtu siç duhen dalluar se në cilin person janë ato cilësi, megjithëse dihet mirë se këto cilësi gjenden te profeti në mënyrën më të plotësuar. Prandaj është domosdoshmëri, që nga dora e tij të dalë sheshit diçka e prekshme ose e ndjeshme, të dalë prej dorës së tij diçka që njerëzit e tjerë nuk kanë mundësi në asnjë mënyrë ta bëjnë atë gjë, për shkakun e thjeshtë se nuk mundën. Në vetvete, ky është një argument i ndritur, para të cilit të gjithë janë të barabartë në nënshtrimin ndaj tij, pasi atë e kupton dijetari dhe injoranti, e kupton i ndershmi dhe i mençuri."*

*4. Përse shkenca nuk flet për punët që nuk rrjedhin sipas rregullit të ligjeve të natyrës? A nuk është Një Krijuesi i ligjeve të zakonshme dhe i ligjeve të jashtëzakonshme? Ai, që ka fuqi të vërë në lëvizje punët, me shkaqet e tyre të zakonshme, patjetër që është i fuqishëm t'i vërë ato në lëvizje edhe me shkaqe që janë mbi kapacitetin tonë dhe mbi diturinë tonë.*

*Kur ne vërejmë disa nga bërjet e të Lartit, do të gjemë se ato janë të bëra jo sipas ligjeve të zakonshme. Kjo vërehet në fillimin e krijimit, prandaj vetvetiu lind pyetja: Si ishin ligjet e natyrës në bërjen e Ademit e të Havasë, në fillimin e krijimit të qiejve e të tokës, të pemëve, të lumenjve, të metaleve, të mineraleve dhe të tjera gjëra veç këtyre që u thanë? Ai i krijoi ato nga asgjë që ishte më parë dhe as e mori nga ndonjë model që ishte. Kur ligji i natyrës janë elementët, nga të cilët ajo është e përbërë, atëherë cili është ligji i natyrës për krijimin e atyre elementeve?*

*Po, ne jemi vënë në kërkim të ligjeve të natyrës për gjërat e bëra, ashtu siç jemi mësuar t'i vërejmë krijesat në lëvizjen e tyre të vazhdueshme sipas këtyre ligjeve. Por kjo nuk është e detyrueshme për të gjitha sendet, përderisa Krijuesi i ligjeve është jo sipas këtyre ligjeve, prandaj është e drejta e Tij, që krijimin e tyre ta bëjë jo sipas ligjeve. Ky fakt, nga ana, e vet është një argument për robët e Tij, që Ai i orienton ata të njohin se Ai është Zoti dhe se kjo është fuqia e Tij, si dhe të njohin profetësinë e të dërguarve të Tij.*

*Por ne kemi nevojë për vërtetimin e këtyre argumenteve që na vijnë jo në rrugë sipas shkaqeve të zakonshme, krahas mundësisë së tyre për t'i soditur ato konkretisht, si dhe për vërtetimin e lëvizjes që ato bëjnë, edhe pse nuk shihen.*

*Këto argumente dhe vepra të jashtëzakonshme (keramete), ashtu si ishin për profetët, ashtu janë edhe për personat, të cilëve profetët u kanë lënë porosi. Këto argumente e vepra vijnë me të njëjtin qëllim për të cilin janë lutur profetët që të vijnë; sepse dërgimi i profetëve ka qenë vetëm për të orientuar njerëzit në njohjen e Krijuesit të Lartësuar dhe për të adhuruar vetëm Atë, prandaj edhe të porositurit janë vënë vetëm për të treguar këtë njohje dhe për të thënë se si është adhurimi i vërtetë, prandaj*

*ashtu siç i kërkohej profetit mrekullia, ashtu i kërkohet kerameti edhe imamet, të cilit i ishte lënë porosia.*

*Kur mrekullia është e nevojshme, atëherë nuk ka dallim ndërmjet ngjalljes së të vdekurve, krijimit të shpendëve dhe gurëve e pemëve, që flasin e as ndërmjet gjërave, që janë me më pak rëndësi, sepse për të gjitha fuqia është vetëm prej të Lartit dhe është e vetme për të gjitha. Tek i Plotpushtetshmi nuk ka dallim në krijimin e atomit e të kolonës, as ndërmjet krijimit të qiejve e të insekteve, prandaj çdo mashkull e femër, që ka aftësinë të vështrojë, nuk duhet të mohojnë shembujt e ngjalljes së të vdekurve, bërjen e baltës flori, as lajmet e fshehta që janë njoftuar prej profetëve e prej personave që ata i kanë lënë porosi, me kusht që të jetë vërtetuar se profetësia e imamati i tyre është hyjnore. Në një kohë që nuk mohohet nxjerrja e ujit, rënia e shiut, ushqimi i njerëzve me rrush jashtë stinës së tij dhe të tjera të ngjashme me këto, pasi të gjitha këto, që u thanë për fuqinë e Tij, janë një, prandaj të gjitha ato janë të barabarta në mundësinë e ndodhjes dhe ardhjes kur është nevoja.*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), që ishte imami i pagabueshëm dhe i vënë prej All'llahut të Lartësuar për të zbatuar ligjin e fesë së profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) kishte detyrë të sillte fakte që ai ishte imami. Faktet ai i sillte me vepra të jashtëzakonshme, kur ishte nevoja që ato të silleshin, kur kërkohej siguri prej rrezikut, ashtu siç ishte detyrë edhe për Profetin kur bënte thirrje. Kështu qëndron çështja tek imamet, kurse për Ehli Sun'netin, imam Sàdiku është nga dega e pastër profetike dhe se në të janë bashkuar të gjitha virtytet, ashtu siç thuhet qartë në fjalët e tyre. Disa nga këto virtyte ne i kemi përmendur në kapitullin "Kush është*

*imam Sàdiku?”. As për ata nuk ka ndonjë gjë të habitshme, kur prej tij dalin argumente e keramete, madje ata edhe kanë transmetuar prej tij vepra të jashtëzakonshme dhe i kanë shkruar ato. Prandaj nuk ka problem sikur edhe ne të vazhdojmë të sjellim diçka prej kerameteve të tij e prej pozitës së tij të lartë. Të gjitha këto e bëjnë të qartë pozitën e tij të lartë.*

*Autori i librit “Qyteti i mrekullive” ka përmendur për atë më shumë se treqind keramete e punë të befasishme. Tani do të përmendim disa nga ato që janë transmetuar në librat e vyer e në botimet e çmuara dhe, për të cilat, të dy grupet ndajnë një mendim të përbashkët, madje të dy grupet janë në paqe për atë.*

#### *Lutja e tij gjente përgjigje*

*Sabbàni, në librin “Is’âfu Ràgibijn”, thotë: “Lutja e tij gjente përgjigje. Kur ai i lutej All’llahut për ndonjë send, pa e mbaruar akoma fjalën, e kishte sendin para duarve.”*

*Sha’ràniyu, në librin “Leuàkihul Enuàr”, thotë: “Kur imam Sadiku kishte nevojë për ndonjë send, thoshte: “O Zoti im, ne kemi nevojë për këtë!” Pa e mbaruar akoma lutjen e tij, sendi do të ishte vënë pranë tij.”*

*Fjala e këtyre të dyve, jo vetëm që tregon se lutja e tij gjente përgjigje, por ajo e gjente përgjigjen shumë shpejt, sikur Atij që i kërkohej të ishte në krah të tij ose para tij. Insistimi i këtyre autorëve për shpejtësinë e përgjigjes, që gjente lutja e tij, vjen nga shumica e madhe e transmetimeve që janë përcjellë prej tij nëpër rreshtat e librave dhe nga ato që janë ruajtur në mendjet e në zemrat e njerëzve, derisa ato janë bërë diçka që ata e ndiejnë dhe çështje shumë të njohura.*

*Nga ato që ka përmendur vetë imam Sàdiku është edhe qëllimi që kishte Mensùri për ta vrarë atë disa herë, por All'llahu, me mirësinë e lutjes së Tij, hynte ndërmjet Sàdikut dhe vendosmërisë së Mensùrit, madje e përmbyste gjendjen dhe ndodhte e kundërta e asaj që ai kishte vendosur kundër tij. Prandaj ai ngrihej për ta pritur, madje edhe e tejkalonte masën në respektimin e tij.<sup>1</sup>*

*Kur imam Sàdikut i komunikuan fjalët e tij, ai u zemërua dhe u lut kundër tij me këto fjalë: “O Zoti im, vendose atë nën sundimin e njërit prej qenve të Tu, që ai ta hajë atë!”*

*Emevitët atë e dërguan në Kufe dhe rrugës e shqeu një luan.<sup>2</sup>*

*Në kohën që Dàùd ibn Ali El Abbàsiju ishte vali (mëkëmbësi) i Medines, i emëruar prej Mensùrit, çoi njerëz dhe vrau Mual'là ibn Khanijsin, shërbyesin e imam Sàdikut. Nuk u mjaftua vetëm me kaq, por deshi të keqen edhe për imamin. Prandaj imami u lut kundër Dàùdit dhe e dëgjua të thoshte: “Në këtë orë, në këtë orë.” Pa e plotësuar akoma lutjen, u dëgjua të thirrura në shtëpinë e Dàùdit dhe thanë: “Ai vdiq menjëherë.”<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> “El-Menàkib”, vëll. 4, f. 231, për këtë referohu në: “Nùrul Ebsàr” të Shebelenxhiut, në “Tedhkiretul-khavàs” të Sibtit, në “Metàlibu Suël” të Ibn Talha Esh’shàfi’ijut, në “El fusùlul Muhim’meh” të Ibn Sab’bàg El Màlikiut, në “Es’Sauàikul Muhrikah” të Ibn Haxherit, në “Jenàbi’ul Meueddeh” të shejh Sulejmànit, në paraqitjen prej tij të gjendjeve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe në shumë vepra të tjera, të cilat ne i kemi përmendur në mënyrë të shkoqitur në vendin e vet.

<sup>2</sup> “Nùrul Ebsàr”, “Es’savàik”, “El Fusùl” dhe “El Menàkib”, vëll. 4, f. 234.

<sup>3</sup> Burimet e mësipërme dhe “El Menàkib”, vëll. 4, f. 230.

Nga lutjet e tij, që kanë gjetur përgjigje të shpejtë, është edhe ajo që i ka ngjarë Lejth ibn Sa'dit<sup>1</sup>, i cili tregon: "Në vitin 113 të hixhrit kam kryer Haxhin dhe, pasi fala namazin e pasdites, i këndova lutje Ebù Kajsit, kur dëgjoj një burrë që po lutej duke thënë: "O Zot, o Zot, (ja Rab'b)!", derisa iu pre fryma. Pastaj thoshte: "O i Gjallë, o i Gjallë (ja Haj'ju)!", derisa iu pre fryma. Pastaj ai vazhdoi: "O Zoti im, më hahet rrush, prandaj më ushqe me rrush! Xhybja ime është grisur, prandaj më vish!"

Lejthi thotë: "Ai nuk e kishte plotësuar akoma fjalën, kur unë pashë një shportë të mbushur me rrush, megjithëse në këtë kohë hardhitë nuk kishin rrush, pashë edhe dy xhybe, që kurrë nuk kisha parë si ato. Ai deshi të hante, por unë i thashë: "Unë jam ortak me ty, sepse kur ti luteshe, unë thosha: "Amin"

Ai tha: "Ha, por as mos fshih gjë e as mos rezervoj gjë." Më vuri përpara njëren nga dy xhybet, por unë thashë: "Njëra nuk më mbaron punë, njëren do të vesh poshtë dhe tjetren do ta mbaj sipër."

Pastaj ai mori dy rrobat e tij dhe zbriti poshtë. Në rrugë e takoi një burrë, i cili i tha: "Më vish mua, o nipi i të Dërguarit të All'lahut!"

Ai i dha atij të dyja rrobat.

Atëherë unë pyeta: "Kush është ky?"

---

<sup>1</sup> Është nga fisi El Khuzàij dhe është nga juristët e ligjit të fesë të masës. Ka transmetuar prej Sejid ibn Xhubejrit. Prej tij nuk njihet ndonjë transmetim prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) , por ai ka parë prej tij keramete të mëdha, për të cilat kanë transmetuar shumë bashkëkohës të tij.

*Më thanë: “Ai është Xha’fer Sàdiku.”<sup>1</sup>*

*Në një transmetim tjetër, të cituar në librin “Metàlibu Suël”, thuhet: “Unë bëra përpara dhe hëngra diçka, që kurrë nuk kisha ngrënë si ajo.*

*Para tij kishte rrush pa bërthamë. Hëngra sa u ngopa dhe shporta nuk u pakësua.*

*Unë them: “Ky keramet i tij ka ndodhur në kohën e babait të tij, imam Bàkirit, (Paqja qoftë mbi të!) para kthimit të imamatit tek ai, sepse imam Bàkiri ka vdekur ose në vitin 114 ose në vitin 117 të hixhrit.*

*Njerëzit kërkonin ndërmjetësim me lutjen e tij, për shkak se lutja e tij gjente përgjigje. Ja, Habbàbeh El Uàlibijeh, që ishte nga gratë e virtytshme, hyri tek ai dhe e pyeti atë për një çështje rreth hallallit e haramit. Të pranishmit u çuditën nga këto pyetje, sepse ata nuk kishin parë ndonjë pyetës më të mirë se ajo, ndërkaq sytë e saj lotuan dhe imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Përse shikoj, që sytë e tu lotojnë?*

*Ajo tha: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) më është shfaqur një sëmundje, nga ato sëmundjet e këqija, që kanë prekur edhe profetët (Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!); gjithashtu, kjo sëmundje prek edhe eulijatë. Të afërmit e njerëzit e shtëpisë sime filluan të thonë për mua: “E ka prekur e keqja!”*

*Meqenëse zotëria i saj ishte ashtu siç tha ajo, që të impononte bindje, patjetër që ai do të lutej për të dhe All’llahu do t’ia largonte asaj sëmundjen. Megjithëse, unë betohem te All’llahu e jam e kënaqur me këtë gjendje, sepse e di që sëmundja është pastrim dhe shlyerje*

---

<sup>1</sup> “Is’âfu Rràgibijn”, “Metàlibu Suël”, Es’savàik”, “Keshful gum’meh”, “Safvetu Safveh” dhe “El Menàkib”, vëll. 4, f. 233.

*mëkatesh dhe e di se kjo është sëmundje e njerëzve të mirë.” Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha asaj: “Ata kanë thënë: “Ty të ka prekur e keqja?”*

*Ajo tha: “Po, o nipi i të Dërguarit të All’llahut.”*

*Sàdiku lëvizi buzët dhe tha diçka, që nuk u mor vesh, nëse ishte lutje dhe i tha: “Hyr në dhomën e grave, që të shohësh trupin tënd.”*

*Ajo hyri, hoqi rrobat, por nuk gjeti asgjë në trupin e saj. Atëherë ai i tha: “Tani shko dhe u thuaj atyre: “Ajo, që e afron atë tek All’llahu, është imamati i tij.”<sup>1</sup>*

*Hab’beja është e bija e Xha’fer Esedij’jit. Mbiemri El Vàlibij’jeh tregon se ajo është nga fisi Vàlibij, që është dega Esed e këtij fisi. Ka qenë mbajtësja e guralecit, mbi të cilin prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka gdhendur shenjën e imamatis; Hab’bàbeh ka jetuar gjatë dhe ka arritur edhe imam Rizànë (Paqja qoftë mbi të!). Ajo ka vdekur në kohën e tij dhe ai e ka qefinosur me këmishën e tij. Ky nuk ka qenë kerameti i parë, që ajo ka parë prej imamëve të Ehli Bejtit, sepse ajo ka ardhur tek imam Husejni (Paqja qoftë mbi të!) kur asaj i kishin dalë njolla të bardha në lëkurë dhe ajo u shërua nga kjo sëmundje; gjithashtu, ajo ka ardhur tek imam Sexh’xhàdi (Paqja qoftë mbi të!) kur numëronte 113 vjet nga jeta e saj. Ishte aq e moshuar, sa dridhej. Ajo e pa imamin të bëjë ruku e sexhde dhe i erdhi keq që ai bëri shenjë me gishtin tregues në drejtim të saj dhe asaj iu kthye rinia. Kur ajo erdhi tek*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 47, f. 121 dhe f. 169, cituar prej librit “Tib’bul Eimem’meh” –“Mjekësia e imamëve”, libër i mbledhur prej Abdullah Ebù At’tàb dhe prej vëllait të tij Husejnit, të cilët ishin djemtë e Bestam Zijàtit. Në lidhje me vërtetësinë e librit është thënë se ai libër është një përmbledhje në fushën e mjekësisë e në rrugë mjekësore për ushqimet dhe dobitë e tyre, për shërimin me këndim Kur’ani dhe se është libër me dobi shumë të mëdha.



*imam Rizài, sipas një transmetimi, edhe ai i ktheu asaj rininë, por ajo preferoi të vdiste dhe kështu ajo vdiq në shtëpinë e tij.*

*Tek ai ka ardhur një grua tjetër dhe i tha: “T’u bëfsha kurban, me babë, me nënë e me të gjithë njerëzit e shtëpisë sime, të gjithë jemi shërbëtorët e tu!”*

*Ai tha: “The të vërtetën, por, ç’dëshiron?”*

*Ajo tha: “T’u bëfsha kurban o nipi i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në krah më ka prekur sëmundja dhe lëkura më është bërë më njollë, prandaj lutu All’llahut që ta largojë prej meje këtë sëmundje.”*

*Imami tha: “O Zoti im, me të vërtetë vetëm Ti i shëron të verbrit e lindur dhe lebrozët, vetëm Ti i ngjall kockat e ronitura (“All’llâhum’me in’neke tubriul-ekmehe uel ebresa ue tuhjiyl idhàme ue hije remijm”), vishe këtë grua me faljen e me shërimin Tënd, si ta shohësh Ti pas lutjes sime.”*

*Gruaja tha: “Për All’llah, unë u ngrita dhe nuk kisha më prej sëmundjes as pak e as shumë.”<sup>1</sup>*

*Bekr ibn Muhammed El-Ezedij<sup>2</sup> ka thënë: “Po udhëtonim për në Mekke dhe një kushëriri im u çmend. Kur shkuam tek Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!), pasi ia treguam problemin që kishim, i kërkuam që ai të lutej për*

---

<sup>1</sup> “Emâlij” e shejhut Et’tùsij, kuvendi i 14<sup>të</sup>.

<sup>2</sup> Ka transmetuar prej imam Sâdikut, imam Qâzimit dhe imam Rizàsë (Paqja qoftë mbi ta!). Është nga transmetuesit e besueshëm dhe për të kanë transmetuar shumë prej tyre.

*të dhe ai u lut. Unë e pashë kushëririn tim të çmendur dhe e pashë kur erdhi në vete.”<sup>1</sup>*

*Tek ai erdhi një plak. Në këtë kohë ai po rrinte në shtëpi, në vathën e dheneve, së bashku me një grup nga pasuesit e tij. Plaku përshëndeti me “Selam” dhe pastaj foli: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut, unë ju dua ju të Ehli Bejtit dhe nuk kam asnjë përgjegjësi ndaj armikut tuaj, por mua më ka rënë një gjë shumë e rëndë, prandaj të kam ardhur në shtëpi, që të kërkoj mbrojtje me atë që do të gjejë në shtëpi.”*

*Pastaj qau, u var pas imam Sàdikut dhe filloi t’i puthë atij kokën e këmbët. Ndërkaq Sàdiku largohet prej tij, pati mëshirë për të dhe qau. Pastaj tha: “Ky është vëllai juaj, që ka ardhur tek ju të kërkojë mbrojtje me ju, prandaj ngriji duart.”*

*Edhe imam Sàdiku i ngriti duart bashkë me të tjerët dhe tha: “O Zoti im, Ti i ke krijuar këto shpirtra prej asaj balte që Ti vetë përzgjodhe, prej asaj Ti bërë miqtë e Tu dhe miqtë e miqve Tuaj. Nëse Ti dëshiron, i largon prej tyre sëmundjet! O Zoti im, ne kërkojmë mbrojtje me shtëpinë Tënde të shenjtë, në të cilën është i siguruar çdo send! Unë të lutem vetëm Ty, që je i mbuluar me dritën Tënde prej krijesave të Tua, të lutem me të vërtetën e Muhammedit, Aliut, Fâtimesë, Hasanit e Husejnit, o qëllimi i fundit i çdo të hidhëruari, i çdo të pikëlluari, i çdo të godituri, i çdo të detyruari dhe i çdo të sprovuari, që ta*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuâr”, f. 47, f. 122 dhe f. 170, është prej atyre që janë afër transmetuesve të besueshëm dhe ky është Ebù Xha’fer Muha’med Abdullah ibn Xha’fer El Humejrij El Kumij, (Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!), është nga paria e shokëve dhe nga të besueshmit e tyre. Atij i ka shkruar shtetari dhe e ka pyetur për çështje të kapitujve të ligjit të fesë. Ai ka edhe vëllezër të cilët janë: Xha’feri, Ahmedi dhe Husejni. Çdonjëri prej tyre ka një akt librimi, thuhet se akti i librimit është për babain e tij.

*sigurosh atë me sigurinë tonë! Të lutem të fshish prej baltës së tij ato sprova të rënda që ke vendosur në caktimin Tënd, të lutem të largosh pësimin e tij të rëndë, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve!”*

*Kur ai përfundoi lutjen, burri u largua. Kur arriti në derën e xhamisë, u kthye dhe qau, pastaj tha: “All’llahu e di më mirë ku e ve mesazhin e Tij. Për All’llah, nuk kisha arritur akoma në derën e xhamisë dhe unë kisha nga ato që gjej, pak dhe jo shumë.”<sup>1</sup>*

*Fytyra e Jùnus ibn Am’màrit<sup>2</sup> po merrte ngjyrë të bardhë dhe imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) e shikoi në ballë, fali dy rekate namaz dhe këndoi disa lutje. Pa dalë akoma nga qyteti, bardhësia u hoq prej fytyrës së tij.<sup>3</sup>*

*Tarkhàni, që ishte shitës skllëvërish, kafshësh e ndërmjetësues shitjesh, tregon: “Shkova tek Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) kur kishte ardhur në Hijreh, më pyeti: “Me ç’punë merresh?”*

*I thashë: “Ndërmjetësues shitjesh.”*

*Ai më tha: “Më gjej një mushkë laramane.”*

*I thashë: “T’u bëfsha kurban, po si është kjo laramane?”*

*Ai tha: “E zezë, me bark të bardhë, me kofshë të bardha e me buzë të bardha.”*

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 47, f. 122 dhe f. 170.

<sup>2</sup> Është nga Kufe dhe është vëllai i dy transmetuesve të besueshëm Is’hàkut e Ismailit, mbase edhe Jùnusi është futur ndër transmetuesit e besueshëm.

<sup>3</sup> “Menàkib” e Ibn Shehràshùbit, vëll. 4, f. 232.

Unë thashë: “Për All’llah nuk kam parë si kjo që po më thua.”

U largova prej tij dhe hyra në një hendek. Ndërkaq shoh një djalë që po shkonte t’i jepte ujë mushkës së tij, e cila kishte ato cilësi, prandaj unë e pyeta djalin: “E kujt është kjo mushkë?”

Djali më tha: “E zotërisë tim.”

E pyeta: “A e shet ai mushkën?”

Djali tha: “Nuk e di.”

Unë e ndoqa dhe prita derisa erdhi zotëria i tij dhe i bleva atij mushkën. Mora mushkën në dorë, shkova tek ai dhe i thashë: “Me këto cilësi e deshe mushkën, kurban t’u bëfsha, lutu All’llahut për mua.”

Ai tha: “All’llahu të shtoftë pasurinë dhe fëmijët!”

Tarkhàni thotë: “Ja kështu unë u bëra me më shumë pasuri e fëmijë ndër banorët e Kufes.”<sup>1</sup>

Atij i ka kërkuar edhe Ham’màd ibn Isà,<sup>2</sup> që t’i lutej All’llahut, që t’i jepte atij aq shumë sa të shkonte në Haxh sa më shpesh, t’i jepte ara të mira, një shtëpi të bukur, një grua prej shtëpive të mira e fëmijë të mirë. Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) u lut për atë që i kërkoj. Ai e kushtëzoi të bënte pesëdhjetë Haxhe. All’llahu ia dha tij të gjitha sa i kërkoj, prandaj ai bëri Haxh pesëdhjetë herë dhe, kur shkoi të kryente Haxhin e pesëdhjetë, përfundoi në luginën Xhahfeh, që është ndërmjet Mekkes e Medines. Aty e

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuâr”, f. 47, f. 125 dhe f. 200.

<sup>2</sup> Është nga fisi Xhehenij dhe është nga Basra. Ka qenë nga pasuesit e besueshëm të imam Sàdikut e të imam Qazimit (Paqja qoftë mbi të dy!).

rrëmbyen rrjedhat e ujërave dhe shërbyesit e nxorën të vdekur. Prandaj ai u quajt: "Ham'màdi, i mbyturi i Xhahëfes"<sup>1</sup>

Zejd Esh'sheh'hàmi<sup>2</sup> tregon: "Po bëja Tavàf rreth Qabesë, shputa e dorës sime ishte në shputën e dorës së Ebù Abdil'lahit, Xha'fer Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) ndërsa lotët i rridhnin nëpër faqe. Ai tha: "O Sheh'hàmi, a nuk e pe se ç'bëri Zoti im për mua?" Pastaj qau dhe u lut dhe tha: "O Sheh'hàmi, unë i kërkova Zotit tim për Sedijrin dhe për Abdu Selàm ibn Abdurrahmanin<sup>3</sup>, të cilët ishin të dy në burg, Ai m'i dhuroi mua dhe që të dy i liroi nga burgu."<sup>4</sup>

Mensùri burgosi Abdul Hamidin<sup>5</sup>, ndërkaq për këtë njoftuan imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!). Ishte koha pas namazit të pasdites dhe gjendej në bujtinë, ai ngriti të dyja duart për një orë dhe pastaj u kthye kah Muhammed ibn Abdullahu<sup>6</sup> dhe tha: "Afrohu tek All'illahu, që të lirohet shoku yt."

Muha'medi tregon: "Pyeta Abdul Hamidin se në ç'orë e liroi Ebù Xha'ferin Mensùri?"

<sup>1</sup> "El Khràixhu uel Xheràihu", f. 271.

<sup>2</sup> Do të përmendet ndër transmetuesit e besueshëm e të dëgjuar.

<sup>3</sup> Të dy do të përmenden ndër personat e dëgjuar.

<sup>4</sup> "El Keshà", f. 138.

<sup>5</sup> Në të vërtetë ai është Ibnu Ebul A'làë, El Ezedij, ka qenë me fizik të shëndoshë dhe është nga Kufe. Në një transmetim të librit "Keshful Gum'meh" ka një prononcim për atë. Ka qenë prej shokëve të imam Sàdikiut dhe nga transmetuesit e tij të besueshëm.

<sup>6</sup> Është pjesëmarrës ndërmjet të shumtëve dhe nuk përjashtohet që të jetë hashimi, pasi edhe ndër ata ka shumë.

*Ai më tha: “Ditën e Arafatit, pas namazit të pasdites.”<sup>1</sup>*

*Në këtë keramet të madh janë bashkuar pranimi i lutjes dhe njoftimi që ai bëri edhe për lirimin e Abdul Hamidit, ashtu si dy shokët e tij më parë.*

*Këto ishin vetëm disa nga lutjet e tij, që kanë gjetur përgjigje dhe janë të regjistruara nëpër libra, ose janë ruajtur në mendjet e transmetuesve; pasi lutjet e tij kanë qenë vetëm në të mirë të njerëzve. Është e vërtetë se ai edhe është lutur kundër ndonjërit, kur kjo ka qenë për përmirësim. Ai kurrë nuk është lutur kundër asnjë njeriu, sepse ai ishte i butë dhe i prirur vetëm nga e mira, megjithëse kishte pësuar prej armiqve shumë mundime e fyerje, madje ishin aq të rënda, sa do të fundoseshin brenda në tokë nga pesha e rëndë. Megjithëkëtë ai nuk u lut kundër asnjërit prej tyre. Ai është lutur për dënim vetëm për Dàùd ibn Aliun dhe Hakem El Kelbijun për një punë që vetëm ai e di më mirë; gjithashtu, ai është lutur edhe për dënimin e disa shërbyesve të Zemzemit.*

*Imam Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) ishte duke drekuar me disa shokë të tij. Ndërkaq ai i tha njërit prej shërbyesve të tij: “Nisu dhe na sill ujë Zemzemi!” Shërbyesi u nis dhe nuk vonoi të vinte, por ai nuk kishte sjellë ujë. Atëherë ai tha:*

*“Njëri prej shërbyesve të Zemzemit ma ndaloi mua ujin.”*

*Por ai i tha: “A dëshiron ujë për zotin e Irakut?”*

---

<sup>1</sup> “Menàkib” i Shehràshùbit, vëll. 2, f. 360.

Fytyra e imam Ebù Abdul'lahit ndërroi ngjyrë. Nuk hëngri dhe lëvizi buzët. Pastaj i tha shërbyesit: "Shko dhe na sill ujë!" Pastaj filloi të hajë dhe vazhdoi të hante derisa erdhi shërbyesi me ujin, por fytyra e tij vazhdonte akoma të kishte ngjyrë tjetër dhe tha: "Çfarë ka pas teje?"

Ai tha: "Shërbyesi u rrëzua në pusin e Zemzemit, mbaroi dhe të tjerët e nxorën atë."

Ai falënderoi All'llahun kundër tij.<sup>1</sup>

Një herë tjetër ai ka dërguar shërbyesin e tij në pusin e Zemzemit, që t'i sillte ujë, pastaj e kanë dëgjuar të thoshte: "O Zoti im, verboja atij shikimin! O Zoti im, lidhe gjuhën e tij! O Zoti im shurdhoje dëgjimin e tij!"

Shërbyesi u kthye duke qarë. Ai i tha: "Çfarë ke?"

Ai tha: "Filani kurejshit më ndaloi të mbush ujë."

Ai i tha: "Kthehu se me kaq je mjaftuar."

Ai u kthye, por u verbua, u shurdhua, nuk fliste dot dhe njerëzit u mblodhën rreth tij.<sup>2</sup>

Ai njofton për ngjarje që do të ndodhnin

Për sa e sa ngjarje ka njoftuar imam Sadiku të cilat kanë ndodhur pas një kohe të shkurtër ose edhe për punë që janë bërë, siç njoftoi disa herë për sundimin e abasive

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", f. 15, f. 47 dhe f. 98; "El Khràixhu uel Xheràihu" e Kutbudijn Sa'dullàh ibn Hibetullàh Erràvendij, ka qenë nga dijetarët e mëdhenj, jurist në fushën e hadithit. Nga veprat e tij është edhe libri "Sherhu Nehxh". Ka vdekur në muajin Shev'vâl të vitit 573 të hixhrit.

<sup>2</sup> "Bihàrul Anuàr", f. 47, f. 108 dhe f. 139.

*para se ata të vinin në pushtet. Erdhi Ebù Muslim El Kharàsànij, bisedoi me të në fshehtësi dhe i bëri thirrje që të dilte në përkrahje të tij, ndërkaq e njoftoi se shumë njerëz i janë përgjigjur thirrjes së tij. Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha atij: “Kjo që ti po tregon nuk është për ne, derisa me këtë luajnë fëmijët e abasitëve.”*

*Ai shkoi tek Abdullah ibn Hasani dhe i bëri edhe atij thirrje. Abdullahu mblodhi njerëzit e shtëpisë dhe desh t'i hynte punës, thirri për këshillim edhe Ebù Abdil'lahin (Paqja qoftë mbi të!). Kur erdhi, u ul ndërmjet Seffàhut e Mensùrit. Kur filloi këshillimi, imam Sàdiku i ra me dorë Seffàhut në sup dhe tha: “Jo, betohem në All'lah, ky do të marrë i pari sundimin.” Pastaj me dorën tjetër i ra Mensùrit në sup dhe tha: “Me të do të luajnë fëmijët e pasardhësve të këtij.” U çua dhe doli nga kuvendi.”<sup>1</sup>*

*Një herë tjetër i bëri thirrje Abdullah ibn Hasani për bësedhënie për të birin, Muhammedin, por ai i tha: “Kjo punë, të betohem në All'lah, nuk është as për ty e as për djalin tënd, por do të jetë për këtë, domethënë, për Seffàhun dhe pastaj për këtë, domethënë për Mensùrin dhe pas këtij për pasardhësit e këtij.”*

*Kur u largua ai, i shkoi pas Ebù Xha'feri dhe i tha: “A e di se ç'the o Ebù Abdil'lah?”*

*Imami i tha: “Betohem në All'lah, që e di. Ajo punë patjetër ashtu do të jetë.”<sup>2</sup> Për sa e sa punë të tjera të sundimit të abasive ka njoftuar ai!*

*Gjithashtu, ai ka njoftuar në disa vende edhe për vrasjen e Muhammedit dhe Ibràhimit, dy djemtë e Abdullah*

<sup>1</sup> “Kitàbul Vesij'jeh” e autorit El Mes'ùdij, f. 141.

<sup>2</sup> “Mekàtilu Tàlibij'jijn fij tesmijetil Mehdij”, f. 255-256; “Bihàrul Anuàr”, f. 47 dhe f. 131.



*ibn Hasanit. Një ditë tha: “Mervàni është i fundit i emevive dhe, nëse Muhammed ibn Abdullahu do të ngrihet, u vra.”<sup>1</sup>*

*Një ditë, duke e kundërshtuar Muhammedin, i ka thënë: “Më duket se e shikoj kokën tënde të vënë mbi një gur me grerëza dhe prej kokës rrjedh gjak në këtë vend e në atë vend të saj.”*

*Muhammedi shkoi tek i ati dhe e njoftoi për sa i kishte thënë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) atëherë i ati i tha: “All’llahu më shpërbleftë mua në ty! Në të vërtetë Xha’feri më ka njoftuar se ti do të jesh i grerëzave.”<sup>2</sup>*

*Një ditë tjetër ai ka njoftuar Um’m Husejnin, të bijën e Abdullah ibn Muhammed ibn Ali ibn Husejn (Paqja qoftë mbi ta!), kur ajo e ka pyetur për punën e Muhammedit.*

*Imami është përgjigjur: “Një ngatërresë, në të cilën do të vritet Muhammedi në shtëpinë e një rumiu, kurse vëllai i tij do të vritet për nënën e për babain e tij në Irak, atëherë kur thundrat e kalit të tij të jenë në ujë.”<sup>3</sup>*

*Ai i ka thënë Abdullah ibn Xha’fer ibn El Musev’virit<sup>4</sup>: “A e sheh atë që ka veshur rrobë të verdhë, domethënë Ebù Xha’ferin?”*

---

<sup>1</sup> “Kitàbul Vesij’jeh”.

<sup>2</sup> “A’lâmul Verà” e Tabresij’jit, f. 269. Ai është Fadl ibn Hasan ibn Fadl, është nga krerët e dijetarëve të imamitëve. Është autori i librit “Mexhmeul Bejàn fij tefsiril Kur’àn”. Si ky libër nuk është shkruar më. Ka shkruar edhe vepra të tjera të rëndësishme. Ka vdekur natën e drekës së Kurban Bajramit në Sebzevar në vitin 548 të hixhrit.

<sup>3</sup> “El Mekàtil fij Tesmijetil Mehdij”.

<sup>4</sup> Në fakt, ai është nga fisi Makhremij, sipas gjyshit të tij Makhremeh, që është baba i Musev’virit. Atë e kanë numëruar ndër pasuesit e imam Sàdikut. “El Xharàixhu uel Xheràihu”, f. 244.

*“Po.”, i tha.*

*Atëherë imami tha: “Betohem në All’llah, se ne do të shohim se ai do të vrasë Muhammedin.”*

*Por ai tha: “Ose Muhammedi do ta vrasë atë?”*

*Me vete thashë: “Po, betohem në Zotin e Qabesë, ai e ka smirë atë dhe, unë nuk e lashë këtë botë pa e parë atë të vrasë.”*

*Për këtë çështje ai ka njoftuar edhe babain e atyre të dyve, Abdullah ibn Hasanin dhe i ka thënë: “Mensùri, do të vrasë Muhammedin mbi gurët e vajit, pastaj do të vrasë vëllanë e tij në brigjet e lumit, kur këmbët e kalit të tij të jenë në ujë.”<sup>1</sup>*

*Ka njoftuar për punët e abasive dhe të Muhammedit e Ibrahimit. Ato ndodhën ashtu siç kishte njoftuar ai, pa lëvizur asgjë nga fjalët e tij.*

*Ai ka njoftuar edhe Shuajb ibn Mejthem<sup>2</sup> se atij i është afruar vdekja dhe Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “O Shuajb, sa mirë është për atë burrë që vdes duke qenë mik me ne dhe kundërshtar i armikut tonë!”*

*Shuajbi i tha: “Betohem në All’llah, unë e di mirë se, ai, që vdes kështu, është në një gjendje të mirë.” Imami tha: “O Shuajb, bëji mirë vetes, mbaji lidhjet me të afërmit tuaj, jepi besën vëllezërve tuaj, mos ndërro gjë të thuash: “E rezervoj për vete e për njerëzit e familjes sime, sepse Ai, që i ka krijuar ata, i furnizon.”*

<sup>1</sup> “El Mekâtilu fîj Tesmijetil Mehdij”, f. 255-256.

<sup>2</sup> Et’tem’mâr, ai është nga pasuesit e imam Sâdikut. Ne kemi shkruar për të në kumtesën tonë “Mejthem Et’tem’mâr” f. 78.

*Atëherë Shuajbi tha: “Thashë me vete: “Për All’llah, ai po me njofton vdekjen time.”*

*Pas këtij njoftimi nuk kaloi as një muaj dhe ai vdiq.<sup>1</sup>*

*Gjithashtu ai ka njoftuar Is’hàk ibn Am’màr Sajrefij’jin, i cili është nga të besueshmit e nderuar se së shpejti do të vdesë në muajin Rebijë. Kjo ka ndodhur atë ditë, kur Is’hàku i tha imam Sàdikut: “Ne kemi pasur dhe veprojmë me njerëzit, por kam frikë të mos ndodhë, që pasuritë tona të jenë të shpërndara.”*

*Atëherë imam Sàdiku i tha: “Mblidhi pasuritë tuaja në muajin Rebijë.” Is’hàku vdiq në muajin Rebijë.<sup>2</sup>*

*Ai ka njoftuar edhe për vrasjen e shërbyesit të tij, Mual’là ibn Khanijsit, të cilin e vrau Dàùd ibn Aliu. Këtë njoftim ai e bëri një vit para se ai ta vriste, madje ai kishte njoftuar për gjithçka që do të bëhej kundër tij.<sup>3</sup>*

*Atë e ka pyetur Ebù Besijrin për Ebù Hamza Themàliun, për të cilin i tha: “Pasardhësit e tij janë të mirë. Kur të kthehesh tek ai, përshëndete nga unë dhe njoftoje se ai do të vdesë në këtë orë e në këtë muaj.”*

*Ebù Besijri tregon: “Unë u ktheva, por Ebù Hamzai vdiq pikërisht atë ditë, në atë orë e në atë muaj.”<sup>4</sup>*

*Kur tek ai arriti lajmi i vrasjes së Zejdit dhe i kryqëzimit të tij, lajmi i largimit të djalit të tij Jahjàsë, për në Khorasàn, si dhe lajmi për grumbullimin e njerëzve rreth tij, imam Sàdiku tha: “Edhe ai do të vritet e do të*

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuâr”, f. 47 dhe f. 126; “El Menàkib”, vëll. 3, f. 350.

<sup>2</sup> “Menàkib” i Shehràshùbit, vëll. 3, f. 368; “A’lâmul Verà”, f. 270.

<sup>3</sup> “El Keshà” në lidhje me gjendjet e Mual’lâsë, f. 239.

<sup>4</sup> “Keshful Gum’meh”, vëll. 3, f.19.

*kryqëzohet, ashtu siç u vra e u kryqëzua babai i tij.” Me të vërtetë, ai u vra në Xheuzexhân dhe u kryqëzua.<sup>1</sup>*

*Në disa raste ai ka njoftuar për ngjarje që nuk kishin ndodhur, por që ndodhën ashtu siç kishte njoftuar ai. Njoftimet e tij, për ngjarje që do të ndodhnin, janë të shumta.*

*Tani ja disa nga ato:*

*Ndodhi një grindje ndërmjet Muhzim ibn ebij Burejdeh El Esedij El Kufij, i cili është nga transmetuesit e imanit dhe nënës së tij. Kur ai shkoi tek ajo për një nevojë, fjala e tij me nënën, në Medine, qe e ashpër. Kur u gdhi, ai shkoi tek imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), i cili filloi të thotë: “O Muhzim, ç’pate që i fole ashpër nënës tënde? A nuk di se barku i saj ka qenë shtëpia ku ti ke banuar, se prehri i saj ka qenë djepi, ku je përkundur dhe se gjiri i saj ka qenë ena nga ku ke pirë? Prandaj mos i fol ashpër asaj.”<sup>2</sup>*

*Tek ai hyri një burrë dhe imam Sàdiku: “Bëj Teube para All’llahut për atë që bërë mbrëmë.”*

*Ky burrë kishte ardhur në Medine dhe kishte rënë në një shtëpi ku ishte edhe një grua, e cila e kishte mahnitur. Kur ai u largua natën, e hapi derën, zgjati dorën në drejtim të gjoksit të saj dhe e kapi atë.<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> “Jenàbij’ul Meved’deh”, f. 381.

<sup>2</sup> “Besàiru Derexhât”, vëll. 5, f. 263.

<sup>3</sup> “Besàiru Derexhât”, vëll. 5, f. 262.

*Një burrë, nga banorët e Kufes, shkoi tek banorët e Khorasanit, që t'u bënte atyre thirrje për të mbështetur imam Sàdiku, që ai të merrte pushtetin, por ata patën kundërshtime për këtë punë. Ndër ata kishte të bindur, që i përgjigjeshin thirrjes, kishte edhe kundërshtarë, që e refuzonin këtë thirrje, kishte edhe të përkushtuar, që nuk prononcoheshin. Prandaj secili grup dërgoi nga një burrë tek imam Sàdiku, me qëllim që t'ia bënin të qartë gjendjen atij. Këta burra bënë një pjesë të rrugës së bashku, por njëri prej tyre kishte qëndruar i vetmuar me një femër, që ishte me disa njerëz të tjerë. Kur ata arritën tek imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) e njoftuan për qëllimin që kishte. Ai i tha atij që po fliste. Ishte pikërisht ai që kishte prekur atë femrën: "Ti prej cilit nga të tre grupet je?"*

*Ai tha: "Jam nga grupi i të përkushtuarve."*

*Atëherë imami tha: "Po ku është përkushtimi yt në filan ditë, me filan femër?"*

*Ai burri heshti.<sup>1</sup>*

*Në jetë të jetëve qëndron e vërteta. Kjo ndodhi është argumenti më i madh, që tregon për imamatin, nëse njerëzit do të kërkonin të vërtetën dhe argument për imamatin.*

*Abdullah Nexh'xhaiu<sup>2</sup> ka qenë zejdi i thekur ndaj Abdullah ibn Hasanit dhe një ditë ai shkoi tek imam Sàdiku*

---

<sup>1</sup> "El Menàkib" dhe "Besàiru Derexhàt", vëll. 5, f. 265; ai është Muhammed ibn Muahm'med ibn Hasan Es'saf'fàr El Kumij Ebù Xha'fer El A'rexh; është ndër banorët e Komit. Ka qenë lider me besueshmëri të madhe e me pozitë të nderuar. Ka transmetuar pak, ka shkruar shumë libra të vlefshme. Ka vdekur në vitin 290. Shejh Tùsij e ka numëruar atë ndër burrat e tij dhe ndër pasuesit e Hasan Askeriut (Paqja qoftë mbi të!). Libri i tij "Besàiru Derxhàt" është libër me vlera të shumta e të mëdha.

<sup>2</sup> Ebù Bexhijr El Esedij, ka qenë mëkëmbës (vali) në Ehvâz, pasi është prononcuar për imamatin e Sàdikut, filloi të ketë korrespondencë me të dhe ta pyesë për punë nëpunësish që kishte dhe imami i ka dërguar një

dhe ai i tha atij: “Ç’pate që e bërë atë që bërë? A e kujton atë ditë, kur kalove pranë derës së disa njerëzve dhe mbi ty kulloi vatha e bagëtisë, që ishte poshtë shtëpisë? Kur ti i pyete, të thanë: “Kjo është ndyrësi.” Pastaj ti u krodhe në lumë me gjithë rroba, të cilat kullonin. Ndërkaq rreth teje u mblodhën fëmijët, që qeshnin me ty dhe thërrisnin me zë të lartë.” Kur ai doli, imam Sàdiku, tha: “Ky është shoku im dhe jo dikush tjetër.”<sup>1</sup>

Nga ata që ai i ka numëruar rrugës është edhe hyrja e Ebù Besijrit tek imam Sàdiku duke qenë xhynyb dhe sprapsja që i bëri atij Sàdiku. Këtë ngjarje e tregon vetë Ebù Besijri: “Hyra tek Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!), pasi unë doja që ai të më jepte argument për imamatin e tij, ashtu siç më kishte dhënë Ebù Xha’feri. Unë hyra tek ai xhynyb. Ai tha: “O Ebù Muhammed, po hyn tek unë xhynyb?”

Unë i thashë: “Këtë e kam bërë me qëllim.”

Atëherë ai tha: “A nuk beson?”

Thashë: “Patjetër, por desha që të më qetësohet zemra.”

Atëherë unë thashë: “Me të vërtetë, ai është imam.”<sup>2</sup>

Njoftimi i tij për ato që janë në shpirt

---

libër të madh, ku ishin përgjigjet e tij. Në libër janë përmendur punët, që ai kishte detyrë të dinte nga jetëshkrimi, e nga puna e mirë, të cilat ne do t’i përmendim në porositë e tij.

<sup>1</sup> “El Menàkib” dhe “Besàiru Derexhàt”, vëll. 5, f. 265 etj.

<sup>2</sup> “Vesàilu Shi’ah”, vëll. 1, f. 3 dhe f. 490; disa hadithe të Ebù Besijrit i ka përmendur shejhu El Mufijid në librin “El Irshàd”. Gjithashtu, e ka përmendur Ibn Bâbùjeh në librin “Delàilul Imàmeh”; e ka përmendur edhe Et’tabresiu në librin “A’lâmul Verà” e autorë të tjerë.

*Kur shpirti i besimtarit pastrohet nga zhuli i poshtërsive, bëhet si një pasqyrë, në të cilën shihet qartë çdo gjë që është para saj. I Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: "Ruhuni nga shikimi i vëmendshëm i besimtarit, sepse ai shikon me dritën e All'llahut."*

*Kur është kështu për pozitën e një besimtari, si do të ishte puna për imamin e besimtarëve?*

*Ja Hizri (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) shqyen anijen, ndërton murin e vret djalin. Këto punë nuk ishin prej tij, por ato ishin dituri, që atij ia kishte dhënë i Gjithëdituri, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe nuk ka nevojë për asgjë. Atëherë nuk është ndonjë çudi, që imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) di gjëra që regëtojnë në shpirtërat e njerëzve, kur ai shfaq kerametin. Umer ibn Jezijdi<sup>1</sup> hyri tek imam Sàdiku. Ai ishte i sëmurë, po rrinte i mbështetur me shpinë në mur.*

*Umeri tha me vete: "Nuk e di se si do të jetë sëmundja e tij. Sikur ta pyesja për imamin, që do të jetë pas tij?" Ndërsa po mendonte këtë, Sàdiku ktheu kokën në drejtim të tij dhe tha: "Çështja nuk është ashtu si kujton ti, nga kjo dhembje mua nuk më gjen gjë."<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> A janë dy shitës rrobash të vjetra apo është një? Sido që të jetë, ata të dy janë nga përkrahësit e imam Sàdikut dhe transmetuesit e tij të besueshëm.

<sup>2</sup> "Besàiru Derexhât", vëll. 5, f. 259.

*Tek ai hyri Hasan ibn Mùsà Elhan'nàti<sup>1</sup>, Xhemijl ibn Derr'ràxhi<sup>2</sup> dhe Àidh El Ahmesij'ji<sup>3</sup>, i cili po thoshte: "Unë kam një problem, për të cilin dua të pyes atë."*

*Kur u përshëndetën e u ulën, ai u kthye me fytyrë në drejtim të Àidhit dhe tha: "Kush i shkon All'llahut me ato që ai ka bërë detyrim mbi të, përveç këtyre gjërave, Ai nuk do ta pyesë atë për asgjë tjetër." I shkeli atyre syrin dhe ata u ngritën. Por, kur ata morën të dilnin, ai tha: "Ç'nevojë kishe ti?"*

*Ai tha: "Atë që dëgjuam, sepse unë jam i pafuqishëm të fal namaz natën dhe kisha frikë se do të dënohem e të shkatërrohesha fare."<sup>4</sup>*

*Tek ai hyri Shihàb ibn Reb'beh,<sup>5</sup> që donte ta pyeste për një njeri xhynyb, i cili merr një grusht ujë prej enës, por, kur shkoi tek ai, e harroi çështjen. Ndërkaq Ebù Abdil'lahi e shikoi dhe tha: "O Shihàb, nuk ka ndonjë gjë kur ai, që është xhynyb, merr ujë me grusht në enën e ujit."<sup>6</sup>*

<sup>1</sup> Ai është nga shokët e imam Sàdikut. Për atë kanë transmetuar disa transmetues të besuar dhe dijetarë të bazave të jurisprudencës. pasi edhe ata, që nuk kanë transmetuar prej tij, janë të besueshëm si puna e Ibn Ebij Umejrit.

<sup>2</sup> Është nga fisi Nekha'ij dhe ne do t'i përmendim atë ndër transmetuesit e tij të besuar.

<sup>3</sup> Për atë kanë transmetuar të besuar si Xhemijl ibn Derr'ràxhi dhe imam Sàdiku ka shkuar tek ai.

<sup>4</sup> Shejhu në librin "Tehdhijbul Emàlij"; El Kelbij në librin "El Kâfij", S dùku në librin "El fekih". Këta autorë e kanë përmendur atë në librin e namazit në pjesën: "Namazi i natës" dhe "El Menàkib", vëll. 3, f. 226.

<sup>5</sup> Është nga dijetarët e Kufes, nga shokët e imam Sàdikut dhe nga transmetuesit e tij të besuar.

<sup>6</sup> "Besàiru Derexhàt", vëll. 5, f.63; "Bihàrul Anuàr", f. 13, f. 47 dhe f. 68.



*Xha'fer ibn Hârùn Ez'zîj'jâti<sup>1</sup> po rrotullohej rreth Qabes. Në Tavaf ishte edhe Ebù Abdil'lahi. Zij'jati shikoi në drejtim të tij dhe tha me vete: "Ky është argumenti i All'llahut, ky është ai që All'llahu nuk pranon asgjë pa e ditur ai."*

*Ndërsa ishte në këto mendime, i vjen nga mbrapa Sàdiku, i bie me dorë më sup dhe i thotë: "Ata (themudasit) thanë: "Vallë, a të ndjekim një njeri nga mesi ynë? Atëherë do të ishim vërtet në rrugë të humbur dhe të çmendur." (Sure "El Kamer", ajeti 24), pastaj u largua prej tij.<sup>2</sup>*

*Tek ai ka hyrë Halid ibn Nexhijh El Xhev'vâzi.<sup>3</sup> Në këtë kohë tek ai ishin edhe disa të tjerë. Halidi u maskua dhe mbuloi kokën, u ul në një qoshe dhe po thoshte me vete: "Të mjerët ju, sa të shkujdesur jeni para Zotit të botëve, ndaj atij me të cilin po flisni!"*

*Imam Sàdiku e thirri dhe i tha: "Mjerë ti o Halid! Beto hem në All'llah se unë jam një rob i krijuar dhe unë kam një Zot, të Cilin e adhuroj. Nëse unë nuk e adhuroj Atë, betohem në All'llah, Ai më ndëshkon në zjarr."*

*Halidi tha: "Jo, për All'llah, nuk po flas për ty, por them vetëm atë që ti ke thënë për veten tënde."<sup>4</sup>*

---

<sup>1</sup> Nuk ka tekst për vërtetimin e tij, por ata e kanë nxjerrë në shesh se ai është prej Has'sanit.

<sup>2</sup> "Besàiru Derexhât", vëll. 5, f. 65; "Bihàru Anuàr", f. 25, f. 47 dhe f. 70.

<sup>3</sup> Sido që të jetë, ai e përmirësoi besimin e tij pas atij renegatizmi. Atë e kanë numëruar ndër shokët e imam Qâzimit. Gjithashtu, ai ka qenë edhe portieri i mam Rizàsë pas tij.

<sup>4</sup> "Besàiru Derexhât", vëll. 5, f. 261.

*Kjo është pak nga ajo shumicë e madhe, që kanë transmetuar librat e vyer nga kerametet e veprimet e larta të Ebù Abdil'lah Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Nuk na habit fakti se librat kanë përmendur shumëfishin e asaj që ne sollëm në fillim të kapitullit të kerameteve të tij e deri tani.*

*Nuk ka dyshim që jeni të mahnitur me ato që u paraqitën. Ne nuk kemi rrugë tjetër, përveç tekstit, për të vërtetuar kerametin. Ata, që i kanë shijuar këto pamje, kanë qenë ose bashkëkohës të Profetit ose të imanit. Atëherë, si qëndron puna e kerameteve për njerëzit e brezave të mëvonshëm, si dhe të bashkëkohësve të tij, që nuk kanë qenë të pranishëm që të shikonin kerametin? A ka rrugë për të vërtetuar atë që është cituar? Vetë citimi, a është i saktë në konsideratën e autorit e të transmetuesit? Është kërkesë që konsiderata e tij duhet të arrijë gradën e përcjelljes nga disa grupe e në rrugë të ndryshme, por edhe kjo ose për një çështje të caktuar ose për disa çështje, nga të cilat rezultatja është besimi në daljen e mrekullive prej profetit ose e kerameteve prej të porositurit, edhe nëse besimi nuk arrihet për ndonjërin nga kerametet.*

\* \* \*

## **PËRZGJEDHJE NGA FJALA E TIJ**

*Fjalën e imam Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!) nuk e ndërpret ndonjë shenjë e nuk e përmbledhin faqet, aq të shumta janë bazat e dijes së tij dhe aq të gjera janë degët e diturisë së tij. Duam, që nga fjala e tij, të përmendim katër pjesë: Predikimet, Këshillat, Porositë dhe Fjalët e urta. Në këto pjesë janë të mirat që merr paria sunduese, këtu pinë ujë të eturit, si në këto është gjallëria e shpirtave. Kam punuar për t'i mbledhur e për t'i përzgjedhur këto prej librave e botimeve më të mira.*

### **1 - FJALIMET E TIJ**

*Nga shënimet, që kemi, nuk njihet që ai të jetë ngjitur në podiume për të dhënë orientime, por as kushtet nuk mundësuan që ai të predikonte para masave. Megjithëkëtë, me aq sa më lejuan kërkimet, unë zbulova dy predikime të tij, njëri i gjatë dhe tjetri i shkurtër.*

*Predikimi i parë është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë bën fjalë për cilësitë e Profetit. Ai thotë:<sup>1</sup> “Zoti ynë, me butësinë e Tij, me kujdesin dhe me dashamirësinë e Tij nuk ka ndaluar edhe krimin e tyre më të madh e punën e tyre më të keqe, vënien dorë nga ana e tyre mbi më të dashurin e profetëve të Tij dhe më të nderuarin ndër ta, Muhammed ibn Abdullahun (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), lindja e të cilit është në shkallën më të lartë të madhështisë, nderimi i tij është në rrënjën e pemës, pozita e tij është pa asnjë shtrembërim, origjina e tij nuk ka asnjë përzierje, cilësitë e tij nuk janë të panjohura për dijetarët. Për të kanë përgëzuar profetët në librat e tyre, dijetarët kanë folur për cilësitë e tij me ato shprehje, që të urtët kanë shpresuar t’i përshkruajnë: i edukuar, që nuk i afrohesh, hashimi, që nuk i rri kush përballë, i gjerë, sa nuk arrihet. Morali i tij ishte turpi, natyra e tij ishte bujaria, i krijuar në madhësinë e rëndësisë së profetësisë e të moraleve, i stamposur me cilësitë më të buta të mesazhit, derisa caktimet e All’llahut të përfundojnë në kohën e tyre. Ai e çoi në qëllimet më të larta vendimin e padiskutueshëm të All’llahut. Me të Ai përgëzon të gjitha kombet që do të vijnë, Ai bëri që brezat të vijnë nga shpina e një babe në një babë tjetër. Racën e tij Ai nuk e përziën me naivë, lindjen e tij nuk e ka ndotur me prostitucion. Ai ishte i kënaqur me të dhe e ruajti nga mëkatet, Ai i dha atij çelësat e diturisë dhe burimet e fjalëve të urta, Ai e dërgoi atë mëshirë për njerëzit, pranverë për vendin. All’llahu i zbriti atij Librin, në të cilin*

---

<sup>1</sup> Kjo fjalë mund të mos jetë fillimi i predikimit. Prandaj si fillim, patjetër duhet të ishte një fjalë tjetër dhe jo kjo; megjithëse unë kam parë me kujdes të gjithë kapitujt e librit “El Kâfij”, përsëri nuk kam gjetur më shumë nga sa kemi sjellë.

janë shpjegimet e qarta, ai është Kur'ani në gjuhën arabe. Mbase ata do të frikësohen. Ai e shpjegoi librin për njerëzit dhe u vuri atë platformë veprimi me dituri të shkoqitura, me një fe të cilën ai e shpjegoi qartë, me obligime, që Ai i ka vënë detyrë, me sanksione të përcaktuara, që ai i ka shpjeguar për njerëzit; punë, që Ai i ka zbuluar për njerëzit dhe i ka shpallur ato sheshit. Në ato punë ka argumente, që çojnë në shpëtim dhe shenja që bëjnë thirrje për udhëzim në rrugën e drejtë. I Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) e kumtoi atë me të cilën ishte dërguar, e tha me zë të lartë atë për të cilën ishte urdhëruar. Ai e kreu barrën e rëndë të profetësisë, uroi për Zotin e tij, luftoi në rrugën e Zotit të tij, e këshilloi ummetin e tij dhe i bëri atyre thirrje për shpëtim. Ai i nxiste ata të përmendnin Atë, duke i drejtuar në rrugën e udhëzimit të drejtë. Për njerëzit ai vuri themelet e këtij udhëzimi me programe nxitëse. Ai tregoi gradët e larta, duke ngritur flamujt e diturisë, që njerëzit, pas tij, kurrë të mos bien në rrugën e humbjes. Me njerëzit ai ishte i dashur e i mëshirshëm.<sup>1</sup>

Pjesa e dytë ka të bëjë me cilësitë e imamëve (Paqja qoftë mbi ta!) dhe këtë pjesë e ka përmendur El Kulejni, në "El Kâfij", pjesa "Argumenti", në kapitullin e rrallë e përgjithësues të përshekrimit të imamit e të cilësive të tij.

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Lindja e Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)", pasi ka përmendur referimin prej Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: "Në një predikim të tij të veçantë ka përmendur gjendjen e Profetit Muhammed, si dhe gjendjen dhe cilësitë e imamëve. Këtu ai ka përmendur atë që është e veçantë për Profetin kurse në një kapitull të veçantë ka përmendur mirësinë e imamit, cilësitë e imamit dhe atë që është e veçantë për imamin.

*Atë e ka përmendur edhe El Mes'udij Ali ibn Husejn<sup>1</sup> në librin "El Vesij'jeh" faqe 139 dhe ka thënë: "Kur urdhri i All'lahu të Lartësuar shkoi për tek ai – domethënë për tek imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) përkrahësit e pasardhësve të imam Aliut (shi'at) u mblodhën dhe ai mbajti para tyre një predikim: "Falënderoi All'lahun dhe u kujtoi atyre ditët e All'lahut."*

*Pastaj ai përmendi pjesën, që ne do të sjellim më poshtë. Ndërmjet tregimit të El Kulijnit dhe tregimit të El Mes'udijut ka pak ndryshim, por ne do ta sjellim predikimin sipas variantit të El Kulijnit, sepse në të ka më shumë material.*

*Imam Sadiku ka thënë: "All'lahu i Lartësuar, me imamët e udhëzuar në rrugën e drejtë prej Ehli Bejtit të Profetit tonë, ka shpjeguar qartë fenë e Tij. Me ata Ai ka ndriçuar rrugët e fesë, ka hapur brendësinë e burimeve të diturisë së fesë. Prandaj çdo pjesëtar i ummetit të Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij), që e di se ka për detyrë njohjen e së drejtës së imamit të tij, ka shijuar ëmbëlsinë e besimit të vet, ka mësuar virtytin e gëzimit të Islamit të tij, sepse All'lahu i Lartësuar e ka vënë imamin dituri për njerëzit e Tij dhe e ka bërë argument për njerëzit e kohës së tij. All'lahu e ka bërë imamin të respektuar, e ka mbuluar me dritën e madhështisë së Tij, e furnizon atë prej qiellit me një shkak. Materialet e Tij nuk ndërpriten dhe ato, që janë tek All'lahu, arrihen vetëm me argumentin e shkaqeve të Tij.*

---

<sup>1</sup> Ebul Hasan El Hedhelij El Bagdâdij, autor i botimeve me vlera të mëdha, ndër të cilat, më e dëgjuaara është "Murùxhu Dheheb", është imami në medh'heb, por te ai mbështeten të dy grupet. Nuk është saktësuar viti i vdekjes së tij, por thuhet se ka qenë gjallë deri në vitin 345.

All'llahu nuk i pranon punët e robëve vetëm me njohjen e imanit të tij,<sup>1</sup> i cili është i ditur për ato që kanë ardhur nga veshjet e errësirës, nga përgjithësimet e viteve dhe nga dyshimet e sprovave. All'llahu i Lartësuar vazhdimisht i përzgjedh ata prej pasardhësve të imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) imamë pas imami. Për këtë qëllim Ai jo vetëm që i përzgjedh ata, por edhe i ruan nga mëkatet. Ai është i kënaqur që imami është në mesin e njerëzve të Tij, por edhe njerëzit janë të kënaqur prej imamëve. Sa herë që një imam shkon, në vendin e tij All'llahu ve një imam tjetër, të ditur dhe shpjegues, udhëzues e ndriçues, imam me vlera të larta. Ata udhëzojnë të vërtetën dhe zbatojnë drejtësinë. Janë kujdestarë e thirrës në rrugën e Tij. Me udhëzimin e imamëve, Ai i bën ata rob në fe, në dritën e tyre Ai lehtëson vendin, me mirësinë e tyre Ai rrit përfundimet e rezultateve. All'llahu ka bërë që ata të jenë për njerëzit pishtarë në errësirë, çelësa për besimin në cilësitë e Tij, kolona të Islamit. Imami është i përzgjedhuri, prej të cilit të tjerët janë të kënaqur, është udhëzuesi i ruajtur, që vjen me rezultate, është i shpresuari, që do të jetë në krye të punëve. Me të tilla cilësi e ka përzgjedhur atë All'llahu, me të tilla karakteristika e ka punuar Ai prej diturisë së Tij dhe në krahët e rërave e ka shpërndarë, ndër të ulëtit e vuri kur e krijoi, hije para krijimit, erë e freskët nga e djathta e Arshit të Tij. Tek Ai imami është i mbushur me urtësi në diturinë e së panjohurës. Ai e përzgjedhi atë me diturinë e Vet, e ruajti me pastërtinë e Tij, mbetje prej Ademit (Paqja e

---

<sup>1</sup> Ashtu siç ka thënë profeti Muhammed "Kush vdes dhe nuk e njeh imamin e kohës së tij, ka vdekur si në kohën e injorancës para Islamit.", domethënë: nuk është bërë mysliman dhe nuk ka bërë ndonjë punë nga feja islame, si, adhurime, etj.

*All'llahut qoftë mbi të!), nga më të mirët e pasardhësve të Nuhut, krejtësisht i pastër prej familjes së Ibrahimit, brezni prej Ismailit, më i miri prej degës së Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) vazhdon të jetë nën kujdesin e All'llahut. Ai e ruan atë dhe e mbron me mbulimin e Tij, largon prej tij rrjetat e Ibliisit e të ushtrisë së tij, spraps prej tij gjithçka të ligë, që stiset në errësirën e natës dhe të gjitha magjitë, punët e liga e nxitësit për punë të liga janë të larguara prej tij. Imami është pa sëmundje e pa lëngata, është i ruajtur nga të gjitha mëkatet. Imami është i njohur për butësi e mirësi në rininë e tij, në mbarimin e jetës është i përmbajtur në ndershmëri, në dituri e në virtyt. Ai arriti kohën e fundit të babait të tij dhe kur ai kaloi, pas tij urdhri i All'llahut u bë për të; ai vazhdoi fenë e tij dhe Ai e bëri atë argument për robët e Vet, e vlerësoi në vendin e tij, e përforcoi me Xhibrijlin e Tij, i dha nga dituria e Vet, i njoftoi sqarimin e shpjegimeve të Tij, e vuri atë dijetar për njerëzit e Vet, e bëri argument për banorët e botës së Tij dhe ndriçim për besimtarët e fesë së Tij, e bëri më të vlerësuarin mbi robët e Tij. Me të është i kënaqur All'llahu, që ai është imam për ta, në atë Ai ka depozituar sekretin e Tij, ka ruajtur diturinë e Vet, ka fshehur urtësinë e Tij dhe e ka përkujdesur atë për fenë e Vet, e ka deleguar atë për punën e Tij të rëndësishme. Me atë Ai ka gjallëruar obligimet e rrugës së Tij, si dhe detyrimet e penalitetet e Tij. Imami zbatoi drejtësinë, kur injorantët ishin në mëdyshje dhe kur polemizuesit e kotë u turbulluan me drita vezulluese, me shërimin dobisjellës, me të vërtetën që shkëlqen, me shpjegimin valëvitës prej të gjitha daljeve, në rrugën që kanë ecur të drejtët nga prindërit e tij. Të drejtën e këtij dijetari nuk e njeh vetëm i keqi dhe e mohon vetëm*



*mashtuesi. Kësaj rruge i ve pritë vetëm ai që, me naivitetin e tij, del kundër All'llahut të Lartësuar.*

*Unë them: “Mbase ti edhe mund të stepesh nga gjykimi sipas të zakonshmes, që te një njeri të jenë këto cilësi të mëdha dhe të bësh pyetjen: “Si i mban ai këto cilësi? Nëse do të mendosh, do të gjesh se imami është zëvendësues i të Dërguarit, prandaj zëvendësi i tij detyrimisht duhet të kryejë edhe detyrat e tij, të jetë orientues për ummetin, përmirësues për të gjithë njerëzit. Ai nuk pohon që këto cilësi janë të shkëputura prej tij. Ai patjetër duhet të jetë i stolisur me këto cilësi.”<sup>1</sup>*

*Predikimi i dytë është transmetuar në “El Menàkib” të Shehràshùbit, vëll. 1, f.183-184. Ai ka thënë: “Kur Hishàm ibn El Velijdi hyri në Medine, tek ai erdhën pasardhësit e Abbàsit dhe u ankuan për Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!) se ai paska marrë atë që ka lënë Mâhir El-Khusij dhe nuk i kishin marrë ata.”*

*Atëherë Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) mbajti një predikim. Ndër të tjera ai tha: “Kur All'llahu dërgoi të Dërguarin e All'llahut, babai ynë Ebù Tàlibi, e ka mbajtur atë nën kujdesin e nën shoqërinë e tij dhe ka qenë ndihmues për të. Babai juaj Abbàsi dhe Ebù Lehebi gënjejnë, ata janë nën sundimin e djajve të mohimit, babi juaj tejkalon edhe kufijtë e gjërave që nuk i di dhe që çojnë në shkatërrim. Ai udhëhoqi fiset në Bedër. Ai ishte i pari i këmbësorëve dhe i kalorësve të atyre fiseve. Atë ditë ai ishte edhe bukëdhënësi i tyre dhe personi që luftoi më shumë.*

---

<sup>1</sup> Te “Parashtrimi”, në fillim të librit, ka një argument për imamatin, të cilin e konsiderojmë të mjaftueshëm për përcaktimin e cilësive të imamit, dhe kjo krahas argumenteve për këtë çështje, që janë në kumtesën tonë “Shi'at dhe imamati”.

*Babai juaj ishte ai, që ne i dhamë lirinë. Ai përqafoi Islamin nën presionin e shpatave tona. Ai kurrë nuk emigroi për tek All'llahu e i Dërguari i Tij, prandaj All'llahu e ka ndaluar që ai të jetë i parë mbi ne: "Vërtet, ata që besuan dhe mërguan (për hir të besimit), e më pas luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugën e Allahut dhe ata që u dhanë strehim e i ndihmuan, janë miq e mbrojtës për njëri-tjetrin. Por, ata që besojnë e që nuk kanë mërguar, nuk të kërkohet t'i mbrosh, derisa të mërgojnë. E, nëse ju luten që t'i ndihmoni për çështjen e fesë, atëherë jeni të detyruar t'u dilni në ndihmë, përveçse (kur ju duhet të luftoni) kundër një populli me të cilin keni marrëveshje. Allahu e sheh mirë atë që veproni." (Sure "El-Enfâl", ajeti 72)*

*Sundimtari për ne ka vdekur. Krenaria jonë është trashëgimia e tij. Sundimtari ynë dhe patjetër edhe unë, jemi djemtë e të Dërguarit të All'llahut. Nëna jonë është Fâtimja, ruajtësja e trashëgimisë së tij."*

*Unë them: "Sàdiku qëndron më lart, që të miratojë pasardhësit e Abbàsit për shkak të pasurisë, por mund të mendohet se ai ka qëllim të zbulojë një gjendje të panjohur të Abbàsit, për shkak se sundimi do të ishte te pasardhësit e tij dhe që njerëzit të mësonin natyrën e atyre që do të kishin mbi qafat e veta."*

*Këto fjalë kaq të përmbledhura i sjellin historisë dobi të shumta. Megjithëse unë mendoj se historia nuk i përmend këto qëndrime për Abbàsin.*

*Më lart unë kam thënë: "Me aq sa jam munduar, nuk kam gjetur predikime të Ehli Bejtit përveç këtyre që përmendëm. Nëse do të numëronim si predikim edhe qëndrimin e tij përballë Shejbeh ibn Gaffàlit, valiut të Mensùrit në Medine, të cilin ne e kemi përmendur në pjesën e parë, duke përshkruar qëndrimet e tij me Mensùrin e me shtetarët e tij në pjesën e parë të librit, atëherë do të ishin tre predikime.*

## 2 – KËSHILLAT E TIJ

*Imami ynë (Paqja qoftë mbi të!) vazhdon të shpërndajë këshillat e tij ndër njerëzit, që t'i edukojë e t'i orientojë ata në rrugën e qartë të All'llahut të Lartësuar, duke u kujdesur për lumturinë e tyre në të dyja jetët. Nga këshillat e tij tek ne kanë arritur aq shumë, sa nuk përmbledhen të gjitha dhe gjenden të shpërndara në faqet e librave që ne kemi mundur të kemi në dorën tonë.*

*Ne menduam që të sjellim më të rëndësishmet e këshillave, që kanë arritur tek ne, duke i renditur ato në kapituj të veçantë, si më poshtë:*

### *Njohja*

*Njohja e All'llahut të Lartësuar është e para e detyrave, është baza e virtyteve dhe e punëve, madje është qëllimi i qëllimeve, është përfundimi i plotësimit të njeriut, sepse sipas virtyteve është edhe nderimi ndër njerëzit. Prandaj edhe ne e vumë njohjen në krye të këshillave të tij. Nga fjala e tij është e mjaftueshme të sjellim nga këto këshilla fragmentet e mëposhtme, të cilat bëjnë thirrje për njohjen e All'llahut dhe e nxisin njohjen, duke zbuluar vlerën e madhe të efekteve të njohjes, si dhe kënaqësinë e madhe të saj. Paqja e shpëtimit qoftë mbi të! - ka thënë: "Sikur njerëzit të dinin mirësinë e madhe, që ka në njohjen e All'llahut të Lartësuar, nuk do t'i hidhnin sytë e tyre në bukuritë e mirësitë që All'llahu ka krijuar në këtë botë. Bota tek ata do të ishte më e pakët nga sa ata e shkelin me këmbët e tyre, për faktin se do të kishin gëzuar mirësinë e madhe të njohjes së All'llahut të Lartësuar, do të kishin shijuar vetëm atë që shijohet në kopshtet e Xhenneteve së bashku me miqtë e All'llahut. Njohja e All'llahut të*

*Lartësuar është humanizëm nga çdo lloj barbarie, është shoqëruese në çdo vetmi, është dritë në çdo errësi, është fuqi në çdo dobësim dhe është shërim nga çdo sëmundje.*

*Para jush ka pasur njerëz që janë vrarë, janë djegur në zjarr, janë sharruar me sharrë dhe, nga torturat, atyre toka, që është kaq e gjerë, u ishte bërë tepër e ngushtë. Megjithatë asgjë nuk i sprapsi ata në atë që kishin. S'kishte torturë e fyerje që t'i bënte ata të hiqnin dorë nga ajo që kishin, megjithëse nuk po hakmerreshin kundër atyre për ndonjë gjë tjetër, përveç faktit se ata kishin besuar All'llahun, Madhështorin, të Lavdëruarin. Prandaj kërkoni gradat e tyre, bëni durim ndaj goditjeve të kohës suaj, që të arrini mundin e tyre.”<sup>1</sup>*

*Imam Sadiku e përshkruan njohjen e All'llahut si një person që e ka shijuar atë. Sa ushqim i shijshëm do të ishte kjo për njerëzit! Por ne, që jemi kaq të shkujdesur, nuk e njohim këtë lloj kënaqësie; por ne dimë e mësojmë se kush orientohet në njohjen e All'llahut të Lartësuar dhe i afrohet qoftë edhe një pëllëmbë rrethimit të shenjtërisë, është larguar një milje nga kënaqësitë e kësaj jete. Sa më shumë të zhvishet nga zbukurimet e kësaj, aq më shumë do të jetë i përkorë, si dhe në njohjen e Atij, ekzistenca e të cilit është domosdoshmëri.*

### *Frika dhe shpresa*

*All'llahu i Lartësuar ka bashkuar madhështinë e dhembshurinë, zemërimin e kënaqësinë; gjerësinë e mëshirës së Tij e ka vënë mbi zemërimin e Tij; mbi shpërblimin e Tij të madh ka vënë dënimin e Tij të rëndë;*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 8, f. 207 dhe f. 347.

*për atë që është e gjerë mëshira e Tij, shpresa, me gjithpërfshirjen e saj, është afër edhe për kriminelin, për atë që është i ashpër, dënimi i Tij, frika nga zemërimi i Tij, është i sigurt, prandaj për besimtarin është domosdoshmëri që ai gjithmonë të jetë ndërmjet frikës e shpresës, sepse ai nuk mund të dijë se për cilën shkarje do të dënohet dhe kështu të shkruhet në regjistrin e kriminelëve. Gjithashtu, ai nuk e di se për ç'të mirë do të shpërblehet dhe kështu do të llogaritet ndër bamirësit.*

*Prandaj ai ka detyrë të përhershme të bëjë kujdes e të ruhet nga shkarjet, të ruajë e të shtojë sa më shumë të mirat. Mësimet e imam Sàdikut për frikën dhe shpresën janë nga mësimet më të rëndësishme, që shpjegojnë të vërtetën e frikës e të shpresës, mënyrën se si ato bashkohen dhe domosdoshmërinë që të jenë së bashku te besimtari. Gjithashtu, shpjegohet edhe efekti i mungesës së tyre, shtu këtu edhe elementë të tjerë të ngjashëm. Për këtë fakt ai thotë: “Kije frikë All’llahun sikur ti e sheh Atë, edhe pse nuk e sheh Atë, Ai të shikon ty. Nëse ti beson se Ai nuk të sheh ty, të jesh i sigurt që ke mohuar; nëse ti e di se Ai të sheh ty dhe pastaj ti nxiton ta kundërshtosh Atë, atëherë e ke bërë Atë prej më poshtëruesve që të shikojnë ty.”<sup>1</sup>*

*Unë them: ‘Përsa i përket mohimit, që ai i shikon njerëzit, do të thotë mohim i diturisë së Tij për qeniet, por kjo i çon krijesat e Tij në mohimin e ekzistencës së Tij.’*

*Kurse shprehja, që ai të jetë prej më poshtëruesve që të shikojnë ty, është fare e qartë, sepse, kur njeriu e ndien*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Frika dhe shpresa”, vëll. 2, f. 2 dhe f.67.

*se dikush me autoritet, me fuqi e me forcë dhe që mbikëqyr punën e tij, është i zemëruar me të, patjetër që i ka të gjitha mundësitë ta asgjësojë atë. Prandaj nuk ka rrugë tjetër veç heqjes dorë nga kundërshtimi i tij, qoftë nga turpi, qoftë nga kujdesi për t'u ruajtur, qoftë edhe nga frika; sepse poshtërimi me shikimin prej Atij që di çdo gjë, është vetëm mbi atë që nuk ruhet e nuk ka frikë, ose mbi atë që është i shkujdesur ndaj arritjes së kënaqësisë së Tij, ose të qëndrojë sa më larg zemërimit të Tij, ose të arrijë shpërblimin e tij dhe të ketë frikë prej dënimit të Tij; kurse ai, që e kundërshton Atë, duke e ditur se i Larti e sheh atë, nuk ka dyshim se e ka bërë Atë më poshtëruetin e shikuesve.”*

*Kush ka njohur All'llahun, e ka frikë Atë, kush ka frikë All'llahun, është i ashpër, me veten në këtë botë.*

*Në të vërtetë, edhe frika e madhe prej All'llahut të Lartësuar është adhurim, sepse All'llahu i Lartësuar thotë: “...në të vërtetë All'llahun nga robët e Tij e kanë frikë vetëm dijetarët...” (Sure “Fâtir”, ajeti 28) I Larti thotë: “...mos kini frikë prej njerëzve, por frikësohuni vetëm prej Meje...” (Sure “El Mâide”, ajeti 44); përsëri i Larti thotë: “...dhe kush e ka frikë All'llahun, Ai bën për atë një rrugëdalje.” (Sure “Et Talâk”, ajeti 2)*

*Dashuria për ndershmërinë dhe kujtimi i All'llahut nuk mund të jenë në zemrën e të frikësuarit të tmerruar.”<sup>1</sup>*

*Për fjalën e All'llahut: “Dhe për atë që ka frikë daljen para Zotit të vet, ka dy Xhennete.”, imam Sadiku ka thënë (Sure “Er Rrahmân”, ajeti 46)*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Frika dhe shpresa”, vëll. 2, f. 7 dhe f. 68.

*Kush e di se All'llahu e sheh dhe e dëgjon ç'thotë, kush e di se All'llahu e di ç'punë të mirë ose të keqe bën ai, kjo atë e ndalon nga bërja e punës së keqe. Pikërisht ky është ai që i frikësohet daljes para Zotit të vet, prandaj ai e ndalon veten nga veprimi sipas dëshirave."*

*Imam Sadiku ka thënë: "Besimtari është mes frikës së një faji të kaluar, që nuk e di se ç'ka bërë All'llahu në të dhe jeta që i ka mbetur, si dhe midis frikës së të panjohurës, se ç'punë shkatërruese do të bëjë gjatë jetës që i ka mbetur. Prandaj ai gdhiet vetëm i frikësuar dhe atë nuk e përmirëson asgjë përveç frikës."*<sup>1</sup>

*Unë them: 'Përmirësimi i besimtarit gjithmonë është me frikë. Kur ai ka frikë, orientohet me çdo gjymtyrë e me çdo kockë të vogël të gjoksit për të sprapsur sendin prej të cilit ka frikë, kështu që ai largohet nga mëkati e kundërshtimi i All'llahut dhe pranon bindjen ndaj Tij.'*

*Imam Sadiku ka thënë: "Kush e ka frikë All'llahun, All'llahu bën që çdo send të ketë frikë prej tij, kurse ai, që nuk e ka frikë All'llahun, All'llahu bën që ai të ketë frikë prej çdo sendi."*<sup>2</sup>

*Besimtari duhet të ketë frikë All'llahun e Lartësuar si të jetë duke ndenjur përmbi zjarrin, por edhe të shpresojë, sikur të jetë prej banorëve të Xhennetit. All'llahu i Lartësuar është në kujtimin e robit të Tij. Nëse ai është*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Frika dhe shpresa", vëll. 2, 12 dhe f. 71.

<sup>2</sup> "Mexhâlis" të shejhut Et'tûsij, kuvendi i 2-të; "El Kâfij", kapitulli: "Frika dhe shpresa", vëll. 2, f. 3 dhe f. 68.

*mirë, atëherë është për mirë, nëse ai është për keq, atëherë është për keq.”<sup>1</sup>*

*Unë them: ‘Besimtari duhet të jetë ndërmjet frikës e shpresës, ashtu siç thotë i Larti: “...lusin Zotin e tyre nga frika e me shpresë...” (Sure “Es Sexhdeh”, ajeti 16)’*

*Vetëm frika mund të ngjallë stresin dhe prerjen e shpresës nga mëshira e All’llahut, por kjo e frenon robin nga puna e mirë; gjithashtu, vetëm shpresa, mund të bëjë që robi të ndihet i sigurt nga dënimi i All’llahut, që në fakt është shkarje në rrugën e humbjes dhe humbje e shpresës, të cilat e ndalojnë robin të kryejë adhurimin; kurse qëllimi me shprehjen “All’llahu është në kujtimin e robit të Tij.” nuk është larg kuptimit të thuhet se Ai është në përkujdesje të robit dhe e shpërblen atë sipas asaj që Ai është në mendjen e robit. Nuk është çështja se Ai nuk është në kujtimin e robit, por robi bën të atilla punë të këqija, nga të cilat All’llahu nuk është i kënaqur prej tij, në një kohë që robi kujton se në punën e tij ka mirësi, ashtu siç ishte njoftuar.*

*Paqja e shpëtimi qoftë mbi të!- ka thënë: “Besimtari nuk është besimtar, nëse ai nuk ka frikë e shpresë dhe ai nuk ka frikë e shpresë nëse nuk bën ato punë për të cilat ka frikë dhe shpreson.”<sup>2</sup>*

*Unë them: ‘Puna është ajo që e nxjerr sheshit frikën e shpresën. Prandaj, nëse ai nuk punon, gënjen në pretendimin për frikën e shpresën, prandaj ai ka detyrë të reflektojë mbi ndjenjën e kënaqësisë e të dhembjes. Nëse ai ka frikë për veten e vet, ose për ndonjë gjë të vlefshme*

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Frika dhe shpresa”, vëll. 2, f. 3 dhe f. 71.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Frika e shpresa”, vëll. 2, f. 11 dhe f. 71



*që ka, do të përpiqet të bëjë kujdes nga të gjitha anët, kurse ai, që shpreson, ndërmjetëson me bujari që të afrohet tek personi prej të cilit ka frikë.'*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi tël) ka thënë: "Kujtimi i mirë për All'llahun është që ti të shpresosh vetëm te All'llahu dhe të kesh frikë vetëm nga faji yt."<sup>1</sup>*

*Unë them: 'Është kështu, sepse shpresa te dikush tjetër e jo te All'llahu nuk është gjë tjetër veçse dyshim në fuqinë e në mëshirën e All'llahut për robët e Tij, ose është një hamendje se dikush tjetër përveç All'llahut ka fuqi që e bën të panevojshme frikën e shpresën prej Tij. Por kjo është keqkuptim për të Gjithëfuqishmin, Mëshirëplotin; kështu është edhe frika prej fajit ose frika prej vdekjes apo frika prej krijesave të tjera, sepse ai në të vërtetë nënkupton dyshim në fuqinë e All'llahut e në mëshirën e Tij.'*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi tël) është pyetur: "Si janë ata njerëz, që mëkatojnë dhe thonë: "Ne shpresojmë." dhe vazhdojnë kështu derisa u vjen vdekja?" Atëherë është përgjigjur: "Ata lëkunden në shpresat, ata gënjejnë dhe nuk shpresojnë."*

*Ai, që shpreson ndonjë gjë, e kërkon atë. Kush ka frikë prej ndonjë sendi, ikën me vrap prej atij sendi."<sup>2</sup>*

*Unë them: 'Shpresa nuk arrihet pa punë e pa kërkesë. Mund të ndodhë që të arrihet edhe rastësisht; gjithashtu, as prej frikësuesit nuk je i shpëtuar pa u larguar*

---

<sup>1</sup> "El kâfij", kapitulli: "Kujtimi i mirë për All'llahun", vëll. 2, f. 4 dhe f. 72.

<sup>2</sup> "El Kâfij", vëll. 2, f. 5 dhe f. 68.

*prej Tij, por ndodh që ai të largohet edhe rastësisht; gjithsesi, në të dyja rastet, si mund të mbështet i mençuri në rastësinë?!*

### *Ruajtja dhe devotshmëria*

*Nga shenjat e njohjes së të Lartësuarit dhe e frikës prej Tij është devotshmëria dhe ruajtja nga ndalimet e Tij, prandaj imam Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) bënte shumë kujdes, që të mos ngatërrohej në kundërvajtje. Kishte dëshirë të madhe, që në punët e fesë të përqendrohej me devotshmëri deri edhe në heqjen dorë nga gjërat e lejuara.*

*Ai një herë ka thënë: “Kijeni frikë All'llahun dhe ruajeni fenë tuaj me ruajtje të kujdesshme.”; një herë tjetër, pasi ishte shprehur që të përkushtohej në përkohshmërinë, thoshte: “Është detyrë të jeni shumë të ruajtur.”<sup>1</sup>; në një rast të tretë ai thoshte: “Detyrimi më i rëndë, që ka vënë All'llahu për krijesat e Veta, është përmendja e shumtë e Tij. Nuk dua të them për shprehjet: “Subhàne-ll'illàh”- “I Plotpushtetshëm është vetëm All'llahu, të Cilit nuk i mungon asgjë e nuk ka nevojë për asgjë”, “Là ilàhe il'le-all'illàh” – “Nuk ka zot tjetër përveç All'llahut” dhe “All'illàhu Ekber” – “All'llahu është më i madhi”, edhe pse përmendja me këto shprehje është prej Tij, unë dua të them përmendja e All'llhut për gjërat që Ai ka lejuar e ka ndaluar. Nëse ajo është bindje, ai punon me të dhe, nëse ajo është mëkat, ai e le atë.”<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Ruajtja”, vëll. 2, f. 3 dhe f. 76.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Largimi nga gjërat e ndaluara” vëll. 2, f. 4 dhe f. 77.

*Unë them: 'Është e vërtetë, qëndrimi i njeriut para detyrës dhe ndalimi kategorik është shumë i rëndë, sepse në të dyja rastet i duhet të vërë All'lahun para syve, pastaj të bëjë atë që duhet bërë dhe të mos pranojë të ndaluarën, sepse ruajtja kërkon që në këto qëndrime ai të dijë kur ruajtja nuk është imponuese përveç shpirtit dhe fesë.'*

*Një herë është pyetur, nga njerëz që dinë të vërtetën e ruajtjes, për njohjen e ruajtjes së kujdesshme dhe është përgjigjur: "Ai, që ruhet nga gjërat që All'lahu i Lartësuar i ka ndaluar në mënyrë të prerë."<sup>1</sup>*

*Ai është pyetur për fjalën e të Lartit: "Dhe Ne do t'u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t'i shndërrojmë në pluhur e hi."<sup>2</sup> (Sure "El Furkân", ajeti 23) dhe ka thënë: "Betohem në All'lah, nëse punët e tyre janë shumë më të bardha se rrobat e koptëve, por, kur atyre u vihet përpara një gjë e ndaluar, ata nuk e lënë atë."<sup>3</sup>*

*Një ditë Mufeddal ibn Umeri tha: "Sa e dobët është puna ime!" Imami i tha: "Pusho, kërkoj All'lahut faljen e mëkateve, sepse puna e pakët, kur është e shoqëruar me devotshmëri, është më e mirë se shumë punë pa devotshmëri."*

*Por Mufeddali e pyeti: "Si qenka shumë dhe pa devotshmëri?"*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Ruajtja", vëll. 2, f. 8 dhe f. 77.

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Largimi nga veprimet e ndaluara", vëll. 2, f. 5 dhe f. 81.

<sup>3</sup> El Xhë'fij El Kufij, është prej atyre që kanë marrë prej imam Sâdikut e imam Qâzimit (Paqja qoftë mbi të dy!) ka qenë nga veqilët e imam Sâdikut në Kufe. Ne do ta përmendim atë ndër transmetuesit e tij të besueshëm e të dëgjuar.

*Imami iu përgjigj: “Po, i ngjan atij burrit që jep ushqim, është i butë me fqinjët e vet, është i gatshëm të presë mysafirë të shumtë, por, kur para tij hapet porta e haramit, ai hyn në atë portë.”<sup>1</sup>*

*Kjo fjalë është e ngjashme me fjalën e Profetit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) kur tha: “Kush thotë “Là ilàhe il’le-ll’làh” – “Nuk ka zot tjetër përveç All’llahut”, për atë mbillet një pemë në Xhennet.», ndërkaq disa nga sahabët e nderuar i thanë: “Atëherë pemët tona në Xhennet qenkan shumë!”, por i Dërguari i All’llahut ka thënë: “Por, mos hidhni mbi to zjarr e t’i digjni.”*

### *Përkohshmëria*

*Përkohshmëri është largimi nga kjo botë me zemër e me gjymtyrë, dëshira e madhe për botën e ardhshme dhe për ato që janë tek All’llahu i Lartësuar. Përkohshmëria është njëra nga veprimet e nderuara të fesë dhe pozita më e lartë e arifinëve (atyre që njohin All’llahun, ashtu siç është detyrë të njihet Ai).*

*Është e vërtetë se njohësi i All’llahut nuk duhet të mobilizohet për interesat e kësaj bote, qoftë kur ato i dalin përpara, qoftë kur i ka nga mbrapa, sepse dalja e atyre përpara e shqetëson atë nga kontakti me ato fruta të njoma, ëmbëlsia e të cilave ndihet vetëm kur njeriu është i zhveshur nga të tilla shqetësime.*

*Për të gjitha këto, Sàdiku i Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) thotë: “Gjithë mirësinë Ai e ka bërë në një shtëpi dhe*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Bindja”, vëll. 2, f. 7 dhe f. 76.

*çelësin e mirësisë Ai e ka bërë në përkohshmërinë në këtë botë.”*

*Për ne ai transmeton prej orientuesit më të madh, gjyshit të vet, Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) fjalën e tij: “Burri nuk e gjen ëmbëlsinë e besimit, derisa të mos interesohet se cili e hëngri këtë botë.”*

*Pastaj, imam Sàdiku thotë: “Haram për zemrat tuaja, që ata të njohin ëmbëlsinë e besimit, derisa të jeni të përkohshëm në këtë botë.”*

*Një herë tjetër, duke nxitur përkohshmërinë, ka thënë: “Të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) nuk i ka pëlqyer gjë tjetër prej kësaj bote, veçse të ishte i uritur e i frikësuar.”*

*Një herë tjetër ai ka thënë: “Kur All'llahu do të mirën për robin e Vet, e bën atë të përkorë në këtë botë, e bën të ditur në ligjin e fesë dhe bën që ai të vështrojë në të metat e kësaj bote. Atij, që i janë dhënë këto, i është dhënë mirësia e kësaj bote dhe e botës së ardhshme.”*

*Unë them: ‘Është e vërtetë se gjithë mirësia qëndron në këto tri gjëra, sepse në to është qetësia, siguria dhe zgjuarsia. Kjo është mirësi në këtë botë, e cila shumë shpejt do të kalojë, është hapi për të kapur frutat e arrira në atë botë të pambarimtë, ashtu siç ka premtuar All'llahu.’*

*Gjithashtu, ai ka thënë: “Në këtë botë askush nuk ka kërkuar të vërtetën në ndonjë portë më të mirë se në përkohshmërinë, e cila është e kundërta e asaj që kërkojnë armiqtë e së vërtetës, të cilët kanë dëshirë të madhe për*

*këtë botë. Por---r kujdes, ajo është prej të Durueshmit të madh dhe Bujarit, por kjo botë është vetëm për pak ditë.”*

*Unë them: ‘Ajo, që hyn mes njeriut e së vërtetës, është dashuria për këtë botë dhe dëshira e madhe për të. Dëshira për botën qëndron te pasuria e shumtë, e cila e ndalon njeriun të kryejë detyrimet që ka, ndërsa dashuria për pozitë e autoritet e ndalon njeriun, e bllokton që ai të flasë të vërtetën; kurse prirja për qetësi i vë pritë që ai të mos kryejë obligimet. Në këtë gjendje burri nuk e përballon të thotë të vërtetën, ose të punojë me të vërtetën, ose të kumtojë të vërtetën, nëse ai nuk i largohet këtyre shpresave shpirtërore. Largimi nga këto dëshira ka nevojë për durim e shpirt bujar. Pastaj Sàdiku foli me hollësi për mirësitë që kanë krerët e të durueshmëve dhe bujarëve dhe tregoi se durimi e bujaria nuk duhet të jenë të dashura tek njerëzit, kur atyre u tërhiqet vëmendja dhe u thuhet se qëndrimi në këtë botë është vetëm për pak ditë. Kur njeriu njeh se gjendja e shtrënguar nuk vazhdon, ai e mendon veten bujar e të durueshëm për të tilla gjëra të urryera.*

*Pastaj imam Sadiku nxiste dëshirën për përkohshmëri në rrugën që i sillte dobi më shpejt, për rrugën më të shpejtë për tek sendi, pasi njeriu gjithmonë dëshiron që puna e tij të ketë një rezultat të shpejtë. Kush është i përkorë në këtë botë, All’llahu ka ngulur urtësinë në zemrën e tij, me atë ia ka bërë gjuhën të zhdërvjellët, ka bërë që të vështrojë mangësitë e kësaj bote, të shikojë*

*sëmundjen dhe ilaçin e saj dhe atë All'llahu e çon shëndoshë e mirë për në shtëpinë e paqes.”<sup>1</sup>*

*Po, është detyrë të njohim përkohshmërinë dhe të vërtetën e saj, që të mos biem në veshje të kota e boshe. Disa të ditur prej shokëve të tij e kanë pyetur për kufirin e përkohshmërisë në këtë botë.*

*Paqja e shpëtimi qoftë mbi të! - ka thënë: “Atë e ka kufizuar vetë All'llahu në Librin e Vet me fjalën e Tij të nderuar: “Këtë paracaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë” (Sure “El Hadid”, ajeti 23)*

*Më i dituri i njerëzve është ai që ka më shumë frikë All'llahun dhe ai që e ka më shumë frikë Atë, është më i dituri i njerëzve dhe më i dituri i njerëzve, është më i përkori i tyre në këtë botë.”<sup>2</sup>*

*‘Unë them: “Përkufizimi, që ai i bën përkohshmërisë, sipas ajetit të nderuar, na bën të kuptojmë se përkohshmëria në këtë botë, nuk qëndron në disa koncepte, që propagandojnë jetën e rëndë e veshje të ashpra, edhe pse këto disa herë mund të jenë gjurmë të përkohshmërisë. Në të vërtetë, përkohshmëria qëndron më lart se kaq.’*

*Kur njeriu i largohet kësaj bote, ai nuk dëshpërohet për ato që humb, por as nuk gëzohet për ato që mund t'i vijnë. Nëse ai do të priste me kënaqësi të ardhurat, ai do të*

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Ulja e kësaj bote dhe përkohshmëria në të”, vëll. 2, f. 1 dhe f. 128.

<sup>2</sup> “Bihârul Anuâr”, f. 7, f. 78 dhe f. 193.

*hidhërohej për të humburën e do të gëzohej për të ardhurën, prandaj zbuluesi më i mirë i përkohshmërisë në këtë botë është pikërisht ky hidhërim e ky gëzim.*

*Nëse përkohshmëria do të ishte largim i plotë nga mirësitë e kësaj gjithësie dhe nga kënaqësitë që janë në të, ashtu siç veprojnë sufitetë, në një kohë që All'llahu të gjitha gjërat e mira i ka krijuar për robtë. Mos vallë mendon se Ai, që u ka dhënë atyre gjërat e mira, është bujar dhe nga ana tjetër nuk i vjen mirë që ata i kanë arritur këto të mira vetëm prej Tij? Atëherë lind pyetja: “Për cilin i ka krijuar Ai këto furnizime të mira?”*

*Përsëri i Larti na njofton: “Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.” (Sure “El A’râf”, ajeti 32)*

*Imam Sadiku na e zbulon gjerësinë e kësaj me fjalën e tij: “Kjo botë vjen me të mirat e saj dhe atë e vërtetojnë banorët e saj, të mirët dhe jo të këqijtë, besimtarët dhe jo hipokritët, myslimanët dhe jo mohuesit e saj.”*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) e tha këtë fjalë kur i treguan një rrobë të bardhë dhe e qortuan për këtë pamje, duke e marrë si dëshirë për këtë botë, në një kohë që simboli i prindërve të tij ishte përkohshmëria.*

*Prej robit synohet, që interesimi i tij të jetë në atë që është më e lartë, në atë që është më e qëndrueshme e më dobishme.*



*All'illahu i Lartësuar ka urdhëruar obligimet, ka përcaktuar edhe penaltitetet dhe robët nuk kanë pyetur se çfarë ka pas kësaj. Imam Sàdiku na orienton në këtë të vërtetë: "Njeriu më i ruajtur është ai që ndalon në gjërat e dyshimta; njeriu më adhures është ai që kryen obligimet e urdhëruara; njeriu më i përkorë është ai që heq dorë nga harami dhe njeriu, që përpiket më shumë, është ai që nuk mëkaton."<sup>1</sup>*

### *Kjo botë*

*Kjo botë për njeriun nuk është vetëm vetja e tij e instinktvet, dëshirat, mendimet e besimet. Çdo gjë tjetër jashtë vetes së tij është e huaj për të. Njeriu lidhet me këtë botë në atë masë që ajo ka lidhje me mendimet, me idetë e me plotësimin e dëshirave të tij, si dhe me realizimin e çdo gjëje në të cilën e shtyjnë instinktvet.*

*Kur të gjitha dëshirat e tij të jenë të plotësuara, ai ka arritur gjithçka nga mirësitë që ka në botën e tij, ndryshe ai është i privuar prej saj në atë masë, që disa nga dëshirat e tij mbeten të uritura ose të ndrydhura.*

*Por njeriu e ka të pamundur të plotësojë të gjitha dëshirat e tij. Le të marrin si shembull dëshirën për të qenë i parë e për sundim, e cila është nga dëshirat më të fuqishme e më të forta. Sado pushtet të arrijë njeriu dhe, sado të zgjasë pushteti i tij, do të ketë edhe fusha të tjera, që nuk i përfshin pushteti, pasi ato ose janë aq të dendura, sa rëndojnë mbi atë, ose janë aq shtrënguese, sa e rrethojnë atë, ose janë forca kryengritëse, që dalin kundër tij; atëherë dëshira e pushtetit në këtë gjendje kurrë nuk është e ngopur, sado të përpiket ai ta ngopë atë, sepse ajo, sa më shumë të ushqehet, aq më shumë forcohet e ashpërsohet, por kurrë nuk e arrin cakun e ngopjes. Shembull i ngjashëm me këtë është edhe dashuria për të*

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", f. f. f. 87 dhe f. 192.

*pasur sa më shumë pasuri e prona. Njeriu mund të mbledhë pasuri të shumta, por vetë pasuritë, nga natyra e tyre, nuk mund të jenë të gjitha në dorën e një njeriu të vetëm, pavarësisht nga dëshira e nga kujdesi i tij për të grumbulluar sa më shumë pasuri.*

*Duhet shtuar se plotësimi i dëshirës për sundim e për të zotëruar pasuri, detyrimisht realizohet në kurriz të shumë dëshirave të tjera, siç është dëshira për qetësi, stabilitet dhe siguri, sepse ruajtja e sundimit dhe e zotërimit të pasurive, ose edhe zgjerimi i pushtetit e shtimi i pasurive kërkon sprapsjen e konkurrentëve e të kryengritësve. Sa më shumë të shtojë njeriu pushtetin e pasurinë, aq më shumë shtohen konkurruesit, për pasojë shtohet edhe privimi i tij nga plotësimi i shumë dëshirave. Gjithashtu, sa më shumë të zhytet njeriu në plotësimin e dëshirave dhe sa më shumë kujdes të tregojë ai për këtë botë, aq më furishëm do të vërshojnë dëshirat e tij, për pasojë, pjesa më e madhe e dëshirave të tij nuk do të jenë të plotësuara, do ta mundojnë atë dhe do t'i shkaktojnë dhembje. Jetesa e tij do të bëhet e ngushtuar, do të humbë qetësinë dhe do të vazhdojë në këtë rrugë derisa të vdesë.*

*Nuk ka si të paraqitet më bukur kjo anë e jetës së njeriut nga sa është përshkruar me fjalët e imamit tonë (Paqja qoftë mbi të!): “Shembulli i kësaj bote është si shembulli i ujit të detit. Sa më shumë të pijë i eturi nga ky ujë, aq më shumë do t'i shtohet etja, derisa uji do ta vrasë atë.”<sup>1</sup>*

*Imam Sadiku ka thënë: “Shembulli i atij, që bën kujdes për këtë botë, është si shembulli i krimbit të mëndafshit, sa më shumë fije të pështjellë ai rreth vetes, aq*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Mangësitë e kësaj bote dhe përkohshmëria në të”, vëll. 2, f. 24 dhe f. 136.

*më larg është dalja, derisa ngordh brenda pështjelljes që thuri.”<sup>1</sup>*

*Në lidhje me paralajmërimin për t’u ruajtur prej kësaj bote imam Sadiku ka thënë: “Shembulli i kësaj bote është si shembulli i gjarprit, i cili në prekje është i butë dhe në brendësi ka helmin vrasës. Atij i ruhet burri i mençur dhe sipër tij nxitojnë të rinjtë ta kapin me duart e tyre.”<sup>2</sup>*

*Unë them: ‘Burri i mençur është njeriu me përvojë, i cili e ka provuar këtë botë dhe e di se ajo fsheh shumë dhembje, sëmundje e pësime, kurse i riu pa përvojë, është si puna e fëmijës, që shikon ëmbëlsinë e saj dhe nuk ndien se ajo është e hidhur, prandaj mashtrohet prej saj, ashtu siç mashtrohet nga butësia kur prek gjarprin, edhe pse në brendësi ai ka helmin.’*

*Imami (Paqja qoftë mbi të!) si dhe të gjithë njerëzit e mirë tërheqin vëmendjen e paralajmërojnë nga mashtrimi i kësaj bote, sepse mashtrimi i saj shkakton te njeriu kapërcimin e caktuar, mendjemadhësinë, harresën e botës së ardhshme. Për pasojë, në të gjitha rastet, që i ofron jeta e kësaj bote, ai harron e lë pas dore punët që ka detyrë të kryejë për botën e ardhshme. Nëse ti dëshiron t’i largohesh mashtrimit, duke e njohur këtë botë, vështro me kujdes fjalët me të cilat ajo përshkruhet: “Kjo botë, edhe pse ti kënaqesh me gëzimet e saj, të mashtron me bukuritë e veta. Në të vërtetë, kjo botë i ngjan pranverës së vonuar, e*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Dashuria për këtë botë dhe kujdesi ndaj saj”, vëll. 2, f. 7 dhe f. 316.

<sup>2</sup> Libri “Ez Zuhdu” i të besueshmit të nderuar Husejn ibn Sejjd ibn Ham’mâd ibn Mehrân El Ehuâzj, kapitulli: “Ç’është thënë për këtë botë dhe për atë që e kërkon atë”, f. 45 dhe f. 121

*cila të mahnit me blerimin e saj dhe thahet kur i mbaron koha. Ai, që e këshillon veten dhe di detyrat e të drejtat e veta, e shikon këtë botë me mendjen që ka prej Zotit të Lartësuar dhe ruhet nga e keqja e përmbysjeve që Ai sjell. Kjo botë ka mashtruar njerëz, të cilët janë ndarë prej saj më shpejt nga sa kanë qenë tek ajo. Megjithëse e kanë dëshiruar atë kaq shumë, atyre u ka trokitur mbarimi i jetës natën kur ishin në gjumë ose ditën kur ishin duke luajtur. Si dolën ata prej saj? Ku arritën pas saj? Atyre nga pas i shkuan sëmundjet e pendimi u mbeti trashëgim.*

*Kjo botë u ka dhënë atyre të gëlltisin pijen e hidhur dhe u ngeci në fyt kupën e ndarjes. Oh sa mjerim për atë që është i kënaqur me këtë botë, ose që e ka dashur atë si dritën e syrit! A nuk e ka parë vdekjen e prindërve të tij dhe të atyre që kaluan prej miqve e armiqve të tij? Sa gjatë ka mbetur i hutuar, sa keq kur është kthyer në të, sa ka humbur kur ka kontaktuar me të! Sa i madh ka qenë pikëllimi i tij, kur ka parë se i është afruar vdekja dhe i janë prerë të gjitha shpresat e dëshirat! Kujtonte se jeta e tij nuk do të kishte fund kurrë, që ai do të arrinte plotësimin e të gjitha dëshirave e shpresave. Atë e shkurtoi vetëm pleqëria, fundi i saj qe vetëm rëndim e poshtërim. I kërkojmë All'llahut për ne e për ty punë të mirë në bindje ndaj Tij dhe vendstrehim në mëshirën e Tij, largim prej kundërshtimit të Tij, ndërgjegjësim në detyrimet që kemi ndaj Tij, sepse kjo është vetëm për Atë.”*

*Mendo në fjalën e tij për cilësimin e kësaj bote dhe cilësimin e atyre që janë dhënë pas saj: “Sa kërkues të dynjasë nuk e kanë arritur atë!”*

*Ka nga ata që janë ndarë nga kjo botë pa e arritur atë. Prandaj puna jote të mos jetë e shumtë në kërkim të saj. Merr nga kjo botë prej Dhënësit e Zotëruesit të saj. Shumë prej njerëzve janë kujdesur shumë për këtë botë, kurse ajo nuk kujdeset fare për ta, madje ajo i ka shtrirë të vdekur. Individit është munduar që të arrijë sa më shumë prej saj dhe ka lënë kërkimin e botës së ardhshme, derisa i është sosur jeta dhe së fundi i ka ardhur ora e vdekjes.*

*Sa e vërtetë është fjala e tij në analizën e kësaj bote dhe në radhën e ardhjes së njerëzve në të: “Ç’është kjo botë e ç’mund të jetë? A nuk është kjo botë një gjellë, që ti e hëngre, ose një rrobë, që ti e veshe, ose një mjet, që ti hipe në të? Besimtarët nuk janë të sigurt në këtë botë, nuk janë të sigurt as për ardhjen e botës tjetër. Kjo botë është shtëpia që zhduket, kurse bota e ardhshme është shtëpia e përhershme, banorët e kësaj bote janë të shkujdesur. Të devotshmit në këtë botë janë ata që kanë më pak siguri dhe që ndihmojnë më shumë. Nëse ti harron, ata të kujtojnë. Kur të kujtojnë, të mësojnë. Llogarite këtë botë si një shtëpi ku ke banuar dhe je larguar prej saj, ose si një pasuri, që e ke arritur në gjumë dhe kur je zgjuar, në dorën tënde nuk kishte asgjë prej asaj pasurie.”<sup>1</sup>*

*Dëgjo me vëmendje fjalën e tij (Paqja qoftë mbi të!): “Kjo botë mbi mua ka zbritur ashtu siç zbret një i vdekur. Kur jam detyruar, kam ngrënë prej saj. All’llahu i Lartësuar e di se ç’janë njerëzit punëtorë dhe për ku shkojnë ata. Ai ka qenë i butë ndaj tyre, për punët e tyre të këqija, sepse Ai e ka ditur që përpara se çdo të bënin ata, prandaj ti mos*

---

<sup>1</sup> “Tuhuful Ukùl” e dijetarit të shquar në fushën e jurisprudencës së ligjit të fesë Hasan ibn Ali ibn Husejn ibn Shu’beh El Harànij El Halebij, f. 208.

*u mashtro nga kërkesa e bukur e atij që nuk ka frikë se po i kalon koha.” Pastaj ai lexoi fjalën e të Lartit: “Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhështi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat.” (Sure “El Kasas”, ajeti 83)*

*Ai filloi të qajë dhe tha: “Betohem në All’llah, me këtë ajet shkuan edhe shpresat.” Pastaj tha: “Betohem në All’llah, fituan të mirët, të cilët nuk mendojnë as milingonën. Atyre u mjafton dituria, që kanë për frikën ndaj All’llahut, por edhe për mendjemadhësinë është e mjaftueshme injoranca.”<sup>1</sup>*

*Unë them: ‘Me fjalën e tij: “Betohem në All’llah, me këtë ajet shkuan edhe shpresat.”, ai ka pasur qëllim shpresat e atyre që kanë bërë punë të këqija. Ata kishin butësinë e All’llahut dhe kujtonin se janë të shpëtuar prej dënimit të Tij në botën e ardhshme, por ajeti tregon qartë se bota e ardhshme është vetëm për ata që nuk kanë qëllim mendjemadhësinë e ngatërresat, prandaj askush nuk ka pjesë në atë përveç këtyre që u thanë. Atëherë të tjerët, përveç tyre, nuk kanë pjesë në Xhennet. Ku janë shpresat e atyre, që shpresonin, kur nuk janë më prej banorëve të tij? Ajeti i ka prerë shpresat e shpirtrave të tyre.’*

*Tek ai u ankua një burrë për diçka dhe i tha: “Duro dhe All’llahu do të të japë ty një rrugëdalje.” Heshti për një farë kohe, u kthye kah ai dhe tha: “Më fol për burgun e Kufes, si ishte ai?”*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, f. 7, f. 78 dhe f. 193.

*Burri tha: “All’llahu e përmirësoftë! Ai ishte i ngushtë, binte erë të rëndë. Të burgosurit ishin në gjendje shumë të keqe.”*

*Atëherë imam Sadiku (Paqja qoftë mbi tël) tha: “Ti në burg dëshiroje të kishe gjerësi. Po a nuk e di ti se kjo botë është burgu i besimtarit?”*

*Mendo pak në fjalën e imam Sádikut: “Ai që gdhiet e ngriset, duke pasur si shqetësim këtë botë, All’llahu e bën të varfër zemrën e tij, punën e tij e copëzon dhe ai arrin nga kjo botë vetëm aq sa është pjesëtuar për të; por, kur ai gdhiet e ngriset duke pasur si shqetësim botën e ardhshme, All’llahu e pasuron zemrën e tij dhe e bashkon punën e tij.”<sup>1</sup>*

*Unë them: ‘Ai, që shqetësohet më shumë për këtë botë, dëshirat i rëndojnë gjithnjë e më shumë dhe kurrë nuk ka mundësi t’i ngopë ato. Prandaj ai gjithmonë është nevojtar dhe varfëria vazhdimisht i rri para syve, interesimi i tij është i shpërndarë nëpër të gjitha punët e kësaj bote. Për pasojë është e shpërndarë edhe puna e tij, megjithëkëtë ai nuk arrin nga kjo botë, kaq e gjerë dhe e pasur, asgjë më shumë përveç asaj që është pjesëtuar për të. All’llahu i jep kënaqësi zemrës së atij që interesohet për botën e ardhshme. Kush ka kënaqësinë e zemrës, është i pasur, për pasojë, interesimi i tij nuk është i shpërndarë nëpër anët e ndryshme të jetës, puna e tij është e mbledhur dhe ai ka qetësi në mendimin e tij.’*

*Imami sjell për ty shembullin e humbjes së kërkuesve të kësaj bote të zhdukshme kur thotë: “Ai, që i përzien*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Dashuria për këtë botë dhe kujdesi ndaj saj”, vëll. 2, f. 15 dhe f. 319.

*shumë punët në këtë botë, do të ndiejë humbje të rëndë, kur të ndahet prej saj.”<sup>1</sup>*

*Sa bukur i ka krahasuar ata që i janë kthyer kësaj bote: “Zemra e atij që është e varur nga kjo botë vuan nga tre cilësi: një brengë, që nuk hiqet, një shpresë, që nuk arrihet dhe një shpresë e paarritshme.”<sup>2</sup>*

*Unë them: ‘Fjalët e tij kanë dhënë një model për këtë botë dhe për të mashtruarit prej saj. E ka thënë këtë fjalë për të shkujdesurit dhe për t’i paralajmëruar ata prej zbukurimeve të saj mashtruese.’*

### *Hipokrizia*

*Hipokrizia është kërkesa e një pozite në zemrat e njerëzve me cilësitë e së mirës ose me diçka që tregon gjurmë të së mirës: me veshje, me paraqitje, me lëvizje, me heshtje, etj.*

*Hipokrizia është nga mëkatet e rënda shkatërruese. Ajetet e Kur’anit dhe hadithet e Profetit flasin prerë për të keqen e këtij vesi. Prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) janë transmetuar shumë hadithe për të keqen e hipokrizisë dhe mangësinë e hipokritit. Në një rast ai ka thënë: “Çdo hipokrizi është shirk<sup>3</sup> (vënie shok e ortak All’llyhut në adhurim). Kush punon për njerëzit, ka për detyrë*

---

<sup>1</sup> Burimi i mësipërm, vëll. 2, f. 16 dhe f. 320.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, vëll. 2, f. 17 dhe f. 320.

<sup>3</sup> Në këtë rast, me adhurimin e All’llyhut synohet afrimi tek njerëzit. Ky synim është që afrimi të jetë vetëm tek ai që ka autoritet, fuqi, prej të cilit vjen dobia e dëmi dhe nuk synohet afrimi tek All’llyhu i Lartësuar, por ky është vetë shirk.



*shpërblimin e tij dhe kush punon për All'llahun, Ai është garantues për shpërblimin e tij.*"<sup>1</sup>

*Një herë tjetër, për fjalën e të Lartit: "Thuaj: "Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!" (Sure "El Kehf", ajeti 110), ai ka thënë: "Njeriu bën një punë që ka shpërblim, por me atë punë ai nuk ka qëllim bindjen ndaj All'llahut, por do që të dalë i pastër para njerëzve dhe dëshiron që njerëzit të dëgjojnë për punën e tij. Pikërisht me këtë qëllim ky i ka vënë shok e ortak në adhurim Zotit të vet. Nuk ka ndonjë rob, që e mban të fshehtë të mirën dhe ditët kalojnë derisa All'llahu për atë të zbulojë të mirën. Nuk ka ndonjë rob që mban të fshehur të keqen dhe ditët kalojnë derisa All'llahu për atë të zbulojë të keqen."*<sup>2</sup>

*Ajo që bën ndonjëri prej jush, duke nxjerrë në shesh një të mirë e duke mbuluar një të keqe, a nuk kthehet në vetvete dhe të mësojë se nuk është kështu? All'llahu i Lartësuar thotë: "Po, njeriu është dëshmitar i vetvetes." (Sure "El Kijàmeh", ajeti 14); sepse ndërgjegjja, kur është e shëndetshme, përforcon atë që është sheshit."*<sup>3</sup>

*Unë them: 'Sa fjalë e lartë! Hipokriti i kthehet vetes dhe e di se ka nxjerrë në shesh të kundërtën e asaj që ka në zemër, pasi kjo duket në punët e tij. Ai, me kthimin në*

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Hipokrizia", vëll. 2, f. 3 dhe f. 293.

<sup>2</sup> "El Kâfij", vëll. 2, f. 12 dhe f. 295.

<sup>3</sup> "El Kâfij", vëll. 2, f. 11 dhe f. 295.

*vetvete, e ndien këtë dobësi e këtë mashtrim, prandaj dobësia në punën e tij duket, për pasojë ai tronditet.*

*Përsa i përket atij, tek i cili përputhet e fshehta dhe e dukshmja në punët e mira, ai është i fuqishëm në punën e tij, sepse ka siguri në vetvete dhe e ndien fuqinë në veten e tij. Ndenja e fuqisë është zotëruese mbi fjalët e njeriut e mbi punët e tij.”*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) gjithashtu, ka thënë: “Kush ka qëllim All’llahun, All’llahu nxjerr në shesh më shumë nga sa ai ka pasur qëllim dhe, kush ka qëllim njerëzit, ai ka lodhje trupore, nuk e merr gjumi natën dhe All’llahu shfaq vendosmërinë e Tij, që punën e tij ta zvogëlojë në sytë e në veshët e njerëzve.*

*Njeriu nuk mund të punojë e të kërkojë ndjesë në kundërshtim me atë çka di All’llahu prej tij. I Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) thoshte: “Kush mban të fshehtë një sekret, atë All’llahu ia vesh atij për rrobë të sipërme. Nëse është për mirë, atëherë është mirë, nëse është për keq, atëherë është keq.*

*Bëj shumë kujdes prej hipokrizisë, sepse punon për dikë tjetër e jo për hir të All’llahut dhe All’llahu e lë atë në dorën e atij për të cilin ai kreu punën.”<sup>1</sup>*

*Unë them: ‘Këto ishin disa pjesëza prej fjalës së tij për hipokrizinë. Në këto pjesëza ai ka shpjeguar të keqen e këtij qëllimi dështak, si dhe humbjen e atij, që, me hipokrizinë, kërkon të fitojë kënaqësinë e njerëzve. Atë*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, vëll. 2, f. 1 dhe f. 293

*vetë koha e diskrediton, prandaj puna, që ai bën, nuk e pastron atë dhe ai nuk arrin të ketë ato për të cilat punoi me hipokrizi.'*

### *Padrejtësia*

*E keqja e padrejtësisë është në kuptimin e mizorisë e të sulmit mbi tjetrin. Ky është kuptimi më i përhapur, për të cilin përputhen mendimet e njerëzve të mençur dhe për të cilin janë në pajtim të gjitha mendjet. Padrejtësia është nga veprimet më të qarta, për të cilat asnjë njeri nuk ka dyshim, prandaj All'llahu i Lartësuar, kur ka dashur të tregojë sa i ulët është shirku (idhujtaria) dhe sa veprim i keq është ai, e ka cilësuar me fjalën padrejtësi: "...shirku (idhujtaria) është padrejtësia më e madhe." (Sure "Lukmàn", ajeti 13)*

*Shumë ajete të Kur'ânit Famëlartë dhe shumë hadithe flasin për poshtërsinë e padrejtësisë dhe për ndalimin e saj. Nga hadithet do të sjellim ato që janë thënë prej imamit tonë, Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!).*

*Padrejtësia ndryshon nga shumë në pak, nga e ashpër në të dobët, ashtu siç e tregon ajeti i Kur'ânit, prandaj imam Sâdiku thotë: "Nuk ka padrejtësi më të ashpër se ajo që i është marrë njeriut përdhunisht dhe ai nuk ka ndihmë tjetër përveç All'llahut."<sup>1</sup>*

*Unë them: "Tregues për këtë është i dobëti, i cili është i pafuqishëm të vërë një mesatare për veten e tij, prandaj ndihmësi i tij është All'llahu, i Cili do ta marrë të drejtën që atij i është marrë përdhunisht. Por si do të ishte gjendja e atij njeriu, kur armiku i tij e ai që hyn ndërmjet tij*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", vëll. 2, f. 4 dhe f. 331.

është All'illahu?' Ky njeri është i ngjashëm me atë që transmetohet prej imam Zejnel Àbidinit (Paqja qoftë mbi të!) kur thotë: "Ruhu shumë, të mos i bësh padrejtësi atij që nuk gjen kundër teje ndihmës tjetër përveç All'illahut."<sup>1</sup>

Mos mendoni se i padrejtë është vetëm ai që ushtron drejtpërdrejt padrejtësinë. Ebù Abdil'lahi, imam Sadiku ka thënë: "Ai që bën padrejtësi, ndihmësi i tij dhe ai që e miraton padrejtësinë, të tre, janë pjesëmarrës në padrejtësi."<sup>2</sup>

Madje mbi këta të tre ai ka shtuar me fjalën e tij: "Edhe ai, që justifikon të padrejtin për padrejtësinë që bën, All'illahu do ta vërë atë nën sundimin e një tjetri, që do t'i bëjë atij padrejtësi. Nëse ai do të kërkojë ndihmë, thirrja e tij për ndihmë nuk do të gjejë përgjigje dhe All'illahu atë nuk do ta shpërblejë për padrejtësinë që i është bërë."

Kaq e rëndë është e keqja e padrejtësisë, sa ai, që bën nijet të mos kryejë padrejtësi, ka shpërblim. Imam Sàdiku thotë: "Kush gdhihet dhe bën nijet të mos kryejë ndonjë padrejtësi, All'illahu i fal atij fajet që ai do të bëjë atë ditë, kur ai nuk vret njeri dhe nuk ha haram pasurinë e jetimit."

Tek ai hynë dy vetë, që kishin pasur një bashkëpunim, por ishin grindur. Ai nuk dëgjoi asnjë fjalë prej të dyve. Por imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) thotë: "Askush nuk e ka fituar të mirën që e ka marrë me padrejtësi, sepse atij që i është bërë padrejtësia, merr nga

<sup>1</sup> "El Kâfij", vëll. 2, f. 5 dhe f. 331.

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli "Padrejtësia", vëll. 2, f. 16 dhe f. 333.

*borxhi i ushtruesit të padrejtësisë më shumë nga sa ka marrë ai nga pasuria e personit që i bëri padrejtësi. Ai që u bën keq njerëzve, nuk ka përse t'i vijë rëndë kur edhe atij i bëjnë keq. Në të vërtetë njeriu korr atë që mbjell. Askush nuk ka korrur prej të hidhurës të ëmblën dhe as prej të ëmblës të hidhurën.” Ndërkaq të dy burrat, pa u ngritur mirë më këmbë, u pajtuan.*

*Unë them: ‘Sa këshillë e goditur dhe sa shembull i drejtë! Por shpirtërat janë gatuar në të keqen, në dëshirën për të sulmuar e për të mposhtur, prandaj janë të verbër për të parë shembuj të tillë. Ndryshe si do të shpresojë ndonjë që të korrë të ëmblën prej të hidhurës dhe të mirën prej të keqes, kur ai vetë nuk e shpërblen të keqen me të mirë dhe padrejtësinë me zemërgjerësi? Si mund të shpresojë të shpërblejë vetveten me atë që ai nuk e ka bërë për njerëzit?’*

*Një ditë kek imami hyri Zijâd El Kindij<sup>1</sup> dhe imami i tha: “O Zijâd, u bërë vali mbi ta?”*

*Ai tha: “Po, o nipi i të Dërguarit të All’llahut unë kam burrëri, nuk po lë pasuri, por unë e zbus çështjen e vëllezërve të mi tek mbreti.*

*Atëherë imam Sàdiku thotë: “O Zijâd, nëse ti e bën këtë, në qoftë se vetja të thërret, që t’i bësh padrejtësi*

---

<sup>1</sup>I bn Mervân El Kindij El Enbàrij ka jetuar deri në ditët e imam Rizàsë (Paqja qoftë mbi të!). Ka shkuar në vakuf dhe ka qenë veqil i imam Qazimit (Paqja qoftë mbi të!). Atij i mbetën pasuri të shumta për shkak të arrestimit të imam Qàzimit dhe imam Rizàit ia kërkoi atij pas babait të vet, ashtu siç kishte kërkuar Ali ibn Ebij Hamza dhe Ali ibn Isà, të cilët janë shprehur për vakufin nga kujdesi për ruajtjen e pasurisë. Zijâdi është prej atyre që kanë transmetuar tekste prej imam Rizàsë dhe është i besueshëm në transmetim.

*njerëzve dhe ti e ke këtë fuqi, kujto se edhe All'llahu i Lartësuar ka fuqi të të dënojë ty, të largojë atë që ti ke sjellë për ta, por edhe të të bëjë të qëndrueshëm.<sup>1</sup> Ajo, që ti ke në shpirtin tënd, është kundër teje.”<sup>2</sup>*

*Unë them: ‘Shtetari i parë (valiu) është i ekspozuar për padrejtësi, por All'llahu i Lartësuar është i Fuqishmi, që ka mundësi të dënojë ushtruesin e padrejtësisë e të hyjë mes tij; gjithashtu, Ai ka mundësi të largojë padrejtësinë prej atij që i është bërë padrejtësia dhe ta kthejë atë kundër atij që e ushtroi. Njeriu, që synon të bëjë padrejtësi, sikur edhe për një çast të vetëm të kalonin në mendjen e tij këto të vërteta, me siguri do të hiqte dorë nga qëllimi.’*

*Ky është nga mjetet më të bukura për t’u mbrojtur prej padrejtësisë.*

*Krimi i padrejtësisë është i rëndë tek All'llahu i Lartësuar, lutja e atij që i është bërë padrejtësi gjen përgjigje kundër atij që i ka bërë padrejtësinë, ashtu siç ka thënë Ebù Abdil lahi (Paqja qoftë mbi të!): “Ruhuni nga padrejtësia, sepse lutja e atij që i bëhet padrejtësi ngjitet lart në qiell.”<sup>3</sup>*

*Unë them: ‘Ngjitja e lutjes lart në qiell është metaforë për pranimin e lutjes dhe mos sprapsjen e saj.’*

### *Besimtari*

---

<sup>1</sup> *Largimi prej mëkatit dhe qëndrimi në mëkate, që të dy janë mbështetur te njëri-tjetri mbi dënimin tënd, prandaj vlerësimi bëhet sipas shkallës së largimit e shkallës së qëndrimit.*

<sup>2</sup> *“Mexhâlis” i shejh Tûsit, kuvendi i 11-të.*

<sup>3</sup> *“El Kâfij”, kapitulli: “Lutja e kujt gjen përgjigje?”, vëll. 2, f. 4 dhe f. 509.*

*Besimi, në të gjitha sendet, është zënia vend e besimit në shpirt. Individu është i përkushtuar ndaj këtij besimi dhe sakrifkohet në rrugën e tij. Kur besimi zë vend te njeriu, ai bëhet pjesë e pandashme dhe e pashkëputshme e shpirtit të tij, madje ai është shpirti i tij i vërtetë. Nëse do të ishte e lejueshme, që njeriu të hiqte dorë prej shpirtit të vet, përsëri nuk do të shpëtonte prej besimit, prandaj është e pranueshme që ai mund të heqë dorë prej besimit, por jo të shpëtojë prej tij.*

*Në mënyrë të veçantë, besimi fetar, me të gjitha pjesët e kërkuara, sidomos besimi te All'llahu, është më i fuqishëm se çdo besim tjetër që mund të hyjë në shpirt. Kur njeriu njeh Zotin e vet, ai është besimtar në fuqinë e Tij, në sistemimin e punëve prej Tij e në drejtësinë e Tij, prandaj patjetër duhet të lërë pas dore të gjitha dëshirat e kësaj bote, pa u shqetësuar për çka ndodh në të; gjithashtu, patjetër duhet të jetë i pajisur me këto cilësi, që ne do t'i citojmë për ty prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!).*

*Atë që ti e sheh se nuk është i pajisur me ato cilësi, mësoje se ai nuk është besimtar i vërtetë; ose ai e ka besimin të dobët dhe besimi nuk ka zënë vend në shpirtin e tij.*

*Ebù Abdil'lahi për cilësitë e besimtarit ka thënë: "Besimtari patjetër duhet të ketë tetë cilësi: madhështi në tronditje, durim në sprovat, falënderim në gjendje të mirë, i kënaqur me furnizimin që i ka dhënë All'llahu, nuk i bën padrejtësi armiqve, nuk i bën padrejtësi miqve, trupi i tij është i lodhur prej vetë atij dhe njerëzit prej tij janë të qetë."*

*Pastaj ai tha: “Dituria është miku i ngushtë i besimtarit, qetësia është ministri i tij, durimi është komandanti i ushtrive të tij, shoqërimi është vëllai i tij dhe babai i tij është butësia.”<sup>1</sup>*

*Unë them: ‘Në të vërtetë njeriu jo rrallë herë e gjen veten me shumë cilësi, të cilat e shtyjnë në dashurinë ndaj vetes, të kënaqet prej vetes e të mos shikojë të metat që ka.’*

*Në fakt ky është fillimi i punëve poshtëruese, madje është fillimi i çdo pune të ulët. Kur njeriu lexon fjalë si këto që u thanë prej imam Sâdikut të Ehli Bejtit, për cilësinë e besimtarit, duke vënë rregull dhe duke i analizuar në liri të plotë e me sinqeritet, patjetër do të gjejë stabilitet e do të zemërohet me vetveten, pasi ta njohë atë. Pastaj detyrimisht ai duhet të dijë përse All’llahu ka thënë në fjalën e tij të nderuar: “Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh ti, nuk janë besimtarë.” (Sure “Jûsuf”, ajeti 103)*

*Gjithashtu, imam Sadiku ka thënë: “Për besimtarin në fe ka forcë, në butësi ka vendosmëri, në ndërgjegjësim ka besim; ai kujdeset të mësojë rregullat e ligjit të fesë, aktivitetin e drejton për në rrugën e drejtë, në qëndrimin e drejtë ka mirësi, në vetëpërmbytjen ka dituri, në shoqërimin ka zgjuarsin, në të drejtën ka bujari, në pasuri ka qëllim, në varfëri ka zbukurim, në dëshirën për punë të mira ka përkushtim, në luftën për në rrugën e All’llahut ka kujdes, kur është i zënë me punë ka falje namazi, në gjendje të shtrënguar ka durim, në rastet e tronditjeve ka burri, në gjendje të mirë është falënderues, nuk përgojn*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Besimtari dhe cilësitë e tij”, si dhe kapitulli “Lidhja me Islamin”, vëll. 2. f. 2 dhe f. 220.



*të tjerët, nuk tregon mendjemadhësi, nuk ndërpret lidhjet me të afërmit, nuk është i dobët, nuk është as prepotent e as i ashpër, nuk e parakalon qartësinë e tij, barku i tij nuk e diskrediton, nuk e sundojnë instinktët seksuale, nuk i ka smirë njerëzit, nuk turpëron e nuk e turpërojnë; nuk vjedh, ndihmon atë që i është bërë padrejtësi, mëshiron të mjeruarin, për vete ndihet i pasur, njerëzit prej tij kanë qetësi, nuk e do madhështinë e kësaj bote, nuk ndihet keq nga poshtërsia e saj, për njerëzit është i shqetësuar, që të mos i dalin përpara, në gjykimin e tij nuk vërehet mangësi, në mendimin e tij nuk ka vyshkje, në fenë e tij nuk ka humbur asgjë, orienton në rrugën e drejtë atë që i kërkon këshillë, ndihmon atë që e ka ndihmuar dhe indinjohet nga rënkimet e injoranca.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Imami i besimtarëve, Sàdiku është kujdesur në përshkrimin që u bën imamëve të Ehli Bejtit, ndryshe ku mund të gjendet shembulli i këtij besimtari të plotësuar? A njihni ndonjë besimtar prej myslimanëve me cilësi të tilla? Është e vërtetë se ai mund të jetë i stolisur me këto cilësi të lavdërueshme, përsëri situata e tij është ashtu si e ka përshkruar All’llahu: “Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh ti, nuk janë besimtarë.” (Sure “Jùsuf”, ajeti 103)’*

*Imam Sadiku ka thënë: “Besimtari nuk është besimtar derisa ta ketë mendjen të plotë. Mendja e tij nuk është e plotë, derisa të ketë dhjetë cilësi: prej tij tjetri shpreson mirësi, e keqja prej tij është e siguruar, për vete heq dorë nga shumica e të mirave, i numëron të shumta të mirat e pakta që i vijnë nga të tjerët, i numëron të shumta të*

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli “Myslimani dhe cilësitë e tij”, vëll. 2, f. 4 dhe f. 231.

*këqijat e pakta që dalin prej shpirtit të tij, i mënjanohet shumë të këqijave që i vijnë nga të tjerët, gjatë gjithë jetës së vet nuk është pesimist as në kërkim të plotësisimit të nevojave të veta e as në kërkimin e diturisë, poshtërimi për atë është më i dashur se madhështia<sup>1</sup>, për atë varfëria është me e dashur se pasuria, nga kjo botë atij i mjafton buka e gojës dhe e dhjeta. Po cila është e dhjeta? Ai, njerëzve që takon, u thotë:*

*“Ai është më i mirë e më i devotshëm se unë. Njerëzit janë dy burra: njëri burrë më i mirë e më i devotshëm se ai dhe një burrë më i keq e më i ulët se ai. Kur ai takon atë, që është më i mirë se ai, tregohet kryeulët që të bashkohet me të; kur ai takohet me atë, që është më i keq e më i ulët se ai, thotë: “Shpresoj që e keqja e tij është kjo që duket dhe e mira e tij është në brendësi.” Kur ai e bën këtë, njerëzit e kohës së tij lartësohen e lumturohen.<sup>2</sup>”*

#### *Këshillat e tij për punë të ndryshme*

*Nga këshillat e tij të larta e të bukura, që lënë gjurmë në shpirt, është fjala e tij, kur atij i ka kërkuar këshillë një burrë: “Kur All’llahu ka marrë përsipër furnizimin, atëherë për çfarë është interesimi yt? Kur furnizimi me ushqim është i pjesëtuar, atëherë për çfarë është kujdesi? Kur llogaridhënia është e vërtetë, atëherë për çfarë është*

---

<sup>1</sup> Me poshtërim ai ka qëllim nënshtrimin në adhurim në bindje ndaj All’llahut, që është për atë më e dashur se sa madhështia në kundërshtimin e urdhrave të Tij. Libri i All’llahut është i qartë: “Madhështia i takon vetëm All’llahut e të Dërguarit të Tij. Ose me fjalën poshtërim ai ka qëllim të mbajë në mendje përmendjen e All’llahut nga madhështia në dukjen e jashtme, gjithashtu të tërheqë vëmendjen që si person të tejkalojë masën.

<sup>2</sup> “El Mexhàlis” i shejh Tùsijit, kuvendi i 5-të.

*grumbullimi? Kur shpërblimi prej All'lahut është i vërtetë, atëherë për çfarë është përtacia? Kur koha vjen prej All'lahut, atëherë për çfarë është koprracia? Kur dënimi është prej All'lahut, atëherë për çfarë është mëkati? Kur vdekja është e vërtetë, atëherë për çfarë është gëzimi? Kur dhënia e sendeve është e drejta e All'lahut, atëherë për çfarë është mashtrimi? Kur djalli është armik, atëherë për çfarë është shkujdesja? Kur kalimi mbi Sirat është i vërtetë, atëherë për çfarë është hidhërimi? Kur kjo botë do të zhduket, atëherë për çfarë është siguria në të?"<sup>1</sup>*

*Unë them: "Të gjitha këto janë mohime për njeriun, që ai të mos manifestojë cilësi jo të lavdërueshme, siç janë: interesimi, kujdesi, grumbullimi i pasurisë, përtacia, etj., duke ditur se furnizimi me ushqim është garanci nga ana e All'lahut të Lartësuar dhe se ushqimi është i pjesëtuar. E vërtetë është edhe llogaridhënia, si dhe të tjerat që përmendi imami – Paqja e shpëtimit qoftë mbi tël.*

*Por ajo që i shtyn njerëzit në këto të këqija, megjithëse e dinë, është dashuria e tyre për vetveten dhe sundimi i dëshirave të tyre mbi mendjet e tyre."*

*Nga këshillat e tij të shkëlqyera është edhe kjo fjalë tjetër e tij: "Ju jeni në afate kohore, që janë në grushtin e dorës dhe me ditë të numëruara. Vdekja vjen papritur. Kush mbjell mirësi, korr shpresë dhe kush mbjell të keqen, korr pendim. për çdo fermer ka të mbjella, i ngadalshmi juaj nuk e parakalon atë që është caktuar për të, as i më i kujdesshmi juaj nuk e arrin atë që nuk është caktuar për të;*

---

<sup>1</sup> "Kitàbu Teuhijd" i Sudùkut,, kapitulli " El Erzàku, uel Es'àru uel Àxhàlu"; "Kitàbul Khisàl", vëll. 2, f. 61, kapitulli "El Ishreh".

*kush jep të mirën, edhe All'llahu i jep atij dhe kush ruhet nga e keqja, edhe All'llahu e ruan atë.<sup>1</sup>*

*Vonimi i pendimit është mendjemadhësi, zgjatja e durimit është hutim, kapja me një argument për të kundërshtuar All'llahun është shkatërrim, këmbëngulja në fajë është siguri për dënimin e All'llahut, por nga dënimi i All'llahut nuk është i siguruar askush përveç njerëzve që janë në rrugën e humbjes.<sup>2</sup>*

*Kush ka frikë All'llahun, Ai e ruan atë, kush e falënderon All'llahun, Ai ia shton atij, kush e krediton All'llahun, Ai e shpërblen atë.<sup>3</sup>*

*Një këshillë shumë e vlefshme është edhe fjala e tij për Ebù Besirin: "A nuk hidhërohesh? A nuk je i interesuar? A nuk ke dhembje?"*

*Ai tha: "Posi jo."*

*Atëherë imami tha: "Kur është kështu me ty, kujtoje vdekjen dhe vetminë tënde në varrin tënd, kujto rrjedhën e syve të tu mbi faqet e tua, kujto prerjet e lidhjeve të tua, kujto si krimbat do të hanë mishin tënd, kujto plakjen tënde në varr dhe shkëputjen nga kjo botë, sepse kjo të nxit ty që të punosh dhe bën që të heqësh dorë nga kujdesi i shumtë për këtë botë."<sup>4</sup>*

---

<sup>1</sup> "El Irshâd" e Mufijdit, (Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!) për gjendjet e imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!).

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, f. 283.

<sup>3</sup> "Bihârul Anuâr", f. 24, f. 78 dhe f. 199.

<sup>4</sup> El Mexhâlis" i shejh Tûsit, kuvendi i 55-të.

*Unë them: 'Sikur njeriu të mendonte për këto fjalë, ai do të ishte sprapsi më i madh nga mëkatet e rënda, do të ishte shtytësi më i madh për të fituar bindjen ndaj All'lahut. Si do të bëjë ai kujdes për këtë botë, në një kohë që bën të keqen e nuk vjen me ndonjë të mirë? Sikur njeriu të shikonte në këtë jetë gjendjen tmerruese të varrit të tij, do të lemerisej e do të mallkonte veten.'*

*Prej këshillave të imam Sadikut (Paqja qoftë mbi tël) është: "Nuk është prej asnjërit, edhe kur atë e ndih mojnë të mirat e jetës, përveçse prej ecjes ndërmjet dy gjërave të urryera: Ai, që rri në pritje të përshpejtimit të rastit, e ka të ngadaltë përfundimin, rastin e tij e kanë rrëmbyer ditët, sepse puna e ditëve është rrëmbimi dhe rruga e kohës është dalja e sendit nga dora.<sup>1</sup>"*

*Unë them: Kjo fjalë është nga fjalimet më të arrira të urtësisë, që shprehin të vërtetat e gjithësisë. Përsa i përket pjesës së parë, që është jetesa e mirë, secili prej nesh ka mundësi të provojë në veten e tij dhe te të tjerët se jetesa e mirë nuk vjen nga plotësimi i nevojave tona, sado që të arrijë pushteti ose kapaciteti ynë financiar. Sekretin është në atë se njeriu kurrë nuk ka mundësi t'i plotësojë të gjitha dëshirat e tij, edhe sikur ato t'ia sjellë jeta e kësaj bote. Kështu edhe "Xhen'neti është i mbushur me punë të padëshirueshme."*

*Përsa i përket pjesës së dytë dhe që është "rasti", ai nuk kalon mbi njeriun pa u mbledhur mijëra shkaqe të jashtme me vetë përzgjedhjen e tij dhe, kur ai kalon dhe ai rri e pret përfundimin e rastit, rasti i del atij nga dora, që*

---

<sup>1</sup> "Tuhul Ukùl", f. 281.

*do të thotë se ai nuk punon me shkakun e fundit, që është përzgjedhja dhe vullneti i tij i prerë. Në shumicën e herëve nuk i vjen mbarë që të bashkojë shkaqet edhe një herë tjetër në sistemin e gjithësisë, sepse mbledhja e tyre për herë të dytë, nuk është më nën përzgjedhjen e tij, prandaj edhe është emërtuar “rast”. Për të gjitha këto, i vendosuri i mençur ka detyrë të shfrytëzojë rastin kur ai të paraqitet.*

*Hipokriti (munafiku) nuk ka dëshirë për gjërat me të cilat besimtarët janë të lumtur, sepse i lumturi nxjerr mësim nga këshilla e devotshmërisë edhe atëherë kur me këshillën është qëllimi për tjetër gjë.”*

*Ky ishte njëri nga bistakët e këshillave të tij shumë të vlefshme, me të cilat ne zbukuruar këtë udhëtim. Mbase na lumturon pjesa e caktuar për ne, që të marrim e të punojmë me këto këshilla.*

### 3 – POROSITË E TIJ

*Vlera shoqërore e njeriut qëndron në të mirat që ai bën për shoqërinë, ashtu siç qëndron vlera e tij personale në punët që ai i bën mirë. Për imam Sadikun edhe sikur të mos kishte tjetër gjë përveç atyre që ne përzgjedhëm nga fjalët e tij, do të ishte më se e mjaftueshme për të treguar pozitën e diturisë së tij hyjnore dhe interesimin e tij për përmirësimin e ummetit. Ti ke lexuar ato pak rreshta nga këshillat e tij dhe tani do të lexosh diçka edhe nga porositet e tij, ku do të gjesh punën e mundin e madh që kanë derdhur barinj të hyjnorë të ummetit e udhëzuesit e tij për të të orientuar në vendet ku është e mira.*

#### *Këshilla e tij për djalin e tij, imam Qàzimin*

*Tek ai hynë disa prej pasuesve të tij, në kohën kur para tij po qëndronte djali i tij, Mùsài, të cilin po e porosiste. Ndër të tjera ai i tha: “O bir, pranoje porosinë time, mbaje mend fjalën time! Nëse ti do ta mbash atë në mendje, do të jetosh i lumtur e do të vdesësh i lavdëruar! O bir, ai, që është i kënaqur, është i pasur; ai, që hedh sytë në ato që janë në dorën e tjetrit, vdes i varfër; ai, që nuk është i kënaqur me atë që ka pjesëtuar All’llahu për të, e akuzon All’llahun në vendimin e Tij; ai, që zvogëlon shkarjen e vet, zmadhon shkarjen e tjetrit; ai, që zbulon perden e tjetrit, ka nxjerrë në shesh pjesët e trupit të tij që nuk duhet të shihen; ai, që e nxjerr shpatën nga milli për kryengritje, me atë do të vritet; ai, që e urren pusin e vëllait të tij, brenda tij do të bjerë; ai, që përzihet me naivët, urrehet shumë; ai, që rri me dijetarët, fiton autoritet; ai, që hyn në vendet e së keqes, akuzohet. O bir, thuaje të vërtetën, qoftë kur është në favorin tënd, qoftë*

*kur është kundër teje, bëj shumë kujdes nga çuarja e prurja e fjalëve, sepse kështu mbillet urrejtja e armiqësia në zemrat e burrave! O bir, kur të kërkosh bujari, je i detyruar ta kthesh atë në mënyrë të barabartë, sepse te bujaria janë vendet e të gjitha gjërave, te vendet e gjërave janë bazat, te bazat janë degët dhe degët kanë fruta, fryti nuk bëhet i mirë pa degë, nuk ka bazë të qëndrueshme veçse një vend të mirë. O bir, nëse shkon për vizitë, vizito të mirët dhe mos vizito të këqijtë, sepse ata janë shkëmbinj të ngurtë dhe prej tyre nuk shpërthen ujë, ata janë pemë, që nuk i gjelbërojnë gjethet dhe tokë ku nuk mbin bari.”<sup>1</sup>*

Unë them: ‘Disa nga këto fraza janë edhe në “Nehxul-Belagah”. Nuk ka ndonjë gjë të habitshme, pasi dituria e tyre kalon nga njeri tek tjetri dhe mbase imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka përmendur ato për të dëshmuar.’

*Porosia e tij për shokët e tij*

*Me emrin e All’llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, lutuni Zotit tuaj për shëndet, kini detyrë të jini të fortë, seriozë e të qetë. Detyra juaj është të jini të turpshëm e të pastër me ato gjëra që janë pastruar të mirët para jush. Kijeni frikë All’llahun dhe frenojeni gjuhën, bëni kujdes nga fjalët e rënda, që nxjerrin gjuhët tuaja me gënjeshttrat, me shpifjet, me mëkatet e me sulmet. Nëse ju do të frenoni gjuhët tuaja, në ato që kanë miratimin e All’llahut dhe prej të cilave Ai ju ka ndaluar, kjo është shumë më mirë për ju tek Zoti juaj, se sa të nxirrni ato fjalë të rënda; nëse gjuha nxjerr fjalë të rënda, nga ato që nuk*

<sup>1</sup> “Nùrul Ebsàr”, e Shelenbexhijit, f. 163; “Hilij’jetul Enbijà”, e Hafidh Ebù Naimit, vëll. 3, f. 135.



kanë miratimin e All'llahut dhe nga ato që Ai i ka ndaluar e që e pengojnë robin të afrohet tek All'llahu, keni dënimin e Tij. Këto fjalë ju shurdhojnë e ju verbojnë dhe All'llahu jua sjell trashëgim Ditën e Gjykimit dhe me ato do të bëheni ashtu siç thotë i Larti: “Mohuesit i shëmbëllejnë kafshëve, të cilat, kur i thërret dikush, dëgjojnë vetëm thirrje e zë, por s'kuptojnë asgjë. Ata janë të shurdhër, memecë dhe të verbër e nuk kuptojnë asgjë.” (Sure “El Bekare”, ajeti 171), që do të thotë se ata nuk do të flasin e nuk do të lejohen që të justifikohen. Keni detyrë të heshtni, përveçse për fjalët, ku All'llahu sjell dobi për ju nga punët e botës së ardhshme dhe për të cilat Ai ju shpërblen. Luteni All'llahun sa më shumë, sepse Ai do prej robëve të tij besimtarë, që t'i luten. Ai i ka premtuar robëve të Vet besimtarë përgjigjen e lutjes. All'llahu e kthen lutjen e besimtarëve Ditën e Gjykimit në punë dhe i shton ato në Xhennet. Përendeni sa më shumë All'llahun (bëni thikër), sa të keni mundësi, në çdo orë të natës e të ditës, sepse All'llahu ka urdhëruar ta përmendni Atë sa më shumë. All'llahu i përmend ata besimtarë që e përmendin Atë. Dijeni se kur ndonjë prej robëve të Tij besimtarë e përmend All'llahun, patjetër që edhe Ai e përmend atë me mirësi. Jepini All'llahut më të mirën nga vetja juaj, jepeni me bindje dhe me zemërbardhësi, sepse asnjë e mirë nuk arrin tek All'llahu veçse me bindje ndaj Tij dhe me largimin nga gjërat që Ai ka ndaluar. Të vërtetën e jetës Ai e thotë në fjalën e Tij: “Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta, sepse, ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar.” (Sure “El En'âm”, ajeti 120)

Mos ndiqni dëshirat e mendimet tuaja, ndryshe do të bini në rrugën e humbjes, sepse njeriu, që ka shkarë më

*shumë në rrugën e humbjes, është ai që ndjek dëshirat e mendimet e veta pa udhëzimin e All'lahut. I bëni mirë vetes tuaj, sa të keni mundësi. Nëse bëni mirë, e keni bërë për vete, nëse bëni keq, përsëri e keni bërë për vete. Dijeni se asnjë prej robëve të Tij nuk ka besuar derisa robi të jetë i kënaqur me ato që Allahu ka bërë për të, qofshin nga ato gjëra që ai i do ose i urren. Për atë që duron e është i kënaqur prej All'lahut, Ai i jep njeriut atë që meriton dhe ajo që bën All'lahu, është më e mirë për të nga ajo që ai do ose e urren.*

*Kini detyrë të ruani kohët e faljes së namazve, edhe namazin e mesit. Faleni namazin për All'lahun e në bindje të Tij, ashtu siç ka urdhëruar All'lahu në Librin e Vet.*

*Ruhuni shumë nga madhështia e mendjemadhësia, sepse madhështia është rroba e sipërme e All'lahut dhe, kush i heq All'lahut rrobën e Tij të sipërme, Ditën e Gjykimit All'lahu e shkatërron dhe e poshtëron. Mos sulmoni njëri-tjetrin, sepse sulmi nuk është nga cilësitë e njerëzve të mirë, pasi All'lahu mësymjen e sulmuesit e kthen kundër tij dhe ndihma e All'lahut është për të sulmuarin. Ai që ka ndihmën e All'lahut triumfon dhe atij i vjen fitorja prej Tij; ruhuni nga smira ndaj njëri-tjetrit, sepse smira është origjina e mohimit<sup>(1)</sup>, bëni shumë kujdes që të ndihmoni një mysliman, të cilit i është bërë padrejtësi, ndryshe ai i lutet All'lahut kundër jush dhe lutja e tij gjen përgjigje kundër jush, sepse babai ynë, i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) thotë: "Me të vërtetë, lutja e myslimanit, që i është bërë padrejtësi, gjen përgjigje. Me të vërtetë, ndihma e ndërsjellë e myslimanit është më e mirë e me shpërblim më të madh se agjërimi i një muaji dhe qëndrimi në Iëtikâf në xhaminë e Qabesë."*

*Dijeni se Islami është dorëzim dhe dorëzimi është Islami; kush dorëzohet, është mysliman, kush nuk dorëzohet, nuk ka Islam. Ai, që gëzohet të lartësohet shpirtërisht me mirësinë, le t'i bindet All'llahut, sepse ai, që i bindet All'llahut, padyshim që mirësia ka arritur në shpirtin e tij. Ruhuni shumë të mos mëkaton, duke kundërshtuar All'llahun; kush shkel kufijtë, që ka ndaluar All'llahu, ka arritur të keqen në shpirtin e vet. Nuk ka shkallë ndërmjet mirësisë e të keqes. Ata, që bëjnë të mira, tek Zoti i tyre kanë Xhennetin dhe ata, që bëjnë keq, tek Zoti i tyre kanë zjarrin, prandaj punoni në bindje të All'llahut dhe largohuni nga kundërshtimi i gjërave që Ai ka ndaluar."*

*Unë them: "Nga kjo porosi e gjatë ne kemi shkëputur këtë lule erëkëndshme, e treguar në fillimin e "Reudatul Kâfij" të El Kulijniit, i cili ka thënë: "Imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi të!) e ka shkruar këtë për shokët e tij dhe i ka urdhëruar ata që ta studiojnë e ta shikojnë me kujdes, të përqendrohen në këtë porosi e të punojnë me të. Ata e vinin këtë porosi aty ku falnin namaz në shtëpitë e tyre dhe, kur mbaronin faljen e namazit, i hidhnin një sy edhe kësaj porosie."*

*Porosia e tij për Abdullah ibn Xhundubin: "Abdullah ibn Xhundub El Bexhelij El Kûfij, ishte shok i imam Sâdikut, imam Qâzimit e imam Rizâit (Paqja qoftë mbi ta!) ka qenë zëdhënës për Qâzimin e për Rizanë dhe ishte adhurues për pozitën e lartë; El Keshij'ji i ka thënë Ebul Hasanit (Paqja qoftë mbi të!): "A nuk je i kënaqur prej meje?"*

*Ai i ka thënë: "Po, për All'llah edhe i Dërguari i All'llahut është i kënaqur."*

*Imam Sâdiku i ka dhënë një porosi atij, në të cilën janë mbledhur këshillat më me vlerë, prej së cilës ne kemi*

*shkëputur pjesëzat e mëposhtme: “O bir i Xhundubit, është shkatërruar ai që mbështetet në punën e tij. Ai, që guxon të mëkatojë, nuk shpëton me mëshirën e All’llahut.”*

*I biri i Xhundubit e pyeti: “Po cili shpëton?”*

*Ai tha: “Ata që janë mes frikës e shpresës, si të ishin zemrat e tyre në kthetrat e një shpendi, dëshirë e madhe për shpërblim dhe frikë prej dënimit.*

*O bir i Xhundubit, atë e gëzon fakti se All’llahu do ta martojë me huritë dhe se do të drejtohet me dritën! Le t’i dhurojë gëzim vëllait të tij besimtar!*

*O bir i Xhundubit, djalli ngre prita për gjueti, me të cilat pret gjahun, ruhuni rrjetave e pritave të tij!”*

*I biri i Xhundubit i tha: “O bir i të Dërguarit të All’llahut – (Paqja e shpëtimit i All’llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij) –, si janë ato?”*

*Ai tha: “Pritat e djallit janë pengimi për t’i bërë mirësi vëllezërve, kurse rrjeta e tij është gjumi për të mos falur namazin, që All’llahu ka urdhëruar të kryhet, por ai nuk e adhuron All’llahun në të njëjtën masë me hapat që hedh për t’i bërë mirë vëllezërve e për t’i vizituar ata. Mjerim i madh për ata që janë të shkujdesur në faljen e namazit, që flenë nëpër dhoma të veçanta e që tallen me All’llahun e me ajetet e Tij në Kur’àn! Për këta njerëz, në botën e ardhshme, nuk ka më pjesë nga mirësitë. Ditën e Gjykimit atyre nuk do t’i flasë All’llahu, as nuk do t’i pastrojë. Ata kanë një dënim të dhimbshëm.*

*O bir i Xhundubit, kush nxiton në ndihmë të vëllait të vet, është si ai që kryen ecjen (Saëjin) ndërmjet Safàsë e*

*Merves. Kush i kryen atij nevojën, është si ai që shpejtoi të derdhte gjakun e tij në rrugën e All'llahut ditën e Luftës së Bedrit e ditën e Luftës së Uhudit. All'llahu e ka lëshuar dënimin mbi ndonjë ummet vetëm atëherë kur ata kanë nëpërkëmbur të drejtat e vëllezërve të tyre të varfër.*

*O bir i Xhundubit, nëse dëshiron, që i nderuari të jetë fqinjë me ty dhe të banosh në Xhennet në fqinjësi me të, kjo botë le të jetë tek ti pa ndonjë vlerë. Vdekjen tënde mbaje para syve të tu, mos rezervoj gjë për nesër, dije se do të kesh atë që ke sjellë dhe kundër teje do të jetë ajo që e ke vonuar.*

*O bir i Xhundubit, kush e kufizon veten nga fitimi i tij, mbledh për të tjerët. Kush i bindet dëshirave të veta, i është bindur armikut të vet. Kush ka frikë All'llahun, kjo i mjafton atij në ato që ai interesohet për punët e kësaj bote e të botës së ardhshme dhe i ruan atij atë që është larguar prej tij. Është i mangët kush nuk numëron për çdo provë një durim, për çdo mirësi një falënderim e për çdo vështirësi një lehtësim. Mbaje veten me durim në çdo provë: te fëmijët, te pasuria, te pasardhësit. Në të vërtetë, Ai bën që të vdesë ajo për të cilin ka nevojë dhe e merr dhuratën e Tij që të sprovtojë në të dyja falënderimin e durimin tënd. Shpresoj te All'llahu, në atë mënyrë që shpresa nuk të çon deri aty sa të kundërshtosh urdhrin e All'llahut. Kije frikë All'llahun, në atë mënyrë sa frika nuk të bën të pikëlluar prej mëshirës së Tij. Mos u mashtro as nga fjala e injorantit e as nga lavdërimet e tij, ndryshe do të bëhesh mendjemadh e shtypës dhe do të jesh i shkujdesur në punën tënde. Puna më e virtytshme është adhurimi e kryeultësia. Mos e humb pasurinë tënde e të*

*shpëtosh pasurinë e tjetrit,<sup>1</sup> që ti e kë lënë pas shpine. Ji i kënaqur me atë që All'illahu ka pjesëtuar për ty, shiko vetëm atë që ke dhe mos shpreso atë që nuk e arrin dot. Ai, që është i kënaqur me aq sa ka, është i ngopur dhe ai, që nuk kënaqet me aq sa ka, kurrë nuk ngopet.*

*Merre pjesën tënde prej botës tënde të ardhshme, të mos jesh gjysmak në pasuri e as i padurueshëm në varfëri, të mos jesh i ashpër e prepotent, që njerëzit të mos duan të të afrohen, të mos jesh as i dobët, që njerëzit të ndihen të përçmuar që janë njohur me ty, mos u armiqëso me atë që është mbi ty, mos e vër në lojë atë që është nën ty, mos ia hiq punën atij që ka aftësi ta kryejë, mos iu bind naivëve; në çdo punë qëndro derisa të mësosh hyrjet e daljet e saj, para se të biesh brenda në të e të pendohesh; merre veten për një armik, të cilin e lufton; nëse i jep një njeriu, mos e prish dhënien duke ia përmendur shpesh, sepse kështu është shumë më bukur. Ke detyrë të heshtësh, që të të numërojnë të butë, i paditur ose i ditur qofsh, sepse heshtja për ty është zbukurim tek dijetarët dhe mbulesë për ty tek injorantët.”*

*Nga kjo porosi është edhe tregimi i tij për fjalën që Isà'i (Paqja e All'illahut qoftë mbi të!) u tha shokëve të vet: “Bëni kujdes të madh me shikimin, sepse shikimi mbjell në zemër dëshirat dhe kjo është e mjaftueshme që tek dëshiruesi të jetë ngatërresë ose përgëzim për atë që sheh me zemër e nuk sheh me sytë e ballit. Mos i shikoni të metat e njerëzve si zotërinjtë, por i shikoni të metat e tyre*

---

<sup>1</sup> Në shpjegim të fjalës së tij: “Pasinë e tjetrit...”, do të thotë se pasuria që ti e le pas, është pasuri e tjetër kujt, prandaj mos u intereso që të përmirësosh atë dhe të humbësh pasurinë tënde, nga e cila duhet të përfitosh, duke e shpenzuar në rrugë bamirësie.

*me pamjen e një robi. Njerëzit janë vënë në sprovë e gëzojnë shëndet, prandaj mëshironi të sprovuarit dhe falënderoni All'llahun për shëndetin."*

*Pastaj imam Sádiku (Paqja qoftë mbi tël) tha: "O bir i Xhundubit, mbaji lidhjet me atë që i ka ndërprerë lidhjet me ty, jepi atij që nuk të ka dhënë, bëji mirë atij që të ka bërë keq, përshëndete me "Selam" atë që të ka sharë. Ji i matur me atë që është armiqësuar me ty, fale atë që të ka bërë padrejtësi, ashtu siç ke edhe ti dëshirë të të falin. Nxirr mësim nga falja e All'llahut. A nuk e sheh se dielli i Tij i lëshon rrezet mbi të mirët e mbi mëkatarët dhe se pika e ujit të Tij zbret për njerëzit e mirë dhe për ata që gabojnë?"*

*O bir i Xhundubit, Islami i kushton rëndësi të madhe ndjenjës së turpit. Zbukurimi i besimtarit është maturia, burrëria e tij është puna e mirë, kolona mbajtëse e tij është përkushtimi. Për çdo send ka një themel dhe themeli i Islamit është i dashuri ynë i Ehli Bejtit."<sup>1</sup>*

*Unë them: "Sa shumë fjalë të larta e këshilla të dobishme ka përfshirë kjo porosi. Çdo porosi e çdo këshillë e tij që ke lexuar, ka kaluar nëpër kulmin e lartësisë së shprehjes, largpamësinë e kujtimit e të tërheqjes së vëmendjes. Prandaj ti thua: "A ka fjalë tjetër pas kësaj?"*

*Porosi të tilla meritojnë komente e shpjegime, veçse kjo është më larg se qëllimi i fundit, prandaj mbështetu në këtë porosi, që të sistemosh punët.*

*Porosia e tij për Adullah Nexh'ashijun*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anvâr", fvol. 1, f. 78 dhe f. 279.

*Abdullah ibn Sulejmàn En'nùfelij tregon: "Isha tek Xha'fer ibn Muhammed Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), ndërkohë erdhi tek ai një shërbyes i Abdullah Nexhàshijut, përshëndeti me "Selam" dhe i dha një letër. Ai e hapi letrën dhe e lexoi. Në rreshtat e para të saj shkruhej: "Me ermin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, All'llahu i zgjattë jetën zotërisë tim dhe më bëftë mua kurban për të nga çdo e keqe. Unë u vura në sprovë, kur u ngarkova me detyrën e valiut në krahinë Ahvâz. Nëse zotëria im mendon të më caktojë mua një kufi, ose të sjellë për mua një shembull, që unë ta marr atë argument prej tij, që të më afrojë tek All'llahu i Lartësuar dhe tek i Dërguari i Tij, le të shkruajë shkurtimisht atë që mendon se unë duhet të punoj me të, ku duhet të veproj me shpirtmirësi dhe ku duhet të jem i prerë, ku ta jap zekatin tim dhe kujt t'ia jap, cilin të shoqëroj dhe tek kush të qetësohem, cilin të besoj e tek kush të jem i sigurt, kujt t'ia besoj të fshehtëm time. Mbase All'llahu më shpëton mua me udhëzimin tënd e me drejtimin tënd, sepse ti je argumenti i All'llahut mbi robët e Tij, je besniku i Tij në vendin e Tij dhe mirësitë e Tij janë të vazhdueshme për ty."*

*Abdullah ibn Sulejmàni tregon: "Ebù Abdil'lahi u përgjigj: "Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, All'llahu të trajtoftë me mirësinë e bërjes së Tij, me butësinë e Tij kur të jep e të ushqen me kujdesin e Tij, pasi për këto vetëm Ai e ka në dorë. Tek unë erdhi i dërguari yt me letrën tënde, të cilën unë e lexova dhe i kuptova të gjitha ato që kishe përmendur e ato që pyet. Ti thua se je vënë në sprovë duke të emëruar mëkëmbës (vali) të Avâzitet. Në të vërtetë, kjo mua edhe më gëzoi, edhe më mërziti. Përsa i përket gëzimit tim për emërimin tënd vali unë thashë: "Mbase All'llahu me ty ndihmon ndonjërin, që i është bërë padrejtësi prej familjes së të*



*Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe se Ai me ty e forcon atë. Unë u mërzita nga emërimi yt dhe frika më e pakët që kam për ty, është se do të gjurmosh ndonjë mikun tonë dhe kështu nuk do të nuhasësh rrethimin e shenjtërisë.*

*Unë do të përmbledh për ty të gjitha sa më kërkove. Nëse ti do të punosh me to dhe nuk do ta tejkalosh masën, kam shpresë se, me lejen e All'llahut, do të jesh i shpëtuar. Mua më ka treguar babai im prej prindërve të tij, prej imam Ali ibn Ebi Tâlibit prej të Dërguarit të All'llahut i cili ka thënë: "Kujt i kërkon këshillë vëllai i tij besimtar dhe ai nuk është i sinqertë në këshillën që jep, All'llahu ia heq atij të vërtetën që ka. Unë do të të jap një mendim. Nëse ti punon sipas atij mendimi, ke shpëtuar prej asaj që unë kam frikë për ty. Shpëtimi yt qëndron në mosderdhjen e gjakut të miqve të All'llahut, në largimin e mundimit e të fyerjeve prej tyre, në butësinë me shtetasit, në maturinë e në mirëtrajtimin, në butësinë edhe ndaj atij që nuk është i pafuqishëm, në ashpërsinë pa dhunë, në mirëtrajtimin e shokut tënd dhe të atyre që ai i dërgon të vijnë tek ti. Merre vetë në dorë çështjen e ndarjes së shtetasve të tu, sepse përputhja e tyre, dashtë All'llahu, qëndron me atë që përputhet me të vërtetën dhe drejtësinë.*

*Bëj shumë kujdes nga lumturia dhe nga ata që çojnë e sjellin fjalë. Asnjëri prej atyre të mos afrohet tek ti dhe All'llahu të mos shikojë ndonjë ditë ose ndonjë natë se ti ke pranuar pará prej tyre, ose diçka të ngjashme me paranë, ndryshe All'llahu zemërohet me ty dhe të shqyen e të heq mbulesën tënde.*

*Përsa i përket atij, me të cilin gëzohesh, tek i cili qetësohesh dhe i mbështet punët e tua, është burrë i sprovuar, burrë që shikon në përfundimin e punëve, besnik dhe që përputhet me ty në fenë tënde. Ai ka dalluar bashkëpunimin tënd dhe ka provuar të dy grupet. Nëse këtu do të shikosh orientim për të vërtetën, kjo është vetëm puna jote e puna e tij.*

*Por bëj shumë kujdes, që të japësh qoftë edhe një dirhem, ose të heqësh një rrobë, ose të ngarkosh mbi kafshë jo për hir të All'llahut, por për një poet, ose për një shakaxhi, ose për një komik, patjetër të japësh një shumë të ngjashme me atë për hir të All'llahut.*

*Le të jenë shpërblimet që ti jep, dhurimet që bën apo edhe ato që heq për komandantët, për korrierët, për nipërit, për letrarët, për policinë e për ata që mbledhin të pestat, si dhe çdo gjë tjetër që dëshiron ta shpenzosh në rrugë bamirësie, suksezi, sadakaje, për Haxh, për ujë që të pinë të tjerët ose rroba për të falur namaz, si dhe dhurata të ndryshme, të cilat ti i dhuron për hir të All'llahut të Lartësuar e në respekt të të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) patjetër që të jenë nga fitimi yt më i pastër.*

*O Abdullah, përpiqu të mos mbledhësh thesare prej ari e prej argjendi, ndryshe do të jesh prej atyre që përfshihen në ajetin e Kur'ânit, në të cilin All'llahu i Lartësuar thotë: "O besimtarë! Në të vërtetë, shumë priftërinj dhe murgj përlajnë pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga rruga e All'llahut. Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të All'llahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm." (Sure "Et Teube", ajeti 34)*

*Mos e pakëso atë ëmbëlsirë e atë gjellë, që të ka tepruar dhe që ti e shpenzon për të mbushur barqet e zbrazura, sepse me atë të qetësohet zemërimi i All'Ilahut të Lartësuar. Unë kam dëgjuar prej babait tim, të cilit i kanë treguar prindërit e vet dhe ata kanë dëgjuar prej Prijësit të Besimtarëve, i cili ka dëgjuar Profetin (Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): “Nuk ka besuar te All'Ilahu e në Ditën e Fundit ai që fle i ngopur dhe fqinji i tij është i uritur. Ne thamë: “Mbeturinat tona, o i Dërguari i All'Ilahut?” Ai tha: “Nga gjella juaj e tepërt, nga hurmat tuaja të tepërta, nga ushqimi juaj, nga rrobat tuaja e me veshjet tuaja, shuani me ato zemërimin e Zotit.””*

*Prijësi i Besimtarëve doli nga kjo botë dhe në qafën e tij nuk i rëndonte pesha e sendit të asnjë njeriu. Ai e takoi All'Ilahun e Lavdëruar, i panjollë dhe i paqortuar. Pas tij e nën shembullin e tij vazhduan imamët, ashtu siç u është kumtuar. Ata nuk u përlyen me asnjë send të keq (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi ata dhe të gjithë qofshin në shpërblimet më të mira!).*

*Unë të orientova në moralet më të nderuara të kësaj bote e të botës së ardhshme. Nëse ti do të punosh sipas këshillës, që unë të kam dhënë në këtë letrën time dhe pastaj mbi ty do të rëndojnë faje e gabime, aq të rënda, sa të maten me peshën e maleve e me dallgët e deteve, ti shpresoj se All'Ilahu i Lartësuar, me fuqinë e Tij, do t'i largojë ato prej teje.*

*O Abdullah, ruhu shumë të mos frikësosh ndonjë besimtar, sepse babai im më ka treguar prej babait të vet, prej gjyshit të tij Ali ibn Ebi Tâlibit (Paqja qoftë mbi ta!) se ai ka thënë: “Kush hedh shikimin mbi një besimtar për ta frikësuar atë me atë shikim, atë do të frikësojë All'Ilahu atë*

*ditë kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së All'lahut dhe do ta gjykojë në atë formë që mishi i tij, trupi i tij dhe të gjitha gjymtyrët e tij të jenë si ato grimcat që shihen nën rrezet e diellit që hyn nga e çara e dritares, derisa ta kthejë atë ashtu siç ka qenë.”*

*Babai im më ka treguar prej prindërve të vet, prej Aliut, prej Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): “Ai që ndihmon një besimtar të lemerisur nga frika, atë do ta ndihmojë All'llahu atë ditë kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së All'lahut dhe Ai do ta sigurojë prej frikës më të madhe, do ta sigurojë prej përmbysjes së keqe. Ai, që i kryen një nevojë vëllait të vet besimtar, All'llahu do t'i kryejë atij shumë nevoja dhe njëra nga ato është Xhenneti. Ai që vesh një vëlla besimtar të zhveshur, atë e vesh All'llahu me rrobat më të mira e me mëndafshet e Xhennetit, ai vazhdon të jetë në kënaqësinë e All'lahut derisa i veshuri prej tij të vazhdojë të ecë me ato rroba. Ai, që ushqen vëllanë e tij të uritur, e ushqen All'llahu me ushqimet më të mira të Xhennetit. Ai, që i jep të pijë ujë një të eturi, All'llahu do t'i japë atij të pijë nga parfumi i vulosur (err'rrehijkul makhtùm). Ai, që i shërben vëllait të vet, All'llahu vë në shërbim të tij djemtë e përhershëm dhe e lejon të banojë së bashku me miqtë e tij të pastër. Ai, që mbart vëllanë e tij me kafshën e vet, All'llahu e mbart atë mbi një deve prej deveve të Xhennetit dhe Ditën e Gjykimit All'llahu i mburret engjëjve që janë më afër Tij. Ai, që marton vëllanë e vet besimtar me një grua dhe ai është i gëzuar me të, është i mbledhur me të dhe gjen qetësi tek ajo, All'llahu atë do ta martojë me huritë, do ta gëzojë atë me shoqërinë e të dashurve të tij, me miqtë e me njerëzit e shtëpisë dhe ata do të jenë të gëzuar me shoqërinë e tij. Ai, që ndihmon vëllanë e tij besimtar nga*

*dhuna e një mbreti mëkatar, All'llahu do ta ndihmojë atë në Urën e Siratit, atëherë kur lëkunden këmbët. Ai, që viziton vëllanë e tij besimtar në shtëpinë e tij, pa pasur ndonjë nevojë prej tij, shkruhet prej vizitorëve të All'llahut dhe meriton të ketë respektin që All'llahu ka rezervuar për vizitorët e Tij.”*

*O Abdullah, babai im më ka treguar prej prindërve të tij dhe ata prej Aliut (Paqja qoftë mbi të!) se ai një ditë ka dëgjuar të Dërguarin e All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) të thotë: “O njerëz, në të vërtetë nuk është besimtar ai që mallkon me gjuhën e tij dhe nuk beson me zemrën e vet<sup>1</sup>, prandaj mos gjurmoni shkarjet e besimtarëve, sepse ai, që gjurmon edhe një shkarje të një besimtari, All'llahu do të gjurmojë Ditën e Gjykimit shkarjet e tij dhe do ta diskreditojë atë brenda në shtëpinë e vet.”*

*Babai im më ka treguar se Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “All'llahu i ka marrë besën besimtarit, që ai nuk vërteton fjalën e vet, nuk ndjek rrugë mesatare ndaj armikut të tij dhe nuk shëron zemërimin e vet, veçse me diskreditimin e vetes, sepse çdo besimtar është i frenuar dhe kjo është për qëllim të shkurtër e për një qetësi të gjatë.”*

*O Abdullah, babai im më ka treguar prej prindërve të tij dhe ata prej Aliut (Paqja qoftë mbi të!) se ai një ditë ka dëgjuar të Dërguarin e All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) të thotë: “Më erdhi Xhebraili (Paqja qoftë mbi të!) dhe tha: “O Muhammed,*

---

<sup>1</sup> Ka qëllimin se ai që përmend njerëzit për të keq dhe jo me atë çka ai beson për ata.

*All'llahu të përshëndet me "Selam" dhe thotë: "Për besimtarin kam nxjerrë njërin prej emrave të Mi dhe e kam quajtur atë besimtar, prandaj besimtari është prej Meje dhe Unë jam prej tij. Ai, që poshtëron një besimtar, në të vërtetë më ka shpallur Mua luftë."*

*O Abdullah, babai im më ka treguar prej prindërve të tij dhe ata prej Aliut (Paqja qoftë mbi të!) se ai një ditë ka dëgjuar të Dërguarin e All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) të thotë: "O Ali, mos diskuto me njeri pa parë në ndërgjegjen e tij. Nëse ndërgjegjja e tij është e mirë, All'llahu i Lartësuar kurrë nuk do ta bëjë mikun e Tij të dështojë, nëse ndërgjegjja e tij është e keqe, ai i ka të mjaftueshme të këqijat e veta. Sikur të përpiqeshe të punoje me atë më shumë nga sa ka mëkatuar ai kundër All'llahut të Lartësuar, kurrë nuk do të kishe fuqi ta drejtoje atë."*

*Shkalla më e ulët e mohimit është që burri të dëgjojë prej vëllait të vet një fjalë dhe ta mbajë mend, me qëllim që ta diskreditojë atë me atë fjalë, për të tillë njerëz nuk ka pjesë në mirësitë."*

*O Abdulla, më ka treguar babai im, prej prindërve të vet, prej Aliut (Paqja qoftë mbi të!): "Ai, që thotë për një besimtar atë që i kanë parë sytë e i kanë dëgjuar veshët dhe është nga ato që e ul dhe i shemb atij burrërinë, është prej atyre, për të cilët All'llahu i Lartësuar ka thënë: "Ata që duan të përhapen shpifjet e turpshme (ose imoraliteti) ndër besimtarët, i pret një dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në tjetrën; All'llahu i di të gjitha e ju nuk i dini." (Sure "En Nùr", ajeti 19)*

*Ai, që tregon prej vëllait të vet besimtar dhe me atë tregim do të shembë burrërinë e tij e bërjen e tij me të meta, atë e poshtëron All'llahu me gabimet e veta, derisa ai të vijë në një rrugëdalje për ato që ka thënë, por kurrë e asnjëherë nuk do të arrijë në rrugëdaljen. Ai, që fut gëzim te vëllai i tij besimtar, në të vërtetë ka futur gëzim te Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!); ai, që ka futur gëzim te Ehli Bejti, ka futur gëzim në të Dërguarin e All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!); ai, që ka futur gëzim te i Dërguari i All'llahut, në të vërtetë ka gëzuar All'llahun, atëherë ai është bërë i meritueshëm që All'llahu ta fusë në Xhennet.*

*Unë të porosis për devotshmëri ndaj All'llahut, t'i japësh përparësi bindjes ndaj Tij dhe të kapesht pas litarit të Tij. Ai, që kapet pas litarit të All'llahut, padyshim është udhëzuar në rrugën e drejtë. Kije frikë All'llahun dhe mos prefero asnjë njeri mbi kënaqësinë e dëshirën e Tij, sepse devotshmëria është porosia e All'llahut të Lartësuar për njerëzit dhe Ai nuk pranon gjë tjetër prej tyre veç devotshmërisë e nuk vlerëson gjë tjetër më shumë se atë. Mësoje se njerëzit nuk janë obliguar me ndonjë gjë më të madhe se devotshmëria dhe se ajo është porosia jonë e Ehli Bejtit. Nëse nuk ke mundësi të arrish një gjë prej kësaj bote, nesër do të pyetesh për atë, prandaj puno.”*

*Abdullah ibn Suljemàni ka thënë: “Kur Nexh'xhàshiu mori letrën e imam Sàdikut dhe pasi e lexoi, tha: “Betohem në All'llah, që nuk ka Zot tjetër përveç Atij e që është Zotëruesi im, ai ka thënë të vërtetën. Kushdo, që ka punuar sipas kësaj porosie, ka shpëtuar.”*

*Abullahu punoi sipas asaj gjatë gjithë ditëve që i kishin mbetur nga jeta e tij.<sup>1</sup>*

*Lexues i nderuar, mendo për këto këshilla të shenjta dhe vështroi këta paragrafë disa herë; mendo se ç'lumturi të madhe do të arrinte njerëzimi, sikur mbretërit e shtetarët të mbanin parasysh porositë e shkruara në këtë letër, sikur vetë njerëzit të ecnin sipas këtyre porosive të kësaj letre. Fatkeqësisht njerëzit vazhdojnë në rrugën e tyre e nuk zgjohen të dëgjojnë këto këshilla.*

*Nga porositë e tij për pasuesit e tij*

*Zejd ibn Sheh'hâmi tregon se Ebû Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Përshëndet nga unë me "Selam" këdo që e shikoni se më bindet mua dhe vepron sipas fjalës sime. Unë ju porosis për devotshmëri ndaj All'llahut të Lartësuar e për ruajtje të madhe në fenë tuaj, për punë për hir të All'llahut, për falje të drejtë, për kryerjen e emanetit, për sexhde të gjatë e për fqinjësi të mirë, sepse me këto ka ardhur Muahm'medi (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).*

*Kryejini emanetin tek personi që ju është besuar, i mirë ose mëkatar qoftë ai, sepse i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka urdhëruar të çohet në vend edhe fija e perit e gjilpëra. Mbani lidhje me njerëzit e fisit tuaj; merrni pjesë në varrimin e tyre, vizitoni të sëmurët e tyre, kryeni edhe detyrimet që kini ndaj tyre, sepse kur një burrë prej jush është i ruajtur në fenë e tij, ai është i vërtetë në fjalë, kryen emanetin, ka sjellje të mirë me njerëzit e për atë thuhet: "Ky është Xha'ferij." Kjo mua më gëzon, prej atij mua më*

---

<sup>1</sup> "Bihârul Anuâr" f. 78, f. 112 dhe f. 271.



*hyn gëzim. Nëse është ndryshe, mua më hyn e keqja e turpi i tij. Pastaj të tjerët thonë: “Kjo është edukata e Xha’ferit.”*

*Betohem në All’llah, mua më ka treguar babai im se burri i një fisi, që ishte nga pasuesit e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ishte hijeshia e fisit, asnjë nuk e kryente emanetin si ai, asnjë nuk i kryente detyrimet si ai, asnjë nuk ishte më i drejtë se ai në fjalë, tek ai gjendeshin porosinë e njerëzve dhe tek ai ata linin në mirëbesim sendet e tyre. Pyet fisin për atë dhe ata do të thonë: “Kush është si filani? Asnjëri prej nesh nuk e kryen emanetin si ai dhe asnjëri prej nesh nuk flet më drejt, se ai.”<sup>1</sup>*

### *Porosia e tij për një besimtar të qarkut <sup>2</sup>*

*Prej porosive të tij këpusim lulen që kemi më afër për një besimtar të qarkut. Imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “O bir i Nu’mànit, ruhu nga hipokrizia, sepse ajo e ul për tokë punën tënde; ruhu shumë prej polemikës, sepse ajo të shkatërron; bëj kujdes të madh nga armiqtë e shumta, sepse ato të largojnë prej All’llahut. Ata, që kanë qenë para jush, mësonin dëgjimin në heshtje, ndërsa ju mësoni fjalën. Kur ndonjëri prej atyre donte të adhuronte, ai mësonte dëgjimin në heshtje para adhurimit, nëse ai e bënte mirë dëgjimin në heshtje, atëherë ishte i aftë të adhuronte, ndryshe ai thoshte: “Unë nuk jam për këtë.” Në të vërtetë, ka shpëtuar nga mëkatet ai që ka heshtur gjatë dhe ka duruar mundimet e poshtërimet në shtetin e së gabuarës. Kështu janë të përzgjedhurit e miqtë e vërtetë të*

<sup>1</sup> “El Kâfij”, pjesa: “Shoqërimi”, kapitulli “Mà jexhibu minel ishreh”, vëll. 2. f. 5 dhe f. 636.

<sup>2</sup> Muhammed ibn Nu’màn Sajrefij El Kùfij, përmendet si ndër të dëgjuarit. Për atë unë kam shkruar një kumtesë të veçantë.

*All'lahut dhe ata janë besimtarët. Beto hem në All'lah, sikur ndonjë prej jush të sillte para All'lahut aq flori sa ka bota dhe pastaj të kishte smirë një besimtar, padyshim që me këtë flori ai do të hekurosej në zjarr.*

*O bir i Nu'mànit, kush është pyetur për ndonjë dituri dhe ka thënë: "Nuk e di.", në të vërtetë ai e ka ndarë diturinë në dy pjesë. Besimtari, që ka smirë në një kuvend, kur ngrihet të largohet nga kuvendi, prej tij është larguar urrejtja.*

*O bir i Nu'mànit, nëse dëshiron të të besojnë, duaje vëllain tënd, mos bëj shaka me atë, mos dysho në atë, mos iu mburr atij, mos u armiqëso me atë, mos ia trego mikut tënd atë gjë që të gëzon ty, por tregoi vetëm ato gjëra, për të cilat edhe sikur të mësonte armiku yt nuk do të të dëmtonte ty, sepse miku yt një ditë mund të jetë edhe armiku yt.*

*O bir i Nu'mànit, fjala e arrirë nuk është as në mprehtësinë e gjuhës e as në turbullimet e shumta mendore, por është në drejtësinë e kuptimit dhe në qëllimin e argumentit."<sup>1</sup>*

#### *Porosia e tij për Hamràn ibn A'junin <sup>2</sup>*

*Imam Sadiku i ka thënë: "O Hamràn, shiko në atë që është më poshtë se ti dhe mos shiko në atë që është sipër teje, sepse kjo është më e kënaqshme për ty në lidhje me atë që është pjesëtuar për ty dhe është më e mundur që ajo të shtohet prej Zotit tënd. Mëso se puna e pakët, por e vazhdueshme dhe e ndërjegjeshme, është më e vlerësuar*

<sup>1</sup> "El Bihâr", vëll. 78, f. 292.

<sup>2</sup> Përmendet si ndër transmetuesit e dëgjuar.

tek All'lahu se puna e shumtë dhe e pandërgjegjshme. Mëso se nuk ka ruajtje më të dobishme se largimi prej ndalimeve të All'lahut e nga heqja dorë prej mundimit e fyerjes së besimtarëve dhe përgojimit të tyre. Nuk ka jetesë më të gëzueshme se morali i mirë e as pasuri më të dobishme se të kënaqurit me pak, por që ka shpërblim dhe nuk ka injorancë më dëmtuese se vetëpëlqimi.”<sup>1</sup>

#### *Porosia e tij për Mufeddal ibn Umerin* <sup>2</sup>

Imam Sadiku i ka thënë Mufeddal ibn Umerit: “Të porosis ty për devotshmëri ndaj All'lahut e për bindje ndaj Tij. Prej devotshmërisë është bindja dhe ruajtja prej All'lahut e përulja ndaj Tij, është siguria e zemrës, është përpjekja e veprimi sipas urdhrit të Tij e këshillave të dërguarve të Tij, nxitimi për në kënaqësinë e Tij dhe largimi nga gjërat që Ai ka ndaluar. Ai, që është i devotshëm dhe ka frikë All'lahun, me lejen e Tij, e ka ruajtur veten prej zjarrit, ka prekur të gjitha të mirat e kësaj bote e të botës së ardhshme. Ai, që urdhëron për frikë e për devotshmëri ndaj All'lahut, ka shpëtuar. All'lahu, me këshillën dhe me mëshirën e Tij, na ka bërë prej të devotshmëve.”<sup>3</sup>

#### *Porosia e tij për Xhemijl ibn Derràxhin* <sup>4</sup>

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Xhemijl ibn Derràxhit: “Më të mirët prej jush janë ata që tolerojnë dhe më të këqijtë prej jush janë koprracët. Kush bën punë

<sup>1</sup> “Reudatul Kâfij”, vëll. 8, f. 204 dhe f. 238.

<sup>2</sup> Do të përmendet ndër të dëgjuarit; është autor i “Teuhijdit”, që është përmendur në pjesën e parë.

<sup>3</sup> “Besàiru Derexhât”, vëll. 1, f. 526.

<sup>4</sup> Me lejen e All'lahut do ta përmendim ndër të dëgjuarit.

*të mira me vëllezërit dhe shpejton në ndihmë të tyre, kjo është thyerje e hundës për djallin, largim prej zjarrit dhe hyrje në Xhennetet. O Xhemijl, njofto për këtë bisedë “gurerët” nga shokët tuaj.”*

*Xhemijli tregon: “I thashë: “T’u bëfsha kurban, po cilët janë “gurerët” nga shokët e mi?”*

*Imami (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “Janë ata që i bëjnë mirë vëllezërve të tyre në ngushticë e në bollëk.”*

*Ai tha: “O Xhemijl, për shokun tënd të mirë, kjo është diçka e lehtë. All’llahu i Lartësuar e ka lavdëruar me fjalën e Tij edhe atë që bën pak: “Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (Sure “El Hashr”, ajeti 9)<sup>1</sup>*

#### *Porosia e tij për Mual’là ibn Khanijsin*

*Ai i tha Mual’là ibn Khanijsit, i cili dëshironte të udhëtonte: “O Mual’là, madhëroje All’llahun, që edhe Ai të të madhërojë ty!”*

*Mual’là tha: “Me çfarë o nipi i të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij)?”*

*Imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “O Mual’là, kije frikë All’llahun, që të gjitha sendet të kenë frikë prej teje!”*

---

<sup>1</sup> “Khisàlu Sudùk” (All’llahu e mëshiroftë!) kapitulli: “Të tre”.

*O Mual'là, shfaq dashuri ndaj vëllezërve të tu, duke i dhënë atyre, sepse All'llahu i Lartësuar dhënien e ka bërë dashuri dhe mosdhënien shkak për zemërim! Betohem në All'llah, nëse do të më kërkoni mua dhe unë ju jap, kjo për mua është shumë më e dashur se kur nuk më kërkoni dhe nuk ju jap gjë, kështu që ju zemëroheni me mua. Kurdo që All'llahu i Lartësuar të sjellë në duart e mia ndonjë send për ju, i lavdëruar është vetëm All'llahu i Lartësuar, mos e largoni atë që falënderon për atë që ka dhënë All'llahu për ju me duart e mia.”<sup>1</sup>*

### *Porosia e tij për Sufjân Theuriun <sup>2</sup>*

*Sufjâni tregon: “Takova imam Sàdikun dhe i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'llahut, më jep një porosi!”*

*Ai më tha: “O Sufjân, nuk ka burrëri për gënjeshtarin, as vëlla për atë që ndërron shpejt mendje, nuk ka qetësi për smirëziun dhe as nderim për atë që është me moral të keq.”*

*Unë thashë: “O nipi i të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) më shto akoma më shumë.”*

*Ai tha: “O Sufjân siguro All'llahun që je besimtar; kënaqu me atë që All'llahu ka pjesëtuar për ty, që të jesh i pasur; trego fqinjësi të mirë me fqinjin tënd, që të jesh mysliman; mos u shoqëro me mëkatarin, që ai të të mësojë nga mëkatet e tij; për punën tënde këshillohu me ata që e kanë frikë All'llahun e Lartësuar.”*

<sup>1</sup> “Mexhàlisu i shejh Tusit”, kuvendi i 11-të.

<sup>2</sup> Është përmendur në “Diskutimet e tij” në pjesën e parë; gjithashtu edhe te “Përkohshmëria e tij”. Do të përmendet edhe ndër dijetarët e mëdhenj, që kanë transmetuar prej tij (Paqja qoftë mbi të!) prej Ehli Sun'netit.

*Unë i thashë: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut më shto akoma më shumë.”*

*Ai tha: “O Sufjàn, kush dëshiron madhështinë pa fisin, pasuri pa mall dhe autoritet pa pushtet, le të shkojë tek ai, që e kanë poshtëruar mëkatet ndaj All’llahut, të madhështojë e t’i bindet atij.”<sup>1</sup>*

*Një herë i tha imam Sàdikut: “Nuk largohem derisa të më flasësh.”*

*Ai i tha: “Unë të flas ty, por fjalët e shumta nuk janë të mira për ty, o Sufjàn. Kur All’llahu të ka dhënë një të mirë dhe ti dëshiron që ajo të jetë e qëndrueshme dhe e vazhdueshme, falëndero sa më shumë për atë të mirë, sepse All’llahu i Lartësuar ka thënë në librin e Tij: “(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: “Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë”. (Sure “Ibràhim”, ajeti 7) Kur furnizimi me ushqim të vonohet, kërkoi All’llahu sa më shumë faljen e mëkateve, sepse All’llahu i Lartësuar ka thënë në librin e Tij: “e u thashë: “Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t’ju dërgojë shi të bollshëm, t’ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!” (Sure “Nùh”, ajetet 10-12)*

*O Sufjàn, kur të të hidhërojë ndonjë punë prej mbretit ose prej ndonjë tjetri, thuaj sa më shumë: “Là haule ue là kuv’vete il’là bil’lâh.” (“Nuk ka forcë e pushtet tjetër*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 78, f. 6 dhe f. 192.

përveç All'lahut.”<sup>1</sup>, sepse kjo frazë është çelësi i largimit të së keqes dhe një thesar prej thesareve të Xhennetit.”

### *Porosia e tij për Invàn El Basrij* <sup>2</sup>

Invàn El Basrij nuk ishte i barabartë me Màlik ibn Enesin dhe dëshironte të këshillohej me imam Sàdikun (Paqja qoftë mbi të!). Kur shkoi tek ai, imami i tha: “Unë jam burrë, që më kërkojnë, megjithëkëtë unë kam lutje dhikër në çdo orë të natës e të ditës, prandaj mos më pengo në dhikërat e mia dhe merr prej Màlikut, shko tek ai ashtu siç shkoje më parë si i barabartë me të.”

Invàni vazhdon: “M’u errën sytë. Hyra në xhaminë e të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) e përshëndeta atë me “Selam” dhe të nesërmen u ktheva në “Reudah”, ku fala dy rekate namaz dhe u luta: “Të lutem vetëm ty o All'lah, zbutë zemrën e Xha'ferit ndaj meje dhe bëj të mundur që edhe unë të kem pjesë nga dituria e tij, që unë të udhëzohem në rrugën Tënde të drejtë.”

Kur durimi im po sosej dhe zemra po më shtrëngohej, u nisa të shkoj tek Xha'feri. Arrita në portën e tij, kërkoja leje për të hyrë tek ai dhe më doli një shërbyes i tij, i cili më pyeti: “Ç'nevojë ke?”

I thashë: “Përshëndete me “Selam” të ndershmin!”

Por ai më tha: “Është duke u falur në vendin e vet ku fal namaz.”

---

<sup>1</sup> “Hilij’jetul Eulijài”, i Ebù Naimit, vëll. 3, f. 193.

<sup>2</sup> Ky nuk përmendet në librat e burrave tanë.

*U ula në anë të portës së tij, qëndrova fare pak derisa erdhi shërbyesi e më tha: “Hyrë me begatinë e All’llahut.”*

*Hyra, përshëndeta me “Selam” dhe Sádiku ma ktheu përshëndetjen me “Selam” dhe pastaj tha: “Ulu, All’llahu të faltë mëkatet!*

*U ula. Ai vari kokën mbi gjoks dhe, si e ngriti kokën, foli: “Baba i kujt je ti?”*

*I thashë: “Baba i Abdullahut.”*

*Ai tha: “All’llahu ta bëftë të qëndrueshëm epitetin tënd dhe e përputhtë atë me ty o Ebù Abdil’lah! Ç’kërkesë ke?”*

*Me vete thashë: “Sikur nga kjo vizita ime dhe përshëndetja ime “Selam” që i bëra, të mos kishte më gjë tjetër përveç kësaj lutjeje që ai bëri për mua, kjo do të ishte shumë, por ngriti kokën dhe tha: “Ç’kërkesë ke?”*

*Unë thashë: “I jam lutur All’llahut, që të zbusë zemrën tënde ndaj meje dhe të më bëjë pjesë prej diturisë tënde. Unë shpresoj se All’llahu i Lartësuar i është përgjigjur lutjes sime për të nderuarin në atë që unë i kërkoja.”*

*Por ai më tha: “O Ebù Abdil’lah, dituria nuk është me të mësuar, pasi ajo dritë bie në zemrën e atij që All’llahu i Lartësuar dëshiron ta udhëzojë në rrugën e drejtë. Nëse ti dëshiron dituri, së pari, kërko në veten tënde të vërtetën e qenies rob i All’llahut dhe kërkoje diturinë duke e vënë atë në përdorim, pastaj kuptoje All’llahun me mendjen tënde.”*

*Unë thashë: “O i nderuar!”*



*Por ai më tha: “Thuaj o Ebù Abdil-lah!”*

*Dhe unë thashë: “O Ebù Abdullah, ku qëndron e vërteta e të qenit rob i All’llahut?”*

*Ai tha: “Në tri gjëra: robi të mos shohë në veten e tij atë pasuri që i ka dhënë All’llahu, sepse robërit nuk kanë pasuri dhe ata e shohin pasurinë si pasuri të All’llahut, ata e shpenzojnë pasurinë aty ku i urdhëron All’llahu, sepse robi nuk bën sistemim të punëve, gjithçka, që merr, është vetëm në ato për të cilat e ka urdhëruar All’llahu i Lartësuar t’i bëjë, si dhe në ato punë për të cilat Ai e ka ndaluar. Kur robi nuk shikon në brendësi të vet pasurinë, që i ka dhënë All’llahu, ai e ka të rëndë të shpenzojë aty ku All’llahu e ka urdhëruar ta shpenzojë atë pasuri. Kur robi i vesh vetes sistemimin e punëve të tij dhe jo Sistemuesit të tij, i duken shumë të rënda pësimet që e godasin në këtë botë. Kur robi merret me punët që e ka urdhëruar All’llahu dhe heq dorë nga ato që Ai e ka ndaluar, atëherë ai nuk i kryen urdhrat e ndalimet për hipokrizi ndaj njerëzve e për krekosje para tyre. Kur All’llahu e respekton robin me këto të tria, atij i duken të ulëta: kjo botë, djalli dhe njerëzit. Ai nuk e kërkon këtë botë për të shtuar pasuri e për t’u krenuar; ai nuk kërkon madhështinë e lartësimin, që është ndër njerëzit, por nuk i le ditët e veta të shkojnë kot. Ja kjo është grada e parë e ruajtjes, ashtu siç ka thënë All’llahu i Lartësuar: “Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhështi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat.” (Sure “El Kasas”, ajeti 83)”*

*Invàni vazhdon, i thashë: “O Ebù Abdil’lah, më jep një porosi.”*

*Ai tha: “Të porosis për nëntë gjëra, që janë porosia ime për ata që dëshirojnë rrugën e All’llahut të Lartësuar. Unë i lutem All’llahut ta bëjë të mbarë edhe për ty, që t’i përdorësh ato; tre nga ato janë për ushtrimin e vetvetes, tre të tjera janë për butësinë dhe tre janë për diturinë, mbaji ato në mendje dhe ruhu të mos jesh i shkujdesur me ato.”*

*Invàni thotë: “Unë e vura zemrën time në dispozicion të tij dhe ai tha: “Ato, që janë për ushtrimin e vetvetes: ruhu të mos hash, kur nuk ke oreks, sepse kjo të sjell kokëtrashësi e mungesë të arsyes. Ha vetëm, kur ke uri. Kur të hash, ha vetëm hallall dhe thuaj “Bismil’lâhir-rr’rahmâni-rr’rahim”, ndërkaq ai citoi edhe hadithin e të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): “Njeriu nuk ka mbushur ndonjë enë më të keqe se barkun e tij.”*

*Nëse patjetër duhet, atëherë një të tretën për gjellët, një të tretën për pijen dhe një të tretën për shpirtin. Për butësinë: “Ai, që të thotë: “Nëse thua një, unë kam dëgjuar dhjetë.”, ti i thuaj atij: “Nëse unë them dhjetë, ti nuk ke dëgjuar një.”*

*Atij, që të shan, i thuaj: “Nëse i ke të vërteta fjalët që thua, lutju All’llahut që të më falë mua mëkatet. Nëse ti po gënjen me fjalët që thua, betohem në All’llah, unë do t’i lutem All’llahut të t’i falë mëkatet e tua.” Ai që të premtton me pabesi, ti premttoi këshillë e përkujdesje.*

*Ato që janë për diturinë: Pyet dijetarët për ato që nuk di, por bëj kujdes të mos i pyesësh ata me kryeneçësi*

e për t'i provuar. Ruhu shumë të mos punosh sipas mendimit tënd. Mbaj rezervë në të gjitha rrugët e mundshme, ik me vrap prej përgjigjeve ndaj çështjeve me probleme, që All'llahu të të largojë prej luanit dhe qafën tënde mos e bëj urë për njerëzit. Tani ngrehu e ik prej meje o Ebù Abdil-lah se unë të këshillova dhe mos bëj ngatërresa për mua se pastaj bëhesh pa vlerë, sepse unë jam koprrac për gjerat që janë të vyera në shpirtin tim. Paqe e shpëtim për atë që ndjek udhëzimin për në rrugën e drejtë.”<sup>1</sup>

### *Nga porositë e tij të çmuara*

Sa të vlefshme janë këshillat e tij dhe sa të çmuara janë porositë e tij! Ai nuk ka lënë fushë pa e sqaruar me këshilla dhe nuk ka lënë portë të orientimit pa hyrë. Ai herë na nxit për devotshmëri, për ruajtje e përpjekje, herë për sexhde e ruku të zgjatur dhe thotë: “Bëhuni thirrës të vetes jo me gjuhët tuaja, të jini shtytës përpara dhe mos jini të këqinj, që rrinë në fund.”<sup>2</sup>

Herë tjetër ai dëshiron prej nesh të lartësohemi mbi këto shkallë dhe të jemi prej atyre që falënderojnë, që bëjnë lutje e që mbështeten te All'llahu dhe thotë: “Ai që jep tre, nuk i ndalohen tre: ai që jep lutjen, atij i jepet përgjigjja për lutjen; ai, që jep falënderimin, atij i jepet shtimi; ai që jep mbështetjen në All'llahun, atij i është dhënë e mjaftueshmja. Pastaj tha: “A ke lexuar në librin e All'llahut të Lartësuar: “...kush mbështetet në All'llah, Ai i mjafton atij...” (Sure “Et Talàk, ajeti 3); dhe: “...nëse ju

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 1, f. 17 dhe f. 224.

<sup>2</sup>

“El

Kâfij”,

kapitulli:

“Ruajtja”.

*falënderoni, patjetër që Unë ua shtoj...” (Sure “Ibràhim”, ajeti 7); dhe: “...lutmëni Mua, Unë ju përgjigjem...” (Sure “Gàfir”, ajeti 60)”*

*Ai na orienton për pozitë më të lartë se kjo dhe thotë: “Nëse ndonjë prej jush dëshiron të mos i kërkojë All’llahut asgjë, Ai patjetër do t’i japë atij, prandaj të mos ndihet ngushtë nga të gjithë njerëzit e të mos shpresojë te askush përveçse te All’llahu dhe, kur All’llahu bën që kjo të jetë në zemrën e tij, atëherë ai nuk i kërkon All’llahut asnjë send, prandaj All’llahu patjetër që i jep atij.”<sup>1</sup>*

*Një herë tjetër na shtyn të kemi dëshirë për moralet e respektuara e për cilësitë e mira dhe na tregon kryeultësinë, duke na përshkruar disa nga format e saj: “Kryeultësi është që ti të jesh i kënaqur prej një kuvendi dhe prej një tjetri jo, të përshëndesësh me “Selam” këdo që takon, të heqësh dorë nga polemika, edhe kur ke të drejtë dhe të mos dëshirosh të lavdërohesh për devotshmërinë.”<sup>2</sup>*

*Ai përmend disa cilësi të larta, me të cilat njeriu zbukurohet e ngjitet në grada të larta dhe u thotë shokëve të tij: “Dëgjoni prej meje një fjalë, e cila është më e mirë se të ziheni se çfarë ngjyre ishin qimet. Asnjëri prej jush nuk flet për atë që nuk i intereson dhe le të lërë edhe fjalët e shumta për atë që i intereson, derisa të gjejë vendin edhe për atë. Ka të ngjarë se ai e thotë fjalën jo aty ku duhet dhe si duhet, bën fajtor veten. Asnjëri prej jush të mos i shfaqë hipokrizi ndonjë naivi e ndonjë njeriu të butë. Ai, që shfaq hipokrizi ndaj një të buti, e ka larguar atë sa nuk bëhet më larg, ai, që shfaq hipokrizi ndaj një naivi, atë*

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Mos pasja nevojë për njerëzit”.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Kryeultësia”.

*e ka rrëzuar për tokë. Përmendeni vëllain tuaj kur nuk është me ju me fjalët më të mira që dëshironi të përmendeni vetë në mungesën tuaj dhe bëni punë të atilla, që ju e dini se ato shpërblehen me të mira.”<sup>1</sup>*

*Ai përshkruan për ne moralin e mirë dhe na shtyn të garojmë e të vetëpajisemi me moral: “Kur përzihesh me njerëz, nëse ke mundësi, mos u përziej me asnjë njeri, përveç atëherë kur dora jote është sipër tij. Kur ke mundësi t’i japësh, atëherë bëje, sepse te njeriu ka disa mangësi në adhurim. Ndër mangësitë është morali i mirë dhe All’llahu bën që ai, me moralin e tij të mirë, të arrijë gradën e agjëruesit e gradën e atij që fal namaz.”<sup>2</sup>*

*Sa shumë nxit për t’u zbukuruar me veshjen e moralit të mirë e me të ngjashmin me të, bujarinë. Për këtë le të shikojmë në këtë fjalë të tij: “Me të vërtetë, All’llahu është i kënaqur që Islami është feja juaj, atëherë përmirësojeni shoqërimin e tij me bujari e me moral të mirë.”<sup>3</sup>*

*Me gojën e Mufeddal ibn Umer El Xheafij ai na porosit për gjashtë cilësi, që nuk peshohen me vlerë, kur i tha atij: “Të porosis për gjashtë cilësi dhe këto t’ia kumtosh pasuesve të mi.”*

*Mufed’dàli pyeti: “Cilat janë ato o zotëria im?”*

*Imam Sadiku iu përgjigj: “Çuarja në vend e emanetit, të jesh i kënaqur për vëllanë tënd me atë që kënaqesh edhe ti dhe dije se punët kanë një fund, prandaj bëj shumë*

---

<sup>1</sup> “Kuvendet e shejhut Tùsit”, kuvendi 2-të.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Moralin e mirë”.

<sup>3</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Frenimi i zemërimit” dhe kapitulli: “Moralet e larta”.

*kujdes nga përfundimi. Punët kanë të papritura, prandaj të jesh i kujdesshëm e të ruhesh. Ruhë shumë nga ngjitja e lehtë në mal, kur rrëpira është e fortë. Mos i premtë vëllait tënd, kur mbajtja e premtimit nuk është në dorën tënde.”<sup>1</sup>*

*Pash Zotin tënd, më thuaj mua, si janë këto cilësi?! Sa nga ato kemi ne që të rreshtohemi në radhët e engjëjve, që janë afër All’llahut? Ku është ai që të na dëgjojë?”*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “Mos bëj shaka, se të largohet drita jote; mos gënje, se të largohet autoriteti yt, ruhu shumë nga dy vese: nga ngushtësia e përtacia. Kur ti tregohesh i ngushtë, nuk duron dot të vërtetën dhe, nëse je përtac, nuk do të kryesh detyrën.*

*Mesijhu (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) thoshte: “Ai që shqetësohet shumë e nuk bën punë, ka dhembje në trup dhe e ka keqësuar moralin e tij. Ai, që flet shumë, ka mundur veten dhe ka shtuar sëmundjen e vet. Ai, që gënjen shumë, atij i largohet dinjiteti dhe burrit, që nuk ka turp, i largohet burrëria.”<sup>2</sup>*

*Nga porositë për shokët është edhe fjala e tij: “Shkëmbeni vizita me njëri-tjetrit, sepse këto i japin gjallëri zemrave tuaja. Përmendni hadithet tona, sepse ato ju zbusin ndaj njëri-tjetrit. Nëse ju veproni me to, jeni orientuar në rrugën e drejtë dhe keni shpëtuar; nëse ju i lini ato, do të vazhdoni të shkatërroheni, prandaj veproni me ato dhe unë jam përkujdesës për shpëtimin tuaj.”<sup>3</sup>*

*Unë them: ‘Është e vërtetë se orientimi në rrugën e drejtë dhe shpëtimi qëndrojnë në veprimin sipas fjalës së*

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 78, f. 94 dhe f. 250.

<sup>2</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 78, f. 26 dhe f. 199.

<sup>3</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Tedhâkirul Ikhvân”.

tyre, kurse rruga e humbjes e shkatërrimi vijnë nga lënia e këshillave të tyre, sepse ata nuk kanë folur për ndonjë rrugë të orientimit në të vërtetën pa e treguar atë, gjithashtu nuk kanë shpjeguar ndonjëherë nga rrugët e humbjes pa ndaluar ecjen në atë rrugë.’

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Bëjeni punën për hir të All’llahut<sup>1</sup> dhe mos e bëni për njerëzit, sepse ajo, që është për All’llahun, është për All’llahun, ajo që është për njerëzit, nuk ngjitet lart në qiell. Mos krijoni armiqësi në fenë tuaj, sepse armiqësia sëmur zemrën. All’llahu i Lartësuar i ka thënë Profetit të (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): “Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar.” (Sure “El Kasas”, ajeti 56); dhe: “Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë, ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?!” (Sure “Jûnus”, ajeti 99); lëri njerëzit, sepse ata kanë marrë prej njerëzve, kurse ju keni marrë prej të Dërguarit të All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe prej Aliut (Paqja qoftë mbi të!), prandaj nuk ka barazim. Unë kam dëgjuar babain tim të thotë: “Kur All’llahu e ka shkruar për robin, që ta fusë në këtë punë, ai është më i shpejtë se shpendi për në folenë e vet.”<sup>2</sup>

Unë them: ‘Sa kanë qenë polemikat e ndërtuara mbi baza të sakta? Njëpërmjet bazave ndahet çështja e njërës nga të dyja palët, por nuk kthehet në atë që ishte për shkak të qartësisë që ai ka në të drejtën dhe falë kësaj

<sup>1</sup> Mendoj me këtë ai ka qëllim parësinë e Ehli Bejtit.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Terku du’ài n’nàs”.

*qartësie rrezaton e vërteta. Sa ateistë e mohues kanë përqafuar Islamin me pak argumente dhe për shkaqe fare të zakonshme?*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) dëshironte që shokët e tij të kishin një vendbanim të përhershëm dhe punën ta shikonin me largpamësi. Për këtë thoshte: “Duronin në këtë botë, sepse kjo është vetëm një për një orë, për atë që ka kaluar, për atë ti nuk gjen as dhembje e as gëzim, kurse për atë që nuk ka ardhur, ti nuk e di si është. Në të vërtetë, ajo është ora jote, në të cilën ti je brenda saj. Prandaj duro dhe mos kundërshto All’llahun.”<sup>1</sup>*

*Unë them: Kjo fjalë përshkruan për ty gjendjen e njeriut në këtë jetë, sepse e kaluara harrohet, hidhërim ose gëzim qoftë, kurse e ardhmja është e panjohur dhe njeriu është bir i kohës së tij. Durimi për një orë është diçka e lehtë dhe është e barabartë qoftë kur është bindje ndaj All’llahut dhe njeriu e plotëson, qoftë kur është mëkat dhe njeriu largohet prej saj. Në çdo orë njeriu është për atë orë, ashtu siç thotë poeti në fjalën e tij:*

*“Ç’kaloi humbi dhe e shpresuara nuk është pranë.*

*Për ty është ora në të cilën ti je brenda saj.”*

*Imam Sadiku ka thënë: “Bëje zemrën<sup>2</sup> tënde të afërm të mirë dhe një djalë që mban lidhjet me të afërmit; bëjë punën tënde baba, që ti e ndjek atë dhe veten tënde bëje*

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 78, f. 311.

<sup>2</sup> Mendoj se këtu me “zemër”, ka qëllim mendjen, sepse kjo fjalë ka ardhur shumë shpesh në hadithet.



*armik, që ta luftosh; bëje pasurinë tënde të zhveshur, që ta kthesh atë.<sup>1</sup>*

*Nëse ke fuqi të mos njohësh, bëje. Për detyrimet, që ke, të mos të të lavdërojnë njerëzit; për detyrimet që ke, të jesh i poshtëruar tek njerëzit kur je i lavdëruar tek All'llahu.”<sup>2</sup>*

*Duke nxitur për lutje ai thoshte: “Lutja spraps vendimin, derisa ai nuk është nënshkruar, prandaj bëj sa më shumë lutje, sepse lutja është çelësi i çdo mëshire dhe sukses për çdo nevojë. Ato, që janë tek All'llahu i Lartësuar, arrihen vetëm me lutje, pasi porta në të cilën trokitet shpesh, do të hapet për atë që troket.”<sup>3</sup>*

*Sa e nderuar është fjala që ai ka thënë: “Mos atakoni në të metat e atij që vjen tek ti me dashamirësi dhe mos qëndroni në një të keqe, që e ul atë, sepse kjo nuk është nga moralet e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe as prej moraleve të miqve të All'llahut të Lartësuar.”<sup>4</sup>*

*Sa fjalë të dobishme ka thënë imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!): “Shikoni mirë në atë që nuk e dini dhe këshilloni veten. Luftoni në kërkim të asaj që për ju nuk ka pengim të mos e dini, sepse për fenë e All'llahut ka kolona dhe atij, që nuk i di ato, nuk i sjell dobi lodhja e madhe në kërkim të shfaqjes së adhurimit të tij, as nuk dëmtohet ai, që i njeh ato, kur afrohet me to me mirë ekonomizim. Nuk*

<sup>1</sup> “El -Bihàru fîj ahvâlihî”, vëll. 11.

<sup>2</sup> “Bihàrul Anuâr”, vëll. 78, f. 95 dhe f. 224.

<sup>3</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Lutja spraps pësimin e vendimin”.

<sup>4</sup> “Reudatul Kâfij”.

*ka rrugë të drejtë për një njeri pa ndihmën e All'llahut të Lartësuar.*<sup>1</sup>

### *Shoqërimi*

*Ishte e bukur dhe dobisjellëse që ne i mblodhëm porositë e tij sipas temave. Po ju japim mundësinë të shijoni bukurinë e porositve të tij. Po fillojmë me shoqërimin.*

*Nuk ka dyshim se njeriu, nga instinkti i tij, kërkon të ketë kontakt e të kopjojë bashkëkohësit e moshatarët e vet. Nëse ata janë të mirë, ai merr prej atyre të mirat që kanë. Në qoftë se ata janë të këqij, patjetër që do ndikohet nga të këqijat e tyre, çka ndodh shpesh me shumicën e njerëzve. Për të gjitha këto imami ynë i drejtohet me këshillën e tij të gjithë njerëzve: “Bëni kujdes, mos u shoqëroni me mbretërit e me ata që janë të dhënë pas kësaj bote, sepse në këtë lloj shoqërimi është ikja e fesë suaj dhe pasoja për ju është hipokrizia, e cila është një sëmundje e keqe, që nuk ka shërim. Ajo sjell zemërngurtësi dhe u merr nënshtrimin ndaj All'llahut.*

*Kini detyrë të rrini me njerëz si ju<sup>2</sup>, me njerëzit normalë, sepse tek ata ju do të gjeni burimet e diamanteve; ruhuni shumë të mos i zgjasni duart te gjërat, që janë në dorën e atyre që janë të dhënë pas kësaj bote, sepse ai, që i zgjat duart në të tilla gjëra, për atë do të zgjatet dëshpërimi, nuk i shërohet zemërimi, i shikon të vogla mirësitë e All'llahut që janë tek ai dhe e falënderon fare pak All'llahun. Shiko në atë që është më poshtë se ti, sepse*

<sup>1</sup> “El Irshâd” i shejh Mufijdit”, në lidhje me gjendjet, f. 283.

<sup>2</sup> Mendoj se me fjalën “njerëz si ju” ai ka qëllim njerëzit që nuk i përkasin shtresave të larta.

*kështu do të jesh nga ata që e falënderojnë All'llahun për mirësitë e dhëna dhe do të jesh i meritueshëm për më shumë mirësi dhe, për bujarinë e Tij, do të jesh i qetë.”<sup>1</sup>*

#### *Garimi në punë të mira*

*Përgatitja e punës së mirë është një rast që nuk duhet humbur, sepse ka të ngjarë që, kur humbja është e madhe, përbën premisa për pendim, për faktin se të gjitha punët janë raste që kalojnë dhe nuk është në dorën tonë të rikthejmë rastet e humbura, sepse janë mijëra shkaqe të përgatitura për kushtet e punës dhe shumica e tyre janë jashtë fuqisë e vullnetit tonë. Prandaj Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) nxit që të shfrytëzohen këto raste kalimtare dhe thotë: “Kur dëshiron të bësh diçka të mirë, mos e vono atë, sepse All'llahu i Lartësuar, kur sheh robin të bëjë një punë në bindje të Tij, thotë: “Betohem në madhësinë Time, pas kësaj Unë kurrë nuk do të të ndëshkoj ty!”*

*Ka shumë thënie të ngjashme për këtë çështje.*

*Gjithashtu, ai ka nxitur për garim në punë të mira, kur njeriu ka vendosmërinë për ta bërë atë punë dhe ka ndaluar këmbënguljen kur puna është mëkat; dhe ka thënë: “Kur dëshiron të bësh një të keqe, mos e bëj atë menjëherë, pasi All'llahu, kur e sheh robin në punë mëkati, thotë: “Betohem në madhësinë Time, pas kësaj Unë kurrë nuk do të ta fal mëkatin tënd.”<sup>2</sup>*

*Edhe porositë e tij të ngjashme nuk mund të përmbliidhen në disa radhë.*

#### *Dituria në rregullat e ligjit të fesë*

---

<sup>1</sup> Libri i Zejd En'neresij'jit është nga librat fundamentalë, që merren në konsideratë, por që akoma është në dorëshkrim.

<sup>2</sup> “Vesàilu Shi'ah”, vëll. 1, f. 18.

*Dituria e rregullave të ligjit të fesë është rrugë për adhurimin e të Lartit. Me këtë dituri ruhet sistemi i fesë islame dhe vetë ligjet e saj. Madje feja islame qëndron dhe vazhdon me dijetarët e saj në fushën e ligjit të fesë dhe me dispozitat që ata nxjerrin prej këtij ligji. Për të gjitha këto prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) janë transmetuar shumë hadithe për mësimin e rregullave të ligjit të fesë. Edhe pse për këtë çështje është folur shkurt më sipër, tani do të sjellim edhe hadithe të tjera që flasin për diturinë e rregullave të ligjit të fesë.*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ai, që punon pa fuqinë e kuptimit, është si ai që shkon pas mirazhit në një tokë të thatë, sa më shpejt të ecë ai, aq më shumë i largohet.”*

*Gjithashtu, ka thënë: “Nuk ka të mirë në atë shok prej nesh, që nuk është i ditur në rregullat e ligjit të fesë. Njerëzit nuk do të jenë në gjendje të mirë, derisa të pyesin e të bëhen të ditur në rregullat e ligjit të fesë.<sup>1</sup> Kur All’llahu i do të mirën një robi, e bën atë të ditur në rregullat e ligjit të fesë. Plotësimi dhe i gjithë plotësimi, qëndron në diturinë e rregullave të ligjit të fesë, në durimin ndaj pësimeve dhe në vlerësimin e mjeteve të jetesës.”<sup>2</sup>*

*Për rëndësinë e madhe të diturisë, për rregullat e ligjit të fesë dhe efektin që ka kjo dituri në fenë islame, për pozitën e dijetarit në fushën e ligjit të fesë dhe për vdekjen e tij imam Sadiku ka thënë: “Nuk ka vdekje më të dashur*

---

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 1. f. 61 dhe f. 221.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Cilësitë e mirësia e diturisë dhe përparësia e dijetarëve”.

*për djallin, se kur vdes një dijetar i rregullave të ligjit të fesë.”*

*Gjithashtu, prej tij transmetohet: “Kur vdes besimtari i ditur në rregullat e ligjit të fesë, në Islam ka ndodhur një e çarë që nuk e mbyll asnjë send.”<sup>1</sup>*

#### *Mirësitë dhe falënderimi për mirësitë*

*Nga porositë e tij për mirësitë, ruajtjen e qëndrueshmërinë e tyre, tregon fjala e imam Sádikut: “Mirëtrajtoni fqinjësinë e mirësive dhe bëni kujdes, që ato të mos kalojnë nga ju te të tjerët, sepse mirësitë kurrë nuk largohen prej ndonjërit. Ato përsëri mund të kthehen.”*

*Prijësi i Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) thoshte: “Ndodh që një send largohet, por ai përsëri del përpara.”<sup>2</sup>*

*Ai i ka mësuar ata si të ruajnë mirësitë dhe i ka thënë Sedijr Es’sajrefij’jit: “Sa më shumë të shtohet pasuria e një burri, aq më i rëndësishëm bëhet argumenti i All’llahut të Lartësuar kundër tij, prandaj, nëse kini mundësi të sprapsni këtë argument, veproni.”*

*Por ai i tha: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut po me se?”*

*Imami i tha: “Duke i lehtësuar vëllezërve tuaj vështirësitë e jetës. Të kini fqinjësi të mirë me pasurinë, o Sedijr. Falënderojeni atë që u bën mirësi, bëni mirësi atij që ju falënderon dhe, nëse ju do të jini të këtillë, e keni merituar të keni më shumë prej All’llahut; gjithashtu të jini*

---

<sup>1</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 1. f. 56 dhe f. 220.

<sup>2</sup> “Kuvendet e shejhut Tûsit”, kuvendi i 9-të.

*të sinqertë midis jush. Pastaj lexoi ajetin e Kur'ânit: "...nëse falënderoni, do t'ua shtojmë..." (Sure "Ibrâhim", ajeti 7) <sup>1</sup>*

*Nga rrugët e falënderimit është që robi të shpallë llojet e shumta të mirësive, që All'llahu i Lartësuar i ka dhënë atij. Në këtë kontekst, imami orientues për në rrugën e drejtë, Ebù Abdil'lahi na tërheq vëmendjen për këtë veti të vyer: "All'llahu e do të bukurën dhe vetëzbukurimin. Ai urren vështirësitë dhe paraqitjen e rreme të vështirësive. All'llahu i Lartësuar, kur i jep një mirësi robit, dëshiron të shohë gjurmët e asaj mirësie."*

*I është thënë: "Po si është kjo?"*

*Ai (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: "Pastron rrobën e vet, parfumohet, fshin oborrin e shtëpisë, rrethon me avlli shtëpinë e vet, madje edhe lëkurëpunuesit, para perëndimit të diellit, e ka mohuar varfërinë dhe i është shtuar furnizimi me ushqim."<sup>2</sup>*

*Këto ishin disa nga rrugët e shfaqjes së falënderimit dhe shpalljes së mirësive, pasi kështu veprohet në përputhje me fjalën e të Lartit: "dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!" (Sure "Ed Duhâ", ajeti 11)"*

*Me këta shembuj e me shembuj të tjerë të ngjashëm imami ka falënderuar për mirësitë.*

### *Mirëshoqërimi*

*Mirëshoqërimi nuk është një urdhër, që të vjen për të dhënë më shumë, pa e nënshtruar e pa e frenuar vrellin e*

---

<sup>1</sup> "Kuvendet e shejhut Tûsit", kuvendi i 11-të.

<sup>2</sup> "Kuvendet e shejhut Tûsit", kuvendi i 10-të.

*vetes, sepse ajo, që kërkohet më shumë prej teje, është që, për të mirën e shokut tënd, të heqësh dorë nga dëshirat e interesat e tua, madje t'i japësh përparësi shokut në disa gjëra që ti ke. Për këtë çështje Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Imponoi vetes mirëshoqërimin e atij që ke pranë."*

*Duke qenë se mirëshoqërimi ka shumë rrugë, patjetër që njeriu mund të mos e dijë se cila është rruga më e mirë për t'u ndjekur. Ai na ka mësuar si të mirëshoqërojmë personin me të cilin jemi duke u shoqëruar.*

*Për këtë, imam Sadiku ka thënë: "Përmirëso moralin tënd, shtrëngoje gjuhën tënde, frenoje zemërimin tënd, pakësoi gabimet e tua, mbille në gjuhë kërkimin e faljes që shpirti yt të bëhet bujar."<sup>1</sup>*

*Ai ka dashur që ne ta bëjmë mirëshoqërimin një simbol të përhershëm me këdo që shoqërohemi. Për këtë ka thënë: "O ndjekës të familjes së Muhammedit, nuk është prej nesh ai që nuk zotëron veten në çaste zemërimi, as ai që nuk mirëshoqëron personin në shoqërimin e të cilit është."<sup>2</sup>*

*Shembuj të tillë janë të shumtë.*

*Ai ka vënë detyrë përqendrimin në përzgjedhjen e më të mirës për shokun edhe pas ndarjes me të, si dhe njohjen e gjendjes e të nevojave, që mund të ketë shoku. Për këtë ai i ka thënë Mufeddal ibn Umerit, kur ai hyri tek*

---

<sup>1</sup> "El Vesàil". vëll. 8, f. 2 dhe f. 402.

<sup>2</sup> I njëjti burim, vëll. 8, f. 3 dhe f. 402.

ai, pasi ishte kthyer nga një udhëtim. Në fillim e pyeti:  
“Kush të shoqëroi?”

Ai i tha: “Njëri prej vëllezërve të mi.”

Ai i tha: “Ç’bëri ai?”

Ai tha: “Që kur hyri, unë nuk e dita pozitën e tij.”

Atëherë ai i tha: “A nuk e di ti se kush shoqërohet me një besimtar, qoftë edhe dyzet hapa, Ditën e Gjykimit All’llahu do ta pyesë se me kë është shoqëruar?”<sup>1</sup>

### Shoqërimi në udhëtim

Për udhëtimin ka një edukatë të veçantë, që nuk ngjan me edukatën kur njeriu është në vendbanimin e tij. Në shikimin e parë ti mund të gesh se dorëgjërësia në shpenzime e në dhënien e bukës për shokët e tu është pjesë e burrërisë, bujarisë, nderit, vullnetit të lartë, madje edhe e mirëshoqërimit. Por imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) e ndalon këtë edukatë gjatë udhëtimit, sepse është një detyrim për shokun me atë që ai nuk ka mundësi ta mbajë, nëse me këtë lloj bujarie ka qëllim të garojë me shokun, ose edhe ta fyejë atë, prandaj ai ka të drejtë të ndalohet nga shoqërimi. Nuk është sjellje e mirë që gjatë shoqërimit të poshtërosh shokun tënd. Për këtë ai i thotë Shihàb ibn Abd Rab’bes<sup>2</sup>: “Mos e bëj o Shihàb, nëse ti e shtron dhe ata e shtrojnë, ua ke hedhur atyre në fytyrë. Nëse ata nuk hanë, përsëri i ke poshtëruar. Prandaj shoqërohu me të ngjashëm me veten.

<sup>1</sup> “El Vesàil”. vëll. 8, f. 8 dhe f. 403.

<sup>2</sup> El Kùfij, është prej shokëve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) dhe është nga transmetuesit e tij të besueshëm. Për atë kanë transmetuar të besueshëm si Ibn Ebin Umejri.



*Këto fjalë qenë pasi Shihâbi i tha imamit: “Ti e more vesh gjendjen time dhe sa dorëgjërë isha unë me vëllezërit e mi. Unë do të shoqëroj një grup prej tyre në rrugën për në Mekkë dhe ndaj tyre do të jem shumë dorëgjërë.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Ashtu siç e poshtëron njeriu tjetrin, kur dikush i shton shpenzimet për atë, po ashtu poshtërohet edhe kur dikush i jep atij më shumë.*

*Imami, ashtu siç ndaloi në të parën shoqërimin me të pafuqishmin nga gjendja, ashtu ndaloi në të dytën shoqërimin me më të fuqishmin nga ana e pasurisë dhe i tha Ebù Besijrit: “Ai, që nuk dëshiron të poshtërojë veten, le të dalë në udhëtim me atë që është si ai vetë.”*

*Këtë fjalë imami e tha pasi Ebù Besijri e pyeti për një njeri që udhëton së bashku me njerëz që janë në gjendje të mirë, në një kohë që ai ka më pak nga të gjithë ata. Ata do t’i japin, në një kohë që ai nuk ka mundësi t’u japë ashtu siç i dhanë ata.*

*Imami i ka thënë Hish’shà ibn El Hakemit, kur ai e ka pyetur për të njëjtën çështje: “Shoqërohu me të ngjashmit me ty.”<sup>2</sup>*

*Në të dy rastet imami, bosht të çështjes, ka bërë shoqërimin me të ngjashmit, me qëllim që të mos poshtërojë tjetrin ose veten. Kjo është njëra ndër urtësitë e larta dhe njëra nga dëshirat e tij në pajisjen e njerëzve me moralin e bukur.*

---

<sup>1</sup> “El Vesâil”, kapitulli: “Është veprim i lavdëruar që udhëtari të shoqërohet me një të ngjashëm si vetja” vëll. 8, f. 1 dhe f. 302.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, vëll. 8, f. 5 dhe f. 303.

### *Fqinjësia e mirë*

*Nga edukata e njeriut dhe nga rëndësia e mendjes së tij është edhe fqinjësia e mirë, që në fakt është njëra nga moralet e mira, për të cilin bën thirrje mendja. Arabët krenoheshin me fqinjin dhe luftonin për të me sa kishin mundësi. Prandaj edhe Islami e pohoi këtë veti bujare. Madje e vlerësoi akoma më shumë dhe nxiti në këtë drejtim. Në të të njëjtën kohë edhe porositë e Profetit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) kanë qenë të vazhdueshme për fqinjësinë e mirë, madje aq të theksuara kanë qenë ato porosi, sa Prijësi i Besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "I Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) gjithnjë na porosiste për fqinjin, aq sa ne kujtuam se na e bëri trashëgimtar."*

*Në këtë avlëmend kanë endur edhe djemtë e tij dhe i drejti i tyre, imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!). Në një rën nga porositë e tij ka thënë: "Kini detyrë të jini të devotshëm!", derisa ka arritur në frazat: "Moral të mirë e fqinjësi të mirë."<sup>1</sup>*

*Kjo porosi është përsëritur prej tij në disa raste, derisa ata, që e kanë lënë, janë turpëruar. Imam Sadiku ka thënë: "A nuk turpërohet ndonjë burrë prej jush, që fqinji i tij të njohë të drejtën e tij dhe ai të mos njohë të drejtën e fqinjit të vet?"<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> "El Vesâil", kapitulli: "Është detyrë shoqërimi i njerëzve", vëll. 11, f. 8 dhe f. 156.

<sup>2</sup> Burimi i mësipërm, vëll. 8, f. 5 fhr f. 399.

*Transmetuesit kanë përcjellë një hadith edhe për atë që nuk manifeston fqinjësi të mirë: “Nuk është prej nesh ai që nuk manifeston fqinjësi të mirë ndaj fqinjit të vet.”<sup>1</sup>*

### *Pranimi i këshillës*

*Njihet nga anon balanca e mendjes së të riut, sa e dëgjon ai këshillën dhe sa vepron sipas fjalës së këshilluesit. Kurse injorantin e rrëmben kryeneçësia, kështu që jo vetëm nuk e dëgjon këshillën, por, sipas mendjes së tij, thotë se këshilluesi do t'i zbulojë atij të metat. Dihet se injoranti nuk mund të pranojë se ai është me të meta, kështu ai humb rastin të zbulojë të metat, në një kohë që këshilluesi e nxit që t'i mbulojë duke i përmirësuar ato. Prandaj i pastërti nga të metat, imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), nga dëshira për të na mësuar, ka thënë: “Më i dashuri nga vëllezërit e mi, për mua, është ai që më tregon të metat e mia.”<sup>2</sup>*

*Unë them: ‘Si të mos jetë ai më i dashuri prej atyre, kur ai dëshiron të zhvishet nga poshtërsitë e të stoliset me virtyte? E mira e kësaj vetie prej vëllait e bën zbulimin e të metave dhuratë, që është qëllimi më i lartë, kur ai i nxit vëllezërit që ata të kenë dëshirë të stolisen me këtë veti e ta shkëmbejnë atë ndërmjet njëri-tjetrit.’*

*Pranimin e këshillës për besimtarin, imam Sadiku e ka bërë një urdhër të domosdoshëm. Për këtë ai ka thënë: “Besimtari ka nevojë të këto tri cilësi: mbarësinë prej*

---

<sup>1</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Mirëshoqërimi është veprim i preferuar”, vëll. 8, f. 5 dhe f. 489.

<sup>2</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Pranimi i këshillës është veprim i preferuar”, vëll. 8, f. 2 dhe f. 413.

*All'llahut të Lartësuar, të jetë këshillues i vetes dhe të pranojë këshillën e atij që e këshillon.”<sup>1</sup>*

### *Konsultimi*

*Për atë, që konsultohet me ata që dinë të vështrojnë në thellësi të punëve, bëhen të qarta hyrjet e daljet, zbulohen rrugët e suksesit dhe mënjanohet nga vendet ku mund të shkasë në gabime. Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!), duke zbuluar për ne këtë të vërtetë, thotë: “Kurrë nuk është shkatërruar njeriu prej konsultimit.”<sup>2</sup>*

*Ai na orienton në kërkim të një konsulenti për çështje të paqarta, që mund të na vijnë dhe thotë: “Kur ndonjëri prej jush vihet para problemeve dhe nuk di si të veprojë, për atë nuk asnjë pengim të konsultohet me një burrë të mençur, fetar dhe që ruhet nga veprimet e nga gjërat e ndaluara.”<sup>3</sup>*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka përshkruar kushtet e konsultimit e të konsulentit: “Konsultimi nuk mund të jetë jashtë kufijve të vet dhe vetëm prej atij që i njeh kufijtë e konsultimit, ndryshe dëmi i konsultimit do të jetë për të konsultuarin më i rëndë se dobia e tij. Kushti i parë, që kërkohet prej konsultuesit, është që ai të jetë njeri i mençur; i dytë, të jetë i lirë dhe fetar; i tretë, të jetë i drejtë dhe vëllazëror; i katërti, ta informosh atë për të fshehtën tënde deri në atë shkallë sa ai ta dijë*

<sup>1</sup> “El Vesàil”, vëll. 8, f. 3 dhe f. 413.

<sup>2</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Konsultimi me mendimtarët është veprim i preferuar”, vëll. 8, f. 4 dhe f. 424.

<sup>3</sup> I njëjti burim, kapitulli: “Është veprim i preferuar konsultimi me një të ruajtur, të mençur dhe që rri larg veprimeve të ndaluara”, vëll. 8, f. 7 dhe f. 426.

*informacionin, ashtu siç di ti për veten tënde. Pastaj ai e ruan sekretin tënd e nuk e zbulon atë. Kur konsulenti është i mençur, ti do të përfitosh nga konsulenca e tij.*

*Nëse ai është i lirë e fetar, përpiqet të të këshillojë, kur ai është njeri i drejtë e vëllazëror, e mban të mbyllur sekretin tënd kur ti ia tregon atij, dhe kur ti ia tregon atij sekretin tënd dhe ai e di atë ashtu siç e di edhe ti, konsultimi është plotësuar dhe këshilla është përsosur.”<sup>1</sup>*

*Imam Sadiku ka paralajmëruar të mos kundërshtohet konsulenti, kur ai i plotëson të gjitha kushtet: “Konsultohu me një burrë të mençur, që ruhet nga veprimet e nga gjërat e ndaluara, sepse ai të urdhëron vetëm në të mirën, por bëj kujdes të mos e kundërshtosh atë, sepse kundërshtimi i të ruajturit nga të ndaluarat e të mençurit është ngatërresë në punët e fesë e në punët e kësaj bote.”<sup>2</sup>*

*Imami e ka detyruar konsulentin të këshillojë dhe e ka paralajmëruar atë nga dhënia e këshillës, në përshtatje me situatën, herë po e herë jo ose edhe duke mos e këshilluar fare. Për këtë ka thënë: “Atij që i kërkon konsulencë vëllai i tij dhe ai nuk e këshillon atë, duke i dhënë, qoftë edhe një mendim të thjeshtë, All’llahu i Lartësuar ia zhvesh atij mendimin.”<sup>3</sup>*

*Këto ishin disa nga detyrimet e konsulentit e të atij që kërkon konsulentë. Ne po mjaftohemi vetëm me kaq, pa sjellë më shumë prej fjalëve të tij për këtë çështje.*

<sup>1</sup> “El Vesàil”, vëll. 8, f. 8 dhe f. 426.

<sup>2</sup> “El Vesàil”, vëll. 8, f. 5 dhe f. 426.

<sup>3</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Detyra e këshillimit të atij që kërkon konsulencë”, vëll. 8, f. 2 dhe f. 427.

### *Sa më shumë vëllezër!*

*Njeriu gjen shumë ndihmë nga vëllezërit e vet, sepse vëllai është ndihmë në pësimet, zbutës në vështirësi, shok i dashur në raste barbarie, konsulent në raste hutimi, vënës në rrugën e drejtë nga rrëzimet, ruajtës në raste përgojimi e të tjera dobi, që lapsi e ka të pamundur t'i shkruajë. Për të gjitha këto, imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi të!), duke treguar vlerën e madhe të tyre, thotë: “Në këtë botë bëj sa më shumë miq, sepse ata të sjellin dobi në këtë botë e në botën tjetër. Në këtë botë ata të kryejnë nevojat, kurse në botën tjetër, banorët e Xhehen'nemit thonë: “Për ne nuk ka kush të ndërmjetësojë dhe ne nuk kemi as ndonjë mik të ngushtë.”<sup>1</sup>*

*Mbase qëllimi i imam Sâdikut për dobinë e miqësisë në botën tjetër, qëndron në atë se miku, për hir të All'llahut, është i mençur e me fe, prandaj ai nuk e drejton shokun në ndonjë rrugë tjetër përveçse aty ku është interesi i tij për të dyja botët dhe e shpëton atë më udhëzimin e me këshillat prej zjarrit. A ka dobi më të madhe se kjo në botën tjetër?*

*Ose ai mund të përfitojë prej lutjes së tjetrit, ashtu siç ka thënë në një hadith tjetër: “Kërkoni të kini sa më shumë vëllezër, sepse për çdo besimtar ka një lutje të pranueshme.”*

*Ose miku mund të ndërmjetësojë, ashtu siç ka thënë imami (Paqja qoftë mbi të!): “Kërkoni të kini sa më shumë vëllezër, sepse për çdo besimtar ka një ndërmjetësim. Sa më shumë vëllazëri me besimtarët, sepse për ata tek All'llahu ka një dorë dhe Ai Ditën e Gjykimit i shpërblen*

<sup>1</sup> *El Vesâil*, kapitulli: “Përfitimi nga vëllezërit e miqtë”, vëll. 8, f. 5 dhe f. 407.

*ata me atë dorë.<sup>1</sup> Madje vëllai besimtar ka meritën të ketë të gjitha këto ëmbëlsi.*

### *Durimi ndaj vëllezërve*

*Pagabueshmëria nuk është tek të gjithë njerëzit. A ka njeri, që nuk gabon, që nuk është i shkujdesur e nuk harron? Prandaj është e pamundur të fitosh një mik pa asnjë të metë ose të kesh një shok, që të mos ketë bërë ndonjë gafë të rëndë. Prandaj ai, që dëshiron të ketë sa më shumë miq, patjetër nuk duhet të shikojë të metat e tyre dhe të mos i vërë re punët e tyre të këqija. Nisur nga këto imam Sadiku ka thënë: “Ku je ti me të gjitha këto me vëllain tënd? Cilët janë burrat e shpejtë?”<sup>2</sup> dhe përsëri i është përgjigjur pyetjeve të bëra prej tij: “Ai, që nuk vëllazërohet me atë që ka të meta, i ka të pakët miqtë.”<sup>3</sup>*

*Kur burri dëshiron dashuri të qëndrueshme prej vëllait të vet, të mos i bëjë atij pyetje, ashtu siç thotë imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!):*

*“Bërja e pyetjeve është ndarje.”*

*Gjithashtu, ka thënë: “Mos bëj kontroll te njerëzit, sepse do të mbetesh pa asnjë mik.”<sup>4</sup>*

*Për njeriun me përvojë është detyrë të kënaqet prej vëllait të tij me të tjera gjëra, sepse kështu dashuria do të jetë e qëndrueshme, ashtu siç ka thënë imam Sadiku: “Nuk është maturi kërkimi i miqve me maturi. Ai, që nuk është i*

<sup>1</sup> “El Vesâil”, vëll. 8, f. 408.

<sup>2</sup> “El Vesâil”, kapitulli: “Durimi ndaj vëllezërve është veprim i preferuar”, vëll. 8, f.458.

<sup>3</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 78, f. 278.

<sup>4</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 78, f. 109 dhe f. 253.

*kënaqur me mikun e tij pa i dhënë atij përparësi mbi veten, do të vazhdojë zemërimin e tij.”<sup>1</sup>*

*Është e vërtetë se qortimi nuk sjell çarje në pajtimin e në dashurinë e qëndrueshme, madje mund të heqë zhulin e zemrave e të largojë urrejtjen e ndrydhur në zemra! Nëse qortimi është i shpeshtë, atëherë ai do të pasqyrojë gjendje të rënduar. Prandaj imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ai, që i vë shpesh në dukje të metat e mikut të vet, ka pak miq. Kush qorton për çdo faj, do të vazhdojë të vërë në dukje të metat e të tjerëve.”<sup>2</sup>*

### *Të drejtat e vëllezërve*

*Vëllezërit kanë të drejta të shumta, që nuk është punë e lehtë të thuhet të gjitha. Ne nuk dëshirojmë të thellohemi në të gjitha sa janë thënë për këtë çështje, por do të sjellim vetëm një hadith, pasi edhe me kaq është e mjaftueshme, sikur vëllai të punojë sipas këtij hadithi në drejtim të vëllait të vet. Imami i ka thënë Mual'lâ ibn Khanijsit, pasi i përmendi atij shtatë të drejta: “E drejta më e lehtë prej këtyre është të duash për vëllanë tënd atë që do për vete dhe të mos duash për vëllanë tënd atë që nuk do për vete.*

*E drejta e dytë është të largosh zemërimin e tij, të ndjekësh ato punë, nga të cilat ai është i kënaqur dhe t'i bindesh urdhrat të tij.*

---

<sup>1</sup> “El Vesâil”, kapitulli: “Durimi ndaj vëllezërve është veprim i preferuar”, ol. 8, f. 458.

<sup>2</sup> “Bihârul Anuâr”, vëll. 78, f. 278.



*E drejta e tretë është ta ndihmosh atë personalisht, me pasurinë tënde, me gjuhën tënde, me dorën tënde e me këmbën tënde.*

*E drejta e katërt është që të jesh syri i tij, udhërrëfyesi i tij dhe pasqyra e tij.*

*E drejta e pestë është që ti të plotësosh nevojat që ka: urinë, etjen, veshmbathjet, etj.*

*E drejta e gjashtë është që ti ke shërbyes dhe vëllai yt nuk ka shërbyes, atëherë ke detyrë t'i dërgosh shërbyesin tënd, të lash rrobat e tij, të gatuash për të dhe t'i shtrosh atij dyshekun. E drejta e shtatë është që të plotësosh betimin e tij, t'i përgjigjesh ftesës së tij, ta vizitosh atë kur është sëmurë, të marrësh pjesë në varrimin e tij. Kur e mëson se ai ka ndonjë nevojë, shko shpejt t'i kryesh nevojën që ka. Mos e streho atë derisa ai të ta kërkojë këtë, por ti fillo i pari, kur ti ta bësh këtë, ke puqur miqësinë tënde me miqësinë e tij dhe miqësinë e tij me miqësinë tënde.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Ku jemi ne me këto të drejta? Sa jemi në gjendje t'i kryejmë këto dhe të punojmë sipas këtyre të drejtave, pasi shpirtërat janë të prirur kah e keqja? Ndërkaq egoizmi i ndalon këto ndjenja e këto virtyte.”*

#### *Barazia e vëllezërve*

*Në nëntitullin e mësipërm përmendën të drejtat e vëllezërve dhe ndër të drejtat është edhe barazia. Sádiku - Paqja e shpëtimiti qoftë mbi të! - për barazinë midis vëllezërve ka thënë: “Shiko ato që ke bërë mirë dhe me ato*

---

<sup>1</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Kryerja e të drejtës së besimtarit është detyrë”, vëll. 8, f. 7 dhe f. 455

*kthehu tek vëllezërit tuaj.<sup>1</sup> Afrohuni tek All'llahu me barazinë e vëllezërve tuaj.”<sup>2</sup>*

*Nisur nga fakti se barazia ka efekt të fortë në shpirtira, imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Tri janë gjërat më të rënda nga detyrimet që All'llahu ka vënë për njerëzit: matura e besimtarëve ndaj vetes, derisa besimtari të jetë i kënaqur për vëllain e tij vetëm me ato që është i kënaqur edhe për vete, barazia e vëllait besimtar në pasuri, përmendja e All'llahut në të gjitha gjendjet që ndodhet. Nuk është përmendje e All'llahut vetëm thënia e shprehjeve: “Subhanall'lah”, ose “Elhamdu lil'lah”, por kur lë një veprim që All'llahu e ka ndaluar kryerjen e këtij veprimi.”<sup>3</sup>*

*Unë them: “Është e vërtetë që këto të tri gjëra të jenë nga punët më të rënda për njeriun, sepse ato janë përplasja më e fuqishme e instinkteve dhe e dëshirave shpirtërore, siç janë: dashuria për veten, dashuria për pasurinë e dëshira për të qenë mbi të tjerët. Nisur nga rëndësia e madhe që ka matura dhe barazia e vëllezërve, imami i ka numëruar ato ndër detyrimet që ne duhet të zbatojmë, megjithëse në të vërtetë ato nuk janë nga gjërat e urdhëruara.*

### *Bamirësia ndaj vëllezërve*

*Bamirësia është njëra nga degët e oazit të barazisë dhe prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) janë transmetuar hadithe, që nxisin për bamirësi. Ja porosia, që i tha Xhemijl ibn Derràxhit: “Nga besimi i sinqertë është bamirësia ndaj*

<sup>1</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Barazia e vëllezërve është veprim i preferuar”, vëll. 8, f. 4 dhe f. 415

<sup>2</sup> Cilësitë e Sadùkut, - Erëkëndshëm qoftë dheu i tij!-, kapitulli: “I pari”.

<sup>3</sup> “El Vesàil”, kapitulli: “Barazia e vëllezërve është veprim i preferuar”, vëll. 8, f. 5 dhe f. 415.

*vëllezërve dhe nxitimi në kryerjen e nevojave të tyre, sepse bamirësinë ndaj vëllezërve, me siguri që e do i Gjithëmëshirshmi. O Xhemijl, për këto njofto shokët tuaj “garerë”.*

*Xhemijli tha: “Kurban t’u bëfsha, po cilët nga shokët e mi janë këta “garerë”?”*

*Ai i tha: “Janë bamirësit ndaj vëllezërve në gjendje të mirë e në gjendje të vështirë.”*

*Në porosinë e mësipërme për Abdullah ibn Xhundubin ai thotë: “Ai e adhuron All’llahun në atë masë sa hapa hedh për bamirësi ndaj vëllezërve.”*

*Djalli, duke e ditur rëndësinë e madhe që All’llahu i kushton bamirësisë ndaj vëllezërve, mundohet me çdo mënyrë që ajo të mos realizohet.*

*Për këtë imami thotë: “O bir i Xhundubit, djalli ngrë prita, me të cilat ai pret gjahun. Prandaj ruhuni të mos bini në rrjetat e në pritat e tij.”*

*Ai e pyeti: “O nipi i të Dërguarit të All’llahut, si janë ato?”*

*Imam Sádiku iu përgjigj: “Pritat e djallit janë ndalimi nga bamirësia ndaj vëllezërve.” Janë të shumta thëniet që kanë ardhur për bamirësinë ndaj vëllezërve e për nxitjen për bamirësi ndaj tyre, por është e mjaftueshme edhe kaq sa kemi përmendur.*

*Fjala e vërtetë dhe kryerja e emanetit*

*Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) porosiste shokët e vet, që vinin tek ai, ose ata që largoheshin prej tij, për fjalë të vërtetë dhe për kryerjen e emanetit. Më lart është thënë diçka për këtë çështje.*

*Këto dy veti, që janë nga cilësitë më të mira, kanë një efekt të dukshëm në fe. Ky efekt është dashuria në shpirt, bashkëpunimi dhe siguria që kanë njerëzit në të. Gjithashtu, në këto dy veti ka pasuri. Për këtë çështje do të përmendim vetëm një ngjarje, për të cilën mendojmë se është e mjaftueshme.*

*Paqja e shpëtimit qoftë mbi të!- i tha Abdurrahmàn ibn Sijâbes, i cili kishte hyrë tek Sâdiku, pas vdekjes së djalit të tij të ri: “A dëshiron të të jap një porosi?”*

*“Posi jo, kurban t’u bëfsha!”*

*Atëherë ai tha: “Detyra jote është të flasësh të vërtetën e të kryesh amanetin. Kështu ti bëhesh ortak i njerëzve në pasurinë e tyre.” Dhe bashkoi gishtat e tij.*

*Abdurrahmani thotë: “Unë e mbajta në mendje këtë fjalë dhe dhashë zekat 300000 dirhem.”<sup>1</sup>*

*Unë them: “Kjo ishte porosia e fundit, që unë pasqyrova. Shpresoj t’ia kem arritur qëllimit me këto porosi të imam Sâdikut, për çështje të ndryshme. Porositë e tij kanë pasur si qëllim lumturinë e njerëzve dhe triumfin e tyre në të dyja botët.*

\* \* \*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Mendja”.

#### **4 – FJALËT E TIJ TË URTA**

*Prej imam Sádikut (Paqja qoftë mbi të!) kemi fjalë të urta, të atilla, që i lartësojnë shpirtërat e mirë në radhët e engjëjve dhe që i tërheqin njerëzit drejt mirësisë e lumturisë. Patjetër që është kështu për këdo që punon me këto fjalë të urta të tij dhe i sistemon ato. Unë kam mbledhur disa nga këto dhe në këtë punim jam munduar t'i përzgjedh.*

*Imam Sádiku ka thënë:*

*1: I Gjithëmëshirshmi adhurohet me mendje dhe me të fitohet Xhenneti.*

*2: Në të vërtetë, shpërblimi është në masën e mendjes.*

*3: Njeriu me mendje më të plotësuar, është njeriu me moralin më të mirë.*

4: Kolona mbajtëse e njeriut është mendja.

5: Mendja është argumenti tregues i besimtarit.

6: Plotësimi i mendjes qëndron në tri pika: në nënshtrimin ndaj All'llahut, në diturinë sa më të mirë dhe në heshtjen, përveçse në të mirë.

7: Injoranca qëndron në tri gjëra: në mendjemadhësinë, në polemikën e ashpër dhe në mosnjohjen e All'llahut.

8: Forma më e mirë e mendjes është adhurimi, fjala më e besueshme e mendjes është dituria dhe pjesa me e vlerësuar e mendjes është urtësia.<sup>1</sup>

9: Shikimi i shumtë në diturinë hap mendjen.<sup>2</sup>

10: Dituria është pritëse, fjala e drejtë është madhështi, injoranca është poshtërim, kuptimi është lavdi, bujaria është sukses, morali i mirë tërheq dashuri, dietarin e kohës së tij nuk e sulmojnë mveshjet dhe shtrëngimi është përkeqësim për mendjen.

11: Nëse dëshiron të respektohesh, trego butësi dhe nëse dëshiron të poshtërohesh, trego ashpërsi.

12: Kush është bujar në origjinën e vet, e ka zemrën të butë dhe, kush është i ashpër, e ka zemrën të ashpër.

13: Ai, që i bie shkurt, ngatërrohet dhe ai, që ka frikë nga përfundimi, nuk hyn në ato që nuk ka dijeni.

---

<sup>1</sup> "Biharul Anvâr", vëll. 1, f. 24 dhe f. 131.

<sup>2</sup> "Biharul Anvâr", vëll. 1, f. 32 dhe f. 159.

14: Ai, që sulmon një punë, pa dituri, ka prerë hundën e vet.<sup>1</sup>

15: Dijetarët janë ruajtës besnikë, të pastrit janë kështjella dhe të porositurit janë paria.<sup>2</sup>

16: Me të vërtetë, për diturinë ka një bravë dhe çelësi është pyetja.<sup>3</sup>

17: Ai, që punon, pa ditur përfundimin, është si ai që ecën pa rrugë, të cilit shpejtësia nuk i shton gjë tjetër përveç largësisë.

18: All'illahu nuk pranon asnjë punë, veçse me dituri. Nuk ka dituri veçse me punë. Ai që di, dituria e drejton në punë. Ai, që nuk punon, për atë nuk ka dituri.

19: I njohuri plotësohet vetëm me tri gjëra: me shpejtësinë e tij, me urrejtjen e tij dhe me mbulimin e tij.<sup>4</sup>

20: Nuk e ka pakësuar ai që mendon një send, për të cilin ka fuqi, nuk e pakëson ai, që e ka fuqinë për një send, që i përshtatet atij, nuk ka pakësim për atë që e përshtat atë për vete dhe e ve aty ku duhet. Kur bashkohen qëllimi, fuqia, përshtatshmëria dhe vënia në vendin e vet, aty është lumturia.

21: Katër gjëra, edhe kur janë pak, janë shumë: zjarri, armiqësia, varfëria dhe sëmundja.

22: Shoqërimi për njëzet ditë është afrim.

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Mendja".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Cilësitë e diturisë dhe virtyti i dijetarëve".

<sup>3</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Pyetja për dituri dhe studimi i saj".

<sup>4</sup> "Hilij'jetul Eulijà", prej Sufjân Thuërij'jut, vëll. 3, f. 198.

23: Ai, që nuk qetësohet në të panjohurën, që nuk ka kujdes kur i thinjet koka dhe ka frikë All'llahun pa dijëni, nuk ka mirësi.

24: Ai, që të respekton, respektoje edhe ti. Respekto veten prej atij që të fyen e të provokon.

25: Ndalimi i bujarisë është paragjykim për të Adhuruarin.

26: Njerëzit, që burri ka në ngarkim, janë robër të tij, prandaj kujt i është dhënë një e mirë, le të jetë dorëgjere me robërit e tij. Nëse nuk vepron kështu, ka të ngjarë që ajo mirësi të largohet prej tij.

27: Me tri gjëra All'llahu i shton myslimanit madhështinë: me tolerancën ndaj atij që i ka bërë padrejtësi, me dhënien atij, që nuk i ka dhënë dhe me mbajtjen e lidhjeve me të afërmin, që i ka ndërprerë lidhjet me të.

28: Zemërimi nuk e nxjerr besimtarin nga e vërteta, edhe kur ai është i kënaqur. Kënaqësia e tij nuk e fut atë në rrugë të gabuar.

29: Për miqësinë ka pesë kushte, në atë që është miqësia, atij përmendi miqësinë dhe në atë që nuk është miqësia, mos i përmend asgjë nga miqësia. Miqësia është kur zburimi i shokut të tij të jetë zburimi i vetë atij; ajo, që ai mban në shpirt, të jetë si ajo që e nxjerr sheshit; atë të mos e ndryshojë pasuria. Ai ta shohë atë të përshtatshëm



*për të gjithë dashurinë e tij dhe të mos e dorëzojë atë në raste pësimesh të rënda.<sup>1</sup>*

*30: I ndershmi nuk duhet të jetë i ngadaltë në katër gjëra: në ngritjen prej kuvendit të babait të vet, në shërbimin ndaj mikut të tij, në shërbimin ndaj kafshës që e përdor për hipje, edhe sikur të ketë njëqind robër, si dhe në shërbimin ndaj personit prej të cilit merr mësim.*

*31: Dijetarët janë besnikët e të dërguarve, derisa ata nuk shkojnë në dyert e mbretërve.<sup>2</sup>*

*32: Tek ai hynte e dite një burrë prej masës, por ai nuk po vinte më dhe ai e pyeti për të. Disa i thanë: “Ai del, pasi është fshehur dhe do që ata të jenë të shpejtë prej tij.”*

*Atëherë imami (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Origjina e njeriut është mendja, nderi i tij është feja e vet, respekti i tij është devotshmëria që ka dhe njerëzit në Àdemin janë të barabartë.”<sup>3</sup>*

*33: Moralet e nderuara janë dhjetë. Ato mund të jenë te burri e nuk janë te djemtë e tij, mund të jenë te djali dhe nuk janë te babai i tij, mund të jenë te skllavi e mund të mos jenë te i liri. U tha: “Cilët janë ato?”*

*Imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) u përgjigj: “Drejtësi me njerëzit, drejtësi në fjalë, kryerja e emanetit, mbajtja e lidhjeve me të afërmit, përshëndetja e mikut që të vjen në shtëpi, ushqimi i lypësit, shpërblimi i mjeshtrit, përlje ndaj*

<sup>1</sup> “Nùrul Ebsâr”, e Sheblnexhij’jut. F. 141.

<sup>2</sup> “Leuàkihul Enuâr” e Sha’rànij’jut, vëll. 1. f. 28.

<sup>3</sup> “Tedhkiretul Khavàs”, e nipit të Ibn Xheuzijes, f. 343.

*fqinjit, përrulje ndaj shokut. E para e të gjithave, sa u thanë, është turpi.*<sup>1</sup>

*34: Nga qartësia e diturisë së burrit mysliman është që ai nuk i kënaq njerëzit me zemërimin e All'llahut. Ai nuk i qorton ata për gjëra që atyre nuk ua ka dhënë All'llahu: furnizimin me ushqim nuk e drejton kujdesi i ndonjë të kujdesshmi, as nuk e spraps imponimi i ndonjë imponuesi. Sikur ndonjë prej jush të largohet prej furnizimit të tij me ushqim, ashtu siç largohet prej vdekjes, patjetër që furnizimi i caktuar për atë do të arrinte, ashtu siç e arrin edhe vdekja.*

*35: All'llahu i Lartësuar, me drejtësinë e Tij, shpirtin dhe qetësinë e ka bërë në qartësinë e në kënaqësinë, kurse merakun dhe dëshpërimin e ka bërë në dyshimin e në zemërimin.*<sup>2</sup>

*36: Kryet e bindjes ndaj All'llahut është durimi e kënaqja prej All'llahut në atë që Ai ka dashur ose e ka urryer për robin; robi nuk është i kënaqur prej All'llahut në atë që ai do ose e urren, vetëm nëse për atë ka të mirë në atë që ai do ose në atë që ai e urren.*

*37: Më i dituri i njerëzve për All'llahun është më i kënaquri i tyre ndaj vendimit e caktimit të All'llahut.*<sup>3</sup>

*38: Mos përgojo, se do të përgojohesh, mos hap gropë për vëllain tënd, se do të biesh vetë brenda. Dije mirë, se çfarë të bësh, ashtu do të të bëhet.*<sup>4</sup>

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Të nderuarat".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Mirësia e qartësisë".

<sup>3</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Kënaqësia me vendimin e caktimit të All'llahut".

<sup>4</sup> "Mexhâlisu Sudûk", kuvendi i 65-të.

39: *Ruhuni nga shakatë, sepse shakaja të heq ujin e fytyrës dhe largon seriozitetin e burrave.*

40: *Mos polemizo, se të shkon autoriteti dhe mos bëj shaka, se do ta bëjnë edhe me ty.<sup>1</sup>*

41: *Ruhuni shumë nga armiqësia, sepse ajo të çon në punë të këqija e të urryera dhe zbulon pjesët e trupit, që duhet të jenë të mbuluara.<sup>2</sup>*

42: *Kush nuk ka turp nga kërkimi i hallallit, e ka të lehtë gjetjen e ushqimit dhe familja e tij bëhet e mirë.<sup>3</sup>*

43: *Ti çuditësh me atë që është koprrac në këtë botë, kur ajo është duke ardhur tek ai, ose me atë që është koprrac ndaj kësaj bote, kur ajo është duke i kthyer shpinën atij. Atë nuk e dëmton shpenzimi, kur bota është duke ardhur për tek ai dhe nuk i sjell dobi mosdhënia, kur bota është duke i kthyer atij shpinën.<sup>4</sup>*

44: *I burgosur është ai që e kanë burgosur interesat e veta në këtë botë prej botës së tij të ardhshme.<sup>5</sup>*

45: *Që zemrat tuaja të mos ndiejnë punën që ka kaluar, duhet që mendjet tuaja të punojnë, që të përgatiten për atë që nuk ka ardhur akoma.<sup>6</sup>*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Lajkat dhe qeshja".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Polemikat, grindjet dhe armiqësitë".

<sup>3</sup> "Mexhâlisu Shejh Tûsij", kuvendi i 42-të.

<sup>4</sup> "Mexhâlisu Shejh Sudûk", kuvendi i 32-të.

<sup>5</sup> "El Irshâd" i shejh Mufijdit", në lidhje me gjendjet e imam Sâdikut.

<sup>6</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Dashuria për këtë botë dhe ruajtja prej saj".

46: Bëni që, me sadaka, të zbresë furnizimi për ju. Ruajeni pasurinë tuaj me zekatin. Nuk është varfëruar ai që bën ekonomi.

Sistemimi është gjysma e jetesës, dashuria është gjysma e mendjes, pakësimi i njerëzve të shtëpisë është njëra nga dy lehtësirat, puna nuk është e arrirë përveçse tek ai që mjaftohet me aq sa ka dhe që ka fe, All'llahu e zbret durimin në masën e sprovës dhe Ai e zbret furnizimin sipas nevojës; kush ka fuqi për furnizimin e tij, atë e ushqen All'llahu i Lartësuar; kush shpërdoron mjetet e jetesës së tij, atë e privon All'llahu i Lartësuar.<sup>1</sup>

Unë them: “Disa nga këto fjalë të urta janë vënë në gojën e Prijësit të Besimtarëve në “Nehxhul Belàga” dhe mbase imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka përmendur për njoftim.”

47: Pasuria më e madhe është kur roja nuk ka rob lufte.<sup>2</sup>

48: Nuk ka gjë më të mirë se heshtja, nuk ka armik më dëmtues se injoranca dhe nuk ka sëmundje më të pashërueshme se gënjeshtria.<sup>3</sup>

49: Tri gjëra nuk dëmtojnë asnjë send: lutja në raste pësimi të rëndë, kërkimi i faljes së mëkatit për fajin e bërë dhe falënderimi për mirësitë e dhëna.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> “Hilij’jetul Eulijà”, ol. 3, f. 194.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Dashuria për këtë botë dhe ruajtja prej saj”.

<sup>3</sup> “Hilij’jetul Eulijà”, vëll. 3, f. 169.

<sup>4</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Falënderimi”.

50: *Besimtari është i pajtueshëm dhe nuk ka të mirë në atë që nuk pajton e nuk pajtohet.*<sup>1</sup>

51: *I kanë thënë atij: “Ç’është kufiri i moralit të mirë?”*

*Imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: “Zbute zemërimin tënd, thuaj fjalë të mira dhe takoje vëllain tënd me gëzim.”*

52: *Ai, që flet të vërtetën, puna e tij është e pastër, ai, që e ka nijetin të mirë, i shtohet furnizimi me ushqim, ai, që përmirëson bamirësinë e tij me njerëzit e shtëpisë së vet, i zgjatet jeta.*<sup>2</sup>

53: *Turpi është prej besimit.*

54: *Kujt i zbutet fytyra, i zbutet puna.*

55: *Nuk ka besim ai që nuk ka turp.*<sup>3</sup>

56: *Tri veprime janë të nderuara në këtë botë e në botën e ardhshme: të falësh atë që të ka bërë padrejtësi, të mbash lidhjet me atë që i ka ndërprerë ato me ty dhe të jesh i butë kur ai sillet me injorancë ndaj teje.*<sup>4</sup>

57: *Çdonjërit nga të Ehli Bejtit i është dhënë pjesa e tij e butësisë dhe All’llahu atyre ia ka zgjeruar furnizimin me ushqim. Butësia në vlerësimin e jetesës është më e mirë se pasuria e shumtë, sepse butësinë nuk e pakëson asnjë send, kurse nga harxhimi i kotë i pasurisë nuk mbetet*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Morali i mirë”.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Drejtësia dhe kryerja e amanetit”.

<sup>3</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Turpi”.

<sup>4</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Falja”.

*asnjë send prej saj. All'illahu i Lartësuar është i Buti dhe e do butësinë.*

*58: Kush është i butë me urdhrin e tij, ka arritur atë që dëshiron prej njerëzve.<sup>1</sup>*

*59: Kush është i kënaqur me furnizimin që i ka dhënë All'illahu, është më i pasuri i njerëzve.*

*60: Tek ai u ankua një burrë. Ai kërkon dhe i jepet. Megjithatë nuk është i kënaqur, prandaj grindet me veten për atë që ka më shumë se ai. Ky burrë i tha: "Më mëso një send, me të cilin të përfitoj."*

*Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Nëse ajo është aq sa ty të mjafton, ajo të ka pasuruar, madje edhe më e pakta, që është në atë, të pasuron ty. Nëse ajo është e atillë, që nuk të mjafton, nuk të pasuron, madje nuk të pasuron edhe e gjitha sa ka në të."<sup>2</sup>*

*61: Drejtësia është më e ëmbël se uji që pi i eturi.*

*62: S'ka më të gjerë se drejtësia, edhe kur është pak.*

*63: Njeriu më i duruar me veten, miraton gjykimin e një tjetri.<sup>3</sup>*

*64: Nderi i besimtarit është falja namaz natën dhe madhështia e tij është mospasja nevojë për njerëzit.*

*65: Kërkimi i nevojave prej njerëzve është grabitje e madhështisë dhe largim i turpit; kurse prerja e shpresës*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Butësia".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Kënaqja me atë që ke".

<sup>3</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Maturia dhe drejtësia".

*nga ajo që është në duart e njerëzve është madhështi për besimtarin në fenë e tij; kurse lakmia për më shumë, është varfëria aktuale.<sup>1</sup>*

*66: Mbajtja e lidhjeve me farefisën përmirëson moralin, parfumos shpirtin, shton furnizimin dhe vonon vdekjen.<sup>2</sup>*

*67: Është e mjaftueshme butësia për të qenë fitues.*

*68: Kur nuk je i butë, atëherë bëhu i butë.<sup>3</sup>*

*69: Kush e heq dorën mbi njerëzit, ka hequr vetëm një dorë, kurse ata heqin shumë duar.<sup>4</sup>*

*70: Për burrin është e mjaftueshme mbështetja të vëllai i tij, kur ai vjen e i plotëson nevojën që ka.<sup>5</sup>*

*71: Një sadaka, të cilën e dëshiron All'llahu: përmirësimi i marrëdhënieve njerëzëzore, kur ato janë shprishur dhe afrimi ndërmjet tyre, kur njerëzit janë larguar nga njëri-tjetri.<sup>6</sup>*

*72: Kush bashkëvepron me njerëzit dhe nuk u bën atyre padrejtësi, u flet atyre e nuk i gënjen, u premtim atyre e nuk ua thyen premtimin, është prej atyre që e kanë ndaluar të jenë të vetmuar; burrëria e tij është plotësuar,*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Turpi".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Mbajtja e lidhjeve me të afërmit në gjak".

<sup>3</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Butësia"; kjo fjalë gjendet edhe në "En'nehxh" në frazën vijuese: Nëse nuk je i butë, atëherë bëhu i butë dhe është pak për atë që i ngjan të tjerëve, ndryshe ka të ngjarë të jetë prej atyre.

<sup>4</sup> "El Kâfij", kapitulli: "El mudârât".

<sup>5</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Shpejtimi për të ndihmuar besimtarin".

<sup>6</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Në kërkim të pajtimit mes njerëzve".

*drejtësia e tij ka dalë në shesh dhe vëllazërimi me të është bërë detyrë.<sup>1</sup>*

*73: Kush kërkon kryesimin, është shkatërruar.<sup>2</sup>*

*74: Kush mbjell armiqësi, do të korrë farën që shpërndau.<sup>3</sup>*

*75: Zemërimi është çelësi i çdo sherri.*

*76: Zemërimi është shkatërruesi i të urtit.*

*77: Kush nuk e zotëron zemërimin e tij, nuk zotëron as mendjen e vet.<sup>4</sup>*

*78: Smira e ha besimin, ashtu siç ha zjarri drutë.*

*79: Sëmundja e fesë është smira, vetëpëlqimi dhe krekosja.<sup>5</sup>*

*80: Nuk ka ndonjë mendjemadh, që të mos gjejë një poshtërim në shpirtin e vet.<sup>6</sup>*

---

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Besimtari, shenjat dhe cilësitë e tij".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Kërkimi kryesimit".

<sup>3</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Polemikat, zënkat dhe armiqësitë".

<sup>4</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Zemërimi".

<sup>5</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Smira".

<sup>6</sup> "El Kâfij", kapitulli: "Mendjemadhësia". Sa fjalë e madhe! Në të ka njoftim për gropat e thella të shpitrave, sepse ai, që ndien në brendësi të shpirtit të vet poshtërim e mangësi, e mbulon këtë mangësi me kapardisje e mendjemadhësi. E kundërta ndodh me atë që e ndien veten të plotësuar e të respektuar. Shpirtërisht ai nuk ka nevojë për madhështi e krekosje. Mëso se çdonjëri, që ti e sheh të kapardiset e të sillet me prepotencë, e ka shpirtin të përbërë nga mangësitë dhe është mendjemadhësia ajo që e shtyn atë në këtë drejtim.



81: Nuk ka gjë më të keqe për besimtarin, kur ai ka një dëshirë që e poshtëron.<sup>1</sup>

82: Naiviteti është ves shumë i keq. Ai sulmon atë që është poshtë vetes dhe i nënshtrohet atij që është sipër tij.<sup>2</sup>

83: Në të vërtetë, harrimi është ai me të cilin All'llahu ndihmon kundër demagogëve.<sup>3</sup>

84: Ruhu nga rrëzimi i shtrirë, sepse ai nuk thuhet.

85: Më i miri i njerëzve është ai, në të cilin janë së bashku pesë cilësi: kur bën mirë, përgëzon; kur bën keq, kërkon faljen e mëkatit, kur jep, falënderon, kur i bie ndonjë sprovë, duron dhe kur i bëhet padrejtësi, fal.

86: Ebù Hanijfeh i tha atij: “O Ebù Abdil’lah, sa i durueshëm je në faljen e namazit?”

Imami (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “Ah, more Nu’màn, a nuk e di ti se namazi është kurban i çdo të ruajturi dhe se Haxhi është lufta në rrugën e All’llahut e çdo të pafuqishmi? Për çdo send ka pastrues dhe pastruesi i trupit është agjërimi; më e mira punë është pritja e largimit të së keqes prej All’llahut dhe se thirrësi pa veprim është si qitësi pa harkun, prandaj mbaji mend këto fjalë o Nuëmàn.”

87: Për tri gjëra betohem te All’llahu se ato janë të vërteta: nuk është pakësuar ndonjë pasuri as prej sadakasë e as prej zekatit; asnjërit nuk i është bërë padrejtësi kur ka fuqi ta kthejë me të njëjtën masë, por ai frenohet, prandaj

<sup>1</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Lakmia për sa më shumë”.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Naiviteti”.

<sup>3</sup> “El Kâfij”, kapitulli: “Gënjeshtër”.

*atij All'illahu ia zëvendëson padrejtësinë me madhështi dhe nuk ka hapur ndonjë rob për vete portën e lypjes që All'illahu të mos hapë kundër tij portën e varfërisë.*

*88: Burrëria e njeriut është në shpirtin e tij dhe origjina e tij është te ata që le pas dhe në fisin e tij.<sup>1</sup>*

*89: Shtatë gjëra i prishin punët e tyre: burri i butë e i ditur, por që as nuk njihet për butësi e as nuk përmendet për dituri; i urti, pasurinë e të cilit e administron çdo demagog i panjohur, që i vjen atij; një burrë, i cili i beson mashtruesit e tradhtarit; zotëria i shquar, që nuk gjen qetësi; nëna, e cila nuk i mban asnjë sekret pa ia thënë të birit; ai që nxiton të njollosë vëllezërit e tij dhe ai që vazhdon të polemizojë me vëllanë e vet, i armiqësuar me të.<sup>2</sup>*

*90: Mendjemadhi nuk lakmon lavdërimet e bukura, as mashtruesi nuk lakmon të ketë shumë shokë; as ai, që ka edukatë të keqe, nuk lakmon nderimin; as koprraci nuk lakmon të mbajë lidhjet me të afërmit e vet; as ai, që vë në lojë njerëzit, nuk lakmon dashurinë e sinqertë; as ai që ka dituri të pakta në fushën e legjislacionit të fesë nuk lakmon gjykimin; as përgojuesi nuk lakmon shpëtimin; as smirëziu nuk lakmon qetësinë e zemrës; nuk lakmon të nderohet as ai që vazhdon të bëjë mëkate të vogla; gjithashtu, nuk e lakmon kryesinë as ai që ka pak përvojë e që i pëlqen mendimi i vet.<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> "Keshful Gum'meh" mbi gjendjet e imam Sádikut (Paqja qoftë mbi të!), i autorit Ibnul Xheuzij.

<sup>2</sup> "Khisàlu Sudùk", kapitulli i shtatë.

<sup>3</sup> "El Khisàl", kapitulli: "Shoqërimi".

91: Për atë, që vendosmëria është roja i tij dhe e drejta bashkëbiseduesi i tij, gëzimi i tij është i madh dhe burrëria e tij është e plotësuar.

92: Injoranti bujar është më i mirë se një adhurues koprrac.

93: Ai, që kërkon më shumë mbi të drejtën që ka, ka merituar privimin.

94: Më i larti i njerëzve në falje është më i fuqishmi për të dënuar. Njeriu me më pak mendje është ai që i bën padrejtësi atyre që janë nën të e nuk tregohet i gjerë ndaj atij që i kërkon ndjesë.

95: Kurrë të mos jesh i pari tregues dhe ruhu shumë nga mendimi i nxituar.<sup>1</sup>

96: Kërkimi për të arritur qëllimin më të largët është ndarje.

97: Kritika është armiqësi.

98: Durimi i pakët është diskreditim.

99: Përhapja e sekretit është rrëzim.

100: Bujaria është zgjuarsi.

101: Njolloosja është shkujdesje.

102: Është i privuar ai që bën pak në tri gjëra: në lehtësimin e bujarit, në shoqërimin e dijetarit dhe në prirjen nga mbreti.

103: Tri gjëra sjellin nga pas dashurinë: feja, kryeultësia dhe shpenzimi.

---

<sup>1</sup> "Bihârul Anuâr", vëll. 78, f. 105 dhe f. 228.

*104: Kush largohet nga tri gjëra, arrin tri të tjera: kush i largohet sherrit, arrin madhështinë, kush qëndron larg mendjemadhësisë, arrin respektin dhe kush e largon koprracinë, arrin nderimin.*

*105: Tri gjëra bëjnë që të fitohet urrejtja: hipokrizia, vetëpëlqimi dhe padrejtësia.*

*106: Kush nuk ka njëri nga këto tri cilësi, nuk numërohet bujar: ai që nuk ka mendje që ta zbukurojë atë; gjyshe që ta ndihmojë; ose fis që ta përforcojë.*

*107: Me tre qortohet njeriu: me smirën, me çuarjen e prurjen e fjalëve dhe me gabimet.*

*108: Tre që njihen vetëm në tre vende: i buti njihet vetëm në zemërim, trimi njihet vetëm në luftë dhe vëllai njihet vetëm në nevojë.*

*109: Nëse tri gjëra janë te një njeri, ai është hipokrit edhe nëse ai agjëron e fal namaz: kur flet, gënjen; kur premtan, nuk e mban fjalën dhe kur i lihet një send në mirëbesim, tradhton.*

*110: Ruhu nga tre njerëz: prej tradhtarit, prej të padrejtit dhe prej atij që çon e bie fjalë; sepse ai, që ka tradhtuar për ty, shumë shpejt do të të tradhtojë edhe ty; ai, që ka bërë padrejtësi për ty, shumë shpejt do të të bëjë edhe ty padrejtësi dhe ai që të bie fjalë, shumë shpejt do të çojë fjalë edhe kundër teje.*

*111: Besniku nuk është besnik derisa të jetë e sigurt se ai është besnik në tri gjëra: te pasuria, te fëmijët dhe te nderi. Nëse ai ruan dy dhe ka humbur njëri, ai nuk është besnik.*

112: Mos u konsulto me mendjeshkurtrin, mos i kërko ndihmë gënjeshtarit dhe mos beso në dashurinë e atij që të ngushton; sepse gënjeshtari të afron të largëtin e të largon të afërmin, mendjeshkurtri mundon veten e nuk arrin atë që do, kurse ai që të ngushton, nuk të ndihmon ty dhe mbaji lidhjet me të afërmit që i ka prerë lidhjet me ty.

113: Katër nuk ngopen me katër: toka me shi, syri me shikimin, femra me mashkullin dhe dijetari me dituri.

114: Katër gjëra mplakin para kohës së pleqërisë: ngrënia e mishit të tharë, qëndrimi gjatë në mbledhje, ngjitja nëpër shkallë dhe seksi me plakën.

115: Gratë janë tri llojesh: njëra është për ty, njëra është për ty dhe kundër teje, kurse tjetra është kundër teje e nuk është për ty; ajo, që është për ty, është gruaja virgjëreshë; ajo, që është për ty dhe kundër teje, është gruaja e martuar para se të martohet me ty; kurse ajo, që nuk është për ty dhe kundër teje, është gruaja që ka fëmijë me burrë tjetër.

116: Është zotëri ai person, në të cilin gjenden tri cilësi: frenimi i zemërimit, tolerancë ndaj keqbërësit dhe lidhje me veten e me pasurinë.

117: Në tri gjëra është shprehja e qartë: afrimi në kuptimin e qëllimit dhe kërkesës, largimi nga fjalët e kota dhe drejtimi me pak mbi të shumtën.

118: Mundi është tri llojesh: në ndërrimin e vëllezërve, në ndarjen pa shpjegim dhe në spiunimin për gjëra që nuk të interesojnë.

119: Tre vënë ndarëse nga kërkitimi i lartësimit: vullneti i shkurtër, turpi i pakët dhe mendimi i dobët.

120: *Disiplinimi është në tri rrugë: shërbim për mbretin, bindje ndaj prindit dhe nënshtrim ndaj All'Ilahut.*

121: *Sjellja e butë është në tri gjëra: te gruaja e përshtatshme, te djali i mirë dhe te shoku i pastër.*

122: *Atij, që i janë dhënë tri gjëra, ka arritur pasurimin më të madh: kënaqjen me atë që i është dhënë, prerja e shpresës prej asaj që është në dorën e njerëzve dhe heqja dorë nga tepricat.*

123: *Në tri gjëra njeriu nuk mëkaton: në konsultimin me një këshillues, në diskutimet e një smirëzimi dhe në shfaqjen e dashurisë për njerëzit.*

124: *Ai nuk dëshiron të sprovohet me: ai, që nuk dëshiron shpëtimin, sprovohet me poshtërim; ai, që nuk dëshiron punën e mirë, sprovohet me pendim dhe ai, që nuk dëshiron të ketë sa më shumë vëllezër, sprovohet me humbje.*

125: *Nga tri gjëra ka detyrë të largohet çdo njeri: nga shoqërimi me të këqijtë, nga bashkëbisedimi me gratë dhe nga kuvendimi me ata që bëjnë sajesa në fe.*

126: *Tre janë tregues të fisnikërisë së njeriut: morali i mirë, frenimi i zemërimit dhe ulja e shikimit.*

127: *Ai, që është i sigurt në tri gjëra, është i mashtruar: beson në atë që nuk është, mbështetet në atë që nuk ka besim tek ai dhe lakmon atë që nuk e ka.*

128: *Kush përdor tri gjëra, ka prishur fenë dhe botën e tij: ai që mendon për keq, që i jep pushtet e fuqi atij që e dëgjon atë dhe që i jep komandën gruas së vet.*

*129: Mbreti më i mirë është ai që i janë dhënë tri cilësi: butësia, bujaria dhe drejtësia.*

*130: Nuk është detyrë e mbretërve të zvogëlojnë kujdesin në tri gjëra: në ruajtjen e gjakut, në inspektimin e padrejtësive dhe në përzgjedhjen e njerëzve të mirë për punët e tyre.*

*131: I mençuri nuk fyen njeri dhe ata, që kanë më shumë të drejtë të mos i fyejë, janë tre: dijetarët, vëllezërit dhe mbreti, sepse ai, që fyen dijetarët, ka prishur fenë e vet; ai, që fyen mbretin, ka prishur punët e veta në këtë botë dhe ai, që fyen vëllezërit, ka prishur burrinë e vet.*

*132: Njerëzit kanë nevojë të përhershme për tri gjëra: siguri, drejtësi dhe pjellori.*

*133: Tri gjëra e turbullojnë jetën: mbreti mëkatar, fqinji i keq dhe gruaja me moral të keq.*

*134: Banesa bëhet e mirë vetëm me tri gjëra: ajri i mirë, uji i bollshëm dhe toka lehtësisht e punueshme.*

*135: Kujt i janë dhënë tri cilësi, ai është i plotësuar: mendja, bukuria dhe gojëtaria.*

*136: Tre sjellin privimin: ngulmimi në pyetje, përgojimi dhe tallja.*

*137: Kush kërkon tri gjëra pa të drejtë, privohet nga tri gjëra me të drejtë: kush kërkon këtë botë pa të drejtë, privohet me të drejtë nga bota e ardhshme; kush kërkon kryesinë pa të drejtë, privohet me të drejtë nga respekti ndaj tij; kush kërkon pasuri pa të drejtë, privohet me të drejtë nga qëndrimi i pasurisë.*

*138: Njeriu i vendosur nuk duhet të nxitojë të bëjë tri gjëra: pirja e helmit për provë, edhe nëse shpëton prej tij, nxjerrja e sekretit të afërmit smirëzi edhe nëse shpëton prej tij, udhëtimi me det, edhe kur në të ka pasuri.*

*139: Banorët e çdo vendi kanë nevojë për tri gjëra, për të cilët ata kanë frikë në punët e tyre të kësaj bote dhe të botës së ardhshme dhe, nëse ata e kanë të pamundur këtë, janë të uritur: për një dietar për rregullat e ligjit të fesë, për t'u ruajtur nga punët haram; për një pushtetar të mirë, të bindur ndaj All'llahut dhe për një mjek të besueshëm, që shikon në përfundim të punëve.*

*140: Nëse njerëzit shpëtojnë prej tre sendeve, është arritur shpëtimi i përgjithshëm: prej gjuhës së keqe, prej dorës së keqe dhe prej punës së keqe.*

*141: Nëse për shërbyesin nuk është njëra nga tri cilësitë, pronari i tij nuk ka qetësi që e mban atë: fe, që ta udhëzojë, ose edukatë, që ta drejtojë, ose frikë, që ta sprapsë.*

*142: Njeriu në shtëpinë e vet dhe njerëzit e shtëpisë së tij kanë nevojë për tre koncepte, që ai duhet t'i mbajë nga zori, edhe kur ato nuk janë në karakterin e tij: trajtim të mirë, dorëlëshuar me rregull dhe xheloz, duke qenë i martuar.*

*143: Kush sprovohet me njëerën nga tri sprovat, i ka ikur mendja: mirësi, që i kthen shpinën, grua e keqe dhe dhembja për humbjen e një të dashuri.*

*144: Trimëria është bërë për tre karaktere dhe në secilin ka një virtyt, që nuk është në tjetrin: bujari me veten, kokëfortësi ndaj poshtërimit dhe kërkimi i*



*përmendjes së All'llahut. Nëse te trimi këto karaktere janë të plota, ai është heroi që nuk i dilet përpara në rrugën e tij dhe ai është në pararojë të kohës së tij. Nëse karakteret kanë përparësi ndaj njëra-tjetrës, trimëria e tij do të jetë më shumë në atë karakter që ka përparësi.*

*145: Djali ka detyrë ndaj babait e nënës në tri gjëra: t'i falënderojë ata të dy në të gjitha gjendjet, t'u bindet atyre kur e urdhërojnë ose e ndalojnë, por jo kur është fjala për të kundërshtuar urdhrin e All'llahut, si dhe këshillimin e atyre të dyve në fshehtësi dhe sheshit.*

*146: Babai, ndaj djalit, ka detyrim tri gjëra: të mbajë mirë nënën e tij, t'i vërë atij emër të bukur dhe të bëjë të pamundurën për edukimin e tij.*

*147: Gëzimi është në tri cilësi të përhershme: te besa, te kujdesi për të drejtat dhe te ndihma në raste pësimesh.*

*148: Në tri gjëra nxirret mendimi i drejtë: takimi i mirë, dëgjimi me kujdes dhe përgjigja e bukur.*

*149: Burrat janë tri kategorish: i mençur, kokëtrashë dhe mëkatar; të mençurit, kur i flitet, përgjigjet; kur ai flet, thotë të drejtën, kur dëgjon, i vë veshin; kokëtrashë, kur flet, nxitohet, kur bisedon, flet kot dhe, kur nxitet kundër të keqit, vepron; mëkatarit, kur i lë një gjë në mirëbesim, të tradhton dhe, nëse ti i flet atij, ai të shan.*

*150: Me këto tri gjëra së bashku nuk ka vetmi: edukata e mirë, heqja e gjërave, që sjellin mundim dhe largimi i dyshimeve.*

151: Ditët janë tri: ditë, që ka kaluar e nuk arrihet, dita në të cilën janë njerëzit, prandaj kanë detyrë të përfitojnë të mirat e saj dhe e nesërmja, që në duart e tyre është shpresa për të.

152: Në atë që nuk janë tri cilësi, nuk i sjell dobi besimi: butësi që spraps padijen e injorantit, ruajtje, që e pengon nga kërkimi i gjërave të ndaluara dhe moral, me të cilin ai mëson njerëzit.

153: Vëllezërit janë tre: i butë me veten, tjetri i butë me pasurinë e vet dhe këta të dy janë shokë në vëllazëri, kurse tjetri merr prej teje aq sa i mjaftojnë për nevojat që ka dhe ty të do për disa kënaqësi, prandaj këtë mos e numëro ndër të besueshmit.

154: Robi nuk e ka të plotësuar të vërtetën e besimit, derisa te ai të gjenden tri cilësi: dituria për rregullat e ligjit të fesë, rregullimi i mirë i mjeteve të jetesës dhe durimi për pësimet.<sup>1</sup>

155: Falënderoje atë që të bën mirësi dhe bëji mirësi atij që të falënderon, sepse mirësitë nuk largohen kur ti falënderon; gjithashtu, mirësitë nuk qëndrojnë kur ti je mosmirënjohës.

156: I është thënë atij: “Ç’është burrëria?”

Dhe imami (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Mos të të shikojë All’llahu aty ku të ka ndaluar dhe të të gjejë aty ku të ka urdhëruar.”

---

<sup>1</sup> Duke filluar nga Nr. 96, të gjitha i kemi marrë nga libri “Tuhuful Ukùl”, aty ku flitet për imamatën e tij. Ajo që kemi sjellë në fillim është: «Prej fjalës së tij, të cilën, disa pasues, e kanë emërtuar “Nethru Durur”.

*157: Dalja nga dora e një sendi është më e mirë se ta kërkosh atë prej atyre që nuk janë të asaj gjëje. Por më e fortë se vetë pësimi është e keqja që mbetet prej saj.*

*158: Është i pamundur ai që nuk numëron për çdo sprovë një durim, për çdo mirësi një falënderim dhe për çdo vështirësi një lehtësim.*

*159: Nuk kërkohet më shumë prej të dashurit sipas falënderimit dhe nuk pakësohet e urryera sipas durimit.*

*160: Gjëja më e dobishme për njeriun është kur ai i parakalon njerëzit në vënien në dukje të metave të veta; ushqimi më i fortë është fshehja e varfërisë dhe nga gjërat që kërkojnë kujdesin më të madh është këshilla për atë që nuk e pranon dhe fqinjësia me atë që ruhet shumë, kurse shpirti më i gjerë është prerja e shpresës prej njerëzve.*

*161: Ai, që merr ndaj vetes qëndrim akuzues, nuk e njollos asnjërin prej atyre që ka menduar keq për të.*

*162: Kush e mban të fshehtë sekretin e vet, e ka të mirën në dorën e tij. Çdo bisedë, që e dinë më shumë se dy vetë, ka marrë dhenë.*

*163: Vëre punën e vëllait tënd në më të mirën për të dhe mos e kujto të keqe një fjalë që ka dalë prej vëllait tënd kur ti gjen se ajo mbart të mirën.*

*164: Ke detyrime ndaj vëllezërve të sinqertë, sepse ata janë furnizim në mirëqenie dhe pritë në sprova.*

*165: Nga hijeshitë e besimit është dituria mbi rregullat e ligjit të fesë, nga hijeshitë e rregullave të ligjit të fesë është qetësimi në çaste zemërimi, nga hijeshitë e qetësimit në çaste zemërimi është shoqërimi, nga hijeshitë*

*e shoqërimit është butësia dhe nga hijeshitë e butësisë është lehtësimi.*

*166: Falja e bukur është të mos qortosh për fajin dhe durimi i bukur është kur në të nuk ka ankesa.*

*167: Mufeddal ibn Umeri e pyeti se kush numërohet dhe imam Sadiku i tha: “Paratë.”*

*Ai pyeti: “Po respekti?”*

*Imami (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Devotshmëria.”*

*Përsëri ai pyeti: “Po lavdia?”*

*Imami iu përgjigj: “Bujaria. Ah more, a nuk e ke parë ti Hâtem Taj’jin se si u bënë zotërinj njerëzit e tij dhe ç’vend kishte më bujari prej tyre?”*

*168: Puna e mirë është zekati për mirësitë, ndërmjetësimi është zekati për autoritetin, sëmundjet janë zekati për trupin, falja është zekati për fitoren dhe ai, që e jep zekatin e tij, është i siguruar prej grabitjes.*

*169: Nga sjelljet e injorantit është se ai përgjigjet para se të dëgjojë, kundërshton para se të kuptojë dhe jep gjykimin për gjëra që nuk i di.*

*170: Sekretit yt është prej gjakut tënd, prandaj mos e lëviz atë përveçse në damarët e tu.*

*171: Zemra jote është më e gjera për sekretin tënd.*

*172: Ai, që nuk vëllazërohet me atë që nuk ka të meta, ka pak miq; ai, që nuk është i kënaqur prej mikut të vet, duke e preferuar atë mbi veten, zemërimi i tij do të*

vazhdojë dhe ai, që qorton për çdo faj, do të vazhdojë të jetë i ngadaltë.

173: Sikur i keqi të dinte moralin, me siguri do të torturonte veten që ta kishte sa më të lehtë moralin e tij.

174: Sa herë që njeriun e mbulojnë dallgët, sa herë që atij i mbyllet mendimi dhe sa herë që atij i bëhet thirrje për mashtrime, vetëm qetësimi në çaste zemërimi është çelësi i tij.

175: Tre persona kanë vetëm të mira: ata që heshtin, ata që lënë sherrin dhe ata që përmendin shpesh All'llahun e Lartësuar. Mbi këto qëndron kryeultësia.

176: Provoje vëllain tënd në një mirësi, që është e re për ty ose kur ti e bën atë zëvendësin tënd në një punë.

177: Ai, që e nxjerr zemërimin e tij mbi mundimin e vet dhe ai, që i fuqizon dëshirat e veta, i është dobësuar vendosmëria.

178: Kush nuk e ve provimin para sigurisë dhe sigurinë para butësisë, dashuria jep si fryt pendimin.

179: Shikimi i njeriut me bishtin e syrit është njëra anë e njoftimit të tij.

180: Ai, që vepron vetëm sipas mendimit të vet, ka qëndruar mbi shkarjet.<sup>1</sup>

181: Ai, që nuk i kërkon All'llahut nga mirësitë e Tij, është varfëruar.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> "El Bihâr", duke filluar nga Nr. 155.

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli "Mirësia e lutjes dhe nxitja për lutje".

182: Lutja arrin më shpejt se maja e shigjetës.<sup>1</sup>

183: Tek ai ishin disa vetë, të cilëve po u fliste. Njëri prej tyre përmendi një burrë, për të cilin ankohej. Ebu Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Ku është e gjitha kjo me vëllain tënd, cili është nga burrat që nuk gabon?"<sup>2</sup>

184: Afrimi ndërmjet vëllezërve në vendbanim është vizita e ndërsjellë dhe në udhëtim është korrespondenca e shkruar në letra.<sup>3</sup>

185: Zemrat duan atë, prej të cilit kanë më shumë dobi dhe urrejnë atë që i dëmton më shumë ato.<sup>4</sup>

186: Borxhi natën është pikëllim dhe ditën është poshtërim.

187: Bëjini mirë prindërve tuaj, që t'u bëjnë mirë fëmijët tuaj dhe ruani nderin e grave të botës, që të jenë të ndershme gratë tuaja.

188: Burri ka shumë mirësi me vëllain e vet dhe nuk ka të mirë prej shoqërimit me atë që nuk shikon për ty ashtu siç shikon ti për atë.

189: Dy burra u grindën në praninë e imam Sádikut dhe ai u tha atyre: "Dijeni se nuk ka triumfuar me të mirë ai që ka fituar me padrejtësi. Ai, që ui bën keq njerëzve, nuk e urren të keqen kur ia bëjnë atij.

190: Nuk ka jetesë më të uruar se morali i mirë, nuk ka pasuri më dobishjellëse se kënaqësia në gjendje të mirë

<sup>1</sup> "El Kâfij", kapitulli "Lutja është arma e besimtarit".

<sup>2</sup> "El Kâfij", kapitulli "Durimi në qetësi".

<sup>3</sup> "El Kâfij", kapitulli "Korrespondenca me shkrim letrash".

<sup>4</sup> "Reudatul Kâfij".

*ekonomike e që ka shpërblim. Nuk ka injorancë më dëmtuese se pëlqimi i vetes.*

*191: Shtrëngoni dorën e njëri-tjetrit, sepse shtrëngimi i duarve largon urrejtjen.*

*192: Kije frikë All'llahun qoftë edhe pak, në disa nga gjërat që duhet të ruhesh dhe, mes teje e All'llahut vë një perde, qoftë edhe e hollë.*

*193: Shikimi i shumtë me urtësi e bën mendjen pjellore.*

*194: Prej një burri është pyetur për cilësinë e drejtësisë dhe imam Sadiku iu përgjigj: "Kur ai ul bishtin e syrit të tij nga gjërat e ndaluara, kur rrudh gjuhën e tij nga mëkatet dhe kur ndalon dorën e tij nga padrejtësitë."*

*195: Kush nuk njeh mirësinë e asnjërit, i pëlqen vetëm mendimi i vet.*

*196: Dy cilësi nuk janë së bashku te hipokriti: morali i mirë dhe dijenia e rregullave të fesë në Sun'netin.*

*197: Asnjë nuk e përzgjedh dot jetesën e mirë, edhe nëse atë e ndihmojnë punët, përveçse prej ndonjë të çare të urryer. Ai, që pret të vonojë largimin me ardhjen e shpejtë të rastit, rastin e tij e grabisin ditët, sepse ditët janë të atilla që grabisin dhe rruga e kohës është se ajo kalon.<sup>1</sup>*

*198: Sa mendjemëdhenj janë me atë që i ka dhënë All'llahu! Sa janë të lartësuarit shkallë pas shkalle me*

---

<sup>1</sup> "Tuhuful Ukùl", nuk është libri, që ata e kanë emërtuar "Nethru Derijr", f. 281.

*mbulimin që i ka bërë All'llahu dhe sa janë vënë në sprovë me lavdërimin e njerëzve?<sup>1</sup>*

*199: Shëndeti është mirësi e fshehur. Kur ti e ke atë, harron dhe, kur e humb, kujtohesh.*

*200: Shëndeti është një mirësi, që nuk mundëson falënderimin për të.<sup>2</sup>*

*201: Pesimizmi është në tri gjëra: te gruaja, te kafsha dhe te shtëpia. Pesimizmi në gruan është për shumën e madhe të parave të kurorës së saj dhe në mosrespektimin e burrit të saj; në kafshën është për pamjen e saj të keqe dhe në mospranimin e saj për t'i hipur, kurse pesimizmi në shtëpinë është në sipërfaqen e ngushtë, në komshinjtë e këqij dhe në mangësitë e saj të shumta.<sup>3</sup>*

*202: Kur imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) është pyetur: "Cila është cilësia më e bukur e burrit?", ai është përgjigjur: "Seriozitet pa madhështi, tolerancë pa kërkuar shpërblim dhe lodhje jo me gjërat e kësaj bote."*

*203: Kur në atë nuk janë pesë, nuk ka shumë gjëra që i sjellin kënaqësi. Kur E pyetën imam Sádikun: "Cilat janë këto o nipi i të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij?)"*

*Imam Sádiku i tha: "Feja, mendja, turpi, morali i mirë dhe edukata e mirë. Kur në atë janë pesë, ai kurrë nuk ka dhembje në jetë: shëndeti, siguria, pasuria, kënaqësia me*

---

<sup>1</sup> "Reudatul Kâfij".

<sup>2</sup> "Mexhâlisu Sudûk", kuvendi i 40-të.

<sup>3</sup> "Mexhâlisu Sudûk", kuvendi i 42-të.



*atë që ka dhe shoku i vlefshëm, me të cilin i përputhen mendimet.<sup>1</sup>*

*204: Sa herë durimi për një orë ka sjellë një gëzim të zgjatur dhe sa herë një kënaqësi e vetme ka sjellë hidhërim të zgjatur?!<sup>2</sup>*

*205: Nuk është maturi kërkimi me maturi i vëllezërve.<sup>3</sup>*

*206: Nuk ka mendim ai që mban urinimin, nuk ka shok ai që ka përmbysje të shpejta, nuk ka pasurim për smirëziun, nuk ka përsosmëri për atë që nuk vështron në përfundimet, pasi vështrimi në përfundimet është fekondimi i zemrave.*

*207: Është detyrë për ty bujaria dhe morali i mirë, sepse këto të dyja e zbukurojnë burrin, ashtu siç zbukuron varësen perla në mesin e saj.*

*208: Tri gjëra janë prej lumturisë: gruaja që mban trupin drejt në ecje e në shpejtësi, djali i mirë dhe burri që siguron jetesën e tij, që punon për përmirësimin e saj dhe e çon atë për njerëzit e familjes së vet.<sup>4</sup>*

*209: Gjumi është qetësim për trupin, fjala është qetësim për shpirtin dhe heshtja është qetësim për mendjen.<sup>5</sup>*

*210: Mos e quaj burrin mik me cilësitë e njohura, derisa ta provosh atë me tri gjëra: ta zemërosh atë dhe të*

---

<sup>1</sup> "Mexhâlisu Sudûk", kuvendi i 48-të.

<sup>2</sup> "Mexhâlisu shejh Tûsit", kuvendi i 6-të.

<sup>3</sup> "Mexhâlisu shejh Tûsij", kuvendi i 10-të dhe "El Vesâil", vëll. 8, f. 3 dhe f. 458.

<sup>4</sup> "Mexhâlisu shejh Tûsij", kuvendi i 11-të.

<sup>5</sup> "Mexhâlisu Sudûk", kuvendi i 68-të.

*presësh që zemërimi ta nxjerrë nga e vërteta për në të gabuarën, ta provosh në pará e argjend dhe kur të udhëtosh së bashku me të.<sup>1</sup>*

*211: Sa nga mirësitë, që All'llahu i Lartësuar i ka dhënë robit të Vet, nuk janë në punën e Tij? Sa janë ata që shpresojnë dhe zgjedhja është tek një tjetër? Sa janë ata që kanë humbur, deri kur i ka ardhur vdekja dhe ai ka qenë i ngadaltë në pjesën e caktuar për të?<sup>2</sup>*

*212: Nga padrejtësia është edhe kur kalorësi i thotë këmbësorit: "Hap rrugë!"*

*213: Prej dashurisë së burrit në fenë e tij është dashuria e tij për vëllezërit e vet.*

*214: Nderimi i besimtarit është te namazi që ai fal natën dhe madhështia e tij është në heqjen dorë nga mundimi i njerëzve.<sup>3</sup>*

*215: Afrohuni tek All'llahu duke i dhënë pasuri vëllezërve tuaj.*

*216: Për atë që bën ekonomi jam i sigurt se ai nuk varfërohet.*

*217: Bëj durim ndaj armiqve të mirësive, sepse ti nuk e shpërblen atë që kundërshton All'llahun me ndonjë gjë më të mirë, se sa kur i bindesh Atij.*

*218: Kush është i kënaqur me atë që është vendosur për të, vendimi i vjen atij dhe ai është i shpërblyer. Kush*

---

<sup>1</sup> "Mexhâlisu shejh Tûsij", kuvendi i 32-të.

<sup>2</sup> "Bihârul Anuâr", vëll. 78, f. 4 dhe f. 191.

<sup>3</sup> Kjo fjalë ka kaluar me disa shndërtime.

*është i zemëruar me atë që është vendosur për të, vendimi i vjen atij dhe All'illahu e ul për tokë punën e tij.*

*219: Bëjini dhurata njëri-tjetrit, që të duheni me njëri-tjetrin, sepse dhurata i largon urrejtjet.*

*220: All'illahu nuk është adhuruar më mirë se me heshtje dhe me ecje për në shtëpinë e Tij.*

*221: Ty të ndaloj nga dy vese, në të cilat janë shkatërruar burrat: të besosh All'illahun në mënyrë të gabuar dhe t'u japësh shpjegim njerëzve për çështje të fesë, për të cilat ti nuk ke dijeni.*

*222: Nga e vërteta e besimit është që t'i japësh përparësi të drejtës, edhe nëse ajo të dëmton ty; t'i japësh përparësi asaj ndaj të gabuarës, edhe nëse e gabuara ty të sjell dobi dhe logjika jote të mos e kapërcejë punën tënde.*

*223: Ai, që bën kujdes të tepërt, është privuar nga dy cilësi dhe tek ai do të zënë vend dy cilësi: i është privuar kënaqësia me atë që ka dhe ai kërkon qetësinë, i është privuar zgjedhja dhe tek ai ka zënë vend dituria e qartë.*

*224: Me qëndrueshmërinë është shpëtimi dhe me nxitimin është pendimi.*

*225: Ai, që fillon një punë jo në kohën e vet edhe arritja e asaj pune do të vijë jo në kohën e vet.*

*226: Burrat janë tre llojesh: burrë me pasurinë e tij, burrë me autoritetin e tij, burrë me gjuhën e tij, ky është më i miri i të treve.*

227: *Lypja nuk është e mirë përveçse në tre raste: për të ndërprerë gjakmarrjen, për një gjobë të rëndë, në rast varfërie të tejskajshme.*

228: *Ata, që kanë më shumë të drejtë të urojnë pasurimin e njerëzve, janë koprracët, sepse, kur njerëzit janë të pasur, nuk kanë më nevojë dhe kështu ata heqin dorë nga pasuritë e koprracëve. Ata, që kanë më shumë të drejtë të urojnë përmirësimin e njerëzve, janë personat me të meta, sepse, kur njerëzit janë të përmirësuar, do të heqin dorë nga ndjekja e të metave të personave që i kanë. Ata, që kanë më shumë të drejtë të urojnë butësinë për njerëzit, janë mendjeshkurtrit, pasi ata kanë nevojë që njerëzit t'i falin për mendjen e shkurtër që kanë; prandaj koprracët janë bërë që të urojnë varfëri për njerëzit, personat me të meta janë bërë që të urojnë të meta për njerëzit, mendjeshkurtrit janë bërë që të urojnë indiferentizëm për njerëzit. Varfëria ka nevojë për koprracin, ngatërresat kanë nevojë për mbulimin e të metave dhe mendja e shkurtër ka nevojë të shpërblehet me faje.*

229: *Poshtërohet, ai që armiqësohet me tri gjëra: me babain, me mbretin dhe me borxhëdhënësin.<sup>1</sup>*

230: *Të kërkuara prej njerëzve në këtë botë të përkohshme janë katër: pasuria, shtytja përpara, interesimi i pakët dhe nderimi. Përsa i përket pasurisë, ajo gjendet në atë që i është dhënë, prandaj kush e kërkon atë në shumimin e pasurisë, kurrë nuk do ta gjejë; përsa i përket interesimit të pakët, ai gjendet në punët e pakta dhe ai kurrë nuk do ta këtë atë, sado të shtojë punët; përsa i*

---

<sup>1</sup> "El Khisâl" e Sudükut, kapitulli "Tre".

*përket nderimit, ai gjendet në shërbimin ndaj All'lahut dhe ai, që e kërkon nderimin në shërbimin ndaj krijesave, kurrë nuk do ta ketë atë.*

*231: Gjithë diturinë e njerëzve e kam gjetur në katër gjëra: e para, të njohësh Zotin tënd; e dyta, të dish çka bërë Ai për ty, e treta, të dish çka do Ai prej teje dhe e katërta, të dish ato që ty të nxjerrin nga feja jote.*

*232: Kur përhapen katër dalin sheshit katër: kur përhapet prostitucioni, dalin sheshit tërmetet, kur nuk jepet zekati, ngordhin kafshët shtëpiake, kur sunduesi bën padrejtësi në gjykim, ndalohet shiu dhe kur mbrohet poshtërsia, idhujtarët triumfojnë mbi myslimanët.*

*233: Durimi, bamirësia, butësia dhe morali i mirë janë nga moralet e profetëve.*

*234: Katër shkojnë humbur: ngrënia pas ngopjes, drita kur ka hënë, mbjellja në tokë të kripur dhe bërja e një gjëje tek ata që nuk janë për të.*

*235: Katër shkojnë humbur: dashuria që ti ia jep të pabesit, një punë e mirë tek ai që nuk të falënderon për atë, një dituri tek ai që nuk e dëgjon atë dhe një sekret që ti ia beson atij që nuk e ruan atë.<sup>1</sup>*

*236: Pesë janë të pamundura prej pesëve: këshilla është e pamundur prej një smirëziu, mëshira e dashuria janë të pamundura prej armikut, ndalimi nga gjërat e ndaluara është i pamundur prej mëkatarit, besa është e pamundur prej gruas, madhështia është e pamundur prej varfërisë.*

---

<sup>1</sup> "El Khisàl" e Sudùkut, kapitulli "Katër", duke filluar nga fjala Nr. 230.

237: *Pesë janë si them unë: për koprracin nuk ka qetësi, për smirëziun nuk ka kënaqësi, nuk ka besë ai që kthen shpejt, gënjeshtari nuk ka burrëri dhe nuk bëhet zotëri mendjeshkurtri.*

238: *Pesë nuk flenë: i interesuari për të marrë gjakun, zotëruesi i pasurisë së shumtë nuk ka besnik, ai, që u thotë gënjeshtria e shpifje njerëzve kur do të arrijë ndonjë gjë të kësaj bote, ai, që ka marrë shumë pasuri, por që nuk ka pasuri të veten dhe i dashuruari që parashikon se do ndahet prej atij që do.<sup>1</sup>*

239: *Për atë që nuk ka një këshillues nga ana e vet, një ndalues nga vetvetja dhe një shok që ta udhëzojë në të drejtën, ai i ka dhënë mundësi armikut të vet, që ta kapë atë për fyti.<sup>2</sup>*

240: *Njeriu kurrë nuk do të shkatërrohet prej konsultimit.<sup>3</sup>*

241: *Mirësjellja me njerëzit është një e treta e mendjes.<sup>4</sup>*

242: *Nga kryeultësia është që të përshëndetësh me "Selam" këdo që takon.<sup>5</sup>*

243: *Përmendja e së mirës e shemb atë që është bërë.<sup>6</sup>*

---

<sup>1</sup> "El Khisâl" e Sudûkut, kapitulli "Pesë", duke filluar nga fjala Nr. 236.

<sup>2</sup> "Vesâil shi'ah", kapitulli: "Është veprim i preferuar konsultimi me një të mençur", vëll. 8, f. 425.

<sup>3</sup> "Vesâilu shi'ah", kapitulli: "Është veprim i preferuar konsultimi me mendimtarët", vëll. 8, f. 424.

<sup>4</sup> "Vesâilu shi'ah", kapitulli: "Është veprim i preferuar mirësjellja ndaj njerëzve", vëll. 8, f. 434.

<sup>5</sup> "Vesâilu shi'ah", kapitulli: "Është veprim i preferuar përshëndetja me "Selam", vëll. 8, f. 438.

<sup>6</sup> "Men lâ jahdurul fakijh", vëll. 2, f. 33 dhe f. 41.

244: E mira është në fillim, kurse me atë që ti jep, pasi të është lypur, ke shpërblyer lypësin për atë që ai ka shpenzuar për ty prej fytyrës së tij.<sup>1</sup>

245: Sadakaja më e mirë është ftohja e një zemre të nxehtë.<sup>2</sup>

246: Për atë që ditët e tij janë të barabarta, ai nuk ka kuptuar asgjë, për atë që e sotmja është më e mirë se e djeshmja, ai është në gjendje të mirë.<sup>3</sup>

247: Besimtari zbut dhe nuk polemizon.

248: Ai, që nuk e kontrollon të metën që ka, e meta e tij do të vazhdojë dhe, atij që i vazhdon e meta, vdekja është shumë më e mirë.

249: Ai, që kryen një faj pa qëllim, është prej atyre që falen.<sup>4</sup>

250: Frika është trashëgimi e diturisë; dituria është rrezja e njohjes dhe brendësia e besimit; ai, që është i privuar prej frikës, nuk do të jetë dijetar edhe nëse i bien flokët në udhëkryqet e diturisë.<sup>5</sup>

251: Ai, që përgjigjet për gjithçka sa pyetet, me siguri që është i çmendur.<sup>6</sup>

252: Ai, që grindet me njerëzit, i largohet burrëria.<sup>7</sup>

253: Mos kontrollo njerëzit, se do të mbetesh pa asnjë shok.

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 47, f. 61 dhe f. 118.

<sup>2</sup> "Vesàilu shi'ah", vëll. 3, f. 58.

<sup>3</sup> "Vesàilu shi'ah", libri "Zejdu Zejd".

<sup>4</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 17, f. 265 dhe f. 266.

<sup>5</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 18 dhe f. 52.

<sup>6</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 15 dhe f. 117.

<sup>7</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 2, f. 7 dhe f. 128.

*254: Ai që nuk është i kënaqur me shokun e tij, duke e preferuar atë mbi veten, zemërimi i tij do të vazhdojë.*

*255: Mjafton dituria për frikën ndaj All'lahut dhe mjafton mashtrimi nga padija.*

*Kjo ishte e fundit nga ato që unë e pata të lehtë të mbledh e të përzgjedh prej fjalëve të tij të urta. Mbase unë e kam mbajtur pak si gjatë lexuesin në këtë thesar me fjalë të urta, por gjithmonë i vetëdijshëm për vlerën e tyre, pasi nuk barazohen me asnjë çmim.*

\* \* \*





## LINDJA DHE VDEKJA E TIJ

### *Lindja e tij:*

*Ndër dijetarët e hadithit dhe historianët dihet se imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në shtatëmbëdhjetë të muajit Rebij'ul Ev'vel të vitit 80 ose 83 të Hixhretit. Të dyja këto data janë mjaft të përhapura në rrethet e dijetarëve.*

*Më sipër është folur për disa nga qëndrimet e imam Sádikut para Mensùtit, kur ka thënë: "Ja, unë tani po rrjedh në të shtatëdhjetat.", që do të thotë më shumë se kaq. Tregohet prej Muhammed ibn Rrebijut, portierit të Mensùrit, kur një natë imam Sádiku shkoi tek Mensùri, ai thotë për atë: "...dhe i kishte kaluar të shtatëdhjetat."*

*Edhe El Mexhlisij'ji, ka sjellë një tregim prej Muhammed ibn Seijdit, i cili njofton se imam Sádiku vdiq kur ishte shtatëdhjetë e një vjeç. Siç e sheh, nuk ka përputhje as me fjalën e dytë e as me fjalën e parë, sepse ata ndajnë një mendim të përbashkët se vdekja e tij ka ndodhur në vitin 148 të hixhrit. Mbështetur në këtë datë, lindja e tij duhet të jetë tre vjet ose më shumë para vitit tetëdhjetë.*

*Kështu që tregimet për vitin e lindjes së tij u bënë tre dhe data e mesme i bie të jetë viti tetëdhjetë dhe mbase është më i sakti.*

### *Vdekja e tij*

*Thuhet se imam Sádiku ka vdekur në njëzet e pesë të muajit Shev'vâl, por thuhet se ka qenë në gjysmën e muajit*

*Rexheb, por data e parë është më e pranueshme. Historianët e të dyja grupimeve ndajnë një mendim të përbashkët se ai ka vdekur në vitin 148 të hixhrit, ashtu siç thamë më lart.*

*Gjithashtu, autorët e shi'ave kanë një mendim të përbashkët se Mensùri e helmoi me dorën e prefektit të vet të Medines. Thuhet se helmi ishte vënë në bistakët e rrushit, ashtu siç e thotë këtë El Kef'amij'ji në librin "El Misbàh".*

*Helmimin e tij e kanë përmendur edhe disa autorë nga të Ehli Sun'netit, siç thuhet në librat: "Is'âfu Rr'ràgibijn", "Nùrul Ebsàr", Tedhkiretul Khavàs", "Savàikul Muhrikah" etj.*

*Në çastet e vdekjes*

*Kur ishte në frymëmarrjet e fundit të jetës së tij, urdhëroi të mblidheshin të gjithë të afërmit e tij dhe, pasi u mblodhën, i shikoi të gjithë me radhë dhe u foli atyre: "Ndërmjetësimi ynë nuk e arrin atë që nuk i kushton rëndësi namazit."<sup>1</sup>*

*Ky fakt na tregon interesimin e madh të ligjvënësit të shenjtë për namazin. Imami ynë u shqetësua për këtë porosi edhe në çastet e vdekjes, sepse ai ishte imami që interesohej për punën e ummetit dhe orientimin e ummetit në rrugën e përmirësimit deri në frymën e tij të fundit. Namazi ishte puna më e rëndësishme, për të cilin ai porosiste dhe për të cilin tërhiqte vëmendjen.*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 47, f. 2 dhe f. 5; "Mehàsinul Berkij", vëll. 1, f. 80.

Unë mendoj se me këtë porosi ai ka veçuar të afërmit e tij, sepse njerëzit presin prej tyre përmirësimin dhe udhëzimin, pasi kumtimi i kësaj porosie me gojën e tyre është me shumë efekt, për faktin se ata janë degët e të Dërguarit. Ka mundësi që ata mendonin se afërsia e tyre me Profetin është një mjet ndërmjetësimi për ta, edhe nëse kanë neglizhuar në disa dispozita të ligjit të fesë. Megjithatë, imam Sàdiku u tërhoqte vëmendjen atyre, se afërsia nuk u sillte asnjë dobi, nëse ata nuk kryejnë detyrimet që ka vënë All'illahu.

Gruaja e tij, Um'm Hamijdeh,<sup>1</sup> çuditej me këtë gjendje të tij, kur as vdekja nuk ia largoi dot interesimin për këtë porosi, prandaj ajo qante, kur e kujtonte në atë gjendje.<sup>2</sup>

Gjithashtu, në këtë gjendje ai urdhëroi çdo të afërm të mbante lidhjet me të afërmit e vet; ai porositi t'i jepeshin Hasan El-Eftasit shtatëdhjetë dinarë, ndërkaq shërbyesja e tij, Sàlime, i tha atij: "Si po i jep atij burri që ngriti shpatën mbi ty për të të vrarë?"

Ai tha: "Ti dëshiron, që unë të mos jem prej atyre, për të cilët All'illahu i Lartësuar thotë: "Sa për ata që shkelin besëlidhjen me Allahun, pasi janë zotuar për atë e, që këpusin lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të ruhen dhe bëjnë çrregullime në Tokë - mbi ta rëndon mallkimi dhe përfundimi i keq!" (Sure "Er- Rad", ajeti 21)?

O Sàlime, All'illahu ka krijuar Xhennetin dhe erën e tij e ka bërë të këndshme dhe se era e Xhennetit nuhatet sa distanca e dy mijë vjetëve, por erën e Xhennetit nuk do

---

<sup>1</sup> Ajo është nëna e imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të!).

<sup>2</sup> Për gjendjen e tij kemi treguar në komentin e tij vëll. 1, f. 229.

*ta gjejë ai që sillet keq me prindërit dhe ai që pret lidhjet me të afërmit.”<sup>1</sup>*

*Edhe kjo porosi na orienton për rëndësinë e madhe që ka mbajtja e lidhjeve me të afërmit, menjëherë pas namazit. Në shpjegimet e tij ai ka bërë të qartë pasojat që ka prerja e lidhjeve me të afërmit.*

*Imam Sádiku nuk është mjaftuar vetëm të mbajë lidhjet me të afërmit e tij, pasi ai i ka mbajtur lidhjet edhe me ata të afërm, të cilët i kishin ndërprerë lidhjet me të, madje edhe me ata që e kishin luftuar. Të këtilla janë moralet profetike.*

### *Pas vdekjes*

*Djali i imam Sádikut e ka qefinosur të atin me dy rroba shitavije,<sup>2</sup> që ai i ka përdorur për ihram; gjithashtu, e ka qefinosur edhe me një këmishë të tijën dhe me një çallmë, që ishte e imam Ali ibn Husejnit (Paqja qoftë mbi të!), si dhe me një rrobë të sipërme si pelerinë, të cilën e kishte blerë për dyzet dinarë.<sup>3</sup>*

*Ai urdhëroi të ndizej llamba në shtëpinë ku kishte banuar Ebù Abdil’lahi, imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) deri në kohën kur e kishin detyruar të shkojë në Irak, ashtu siç kishte vepruar edhe vetë Ebù Abdil’lahi më parë në shtëpinë ku kishte banuar babai i tij, imam Bákiri (Paqja qoftë mbi të!).*

<sup>1</sup> “El Menàkib”, vëll. 4, f. 273; “El Gajbeh”, e shejhu Tùsit, f. 128.

<sup>2</sup> Është emri i një fshati në Egjipt, prej nga e kanë marrë emrin rrobat.

<sup>3</sup> Është e qartë se ai është El Axhelij’ji, të cilin Shehràshùbi e ka numëruar ndër poetët luftëtarë në rrugën e All’llahut. Ai tregon se imam Sádiku ka shkruar për të. Kjo tregon se ai ka vdekur para imam Sádikut, por ka të ngjarë që të ketë shkruar edhe kur ai ishte gjallë, ose Qâzimi mund ta ketë shkruar dhe ky shkrim gabimisht i është atashuar Sádikut.

*Kur imam Sàdikun e ngritën për ta çuar në Bekij'ë  
për ta varrosur, Ebu Hurejreh tha:<sup>1</sup>*

*“Unë them, ata po ecin me të duke e mbartur  
mbi krahë e supe.*

*A e dinë ata se cilin po çojnë nën tokë?*

*Vdiq, ai që është kreu madhështor i dijetarëve.*

*Nesër do të nxitojnë mbi varrin e tij.*

*Dheu, do të qe më mirë të ishte mbi ndarëset.*

*Ebù Sàdiku, bir i dy të drejtëve,*

*me prindër të pastër e të drejtë.*

*Për të drejtën tuaj Zotëruesi i Arshit është betuar.*

*Ka thënë i Larti, All'Ilahu, Zoti i lindjeve:*

*“Yje, ata janë dymbëdhjetë.*

*Bëhuni garues.*

*Për tek All'Ilahu vrapo me diturinë e Tij!”*

*Imam Sadikun e varrosën në Bekij'ë së bashku me  
gjyshin e tij nga nëna, imam Hasanin dhe me gjyshin e tij  
nga baba, imam Zejnel Àbidijnin, me babën e tij imam  
Bàkirin (Paqja qoftë mbi të gjithë!). imam Sàdiku është i fundit  
prej imamëve që është varrosur në Bekij'ë, kurse bijtë e tij*

---

<sup>1</sup> Është e qartë se ai është El Axhelij'ji, të cilin Shehràshùbi e ka numëruar ndër poetët luftëtarë në rrugën e All'Ilahut. Ai tregon se imam Sàdiku ka shkruar për të. Kjo tregon se ai ka vdekur para imam Sàdikut, por ka të ngjarë që të ketë shkruar edhe kur ai ishte gjallë, ose Qàzimi mund ta ketë shkruar dhe ky shkrim gabimisht i është atashuar Sàdikut.

janë varrosur në Irak, përveç imam Rizait, që është varrosur në Horasan.

### *Epitetet e tij*

Ai është thirrur me epitetet Ebù Abdil'lah, Ebù Ismàijl dhe Ebù Mùsà, por i pari është epiteti më i përhapur e më i dëgjuar; gjithashtu, ai është thirrur me mbiemrat Sàdik, Fàdil, Kàim, Kàfil, Munxhij e me cilësorë të tjerë, por mbiemri i parë është më i dëgjuari.

Me mbiemrin Sàdik e ka thirrur gjyshi i tij, i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij?) ashtu siç shpjegohet te librat: "El Kharàixhu Uel xheràihu", "El Bihâr" vëll. 11, për gjendjet e tij, për sëmundjet e legjislacioneve, "Kifàjetul Ether" e autorit Ali ibn Muhammed ibn Ali El Khaz'zàz, në parathënien për imam Sàdikun kemi një hadith prej Profetit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij?) i cili është përcjellë prej Ebù Hurejeres: "... dhe All'lahu nxjerr prej trupit të tij, d.m.th. prej trupit të Muhammed Bâkirit, fjalën e vërtetë dhe gjuhën e drejtë."

Ibn Mes'ùdi e pyeti: "Si e quajnë atë o Profet i All'lahut?"

Dhe ai i tha: "Atij i thuhet Xha'fer, ai është Sàdik (i vërtetë) në fjalë e në punët e tij. Ai do të goditet, ashtu siç do të goditet Aliu, do të ketë kundërshtarë, ashtu siç do të ketë edhe Aliu."

Me mbiemrin Sàdik ai u bë shumë i njohur, si të ishte emri i tij i vërtetë, madje as që ishte e nevojshme të përmendej me emër, sepse dihej se për cilin bëhej fjalë,

*sapo të përmendej ky mbiemër. Nisur nga ky fakt, edhe ne e kemi vendosur mbiemrin e tij si titull të librit.*

*Gjithashtu, edhe epiteti i tij, Ebù Abdil'lah, është shumë i njohur si emri i tij, madje nuk ka fare nevojë të përmendet me emrin e me mbiemrin e tij, por vetëm me këtë epitet, sidomos në hadithet.*

#### *Përshkrimi i tij*

*Ibn Shehràshubi në librin “El Menàkib”, e ka përshkruar kështu imam Sàdikun: “Kishte trup mesatar, fytyrë të bardhë, flokë të zinj e të dredhur, hundë të ngritur. Në të dyja anët flokët i zbulonin ballin. Lëkurë të hollë.<sup>1</sup> Në faqe kishte një nishan të zi dhe në trup kishte nishane të kuq.”<sup>2</sup>*

#### *Vizita tek ai*

*Vizita e besimtarit, i gjallë e i vdekur, ashtu siç e dëshmojnë njoftimet, ka aq mirësi, sa nuk mund të matet. Kur është kështu për besimtarin, si duhet të jetë për imamin e besimtarëve? Kur viziton vendin ku kanë rënë profetët dhe të porositurit, ka ringjallje të kujtimit të tyre, lavdërim për mirësitë e tyre, bashkim të zemrave me ata, si dhe nxitje të njerëzve, që ata të kenë dëshirë të punojnë sipas shembullit të veprimeve të tyre. Kështu veprojnë të mençurit e kombeve për ringjalljen e bëmave të të*

---

<sup>1</sup> Në një shkrim thuhet: “Flokët i arrinin deri në mesin e gjoksit, deri në bark.

<sup>2</sup> Domethënë ai mendon se në trupin e tij ka skuqje, por nëse germa e parë e fjalës së teksit arabisht (khajelân) do të lexohet (khijelân), merr kuptimin: ajo që është mbi trupin e tij është prej skuqjes.

*mëdhenjve të tyre, për përtëritjen e kujtimit të mirësisë së tyre dhe për të nxitur ecjen sipas udhëzimit të tyre. Duhet shtuar se vizita në vendin e prehjes së Profetit e të imamëve është madhështim për simbolet e fesë së All'llahut të Lartësuar dhe tregues i devotshmërisë së zemrave.”*

*Njoftimet për mirësinë e vizitës së tij janë dy llojesh: lloji i parë janë njoftimet, që kanë ardhur për vizitën e varreve të tyre në përgjithësi; lloji i dytë janë njoftimet e ardhura për vizitën e varrit të tij në veçanti.*

*Njoftimet e llojit të parë janë të mjaft të shumta. Midis të tjerave është edhe fjala e imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!): “Për çdo imam ka një besë në qafën e miqve e të pasuesve të tij dhe nga plotësimi i mbajtjes së besës është vizita e varreve të tyre. Kush i viziton ata nga dëshira për t'i vizituar, imamët e tyre do të jenë ndërmjetësues për ta në Ditën e Gjykimit.”<sup>1</sup>*

*Gjithashtu, kemi edhe fjalën e Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!): “Shkoni tek i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij?) kur keni si qëllim të vizitoni shtëpinë e shenjtë të All'llahut, sepse mos vizitimi i kësaj shtëpie është humbje. Shkoni edhe tek varret e atyre, vizitën e të cilëve e ka bërë detyrë All'llahu dhe aty kërkoni furnizimin.”<sup>2</sup>*

*Edhe imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ai që viziton një imam, bindja ndaj të cilit është detyrë dhe fal*

---

<sup>1</sup> “Vesàilu shi’ah” , vëll. 5, f. 5 dhe f. 253.

<sup>2</sup> “Vesàilu shi’ah” vëll. 5, f. 10 dhe f. 255.



*tek ai katër rekate namaz, All'lahu shkruan për atë një Haxh dhe një umre.”<sup>1</sup>*

*Hadithe të tilla ka aq shumë, sa nuk numërohen. Shumë nga këto hadithe unë i kam përmendur në librat e mezareve.*

*Përsa i përket llojit të dytë të njoftimeve po sjellim si shembull fjalën e imam Sàdikut: “Kush më viziton mua, fajet e tij janë të falura dhe ai nuk vdes i varfër.”<sup>2</sup>*

*Si dhe fjalën e imam Askeriut (Paqja qoftë mbi të!): “Kush viziton Xha’ferin ose babain e tij, syri i tij kurrë nuk ankohet, atë kurrë nuk e prek ndonjë sëmundje e gjatë dhe nuk vdes i sprovuar.”<sup>3</sup>*

*Ka edhe shumë hadithe të tjera përveç këtyre që u thanë.*

*Shoqata*

\* \* \*

*Fladi*

## FËMIJËT E TIJ

*Ka mendime të ndryshme për numrin e djemve të tij, por më të dëgjuarit prej tyre janë ata që ka përmendur shejh Mufijdi, në librin “El Irshâd”: “Ebu Abdul’lahi (Paqja qoftë mbi të!) kishte dhjetë fëmijë: Ismâilin, Abdullahun, Um’m Fervehin dhe nëna e tyre ishte Fâtimja, e bija e Husejn ibn Hasan ibn Ali (Paqja qoftë mbi të dy!); Mûsà Qazimin (Paqja qoftë mbi të!) Is’hàkun, Muhammedin dhe*

<sup>1</sup> “Vesàilu shi’ah”, libri i mezareve prej librit të Haxhit, vëll. 5, f. 25 dhe f. 260.

<sup>2</sup> “El Mukniah” e shejhut Mufijdit, f. 73.

<sup>3</sup> “Vesàilu shi’ah” vëll. 5, f. 2 dhe f. 426.

*nëna e tyre ishte Um'm Velejdi<sup>1</sup>; Abazi, Aliu, Esmaja dhe Fâtîmja ishin me nëna të ndryshme.*

### *Ismàili*

*Ismàili është më i madhi i fëmijëve të imam Sàdikut të cilin e donte shumë, i bënte mirësi të shumta dhe tregonte kujdes të madh, që të mos i ndodhte ndonjë e keqe atij.*

*Madje imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Mufeddal ibn Umerit: “Ky fëmijë, d.m.th. Mùsà Qàzimi, i cili akoma nuk ka lindur, është djalë prej të cilit përkrahësit tanë do të kenë begati shumë të mëdha.”*

*Pastaj tha: “Mos e largo Ismàilin.”<sup>2</sup>*

*Kjo bisedë tregon për mosvënien e imamatit të Ismàili, pasi imamati ishte për Mùsà, por kur u frikësua se kjo do të sillte largimin e respektit ndaj djalit të madh, tha: “Mos e largo Ismàilin.”*

*Imam Sàdiku ka thënë: “Dy herë ishte shkruar që Ismàili të vritej dhe unë iu luta All'Ilahut të Lartësuar, që ta largonte vrasjen prej tij dhe Ai e largoi.”<sup>3</sup>*

*Janë të shumta fjalët e veprimet, që njoftojnë për dashurinë e mëshirën e tij të madhe ndaj të birit. Aq e madhe ishte dashuria e tij për të, sa disa nga përkrahësit menduan se ai do të ishte imami pas babait të tij. Ata mendonin kështu pasi shihnin dashuri e kujdes shumë të madh, si dhe për faktin se Ismàili ishte më i madhi i*

<sup>1</sup> Është thirrur me epitetin Um'm Hamijdeh.

<sup>2</sup> “El Kâfij”, libri “Argumenti”, kapitulli: teksti për imam Qàzimin (Paqja qoftë mbi të!), vëll. 1, f. 8 dhe f. 309.

<sup>3</sup> “Burrat e shejhut Ebù Ali”.

*vëllezërve në moshë dhe ai që ishte më i madhi i vëllezërve, është ndër shenjat se do të ishte imam. Por ai vdiq kur babai i tij ishte gjallë, kështu që ky mendim nuk u vërtetua.*

*Kur vdiq Ismàili, imam Sàdiku bëri diçka të çuditshme. Pasi djali vdiq, ai urdhëroi që t'i zbulonin fytyrën. Ai ishte i qetë. Pastaj e puthi fort në ballë, në nofull e në gushë. Urdhëroi që ta mbulonin dhe përsëri urdhëroi që ta zbulonin dhe bëri si herën e parë. Kur e lanë dhe e mbështollën me qefin, përsëri urdhëroi që t'i zbulonin fytyrën dhe e puthi për herë të tretë në po ato vende, pastaj kërkoi mbrojtje për të me Kur'anin dhe urdhëroi që ta mbështillnin me kujdes.*

*Në një transmetim tjetër tregohet se ai urdhëroi Mufeddal ibn Umerin që të mblidhte një grup prej shokëve të tij. Ata që u mblodhën u bënë tridhjetë vetë, ndër të cilët Ebù Besijri, Hamrà ibn A'juni dhe Dàùd Err'ekij. Ai i tha Dàùdit: "Zbuloi fytyrën."*

*Dàùdi zbuloi fytyrën e Ismàilit, pastaj tha: "Mendo pak o Dàùd dhe shiko, gjallë është ai apo ka vdekur?" Dhe vijoi të thotë: "Jo, ai është i vdekur." Pastaj ia tregoi burrave një e nga një deri tek i fundit dhe tha: "O Zoti im, dëshmo!"*

*Pastaj urdhëroi ta lanin e ta përgatisnin. Pastaj foli: "O Mufeddal, hiqja mbulesën prej fytyre!"*

*Ai ia hoqi mbulesën e fytyrës.*

*Atëherë ai tha: "Gjallë është apo vdekur?" Shikojeni atë, shikojeni të gjithë sa jeni këtu."*

*Ata thanë: “Ai, o zotëria ynë, është i vdekur.”*

*Atëherë ai tha: “E dëshmuat dhe e vërtetuat këtë?”*

*Ata thanë: “Po.” dhe u çuditën nga veprimi i tij, por ai tha: “O Zoti im, dëshmo për ata!”*

*Pastaj e mbartën për në varrin e tij. Kur e vendosën në gropën e varrit, tha: “O Mufeddal, zbuloje fytyrën e tij!”*

*Ai e zbuloi, pastaj iu drejtua njerëzve dhe tha: “Shikojeni, a është gjallë apo ka vdekur?”*

*Dhe ata thanë: “Po, o mik i All’llahut, ai ka vdekur.”*

*Atëherë ai tha: “O Zoti im, dëshmo!”*

*Pasi e varrosën i është kthyer edhe një herë dhe u ka thënë atyre: “Cili është ky i qefinosur, i parfumuar dhe i varrosur në këtë varr?”*

*Ata thanë: “Është djali yt, Ismàili.”*

*Atëherë ai tha: “O Zoti im, dëshmo!”<sup>1</sup>*

*Njerëzit mund të çuditen nga këmbëngulja e imanit, që njerëzit të mësonin për vdekjen e Ismàilit, deri në atë shkallë sa të mos mbetej asnjë lloj dyshimi për vdekjen e tij, por nuk ka çudira në punët e imanit të botës për atë që do të ndodhë. Ai e dinte që do të kishte njerëz, të cilët do të thoshin se ai është imami, pasi ishte më i madhi i djemve të tij dhe do të pretendonin se ai nuk ka vdekur. Prandaj veproi kështu, që të ishte një argument kundër atyre. Për më tepër, ai vetë e nxori në shesh këtë sekret,*

---

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 47, f. 254.

kur e vunë Ismâilin në varr, kur thirri njerëzit që të dëshmonin, nëse ai ishte i vdekur, sepse shumë nga ata të rrugës së gabuar do të dyshonin, pasi ata janë prej atyre që duan të shuajnë dritën e All'llahut. Pastaj bëri shenjë për tek Mûsà Qazimi (Paqja qoftë mbi të!). Pasi u varros Ismâili, ai u tha atyre që të shikonin e të dëshmonin vdekjen e tij, mori Mûsàin për dore dhe tha: "Ky është i vërteti dhe e vërteta është me të derisa All'llahu të lërë tokën e ata që janë mbi të."<sup>1</sup>

Imam Sàdiku u hidhërua shumë kur vdiq Ismâili. Bëri një sexhde të gjatë, pastaj ngriti kryet dhe shikoi pak fytyrën e Ismâilit, pastaj bëri një sexhde tjetër më të gjatë se e para, ngriti kryet, i mbylli sytë, i lidhi mjekrën dhe i hodhi përsipër mbulesën. Pastaj u ngrit më këmbë dhe në fytyrën e tij kishte hyrë një send shumë i madh, të cilin e panë të gjithë. Në këtë gjendje ai hyri në shtëpi dhe qëndroi për një farë kohe. Pastaj doli midis njerëzve i parfumuar, i zbukuruar e i veshur jo me rrobat që kishte. Fytyra e tij shprehte në fshehtësi gjurmët e pikëllimit. Por ai urdhëroi e ndaloi, derisa mbaruan larjen e të vdekurit. Atëherë ai u tha që ta qefinosnin dhe shkroi në anë të qefinit: "Ismâili dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut!"<sup>2</sup>

Njerëzit u çuditën nga ndërrimi i gjendjes së tij dhe i largimit të atij pikëllimi të madh, prandaj disa nga shokët e

---

<sup>1</sup> "Bihârul Anuâr", vëll. 1, f. 188.

<sup>2</sup> Që nga kjo ditë njerëzit, nën shembullin e imamit, vazhdojnë të shkruajnë fjalën e dëshmisë në qefinët e të vdekurit. Mua më është njoftuar prej disa të ngurtëve se ata shkruajnë për çdo të vdekur të tyre: "Ismâili dëshmon..."

*tij nxituan të thonë: “T’u bëfsha kurban, kujtuam se nuk do të kemi më përfitim me ty, kur pamë padurimin tënd.”*

*Imam Sádiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Ne të Ehli Bejtit jemi të padurueshëm derisa nuk na ka rënë pësimi, por kur ai bie mbi ne, ne e përballojmë atë me durim.”*

*Shokëve të tij u shtroi tryezën me gjellët më të mira e me ngjyrat më të bukura, i ftonte të hanin, madje i nxiste që të hanin, ndërkaq njerëzit nuk shihnin gjurmët e pikëllimit në fytyrën e tij. Ia thanë këtë fakt e ai ia ktheu: “Përse unë të mos jem ashtu siç më shikoni ju, kur në njoftimin e më të drejtit të të drejtëve thuhet: “Unë dhe ju do të vdesim.”*

*Por, kur po e mbartnin për ta varrosur, ai doli i zbathur dhe pa rrobën e sipërme, kjo ishte një shenjë e hidhërimit. Ai urdhëroi të venin krevatin në tokë, që ai të zbulonte fytyrën e djalit. Me këtë ai kishte qëllim që njerëzit të shihnin se ai kishte vdekur. Këtë veprim e përsëriti disa herë, deri edhe brenda në varrin e djalit.<sup>1</sup>*

*Pasi mbaruan varrimin, ai u ul me kokën ulur, i rrethuar nga njerëzit. Pas pak ai ngriti kokën dhe tha: “O njerëz, kjo botë është shtëpia e ndarjes, është shtëpia e lëkundjeve dhe nuk është shtëpia e qetësisë. Ndarja e zakonshme është një rrobë, që nuk shtyhet e një dhembje në zemër që nuk hiqet, por njerëzit i bëjnë mirë njeri-tjetrit duke ngushëlluar me fjalë të mira dhe me mendimin e shëndoshë. Ai që nuk qan vëllain e vet, do ta qajë atë*

---

<sup>1</sup> “El Irshâd” e shejhu Mufujdit, f. 285.

vëllai i tij. Ai, që nuk vë përpara një fëmijë, vetë do të jetë i pari që do të shkojë dhe jo djali.”

Pastaj ai recitoi fjalën e Ebù Kharràsh El Hedhelij'jit:

“Mos mendoni se unë harrova besën e tij,  
por durimi im, o i prerë, është i bukur!”<sup>1</sup>

Kur vdiq Ismàili, imam Sàdiku thirri njërin nga pasuesit e tij, i dha para, duke e urdhëruar që me ato para të kryente Haxhin për djalin e tij, Ismàilin dhe i tha: “Kur ti të kryesh Haxhin për të, nëntë pjesë të shpërblimit janë për ty dhe një pjesë është për Ismàilin.”<sup>2</sup>

Ismàili ka vdekur në Urejd<sup>3</sup> dhe është mbartur në krah për në Medinë<sup>4</sup>; varri i tij në Medinë ishte i njohur, por është shembur nga mbretërit sauditë, ashtu siç u shembën edhe varret e prindërve të tij imamë në Bekijë dhe deri më sot nuk është lejuar rindërtimi i atyre varreve.

Veprimet e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!), ndaj djalit të tij Ismàilit, na tregojnë shkakun që e shtynte imam Sàdikun në atë dashuri e bamirësi, gjithashtu na tregojnë edhe sa i devotshëm e i virtytshëm ishte Ismàili; por ka edhe shumë hadithe e njoftime të rreme. Madje disa prej tyre kanë zbuluar për ne perden që mbulonte gënjeshtren e këtyre njoftimeve që gërryejnë si krimbi brenda në dërrasë, ose ato kanë dalë për qëllime të panjohura për ne. Këto hadithe të rreme, tashmë të zbuluara, janë transmetuar edhe në librin “El Kharàixh uel Xheràih” prej Velijd ibn

<sup>1</sup> “Ikmàlu Dijn”, vëll. 1, f. 63; “El Emàlij” e shejh Sudùkut, f. 237.

<sup>2</sup> Bihàrul Anvâr”, vëll. 47, f. 255.

<sup>3</sup> Njëra nga njësitë administrative të Medines.

<sup>4</sup> “El Irshàd” i shejh Mufijdit, f. 285.

*Sabijhut<sup>1</sup>, i cili tregon: “Erdhi tek unë një burrë dhe më tha: “Eja me mua të tregoj për djalin e zotit tënd.”<sup>2</sup> dhe unë shkova me atë burrin. Ai më çoi tek disa njerëz që po pinin, ndër ata ishte edhe Ismâil ibn Xha’feri. U largova shumë i mërziur dhe vajta e hyra brenda në Qabe, por aty gjeta Ismâil ibn Xha’ferin, që po qante i lidhur pas Qabesë, madje veshja e Qabesë ishte lagur prej lotëve të tij.*

*Ai thotë: “Këtë ndodhi ia tregova Ebù Abdil’lahit (Paqja qoftë mbi të!).”*

*Ai tha: “Patjetër që djali im është sprovuar me një shejtan, që është paraqitur në fytyrën e tij.”*

*Vallë a është pastrimi i Ismâilit më i preferuar se ky hadith? Prandaj është e domosdoshme që hadithet e rreme të flaken ose ato të shpjegohen ndryshe nga qëllimet që tregojnë në pamjen e jashtme. Nëse për Ismâilin janë stisur të tilla hadithe të rreme, imam Sâdiku kurrë nuk do të ishte i lidhur aq shumë pas tij, qoftë kur ishte në udhëtim, qoftë kur ishte në vendbanimin e tij. Ndryshe ai do ta kishte larguar atë, ashtu siç largoi djalin tjetër të tij, Abdullahun.*

*Kur Ismâili vdiq, u shporrën edhe fjalët për imamatin e tij, prej të gjithë atyre që mendonin se imamati do të*

---

<sup>1</sup> Ebul Abbàs El Kûfij, ishte prej transmetuesve të imam Sâdikut dhe nga të besueshmit. Ka shkruar një libër, në të cilin ka transmetuar Hasan ibn Mahbûb prej djalit të tij Abbàs.

<sup>2</sup> Me fjalët “Zotit tënd” ai do të thoshte për imam Sâdikun sipas pretendimit të rremë të atyre që thonë se shi’at besojnë se imamët janë zota. Nuk mund të ketë shpifje më të madhe se kaq. Ne më sipër, në pjesën e parë të librit, në faqen 54, të tekstit arabisht, kemi shpjeguar rreth besimit të imamëve te imami, përveç kumtesës sonë “Shi’at dhe imamati”. Është e vërtetë se ka disa grupe që e kapërcejnë logjikën, por imamët, madje edhe grupet nga të shi’ave, nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për këto grupe tejet ekstreme.



*ishte te ai, pas babait të tij. Megjithëkëtë, fjalët për imamtin e tij dolën përsëri pas babait të tij, Sàdikut. Ata, që thonë për imamatin e tij, quhen Ismailij. Ne kemi folur për këtë grup në pjesën e parë, faqe 52, të tekstit arabisht.*

*Edhe shejh Mufijdi, ka përmendur në “El Irshàd” se ata, që kanë atakuar jetën e tij, janë një pakicë, të cilët nuk kanë qenë prej transmetuesve të veçantë të babait të tij, por kanë qenë prej njerëzve të largët. Kur vdiq imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!), njëri grup prej tyre e kaloi fjalën për imamatin e Mùsà Qazimit, pas babait të tij, kurse ata, që mbetën, u ndanë në dy grupe, njëri grup iu kthye jetës së Ismàilit dhe thanë për imamatin e djalit të tij, Muhammed ibn Ismailit, pasi ata besonin se imamati ishte te babai i tij dhe se djali ka më të drejtë se vëllai të zërë vendin e babait; kurse grupi tjetër i qëndroi mendimit se Ismaili ishte gjallë. Në ditët e sotme ata mund të jenë vetëm disa të shpërndarë, që askush nuk di të tregojë se cilët janë; pra, këto dy grupe quhen ismailitë.*

*Dihet se ka prej tyre, që pretendojnë se imamati, pas Ismailit, është te djali i tij dhe te djali i djalit të tij dhe kështu me radhë deri në ditën e fundit.*

#### *Abdullah këmbështrembri*

*Abdullahu ishte djali më i madh i imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) pas Ismàilit, prandaj është ngatërruar puna për një grup, që janë shprehur për imamatin e tij, sepse imamati është në djalin më të madh. Ata nuk e dinë se imamati është në më të madhin, kur ai nuk ka të meta fizike, kurse Abdullahu i kishte këmbët të shtrembra,*

*prandaj u quajt këmbështrembri (El Eftah), kurse ata që pretendojnë imamatin për atë quhen fetahi.*

*Abdullahu kundërshtonte babain e tij në besim dhe thuhej se ai përziante hashevitë dhe anonte kah medh'hebi i merxheive, prandaj edhe respekti i babait për të nuk ishte si për vëllezërit e tij<sup>1</sup>.*

*Mbase babai atë e ka qortuar dhe patjetër e ka këshilluar, por atij nuk i bënte përshtypje as këshilla e as qortimi dhe një ditë i tha: “Ç’të pengon të jesh si vëllai yt? Beto hem në All’llah se në fytyrën e tij unë shoh dritë.”*

*Atëherë Abdullahu i tha: “Përse, a nuk është babai im e babai i tij i njëjti njeri? Edhe nëna ime e nëna e tij është e njëjta grua.”*

*Atëherë imam Sàdiku i tha: “Ai është prej shpirtit tim dhe ti je djali im.”<sup>2</sup>*

*Mendoj se imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) me fjalën e tij “vëllai yt” ka pasur qëllim Ismàilin, prandaj edhe Abdullahu është përgjigjur: “A nuk është babai im e babai i tij i njëjti njeri? Edhe nëna ime e nëna e tij është e njëjta grua.”*

*Ka thënë kështu se vëllai i tij për babë e për nënë ishte Ismàili dhe jo Mùsài.*

*Është i mjaftueshëm ky hadith për të treguar mirësinë e Ismàilit dhe pozitën e tij të lartë tek All’llahu e tek babai*

---

<sup>1</sup> “El Irshad” i shejh Mufijdit, f. 285.

<sup>2</sup> “El Kâfij” libri: “Argumenti” kapitulli: “Teksti origjinal për imam Qàzimin, vëll. 1, f. 10 dhe f. 310.

*i tij; gjithashtu, hadithi tregon edhe injorancën e Abdullahut e pozitën e tij të ulët tek All'llahu dhe tek babai i tij.*

*Abdullahu ka pretenduar imamatin pas babait të tij me argumentin se ai është vëllai më i madh. Imam Sàdiku e kishte lajmëruar djalin e tij, Musa Qàzimin (Paqja qoftë mbi të dy!) se Abdullahu shumë shpejt pas tij do të pretendonte imamatin dhe se do të ulej në vendin ku rrinte ai. Prandaj urdhëroi që të mos grindeshin me të e as të mos i flisnin, sepse ai do të ishte i pari prej familjes së tij që do të bashkohej me atë në atë jetë. Ndodhi ashtu siç kishte njoftuar imam Sàdiku.<sup>1</sup>*

*Ky është edhe shkaku që një grup prej shokëve të imam Sàdikut pretenduan imamatin për të pasuar Abdullahun, por më pas pjesa më e madhe e tyre ndërroi mendim dhe u kthyen në imamatin për Musà Qàzimin (Paqja qoftë mbi të!). Kthimi i tyre ndodhi kur u dobësua pretendimi i Abdullahut dhe u përforcua argumenti prej Ebù Hasanit (Paqja qoftë mbi të!), si dhe faktet që tregonin imamatin e tij.<sup>2</sup>*

*Prej atyre që kanë hyrë tek ai dhe që vërtetojnë saktësinë e pretendimit të tij janë Hishàm ibn Sàlimi dhe Mu'min Et Tàk, ndërsa njerëzit ishin të mbledhur rreth tij dhe i kishin mbërthyer sytë mbi të. Ata të dy e pyetën sa duhet të ndanin për zekatin. Ai tha: "Në dyqind pesë."*

*Ata të dy pyetën përsëri: "Po në një qind?"*

*Ai tha: "Dy dirhem e gjysmë."*

---

<sup>1</sup> "Bihàrul Anuàr", vëll. 47, f. 29 dhe f. 261; "El-Keshà", f. 165.

<sup>2</sup> "El Irshàd" i shejh Mufijdit, f. 285; "El Keshà", f. 165.

*Ata të dy i thanë atij: “Betohemi në All’llah, merxheitë nuk e thonë këtë.”*

*Ai ngriti dorën në drejtim të qiellit dhe tha: “Jo, betohem në All’llah, unë nuk e di se ç’thonë merxheitët.”*

*Kështu ata mësuan se tek ai nuk kishte asnjë send dhe dolën prej tij në rrugë të gabuar, pa ditur ku të drejtoheshin, prandaj u ulën në disa rrugica të Medines duke qarë. Ishin të hutuar dhe që të dy thoshin: “Nuk dimë ku të shkojmë dhe cilit t’i drejtohem: merxheive, kaderive, zejdive, muëtezileve apo havarixhëve.”*

*Ndërsa ishin në këtë gjendje, Hishàmi pa një plak, të cilin nuk e njhte dhe që bënte shenjë me dorë për tek ai, por ai kishte frikë se mos ishte ndonjëri prej spiunëve të Mensùrit, i cili kishte shumë sy në Medine, që të zbulonin kush ishte nga pasuesit e imam Xha’fer Sadikut që atij t’i prisnin kokën. Prandaj Mu’nin Et T’æk i tha: “Bëj mënjanë, se kam frikë për vete e për ty. Mbase ai më gjurmon mua dhe nuk të gjurmon ty, prandaj largohu, që të mos prishesh dhe ruaje veten.”*

*Ebù Xha’feri u largua pak, por jo shumë larg dhe kështu Hishàmi e ndiqte plakun. Ai vazhdoi ta ndjekë plakun nga pas, derisa arriti në portën e Ebù Hasanit, Mùsàit (Paqja qoftë mbi të!) pastaj e la plakun, i cili shkoi në punën e vet. Një shërbyes në portë i tha: “Hyr, All’llahu të mëshiroftë!”*

*Kur ai hyri, Ebù Hasani filloi të thotë: “Tek unë, tek unë, tek unë, jo tek merxheitë, jo tek kaderitë, jo tek zejditë, jo tek mu’tezilet dhe jo tek havarixhët.”*

*Pastaj Hishàmi doli prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të!) dhe Ebù Xha'feri takoi Mu'min Et T'àkun, i cili i tha: "Ç'na sjell?"*

*Dhe ai tha: "Udhëzimin" dhe i tregoi ngjarjen. Pastaj u takua me Mufeddal ibn Umerin dhe Ebù Besijrin, të cilët, pasi hynë tek ai dhe përshëndetën me "Selam" dhe dëgjuan fjalën e tij, e pyetën dhe u larguan prej tij."*

*Hishàmin vinin dhe e takonin njerëzit grupe-grupe dhe çdo njeri, që hynte tek ai, largohej prej tij, përveç një grupi, siç ishte grupi i Am'màr Sàbàtij'jit e të shokëve të tij, kështu që Abdullahu mbeti e nuk hynte njeri tek ai, me përjashtim të disa vetëve. Kur Abdullahu mësoi se shkak, që i ndalonte njerëzit, ishte Hishàmi, vuri në Medine më shumë se një person që ta vrisnin atë.<sup>1</sup>*

*Abdullahu vazhdoi të këmbëngulte në pretendimin për imamatin derisa vdiq. Ai ka jetuar pas babait të tij vetëm shtatëdhjetë ditë. Pas vdekjes së tij njerëzit u kthyen të pranojnë imamatin për Ebù Hasanin (Paqja qoftë mbi të!) përveç disa pak vetëve prej tyre, të cilët u quajtën "fetahi", ashtu siç u tha. Ata u quajtën me këtë emër, sepse pretendonin imamatin për Abdullahun, i cili ishte këmbështrembër<sup>2</sup>, ose e kishte kokën jo të rregullt. Gjurmët e këtij grupi janë ndërprerë pas pak kohe dhe të fundit prej tyre kanë qenë pjesëtarët e fisit beni Fedâl.*

*Is'hàku*

---

<sup>1</sup> "Rixhalul Keshà", f. 165.

<sup>2</sup> "El rshàd" i shejh Mufijdit, f. 286.

*Ishte prej njerëzve bamirës e të mirë, njeri që ruhej shumë, ishte studiues e hulumtues. Prej tij njerëzit kanë transmetuar hadithe e tekste të veçanta, që nuk lenë asnjë dyshim. Ibn Kàsibi,<sup>1</sup> kur fliste për të, thoshte: “Unë kam biseduar me të besueshmin, Is’hàk ibn Xha’feri, i cili shprehej për imamatin e vëllait të tij, Mùsà Qazimin (Paqja qoftë mbi të!) dhe prej babait të tij transmetohet teksti, që nuk le asnjë dyshim për vëllanë e tij, Mùsàne (Paqja qoftë mbi të!)”*

*Gjithashtu, një tekst tjetër transmetohet prej vëllait të tij, Ali ibn Xha’fer, i cili, për nga mirësia dhe ruajtja, nuk ndryshonte nga dy vëllezërit e tij.<sup>2</sup>*

*Is’hàku ishte prej atyre që kanë qenë të pranishëm në dhënien e porosisë prej Qàzimit (Paqja qoftë mbi të!) djalit të tij, Rizàsë (Paqja qoftë mbi të!). Ajo, që dëshmon për virtytin e për ruajtjen e tij, është mbrojtja e tij për Rizànë. Kur imam Qàzimi (Paqja qoftë mbi të!) u nda nga kjo jetë, djemtë e Qàzimit e çuan vëllain e tyre, Rizànë, tek gjykatësi dhe Ab’bà ibn Mùsà i tha: “All’llahu të përmirësoftë dhe, me të, të dhëntë mirësitë! Poshtë librit ka një thesar dhe një diamant dhe ai do që ta fshehë, që ta marrë vetë e të mos e marrim ne, pasi babai ynë (All’llahu e mëshiroftë!), të gjitha sendet i ka lënë tek ai dhe ne na ka lënë varfëri. Sikur të mos e ndaloja veten, do të njoftoja për një gjë para të gjithëve. Menjëherë u hodh drejt tij*

---

<sup>1</sup> Në librat e burrave për Ibn Kàsibin nuk ka gjetur shumë materiale, kurse Et’tarihij’ji dhe El-Kàdhimij’ji e kanë bërë dallimin e Is’hàkut me një transmetim prej Ibn kàsibit dhe nuk kanë përmendur as emrin e tij e as ndonjë gjë prej gjendjes së tij. Kjo fjalë, në lidhje me të vërtetën për Is’hàkun, i adresohet Sufjân Ibn Uajneh, i cili nuk është Ibn Kàsibi.

<sup>2</sup> El Irshâd” i shejh Mufijdit në lidhje me gjendjet e Sàdikut e të Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!) f. 289.

*Ibrâhim ibn Muhammedi<sup>1</sup> dhe tha: “Betohem në All’llah se tani po na njofton për diçka, që ne nuk e pranojmë prej teje dhe nuk të besojmë ty për njoftimin tënd. Pastaj do të jesh ndër ne i njollosur dhe i përzënë. Ne ty të njohin për gënjeshtar. Babai yt ka ditur më mirë se ti nëse ka mirësi te ti, pasi të njihite mirë nga brenda e nga jashtë, prandaj ai ty nuk të besonte as për dy kokrra hurma.”*

*Kundër tij u hodh edhe xhaxhai i tij, Is’hâk ibn Xha’fer dhe duke folur me zë të lartë i tha: “Ti je naiv, i dobët e kokëtrashë dhe për ty dëshmojnë të gjitha ato që bërë dje.” Të gjithë njerëzit e ndihmuan.<sup>2</sup>*

*Prej atyre, që kanë transmetuar prej tij, përveç Ibn Uajneh, janë një grup, ndër të cilët: Bekt ibn Muhammed El Ezedij, Jaëkùb ibn Xha’fer El Xha’ferij, Abdullah ibn Ibrahim el Xha’ferij dhe El Veshâ.<sup>3</sup>*

#### Muhammedi

<sup>1</sup> Është e qartë se ai është djali i Ismâjil ibn Sâdikut

<sup>2</sup> “El Kâfij”, libri: “Argumenti”, kapitulli: “Teksti i vërtetë për imam Rizânë (Paqja qoftë mbi të!) vëll. 1, f. 318.

<sup>3</sup> Bekri është prej atyre që kanë transmetuar prej imam Sâdikut, imam Qâzimit e imam Rizâit (Paqja qoftë mbi ta!) dhe ishte nga transmetuesit e besueshëm, që ka transmetuar prej të besueshmëve; kurse Jaëkùbi ka transmetuar prej Is’hâkut dhe prej tij ka transmetuar El Kulejni në kapitullin: “Lindja e Ebù Hasan Qâzimit (Paqja qoftë mbi të!); gjithashtu ka transmetuar edhe në kapitullin “Es’sihâk” prej kapitujve të kurorëzimit. Kjo dëshmon për sigurinë e tij, por elita e burrave nuk e kanë përmendur atë në ndonjë shkrim të veçantë, madje janë të shumtë ata që e kanë lënë pas dore. Ai është Ibn Xha’fer ibn Ibrâhim ibn Muhammed ibn Ali ibn Abdullah ibn Hasan ibn Ali ibn Ebù Tâlib; kurse Abdullahu është xhaxhai i Ja’kùbit, që u tha më sipër dhe që është Ebù Muhammed, i besueshmi, i drejti; kurse El Veshâ është Hasan ibn Ali ibn Zijâd dhe është prej shokëve të imam Rizâsë (Paqja qoftë mbi të!) dhe është prej transmetuesve të tij të besueshëm.

Muhammedi ishte bujar, trim. Agjëronte një ditë po dhe një ditë jo. Gruaja e tij Hadixheja, e bija e Abdullah ibn Hyseit,<sup>1</sup> thoshte: “Muhammedi kurrë nuk ka dalë ndër ne me të njëjtën rrobë. Ndryshe ai kthehej dhe e vishte. Çdo ditë therte një dash për mysafirët që i vinin<sup>2</sup> dhe quhej me epitelin “Dijbàxheh” për mirësinë e bukurinë e fytyrës së tij.”<sup>3</sup>

Në lidhje me kundërshtimin me shpatë në dorë i përmbahej pikëpamjes së Zejdive dhe në vitin 199 ai është ngritur në Mekke kundër Me'mùnit. Në këtë ngritje atë e ndoqën zejditë xharùdij.<sup>4</sup>

Kur u bë besëdhënia për hilafetin dhe ai bëri thirrje për vete, që të ishte halif dhe u thirri besimtarëve, tek ai hyri imam Rizài (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: “O xhaxha, mos përgënjeshtro babain e vëllait tënd, sepse kjo punë nuk mund të bëhet.”

Pas pak kohe u ngrit kundër tij Isà El Xhelùdij, u takuan dhe e shpartalloi. Pastaj ai kërkoi siguri pranë tij, veshi të zezën,<sup>5</sup> u ngjit në minber dhe e hoqi veten nga pushteti duke thënë: “Kjo punë është për Me'mùnin dhe unë nuk kam të drejtë për këtë post.”<sup>6</sup>

Kur ai deshi të befasonte ushtrinë e El Xhelùdij'jit, Rizài nisi për udhëtim shërbëtorin e vet, me këtë udhëzim:

<sup>1</sup> Ibn Ali ibn Husejn ibn Ali ibn Ebù Tàlib.

<sup>2</sup> “El Irshàd” i shejhut Mufujd për gjendjet e tij, f. 286.

<sup>3</sup> Librat e burrave në parathënien e tij.

<sup>4</sup> “El Irshàd”, f. 286.

<sup>5</sup> E zeza ishte simboli i abasëve. Me këtë ai donte që simboli i tij të ishte si simboli i tyre, kurse pasardhësit e Aliut (alevitë) kishin simbol të gjelbrën.

<sup>6</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 47, f. 5 dhe f.246.



*“I thuaj atij, të nesërmen mos dil. Nëse ti del nesër, do të shpartallohesh dhe shokët e tu janë të vrarë. Nëse ai të thotë se nga e di ti këtë, i thuaj se e kam parë në ëndërr.”*

*Muhammedi tregon: “Shërbyesi fjeti, ai nuk lau pjesët e poshtme të trupit dhe puna rrodhi ashtu siç e kishte mësuar imami kur e nisi për udhëtim.”<sup>1</sup>*

*Kur hoqi veten dhe hoqi dorë nga puna e halifit, El Xhelüddij e çoi tek Me’mùni dhe, kur arriti tek ai, Me’mùni e respektoi, e mbajti pranë vetes në kuvendin e tij dhe i dha shpërblime të mira. Në Horasan banonte së bashku me Me’mùnin dhe hipte në një rën nga mjetet e bijve të xhaxhait të tij. Me’mùni parashikonte prej tij një ndryshim, që nuk e parashikon mbreti prej shtetasve të tij.*

*Një ditë Me’mùni e injoroi atë para një grupi nga fisi i Tàlibut, kur nuk pranoi të udhëtonte së bashku me të, pasi ata ishin ngritur kundër Me’mùnit në vitin 200, por që ai i kishte dhënë siguri, prandaj i kishte dërguar urdhrin e firmosur prej tij: “Mos hipni së bashku me Muhammed ibn Xha’ferin, por hipni së bashku me Abdullah ibn Husejnin.”*

*Ata nuk pranuan dhe u larguan nëpër shtëpitë e veta. Pastaj ai lëshoi një shkresë tjetër: “Hipni me kë të dëshironi.”*

*Pas kësaj ata hipnin së bashku me Muhammedin ibn Xha’ferin kur ai shkonte për tek Me’mùni dhe largoheshin kur largohej ai.<sup>2</sup>*

*Kur ai doli prej Me’mùnit, Rizài (Paqja qoftë mbi të!) e largoi dhe tha: “Unë e kisha vendosur me veten time, që mua dhe atë të mos na bëjë më hije e njëjta çati shtëpie.”*

---

<sup>1</sup> “El Irshàd”, f. 286.

<sup>2</sup> “El Irshàd”, f. 286.

*Umer ibn Jezijdi, i cili ishte tek Ebù Hasani (Paqja qoftë mbi të) thotë: “Me vete thashë: “Ky, që urdhëron për bamirësi e për mbajtjen e lidhjeve me të afërmit, thotë këtë fjalë për xhaxhain e vet.”*

*Ai më shikoi dhe tha: “Kjo është prej bamirësisë e mbajtjes së lidhjeve me të afërmit, sepse kur ai vjen tek unë dhe flet për mua, njerëzit i besojnë fjalët e tij, por kur ai nuk vjen tek unë, njerëzit nuk do të pranojnë fjalët e tij kurdo që t'i thotë.”<sup>1</sup>*

*Nga punët e jashtëzakonshme të Ebù Hasanit, Rizàsë (Paqja qoftë mbi të!), në lidhje me Muhammedin, është edhe rasti kur Muhammedi u sëmur. Për këtë njoftuan imam Rizànë (Paqja qoftë mbi të!). I thanë se atij tashmë i kishin lidhur mjekrën. Ai shkoi tek ai së bashku me disa shokë të tij dhe e gjeti se i kishin lidhur mjekrën. Ndërsa Is'hàku, vëllai i Muhammedit, si dhe djemtë e tij, së bashku me një grup nga të familjes së Tàlibit, po qanin. Ebù Hasani u ul pranë kokës së tij, shikoi në fytyrën e tij dhe buzëqeshi. Ata, që ishin aty, e urryen Ebù Hasanin dhe disa prej tyre thanë: “Ai buzëqeshi për të sharë xhaxhain e vet.”*

*Kur dolën, që të falnin namaz në xhami, shokët i thanë: “T'u bëfshim kurban, ne dëgjuam prej tyre se sa të urryen kur buzëqeshe.”*

*Ebù Hasani, imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Unë u çudita nga të qarët e Is'hàkut, i cili, betohem në All'illah do të vdesë para tij dhe atë do ta qajë Muhammedi.”*

*Vërtet, Muhammedi u shërua, kurse Is'hàku vdiq.<sup>2</sup>*

*Kur ai banonte në Horasan dhe nuk ia nënshtronte veten asnjë gjembi e asnjë kurore, dua të them, Me'mùnit,*

<sup>1</sup> “Bihàrul Anuàr”, vëll. 47, f. 4 dhe f. 246.

<sup>2</sup> “Ujùnu Akhbàru Ridà” (Paqja qoftë mbi të!) vëll. 2, f. 7 dhe f. 206.

*kundërshtimi i tij ishte se ndihej i shtypur, si i burgosuri i një vendi të mbuluar nga punët e tij. Një ditë e njoftuan se shërbyesit e zotëruesit të dy kryesive<sup>1</sup> kishin rrahur shërbyesit e tij. Doli i veshur me dy rroba dhe me një shkop dhe, duke thirrur me të madhe, tha: “Vdekja është më e mirë për ty se jeta në poshtërim.”*

*Njerëzit i shkuan nga pas, derisa ai rrahu shërbyesit e zotëruesit e dy kryesive dhe u mori atyre drutë. Për këtë ndodhi u njoftua Me'muni dhe ai dërgoi fjalë tek zotëruesi i dy kryesive, duke i urdhëruar: “Shkoni tek Muhammed ibn Xha'feri, kërkoni ndjesë dhe lëreni t'i gjykojë ai shërbyesit tuaj.”*

*Zotëruesi i dy kryesive shkoi tek Muhammedi, të cilit i thanë: “Ka ardhur zotëruesi i dy kryesive.”*

*Muhammedi tha: “Nuk do të ulet në vend tjetër përveçse në tokë.”*

*Kështu morën kanapenë, që ishte në shtëpi dhe, së bashku me ata, që u ndodhën aty, e çuan në një anë. Në shtëpi nuk mbeti gjë tjetër përveç një qilimi, mbi të cilin u ul të rrinte Muhammedi. Kur hyri zotëruesi i dy kryesive, Muhammedi i bëri vend të ulej mbi qilim, por ai nuk pranoi të ulej mbi të dhe shkoi u ul mbi tokë, i kërkoi ndjesë dhe i tha që të gjykonte shërbyesit e tij.*

*Muhammed ibn Xha'feri ka vdekur në Horasan dhe Me'muni ka shkuar vetë atje që të merrte pjesë në varrimin e tij. Kur ka arritur pranë shtratit, ku ishte vënë, ka zbritur*

---

<sup>1</sup> Ai është Fadl ibn Sehl, ministër i Me'munit dhe është quajtur zotëruesi i dy kryesive, sepse mbante dy kryesitë, kryesinë e shpatës dhe të lapsit.

*nga mjeti, ka ecur në këmbë, derisa kanë hyrë ndërmjet dy kolonave dhe aty ka qëndruar derisa e kanë ulur. Bëri përpara dhe u lut për Muhammedin, pastaj e ka mbartur deri në varr. Ka hyrë brenda varrit të tij dhe ka qëndruar brenda në varr derisa kanë filluar ta mbulojnë. Pastaj ka dalë dhe ka qëndruar mbi varr, derisa ka përfunduar varrimi. Abdullah ibn Husejni e ka thirrur dhe i ka thënë: “O Prijës i Besimtarëve, sot u lodhe, sikur të hipje.”*

*Por Me'mùni tha: “Kjo afërsi është ndërprerë që prej dyqind vjetësh.”*

*Muhammedi kishte marrë shumë borxhe, prandaj Ismàijl ibn Muhammedi desh të përfitonte nga ky rast prej Me'mùnit, që t'i kërkonte atij të shlyente borxhet e babait të tij. Prandaj i tha vëllait të vet, i cili ishte përkrah Me'mùnit pranë varrit: “Sikur t'i flasim atij për borxhin e babait, pasi nuk do të jesh kurrë ndonjë herë kaq afër tij.”*

*Me'mùni i dëgjoji dhe tha: “Sa borxhe ka lënë Ebù Xha'feri?”*

*Ismàijli i tha: “Njëzet e pesë mijë dinarë.”*

*Ai tha: “All'llahu ia ka shlyer atij borxhin. Po, kujt t'i lë porosi?”*

*Ata i thanë: “Një djali të tij në Medine, që quhet Jahjà.”*

*Mensùri tha: “Ai nuk është në Medine, është në Egjipt.”*

*Ne e dinim se ai ishte atje, por na erdhi rëndë t'i thoshim se ishte larguar nga Medineja, që të mos ndihej*

*keq për këtë gjë, pasi e dinte që ne nuk na vinte mirë që ai ishte larguar prej Medines.”<sup>1</sup>*

### *Aliu*

*Ali ibn Xha’feri arriti të bëjë përpara, aq sa nuk arrihej. Edhe në mirësi atë nuk e kalonte askush, kurse në fushën e hadithit e në besueshmërinë e tij nuk ka të dytë. Kushdo që shfleton librat e hadithit, do të mësojë se sa shumë njoftime ka transmetuar ai prej vëllait të vet, imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të!) dhe se çfarë diturie zbulojnë ato hadithe.*

*Shejh Mufijdi, në librin e tij “El Irshad”, për Aliun thotë: “Ali ibn Xha’feri ishte transmetues hadithesh, ndiqte një rrugë të qartë, ishte shumë i ruajtur, me shumë virtyte, ishte i angazhuar me vëllain e vet Mùsà në (Paqja qoftë mbi të!) dhe prej tij ka transmetuar njoftime të shumta.”*

*Në një tekst për të ka thënë: “Ishte shumë i kapur pas tij, vetëm tek ai përfundonte dhe kishte pasion të madh për të marrë dituri fetare prej tij.”*

*Prej tij janë përcjellë shumë çështje, që tashmë janë bërë shumë të dëgjura, si dhe shumë përgjigje që i ka dëgjuar prej tij. Teksti për vëllain e tij, Qàzimin – (Paqja e shpëtimit qoftë mbi të!) –, është transmetuar prej vëllezërve të tij, Is’hàkut dhe Aliut, dy djemtë e Xha’ferit, të cilët, që të dy ishin njerëz që ruheshin shumë dhe që të dy nuk kanë kundërshtime për transmetimin e tekstit.*

*Duke qenë shumë i ruajtur nga veprimet e ndaluara, ai pohonte imamët pas vëllait të vet, Qàzimit (Paqja qoftë*

---

<sup>1</sup> “El Irshad” i shejh Mufijdit, f. 287.

*mbi të!). Edhe pse ishte i madh në moshë, përsëri gëzonte respekt, si njëri me shumë virtyte. Të gjitha këto veti nuk e thyen atë që të pohonte të drejtën dhe punën me to, në të kundërt, të gjitha këto cilësi i shtuan largpamësinë dhe udhëzimin për në rrugën e drejtë.*

*Ishte një burrë, për të cilin Ali ibn Xha'feri mendonte se ishte prej grupit sufij të vakifive. Ky burrë e pyeti për vëllain e vet, Qazimin. Aliu i tha atij: "Ai ka vdekur."*

*Por pyetësi i tha: "Kush të ka njoftuar për këtë?"*

*Ai i tha: "Pasuria e tij u pjesëtua, gratë e tij u martuan."*

*Pas tij foli një tjetër. Ai tha: "Cili është folësi pas tij?"*

*Aliu tha: "Djali i tij."*

*Ai përsëri pyeti: "Po, ai ç'bëri?"*

*Ai i tha pyetësit: "Vdiq."*

*Por ai tha: "Kush të njoftoi ty për këtë?"*

*Përsëri Aliu tha: "Pasuria e tij u pjesëtua, gratë e tij u martuan."*

*Pas tij foli një tjetër. Ai përsëri pyeti: "Cili është folësi pas tij?"*

*Aliu tha: "Djali i tij, Ebù Xha'feri."*

*Burri i tha atij: "Ti je në këtë moshë e në këtë fuqi dhe babai yt është Xha'fer ibn Muhammedi (Paqja qoftë mbi të!) dhe ti thua këtë fjalë për atë djalë."*

*Aliu i tha atij: "Unë mendoj se ti nuk je gjë tjetër përveçse shejtan."*

*Pastaj e zuri për mjekre, e ngriti lart drejt qiellit dhe i tha: “Ku është mençuria e veprimit tim? All’llahu ka vendosur se është i merituar për këtë dhe nuk ka vendosur që këto thinja të jenë të merituar.”<sup>1</sup>*

*Ja kjo është ruajtja e vërtetë, vënia e shpirtit në presion të dyfishtë, mos rritja e mendjes me punët e përparësisë dhe për shkak të virtyteve, të moshës e të madhësisë, derisa atë shpirt, që lakmon dëshirat, ta shndërrosh në veti të larta.*

*Ai ka falur namaz gjithmonë me Ebù Xha’ferin, duke i njohur atij të drejtën e pozitës së imamit dhe vetë falej pas tij, pa e penguar asgjë në këtë punë se ai ishte xhaxhai i babait të tij, madje uronte që të flijohej për të.*

*Ebù Xha’feri (Paqja qoftë mbi të!), nga dashuria e madhe që kishte për ne, nëse do të ishte e nevojshme, do të jepte edhe jetën. Ndërkaq u ngrit Ali ibn Xha’feri dhe tha: “O zotëria im, do të kisha dëshirë që e mprehta e hekurit të ishte në zemrën time para teje.”*

*Pastaj Ebù Xha’feri (Paqja qoftë mbi të!) u ngrit të largohej, por Ali ibn Xha’feri u çua para tij dhe i drejtoi këpucët që t’i mbathte.<sup>2</sup>*

*Një ditë Ebù Xha’feri (Paqja qoftë mbi të!) hyri në xhaminë e të Dërguarit (Paqja e bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe, kur Ali ibn Xha’feri e pa pa këpucë e pa rrobën e sipërme, u çua përnjëherë, i puthi dorën dhe e nderoi shumë. Por Ebù Xha’feri i tha: “O xhaxha, ulu, të mëshiroftë All’llahu!”*

<sup>1</sup> “El Keshà” f. 429 dhe f. 803.

<sup>2</sup> “El Keshà”, f. 429 dhe f. 804.

*Por ai tha: “O zotëria im, si të ulem unë dhe ti je në këmbë?”*

*Kur u kthye në kuvendin e tij, shokët filluan ta qortojnë e t’i thonë: “Ti je xhaxhai i babait të tij dhe ti bën këtë veprim.”*

*Por ai tha: “Pushoni, sepse All’llahu i Lartësuar - dhe kapi fijet e mjekrës së vet - nuk i ka parë të përshtatshme këto thinja, por ka parë të përshtatshëm këtë djalë të ri. Prandaj e ka vënë aty ku e ka vënë për vetitë e tij. Kërkoj mbrojtjen e All’llahut për fjalët që ata thonë, madje unë për atë jam skllav.”<sup>1</sup>*

*Ky është ai shpirt i shenjtëruar, që e njuh të vërtetën dhe e ndjek atë, prandaj nuk shkon pas gjurmëve të mendjemadhësisë e të fanatizmit apo të mburret me vetveten, pasi dashuria e shpirtit është që njeriu t’i bindet Krijuesit të tij të Lartësuar te miqtë e Tij dhe te njerëzit e tij, që kanë të drejtë të urdhërojnë.”*

*Këto ishin disa nga gjendjet e Ali ibn Xha’ferit, të cilat zbulojnë atë që mban në brendësi ndërgjegjja e tij, si: shenjtërimin, adhurimet, bindjen, diturinë për All’llahun.*

*Me fjalën “skllav” ai nuk ka qëllim adhurimin, por bindjen dhe veprimin në rrugën e tij, vëll. 1, f. 12 dhe f. 322.*

*All’llahu qoftë i kënaqur prej tij! Ai quhej “i gjeri”, pasi banonte në një vend të Medines, që quhej “Urejd”, nga vjen edhe kjo fjalë. Në këtë vend ka vdekur edhe Ismâili. Për shkak të emrit të këtij vendi, edhe djemtë e Aliut thirren “Urejdij”.*

---

<sup>1</sup> “El Kâfij” libri “Argumenti”, kapitulli: “Teksti për Ebù Xha’ferin e dytë (Paqja qoftë mbi të!)”



### *Ab'basi*

*Shejh Mufijdi (All'lahu e mëshiroftë!), në librin e tij "El-Irshàd" thotë: "Abbàs ibn Xha'feri (All'lahu e mëshiroftë!) ishte i mirë, fisnik e bujar."<sup>1</sup>*

*Unë them: "Përveç kësaj fraze nuk kam gjetur gjë tjetër që të flasë për karakterin e Abbàsit, përveç asaj që shejh Mufijdi, - Erëkëndshëm qoftë dhe i tij!-, na ka lënë për të."*

### *Mùsà Qàzimi (Paqja qoftë mbi të!)*

*Në besimin e imamitëve ky është imami pas babait të tij, imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Mbase ndonjë ditë do të na bëhet mbarë të shkruajmë një libër mbi jetën e tij. Por për këtë, ndihmën dhe mbarësinë e marrim vetëm prej të Lartit.*



*Shoqata*

\* \* \*

*Fladi*

### *TRANSMETUESIT E TIJ*

*Transmetuesit e Ebù Abdil'lahit ishin më shumë se katër mijë, ashtu siç kemi treguar. Shejhu Mufijdi, - Erëkëndshëm qoftë dhe i tij!-, në librin e tij "El Irshàd", thotë: "Autorët e librave të haditheve kanë mbledhur emrat*

---

<sup>1</sup> "El Irshàd" i shejh Mufijdit, f. 287.

*e personave të besueshëm, që kanë transmetuar prej tij, pavarësisht nga ndryshimi i tyre në mendime e në pozitë. Ata ishin katër mijë burra.<sup>1</sup> Ibn Shehrâshûbi ka thënë se ai, që i ka mbledhur emrat e tyre, është Ibn Ukdej, kurse të tjerët vetëm kanë shtuar.*

*Ibn Ukdeh, për çdonjërin prej tyre, ka përmendur një transmetim dhe ka theksuar se ndër këta, Et'tabrsij'ji qëndron në majën më të lartë, kurse El Hil'lij është vërtetuesi që merret më shumë në konsideratë; kurse shejh Tûsij i ka përmendur emrat e tyre në librin e burrave.*

*Nuk e shton lartësimin, madhësitinë dhe vlerën e tij shuma e madhe e transmetuesve, në të kundërt transmetuesve u shtohet virtyti e lartësia sipas asaj që ata kanë transmetuar prej tij. Po, kjo është ajo që nxjerr në shesh këtë pozitë të lartë të diturisë dhe thurjen e lavdërimeve për mirësitë e tij, prej kërkuesve të diturisë e të virtytit në shkrimet e shumta e të ndryshme, ashtu siç janë edhe ata vetë.*

#### *Kolosët nga dijetarët e Ehli Sun'netit*

*Janë disa nga kolosët e dijetarëve dhe imamët e Ehli Sun'netit, që kanë marrë prej tij. Marrja e tyre nuk ka qenë ashtu siç merr nxënësi prej mësuesit, pasi ata të gjithë, për atë, që kanë marrë prej tij, kanë ndarë një mendim të përbashkët për imamatin e tij, madhësitinë e tij dhe qenien e tij si prijës i grupit të madh, ashtu siç thotë shejhu Sulejmàn në "El Jenâbij'ë" dhe En'nevevij'ju në "Tehdhijbul Esmâi uel lugât". Për më tepër, ata e kanë konsideruar marrjen prej tij punë të respektuar, me të cilën janë nderuar dhe kanë fituar një virtyt, ashtu siç thotë Esh'shâfi'ij'ju në librin "Metâlibu Suël". Për ty do të sjellim një pjesë nga ata kolosë të dijës.*

---

<sup>1</sup> "El Irshâd" i shejh Mufidit, f. 271

### *Ebù Hanijheh*

*Ndër ata, që kanë marrë prej tij, është Ebù Hanife En'Nu'màn ibn Thàbit ibn Zeuta, është nga skllevërit. Origjina e tij është nga Kabuli dhe ka lindur në Kufe. Aty është rritur dhe ka studiuar. Në Kufe ai kishte një pronë të vetën. Është shpërngulur për në Bagdad dhe në këtë qytet ka vdekur në vitin 150 të hixhrit. Gjithashtu, edhe varri i tij në Bagdad është i njohur. Është themeluesi i njërit nga katër medh'hebet e Ehli Sunnetit. Është mjaft i njohur. Është e tepërt të përmendim më shumë për të.*

*Gjithashtu, është mjaft e njohur edhe marrja e tij prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Ndër ata, që e kanë përmendur këtë fakt, është Esh Shebelnexhij'ju në librin "Nùrul Ebsàr", Ibn Haxheri në librin "Es'savàik, shejh Sulejmàni në librin "El Jenàbij'u", Ibn Sabbàgu në librin "El Fusùl", si dhe të tjerë përveç këtyre që u thanë.*

*El Àlùsij'ji, në librin "MukhtesaruTuhfetul Ithnàsherijeh", faqe 8, ka thënë: "Ebù Hanife është nga të Ehli Sunnetit. Ai krenohej kur thoshte me gjuhën më të qartë: "Sikur të mos ishin dy vitet, Nu'mani do të ishte shkatërruar!"*

*Me dy vitet ai ka për qëllim ato dy vite, gjatë të cilave ka qenë në shoqërinë e tij për të marrë dituri prej imam Xha'fer Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!).*

### *Màlik ibn Enesi*

*Dijetari i Medines, Malik ibn Enesi, është njëri prej atyre që ka marrë prej imam Sàdikut dhe është njëri nga katër medh'hebet. Ibn Nedijmi, në "Fehrast", ka thënë: "Ai është bir i Ebù Àmirit prej humejrijve, që i përket fisit Beni*

*Tejm ibn Murreh, që është njëri nga fiset kurejsh. Ka qëndruar pranë Sàdikut tre vjet. E kanë akuzuar tek Xha'fer ibn Sulejmàn El Abbàsij, i cili ishte vali i Medines. Atij i është thënë: "Ai nuk beson në besëdhënien tuaj."*

*E ka thirrur të akuzuarin për këtë fjalë, i ka hequr rrobat dhe e ka rrahur me kamxhik të shtrirë me shpatulla të zbuluara. Ka vdekur në vitin 179 të hixhrit në moshën 84 vjeçare." Diçka të ngjashme me këto fjalë ka thënë edhe Ibn Khil-likàni.*

*Që Màlik ibn Enesi ka marrë prej Ebù Abdil-lahit është fakt shumë i njohur dhe prej atyre që kanë folur për këtë është: Neueuiju, në librin "Et'Tehdhib"; Shebelenxhiju, në librin "Nùrul Ebsàr"; Sibti, në librin "Et'Tedhkireh"; Shàfi'iu, në librin "El Metàlib"; Ibn Haxheri, në librin "Es'Sauàik"; shejh Sulejmàni, në librin "El Jenàbi"; Ebù Neimi, në librin "El Hiljeh"; Ibnu Sabbàgi, në librin "El Fusùl" e të tjerë autorë përveç këtyre që u thanë.*

#### *Sufjàn Eth'Theurij*

*Sufjàn ibn Se'id ibn Mesrùk Eth'Theurij El Kùfij ka shkuar disa herë në Bagdad. Prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) ka transmetuar shumë gjëra. Gjithashtu, imam Sàdiku e ka porositur atë për punë të vjera, për të cilat është folur në kapitullin "Porositë e tij". Më sipër është folur se ai ka diskutuar me Sàdikun për përkohshmërinë. Ka udhëtuar për në Basra dhe atje ka vdekur në vitin 161 të hixhrit. Duhet të ketë lindur aty nga viti nëntëdhjetë. Thuhet se ka parë ndeshjen e Zejdit dëshmor dhe ka qenë në policinë e Hishàm ibn Abdul Melikut.*

*Fakti, që ai ka marrë prej Sàdikut – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të! – ka ardhur në librat: "Et'tehdhijb", "Nùrul*

*Ebsâr”, “Et’tedhkireh”, El -Metàlib”, Es’Sauà’ik”, El Jenàbij’ë”, “El Halij’jeh”, El Fusul-Muhim’meh” dhe në libra të tjerë; kurse burra nga të shi’ave e kanë përmendur atë në librin “transmetuesit e tij (Paqja qoftë mbi të!)”.*

#### *Sufjân ibn Uajneh*

*Sufjân ibn ‘Ujejneh ibn Ebi Imrân El Kûfij El Mekki*  
*ka lindur në Kûfe në vitin 107 dhe ka vdekur në Mekkë në*  
*vitin 198 të hixhrit. Ka ardhur në Kûfe dhe në kohën e Ebû*  
*Hanijfes ishte djalë fare i ri.*

*Që ka marrë prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të)*  
*është thënë në librat: “Et’Tehdhib”, “Nûrul Ebsâr”, “El-*  
*Metàlibu”, Es’Sauà’iku”, “El Jenàbiu”, “El Hiljeh”, “El*  
*Fusûlu” dhe në libra të tjerë, përveç këtyre që u*  
*përmendën. Gjithashtu, atë e kanë përmendur edhe librat e*  
*shi’ave në “transmetuesit e tij (Paqja qoftë mbi të!)”.*

#### *Jahjà ibn Seijd El-Ensàrij*

*Jahjà ibn Seijd ibn Kajs El Ensàrij është prej fisit Benij*  
*Nexh’xhâr dhe është nga brezi i dytë i myslimanëve*  
*(tàbi’inëve). Ka qenë kadi i Mensùrit në Medine, pastaj*  
*është emëruar krye kadi. Ka vdekur në Hàshimij’jeh në*  
*vitin 143 të hixhrit.*

*Referohu në burimet e mësipërme për transmetimin e*  
*tij prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të). Përveç këtyre*  
*burimeve, këtë fakt e kanë përmendur autorë shi’ash.*

#### *Ibnu Xherijh*

*Abdul Melik ibn Abdul Aziz ibn Xherijh El Mekki*  
*ka dëgjuar shumë dijetarë dhe ka qenë nga dijetarët e masës,*

*të cilët besonin se ishte një stoli që sjell kënaqësi, ashtu siç mendonin edhe shumë të tjerë prej tyre. Në rrugët e transmetimit të Sadikut është përmendur në kapitullin: “Ç’pranohet nga pretendimet pa argument”.*

*Gjithashtu, është përmendur edhe në “El Kàfij”, kapitulli: “Ç’ka lejuar All’llahu nga kënaqësitë”. Shiko se si iu përgjigj pyetjes, që i bëri imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!): “Tako Abdul Melik ibn Xherijhun dhe pyete atë për këto punë, sepse tek ai ka dituri për të tilla punë.”*

*Ai shkoi dhe Ibn Xherijhu i diktoi të shkruante shumë gjëra rreth kënaqësive e stolive.*

*Ibn Khil-likàni ka thënë: “Abdul Meliku është ndër dijetarët e dëgjuar. Ai ka lindur në vitin 80h. Ka shkuar në Bagdad tek Ebù Xha’fer Mensùri dhe ka vdekur në vitin 149 të hixhrit. Thuhet se ka vdekur në vitin 150, ashtu si thuhet se ka vdekur në vitin 151 të hixhrit.*

*Burimet e mësipërme kanë përmendur se ai ka marrë prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Gjithashtu, atë e kanë përmendur edhe burrat e shi’ave.*

#### *El-Kattàn*

*Ebù Seijd Jahjà ibn Se’id El Kattàn El Basrij ka qenë nga imamët e hadithit. Madje është quajtur “Dijetari i hadithit i kohës së tij”. Autorët e gjashtë librave të sakta të hadithit dhe autorë të tjerë të librave të haditheve e kanë marrë si argument. Ka vdekur në vitin 198 të hixhrit. Është treguar prej Ibn Kutejbes se numërohet ndër burrat e shi’ave, por shi’at nuk e pohojnë atë ndër burrat e tyre.*

*Është përmendur në librat “Et’Tehdhijbu” dhe El Jenàbiu”, si dhe në libra të tjerë përveç këtyre dy librave nga të Ehli Sunnetit, kurse prej shi’ave e kanë përmendur Esh’Shejh, Ibn Dàùdi, En’Nexh’xhàshiju, etj.*

#### *Muhammed ibn Is’hàk*

*Muhammed ibn Is’hàk ibn Jesàr është autori i librave “El Megàzij” dhe “Es Sejr”. Është nga Medineja dhe ka banuar në Mekkë. Ibn Khalkàni ka thurur për të fjalë të shumta lavdëruese; ndërmjet tij dhe Maliqit ka pasur armiqësi dhe çdo njëri ka atakuar tjetrin. Shkoi në Hijreh tek Mensùri, për të cilin shkroi librin “El Megàzij”.*

*Ka shkuar në Bagdad dhe aty vdiq në vitin 151 të hixhrit. Fjalën, që ka marrë prej Sàdikut, e ka treguar në librat “Et’Tehdhijbu, “El Jenàbiu”. Shi’at e kanë përmendur këtë fakt. Shejhu, në librin e tij “Er’Rixhâl”; El Al-làme, në librin “El Khulàsah”; “El Keshà”, në librin e tij “Er Rixhâl” dhe autorë të tjerë.*

#### *Shuëbeh ibn El Haxhàxh*

*Prej imam Sàdikut ka marrë edhe Shu’beh ibn El Haxhàxh El Ezedij, i cili ishte nga imamët e mëdhenj të Ehli Sun’netit. Shu’beh ka dhënë fetva në favor të daljes në luftë përkrah Ibràhijm ibn Abdullah ibn Hasan, madje thuhet se ka qenë nga dijetarët e hadithit që dolën përkrah Ibrahim ibn Abdullahut.*

*Një grup autorësh të Ehli Sun’netit e kanë numëruar atë prej shokëve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Autorët e librave: “Et’tehdhijbu”, Es’savàiku”, El Hilij’jeh”, El-Jenabij’u”, El Fusùlu”, Et’tedhkireh” dhe libra të tjerë; gjithashtu atë e kanë përmendur edhe librat e shi’ave.*

### *Ej'jùb Sexhestànij*

*Ndër ata, që kanë marrë prej Sàdikut është edhe Ej'jùb ibn Ebù Temijmeh Sexhestànij El Basrij; i thuhet edhe Es'sakhtejànij, por mbiemri i parë është më i dëgjuari. Ka qenë shërbyes i Am'màr ibn Jàserit dhe e kanë konsideruar ndër juristët e mëdhenj në fushën e ligjit të fesë (fukahàë) të brezit të dytë të myslimanëve (tàbi'inët). Ka vdekur në vitin 131 të hixhrit në Basra, i prekur nga murtaja. Kur vdiq ishte 65 vjeç.*

*Ndër burrat e imam Sàdikut (Paqja goftë mbi të!) është renditur në librat: "Nùrul Ebsàr", "Et'tedhkireh", El Metàlibu", "Es'savàiku", "El Hilij'jeh", "El Fusùl" dhe në libra të tjerë. Gjithashtu, e kanë përmendur edhe librat e burrave të shi'ave.*

*Këta ishin disa prej nxënësve të Sàdikut (Paqja goftë mbi të!) nga dijetarët e mëdhenj dhe nga juristët e dalluar të Ehli Sun'netit. Ka edhe të tjerë veç këtyre që janë numëruar ndër nxënësit e tij. Për më shumë njohuri referohu në librin "Hilij'jetul Eulijài", megjithëse duhet theksuar se Ebù Najmi, me fjalën e tij, ka treguar edhe për të tjerë ose ka lënë të kuptohet se veç këtyre janë edhe shumë të tjerë.*

\* \* \*

**TRANSMETUESIT E TIJ TË BESUESHËM,  
MË TË DËGJUAR, PREJ SHI'AVE**



*Kur transmetuesit e besueshëm, të përmendur në librat e burrave, janë më shumë se katër mijë, nuk është vendi që këtu të përmenden të gjithë, pasi librat e burrave, për shumicën e tyre, kanë studime mjaft të arrira. Por nuk është e drejtë që ata të lihen pa u përmendur, pasi përmendja e tyre bën pjesë në qëllimin e librit. Prandaj kemi menduar që, nga transmetuesit e besueshëm, të përmendim ata që janë më në zë prej tyre, për faktin se kështu kemi sjellë qoftë edhe një rën anë nga anët e jetës së imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Njëkohësisht jemi edhe larg zgjatjes lodhëse.*

### *Ebàn ibn Tha'eb*

*Ebù Saëd Ebàn ibn Thaëleb El Kibrij El Xherijrij ka transmetuar prej imam Sexh'xhàdit, imam Bakirit dhe imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi ta!). Ka vdekur në kohën e imam Sàdikut, në vitin 141 të hixhrit , por thuhet se vdekja e tij është në vitin 140 të hixhrit. Kur të qarat për të arritën tek Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!), ai tha: "Betohem në All'lah, vdekja e Ebànit po më shkakton dhembje në zemër."*

*Nuk ka dyshim se kjo shprehje të informon ty për pozitën e lartë e për rëndësinë e madhe që ai kishte pranë tij. Vallë, si do të ishte personi, vdekja e të cilit shkaktonte dhembje në zemrën e Sàdikut?*

*Ai kishte dituri të shumta e argumente të forta. Për këtë e dëshmon fjala që i ka thënë atij imam Bàkiri (Paqja qoftë mbi të!): "Rri në xhaminë e Medines dhe shpjegoju njerëzve, sepse unë kam shumë dëshirë, që ndër përkrahësit e mi të ketë të ngjashëm me ty."*

*Gjithashtu, dëshmon edhe fjala që ka thënë për të imam Sàdiku: “Atë, që unë e kam ngarkuar me detyrë në banorët e Medines, e dua të jetë si ti.”*

*Nëse ai nuk do të kishte kaq shumë virtyte dhe forcë në argumentim, ne nuk do të kishim përballur dot këto rrugë pa krye e me të tilla rreziqe, sepse dështimi i tij do të qe dështim edhe për ata të dy.*

*Vetëm prej imam Sàdikut ai ka transmetuar tridhjetë mijë hadithe, ashtu siç ka njoftuar vetë imam Sàdiku për këtë; gjithashtu ai ka urdhëruar Ebàn ibn Omanin që t'i transmetojë ato prej tij.*

*Ai nuk ka qenë i specializuar vetëm në fushën e hadithit e të teologjisë, pasi kishte dituri në disa fusha, si: në tefsir (komentim i Kur'ânit), edukatë, sintaksë dhe në metodologjinë e këndimit të Kur'ânit. Ai ka dëgjuar prej arabëve, banorë të shkretëtirës dhe ka treguar prej tyre. Është autor i librit “ElvGarijbu fil Kur'ân”.*

*Tregues i lartësisë së tij është edhe mendimi i përbashkët i të dy grupimeve për besueshmërinë e tij, pasi atë e kanë konsideruar të besueshëm autoritetet më të madha të dijes në fushën e hadithit, duke pohuar edhe përkatësinë e tij në grupin e përkrahësve të djemve të Aliut. Ndër ata dijetarë janë: Ahmedi, Jahjà, Ebù Hàtemi, En'nesàij'ji, Ibn Adiji, Ibn Axhlàni, El Hàkimi, El Ukajlij, Ibn Sa'di, Ibn Haxheri, Ibn Haj'jàni, Ibn Mejmùneh dhe Edh'dhehebij'ji në librin “Mijzànul I'tidàl”. Gjithashtu, atë e kanë numëruar ndër tàbi'inët (myslimanët e brezit të dytë). Kjo është e mjaftueshme si argument dhe tregues për besueshmërinë e tij të madhe, si dhe për virtytin e tij, që kishte arritur në ato kufij sa askush nuk i mohon dot.*

### *Is'hàk Es'sajrefij*

*Is'hàk ibn Am'màr ibn Haj'jàn Es'sajrefij El Kùfij. Ka qenë prej të besueshmëve që kanë transmetuar hadithe prej imam Sàdikut dhe prej djalit të tij, imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Vëllezërit e tij janë Jùnusi, Jùsufi dhe Ismàijli. Është nga një shtëpi e madhe shi'ash. Dy djemtë e vëllait të tij Aliu dhe Beshijri janë dy djemtë e Ismàijlit, të cilët kanë qenë transmetues hadithesh. Imam Sàdiku, kur e shihte atë dhe vëllain e tij Ismàijlin, thoshte: “Në të vërtetë, i ka mbledhur të dy për njerëzit.”, domethënë i ka mbledhur kjo botë dhe bota tjetër, sepse ata të dy zotëronin pasuri të shumta. Me këtë pasuri ata ndihmonin shokët e vet dhe afroheshin. Janë transmetuar për të edhe lavdërimi të tjera.*

### *Es'sukùnij<sup>1</sup>*

*Ismàijl ibn Ebù Zijàd Es'sukùnij ka qenë kadi në Mosul dhe i besueshëm në transmetim. Shokët tanë ndajnë një mendim të përbashkët për të punuar sipas transmetimit të tij. Disa burra kanë thënë se ai ishte nga të masës, por kjo nuk është vërtetuar. Prej tij janë transmetuar hadithe të shumta në fushën e rregullave të ligjit të fesë (fik'h) dhe me të gjitha është punuar, kur është vërtetuar se transmetimi është prej tij.*

### *Ismàijl Es'sajrefij*

*Ismàijl ibn Am'màr ibn Haj'jàn Es'sajrefij El Kùfij është vëllai i Is'hàkut, që u përmend më sipër. Gjithashtu, më sipër u përmend edhe fjala e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) për Is'hàkun, kur i pa të dy: “Në të vërtetë, i ka*

---

<sup>1</sup> Sukùn është emri i një lagje të arabëve të Jemenit.

*mbledhur të dy për njerëzit.”, por ajo, që e shton lartësimin e pozitës së tij, është transmetimi i ardhur në “El Kâfij”, në kapitullin: “Mirësjellja me prindërit” në librin e haditheve të sakta, transmetuar prej Am’mâr ibn Ebù Ismâijl, i cili është personi për të cilin bëhet fjalë: “Unë njoftova Ebù Abdil’lahin për sjelljen e mirë të Ismâijlit, djalit tim dhe ai më tha: “E kam dashur atë dhe më është shtuar dashuria për të.”*

*Vetëm kjo shprehje është e mjaftueshme për të treguar virtytin dhe lartësinë e tij.*

### *Burejd El Axhelij*

*Burejd ibn Muàvijeh El Axhelij është prej atyre që kanë transmetuar prej imam Bâkirit dhe imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka vdekur në kohën e imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!). Tek Ehli Bejti ka arritur madhësi e pozitë, që i kapërcen kufijtë e besueshmërisë, pasi tek ata është lartësuar në shkallë të atillë sa lapsi e ka të pamundur ta përshkruajë. Si e mendon ti, pozitën e atij, për të cilin imam Sâdiku thotë: “Kolonat e tokës dhe të mëdhenjtë e fesë janë katër: Muhammed ibn Muslim, Burejd ibn Muàvijeh, Lejth ibn El Bakhterij El Muràdij dhe Zuràreh ibn A’jun.”*

*Në një hadith tjetër thotë: “Shokët e babait tim ishin zbukurim për të dy gjendjet: si gjallë, ashtu edhe vdekur. E kam fjalën për Zuràreh ibn A’junin e Muhammed ibn Muslimin, por prej tyre është edhe Lejth El Muràdij e Burejd El Axhelij. Këta janë ata që pjesëtojnë me drejtësi, që thonë të vërtetën. Ata janë të parët ndër të parët dhe janë të afruarit.”*

*Në një hadith tjetër për ata ai ka thënë: “Katër janë të ruajturit e besnikët e All’llahut në hallallin e në haramin e Tij.”*

*Kurse në një hadith tjetër ka thënë: “Ata janë ruajtësit e fesë dhe besnikët e babait tim në hallallin dhe në haramin e All’llahut. Ata janë të parët për ne në këtë botë dhe në jetën tjetër.”*

*Janë të shumta fjalët lavdëruese të këtij lloji. Ai ka qenë prej shokëve të imam Bâkirit (Paqja qoftë mbi tël), për të cilin grupi ka një mendim të përbashkët, për të konsideruar të saktë atë që është e saktë prej tyre dhe të pohojnë këtë me diturinë e fik’hut.*

#### *Bekijr ibn A’jun*

*Bekijr ibn A’jun Esh’Shijbâni është vëllai i Zurâres dhe ka transmetuar prej imam Bâkirit e prej imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka vdekur kur imam Sâdiku ishte gjallë. Kur u njoftua për vdekjen e tij, ashtu siç e ka transmetuar El Kulenij’ji, në faqen 120, të tekstit arabisht, ka thënë: “Betohem në All’llah, atë e ka zbritur All’llahu mes të Dërguarit të All’llahut dhe Prijësit të Besimtarëve (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dy e mbi familjet e pastra të të dyve!).”*

*Një ditë imam Sâdiku e kujtoi atë dhe tha: “All’llahu e mëshiroftë Bekijrin.”*

*Abdullah ibn Zurâreh thotë: “E shikova dhe në këtë kohë isha në moshë të re, kur imam Sâdiku tha: “Unë them: “Dashtë All’llahu” (in shâe-ll’làh)” Kjo është e mjaftueshme për atë si dëshmi për gradën e për pozitën e*

*lartë. Ai është prej të besueshmëve, djemve të Aëjunit dhe prej të mirëve të tyre. Për të kanë transmetuar disa të besueshëm.*

### *Ebù Hamza Eth'themàlij*

*Ebù Hamza Eth'themàlij Thàbit ibn Dijnàr ka transmetuar prej imam Sexh'xhàdit, imam Bàkirit dhe imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi ta!). Ka jetuar deri në kohën e imam Qàzimit. Thuhet se ka vdekur në vitin 150 të hixhrit, ose vdekja e tij ka qëlluar pas dy viteve të imamatit të Qàzimit. Thuhet se ai ka arritur edhe vdekjen e Mensùrit në vitin 158 të hixhrit.*

*Ebù Hamzai, për nga madhështia dhe rëndësia e pozitës, qëndronte në vendin më të lartë, aq sa edhe imam Rizài (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë për të: “Ebù Hamzai, në kohën e tij, është si Lukmàni në kohën e tij. Është kështu, pasi i ka shërbyer katër prej nesh: Ali ibn Husejnit, Muhammed ibn Aliut, Xha'fer ibn Muhammedit dhe për një kohë Mùsàsë, djalit të Xha'ferit (Paqja e shpëtimit qoftë mbi ta!).” Në një transmetim tjetër thuhet: “Si Selmàn Fàrisiu në kohën e tij!”*

*Imam Sàdiku dërgoi që ta thërrisnin, ndërsa Ebù Hamzai ishte në Bekij'ë dhe, pasi erdhi, i tha: “Unë getësohem kur të shoh ty.”; kurse Ebù Hasan Mùsài për atë ka thënë: “I këtille të jetë besimtari kur All'illahu e ndriçon zemrën e tij.”, si dhe fjalë të tjera, që kanë thënë imamët për të. Të gjitha këto fjalë tregojnë vlerësimin e lartë që ata kishin për Ebù Hamzanë, si dhe dashurinë e tyre ndaj tij.*

*Ai është transmetuesi i lutjeve të gjata, i përsosmërisë së arritjes gjuhësore dhe i qëllimeve të larta të imam Zejnel*

*Àbidijnit (Paqja qoftë mbi të!) të asaj lutjeje, që lexohet në kohën e syfyrit në muajin e Ramazanit, e cila njihet me emrin “Lutja e Ebù Hamza Themaliut”. Gjithashtu, atë e kanë vlerësuar si të besueshëm edhe dijetarët e Ehli Sun’netit, të cilët kanë transmetuar prej tij.*

### *Khàbir El Xheafij*

*Khàbir Jezijd El Xheafij El Kùfij ka transmetuar prej imam Bâkirit dhe prej imam Sàdikut (Paqja e shpëtimi qoftë mbi të dy!) dhe ka vdekur në kohën e Ebù Abdil-lah Sadiut në vitin 128 të hixhrit, por thuhet edhe në vitin 132. Vetëm prej Bâkirit ka transmetuar shtatëdhjetë mijë hadithe. Kushdo që ndjek hadithet e tij, mëson se ai ishte prej atyre që ka mbajtur sekretet e tyre, gjithashtu ka transmetuar edhe kerametet, që kanë dalë prej atyre të dyve.*

*Imam Bâkiri e urdhëroi Khàbirin të hiqej si budalla dhe ai ashtu veproi. I rrethuar nga fëmijët sillej rrotull sheshit të gjerë të xhamisë së Kùfes, duke thënë: “Unë e gjej Mensùr ibn Xhemhùrin urdhërues dhe jo të urdhëruar.” Nuk kaluan veçse disa ditë dhe prej Hishâm ibn Abdul Melikut erdhi një letër për valiun e tij në Kùfe, me urdhrin që të arrestonte një burrë të quajtur Khàbir ibn Jezijd El Xheafij, t’i priste kokën dhe kokën e tij t’ia dërgonte atij. Valiu pyeti të pranishmit, në kuvendin e tij për Khàbirin dhe ata i thanë: “Ishte burrë i virtytshëm, dijetar, me hadithe e argumente, por u çmend. Ja, është ai që sillet rrotull, duke bërë garë vrapimi me fëmijët në sheshin e madh të xhamisë.”*

*Valiu shikoi në drejtimin që i thanë dhe vërtet ai po luante me fëmijët duke bërë gara vrapimi me shkopin e*

stafetës. Atëherë ai tha: “Falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm All’llahut, që më shpëtoi nga vrasja e këtij.”

Më pas u zbulua sekreti i urdhrit të imam Bâkirit, që Xhâbiri hiqej si i çmendur, pasi, kur ai u ndie i siguruar, u rikthye në gjendjen e tij normale. Gjithashtu, nuk kaloi shumë kohë, që edhe fjala e tij për Mensûr ibn Xhemhurin u bë realitet.

El Ja’kûbij’ji, në historinë e tij, vëll. 3, faqe 81, ka cituar një hadith, të përcjellë prej Xhâbirit, për atë që do të ndodhë me pasardhësit e Abbâsit, të thirrjes në favorin e tyre dhe punën e Kahtabes, që ishte pranë tyre e dëgjonte dhe për të cilin Xhâbiri bëri shenjë duke thënë: “Sikur të donte ai, që unë të them, patjetër që do ta them.”

Nga ky tregim dhe nga tregime të tjera të ngjashëm ti mësove se ai ishte depozitë sekretesh. Në lidhje me Xhâbirin kanë ardhur lavdërime të shumta dhe vetë imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi të!) e ka mëshiruar atë. Thuhet se është prej atyre, ku gjendet dituria e imamëve. Por krerët e dijetarëve të hadithit dhe burrat nga të masës kanë mendime të ndryshme për të. Disa e konsiderojnë të besueshëm, të tjerë e kundërshtojnë, duke thënë se ai ishte nga rafiditë (grup ekstremist që shan sahabët e mëdhenj) dhe që thotë se pas vdekjes njerëzit do të rikthehen në tokë), megjithëse Edh’dhebijju pohon se ai ishte dijetari më i madh i shi’ave.

#### *Xhemijl ibn Derrâxh*

Xhemijl ibn Derrâxh ibn Abdullah En’nekhaj ka transmetuar prej imam Sâdikut dhe prej imam Qâzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Nga fundi i jetës u verbua dhe ka vdekur në kohën e imam Rizàsë.



*Xhemijli ka qenë prej gjashtë shokëve të imam Sàdikut, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët: “Ato, që janë transmetuar prej tij, janë të gradës “Sahijh” dhe i kanë miratuar, duke i përdoruar në dispozitat e ligjit të fesë.”*

*Më sipër është treguar se Ebàn ibn Osmàni i ka numëruar ato dhe thuhet se Xhemijli ishte më i dituri i tyre në fushën e dispozitave të ligjit të fesë.*

*Në lidhje me Xhemijlin kanë ardhur lavdërime, që zbulojnë lartësinë e gradës së tij. Ndër këto lavdërime është edhe rasti kur imam Sàdiku lexoi ajetin: “Këta janë ata që u kemi dhënë Librin, Urtësinë dhe Profecinë. E, nëse ata (banorët e Mekës) i mohojnë këto, Ne do t’ia besojmë një populli tjetër që nuk do t’i mohojë.” (Sure “El En’àm”, ajeti 89)*

*Pastaj bëri shenjë me dorën e tij në drejtim të një grupi, që ishin tek ai, ndër të cilët ishte e dhe Xhemijl ibn Derràxhi. Ata thanë: “Patjetër, All’llahu na bëftë kurban për ty, ne nuk e mohojmë atë.”*

*Xhemijli njihej për adhurim e për sexhde të gjatë.*

*El Hàrith ibn El Mugijreh En’nasrij*

*El Hàrith ibn El Mugijreh En’nasrij ka transmetuar prej imam Bàkirit, prej imam Sàdikut dhe prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi ta!). Ishte prej atyre, që gëzonin grada të larta. Këtë e dëshmojnë disa hadithe. Ndër ato është edhe fjala që imam Sàdiku i tha një grupi, ndër të cilët ishte edhe Jùnus ibn Ja’kùb: “Nëse doni një person, tek i cili të pushoni pranë tij, nuk ka ndonjë ndalim të shkoni tek Hàrith ibn El Mugijreh En’nasrij.”, duke shtuar*

*se Jùnus ibn Ja'kùbi ishte prej atyre që gëzonin një pozitë të lartë, por megjithë lartësinë e punës që ai kishte. Imam Sàdiku e urdhëroi t'i referohej Hàrithit.*

*Dëshmitë për madhështinë e lartësinë e pozitës së tij janë të shumta.*

### *Harijzi*

*Harijz ibn Abdullah El Ezedij El Kùfij Es'sexhestànij origjinën e ka nga Sexhestàni, për shkak të udhëtimeve të shumta që bënte atje për punë tregtie, prandaj u bë i njohur me këtë emër. Ishte nga juristët e ligjit të fesë dhe nga transmetuesit e haditheve. Ka shkruar disa libra në fushën e dispozitave të ligjit të fesë. Prej imam Sàdikut ka transmetuar njoftime të shumta gojarisht, nga biseda dhe me ndërmjetësi. Kushdo, që shfleton librat e hadithit, mëson se hadithet e transmetuara gojarisht prej tij janë të shumta. Gjithashtu, edhe librat e tij konsiderohen bazë të diturive. Është vrarë në Sexhestàn ndërmjet një grupi prej shi'ave. Shkak për vrasjen e tij janë bërë fjalët e gënjeshtër që u përhapën në adresë të tij. Shokët e Harijzit dëgjonin banorët që shanin prijësin e besimtarëve, imam Aliun (Paqja goftë mbi të!) dhe për këtë ata njoftuan Harjzin dhe e i*

*kërkuan atij që t'i lejonte të vrisnin këdo që do të dëgjonin të thoshte të tilla fjalë. Ai i lejoi. Kështu, havarixhët i gjenin të vrarët njëri pas tjetrit, por nuk u shkante mendja tek shi'at, pasi ata ishin vetëm pak vetë, prandaj ishin vënë në kërkim të merxheive dhe i luftonin ata. Vazhduan kështu, derisa ata u thelluan në këtë çështje dhe atëherë u vunë në kërkim të shi'ave. Shokët e Harijzit u mblodhën pranë tij në xhami dhe ata shembën murin e xhamisë mbi*

*ta, madje edhe tokën e përmbysën mbi ta. Mëshira e All'lahut qoftë mbi ta!*

### *Hafs ibn Sàlim*

*Ebù Vilàd El Han'nàt Hafs ibn Sàlim El Xheafij zotërinjtë e tyre ishin nga Kufe. Ishte prej atyre që kanë transmetuar prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Për besueshmërinë e fjalës së tij janë të gjithë të një mendimi, madje askush nuk e ka akuzuar për ndonjë send.*

*Thuhet se ka dalë përkrah Zejdit. Përkrahjen e tij e ka quajtur të drejtë edhe imam Sàdiku. Nuk ka asgjë të çuditshme, që ai të ketë pasur të drejtë në atë dalje, pasi nuk mund ta linte punën e Zejdit, që ai të ishte objektiv i prapësive të emevive.*

### *Hafs ibn Gijàth El Kàdij*

*Hafs ibn Gijàth En'nekhaj El Kùfij El Kàdij ishte ngarkuar me detyrën e kadiut (gjykatësit) prej Harun Rrashidit për rajonin lindor të Bagdadit. Pastaj është ngarkuar me detyrën e kadiut në Kufe dhe aty ka vdekur në vitin 194 të hixhrit. Këtë fakt e ka përmendur En'nexhàshij'ji; gjithashtu, ka përmendur se libri i tij me transmetime prej imam Xha'fer ibn Muhamedit ka njëqind e shtatëdhjetë hadithe.*

*Sipas fjalës më të përhapur, Hafsi, në transmetim, i përmbahet shkollës judike të masës, prandaj, një grup janë të mendimit që të punohet me transmetimet e një grupi që nuk janë prej shi'ave. Hafsi është njëri prej tyre, pasi atashimi ndër përkrahësit e pasardhësve të imam Aliut nuk është shkaku i vetëm për të pranuar transmetimin, pasi në*

*konsideratë merret besueshmëria e transmetuesit, pavarësisht nga medh'hebi i tij.*

*Prej transmetimeve të tij disa kanë nxjerrë se ai ishte nga shi'at imamij, por përkatësia e tij prej masës është fjala më në zë dhe, kur ai fliste për imam Sàdikun thoshte: “Më ka folur më i miri i Xha'ferëve, Xha'fer ibn Muhammedi.”*

*Për ty nuk është e panjohur se të tilla deklarime të një transmetuesi janë një tregues për ne se ai nuk i përkiste grupit të përkrahësve të pasardhësve të Aliut, por ka edhe mundësi që ka dashur ta mbajë të fshehtë përkatësinë e tij në këtë grupim.*

#### *Ham'màd ibn Osmàn*

*Ham'màd ibn Osmàn ibn Zijàd Errevàsij El Kùfij, të cilit i është vënë epiteti En'nàb, ka transmetuar prej imam Sàdikut, prej imam Qàzimit dhe prej imam Rizàit ( Paqja goftë mbi ta!). Ka vdekur në Kùfe në vitin 190 të hixhrit. Ka shkruar një libër, në të cilin transmetojnë prej tij disa nga të besueshmit. Ka qenë prej shokëve të imam Sàdikut (Paqja goftë mbi tël), për të cilët grupi është në një fjalë të përbashkët për të vënë shkallën “Sahijh” ato që janë të kësaj grade dhe të transmetuara prej tyre. Gjithashtu, ato pohojnë për ta se janë nga dijetarët e dispozitave të ligjit të fesë. Më sipër i kemi parë ata kur kemi folur për Ebàn ibn Osmànin.*

*Ham'madi ka dy vëllezër, të cilët janë: Hasani e Xha'feri, djemtë e Osmànit, të dy janë prej transmetuesve të besueshëm dhe janë nga njerëzit e mirë e të virtytshëm.*

#### *Ham'màd ibn Isà*

*Ebù Muhammed Ham'màd ibn Isà El Xhuhenij El Basrij, i mbyturi në ujët që kishte mbetur në anët pellgut (xhahëfeh), ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka jetuar deri në kohën e imam Xhev'vâdit (Paqja qoftë mbi të!), por prej tij nuk njihet të ketë transmetuar prej imam Rizàit e prej imam Xhev'vâdit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka qenë prej gjashtë shokëve të imam Sàdikut, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët që të vihen në gradën "Sahijh" transmetimet e tyre, që janë të sakta; gjithashtu, grupi ka pohuar se janë dijetarë në fushën e dispozitave të ligjit të fesë, ashtu siç u tha më sipër kur folëm për Ebàn ibn Osmànin. Në hadithin e tij ka qenë shumë i vërtetë dhe shumë i ruajtur. Është transmetuar prej tij se ai ka thënë: "Kam dëgjuar prej Ebù Abdil'lahit, Sadikut shtatëdhjetë hadithe, por akoma vazhdoj të kem dyshim në vete. Prandaj i kam reduktuar vetëm në njëzetë."*

*Në pjesën e parë, faqe 254, të tekstit arabisht, është thënë se lutja e tij gjente përgjigje dhe se Ham'màdi i ka kërkuar atij që të lutej për të, që ai të bënte sa më shumë Haxh, të kishte një tokë të mirë, një shtëpi të bukur, një grua prej dyerve të mira e të kishte fëmijë të mbarë. Imam Sàdiku është lutur për aq sa i kërkoi. Por ai e ka kushtëzuar numrin e Haxheve në pesëdhjetë. All'llahu i është përgjigjur lutjes së imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Në fakt, gjendja e tij u bë ashtu siç e kërkoi. U nis për të kryer Haxhin e pesëdhjetë. Kjo ka ndodhur në kohën e imam Xhev'vâdit (Paqja qoftë mbi të!). Kur ka arritur në Xhahfeh, është futur në një luginë, që të lahej, pasi donte të vishte Ihramin. Ajo ishte një luginë me pemë e me rrjedhë uji. Atë e mori rrjedha e ujit, ndërkaq shërbyesit e*

*ndoqën nga prapa, por ata arritën ta nxjerrin të vdekur prej ujit. Ky është edhe shkaku që ai është quajtur “I mbyturi i Xhah’fes”.*

*Thuhet se ai që është lutur për atë ka qenë imam imam Qazimi (Paqja qoftë mbi të!) dhe se mbytja e tij ka ndodhur në vitin 202 të hixhrit.*

### *Hamràn ibn A’jun*

*Hamràn ibn A’jun Esh’shejbànij ka qenë shërbyesi i tyre dhe është vëllai i Zuràres. Ka transmetuar prej imam Bàkirit dhe prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të dy!). Pozita e tij te ata ishte aq afërt, sa nuk I afrohet askush tjetër. Si e mendon pozitën e një burri, për të cilin imam Bàkiri (Paqja qoftë mbi të) thotë: “Ti je nga përkrahësit tanë në këtë botë e në botën tjetër.”?; gjithashtu, për të ai thotë: “Hamràni është prej besimtarëve të vërtetë, që nuk kthejnë kurrë.”, kurse imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) thotë për të: “Për All’llah, vdiq një besimtar. Hamràni është besimtar prej banorëve të Xhennetit. Ai kurrë nuk ka dyshuar, jo, betohem në All’llah, jo, betohem në All’llah! Nuk kam gjetur ndonjë, që ka marrë fjalën time, që i është bindur urdhrin tim dhe që ka ndjekur gjurmët e shokëve të prindërve të mi, përveç dy burrave, që All’llahu i mëshiroftë: Abdullah ibn Ebù Jaëfürin dhe Hamràn ibn Aëjunin, që të dy janë besimtarë të sinqertë prej përkrahësve tanë. Hamràni është një besimtar, që kurrë nuk bëhet renegat. Sa ndërmjetësues i mirë do të jem unë dhe prindërit e mi për Hamràn ibn A’junin! Ditën e Gjykimit ne do ta marrim atë për dore dhe nuk do të ndahemi prej tij, derisa të hymë së bashku në Xhennet.”*

*Ka edhe shumë fjalë të ngjashme, të thëna prej atyre të dyve – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të dy!. Të gjitha këto thënie, siç e sheh, njoftojnë për pozitën e lartë, që ai kishte tek ata dhe ishte në atë gradë, në të cilën kishte vetëm pak të tjerë si ai, edhe pse ata ishin aq shumë burra. Ti ke lexuar e do të lexosh më shumë për këtë figurë; gjithashtu e kupton se këto fjalë, ashtu siç tregojnë pozitën e tij të lartë tek ata, tregojnë edhe besimin e tij të fortë, qëndrueshmërinë e diturisë së tij deri në kufijtë e sigurisë, që nuk mund të dobësohet edhe nëse mbi të kalojnë furtuna, vihet në sprova të rënda dhe e godasin pësime të rënda, duke ditur se koha e tij ishte prej kohëve më të rëndësishme, ku ndërgegjija e burrave u vu në provë.*

*Hamrâni nuk ishte dijetar vetëm në fushën e jurisprudencës së dispozitave të ligjit të fesë, por ishte edhe ndër dijetarët teologë dhe ndër hafizat e librit të All'Allahut, madje emri i tij është i përmendur te ata që kanë shkollat të këndimit të Kur'anit; gjithashtu ka qenë ndër dijetarët në fushën e gjuhësisë e të sintaksës, ashtu siç ka qenë njohës i dialekteve më të dëgjura të arabishtes.*

#### *Hamza ibn Et'taj'jâr*

*Hamza ibn Et'taj'jâr ka qenë i besueshëm, ka qenë ndër dijetarët në fushën e ligjit të fesë dhe teolog. Ka vdekur në kohën e imam Sâdikut. Për Hamza ibn Et'taj'jârin kanë ardhur hadithe, që shprehin për një besim të patundur dhe për besë të qëndrueshme ndaj Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), shprehin edhe për një fuqi të madhe mbrojtëse për ta, për argument të prerë. Kështu e ka treguar El Kesha në faqen 223, sipas transmetimit të*

*Hishàm ibn El-Hakemit: “Ebù Abdil’lahi më ka thënë:  
“Ç’bën Ibn Taj’jari?”*

*Unë thashë: “Vdiq.”*

*Imami (Paqja qoftë mbi të!) tha: “E mëshiroftë All’llahu dhe  
pastë lulishte e gëzim. Ai ka pasur diskutime të forta me ne  
të Ehli Bejtit.”*

*Fjalë të ngjashme ka treguar edhe Mu’min Et’tak, si  
dhe ajo që ka transmetuar Ebàn El Ahmeri prej Taj’jarit, i  
cili ka thënë: “I thashë Ebù Abdil’lahit kam marrë vesh se ti  
e ke urryer diskutimin me njerëzit, e ke urryer armiqësinë.”*

*Ai tha: “Fjalët e njerëzve si ti nuk urrehen. Kushdo,  
që fluturon, është më mirë të bjerë poshtë dhe, nëse bie,  
është më mirë të fluturojë. Ne nuk e urryjmë atë që thotë  
të tilla fjalë.”*

*Taj’jâr është mbiemri i tij dhe i babait të tij,  
Muhammed ibn Abdullah, shërbyesit të Fezàres. Ka qenë  
prej shokëve të imam Bàkirit (Paqja qoftë mbi të!), i cili  
krenohej me të. Në librin “El Keshà”, faqe 22, tregohet  
sipas transmetimit të djalit të tij Hamza, i cili ka thënë:  
“Mua më ka pyetur Ebù Abdil’lahi për këndimin e Kur’ànit  
dhe unë thashë: “Nuk jam unë për këtë.””*

*Por ai tha: “Jo ti, por babai yt.”*

*Pastaj më pyeti për pjesëtimin e pasurisë dhe unë i  
thashë: “Nuk jam unë për këtë.”*

*Por ai tha: “Jo ti, por babai yt.”*

*Pastaj tha: “Një burrë prej kurejshëve, që ishte miku  
im, ishte dijetar dhe këndues Kur’ani. Ai dhe babai yt u*



*mblodhën tek Ebù Xha'feri – Paqja e shpëtimi qoftë mbi të!. Ai i tha: “Secili prej jush le të pranojë njeri-tjetrin dhe secili le të pyesë njëri-tjetrin.”*

*Ata vepruan ashtu, atëherë kurejshiu i tha Ebù Xha'ferit (Paqja qoftë mbi të!) “Ti e more vesh se ç'desha unë. Unë desha që të më mësoje se ndër shokët tuaj ka si ky.”*

*Dhe ai tha: “Ai është i këtillë. Hë, si mendon? Si mendon për atë që Bâkiri (Paqja qoftë mbi të!) e ka futur në diskutim? Si mendon për atë që Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) e merr për të diskutuar në mënyrë të ndërsjellë?”*

*-“Ata të dy janë prej atyre që kanë argumente të qarta dhe forcë në diskutim.”*

*Dàùd ibn Ferkad*

*Dàùd ibn Ferkand El Esedij El Kùfij ka transmetuar prej imam Sàdikut dhe prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Është autor i një libri, në të cilin kanë transmetuar disa prej të besueshmëve; gjithashtu, ai ka shkruar edhe një diskutim me disa zejdiq, që tregon qartë atashimin e tij ndër përkrahësit e pasardhësve të Aliut, si dhe shpejtësinë e përgjigjes së mirë, derisa edhe vetë Ebù Abdil'lahi ka qeshur prej tij.”*

*Kështu e tregon El Keshà, në faqen 221, sipas transmetimit të tij: “I thashë Ebù Abdil-lahit kur po falja namazin e akshamit në xhaminë e të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Një burrë, që po falej prapa meje, më tha: “Përse jeni ndarë në dy grupe për çështjen e hipokritëve, kur Allahu i ka flakur ata në mosbesim për shkak të veprave të tyre?! A*

*mos vallë, dëshironi t'i ktheni në rrugë të drejtë ata që Allahu i ka lënë në humbje? Për atë që Allahu e lë në humbje, ti nuk mund të "gjesh rrugë të drejtë." (Sure "En'Nisà", ajeti 88)?"*

*Unë e mora vesh se ai e kishte fjalën për mua, prandaj u ktheva në drejtim të tij dhe thashë: "...djajtë i nxisin miqtë e vet që t'ju kundërshtojnë ju..." (Sure "El En'am", ajeti 121)"*

*Ndërkaq ai, Hârùn ibn A'di<sup>1</sup> tha: "Ty të ka thyer Ebù Abdil'lahi."*

*Pastaj ai tha: "Iu përgjigje drejt."*

*Dàùdi tha: "Kurban t'u bëfsha, nuk ka problem! Për All'lah ai nuk tha asnjë fjalë." Atëherë Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi tël) tha: "Nuk ka më injorantë se ata. Ndër mexheitë ka bujari dhe dituri edhe ndër havàrixhët ka bujari e dituri, por nuk ka më injorantë se ata."*

*Dàùd Err'ekij*

*Dàùd ibn Kethijr Errekij El Kùfij El Esedij është skllav i tyre dhe ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit. Ka jetuar deri në kohën e imam Rizàsë.*

*Për të ka hadithe të shumta, veçanërisht për kerametet dhe virtytet; gjithashtu, për të ka dhe një libër, i transmetuar prej tij nga një grup të besuarish. Nisur nga fakti se ka transmetuar shumë prej kerameteve të tyre, ata kanë thënë se ai është nga ekstremistët. Kjo është thjesht shkujdesje nga padija.*

---

<sup>1</sup> El Kùfij Ez'zejdij, prej imam Sàdikut është transmetuar edhe qortimi për atë, përveç kësaj që sollëm këtu.

*Në hadithe të shumta tregohet pozita e tij e lartë, ashtu siç e ka treguar El Keshà, në faqen 254, sipas transmetimit të ardhur prej Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!).*

*“Vëreni Dàùd Errekij tek unë në pozitën që kishte Mikdàdi tek i Dërguari i All'Ilahut (Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).”*

*Shikoi Dàùd Errekij, i cili kishte kthyer shpinën dhe tha: “Ai, që gëzohet të shikojë një burrë prej atyre që i shërbenin Profetit, le të shikojë këtë.”*

*Në një vend tjetër thotë: “Vëreni Dàùdin ndër ju në pozitën e Mikdàdit.”*

*Këto shprehje dhe të ngjashme me këto na tregojnë lartësinë e pozitës së tij në fe e në dituri, përveç besueshmërisë së tij në transmetim.*

#### *Zuràrah*

*Zuràrah ibn A'jun Esh'shejbànij ka qenë simpatizant i tyre dhe ka transmetuar prej Bàkirit e prej imam Sàdikut. Ka vdekur në vitin 150 të hixhrit. Ka jetuar edhe dy vjet në kohën e imam Qàzimit*

*Çfarë mund të thoni për Zuràren? A mundet ndonjë i talentuar të na sjellë një fjalë, që të përmbledhë virtytet e Zurares? A janë të mjaftueshme ato që kanë ardhur për të prej imamëve të udhëzuar në rrugën e drejtë, për të qartësuar pozitën dhe lartësinë e punës së tij? Gjithashtu, është e mjaftueshme ajo që është përmendur më sipër për Burejd El Axhelijin.*

*Ne do të përmendim këtu diçka që nuk e kemi përmendur atje, sepse imam Sàdiku një herë i ka thënë atij: “O Zuràrah, emri yt është në vendet më të larta të Xhennetit, por pa zanoren zgjatëse “à”.”*

*Zuràrah tha: “Po, kuraban t’u bëfsha, emri im është Abd Rab’beh (rob i Zotit), por unë jam quajtur me epitetin Zuràrah.”*

*Gjithashtu, ai ka thënë: “Nëse nuk do të ishte Zeràreh, do të mendoja se hadithet e babait tim do të kishin humbur.”*

*Ai i ka thënë Fejd ibn El Mukhtàrit<sup>1</sup>: “Kur të duash ndonjë hadith, ke detyrë të shkosh tek ai që është ulur atje.”, dhe bëri shenjë me dorën e tij në drejtim të Zuràrah. Në një hadith tjetër ai ka thënë: “All’llahu e mëshiroftë Zuràren!<sup>2</sup>*

*Nëse nuk do të ishte Zuràrah e shokët e tij, haditheve të babait tim nuk do t’i kishte mbetur gjurmë.”*

*Imam Rizài ka thënë: “A mendon se ka ndonjë që e ka shpjeguar më qartë të vërtetën se Zuràra?”*

*Ka edhe hadithe të tjera të kësaj natyre. Me këto hadithe ti nuk ke nevojë për fjalë të tjera prej çdo autori fjalëmprehtë, që ka shkruar për Zuràren dhe ka folur për*

---

<sup>1</sup> El Xheafij El Kùfij ka transmetuar prej imam Bàkirit, prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi ta!) dhe është prej transmetuesve të besueshëm të tyre.

<sup>2</sup> Sipas asaj që shihet nga ana e jashtme e këtij hadithi rezulton se Zeràreh ka vdekur në kohën e imam Sàdikut. Nuk përjashtohet fakti që imam Sàdiku është lutur duke kërkuar mëshirë për të, që kur ai ishte gjallë.

*virtytet, për diturinë e për pozitën e lartë, që ai kishte tek Ehli Bejti.*

*Zurarah nuk ishte vetëm jurist në fushën e dispozitave të ligjit të fesë, pasi te ai ishin bashkuar disa virtyte, aq sa Nedijmi, në pasqyrën e lëndës ka thënë: “Zurarah është më i madhi i burrave të shi’ave në fushën e ligjit të dispozitave të fesë, të hadithit, të njohjes së teologjisë dhe të përkatësisë në përkrahje të pasardhësve të imam Aliut.”*

*En’nexhàshij’ji ka thënë: “Ai ishte shejhu i shokëve tanë në kohën e tij dhe ishte i pari i tyre. Ai ishte këndues i Kur’ànit, juristi në ligjin e fesë, teolog, poet dhe letrar. Te ai ishin bashkë virtytet e larta dhe feja.”*

*Ebù Gàlib Erràziz, ashtu siç tregohet prej tij, ka thënë: “Është transmetuar se Zeràreh kishte një shenjë të bërë nga djegia. Ishte trup madh dhe i bardhë. Kur shkonte për të falur namazin e xhumasë, mbante një kësulë të gjatë të zezë. Ndërmjet syve i dallohej gjurma e sexhdes, në dorë mbante një shkop dhe njerëzit qëndronin në këmbë në radhë, që të shikonin pamjen e tij të bukur, mbase kur kthehej prej rrugës së tij. Në diskutim e në polemikë asnjë njeri nuk i qëndronte argumenteve të tij, e impononte veten në vijimësinë e punës dhe zotëronte argumente të prera, por adhurimi e angazhonte tërësisht nga fjalët. Teologët e shi’ave janë nxënësit e tij.”*

*Te Zurara ishin mbledhur të gjitha virtytet, por ai u bë i dëgjuar më shumë në fushën e diturisë së ligjit e të fesë. Disa cilësi të tij dalloheshin mbi cilësitë e tjera të tij, prandaj ai, që futet në detin pa anë e pa fund të*

*dispozitave të ligjit të fesë, e merr vesh se sa i ditur ishte ky burrë në fushën e hadithit. Nuk ka kapitull të dispozitave të ligjit të fesë që të mos ketë një hadith ose disa hadithe të transmetuara prej tij. Ka qenë nga gjashtë të parët prej shokëve të Ebù Xha'ferit. Prandaj grupi ka një mendim të përbashkët për të vënë në shkallën "Sahijh" hadithet e transmetuara prej tyre, si dhe pohimi i tyre për të punuar me to në fushën e dispozitave të ligjit të fesë, prandaj nuk ka asnjë teprim, nëse e numërojmë Zeràrehen më të diturin e tyre në fushën e fik'hut.*

*Zuràrah ishte i njohur për diturinë, virtytet dhe për afërsinë e tij ndaj Ehli Bejtit, por kjo e fundit është krimi më i madh tek armiqtë e tyre dhe për këtë shkak ai vazhdoi të jetë gjithnjë në rrezik. Prandaj imami disa herë e mbante pranë vetes, me qëllim që të largonte rrezikun prej tij. Më pas kanë ardhur hadithe, që e atakojnë Zuràren dhe për këtë shkak është bërë e qartë edhe qortimi i imam Sàdikut për të. Në një hadith të gjatë, të transmetuar në El Keshà, në faqen 61, ai ka thënë: "Unë të qortoj ty për të të mbrojtur, sepse njerëzit e armiqtë janë shumë të shpejtë kundër kujtdo që afrohet me ne e na lavdëron, prandaj ata synojnë të poshtërojnë e të torturojnë të gjithë ata që ne i duam e i afrojmë ... Prandaj unë desha të qortoj ty, që ata të lavdërojnë punën tënde në fe me të metën tënde e me mangësinë tënde, që kjo të jetë pengesë e sprapsës i sherrit të tyre prej teje."*

*Nga këto fjalë mësojmë pozitën e Zuràres tek ata, ashtu siç mësojmë edhe problemin e këtyre haditheve me qortime.*

### *Zejd Esh'sheh'hàm*

*Ebù Usàmeh Zejd Esh'sheh'hàm El Ezedij El Kùfij ka transmetuar prej imam Bàkirit e prej imam Sàdikut. Është thënë se ka transmetuar edhe prej imam Qàzimit. Është prej të besueshmëve dhe prej atyre që kanë një pozitë të lartë.*

*Ja si e përshkruan shejh Mufijdi figurën e tij: “Ai është nga juristët e fesë të shokëve të dy Sàdikëve, imam Bakiri dhe imam Sadiku,. Dijetarët e mëdhenj kanë marrë prej tij dituri në lidhje me hallahin e haramin, fetvà dhe dispozita të fesë.*

*Hadithet flasin se ai kishte një pozitë shumë të lartë. Nga këto hadithe kemi hadithin e transmetuar në El-Keshà, faqe 216, prej vetë Zejdit: “I thashë Ebù Abdil’lahit: “A është emri im ndër këta të lartë, domethënë në librin e atyre që janë betuar?”*

*Ai tha: “Po.”*

*Kemi edhe hadithin tjetër të transmetuar prej tij: “Hyra tek Ebù Abdil’lahi dhe ai më tha: “O Zejd përtërije pendimin (teuben), si dhe adhurimin e fundit.”*

*Unë i thashë: “Kam bërë shumë kujdes.”*

*Por ai tha: “O Zejd, tek ne nuk ka mirësi as për ty që je nga përkrahësit tanë.”*

*Vazhdoi të flasë derisa tha: “O Zejd, kur unë të shoh ty, është si të shikoj gradën tënde në Xhennet. Shoku yt në Xhennet është Hârith ibn El Mugijrej En’nasrij.”<sup>1</sup>*

*Ka edhe hadithe të tjera që tregojnë për ne pozitën dhe gradën e tij të lartë.*

### *Zejd Esh’shehijj*

*Zejd ibn Ali ibn Husejn ibn Ali ibn Ebù Tàlib (Paqja qoftë mbi ta!) ka transmetuar prej babait të tij imam Sexh’xhàdit. Është e mjaftueshme që ka transmetuar “Es’sahijfetu-S’shexhàdij’jeh”, në të cilën janë përfshirë dituria, letërsia, oratoria, dhe gjuhësia. Kjo vepër të mëson ty se si është nënshtrimi ndaj të madhit Zot dhe këtë ta mëson nëpërmjet lutjes së tij e nëpërmjet kërkesës drejtuar Atij, prandaj kjo vepër është një argument i qartë për imamatin e imamëve të Ehli Bejtit, pasi i gjithë kopshti i tyre tregon se ai, që i nxjerr këto fjalë, nuk është si njerëzit e zakonshëm, të cilëve vetëm se i shkon syri.*

*Ai ka transmetuar prej vëllait të tij, imam Bâkirit dhe prej djalit të vëllait të tij, imam Sàdikut. Ai e besonte imamatin e imam Sàdikut dhe në fshehtësi bënte thirrje në favor të tij. Kurrë nuk ka pretenduar imamatin për vete. Pas vdekjes së tij është pretenduar imamati për të. Ka rënë dëshmor në Kûfe në vitin 121 të hixhrit. Atë e ka qarë imam Sàdiku, është lutur e i ka kërkuar All’llahut mëshirë për të. Gjithashtu, ai ka shpenzuar për familjarët e atyre që u vranë së bashku me të. Te Zejdi ishin mbledhur cilësi të larta, që rrallë herë mund të gjenden të gjitha së bashku te*

---

<sup>1</sup> Ky hadith tregon se ai ka vdekur në kohën e imam Sàdikut, prandaj ai nuk është prej atyre që kanë transmetuar prej imam Qàzimit.



*ndonjë burrë, me përjashtim të atyre që janë të ruajtur nga mëkatet (ma'sùmijn). Ndër virtytet e tij përmendim: fik'hun, ruajtjen, bujarinë, trimërinë, përkohshmërinë, adhurimin e të tjera cilësi të lavdërueshme.*

*Në pjesën e parë, f. 48, të tekstit arabisht, është folur për punën e tij.*

### *Sedijr Es'sajrefij*

*Sedijr ibn Hakijm ibn Suhejb Es'sajrefij El Kùfij ishte skllav dhe ka transmetuar prej tre imamëve (Paqja qoftë mbi ta!): prej imam Sexh'xhàdit, prej imam Bâkirit dhe prej imam Sàdikut. Ka transmetuar edhe prej shumë transmetuesve të besueshëm, disa prej të cilëve i përkasin elitës së dijetarëve. Për të janë transmetuar lavdërime e vlerësime, siç është fjala që imam Sàdiku i ka thënë Zejd Sheh'hàmit: "O Sheh'hàm, unë i jam lutur Zotit tim për Sedijrin dhe për Abdu Selàmin, të birin e Abdu Rrahmànit, të cilët ishin në burg. All'llahu që të dy m'i dhuroi mua, duke i dhënë lirinë."; si dhe fjala tjetër e tij kur tek ai ishte vetë Sedijri: "Kur Allahu e do një rob, lëshon mbi të sprovën, njëra pas tjetrës, prandaj ne dhe ju, o Sedijr, do të gdhijemi e do të ngrysemi në sprovë."*

*Ky lartësim prej All'llahut është një argument për pozitën e madhe që ai kishte tek ai, njëkohësisht tregon edhe vlerësimin për të. Është e mjaftueshme të themi se ai ishte prej atyre që i do All'llahu dhe i mbulon me sprovat e Tij. Ka edhe fjalë të tjera që tregojnë gradën e tij të lartë.*

### *El A'mesh*

*Për besueshmërinë, mirësinë dhe madhësinë e Ebù Muhammed Sulejmàn ibn Mehràn El A'mesh El Esedij El Kùfij kanë një mendim të përbashkët të veçantët dhe ata të masës. Ata të masës e përmendin me fjalët më të bukura dhe i kanë njohur atij karakteristika të veçanta, të lavdërueshme, krahas përkatësisë së tij në grupin e përkrahësve të pasardhësve të Aliut. Ja, Edh'dhebij'ji në librin "Mijzànul I'tidâl" thotë: "Ebù Muhammedi është ndër imamët e besueshëm dhe është ndër të vegjlit e brezit të dytë të myslimanëve (Tàbi'inëve).", gjithashtu ai thotë: "Është vërtetuar që El-Aëmeshi është si Sàdiku. Ai zotëron Sun'netin dhe Kur'ànin."*

*Ai ka qenë transmetues i virtyteve të Prijësit të Besimtarëve, imam Aliu derisa edhe të veçantët e ata të masës kanë transmetuar se atë e ka pyetur Mensùri: "Sa hadithe di përmendësh, që flasin për virtytet e imam Aliut."*

*Dhe ai i ka thënë: "Dhjetë mijë hadithe."*

*Në disa transmetime, të disa dorëshkrimeve, thuhet: "Njëmijë hadithe."*

*Ka të ngjarë, që ky ngurrim prej tij ka qenë si masë mbrojtëse nga ana e tij prej Mensùrit, duke e ditur urrejtjen që ai kishte për djemtë e imam Aliut Kur Mensùri e kuptoi qëllimin që pati Aëmeshi, me këtë ngurrim, deshi të sigurohej për ato që atij i vlonin në shpirt dhe i tha: "Pra, dhjetë mijë, ashtu siç the herën e parë?!"*

*Thuhet: "Ai ka lindur në vitin që u vra imam Husejni, në vitin 61 të hixhrit dhe ka vdekur në njëzet e pesë të muajit Rebij'ul Ev'vel të vitit 148 të hixhrit, që është edhe viti i vdekjes së imam Sàdikut."*

### *Semâ'ah*

*Semâ'ah ibn Mehrân El Khadremij El Kûfij ka transmetuar prej Ebû Abdil'lahit dhe prej Ebû Hasanit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka vdekur në Medine dhe ka transmetuar shumë hadithe, që i takojnë fushës së fik'hut, gjithashtu ka transmetuar shumë nga vizitat e imamëve dhe lutje të imam Sâdikut. Për atë ka një libër, të cilin e kanë transmetuar prej tij transmetues të besueshëm, ndër të cilët është edhe një grup. Grupi ka një mendim të përbashkët, që ato, që janë transmetuar prej tyre, janë të shkallës "Sahijh".*

### *Safvân El-Xhem'mâl*

*Safvân ibn Mehrân El Xhem'mâl El Esedij El Kûfij ka transmetuar prej imam Qâzimit e prej imam Sâdikut. Xhem'mâli ka vazhduar të mbajë këtë mbiemër dhe ka qenë shumë i lidhur me Ehli Bejtin (Paqja qoftë mbi ta!). Ai ka punuar me urdhrin e tyre dhe gjithmonë ka qenë në shërbim të tyre. Më sipër, në kapitullin "Sâdiku në Irak", pjesa e parë, faqe 129, e tekstit arabisht, është përmendur materiali që e vërteton këtë fakt, ashtu siç tregon për këtë edhe blerja e tij për shkak të bukurisë së tij, sipas urdhrit të imam Qâzimit. Madje kjo e vërtetë ka tërhequr vëmendjen e Reshijdit, i cili i ka thënë atij: "Unë e di shumë mirë se kush të ka treguar ty për këtë dhe ka bërë me shenjë për Mûsà ibn Xha'ferin, pastaj ka shtuar: "Betohem në All'llah, sikur të mos ishte shoqëria e mirë me ty, padyshim që do të të kisha vrarë."*

*Është e mjaftueshme të thuhet se, për të zbatuar urdhrin e imamit të tij, ai e vinte veten para çdo rreziku. Ka qenë nga transmetuesit më të dalluar dhe nga liderët e transmetuesve të besueshëm; hadithet e tij janë të shumta*

*dhe prej tij kanë transmetuar transmetuesit më në zë.  
Gjithashtu, për të ka një libër, në të cilin kanë  
transmetuar prej tij burrat e besueshëm dhe dijetarët.*

#### *Abdu Rrahmàn ibn El Haxhàxh*

*Abdu Rrahmàn ibn El Haxhàxh El Bexhelij El Kufij ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit. Ka jetuar derisa është takuar me imam Rizànë dhe ka vdekur në kohën e tij. Ka qenë nga dijetarët e shokëve të Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!), gjithashtu ka qenë nga dijetarët në fushën e ligjit të fesë e nga të besueshmit e tij të mirë. Prej imamëve (Paqja qoftë mbi ta!) kanë ardhur mendime të shumta, që e lartësojnë dhe e lavdërojnë atë, madje imamët e kanë përgëzuar atë se do të vdesë në Medine me një gjendje të ndryshuar. Prej tij ka transmetuar elita e transmetueseve, disa prej të cilëve janë dijetarë që u merret fjala në konsideratë. Ka qenë ndër teologët e shquar dhe kishte forcë në kundërshtim, aq sa Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë atij: “O Abdu Rrahmàn, foli banorëve të Medines, se unë dua që burrat e përkrahësve të pasardhësve të Aliut të jenë si ti.”, duke ditur se ai nuk lejonte shumë fjalë me shokët e tij, me përjashtim të disa të veçantëve, si: p.sh. Ebàn ibn Tegal'lubit, Taj'jàrit dhe disa të tjerë, përveç këtyre të dyve. Ai vepronte kështu për vetëmbrojtje, që të mos zbuloheshin e të dilnin jashtë kuadrit të ruajtjes (tekijeh).*

#### *Abdu Selàm ibn Sàlim*

*Abdu Selàm ibn Sàlim El Bexhelij El Kùfij ka transmetuar prej Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!). Për të ka një libër, në të cilin kanë transmetuar transmetues të*

*besueshëm. Ka qenë nga dijetarët në fushën e ligjit të fesë të shokëve të imam Sàdikut. Ai ishte nga krerët e elitës së dijetarëve, prej të cilëve është marrë dituri për hallallin e haramin dhe fetvâ për dispozitat e ligjit të fesë. Për ata, që nuk atakohen, nuk ka rrugë që të poshtërohen, ashtu siç ka thënë shejh Mufijdi.*

#### *Abdu Selàm ibn Abdu Rrahmàn*

*Ibn Shehràshubi në librin e tij “El Menàkib” e ka numëruar Abdu Selàm ibn Abdu Rrahmàn ibn Naijm El Ezedij ndër të veçantët e imam Sàdikut. Më sipër, kur është folur për Sedijrin, kemi treguar fjalën e imam Sàdikut: “O Sheh’hàm, unë i jam lutur Zotit tim për Sedijrin e për Abdu’s’selàmin, të birin e Abdu Rrahmànit, të cilët ishin në burg. Ai m’i dhuroi mua ata të dy, duke i liruar nga burgju.”*

*Kjo fjalë e tij na njofton vlerësimin dhe dashurinë që kishte Ebù Abdil’lahi (Paqja qoftë mbi të!) për ata të dy. Kjo është e mjaftueshme për të shprehur butësinë e tij ndaj tyre, si dhe për të treguar punën dhe pozitën e lartë që kishin ata të dy.*

#### *Abdullah ibn Ebù Ja’fùr*

*Abdullah ibn Ebù Ja’fùr El Abdij El Kufij ishte nga shokët e dy Sàdikëve (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka vdekur në kohën e Ebù Abdil’lahit; por unë nuk kam arritur të kem ndonjë fjalë, që të tregojë lartësinë e pozitës së tij e të flasë për madhështinë e vlerave të tij, se sa i fortë ishte besimi i tij, forca e tij e dijës dhe qëndrimet e tij të drejta në fushën e besimit. Le t’ia lëmë këtë nxjerrësit dhe edukuesit të tij, imamit Xha’fer Sàdikut, që të tregojë gjendjen e tij, sepse ai, me pozitën, me jetëshkrimin e me*

*ndërgjegjen e tij, është njeriu që di më shumë. Ai i ka shkruar Mufaddal ibn Umer El Xheafij'jit, kur Abdullah ibn Ebù Jaëfuri kaloi për tek Zoti i tij: "O Mufaddal, unë ta dhashë ty besën, që ishte më parë tek Abdullah ibn Ebù Ja'furi. Ai u nda nga kjo jetë vepërlavdëruar, i falënderuar për mundimin, me mëkate të falura, i mëshiruar dhe prej tij është i kënaqur All'llahu, i Dërguari i Tij e imami i vet, për atë që unë e kam parësinë prej të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Në kohën tonë asnjë njeri nuk ka qenë më i bindur ndaj All'llahut, të Dërguarit të Tij e imamit të vet më shumë se ai; vazhdoi të ishte i tillë, derisa All'llahu, me mëshirën e Tij, e ndau nga kjo jetë dhe e çoi në Xhennetin e Tij, që aty të banojë së bashku me të Dërguarin e All'llahut e me prijësin e besimtarëve. All'llahu e vuri të banojë mes dy shtëpive, shtëpisë së Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij) dhe shtëpisë së Prijësit të Besimtarëve. Nëse shtëpitë janë një, edhe gradat janë një, por All'llahu, nga ana e Tij, ka shtuar për atë kënaqësinë dhe nga mirësia e Tij ka shtuar për atë faljen e mëkateve, krahas kënaqësisë sime për të."*

*Sikur të mos qe imam Sàdiku, që të na njoftonte për Abdullahun, për devotshmërinë e bindjen e tij, ne nuk do të besonin se dikush nga njerëzit do të arrinte këtë gradë e këtë kënaqësi.*

*Në lidhje me Abdullahun kanë ardhur lëvdata të shumta, që flasin për lartësinë e pozitës së tij e për qëndrueshmërinë e besimit që ai kishte. Madje kanë ardhur sa nuk kanë ardhur për të tjerë. Më lart është thënë diçka e tillë për Hamrànin, të cilit imami i tij, imam Sàdiku, i thotë: "Sikur të ndaje një kokërr shegë në dy pjesë dhe të thoshe se kjo është hallall dhe tjetra haram, padyshim që unë do*

*të dëshmoja atë që the ti, sepse asaj që ti i the hallall, është hallall dhe asaj që ti i the haram, është haram. All'lahu të mëshiroftë, All'lahu të mëshiroftë!"*

*Ky dorëzim, ky delegim i punëve, kjo bindje dhe ky asimilim i mësimëve, janë ato që e kanë ngritur atë në këtë gradë të lartë, edhe pse në zakonin e imamit të tij ishte detyrë, që shokët e tij të ishin ashtu siç ishte Abdullahu. Por, ku jemi ne me këto shpirtra të pastër e të bindur ndaj All'lahut?!*

#### *Abdullah ibn Bekijr*

*Abdullah ibn Bekijr ibn A'jun Esh'shejbànij është skllavi i tyre dhe ka transmetuar prej imam Bâkirit e prej imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të dy!) Është prej gjashtë shokëve të imam Sâdikut, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët, për ta vënë në shkallën "Sahijh". Është numëruar ndër juristët e nderuar të fesë dhe të dijetarëve. Është prej autorëve të bazave të shkruara dhe të botimeve më të dëgjura. Është akuzuar se është "Fetahi", por edhe nëse është e vërtetë, kjo nuk e prish besueshmërinë e tij në transmetim. Në të gjitha rastet ai mbetet i besueshëm në transmetim. Më sipër është përmendur babai i tij, Bekijr, si dhe autoriteti e puna e tij.*

#### *Abdullah ibn Sinàn*

*Abdullah ibn Sinàn ibn Tarijf El Kùfij është skllav i kurejshëve ose vetëm i fisit Benij Hâshim. Ai ka transmetuar prej imam Sâdikut. Thuhet se ka transmetuar edhe prej Qâzimit. Kjo thënie nuk është aq e largët, pasi ai ishte bashkëkohës me të dhe ka mbajtur sekrete të Mensùrit, Mehdiut, Hâdiut dhe Reshijdit. Megjithëkëtë, ai ishte nga përkrahësit e Ehli Bejtit dhe të dijetarëve të mirë*

*në fushën e ligjit të fesë dhe i elitës së transmetuesve të besueshëm, të cilët nuk atakohen për asnjë send. Në lidhje me të, imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Në të vërtetë, vitet atij i shtojnë mirësitë.”*

*Prej imam Sàdikut ai ka parë një keramet të qartë, çka tregon për pozitën e tij tek Ebù Abdil’lahi. Ai është prej atyre që mbanin sekretet e tij. Për atë ka libra, ku transmetuesit më në zë dhe elita e të besueshmëve kanë transmetuar prej tij.*

#### *Abdullah ibn Sherijk*

*Ebù El MuHaxhel Abdullah ibn Sherijk El Ámirij ka shoqëruar imam Bàkirin dhe imam Sàdikun. Tek të dy ishte i dashur dhe në pararojë. Madje e kanë numëruar ndër dishepujt e të dyve. Prej imam Sàdikut është transmetuar se ai ka dalë në ndihmë të të pastrit Mehdiut, (All’llahu e shpejtoftë daljen e tij!) dhe kjo është një mirësi e madhe, virtyt i lartë, fitore, lartësi e madhështi. I lutemi të Lartësuarit, që ai të jetë prej atyre, mbi kokën e të cilit do të valëvitet flamuri i tij fitimtar.*

#### *Abdullah ibn Meskàn*

*Abdullah ibn Meskàn El Kùfij, skllav, ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Është nga të gjashtë shokët e Sàdikut, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët, për ta vënë në shkallën “Sahijh”. Numërohet ndër juristët e mëdhenj të fesë dhe nga krerët e dijetarëve të dëgjuar, prej të cilëve merret dituri për hallallin, haramin e fetvâ për dispozitat e ligjit të fesë. Është nga ata dijetarë, për të cilët nuk ka rrugë, që ata të atakohen për ndonjë send. Ka shkruar*



*shumë libra, në të cilat kanë transmetuar prej tij elita e të besueshmëve dhe krerët e transmetuesve.*

#### *Abdullah ibn En'nexh'xhàshij*

*Ebù Behijr Abdullah En'nexh'xhàshij El Esedij, ka qenë zejdi, pastaj është prononcuar për imamatën e imam Sàdikut kur pa prej tij një keramet. Për këtë referohu në pjesën e parë, faqe 260, të tekstit arabisht. Ka qenë vali në qytetin Ahvâz, i emëruar prej Mensùrit. I ka shkruar imam Sàdikut dhe e ka pyetur rreth jetëshkimit të Profetit e të punës dhe se si të veprojë me pasuritë e veta; gjithashtu, e ka pyetur edhe për punët që lidheshin me detyrën e tij të valiut. Imam Sàdiku i është përgjigjur me një letër të gjatë, e cila është mesazhi i njohur me emrin “Mesazhi i Abdullah En'nexh'xhàshijut”, prej së cilës ne kemi cituar paragrafë shumë të çmuar dhe që është përmendur në kapitullin “Porositë e tij” në këtë pjesë, në faqen 44, të tekstit arabisht. Jeta e tij ka qenë e lavdërueshme dhe nga detyra e tij, si vali, imami ka qenë i kënaqur. Gjithashtu, ka qenë i besueshëm tek dijetarët e mëdhenj, madje shejhu i grupit Tùsij'ji, në librin “Tehdhijbul Mekàsib”, e ka numëruar atë ndër të përkorët, megjithëse ishte i ngarkuar prej Mensùrit me detyrën e të parit të qytetit Ahvaz.*

#### *Abdullah El Kàhilij*

*Abdullah ibn Jahjà El Kàhilij El Kùfij ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qâzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Edhe Ebù Hasani është kujdesur dhe e ka dashur atë, deri në atë masë, sa i ka thënë Ali ibn Jaktijnit: “Siguroje për mua El Kàhilijin, që unë të siguroj për ty Xhennetin.”*

*Imami siguroi atë çka deshi, madje mirësia e tij përfshiu jo vetëm El Kâhilijin, por edhe të afërmit e tij, për më tepër shpenzimet mbi ata vazhduan edhe pas vdekjes së El Kâhilijit.*

*Imam Ebù Hasani (Paqja qoftë mbi të!) e ka përgëzuar atë për të ardhme të bukur në botën tjetër dhe një ditë i tha: “Puno mirë në rrugën tënde, pasi të është afruar mbarimi i jetës!”*

*El Kâhilji qau dhe Ebù Hasani i tha: “Ç’të bëri të qash?”*

*Ai i tha: “Kurban t’u bëfsha, po vajtoja veten.”*

*Ebù Hasani i tha: “Përgëzohu, se ti me të vërtetë je nga përkrahësit tanë dhe je në rrugën e së mirës.”*

*Nuk kaloi shumë kohë nga kjo bisedë dhe ai vdiq.*

*Në këtë tregim e në tregime të ngjashme ti mësove një keramet të El-Kâhilijit, si dhe pozitën e lartë që ai kishte tek ata. Ai ka shkruar një libër, në të cilin kanë transmetuar prej tij krerët e të besueshmëve, si dhe disa nga të Ehli Sun’netit.*

*Abdul-Melik ibn A’jun*

*Ebù Darijs Abdul Melik ibn A’jun Esh’shejbànij ka qenë skllavi i tyre dhe vëllai i Zuràres e i Hamrànit. Ka transmetuar prej imam Bâkirit dhe prej imam Sâdikut. Ka vdekur në kohën e Sâdikut, të cilin, kur e njoftuan për vdekjen e tij, ndodhej në Mekkë, ka ngritur duart lart dhe është lutur për të, ka bërë lutje të gjatë, duke kërkuar*

*mëshirë për të. Kur erdhi në Medine, së bashku me shokët, ka shkuar të vizitojë varrin e tij.*

*Zuràreh tregon: “Ebù Abdil’lahi, pas vdekjes së Abdul Melikut tha: “O Zoti im, për Ebù Darijsin ne ishim njerëzit më të mirë që Ti ke krijuar, prandaj Ditën e Gjykimit peshoi punët e tij në peshoren e Muhammedit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).”*

*Janë edhe hadithe të tjera, që kanë ardhur për të, të cilat, siç i sheh, të tregojnë qartë lartësinë e gradës e të pozitës së tij, njëkohësisht të tregojnë edhe sa i njihite ai imamët e vet.*

*Edhe djali i tij, Darijsit, emrin e të cilit e mban për epitet, ka qenë nga transmetuesit e imam Sàdikut e nga të besueshmit dhe prej tij kanë transmetuar të besueshmit. Bashkëshortja e tij ishte vajza e xhaxhait të vet, Hamrànit.*

*Ubejd ibn Zuràreh*

*Ubejd ibn Zuràreh ibn A’jun Esh’shejbànij ka qenë pasues i tyre. Është prej atyre, që kanë marrë dituri prej Ebù Xha’ferit e prej Ebù Abdil’lahit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka shkruar një libër, në të cilin kanë transmetuar për të ajka e transmetuesve, si dhe disa nga të Ehli Sun’netit. Është nga krerët e të besueshmëve, për të cilët nuk asnjë dyshim; është nga juristët e shquar të fesë dhe nga krerët e dijetarëve të mëdhenj, prej të cilëve merret dituri për hallallin e haramin; gjithashtu është ndër krerët e autorët e librave të bazave të jurisprudencës islame e të botimeve më në zë.*

*Ubejdullah El Halebij*

*Familja Ebù Shu'beh në Kùfe është shtëpi e njohur si shtëpi shi'ash dhe, meqenëse tregtinë e kishin në Haleb, janë quajtur me mbiemrin El Halebij. Ubejdullah ibn Ali ibn Ebù Shu'beh El Kùfij El Halebij ka transmetuar prej gjyshit të tyre, Ebù Shu'beh, prej imam Hasanit e prej imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të dy!) dhe të gjithë ishin të besueshëm. Ubejdullahu ishte më i madhi e më i dituri i vëllezërve, prandaj, kur thuhet mbiemri El Halebij, në të shumtën e herës, qëllimi është vetëm për Ubejdullahun, por në disa raste është edhe për vëllain e tij Muhammedin. Është i pari që ka shkruar libra për shokët e Ebù Abdil'lahit dhe, kur shkroi librin e tij të njohur në fushën e fikh'ut (në fushën e rregullave të ligjit të fesë), ia paraqiti Ebù Abdil'lahit i cili e miratoi, e korrigjoi dhe tha për atë: "A e beson prej atyre një si ky?"*

*Për të kanë transmetuar disa nga krerët e transmetuesve të besueshëm. All'illahu i shpërbleftë me të mira për fenë e tyre dhe i dhëntë atyre shpërblimin e pumëmirëve!*

*El-Alà ibn Rezijn*

*ElAlà ibn Rezijn El Kalà El Kùfij ishte skllav i fisit të thekifëve. Ka transmetuar prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Ka qenë me autoritet dhe i vlerësuar për saktësi e përpikëri, aq sa në lidhje me të nuk ka asnjë lloj insinuate prej asnjërit, madje të gjithë kanë një mendim të përbashkët për madhësinë e tij e për besueshmërinë e tij. Ka shoqëruar Muhammed ibn Muslimin dhe prej tij ka marrë dituri në fushën e fikh'ut. Ka shkruar libra, në të cilat kanë transmetuar prej tij transmetues të besueshëm, disa prej të cilëve janë nga të Ehli Sun'netit.*

*Ali ibn Jaktijn*

*Ali ibn Jaktijn ibn Mùsà El Kùfij El Bagdàdij ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Është e njohur puna e gjendja e tij për besueshmëri, për autoritet e për madhështi, por as pozita, që ai gëzonte pranë Reshijdit, nuk është e panjohur, pasi njoftimet e tij për Reshijdin janë të shkruara. Janë të shumta njoftimet e ardhura për lavdërimet, lartësimin e përgëzimin e tij për një përfundim të bukur dhe për kthimin e tij në kënaqësinë e All'llahut e në Xhennetet e Tij, siç është për shembull fjala e imam Ebù Hasanit: "Kam siguruar për Ali ibn Jaktijnin Xhennetin dhe atë nuk do ta prekë zjarri."; si dhe fjala tjetër e imam Sàdikut që është thënë edhe më lart për Ali ibn Jaktijnin, kur ai ishte duke ardhur: "Kush gëzohet të shohë një burrë prej shokëve të të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), le të shikojë këtë që po vjen."*

*Njëri prej atyre, që ishin aty, e pyeti: "Atëherë, ai është prej banorëve të Xhennetit."*

*Imam Ebù Hasani tha: "Sa më përket mua, unë dëshmoj se ai është nga banorët e Xhennetit."; si dhe fjala tjetër e tij: "Nga lumturia e Ali ibn Jaktijnit është se unë e kam kujtuar atë në Arafât. Unë e kërkova dhuratë Ali ibn Jaktijnin prej Zotit tim të Lartësuar dhe Ai ma dhuroi atë."*

*Ali ibn Jaktijni e derdhi pasurinë e dashurinë e tij dhe këtë e kërkonte vetë. Janë të shumta hadithet që flasin për cilësitë e tij.*

*Përsa i përket punëve të tij të mira, shërbimeve të tij për Ehli Bejtin, kryerjen e nevojave të miqve të tij, të gjitha këto nuk mund të përmbliidhen e të llogariten. Çdo vit ai dërgonte për Haxh bedel, që ta kryenin Haxhin për të. Në disa vite ka dërguar për vete deri në treqind bedelë. Disave*

*u jepte nga njëzet mijë e disa të tjerëve nga dhjetë mijë për çdo Haxh, siç ishin El Kâhilij dhe Abdurrahmân ibn El Haxhâxh, etj. Shuma më e vogël, që i ka dhënë ndonjërit, është një mijë dirhem. Çdo vit çonte tek Ebù Hasani njëqind mijë deri në treqind mijë dirhem dhe Ebù Hasani ka martuar me ato pará tre apo katër prej djemve të vet, ndër të cilët Ebù Hasanin Rizânë (Paqja qoftë mbi të!).*

*Ali ibn Jaktijni i shkroi atij: “Unë, shumë e kurorëzimit për ata, e kam dërguar tek ti.” Por ai, mbi atë shumë, ka shtuar edhe tre mijë dinarë për dasmën, kështu që vetëm në një dërgesë u bënë trembëdhjetë mijë dinarë.<sup>1</sup>*

*Është e mjaftueshme të përmendim se, me shpenzimet e tij, kanë plotësuar nevojat e veta miqtë e tij dhe gjithnjë, me shpenzimet e tij, ka vazhduar të financojë njerëzit e familjes së El Kâhilijit dhe të të afërmeve të tij; gjithashtu, ai, me shpenzimet e veta, i ka kryer nevojat të gjithë miqve që i vinin.*

*Për të vënë në dukje lartësinë e punës së tij dhe vlerësimin e madh që kishte, është e mjaftueshme të sjellim fjalën, që i ka thënë atij Ebù Hasani (Paqja qoftë mbi të): “O Ali, All’llahu i Lartësuar ka miq, krahas miqve të mizorëve, që me ta të sprapsë mizorët prej miqve të Tij dhe ti o Ali je prej tyre.”*

*Këtë fjalë ia ka thënë kur Ebù Ibrâhijm Mùsài u kthye prej Irakut. Edhe Ali ibn Jaktijni i tha atij: “A nuk e sheh gjendjen në të cilën unë jam?”<sup>2</sup>*

*Me një fjalë, Ali ibn Jaktijni ishte sy për All’llahun dhe vendstrehim për miqtë e All’llahut ndaj armiqve të Tij.*

<sup>1</sup> “El Keshà” f. 433 dhe f. 819.

<sup>2</sup> I njëjti burim, f. 433 dhe f. 817.

*Ai i ruante të drejtat e miqve të All'lahut, sprapste të keqen prej tyre. Këto ishin mbi punët e tjera të mira që ai bënte. Gjithashtu, ndër punët e tij janë edhe transmetimet e tij për dispozitat e ligjit të fesë, si dhe shumë punë të tjera, për të cilat lapsi e ka të pamundur t'i shkruajë në bilancin e mirësive të tij e të cilësive të tij të lavdërueshme.*

*Aliu ka lindur në Kûfe në vitin 124. Babai i tij, Jaktijni ishte nga thirrësit kryesorë për shtetin e hashimive. Atë e kërkoi Mervàn El Himàri, por ai u largua për në Medine, u largua edhe gruaja e tij me dy djemtë e saj, Aliun e Ubejdin. Kanë qëndruar në Medine derisa u vendos shteti i abasive. Kur Jaktijni e mori veten, vazhdoi të jetë në shërbim të Seffâhut e të Mensûrit. Megjithëkëtë ai ishte ndër përkrahësit e pasardhësve të Aliut dhe pohonte imamatin. Të tillë ishin edhe djemtë e tij. Vetë Jaktijni dërgonte paratë e tij tek imam Sâdiku (Paqja qoftë mbi të!) derisa lajmi për këtë i shkoi Mensûrit e Mehdiut, por All'lahu e largoi ligësinë e tyre prej tij.*

*Ali ibn Jaktijni ka vdekur në qytetin e paqes, në Bagdad, në vitin 182. Namazin e Xhenazes së tij e ka falur nënmbreti Muhammed Emijni, djali i Reshijdit. Pas tij, në vitin 185, ka vdekur edhe babai i tij, Jaktijni. All'lahu i mëshiroftë të dy!*

#### *Am'mâr Ed'duhenij*

*Ebû Muâvijeh Ammâr ibn Khabbâb El Bexhelij Ed'Duhenij El Kûfij ka qenë nga paria e shokëve të imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të!) e nga të besueshmit e tij. Shtëpia e tij ishte prej shtëpive të njohura të shi'ave në Kûfe në kohën e tyre dhe thuhet se edhe babai i tij, gjithashtu, quhej Muâvijeh.*

*Imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) i është thënë:  
“Am’mâr Ed’dehenij ka dëshmuar sot tek Ibn Ebù Lejlâ<sup>1</sup>,*

*Kadiu i Kûfes dhe kadiu i ka thënë atij: “Çohu o  
Am’mâr, ne të njohim dhe nuk e pranojmë dëshminë tënde,  
sepse ti je nga rafiditë.”*

*Am’mâri është çuar më këmbë, i janë lëkundur këmbët dhe  
e ka mbytur të qarët.*

*Ibn Ebù Lejlâ i ka thënë atij: “Ti je nga burrat që ke  
dituri. Nëse të vjen keq, kur të thuhet se je rafidi, atëherë  
shfajësoje veten nga refuzimi dhe je prej vëllezërve tanë.”  
Am’mâri i tha atij: “Betohem në All’llah se nuk kam shkuar  
atje ku shkove ti, por unë qava për ty e për vete, qava për  
vete, se më vure në një gradë të nderuar, që unë nuk jam  
për të. Ti thua se unë jam rafidij. I mjeri ti! Mua më ka  
llafosur imam Sàdikun se të parët, që janë quajtur me këtë  
emër janë magjistarët, të cilët dëshmuar se magjistar ishte  
Mûsâi, por pastaj ata i besuan atij, e ndoqën atë,  
kundërshtuan urdhrin e Far’aonit dhe patjetër që i pritën  
me qetësi të gjitha sa ranë mbi ata. Far’aoni i quajti ata  
rafidij, për shkak se ata refuzuan fenë e tij dhe rafidij është  
ai që nuk pranon gjithçka që nuk e do All’llahu dhe bën  
gjithçka që e ka urdhëruar All’llahu. Pastaj unë qava për  
vete, nga frika se mos zemra ime mbyllet dhe ky emër i  
nderuar përmbysset në shpirtin tim, pastaj Zoti im më*

---

<sup>1</sup> Ai është Muhammed ibn Abdu Rrahmàn ibn Ebù Lejlâ El Ensàrij El Kûfij; Muhammedi e ka mbajtur detyrën e kadiut (gjykatësit) në Kûfe tridhjetë e tre vjet, në fillim nën emevitët dhe pastaj nën abasitët. Ka lindur në vitin 74 të hixhrit dhe ka vdekur në Kûfe në vitin 148 të hixhrit, duke qenë në sallën e gjyqit. Shejh Tusij e ka numëruar atë prej shokëve të imam Sàdikut por në dukje ai është prej atyre që e kanë luftuar imam Sàdikun në punët e tij.



*qorton e më thotë: “O Am’mâr ishe kundërshtarë (rafidi) për të gabuarat apo punove me bindje ashtu si të ishte thënë?”*

*Kjo do të ishte minimizim për mua në gradat që do të më lejoheshin.*

*Kurse e qara ime për ty ishte për shkak të rrenës së madhe që the, kur më emërtove mua jo me emrin tim; gjithashtu, qava nga dashuria e madhe që kam për ty, prej dënimit të All’llahut të Lartësuar, kur ti e largove prej meje emrin më të nderuar dhe e bërë atë emrin më të poshtër. Si mund të duroja mundimin që do të më shkaktonte fjala jote?”*

*Atëherë imam Sàdiku tha: “Sikur mëkatet e Am’màrit të ishin më të mëdha se qiejt dhe toka, ato do të fshiheshin prej tij në sajë të këtyre fjalëve dhe se këto fjalë do të shtohen në punët e tij të mira tek Zoti i tij...”*

*Siç e sheh, kjo zbulon besimin e tij të fortë, sa edhe furtunat nuk e anojnë atë. Ai ka shkruar një libër, në të cilin kanë transmetuar një grup nga të besueshmit.*

*Ai ka transmetuar prej një grupi të dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sun’netit, ashtu siç kanë transmetuar prej tij një grup prej tyre dhe më pas, e kanë ngritur zërin për atë, edhe pse e dinin se ai ishte ndër përkrahësit e pasardhësve të djemve të Aliut. Atë e ka përmendur Ibn Nedijmi, në përmbajtjen e lëndës dhe e ka numëruar ndër dijetarë e ligjit të fesë prej shi’ave; kurse në fjalor, në fjalën “dehen”, është përmendur fisi benij “dehen”, që prej tyre është edhe Muàvijeh ibn Am’màri.*

Në libin "Et'tàxh" ai ka thënë: "Babai i tij, Am'màri, thirrej me epitetin Ebù Muàvijeh.", kurse prej Muxhàhidit, Ebul Fadlit, Ud'des, Shu'bes dhe dy Sufjanëve, është transmetuar se ai ishte prej të besueshmëve të shi'ave. Ka vdekur në vitin 133.

#### *Am'màr Es'sàbàtij*

Ebù Jakdhàn Am'màr ibn Mùsà Es'sàbàtij është nga Kufeja dhe ka banuar nëpër qytete. Ka transmetuar prej Ebù Abdil'lahit e prej Ebù Hasanit (Paqja qoftë mbi të dy!). Është thënë se është nga fetahitë, por, edhe nëse kjo është e vërtetë, nuk prish ndonjë punë për besueshmërinë e tij në transmetim, sidomos pasi për atë është transmetuar nga imam Qàzimi: "I kërkova dhuratë Zotit tim Am'màrin dhe ai ma dhuroi mua atë."

Këtë e ka përmendur "El Keshà" në tre vende: në faqen 164, 256 dhe 313. Ai e ka numëruar atë ndër krerët e dijetarëve, prej të cilëve merret dituri në lidhje me hallallin e haramin. Shokët kanë punuar me hadithet e tij dhe prej tij ka shumë transmetime, prandaj kushdo, që shfleton librat e hadithit, do të marrë vesh se sa shumë hadithe janë transmetuar prej tij. Në përmbajtjen e lëndës, shejhu ka thënë: "Për atë ka një libër shumë të madh e të mbështetur."

Ai ka edhe dy vëllezër, të cilët janë: Kajsi e Sabahu dhe që të dy kanë transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!) dhe janë nga të besueshmit.

#### *Amër ibn Ebù El Mikdàm*

*Amër ibn Ebù El-Mikdàm Thàbit ibn Hermuz El Axhelij El Kùfij ka transmetuar prej imam Sexh'xhàdit, prej imam Bàkirit dhe prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi ta!). Numërohet ndër të brezit të dytë të myslimanëve (tàbi'inët) dhe në faqen 136 të pjesës së parë, të tekstit arabisht, është përmendur fjala e tij: "Mua më ka thënë Ebù Abdil'lahi që herën e parë që kam hyrë tek ai: "Mësoni të vërtetën para bisedës."*

*Ai thotë: "Kur shikova te Xha'fer ibn Muhammedin mësova se është nga pasardhësit e profetëve."*

*Të dy grupet kanë transmetuar këtë fjalë prej tij. Gjithashtu, ai gëzon një pozitë të respektuar tek të dy grupet. Prej imam Sàdikut ka ardhur një fjalë, që na tregon mirësinë e tij dhe pozitën e lartë që ai kishte tek All'illahu i Lartësuar. Kjo fjalë është thënë kur Sàdiku ishte duke ndenjur në oborrin e Qabesë e dikush tha: "Sa shumë haxhinj!"*

*Imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi tël) tha: "Sa pak haxhinj!"*

*Ndërkaq kaloi Amër ibn Ebù El Mikdâmi dhe ai tha: "Ky është nga haxhinjtë!" (referohu në "El Keshi", faqe 248.)*

*Për atë është shkruar një libër, në të cilin kanë transmetuar të besueshmit. Nexh'xhàshiju ka thënë: "Për atë ka një libër të bukur." dhe pastaj ka përmendur argumentin për saktësinë e përcjellësve të transmetimeve.*

*Ibn Ebù Nasr Es'sekùnij*

*Amër ibn Ebù Nasr El Enmàtij Es'sekùnij Esh'sher'ij është nga të besueshmit, për të cilët nuk ka asnjë mangësi. Për atë ka një libër, në të cilin kanë transmetuar prej tij një grup të besuarish. Disa prej tyre janë nga dijetarët e Ehli Sun'netit. Ai është numëruar ndër shokët e imam Sàdikut*

#### *Amër ibn Udhijneh*

*Amër ibn Udhijneh ka transmetuar prej imam Sàdikut me të shkruar dhe ka transmetuar prej imam Qàzimit me të dëgjuar. Ka qenë shejhu i shokëve tanë të Basras dhe kreu i dijetarëve të tyre, ashtu siç thotë Nexh'xhàshiju. Është larguar nga frika e Mehdiut dhe ka vdekur në Jemen, prandaj nuk ka transmetuar shumë prej imam Qàzimit.*

*El Keshi, në faqen 215, thotë: "Thuhet se emri i tij ishte Muhammed ibn Amër ibn Udhejne, por më shumë është thirrur me emrin e babait të tij."*

*Megjithëse El Kesha ka përmendur se është nga Kùfeja, ai vetë e ka mohuar këtë fakt, ashtu siç e përmend Nexh'xhàshij'ji. Mbase, për nga origjina ai mund të jetë nga Kùfeja, por ka banuar në Basra. Ka shkruar një libër mbi pjesëtimin e pasurive, në të cilin kanë transmetuar prej tij një grup nga të besueshmit.*

#### *Amër ibn Handhaleh*

*Ebù Sakhr Amër ibn Handhaleh El-Axhelij El-Bekrij El-Kùfij ka transmetuar prej imam Bàkirit e prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të dy!). Ai ka një pozitë të lartë tek Ehli Bejti, çka tregon për besimin e tij në shkallë të lartë dhe për besueshmërinë e tij. Për të imam Sàdiku ka thënë: "Ky nuk gënjen për ne."*

*Këtë fjalë imam Sàdiku ia ka thënë Zejd ibn Halijfes<sup>1</sup> se Amër ibn Handhaleh, para disa kohe erdhi tek ne. Kështu thuhet në degët e “El Kâfij”, kapitulli: “Koha e namazit”. Gjithashtu, imam Sàdiku i ka thënë atij: “O Ebù Sakhr, betohem në All’llah se ju jeni në fenë time e në fenë e prindërve të mi, prandaj ne do të ndërmjetësojmë! Betohem në All’llah, betohem në All’llah, betohem në All’llah, atëherë kur armiku ynë do të thotë: “Tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues (tek All’llahu) as ndonjë mik të ngushtë!” (Sure “Esh Shuarë”, ajeti 100-101)” Kanë ardhur edhe thënie të tjera, përveç kësaj në lidhje me atë dhe ashtu siç e pe dhe siç po e lexon, ai është i vërtetë tek i vërteti Sàdiku – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të! – është në fenë e tij e në fenë e prindërve të tij dhe ata do të jenë ndërmjetësues për atë e për të ngjashmit me të. A ka pozitë më lartë se kjo?!*

*Prej dy Sàdikëve (dy të vërtetëve) (Paqja qoftë mbi të dy!) janë transmetuar shumë hadithe për të dhe prej tij kanë transmetuar krerët e të besueshmëve dhe disa nga dijetarët e Ehli sun’netit.*

*Amër ibn Ali ibn Hysejsn (Paqja qoftë mbi të dy!)*

*Amër ibn Ali ibn Hysjen ibn Ali ibn Ebù Tàlib (Paqja qoftë mbi ta!) ka vdekur në vitin 65 të hixhrit, por thuhet edhe në vitin 70 të hixhrit. Shejhu Mufijid, në librin e tij “El Irshàd”, thotë: “Ishte njeri me virtyte të larta, ishte i ngarkuar me sadakatë e Profetit (Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij) si edhe me sadakatë e*

---

<sup>1</sup> El-Hârithij numërohet ndër shokët e Sàdikut e të Qàzimit – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të dy! – është atashuar në vakufin dhe për të, prej Sàdikut – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të!-, janë transmetuar shumë fjalë lavdërimi.

*Prijësit të Besimtarëve, imam Aliut. Ka qenë shumë i ruajtur dhe bujar.*

*Prej Bâkirit – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të! – transmetohet: “Amri është syri im me të cilin unë shoh. Është gjyshi nga nëna i dy të nderuarve, Myrtezasë dhe Rizàsë.”*

*Kjo është thënë nga flamurtari i udhëzimit në rrugën e drejtë në shpjeguesin e librit “Mesàilu Nàsirij’jeh”, në përshkrimin e gjyshërve të tij, nga ana e nënës: “Amër ibn Ali ibn Husejnit (Paqja qoftë mbi të dy!) e ka thirrur me epitetin “El Eshref”, “Më i nderuari.” Me të vërtetë, ai ishte krenaria e fisnikërisë, shumë i vlerësuar dhe ka pasur pozitë në të dy shtetet, në atë të emevie dhe të abasive. Ka qenë njeri i ditur dhe prej tij kanë transmetuar hadithe. Ka edhe shumë thënie të tjera lavdëruese në adresë të tij.*

*El Fadijl ibn Jesàr*

*El Fadijl ibn Jesàr En’nehdiq Arebij Basrij ka transmetuar prej imam Bâkirit e prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka vdekur në kohën e imam Sàdikut. Është prej atyre, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët për ta vënë në shkallën “Sahijh”. Ata kanë pohuar që me hadithin e tij të punohet në fushën e fikh’ut. Është nga gjashtë shokët e Ebù Xha’ferit. Kur Ebù Abdil’lahi, e shikonte atë të vinte, thoshte: “Përgëzoi kryeulëtit. Fadijli ishte prej shokëve të babait tim dhe unë e dua atë person që do shokët e babait tim.”*

*Hadithet, që flasin për virtytet e tij, janë të shumta, madje vetë imam Sàdiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “All’llahu e mëshiroftë Fadijl ibn Jesàrin dhe ai është prej nesh, prej Ehli Bejtit.”*

*Këtë fjalë ai e ka thënë kur e njoftuan se dora e tij do të mbetej në pjesën e trupit që nuk duhet zbuluar kur do ta lajë. Disa hadithe tregojnë se ai ishte depozita e sekreteve të tij. Pas kësaj, a ka nderim, madhështi e besueshmëri tjetër? All'illahu qoftë i kënaqur prej tij!*

### *Ebù Besijr*

*Lejth ibn El Bakhterij Ebù Besijr El Muradij El Kùfij ka transmetuar prej imam Bâkirit e prej imam Sâdikut (Paqja qoftë mbi të dy!). Pozita e tij është më e lartë nga sa mund të madhërohet. Tek të dy Sâdikët (Paqja qoftë mbi të dy!) ka qenë ndër të përparuarit; imam Sâdiku për atë ka shumë fjalë, që zbulojnë për një vend që nuk arrihet e për një gradë, në të cilën shkojnë vetëm pak vetë. Disa nga këto fjalë janë përmendur më sipër për Burejd El Axhelijin, siç ishte fjala e tij: “Kolonat e tokës dhe kolosët e fesë janë katër.” Ndër ta ka numëruar Lejthin, për të cilin po flasim; si dhe fjala e tij: “Shokët e babait tim ishin zbukurim.” dhe ndër ta përsëri ka numëruar Lejthin; apo fjala e tij: “Përgëzoi të nënshtruarit me Xhennet.”, dhe përsëri atë e ka numëruar ndër ata. Vetë Lejthi ka parë keramete prej imam Sâdikut. Ndër këto keramete është kur ai i fshiu të dy sytë dhe e bëri të shihte siç kishte parë më përpara. Gjithashtu, edhe njoftimi, që i bëri atij që kishte ardhur tek ai xhynyb. (Në fakt ai kishte hyrë tek ai xhynyb që ta provonte.)*

*Fjala me qartë është se ky burrë ishte prej dijetarëve të mëdhenj të hadithit, nga krerët e juristëve në fushën e ligjit të fesë. Ai, që shikon librat e hadithit, do të mësojë se sa shumë hadithe ka ai. Gjithashtu, ai është nga gjashtë shokët e imam Bâkirit (Paqja qoftë mbi të!). Edhe grupi ka një mendim të përbashkët për ta vënë në shkallën “Sahijh”.*

### *Mu'min Et'tàk*

*Muhammed ibn Ali ibn En'nu'màn Ebù Xha'fer El Ahvel Es'sajrefij, i quajtur, tek të veçantët, me mbiemrin Mu'min Et'tàk tek të veçantët dhe Shejtànu-t'tak tek masa. Ai, që i njuh qëndrimet dhe diskutimet e tij me krerët e dijetarëve të tyre, në lidhje me imamatin, bëhet e qartë përse e kanë quajtur me këtë mbiemër dhe përse e urrejnë atë, por e vërteta rëndon shumë në shpirt.*

*Ai ka transmetuar prej dy Sàdikëve, (Paqja qoftë mbi të dy!). Prej imamit dhe edukuesit të tij, Sàdikut. Për të kanë ardhur qortime dhe lavdërime. Ndër fjalët e tij përmendim: "Zuràreh ibn A'jun, Muhammed ibn Muslim, Burejd ibn Muàvijeh El Axhelij dhe Ahveli janë njerëzit më të dashur për mua, gjallë e vdekur."*

*Ka edhe fjalë të tjera veç kësaj.*

*Hadithi i tij është mjaft i përhapur në librat e hadithit. Ai, që shikon në diskutimet e tij, mëson se ka qenë i fuqishëm në argumente, i fortë në kundërshtim, i shpejtë në përgjigje, me kujtesë të shpejtë e me zemër të zgjuar. Ai ka qenë në pararojë të teologëve të imamive, për faktin se ai ka gjurmë të larta në fushën e fikh'ut.*

*Puna e tij është më e lartë, se sa të përfshihet në fjalët lavdëruese dhe më e ditur se sa të thuhet shumë fjalë për përkufizimin e tij.*

### *Muhammed ibn Muslim*

*Muhammed ibn Muslim Eth'thekafij El Kùfij El Kasijr ka transmetuar prej dy Sàdikëve (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka arritur kohën e imam Qàzimit. Ishte nga ata të shquar, të cilët koha i shfaq vetëm papritmas; ka qenë shembulli më i lartë në mirësi, në bindjen ndaj imamëve, në përvetësimin*



*e urdhrave të tyre e për të vepruar sipas shembullit të tyre; me njerëzit ishte besnik. Virtyti e mirësia e tij janë të njohura, madje edhe tek ata që i kundërshtojnë veprimet e tij. Ata e kanë akuzuar për refuzim (râfidij), të cilin ai dhe ata, që ndiqnin rrugën e tij, e konsideronin cilësi të bukur dhe krenari të lartë. Ka të ngjarë që ata të jenë kthyer tek ai për çështjet e dyshimta që shikonin në punën e tij, prandaj e injoruan gjykimin për të.*

*Sikur të mos kishin frikë se do të zgjateshim, do të sillnim shembujt të tjerë të ngjashëm.*

*Është quajtur juristi i shekullit të tij në fushën e ligjit të fesë, duke ditur se ai është shekulli më i mirë në fushën e fikh'ut e të dijetarëve të kësaj fushe, aq sa Abdurrahman ibn El Haxhàxh e Ham'màd ibn Osmàn dhe, ti tani e di se cilët janë këta të dy, kanë thënë për atë: "Nuk ka qenë ndonjë prej shi'ave më i ditur në fushën e ligjit të fesë se Muhammed ibn Muslimi."*

*Është fakt, se dijetarët e fikh'ut të shekullit të tij, janë ata që e ruajtën ligjin e fesë të të Përzgjedhurit, Ahmedit (Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ashtu siç e ka thënë këtë imami i tyre Sàdiku.*

*Si të mos ishte dijetari i vetëm në fushën e ligjit të fesë, ai që ka dëgjuar prej Ebù Xha'ferit tridhjetë mijë hadithe dhe prej Ebù Abdil-lahit gjashtëmbëdhjetë mijë hadithe. Kushdo, që hedh një shikim në librat e haditheve, do të mësojë se sa shumë e sa të bollshme janë transmetimet e tij.*

*Përsa i përket lavdërimeve të tij prej imamëve, ato janë të shumta dhe disa prej tyre janë thënë më sipër, kur është folur për Burejd El Axhelijin. Nëse do të dëshironim të njiheshim më shumë nga ato që kanë ardhur për të, do të dilnim nga qëllimi ynë. Gjithsesi, ai është nga gjashtë shokët e Ebù Xha'ferit, për të cilët grupi ka një mendim të*

*përbashkët për të vënë në shkallën "Sahijh" atë që është e saktë prej tyre, si dhe pohimin e tyre për të punuar me to në fushën e fikh'ut.*

*Ai ka vdekur në vitin 150, kur ishte afërsisht shtatëdhjetë vjeç. Kënaqësia e All'llahut qoftë mbi të!*

### *Muràzimi*

*Muràzim ibn Hakijm El Ezedij El Medàij ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!) dhe është vrarë në kohën e Rizàsë – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të!. Muràzimi dhe Sàdiku ishin së bashku me Musàdefin, shërbyesin e Sàdikut, kur e ka thirrur Mensùri në Hijreh. Kur ai i lejoi të ktheheshin, ata u nisën për rrugë në fillim të natës, por i prenë rrugën. Prandaj ai hyri mes atij që preu rrugën dhe udhërrëfyesit. Ndërkaq Musàdifi i kërkoi leje, që bashkë me Muràzimin, të shkonin në ndihmë të udhërrëfyesit e ta vrisnin atë që u preu rrugën. Por imami nuk pranoi. Vetë imami vazhdoi të bisedojë me prerësin e rrugës, derisa ai mbeti i kënaqur. Kjo ndodhi na tregon se Muràzimi ishte nga të veçantët e imamit, gjithashtu na tregon se sa shumë e donte ai imamin, sa i përkushtuar ishte për imamatit e tij dhe sa i përkushtuar ishte në zbatimin e urdhrave të tij.*

*Nexh'xhàshij'ju e të tjerë kanë thënë: "Ai është prej atyre, që i thërriti Reshijdi, atë dhe vëllain e tij<sup>1</sup> dhe që të dy u paraqitën tek Reshijdi, së bashku me Abdul Hamijd ibn Gav'vàsìn.<sup>2</sup> Reshijdi vrau atë dhe Selimin. (All'llahu e*

---

<sup>1</sup> Muràzimi kishte dy vëllezër dhe ata ishin Muahm'medi e Xherijri. Thuhet se Xherijr është blloku i librit të Kur'anit, por në të vërtetë është hekur. Sido që të jetë, që të dy janë të besueshëm dhe nga krerët e teologëve. Imam Qàzimi e pranonte fjalën e Muhammedit dhe e urdhëronte atë të diskutonte, por unë nuk e di se për cilin nga të dy vëllezërit është fjala këtu.

<sup>2</sup> Gav'vàsi është nga shokët e imam Qàzimit. Thuhet edhe se është nga shokët e dy Sàdikëve. Gjithashtu, edhe ky është nga transmetuesit e besueshëm.

*mëshiroftë dhe e bashkoftë me shokët më të nderuar, imamët e pastër!)*

### *Musmië Kerdijn*

*Musmië Kerdijn Ebù Sej'jàr Abdul Melik është arab i pastër prej fisit Bekër ibn Vàil. Musmië është emri i tij dhe Kerdijn është mbiemri. En'nexh'xhàshij'ji, në faqen 298, ka thënë: "Ishte dijetari i fisit Bekër ibn Vàil në Basra, kreu i fisit dhe zotëria i gjuhëtarëve." Ka transmetuar pak prej Ebù Xha'ferit dhe ka transmetuar më shumë prej Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!). Ebù Abdil'lahi ka thënë për të: "O Ebù Sej'jàr, unë po të përgatis ty për një punë të madhe."*

*Gjithashtu, ka transmetuar prej Ebù Hasanit, Mùsàit (Paqja qoftë mbi të!). Për atë ka shumë thënie të rralla.*

### *Muàvijeh ibn Am'màr*

*Muàvijeh ibn Am'màr ibn Khab'bàb El Bexhelij Ed'duhenij El Kùfij; më sipër është përmendur emri i babait të tij Am'màrit. Muàvijeh ka qenë nga krerët e shokëve tanë dhe për nga trimëria qëndronte më lart se pozita e besueshmëria. Në librin "El Vesàil", pjesa: "Kurorëzimi", kapitulli: "Shikimi i skllavit në pronarin e tij", është fjala e imam Sàdikut kur i është drejtuar atij me fjalën "Biri im!". Kjo fjalë tregon për dashamirësinë e dashurinë e tij dhe për kujdesin që ai tregonte për të. A ka pozitë e madhërim më të lartë për të se kjo?*

*Më sipër është përmendur fjala e autorit të fjalorit për fjalën "Duhën", si dhe fjala e autorit të librit "Et'tàxh" për babain e tij, Am'màrin. Këto fjalë tregojnë se Muàvijeh*

*dhe babai i tij ishin dijetarë dhe të njohur për përkatësinë e tyre ndër përkrahësit e pasardhësve të Aliut.*

#### *Maëruf ibn Kharbùdh*

*Maëruf ibn Kharbùdh El Mek'kij ka transmetuar prej imam Sexh'xhàdit, prej imam Bàkirit dhe prej imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi ta!). Është nga gjashtë shokët e Ebù Xha'ferit, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët për ta vënë në shkallën "Sahijh"; gjithashtu kanë pohuar edhe diturinë në fushën e fikh'ut. Në lidhje me atë kanë ardhur hadithe, që tregojnë madhështinë dhe pozitën e tij të lartë. Madje ai është nga ata që kanë mbajtur sekrete, kryente adhurime të shumta dhe sexhden e bënte shumë të gjatë.*

#### *Mual'là ibn Khanijs*

*Mual'là ibn Khanijs është muvalij i Ebù Abdil-lahit (Paqja qoftë mbi të!). Kushdo, që ndjek hadithet e tij, mëson se ai ishte prej juristëve të fesë dhe i njohjes në gradën e imamit; gjithashtu ishte nga krerët e shokëve. Por ajo, që na tregon pozitën e tij të lartë, është pikëllimi i imamit për vrasjen e tij, si dhe dalja e tij i zemëruar, duke tërhequr zvarrë rrobën e tij të sipërme, ndërsa djali i tij, Ismàijli, i shkonte nga prapa, ndërkaq ai thoshte: "Njeriu duron vajtimet e vdekjes dhe nuk duron luftën."*

*Ai vazhdoi të ankohet derisa hyri tek vrasësi i Mual'làsë Dàùd ibn Ali El Abbàsij, valiu i Mensùrit dhe i tha tij: "O Dàùd, vrave skllavin tim dhe more pasurinë time!"*

*Ai nuk u qetësua derisa u zbatua ligji për atë që e vrau Mual'lànë dhe vrasësi ishte Es'sejràfij'ji, shefi i policisë*

*së Dàùdit. Kur atë e çuan në vendin e ekzekutimit, ai filloi të thërrasë me të madhe: “Më urdhërojnë të vras njerëzit për ata dhe pastaj ata më vrasin mua!”*

*Kur u vra Mual’là, imam Sàdiku tha: “Betohem në All’llah, ai hyri në Xhennet. Ah, kjo botë, në këtë botë All’llahu ka vënë armikun e Tij të sundojë mikun e Tij.” Ka dhe shumë fjalë të tjera, të cilat dëshmojnë për pozitën e lartë që gëzonte Mual’là, të cilin Dàùdi e vrau vetëm pse ishte nga kolonat e Ebù Abdil’lahit. Madje ai i kishte dërguar njerëz, që ai të tregonte përkrahësit e shokët e imam Sàdikut. Mual’là e hodhi poshtë me neveri fjalën e tij, megjithëse e kërcënoi se do ta vriste, në qoftë se nuk do t’i tregonte. Mual’là këmbënguli në fshehtësinë e emrave të tyre. Kjo tregon se ai për punë feje është vënë në pozitë shumë të vështirë, ashtu siç tregon fisnikërinë e shpirtit të tij, të cilën e sakrifikoi për ata burra të përzgjedhur. All’llahu qoftë i kënaqur me atë e me ata!*

*Më sipër, në pjesën e parë, në faqen 122 dhe në faqen 256, të tekstit arabisht, është përmendur çështja e Mual’làsë.*

#### *Mufad’al ibn Umer*

*Ebù Abdil’lah Mufad’dàl ibn Umer El Xheafij El Kùfij ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Te ai ishin mbledhur mirësi e cilësi të larta që në pak prej juristëve të fesë, transmetuesve dhe krerëve të të besueshmëve mund të mblidhen. Te Mufad’alin ishin bashkë dituria e mirësia, dobia e ruajtja. Ai ka qenë i ngarkuar prej dy imamëve për të mbledhur të drejtat pasurore dhe me to të bënte mirësi. Me urdhrin e tyre shkonte nëpër shtëpitë e të varfërve, duke u dhënë një pjesë të pasurisë së marrë. Ai kishte edhe cilësi të tjera, por është e mjaftueshme të përmendim këtë detyrë që i ishte besuar, e cila kërkon, që personi, që do të kryejë*

*këtë punë, të ketë zemër të gjerë, vullnet të lartë dhe vendosmëri për të plotësuar nevojat e vëllezërve të tij, si dhe një besim të plotë. Punët e tij dëshmojnë se ai ka gëzuar mbështetje të mjaftueshme dhe Sàdiku e kishte bërë të ngarkuarin e tij personal me punë, pas vdekjes së Abdullah ibn Ebù Ja'fùrit, ashtu siç është thënë më sipër për Abdullahun. Si e mendon përgatitjen e atij që do të ishte zëvendës për një të tillë paraardhës? Ai vazhdoi të mbajë barrën e këtyre punëve, edhe pse ata kishin burra të shumtë në Kùfe. Ai e mbajti këtë detyrë derisa u nda nga kjo jetë.*

*Është e mjaftueshme të thuhet për pozitën e tij të lartë, për të cilën Ebù Abdil'lahi ka thënë: "Betohem në All'illah, që nuk ka Zot tjetër përveç Tij, sa rob i mirë është Mufeddal ibn Umer El Xheafij!."*

*Këtë fjalë ai e ka përsëritur më shumë se tridhjetë herë. Ebù Hasani pas vdekjes së Mufeddalin tha: "Mufeddali ishte gëzimi im dhe qetësimi im. All'illahu e mëshiroftë Mufaddalin! Ai tani është qetësuar.", si dhe shumë fjalë të tjera, që shpjegojnë pozitën e tij. Me një fjalë, burri është në pozitë të lartë kur përmendet për besueshmëri, për vend të nderuar dhe kur peshohet me lavdërime.*

*Ai ka disa libra, që i kanë transmetuar disa prej të besueshmëve. Atij i njihet tregimit i "Teuhijdit" dhe i "Ihlilxhes" prej imam Sàdikut ashtu siç është treguar në pjesën e parë, faqe 149 dhe 164, të tekstit arabisht.*

*Mujes'sir ibn Abdul Azijz*

*Mujes'sir ibn Abdul Azijz En'nekhaj El Kùfij El Medàij ka transmetuar prej dy Sàdikëve (Paqja goftë mbi të*

dy!). Prej tij kanë transmetuar krerët e të besueshmëve dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga të Ehli Sun'netit.

*Ibn Shehràshùbi, në librin e tij "El Menàkib", e ka numëruar atë ndër të veçantët e imam Sàdikut. Thuhet se ka vdekur në kohën e Sàdikut, në vitin 136 të hixhrit.*

*Lavdërimet për të janë të shumta, siç është fjala e Ebù Xha'ferit (Paqja qoftë mbi të!): "O Mujes'sir, në të vërtetë të ka ardhur ora e fundit e jetës disa herë dhe çdo herë All'lahu e ka shtyrë për shkak të lidhjeve që ti mban me të afërmit e tu."*

*Në këtë kuptim kanë ardhur shumë hadithe, siç është fjala që ai i ka thënë atij: "Unë dua erën tuaj dhe shpirtrat tuaj, ju jeni në fenë e All'lahut e në fenë e engjëjve të Tij." Ka edhe shumë hadithe të tjera, që dëshmojnë për keramete e për madhësi.*

#### *Hishàm ibn El Hakem*

*Ebù Muhammed Hishàm ibn El Hakem ka qenë skllav i fisit Kendeh. Është thirrur me epitetin Ebùl-Hakem dhe ka transmetuar prej Ebù Abdil'lahit e prej Ebù Hasanit (Paqja qoftë mbi të dy!). Për të ka shumë libra, që i kanë përmendur burrat në parathëniet e shkruara për të.*

*Ishte i pari në Teologji. Ai shkëlqente dhe nuk kishte asnjë shkarje. Diskutimet e tij në fusha të ndryshme tregojnë për ty fuqinë e argumentit dhe me atë kanë diskutuar shumë dijetarët. Imam Sàdiku i ndalonte shokët e tij, që të diskutonin e të polemizonin, përveçse me ndonjë që ishte i dalë nga rruga e drejtë dhe Hishàmi ishte në pararojë të atyre që ai i lejonte. Gjithashtu, imam Sàdiku e*

*respektonte shumë atë, madje edhe e nxirrte përpara atyre shokëve të tij, të cilët gëzonin autoritet e pozitë të lartë, edhe pse ai ishte i ri. Vetë ai thoshte për të: “Ky është ndihmësi ynë me zemrën, me gjuhën e me dorën e tij. Hishàm ibn El Hakemi është lartësuesi i të drejtës sonë, përçuesi i fjalës sonë, përkrahës i së vërtetës sonë dhe thyerësi i të gabuarës së armiqve tanë. Kush ndjek atë dhe punën e tij, na ka ndjekur ne, kush e kundërshton atë dhe i mënjanohet atij, është armiqësuar dhe është larguar nga ne.”*

*Ka edhe shumë thënie të tjera të kësaj kategorie.*

*Edhe imamë të tjerë të Ehli Bejtit, përveç Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!) e kanë lavdëruar atë, si p.sh. imam Rizài ka thënë: “Ishte njeri i mirë.”; gjithashtu edhe imam Xhev’vâdi e ka lavdëruar me fjalën e tij: “All’llahu e mëshiroftë! Ai nuk ndalej nga kjo anë.”*

*Ka edhe shumë fjalë të tjera si këto që u thanë.*

*Fjalë të tilla prej imamëve të Ehli Bejtit për punën e gjendjen e tij nuk kanë nevojë për zgjuarsi e për dituri të madhe, për të zbukuruar e për të thurur të gjitha lavdërimet, pasi këto fjalë të shpejta bëjnë që ti të shohësh qëndrimin e burrit në mbrojtje të së vërtetës e në luftimin e së gabuarës dhe se fjala e tij në mbrojtje të imamatit është më goditëse se një mijë shpata. Reshijdi ka thënë se ky ishte një burrë i vetëm, që e ka të ndarë fjalën për imamat. Ai ka hequr nga medh’hebet gjërat e shtuara. Vdekja atë e rrëmbeu shumë shpejt, pikërisht në këto diskutime për imamat. Kjo ndodhi kur Reshijdi mësoi për pozitën e tij, atëherë ai pati frikë për veten e vet dhe u largua nga Kûfja i tmerruar dhe me këtë tmerr ai vdiq. Thuhet se ka vdekur në vitin 179 të hixhrit.*



*Për atë kanë ardhur edhe disa atakime, siç janë ato për mbrojtjen e Ehli Bejtit, të asaj mbrojtjeje, gjurmët e së cilës janë gjallë edhe sot. Si do të rrinin pa thurur mashtrime smirëzinjtë e armiqtë e tij? Si do të rrinin ata pa i vënë atij të meta dhe pa shembur atë që ai kishte ndërtuar? Atë e ka atakuar edhe vetë imami, me qëllim që të sprapste të keqen prej tij.*

#### *Hishàm ibn Sàlim*

*Hishàm ibn Sàlim El Xhevàlijki El Xheafij El Al'làf ka transmetuar prej Ebù Abdil'lahit e prej Ebù Hasanit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ishte prej atyre që kanë shkëlqyer në teologji dhe prej atyre, që me rrezatimin e diturisë, kanë nxjerrë në shesh mashtrimet e armiqtë të tyre, duke u imponuar argumentet dhe duke bërë të qartë për njerëzit mënyrën e argumentimit. Gjithashtu, ai ishte prej atyre që është lejuar të diskutojë e të merret me teologji. Sikur të kishte frikë nga shkarjet e tij, detyrimisht do të kishte frikë se do të rrëzohej dhe në asnjë ditë nuk do të kishte lejuar që të futej në diskutime të atilla. Me diturinë e tij ai kishte fluturuar në lartësitë më të mëdha të atmosferës, në një kohë që pushteti ishte armik i Ehli Bejtit dhe ndihmësi i atyre që i kundërshtonin ata për imamat, madje edhe në të gjitha degët e dijes.*

*Ai nuk ishte i specializuar vetëm në fushën e teologjisë, pasi ishte edhe ndër juristët e shquar të fesë. Për të kanë ardhur lavdërime, që na tregojnë lartësinë e pozitës së tij dhe autoritetin e tij të lartë.*

*Edhe për atë kanë ardhur atakime, ashtu siç kanë ardhur edhe për dishepujt e tjerë të ndritur të Ehli Bejtit dhe për shokët e tyre të besueshëm. Përgjigjja për ato atakime është e përgjithshme dhe e kuptueshme; gjithashtu, ata përmendin për çdo atakim një përgjigje më vete. Por si mund të jetë i lejuar atakimi për të mëdhenj të tillë?*

*Feja e vërtetë dhe Ehli bejti ka qëndruar dhe ka dalë në dritë vetëm në sajë të argumenteve të tyre të prera, pasi ata ishin luftëtarë në rrugën e All'llahut.*

*Kundër ndriçimit të gjuhëve e të argumenteve të tyre ngrihen ushtritë, mbreti e terrori.*

### *Jùnus ibn Ja'kùb*

*Jùnus ibn Ja'kùb El Bexhelij Ed'duhenij El Kùfij ka transmetuar prej imam Sàdikut e prej imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!). Ka vdekur në Medine, në kohën e imam Rizàsë (Paqja qoftë mbi të!), i cili i dërgoi të gjitha sendet e duhura për përgatitjen e xhenazes, duke filluar me parfumet (hanut) e me qefinët, urdhëroi shërbëtorët e vet, shërbëtorët e babait të tij e të gjyshit të tij, që të merrnin pjesë në varrim, gjithashtu urdhëroi që ai të varrosej në Bekij'ë. A ka respekt më të madh se kaq?*

*Ishte nga krerët e dijetarëve në fushën e ligjit të fesë, prej të cilëve është marrë dituri për hallallin e haramin. Ka qenë i ngarkuari me punë i Ebù Hasanit Mùsà Qazimit dhe tek imamaët (Paqja qoftë mbi ta!) ka qenë i afërm e i dashur. Për të kanë ardhur disa hadithe, që tregojnë pozitën e nderuar që ai kishte tek ata, ashtu siç tregojnë edhe kujdesin e tyre të madh ndaj tij, siç është fjala e imam Qàzimit: "Ne për ty jemi ruajtës.", si dhe fjala e imam Sàdikut e Qàzimit "Në të vërtetë, ti je prej nesh, të Ehli Bejtit dhe All'llahu bëftë që të jesh me të Dërguarin e Tij dhe me Ehli Bejtin e tij. All'llahu e bën këtë. Qoftë dëshira e All'llahut!"*

*Ka edhe fjalë të tjera të ngjashme, që tregojnë pozitën e punën e tij të nderuar, përveç besueshmërisë në transmetim.*

*Me këtë e përfundojmë fjalën për transmetuesit e besueshëm më në zë të Ebù Abdil'lahit.*

*Të gjithë kanë marrë prej tij dituri të fesë dhe dituri të tjera. Nga këto ti mëson rëndësinë e transmetuesve dhe të transmetimeve prej tij, mëson shkallën e lartë të dijeve e të njohurive të transmetuara dhe të marra prej tij.*

\* \* \*

### **PËRKRAHËSIT E TIJ**

*Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) kishte shumë përkrahës, por në përkrahimin e Muattibit, që do të përmendet më poshtë, ai ka përmendur se ata ishin dhjetë. Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ndër ta ka një tradhtar, prandaj ruhuni prej tij dhe ai është i vogël.”*

*Nuk e ka saktësuar germën “a” ose “f” se kështu do të ishte emër. Po të kishte shqiptuar germën “g”, do të ishte cilësor, por ka mundësi që ai të jetë edhe emër. Sido që të jetë, ai, që gjendej ndër ta, i kishte kapërcyer të dhjetë vjetët. Ka të ngjarë që ata të kenë qenë dhjetë në një kohë të caktuar, prandaj ne do të vazhdojmë të përmendim vetëm ata që kemi mundur të zbulojmë prej tyre.*

#### **1 – Mual'là ibn Khanijs**

*Mual'là ibn Khanijs ka qenë nga skllëverit e Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!). Mual'là ibn Khanijs ka ndihmuar në rregullimin e punëve të Ebù Abdil'lahit – Paqja e shpëtimit qoftë mbi të!. Mual'là ibn Khanijs ishte i*

*besueshëm, sa Ebù Abdil'lahit i tregonte edhe sekretet e tij. Ishte nga transmetuesit e tij të besueshëm.*

## *2 – Muat'tib <sup>1</sup>*

*Ndër sklleverit e tij ishte edhe Muat'tibi, të cilin burrat e kanë numëruar ndër shokët e imam Sàdikut e të imam Qàzimit (Paqja qoftë mbi të dy!).*

*Prej imam Sàdikut është transmetuar se sklleverit e tij janë dhjetë dhe se më i miri e më i virtytshmi i tyre është Muat'tibi.*

*Ebù Abdil'lahi (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Sklleverit e mi janë dhjetë dhe më i miri i tyre është Muat'tibi. Muat'tibi beson se vetëm unë jam më i drejti i njerëzve.”*

*Për Muat'tibin kanë transmetuar krerët e të besueshmëve më në zë, siç janë Jùnus ibn Ja'kùbi, Mual'là ibn Khanijsi, Is'hàk ibn Am'màri e të tjerë. Nga kjo dhe nga fjalë të tjera të ngjashme ti mëson se ai ka qenë nga dijetarët e nga njerëzit më të afërt dhe më të besueshëm. Në librin “El Khulàsah”, El alàmeH e ka vënë atë në shkallën e më të besueshmëve.*

## *3 – Muslim*

*Gjithashtu, ndër ta është edhe Muslimi. Prej Ebù Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) është transmetuar se Muslimi është sindij, por edhe Xha'fer Sàdiku ka thënë: “Shpresoj që ti të jesh i përputhur me emrin.” Një hadith i ngjashëm është transmetuar edhe prej imam Rizàit. Disa hadithe*

---

<sup>1</sup> Emri Muat'tib është thënë të lexohet në këtë formë në librin “El-Khulàsah” të dijetarit të madh El Hilij.

*tregojnë se ai ishte skllav i imamit, madje ishte prej atyre që kanë mbajtur sekretet e tij.*

#### *4 – Musàdef*

*Edhe Musàdefi është ndër skllavërit e tij, të cilin, krerët e burrave, e kanë numëruar ndër shokët e imam Sàdikut e të imam Qàzimit. Prej tij kanë transmetuar dijetarët e mëdhenj të besueshëm, si: Hasan ibn Mahbùbi, Ali ibn Riàbi e të tjerë. Ky është një tregues i besueshmërisë dhe i diturisë së tij, që ai kishte për hadithin, si dhe për pozitën e imamatit.*

*Imam Sàdiku e dërgoi në Egjipt për tregti. Mallrat vlerësoheshin një mijë dinarë. Ai u kthye me një fitim prej një mijë dinarësh, por imam Sàdiku i tha se ky ishte një fitim i madh, megjithëse Musàdifi e bëri me dije se mallrat, që ata kishin sjellë, në Egjipt nuk kushtonin gjë. Ata ishin betuar që këto mallra t'i shisnin vetëm me fitim një dinar për dinar. Imam Sàdiku nuk e pranoi as betimin e tyre e as atë fitim, të cilin e konsideroi haram, prandaj mori vetëm kapitalin bazë dhe e la fitimin, duke i thënë atij: “O Musàdef, fortësia e shpatave është më e lehtë se kërkimi i hallallit.” Këtë fakt ne e kemi përmendur në kapitullin “Dashmirësia e tij” në pjesën e parë, faqe 233, të tekstit arabisht.*

*Ky ishte së bashku me imamin e me Muràzimin, kur Mensùri thirri imamin në Hireh. Më pas Mensùri i lejoi të ktheheshin në Medine, por i vuri roje nga prapa, duke i prerë rrugën. Musàdifi e Muràzimi deshën ta vrisnin prerësin e rrugës, por imami nuk i lejoi. Imami vazhdoi të diskutojë me prerësin e rrugës, derisa mbeti i kënaqur dhe i hapi rrugë. Tashmë kishte kaluar pjesa me e madhe e*

*natës, atëherë imam Sàdiku tha: “O Muràzim, kështu është më mirë apo ajo që më thatë ju të dy?!”*

*Këtë ndodhi ne e kemi përmendur në kapitullin “Butësia e tij”, pjesa e parë, faqe 132, në tekstin arabisht, kurse Muràzimin e kemi përmendur në këtë pjesë.*

#### *5 – Se’id Er Rùmij*

*Ndër ata ka qenë edhe Seijd Er Rùmiju, të cilin shejhTusi e ka numëruar ndër burrat e tij e prej shokëve të imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Prej tij kanë transmetuar Ibn Meskàni, Ebàni dhe Ham’màdi, për të cilët grupi ka një mendim të përbashkët, për t’i vënë në shkallën “Sahijh” ato që janë të sakta prej tyre.*

*Më sipër u përshkrua puna e tyre. Grupi ka vlerësuar diturinë e tyre në fushën e ligjit të fesë. Ky është argument për besueshmërinë e tyre në transmetim.*

*Këta dijetarë e krerë të dijetarëve janë mbështetur në besueshmërinë e tyre dhe në diturinë që ata kishin për hadithin e për dispozitat e ligjit të fesë, si dhe për faktin se kanë marrë prej imamit.*

#### *6 – Sabàhu*

*Ndër ta është edhe Sabàhu, i cili ka qenë ndër shokët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Kjo tregon se ai ka transmetuar prej tij. Si argument për njohjen e imamit është e mjaftueshme mbarësia e lumturia e tij. Jo vetëm nga fjalët e Sabàhut, por edhe nga fjalët e shërbyesve të tjerë mëson se imam Sadiku i plotësonte shërbyesve të vet të gjitha nevojat.*

#### *7 – Tàhiri*

*Prej tyre është edhe Tàhiri. Vërtet imami nuk e ka përmendur në përshkrimin e tij, por është prej shokëve të imam Sàdikut. Ashtu siç e thamë edhe për Sabàhun, kjo zbulohet nga marrja që ai ka bërë prej zotërisë së vet, si dhe nga transmetimet që ka bërë prej tij, që në fakt është një lumturi, fatmirësi dhe një argument se ai kishte arritur gradën e njohjes (maërifet).*

*Tàhiri ka transmetuar qortimin e imam Sàdikut për djalin e tij, Abdullah El Eftahun. Ai e qorton atë për punët e tij, prej të cilave mami nuk mund të ishte dakord.*

#### *8 – Abbàs ibn Zejd*

*Ndër ta është edhe Abbàs ibn Zejd. Ishte nga Medineja. Është numëruar ndër shokët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Për të ka hadithe, por nuk është përmendur më shumë se kaq.*

*Fakti se ka qenë në shërbim të imamit është një fat shumë i madh. Shikimi në çdo kohë i fytyrës së tij është njohja që sjell më shumë lumturi, marrja dituri prej tij dhe pirja ujë prej gotës së tij është nga mirësitë e mëdha të qëndrueshme. Njeriu duhet t'i bëjë gjërat duke vështuar në thellësi të punëve, me qëllim e me vullnet dhe duke pasur kujdesin e duhur në këtë keramet të madh për të, si dhe gjithmonë duke falënderuar All'llahun që i ka mundësuar arritjen e kësaj mirësie rrezatuese.*

#### *9 – El-Fadijl*

*Ndër ta është edhe El Fadijl, i cili është numëruar ndër shokët e imam Sàdikut. Në të vërtetë, për të është folur kur ka rënë në rrugën e Sudùkut, në kapitullin "Porosi të rralla". Më shumë se kaq nuk është përmendur.*

### 10- El-Mugijreh

*Ndër ta është edhe El Mugijreh. Atë e kanë numëruar ndër shokët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Për atë ka një transmetim dhe kjo është e gjitha sa është thënë për të.*

### 11- Mùsài

*Ndër ta është edhe Mùsài, i cili është numëruar ndër shokët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!). Vetëm kaq është thënë për të. Por edhe kaq, ashtu siç e mësove, është një fat i lumtur, është një mbarësi e lartë, që arrihet vetëm me mbarësinë prej të Lartit.*

### 12- Nasër ibn Sàid

*Prej atyre është edhe Nasër ibn Sàid. Kanë përmendur se prej tij ka një transmetim prej Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!). Edhe Nasëri, si shokët e tij, për të cilët u fol më sipër, ishte prej atyre që u veçuan me keramete e me mbarësi.*

### 13 – Sàlimeh

*Ndër ta është edhe Sàlimeh, të cilën shejh Tusi, e ka numëruar ndër shokët e imam Sàdikut (Paqja qoftë mbi të!).*

*Vetëm kaq është treguar për të. Njoftohet se ajo ka qenë pranë Ebù Abdil'lahit kur atij i erdhi vdekja dhe ra në agoni. Në momentet kur erdhi në vete, ai tha: “Jepini Hasan El Eftasit shtatëdhjetë dinarë, filanit jepini kaq dhe filanit kaq.”*

*Por ajo i tha: “Si i jep atij që ka ngritur mbi ty shpatën dhe donte të të vriste?!”*



*Ebù Abdil'lahi i tha: "Ti dëshiron që unë të mos jem prej atyre, për të cilët All'llahu i Lartësuar ka thënë: "Dhe ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të mbahen, që kanë frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarisë së rëndë." (Sure "Er Rra'd", ajeti 21)"*

*Ky tregim është thënë më sipër, në kapitullin "Dhurimet e tij të fshehta", pjesa e parë faqe 229, të tekstit arabisht, si dhe në gjendjen e tij në çastin e vdekjes në këtë pjesë në faqen 104, të tekstit arabisht.*

*Prej këtij tregimi mësohet se Sàlimeh ka qenë e afërt tek imami për fjalën e saj dhe ai i përgjigjej asaj pa asnjë ndalim, madje i përgjigjej, duke e mësuar dhe duke e këshilluar.*

*Me përshkrimin e Sàlimehit mbyllim përshkrimin e sklevërve të imam Sádikut. I lutem All'llahut të Lartësuar të më falë të gjitha shkarjet e gabimet që mund të ketë bërë lapsi.*

*Gjithashtu, i lutem të më lejojë që qëllimi im të mos jetë përzier me gjëra nga të cilat Ai nuk është i kënaqur.*

*Gjithashtu, shpresoj prej zotërisë tim, Ebù Abdil'lahit (Paqja qoftë mbi të!) të më mbulojë mua me nderimin e pranimit të kësaj dhurate, të cilën unë e ofroj pranë pozitës së tij të nderuar e të respektuar, pasi dhuratat janë sipas mundësisë që ka dhuruesi.*

*Falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm Atij, që i kthen gjërat ashtu siç i ka bërë në fillim.*

Imam Xhafer Sadiku (paqja qoftë mbi të!)..... *Muhamed Husejn  
Mudhaffar*

*Paqja e shpëtimiti i All'lahut qoftë mbi më të mirin e robëve,  
Muhammed Mustafasë dhe mbi degët e tij të mira e të  
lavdishme!*

\* \* \*



Imam Xhafer Sadiku (paqja çoftë mbi tël)..... *Muhamed Husejn*  
*Mudhaffar*



Imam Xhafer Sadiku (paqja goftë mbi tël)..... *Muhamed Husejn  
Mudhaffar*

الإمام الصادقُ (عليه السلام)

مؤلف: العلامة الشيخ محمد الحسين المظفر



*Shoqata  
Filadi*

الترجمة الى اللغة الألبانية: الحاج سليم اصطافا

تيرانا: 2011

نام کتاب: الإمام الصَّادِق (عليه السلام)

نویسنده: العلامة الشيخ مُحَمَّدِ الْحُسَيْنِ الْمُظَفَّر

ترجمه به زبان آلبانی: حاجی سلیم اصطافا

زیر نظر: حجة الاسلام و المسلمین محمد رضا حاج خضر

ویرایش: پریدا کولا

مقابله: وُلْنَتْ مَرْيَا

صفحه بندی: کوزتا لاپری

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2011

با همکاری مرکز بین المللی تبلیغ



